

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

Aleks Buda

**SHKRIME
HISTORIKE**

2

1875
1876
1877
1878
1879
1880
1881
1882
1883
1884
1885
1886
1887
1888
1889
1890
1891
1892
1893
1894
1895
1896
1897
1898
1899
1900

948.65


388


AKADEMIA E SHKENCAVE E R P S TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

Aleks Buda

SHKRIME HISTORIKE

2





LËVIZJA KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET 30-70 TË SHEK. XIX*

1) KRYENGRITJET ANTIOSMANE NË VITET 30-40¹

Kryengritjet popullore të vitit 1833

Reformat centralizuese të qeverisë osmane, të cilat u zbatuan menjëherë në Shqipëri me dërgimin e nëpunësve civilë dhe ushtarakë, hasën një qëndresë individuale e kolektive, që filloi me moszbatimin e urdhrave dhe që u shndërrua në kryengritje të armatosura.

Pas dy kryengritjeve lokale që shpërthyen në fillim të vitit 1833 në Kolonjë dhe në Dibër dhe u shtypën, një shtrirje të gjerë, që nuk ishte arritur në periudhat e mëparshme, mori kryengritja në zonën Berat-Vlorë-Delvinë-Çamëri.

Në fillim të korrikut 1833 banorët e krahinës së Tepelenës ngritën krye dhe shtinë në dorë qytetin e Tepelenës. Kryengritja e udhëhequr nga Balil Nesho u shtri në krahinat e Gjirokastrës dhe të Delvinës. Kundër saj u nisën forca të

* Redaktimi është bërë nga St. Pollo. Ky punim është nxjerrë nga teksti i Historisë së Shqipërisë, vëll. 2, Tiranë, 1984, f. 117-177 dhe është pjesë e kreut të dytë të këtij teksti.

1 Në këtë pjesë është bashkautor P. Thëngjilli.

shumta osmane të komanduara nga sundimtari i ri Emin Pasha. Shumica e kryengritësve u vendos në qafën e Peshkëpisë, ndërsa pjesa tjetër, e organizuar në çeta të vogla, u vendos gjatë rrugës për në Peshkëpi. Goditjet e këtyre çetave dhe dezertimi i shumë ushtarëve shqiptarë që ishin rekrutuar me forcë, e vështirësuan gjendjen e qeveritarit osman. Por këtij i erdhi në ndihmë peshkopi ortodoks i Drinopojës (Gjirokastrës), i cili, duke njohur mirë pozicionet e kryengritësve, i kaloi forcat turke nëpër një grykë tjetër. Të papërgatitur për këtë sulm të befasisëm, kryengritësit që luftuan me trimëri, pasi lanë shumë të vrarë, u tërhoqën në fshatin Luzat. Këtu Emin Pasha pësoi një goditje të rëndë, që përfundoi me shpartallimin e trupave osmane.

Të nxitur nga kjo fitore, në kryengritje u hodhën masat popullore të Beratit e të Vlorës. Ajo nisi këtu si një kryengritje fshatare, por brenda një kohe të shkurtër gjeti mbështetje të fortë te qytetarët e Beratit, që rrethuan Kështjellën.

Kryengritja përfshiu krahinat e Tomoricës, të Skraparit dhe të Kurveleshit. Një pjesë e kryengritësve u shkuan në ndihmë rrethuesve të Kështjellës së Beratit, kurse pjesa tjetër zuri rrugët e grykat nga pritej të vinte ushtria turke.

Rrezja e kryengritjes u shtri në krahinat e Delvinës dhe të Çamërisë. Jehona e saj u ndie edhe në Shqipërinë e Mesme. Me kërkesën e popullsisë së Elbasanit, një pjesë e kryengritësve shkoi atje për të ndihmuar në luftën kundër administratës osmane të qytetit.

Në këto rrethana Porta e Lartë e largoi Emin Pashën nga Shqipëria e Jugut, duke menduar se me këtë veprim do të shpërndaheshin kryengritësit. Por ndodhi e kundërta.

Nga mesi i shtatorit nën goditjet e fuqishme të kryengritësve ra Kështjella e Beratit. Në qytetin e çliruar u mbledhën në kuvend përfaqësues nga të gjitha krahinat kryengritëse, të cilët miratuan dy kërkesa themelore: së pari, që drejtimi i krahinave kryengritëse t'u ngarkohej shqiptarëve dhe së dyti, që detyrimet e masave popullore ndaj shtetit të zbrisnin në masën që paguanin, kur në krye të sanxhakut të Vlorës, i cili përfshinte edhe Beratin, kishte qenë sunduesi feudal shqiptar Ahmet Kurt Pasha.

Ndonëse këto kërkesa binin në kundërshtim me politikën e re të Portës së Lartë, qeveritarët osmanë, përpara presionit

gjithnjë më të madh të kryengritësve, u detyruan të hiqnin dorë përkohësisht nga rekrutimi i ushtarëve, të shpallnin amnistinë dhe të lejonin të vendoseshin shqiptarë si myteselimë e mydyrë në kazatë e Beratit, të Vlorës, të Tepelenës, të Gjirokastrës dhe të Përmetit dhe si komandantë në garnizonet e kështjellave të Beratit, të Gjirokastrës etj.

Kjo ishte një fitore e rëndësishme e kryengritjes, por jo e plotë. Politikisht të paformuara dhe me një udhëheqje pa përvojë, forcat e armatosura popullore u shpërndanë me besimin se do të realizoheshin të gjitha kërkesat.

Po atë vit, kryengritjet popullore përfshinë edhe Shqipërinë e Veriut. Vatra kryesore e tyre u bë Shkodra qyteti më i zhvilluar i vendit.

Zbatimi i reformës ushtarake dhe abuzimet e grabitjes e administratës së re shkaktuan edhe këtu një pakënaqësi të përgjithshme. Më 10 prill të vitit 1833 në tregun e Shkodrës u dha kushtimi për mbylljen e dyqaneve. Rreth 4000 veta të armatosur nga popullsia e qytetit dhe nga malësorët përreth zunë sheshin e qytetit. Një delegacion kërkoi nga veziri që të hiqte dorë nga zbatimi i reformave, nga dhuna e nga grabitjet dhe të vendoseshin rregullat që kishin qenë në fuqi në kohën e sundimit të Mustafa Pashë Bushatit. Duke parë karakterin serioz të revoltës dhe për të fituar kohë, mytesarifi Ali Namik Pasha premtoi se do të merrte parasysh kërkesat e popullsisë. Ndërkohë ai mori masa përforcuese. Më 7 gusht 1833 dërgoi një repart ushtarësh në tregun e qytetit për ta shtënë atë në dorë. Përleshje të ashpra u zhvilluan midis forcave osmane dhe njërive popullore kryengritëse.

Të nesërmen u organizua një kuvend me përfaqësuesit e lagjeve të qytetit. Kuvendi zgjodhi një Këshill të Përkohshëm, i cili riorganizoi forcat vullnetare dhe ngarkoi një delegacion të shkonte në Stamboll për t'u ankuar në emër të popullsisë së Shkodrës kundër qeveritarit të qytetit.

Gjatë kohës që pritej përgjigjja nga Stambolli Ali Namik Pasha u orvat të shtypte me forcën e armëve lëvizjen popullore, duke thirrur në ndihmë edhe trupat që kishte mbledhur i biri në Ohër dhe në Elbasan. Mirëpo këto orvatje dështuan para qëndresës së forcave popullore shkodrane, trupat e tij u thyen e u tërhoqën me disfatë.

Vonesa e përgjigjes së Portës së Lartë ua bëri të qartë

kryengritësve se kërkesat e tyre mund të realizoheshin vetëm me luftë e në bashkëpunim me krahinat e tjera të vendit. Përveç bashkëpunimit me malësorët e krahinave përreth qytetit të Shkodrës, u bënë përpjekje për t'u lidhur me popullsinë e Elbasanit. Një delegacion i tyre shkoi në Elbasan, ku banorët e qytetit, të ndihmuar edhe nga vullnetarët e ardhur nga Berati, mbanin të bllokuar qeveritarin e huaj.

Lëvizjet kryengritëse kishin përfshirë kështu krahina të ndryshme të vendit nga Shkodra deri në Çamëri. Porta e Lartë u detyrua të pushonte nga puna Ali Namik Pashën, të pezullonte përkohësisht zbatimin e reformave dhe të premtonte pagimin e dëmeve që ishin shkaktuar gjatë luftimeve.

Përpjekjet për organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme (1834-1835)

Kryengritjet popullore në jug e në veri, me gjithë shtrirjen e gjerë të tyre, nuk arritën të vendosnin lidhje midis tyre dhe të siguronin qeverisjen e tokave shqiptare nga nëpunës vendas. Nga ana tjetër, pasi zgjidhi konfliktin me Egjiptin, Porta e Lartë u orvat përsëri të zbatonte me forcë reformat. Për këto arsye lëvizja kryengritëse filloi përsëri.

Përvoja luftarake e vitit të kaluar u tregoi udhëheqësve të kryengritjeve të veçanta në Toskëri e në Gegëri se rezultatet do të arriheshin në rast se do të organizohej një kryengritje e përgjithshme me një udhëheqje të vetme. Për këtë qëllim, gjatë verës së vitit 1834, u shkëmbyen mendime midis përfaqësuesve të krahinave të ndryshme të vendit, u vendos të organizohej një kryengritje e tillë dhe u hartua edhe një plan i përgjithshëm operativ. Sipas këtij plani, me të rënë Kështjella e Beratit në duart e kryengritësve, gjysma e tyre, së bashku me forcat kryengritëse të Kavajës, të Tiranës e të Mirditës dhe me popullsinë e Shkodrës do të sulmonin trupat e qeveritarit të Shkodrës, kurse gjysma tjetër, së bashku me kryengritësit e sanxhakut të Delvinës do të sulmonte forcat e Mahmut pashës së Janinës. Ky ishte një hap i rëndësishëm që bënin krerët e Shqipërisë. Ata bashkoheshin në një lidhje ushtarake mbarëshqiptare dhe merrnin në duart e tyre nismën për të vepruar bashkërisht.

Kryengritjen e filloi popullsia e qytetit të Beratit, e cila rrëmbeu armët për të mbrojtur nga autoritetet osmane disa ushtarë shqiptarë, të cilët kishin ardhur me leje e nuk dëshironin të ktheheshin në shërbimin ushtarak. Kryengritësit mbyllën qeveritë në kështjellë dhe ftuan udhëheqësin e njohur të kryengritjeve të mëparshme, Tafil Buzin, për të drejtuar veprimet ushtarake. Ai mbërriti në Berat dhe brenda një kohe të shkurtër rreth tij u grumbulluan 10 000 vullnetarë. Kryengritësit futën në dorë magazinat shtetërore të drithit, të cilin ia shpërndanë popullsisë kryengritëse.

Kryengritja u përhap shumë shpejt në krahinat e Vlorës, të Tepelenës, të Skraparit, të Tomoricës, të Mallakastrës dhe të Dishnicës. Ajo arriti në përgjithësi shtrirjen e vitit të kaluar, gjë që dëshmonte për lidhje të forta ndihme dhe bashkëpunimi midis popullsisë së këtyre krahinave dhe për një ngritje të ndërgjegjes politike.

Përfaqësuesit e shtatë krahinave, të mbledhur në një kuvend në Berat, vendosën formimin e një besëlidhjeje politike. Besëlidhjen e drejtonte një pleqësi, e cila, si organ drejtues, bëri një ndarje pune midis anëtarëve të saj. Kryetar u zgjodh Abaz bej Lushnja nga familja e Ngurzajve, kurse Tafil Buzi u ngarkua me drejtimin e veprimeve luftarake dhe për lidhjet me botën e jashtme e sidomos me Mehmet Aliun e Egjiptit. Ky i fundit interesohet gjallërisht për kryengritjet në Shqipëri, sepse i konsideronte si një faktor të rëndësishëm për dobësimin e fuqisë së Perandorisë Osmane me të cilën ishte prej kohësh në konflikt. Besëlidhja nuk kishte vetëm karakter ushtarak ndërkrahinor, por ishte edhe organ qeverisës i dalë nga lufta për të zëvendësuar administratën osmane. Udhëheqja e Besëlidhjes përbëhej nga krerë feudalë, nga përfaqësues të borgjezisë dhe të fshatarësisë.

Në emër të kryengritësve pleqësia i paraqiti qeveritarit osman të sanxhakut, Hamdi Pashës, që kishte zëvendësuar Emin Pashën, kërkesat për të përjashtuar krahinat e kryengritësve nga zbatimi i reformave centralizuese dhe për t'u njohur atyre një qeverisje autonome. Kërkesat e pleqësisë nuk u morën parasysh. Kjo i dha vrull më të madh kryengritjes. Në Besëlidhje hynë edhe krahinat e Sulovës dhe të Vërçës.

Nga mesi i dhjetorit 1834, pas dy muaj lufte, Kështjella e Beratit u dorëzua. Aty u vendos një garnizon i ri, i përbërë

nga 100 ushtarë, që përfaqësonin në mënyrë të barabartë të nëntë krahinat e Besëlidhjes. Komandantët e forcave ushtarake osmane të qytetit u zëvendësuan me kryengritës të dalluar për trimëri. U bë kështu hapi i parë për sigurimin e vetëqeverisjes. Por plani i përgjithshëm operativ i kryengritjes nuk u zbatua më tej, sepse Porta e Lartë kishte marrë ndërkohë një varg masash për ta penguar realizimin e tij. Ajo shpejtoi t'u premtonte udhëheqësve të esnafëve që ishin bashkuar me lëvizjen se do të mernte parasysh kërkesat e tyre.

Nga ana tjetër, qeveritari i Shkodrës Hafiz Pasha kishte mundur të përforconte garnizonin e Kështjellës së Durrësit dhe të qytetit të Kavajës me një sasi të konsiderueshme topash e municionesh. Ai thirri në Shkodër mjaft pashallarë e bejlerë, që kishin marrë pjesë në hartimin e planit operativ, të cilëve u premtoi se do të hiqte dorë nga zbatimi i reformave centralizuese. Këto masa shkaktuan lëkundje te pjesëmarrësit e pavendosur të kryengritjes dhe përçarjen e dobësimin e saj.

Në këto kushte, forcat kryengritëse pas marrjes së Kështjellës së Beratit nuk nisën marshimin drejt Shkodrës dhe Janinës, ndërsa popullsia e Shkodrës nuk u ngrit kundër sundimtarëve osmanë të qytetit.

Në ditët e para të janarit 1835 Pleqësia e Beratit, duke u besuar premtimeve të Hamdi Pashës, që miratonte ndryshimet e bëra në administratën lokale, nënshkroi një marrëveshje për shpërndarjen e forcave kryengritëse. Por, sapo qeveritari osman filloi ta shkelte marrëveshjen, kryengritja rifilloi e udhëhequr nga Tafil Buzi, i cili iu afrua me forcat popullore Janinës. Tafil Buzi përhapi një shpallje, me të cilën u bënte thirrje shqiptarëve të ngjeshnin armët për çlirimin e atdheut të tyre. Kërkesat kryesore ishin dy: dëbimi i nëpunësve dhe ushtarëve turq nga territoret shqiptare dhe zbritja e taksave shtetërore në masën që kishin qenë në kohët e mëparshme. Shpallja e Tafil Buzit ishte një nga proklamatat e para për çlirimin e atdheut. Tafil Buzi, në emër të kryengritësve, i dërgoi edhe një mesazh Mehmet Aliut të Egjiptit, me të cilin i kërkonte përkrahjen e tij.

Jehona që gjeti shpallja brenda në vend dhe kërkesa e ndihmës së Mehmet Aliut e shqetësuan qeverinë osmane, e

cila, krahas masave diplomatike për t'ua prerë ndihmën e Mehmet Aliut, dërgoi kundër kryengritësve forca të shumta ushtarake. Pas një qëndrese të ashpër e të gjatë, kryengritësit nuk ishin më në gjendje t'i bënin ballë armikut. Më 2 maj 1835 Tafil Buzi u detyrua të pranonte amnistinë që i propozoi vali i Rumelisë dhe të hiqte dorë nga lufta.

Po atë muaj një kryengritje e re shpërtheu në krahinën e Myzeqesë. Qindra fshatarë nën udhëheqjen e Alush bej Frakullës vunë dorë mbi çifligjet shtetërore dhe i shpallën pronë të tyre. Kryengritja përfshiu edhe krahinat e Mallakastrës, të Vlorës e të Tepelenës. Numri i kryengritësve arriti në 7000 veta. Me kryepleqtë e krahinave kryengritëse u organizua një kuvend në fshatin Portëzë të Fierit, ku u formua një Besëlidhje e re. Ajo do të kishte një ushtri të përhershme me rrogë. Shpenzimet për mbajtjen e ushtrisë do të përballloheshin prej të ardhurave të çifligjeve shtetërore. Krahinat e besëlidhura do të administroheshin prej kryepleqve vendas dhe vetëm këta do të kishin të bënin, në emër të Besëlidhjes, me pushtetin qendror për të dorëzuar detyrimet ndaj shtetit.

Mirëpo kryengritja e Myzeqesë nuk pati sukses për shkak të veprimtarisë përçarëse të qeveritarëve osmanë dhe sidomos të bejlerëve dhe të agallarëve, të cilët, kur Porta e Lartë u premtoi se nuk do t'i prekte interesat e tyre, lidhën me të një marrëveshje bindjeje dhe nënshtrimi.

Me shtypjen e kryengritjeve popullore në Shqipërinë e Jugut qeveritari i Shkodrës Hafiz Pasha e gjykoi çastin e përshtatshëm për të shkelur premtimet dhe për të rifilluar zbatimin e reformave. Ai bëri një spastrim të mëtejshëm të aparatit administrativ dhe ushtarak duke larguar vendasit e padëshiruar, ngriti taksat doganore nga 2 deri në 5 për qind, caktoi taksa të reja «të jashtëzakonshme» dhe u orvat të zbatonte reformën ushtarake. Për t'i çuar deri në fund këto masa qeveria osmane i dërgoi në ndihmë një ushtri prej 10 000 vetash.

Popullsia e Shkodrës nuk pranoi të zbatonte urdhrat e Hafiz Pashës dhe kundërshtoi të gjitha orvatjet e tij për të zbatuar reformat. Filloi kështu një kryengritje e re e madhe me qendër Shkodrën.

Më 18 maj qeveritari turk pushtoi tregun, kurse regimentet e ushtrisë së rregullt zunë kodrat rreth qytetit. Po atë

ditë ai urdhëroi të arrestohej udhëheqësi i esnafëve Hamza Kazazi. Mirëpo krisma e pushkës së tij ngriti në këmbë gjithë qytetin. Luftimet atë ditë zgjatën 6 orë dhe përfunduan me tërheqjen e forcave qeveritare, pasi lanë shumë të vrarë e të plagosur.

Qëndresën e qytetit e udhëhiqte Këshilli i Ri i Përkohshëm, ku bënë pjesë përfaqësues të borgjezisë tregtare (Haxhi Abdurrahmani e Kasem Hoxha), të zejtarëve (Hamza Kazazi e Dasho Shkreli), të çifligarëve (Hysen bej Bushati, Ali bej Bajrami dhe Jusuf beu) dhe një përfaqësues i klerit të ulët (Haxhi Idrizi) Hamza Kazazi u ngarkua me drejtimin e veprimeve ushtarake.

Luftimet e Shkodrës vazhduan disa ditë. Përpara vendosmërisë së kryengritësve, Hafiz Pasha u detyrua të fillonte bisedimet me ta. Përfaqësuesit e kryengritësve kërkuan largimin e tij, dorëzimin e Kalasë së Shkodrës një shqiptari dhe heqjen e të gjitha taksave të vendosura në kuadrin e reformave centralizuese.

Kur qeveria osmane e hodhi poshtë këtë kërkesë, më 24 maj, mbi 10 000 kryengritës sulmuan ushtarët osmanë. Me qytetarët shkodranë luftuan vullnetarë nga Postriba, nga Gjakova e nga Peja. Luftimet vazhduan me ndërprerje disa javë.

Ndërkohë me kryengritësit u bashkuan Malësia e Mbi-shkodrës, Ulqini dhe Mirdita. Fitoret e arritura nga kryengritësit e vështirësuan shumë pozitën e qeveritarit osman. Hafiz Pasha kërkoi ndihmën e forcave ushtarake të vladikës (peshkopit sundimtar) të Malit të Zi, duke i premtuar atij se do t'i lëshonte toka në veriperëndim të liqenit të Shkodrës. Megjithëse u arriti marrëveshja, vladika i Malit të Zi nuk pati guximin ta vinte atë në jetë. Porta e Lartë ngarkoi atëherë valiun e Rumelisë të grumbullonte forca për të shtypur kryengritjen.

Forcat e valiut u thyen që në ndeshjen e parë që u zhvillua më 14 korrik 1835. Pas kësaj fitoreje kryengritja u shtri në gjithë Shqipërinë Veriore. Fitoret e reja të forcave popullore shqiptare e detyruan Portën e Lartë të bllokonte brigjet e Shqipërisë dhe të niste një ushtri të rregullt prej 30 000 ushtarësh, të pajisur me artileri nën komandën e sekretarit të sulltanit, Vasaf efendiut, dhe të valiut të Rumelisë.

Në pritje të këtyre forcave vali i Rumelisë hyri në bi-

sedime të gjata me kryengritësit për të menjanuar ndeshjet e armatosura. Nismën për bisedime e përkrahu edhe komandanti i kështjellës, së cilës po i mbaroheshin rezervat ushqimore. Njëkohësisht kryengritësve iu dorëzua edhe një dokument i rremë me anën e të cilit sulltani gjoja urdhëronte pranimin e kërkesave të tyre.

Një pjesë e kryengritësve filloi të largohej nga fronti. Pjesa tjetër, e udhëhequr nga Haxhi Idrizi, e kuptoi kurthin dhe e vazhdoi luftën.

Në ndeshjen me ushtarët e shumtë osmanë, më 1 shtator, në afërsi të Lezhës, forcat popullore u detyruan të tërhiqeshin drejt Shkodrës. Nga kjo gjendje e vështirë ata nuk mundën t'i nxirrnin as forcat popullore dibrane e matjane, që u përpoqën të godisnin prapa krahëve ushtritë osmane. Këto, të nisura nga Lezha e Ulqini, mbërritën në Shkodër, më 18 shtator 1835. Pjesa më e vendosur e kryengritësve u largua drejt zonave malore.

Për të mos e acaruar më tej gjendjen, Porta u detyrua të pranonte disa kërkesa të kryengritësve; largoi Hafiz Pashën nga posti i qeveritarit të Shkodrës dhe zëvendësoi shërbimin ushtarak me një taksë në të holla.

Edhe pse kryengritjet e viteve 1834-1835 përfshinë një pjesë të mirë të trëvave të Shqipërisë ato nuk arritën të shndërrroheshin në një kryengritje të përgjithshme me një udhëheqje të vetme e me veprime të bashkërenduara. Arsyet duhen kërkuar jo vetëm në epërsinë ushtarake turke, por edhe në papjekurinë politike të kryengritësve dhe sidomos në lëkundjet e në tradhtinë e krerëve feudalë e të bajraktarëve që braktisnin menjëherë frontin, kur Porta premtonte të kënaqte interesat e tyre partikulariste.

Kryengritjet popullore të Shqipërisë së Jugut në vitet 1836-1839

Shtypja e kryengritjeve të viteve 1834-1835 nuk e qetësoi aspak gjendjen në vend. Porta e Lartë ishte e vendosur të zbatonte reformat dhe priste rastin e volitshëm për të shkelur premtimet e dhëna. Por edhe masat popullore të Shqi-

përisë ishin te vendosura të mos pranonin barrën e rëndë që sillte me vete zbatimi i këtyre reformave. Taktika e qeverisë osmane për të mos vepruar njëherësh në të gjitha krahinat, duke iu shmangur kështu një kundërshtimi të përgjithshëm dhe nga ana tjetër lëkundjet e bashkëpunimi i krerëve feudalë me sundimtarët e huaj bënë që kryengritjet popullore, të cilat nuk reshtën, të kishin tani një karakter të kufizuar lokal, e, si pasojë, të shtypeshin më lehtë nga ushtria osmane.

Në verën e vitit 1836 shpërtheu kryengritja në sanxhakun e Vlorës e udhëhequr përsëri nga Tafil Buzi, por ajo nuk zgjati shumë e u shpërnda për të rifilluar një vit më vonë me një shtrirje më të gjerë, sidomos në fushën e Myzeqesë, kundër orvatjeve të Emin Pashës për të regjistruar nizamë dhe për të çarmatosur popullsinë. Në ditët e para të qershorit 1837 kryengritësit e udhëhequr nga Alush bej Frakulla u ndeshën me forcat osmane përpara qytetit të Beratit dhe i thyen ato. I shoqëruar nga një ushtri e rregullt prej 5000 ushtarësh, Emin Pasha mbërriti në Berat dhe iu drejtua Myzeqesë. Në një përleshje të pabarabartë të zhvilluar në Frakull kryengritësit nuk i përballuan dot trupat osmane. Alush bej Frakulla me 150 veta ranë rob dhe u dërguan në Stamboll, ku u dënuan me punë të detyruar. Megjithëse kryengritja u shtyp, Emin Pasha nuk guxoi për një kohë të zbatonte reformën ushtarake.

Në ditët e para të muajit gusht të vitit 1839 filloi një kryengritje e re në qytetin e Beratit. Qindra vetë sulmuan selinë e qeveritarit të qytetit, i cili mundi të shpëtonte duke u mbyllur në kala. Kryengritja përfshiu të gjitha krahinat e sanxhakut të Vlorës. Në një mbledhje që u bë në qytetin e Beratit përfaqësuesit e kryengritësve, në emër të të gjithë Shqipërisë së Jugut, i paraqitën sulltanit të ri, Abdyl Mexhidit, kërkesën për vendosjen e administratës civile dhe ushtarake shqiptare në të gjitha hallkat, duke propozuar si qeveritar të përgjithshëm nipin e Ali Pashë Tepelenës, Ismail Pashën.

Kur kryengritësit, në shtator të vitit 1839, shtinë në dorë Kështjellën e Beratit, Porta e Lartë u detyrua të shpallte përsëri se hiqte dorë nga zbatimi i reformave.

Kryengritjet e Kosovës, të Dibrës dhe të Pollogut në vitet 1837-1845

Një varg kryengritjesh kundërosmane të drejtuara ndaj administratës së re dhe politikës së saj të shtypjes e të shfrytëzimit përfshiu në gjysmën e dytë të viteve 30 dhe në fillim të viteve 40 qytetet dhe krahinat e Kosovës dhe të Dibrës.

Në verën e vitit 1837 kryengritja që filloi në Gjakovë u përhap shumë shpejt në gjithë nahijen si edhe në krahinat e Hasit deri në bregun e djathtë të Drinit. Kryengritësit shpartalluan forcat qeveritare, shtinë në dorë qytetin dhe pasi mënjantuan krerët e esnafëve, të cilët kërkonin të siguronin vetëm pozitën e tyre të privilegjuar që gëzonin para reformave, shpallën vetëqeverisjen e krahinave të tyre. Kjo ishte një fitore e rëndësishme, por e arritur në një zonë relativisht të kufizuar. Forca të shumta osmane, të përkrahura nga krerë tradhtarë vendas, e shtypën lëvizjen brenda një kohe të shkurtër.

Ndryshe u zhvilluan ngjarjen në krahinën e Dibrës e të Prizrenit. Në Dibër kryengritja filloi në vjeshtën e vitit 1838. Tetë mijë kryengritës rrethuan qytetin. Kuvendi i mbledhur në fshatin Krifcë ia paraqiti të dërguarve të valiut të Rumelisë kërkesat për zëvendësimin e myteselimit të huaj me një shqiptar dhe garancinë për të mos dënuar asnjë pjesëmarrës në kryengritje. Vendosmëria e kryengritësve e detyroi Portën e Lartë të pranonte kërkesat e tyre. Kështu në krahinën e Dibrës u ruajt tradita e qeverisjes prej nëpunësve vendas.

Nga mesi i shtatorit të vitit 1839 banorët e Prizrenit rrëmbyen armët dhe e detyruan qeveritarin osman Ismet Pashën të largohej nga qyteti. Një delegacion i popullsisë kryengritëse i kërkoi Portës së Lartë që të hiqeshin taksat e reja, t'u jepej fund grabitjeve dhe t'i njihej sanxhakut një qeverisje autonome si dhe shkëputja nga vartësia e drejtpërdrejtë ushtarake e myshirit të Rumelisë. Qeveria e Stambollit pranoi një pjesë të këtyre kërkesave. Në sanxhakun e Prizrenit u ndërpre zbatimi i reformave centralizuese.

Ndonëse dekreti i gjylhanesë u shpall në Stamboll, më 1839, qeveria osmane nuk guxoi ta shpallte atë menjëherë në Shqipëri, për t'iu shmangur acarimit të mëtejshëm të gjendjes. Ajo priti disa vjet dhe vetëm më 1843, pasi kishte marrë

masat paraprake, e shpalli zyrtarisht Tanzimatin në Kosovë, duke bërë hapa të mëtejshëm për zbatimin tërësor të reformave. Kjo shkaktoi një valë të re kryengritjesh, që morën përpjesëtime të gjera ndërkrahinore, duke pasur si vatra kryesore gjithmonë qytetet.

Në verën e vitit 1843 ngritën krye banorët e Prizrenit, të cilët i dëbuan nëpunësit e rinj turq. Atë e pasuan kryengritjet në Prishtinë e në Gjakovë. Ushtria osmane e përforcuar kundërveproi menjëherë dhe nuk e pati vështirë t'i shtyp-te këto lëvizje që mbetën të kufizuara e me karakter lokal.

Veprimet e ushtrisë, që u shoqëruan me terror e grabitje, e rritën pakënaqësinë e masave popullore, të cilat pritnin rastin e volitshëm për të ngritur përsëri krye. Agjitorë të ndryshëm qarkullonin nëpër krahina për të organizuar kryengritjen e re, duke i bërë thirrje popullit të përgatitej për luftë. Të tjerë ishin dërguar në krahinat fqinje për të siguruar mbështetjen e tyre, duke u vënë në dukje se «janë vëllezër».

Për t'i dalë përpara rrezikut të shpërthimit të ri të urrejtjes popullore, në fillim të vitit 1844 autoritetet osmane morën masa të ngutshme. Ato përqendruan forca të mëdha ushtarake në pika të ndryshme e sidomos në Manastir, ku gjendja ishte më e nderë.

Në fund të marsit 1844 shpërtheu kryengritja e re. Ajo e gjeti truallin e përgatitur dhe mori qysh në fillim përpjesëtime shumë të gjera. Kryengritja u shtri në Rrafshin e Dukagjinit, në rrethin e Prishtinës si edhe më tej në rrethet e Shkupit, të Kumanovës dhe në krahinën e Pollogut (Tetovë e Gostivar). Pasi çliruan një varg qytetesh, kryengritësit iu drejtuan pastaj Manastirit. Forcat e kryengritësve u rritën me shpejtësi dhe arritën në rreth 10 mijë veta. Në ballë të tyre u vu Dervish Cara, një nga udhëheqësit e vegjël ushtarakë të Shkupit.

Duke luftuar kundër administratës së re grabitqare osmane, kryengritësit, ashtu si ata të krahinave të tjera, kërkonin të qeveriseshin nga bashkëpunëtorët e tyre dhe të çliroheshin nga shtypja e nga shfrytëzimi i egër. Sipas disa burimeve ata i kërkuan Portës së Lartë njohjen për trevat shqiptare të po atyre të drejtave që gëzonte Serbia, d.m.th. autonominë.

Fitoret e rëndësishme të kryengritjes së Kosovës të arritura në një varg betejash me armiqtë ngjallën gëzim e shpresë në krahinat e tjera të vendit, prandaj qeveria osmane mori

masa për të penguar, në radhë të parë, përhapjen e mëtejshme të lëvizjes e shndërrimin e saj në një kryengritje të përgjithshme. Ajo u orvat t'i bindte kryengritësit që të dorëzonin armët, por pa sukses. Atëherë ajo solli forca të reja të mëdha, të cilat arritën t'i thyenin kryengritësit pranë fshatit Kapllan, duke e ndaluar marshimin e tyre drejt Manastirit. Gjatë muajit maj ushtritë osmane e vazhduan sulmin dhe zhvilluan luftime të ashpra me kryengritësit në rrethet e Shkupit e të Tetovës dhe pasi e thyen qëndresën e tyre iu drejtuan vatrave të tjera të kryengritjes në Kosovë, të cilat gjithashtu i mposhtën.

Shtypja e kryengritjes u shoqërua me plaçkitje e me djegie fshatrash dhe me arrestimin e një numri të madh luftëtarësh; një pjesë e mirë u dërguan në Stamboll, ku u hap kundër tyre një proces i madh gjyqësor.

Autoritetet osmane e shfrytëzuan fitoren e korrur në Kosovë për të nënshtruar me forcë edhe Dibrën, e cila i kishte kundërshtuar masat e reja qeveritare. Malësorët e Dibrës, të mbledhur në Kuvend, kishin dhënë besën për mbrojtjen e lirive që kishin gëzuar deri atëherë. Edhe ata, si kosovarët, iu drejtuan vëllezërve të tyre në jug, midis të cilëve Porta e Lartë po mblidhte reparte të çrregullta për t'i nisur kundër Dibrës, që të mos merrnin pjesë në këtë ekspeditë. Malësorët dibranë të udhëhequr nga Cen Leka, me të cilët u bashkuan edhe matjanët gjatë muajit nëntor 1844, u zunë rrugën ushtrive turke të komanduara nga Hajredin Pasha, duke u rreshtuar gjatë lumit Drin. Në përleshjen, që u zhvillua në fshatin Gjoricë, luftëtarët dibranë u bënë ballë me heroizëm sulmeve të ushtrisë. Duke pasur epërsi numerike e teknike, ushtria osmane, pas luftimesh të përgjakshme, i detyroi më në fund kryengritësit të tërhiqeshin nga pozitat e tyre. Ata lanë në fushën e betejës qindra të vrarë e të plagosur. Dhjetëra fshatra u dogjën nga ushtria turke. Duke vënë në dukje heroizmin e dibranëve në luftime, përfaqësuesi francez në Janinë shkruante, më 14 dhjetor 1844 se «është luftuar pëllëmbë për pëllëmbë dhe me një vendosmëri të atillë, saqë edhe gratë e fëmijët qenë rreshtuar me luftëtarët».

Për t'i shpëtuar terrorit të egër të ekspeditës osmane një pjesë e madhe e popullsisë u detyrua të braktiste shtëpitë e të fshihej në male.

SI:PU: 4516
50491

Lufta dhe heroizmi i dibranëve pati jehonë të gjerë në trevat e tjera shqiptare. Shembullin e tyre e ndoqën në pranverë të vitit 1845 gjakovarët. Rreth 8 mijë malësorë, të udhëhequr nga Binak Alia e Sokol Rama, rrëmbyen armët për të kundërshtuar operacionin e çarmatimit që ndërморën trupat osmane dhe çliruan Gjakovën, por përpara epërsisë së forcave armike kryengritësit edhe kësaj radhe u detyruan më në fund të shpërndaheshin.

Me gjithë fitoret e arritura nga ushtria osmane, qeveritarët e Stambollit, edhe pse e shpallën Tanzimatin, u detyruan ta ndërprisnin edhe për disa vjet zbatimin e sistemit të ri në zonat e kryengritjeve.

Kryengritja e vitit 1847 në Shqipërinë e Jugut

Në Shqipërinë e Jugut, Porta e Lartë e shpalli me bujë Tanzimatin, më 1845, në një ceremoni të organizuar në Janinë. Por kishte vite që vendi po i ndiente pasojat shkatërrimtare të ekspeditave ushtarake dhe të nëpunësve grabitqarë osmanë. Në sanxhakun e Beratit, të formuar rishtazi, që përfshinte dhe krahinat e Vlorës, të Mallakastrës, të Skraparit e të Përmetit me detyrën e mytesarifit u ngarkua Hysen Pashë Vrioni, çifligari më i madh i atyre trevave. Forca të rëndësishme ushtarake, një pjesë e të cilave udhëhiqeshin nga pashai vrionas, filluan të përshkonin vendin duke çarmatosur popullsinë dhe duke nxjerrë me forcë taksa e nizamë. Një vjershëtar i kohës, Demir aga Vlonjati, tregon se sapo afroheshin ekspeditat turke të gjithë njerëzit iknin nga shtëpitë «sikur të kishte rënë murtaja». Zbatimi me dhunë e vrazhdësi i reformave, ndonëse së pari u bë vetëm në disa krahina, e kishte shtuar së tepërmi urrejtjen e masave popullore ndaj sundimtarëve osmanë dhe kishte përgatitur truallin për një kryengritje të re.

Duke e ndier këtë rrezik, qeveritarët osmanë i ftuan krenarët e Toskërisë në Manastir për t'i bindur që të hiqnin dorë nga qëndresa e të pranonin Tanzimatin. Të njëjtën gjë bënë në Janinë me rreth 800 agallarë e koxhabashë të fshatrave si edhe me përfaqësues të parisë së qyteteve e të institucioneve fetare. Zyrtarisht atyre iu dha përgjigje pozitive, por në të

vërtetë, siç doli më vonë, shumica kishte vendosur ta kundërshtonte me të gjitha mjetet sistemin e ri.

Për organizimin më të mirë të qëndresës krerët e Shqipërisë së Jugut u mbledhën në një kuvend në Mesaplik të Vlorës, në qershor 1847. Shumicën dërrmuese në kuvend e përbënin përfaqësuesit e fshatarësisë. Kuvendi u shpreh kundër Tanzimatit dhe vendosi: të mos jepeshin ushtarë, të mos paguheshin taksa të reja dhe të mos pranoheshin administrata e re osmane. Ai mori edhe vendime të tjera me një rëndësi të madhe politike. Kuvendi e shpalli popullin shqiptar, myslimanë e të krishterë, një dhe të pandarë, bëri thirrje, që të gjithë, pa përjashtim, të hidheshin në luftë kundër sundimtarëve osmanë dhe kërkoi që t'u sigurohej jeta, nderi, pasuria, të gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga feja. Kuvendi porositi që forcat e armatosura shqiptare, të cilat do të mblidheshin në krahina të ndryshme, të mos i shkaktonin as dëmin më të vogël popullsisë dhe ushqimi i luftëtarëve të sigurohej nga taksat e vjetra që jepte vendi. Mbi këto baza u formua besëlidhja e përfaqësuesve të Shqipërisë së Jugut, ose, siç u quajt, Lidhja Kombëtare Shqiptare. Lidhja formoi një komitet për drejtimin e veprimtarisë politike dhe ushtarake, në krye të të cilit u zgjodh Zenel agë Gjoleka nga Kurveleshi, i dëgjuar për trimërinë dhe përvojën luftarake që kishte fituar në kryengritjet e viteve 30.

Kur në fillim të korrikut xhelepçinjtë erdhën në Kurvelesh për të mbledhur taksat e bagëtive, ata u pritën me armë nga popullsia. Zenel Gjoleka me 500 luftëtarë u drejtuan kundër Delvinës, qendër e administratës osmane, të cilën e çliruan. Kryengritja përfshiu gjithë Labërinë dhe brenda pak kohësh u përhap edhe në trevën e Çamërisë, të Përmetit dhe sidomos të Mallakastrës, ku fshatarët kryengritës zgjodhën si udhëheqës të tyre Rrapo Hekalin. Në të njëjtën kohë shpërthyen kryengritje në trevat veriore, në rrethet e Elbasanit, të Tiranës, të Matit, të Dibrës, të Plavës e të Gucisë.

Çifligarët vrionas mobilizuan të gjitha forcat e tyre dhe të përkrahur nga reparte ushtarake turke sulmuan Mallakastrën. Një betejë e ashpër që zgjati tri ditë u zhvillua në fshatin Greshicë. Kryengritësit, të cilëve u erdhën në ndihmë fshatarë nga Myzeqeja dhe nga krahina e Vlorës, i shpartalluan forcat armike dhe kapën të gjallë Isuf bej Vrionin dhe të vëllanë

që kryesonin ekspeditën, të cilët i ekzekutuan në Qafën e Sinjës.

Pas kësaj fitoreje kryengritësit, rreth 1000 veta, iu drejtuan Beratit dhe e rrethuan. Pas disa ditë luftimesh qyteti ra në duart e tyre. Kryengritësit u përpoqën të merrnin edhe kështjellën, ku ishin strehuar feudalë vrionas dhe forcat turke, por u detyruan të tërhiqeshin nga zjarri i fortë i artilerisë. Për të mbajtur kalanë të rrethuar, në Berat u grumbulluan forca të reja të ardhura nga krahinat përreth deri nga Danggëllia e Përmetit. Ndërkohë, forcat e shtuara të kryengritësve, të udhëhequra nga Zenel Gjoleka, po korrnin suksese të reja. Pasi shpartalluan një ushtri turke që vinte nga Janina, ata sulmuan Gjirokastrën dhe e rrethuan garnizonin në kala.

E shqetësuar nga këto humbje dhe nga përhapja e gjerë e kryengritjes, qeveria e Stambollit, e cila në fillim mendonte t'i bënte ballë kryengritjes me forcat që kishte në vend, mobilizoi tani trupa të reja, të cilat u përqendruan sidomos në Manastir dhe në Janinë për të asgjësuar vatrat më të rrezikshme të kryengritjes në Jug. Për t'i ardhur në ndihmë garnizonit të rrethuar në Gjirokastrë, u dërgua nga Thesalia një ushtri prej 3000 vetash nën komandën e një feudali shqiptar, Shahin bej Kosturit. Por, që në përpjekjet e para me kryengritësit në jug të Gjirokastrës, forcat turke u thyen.

Fitoret e kryengritësve bënë bujë në Shqipëri dhe jashtë. Jehona e saj u ndie edhe në Kosovë, ku filluan të dukeshin shenjat e një lëvizjeje të re. Nëpunësit turq braktisnin në panik postet e tyre, sapo dëgjonin për afrimin e kryengritësve. Udhëtari anglez E. Spenser, që udhëtonte në këtë kohë nëpër Shqipëri, shkruante se «heroi i ditës kudo është Gjoleka».

Për të siguruar suksesin e plotë të kryengritjes Komiteti i Lidhjes u përpoq të gjente edhe një aleat të jashtëm. Për këtë qëllim ai iu drejtua Greqisë, e cila në këtë kohë i kishte acaruar marrëdhëniet me Stambollin. Qeveria greke tregoi një interesim të veçantë për kryengritjen shqiptare jo vetëm sepse përpiquej t'i shkaktonte vështirësi Turqisë duke nxitur shqiptarët të vazhdonin luftën dhe duke u premtuar ndihma materiale e financiare, por edhe sepse synonte ta vinte kryengritjen shqiptare në shërbim të saj për të realizuar synimet territoriale mbi Shqipërinë e Jugut, që ishin shpallur zyrtarisht qysh më 1844, me të ashtuquajturën «Megali Idea» (Idea e madhe).

Këto qëllime ishin shkaku që bisedimet midis Zenel Gjolekës dhe kryeministrit grek J. Koletis ^{Sig. m. d. ushtarake} nuk dhanë rezultat.

Bisedimet shqiptaro-greke dhe rreziku që mund t'i vinte nga një aleancë e mundshme ushtarake midis kryengritësve dhe Greqisë e shtynë Portën e Lartë të vepronte më me vendosmëri për ta shtruar sa më parë Toskërinë. Sulltani i shpalli «fermanllinj» Zenel Gjolekën dhe pasuesit e tij. Një ushtri prej 15 mijë vetash u nis nga Manastiri në drejtim të Beratit. Pas ndeshjesh paraprake gjatë rrugës Elbasan-Berat me forcat e Rrapo Hekalit, trupat osmane iu afruan Beratit. Garnizoni i rrethuar doli atëherë nga kalaja dhe sulmoi kryengritësit në qytet. Duke u ndodhur midis dy zjarresh dhe përballë fuqive shumë më të mëdha, kryengritësit u tërhoqën nga qyteti në rrethet e tij dhe vazhduan luftën të ndarë në çeta më të vogla e me sulme të befasishme. Ndërkaq Z. Gjoleka dhe shokët e tij, Hodo Nivica dhe Halim Çapari, me 1500 veta mbanin të rrethuara trupat armike në Gjirokastër. Prej këtej, një pjesë e forcave kryengritëse iu drejtuan Janinës. Më 28 gusht 1847, në fshatin Dholani, në verilindje të Janinës, ato sulmuan natën në befasi repartet turke prej afër 5000 vetash, që po shkonin në ndihmë të garnizonit të Gjirokastrës dhe i shpartalluan ato. Pas këtij suksesi të shkëlqyer, për forcat shqiptare ishte e hapur rruga për në Janinë, qendrën e eja-jetit të mbetur pa mbrojtje. Por Z. Gjoleka u detyrua të kthehej në Labëri, ku po drejtoheshin trupat osmane që kishin thyer e kishin shpërndarë kryengritësit në rrethin e Beratit. Ushtria turke la mënjanë grykën e Kuçit, ku kryengritësit kishin zënë pritë dhe hyri në Labëri nga ana e Mesaplikut duke djegur fshatrat Bolenë, Kuç, Kallarat etj., për hakmarrje dhe për të terrorizuar popullsinë. Nga ana tjetër, reparte të reja armike zbarkuan në Himarë, për t'u rënë kryengritësve prapa krahëve. Në këto kushte të vështira Z. Gjoleka u detyrua t'i shpërndante fuqitë e veta. Një pjesë e kryengritësve u ndesh me forcat turke në fshatin Palavli, në fushë të Delvinës. Me gjithë trimërinë që treguan, kryengritësit u thyen me humbje nga zjarri i dendur i ushtrisë osmane.

Me shtypjen e kryengritjes në Shqipërinë e Jugut, trupat turke përdorën në masë terrorin mbi popullsinë duke e vazhduar ekspeditën ndëshkuese edhe gjatë dimrit 1847-1848. Ato mundën të shtinin në dorë udhëheqësit kryesorë të kryengritjes

si Rrapo Hekalin me të vëllanë Hamitin, Tahir Çaparin dhe mbi 1000 luftëtarë të tjerë, të cilët i burgosën dhe i internuan. Rrapo dhe Hamit Hekali vdiqën në burg, ndërsa Z. Gjoleka me një grup besnikësh u tërhoq në Greqi, ku gjeti strehim. Ushtria turke arriti të shuante njëjërën pas tjetrës edhe vatrën e qëndresës në trevat e tjera të vendit.

Qeveria osmane ndërmori atëherë zbatimin e sistemit të ri tanzimatist në Shqipërinë e Jugut.

Kryengritja e 1848-ës shënon një etapë më të lartë të lëvizjeve çlirimtare kundër Tanzimatit si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga shtrirja e organizimi i saj. Ajo dallohet, në radhë të parë, për rolin aktiv të masave fshatare në drejtimin e saj. Kjo kryengritje luajti një rol të rëndësishëm për bashkimin e shqiptarëve si një tërësi me interesa të përbashkëta, pavarësisht nga feja dhe krahina, ashtu siç ishte vendosur në kuvendin e Mesaplikut. Ideja e bashkimit u shpreh edhe në këngët popullore që iu kushtuan kryengritjes. Në një nga këto këngë, poeti popullor i drejtohet Z. Gjolekës me fjalët «sos lëfton për vete, por për gjithë vilajete» dhe vë në dukje se udhëheqësi trim nuk lufton «as për mua, as për ti, por për gjithë Shqipëri». Duke folur për këtë kryengritje, Sami Frashëri vinte në dukje se ajo kërkoi bashkimin e gjithë trojeve shqiptare në një Shqipëri autonome.

Në folklor gjejmë mjaft të dhëna edhe për karakterin shoqëror të kësaj kryengritjeje të drejtuar, ashtu si edhe të tjerat, kundër grabitjes e shfrytëzimit nga shteti osman dhe feudalët e mëdhenj vendas. «Nizam e xhelepe s'ka, është vendi fukara», thuhet në një këngë. Dhe në një memorandum të hartuar nga krerët e lëvizjes, më 15 gusht 1847, kryengritësit vinin në dukje se nuk kishte kush të përkujdesej për «fakir fukaranë».

2) IDEOLOGJËT E PARË TË LËVIZJES KOMBËTARE

Dukuritë e reja politike e shoqërore të kryengritjeve kundërosmane të viteve 30-40 e, në mënyrë të veçantë, kërkesat e tyre për trajtimin e veçantë të Shqipërisë dhe administrimin

e saj nga njerëzit e vendit, krijuan truallin dhe u bënë nxitje për lindjen dhe zhvillimin e ideologjisë së re kombëtare. Shprehësit e parë të shquar të ideve të reja u bënë Naum Veqilharxhi dhe Jeronim de Rada.

Naum Veqilharxhi dhe veprimtaria e tij në vitet 40

Naum Veqilharxhi (1797-1854) lindi në Vithkuq (rrethi i Korçës), që ishte një qytezë me zeje e tregti të zhvilluar e me një popullsi arsimdashëse. Që në moshë të re, para vitit 1806, ai shkoi në Vllahi, ku kishte një koloni të rëndësishme shqiptarësh. Më 1821 Naumi, bashkë me shqiptarë të tjerë, mori pjesë në kryengritjen e madhe popullore që shpërtheu kundër sundimit osman nën udhëheqjen e Tudor Vladimireskut.

Lufta kundër sundimit osman në dhe të huaj ia shtoi dashurinë për vendlindjen. Duke punuar si avokat në Brailë të Rumanisë, ai u njoh me idetë revolucionare dhe u formua si demokrat e iluminist. Këtu ai iu kushtua me mish e me shpirt çështjes së çlirimit kombëtar të atdheut të vet — Shqipërisë.

Naumi, i cili në dokumentet e tij personale në mërgim e cilësonte veten me kombësi shqiptare, kishte besim të patundur te populli i vet, në aftësitë e tij për t'u ndriçuar e për t'u çliruar dhe në të ardhmen e tij më të mirë. Ky besim buronte jo vetëm nga patriotizmi i flaktë i tij dhe nga përvoja e njohuritë filozofike e historike që kishte fituar, por edhe nga realiteti i Shqipërisë, ku kryengritjet çlirimtare kundër sundimit osman pasonin njëra-tjetrën nga jugu në veri.

Si iluminist Naumi arriti në përfundimin se popullit shqiptar të zhytur në padije i duhej patjetër arsimimi në gjuhën amtare si mjet për ngritjen e ndërgjegjes dhe përparimin material e shpirtëror të tij, se pa çlirim kulturor nuk mund të kishte çlirimi politik. «Ka ardhur koha, shkruante ai më 1846, që t'i flakim të gjitha paragjykimet e vjetëruara, ka ardhur koha që të mendohemi më me pjekuri dhe më me guxim të këmbëjmë udhë, duke marrë këtë e tutje si shembull kombet e përparuara mbi tokë... Dhe duke synuar këtu, le të ecim pa u lëkundur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje».

Nevoja për masa të efektshme dhe konkrete në fushën e

arsimit në gjuhën shqipe ishte bërë veçanërisht e theksuar në vitet 40, me shtimin e numrit të shkollave të huaja që filluan të hapeshin në Shqipëri.

Naum Veqilharxhi u bë shprehës i atyre rrethëve patriotike shqiptare brenda e jashtë vendit, të cilat e kuptuan rrezikun e madh që paraqisnin shkollat e huaja për bashkimin e popullit dhe për çlirimin e tij kombëtar dhe ndienë nevojën e ngutshme për të përhapur arsimin në gjuhë amtare. Prandaj ai kërkonte një shkollë të re: shqipe nga gjuha, racionaliste nga përmbajtja dhe masive nga shtrirja. Në kushtet e Shqipërisë së prapambetur rruga drejt këtij arsimi do të fillonte nga abetarja dhe për ta hartuar atë duhej përgatitur alfabeti shqip. Alfabetet latine, greke ose arabe që ishin përdorur deri atëherë në shkrimin e shqipes, pa ndonjë përshtatje të veçantë, jo vetëm nuk jepnin plotësisht të gjithë tingujt e saj, por kishin marrë edhe ngjyrë fetare dhe ishin bërë përgues ndikimesh politike armiqësore. Naum Veqilharxhi mendonte se shqiptarët si komb i veçantë, me gjuhë të veçantë duhej të kishin edhe alfabetin e tyre.

Me alfabetin e ri, që sajoi qysh në vitet 20, duke huajtur edhe elemente nga alfabetet e tjera, ai kishte hartuar disa tekste; por këto, siç duket, për vështirësi teknike e mungesë mjetesh mbeten për dy dhjetëvjeçarë të pabotuara. Më 1844 ai botoi në Rumani «Evetorin» e tij — një abetare e vogël, e poligrafuar, e cila është abetarja e parë e gjuhës shqipe.

Abetarja u shpërnda në krahinat jugore të Shqipërisë, në Korçë, në Përmet, në Berat, në Gjirokastrë etj. Megjithëse alfabeti ishte i vështirë për t'u përvetësuar, abetarja ngjalli entuziazmin e bashkatdhetarëve. Në një letër që i drejtohej autorit nga Korça, më 22 prill 1845, e njoftonin se abetaret i kishin marrë «... me gëzim të madh dhe me kënaqësi». Letra i bënte të ditur se paria e Korçës kishte vendosur të fillonte një fushatë për të ndihmuar Naum Veqilharxhin të blinte një shtypshkronjë dhe të hapte shkolla shqipe. «Mjaft për kaq kohë nën zgjedhën e paditurisë», shkruanin patriotët korçarë. «... Të shpresojmë se brenda një kohe të shkurtër, arsimit do të shtrihet në mbarë atdheun tonë dhe në mbarë kombin tonë... Na dërgoni sa më shumë evetore, sepse bashkatdhetarët po kërkojnë pareshtur të gjejnë akoma nga kjo abetare». Kjo pritje e ngrohtë e këto fjalë tregonin se nisma e N.

Veqilharxhit shprehte aspiratat e një publiku të gjerë brenda vendit, që ndiente nevojën për t'u arsimuar në gjuhën amtare si kusht i rëndësishëm për të çarë errësirën mesjetare dhe për t'i hapur atdheut rrugën e përparimit.

Për t'iu përgjigjur kërkesës së patriotëve korçarë, më 1845, Naum Veqilharxhi botoi një abetare të dytë me titull «Fare i ri evetar shqip», shumë më e plotë se e para dhe me një parathënie të gjerë. Me këtë abetare Naumi bënte një përpjekje serioze për ta vënë mësimin mbi baza shkencore; ai e pasuroi gjuhën shqipe me një varg fjalësh e termash të kulturës e të shkencës.

Abetaret e N. Veqilharxhit luajtën një rol të rëndësishëm në hedhjen e hapave të parë të arsimit në gjuhën shqipe.

Pas botimit të abetares së dytë N. Veqilharxhi, me sa duket, u përpoq të krijonte një shoqëri kulturore shqiptare, e cila do të merrej me botimin në Rumani të librave në gjuhën amtare dhe me dërgimin e tyre në Shqipëri.

N. Veqilharxhi ishte një mendimtar i shquar iluminist dhe hyri në histori edhe si ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Idetë e tij ai i shprehu në Qarkoren e hartuar në gjuhën greke, që u drejtoi nga Rumania, rreth mesit të viteve 40, bashkatdhetarëve të vet ortodoksë në Shqipëri, në letrën e gjatë polemizuese dërguar nipit të vet, ku përpjekjet e të ungit për çështjen shqiptare i quante «himera» dhe në parathënien e abetares së vitit 1845. Këto janë dokumentet e para ideologjike e programatike të njohura deri më sot të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të hartuara nga një përfaqësues i intelektualëve patriotë e demokratë shqiptarë.

Naum Veqilharxhi nisej nga koncepti dialektik se si në natyrë, ashtu edhe në shoqëri vepron ligji i zhvillimit, se në bazë të këtij ligji kalohet nga më e ulëta në më të lartën, nga e vjetra në të renë. «Asnjë komb nuk ka rënë nga qielli», «... shoqëria, bashkëpunimi e ka bërë njerinë». Fjalët e rënda që mund të thuheshin për shqiptarët, shkruante ai «tregojnë një gjendje që shkëmbehet e nuk mbetet për jetë. Vetëm kafshët e kanë të përcaktuar fatin nga natyra. Njeriu zhvillohet nga të voglat duke përparuar».

Në shikimin e gjërave N. Veqilharxhi vinte arsyen, të cilën, në kundërshtim me dogmatizmin mesjetar, e quante një mjet shumë të rëndësishëm, që e ndante njeriun nga bota e

kafshëve dhe e bënte zotin e të fshehtave të gjithësisë.

Në bazë të këtyre koncepteve filozofike Naumi e trajtoi edhe çështjen shqiptare, historinë e kombit të vet dhe detyrat që qëndronin përpara vendit. Kombi shqiptar, sipas tij, është krijuar në të njëjtën kohë me kombet e tjera, ai zë një vend të caktuar në tokë, ka karakter të veçantë, gjuhë e zakone të veçanta, shekujt e tij mitologjikë, heroikë, politikë e fetarë dhe ruan në gjirin e tij një thesar të madh kulturor. Të ndihmoje këtë komb të fitonte ndërgjegjen dhe të zhvillohej Naum Veqilharxhi e quante «një borxh ndaj vendbanimit» (vendlindjes — red.).

Shkakun kryesor të gjendjes së mjeruar në të cilën ndodhej populli shqiptar ai e shihte te «pushtimet e shpeshta», te «përmbysjet e gjithanshme», te «ndryshimet politike», te «dogmat fetare», te «padija» dhe sidomos te «lënia pas dore e gjuhës sonë kombëtare dhe zëvendësimi i saj me një gjuhë të huaj...». Faktor vendimtar për nxjerrjen e vendit nga kjo gjendje, N. Veqilharxhi si iluminist, quante përhapjen e arsimit e të kulturës në gjuhën amtare. «Ato kombe, që mbeten në padije, shkruante ai, u shëmbëllojnë thjeshtë skllëverve...», këto kombe «... vetëm atëherë do të mund të dalin nga gjendja e turpshme e mjerimit të tyre, kur do të fillojnë të lëvrojnë gjuhën e tyre kombëtare...».

Me këtë bindje dhe i ndërgjegjshëm për rrezikun që i vinte atdheut nga arsimit në gjuhë të huaj, N. Veqilharxhi i ftonte bashkatdhetarët e tij të përhapnin arsimin dhe kulturën në gjuhën amtare. Ai u jepte zemër bashkatdhetarëve dhe i këshillonte të mos dëshpëroheshin nga gjendja e vajtueshme në të cilën ndodhej vendi i tyre. «Le të hedhim farën e mirë, shkruante ai, dhe me siguri vetë natyra e shenjtë e ngjarjeve do të ndihmojë për gjallërimin, mbirjen dhe rritjen e saj, pemët e bukura dhe shumë të ëmbla të së cilës do t'i korrë padyshim brezi i ardhmë...».

N. Veqilharxhi ishte një patriot demokrat. Ai kërkonte që shkolla shqipe të ishte jo vetëm për të pasurit, por edhe për të varfërit, që interesi i atdheut të vihej mbi interesin vetjak. Por ai nuk e prekte vecse në mënyrë të papërcaktuar çështjen e qëndrimit ndaj qeverisë osmane. Megjithëse kryengritjet çlirimtare në Shqipëri kishin paraqitur kërkesën e vetëqeverisjes së vendit, Naumi, me sa duket, mendonte që, së pari,

duheshin shfrytëzuar kushtet e krijuara formalisht nga dekreti i Tanzimatit për të zhvilluar një veprimtari energjike në fushën e arsimit e të kulturës në gjuhën amtare, derisa të rritej ndërjegjja kombëtare e të arrihej bashkimi i popullit në atë shkallë që të lejonte shtrimin e çështjes së marrëdhënieve politike me Turqinë.

Lëvizja e arbëreshëve të Italisë në përkrahje të çështjes kombëtare shqiptare në vitet 30-40

Në kohën kur Naum Veqilharxhi zhvillonte veprimtarinë e vet në Rumani dhe krijonte lidhje me disa qendra të Shqipërisë së Jugut, në kolonitë arbëreshe të Kalabrisë dhe Sicilisë në Itali filluan të dukeshin shenjat e para të një lëvizjeje në përkrahje të çështjes kombëtare shqiptare. Ngjarjet që po zhvilloheshin në këtë kohë në Shqipëri, kryengritjet e njëpasnjëshme, përpjekjet e patriotëve shqiptarë për arsimin dhe kulturën kombëtare tërhoqën vëmendjen e një vargu intelektualësh të dalë nga gjiri i kolonive arbëreshe. Arbëreshët nuk e kishin harruar vendin e të parëve të tyre dhe i ruanin të gjalla, veçanërisht në folklorin e tyre të pasur, traditat e mëdha të luftës për liri, si dhe gjuhën e doket që kishin marrë nga mëmëdheu.

Të nxitur nga dashuria për atdheun e tyre të dikurshëm dhe nën ndikimin e interesit që shfaqte në gjysmën e parë të shekullit XIX shkenca gjuhësore evropiane për gjuhën shqipe, intelektualët arbëreshë filluan të merreshin me studimin e historisë, të folklorit dhe të gjuhës së këtyre kolonive, si dhe në përgjithësi të mëmëdheut të tyre të dikurshëm. Në kohën kur filluan të bëheshin hapat e parë të gjuhësisë krahasuese dhe u zbuluan lidhjet gjenealogjike të një vargu gjuhësh, studiuesi arbëresh Engjëll Mashi, në vitet e para të shekullit XIX dhe Josif Krispi e Gjon Skiroj në vitet 30 hodhën tezën e prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës së tij nga pellazgët dhe nga pellazgjishtja, gjuhë që mendohej se ishte folur nga banorët më të lashtë të Ballkanit e të Mesdheut. Teza e prejardhjes pellazgjike gjeti atëherë një përhapje të gjerë në qarqet shkencore dhe në opinionin publik.

Po në këtë kohë filloi veprimtarinë e tij Jeronim de Rada nga fshati Makje i Kalabrisë (1814-1903), i cili u bë një nga figurat më të shquara të letërsisë arbëreshe dhe të lëvizjes patriotike shqiptare. Qysh me veprën e tij të parë, me poemën «Këngët e Milosaos» (1836), shkruar në dialektin arbëresh, De Rada i dha letërsisë shqipe një nga veprat e saj më të bukura. Duke trajtuar edhe më tej tema historike, të marra nga luftërat shqiptaro-turke të shekullit XV, si p.sh. në poemën «Serafina Topia» (1843), poeti i frymëzuar nga kryengritjet shqiptare si edhe nga lëvizjet çlirimtare që zienin në Itali, në të cilat mori pjesë vetë, vinte në dukje traditat e mëdha luftarake dhe liridashëse të popullit shqiptar. Me këto vepra ai u bënte të njohur bashkatdhetarëve dhe nëpërmjet përkthimit italisht gjithë botës historinë e lavdishme të popullit shqiptar. Me këtë intelektualët arbëreshë filluan të realizonin atë që e quajtën si detyrë të madhe ndaj mëmëdheut të tyre të lashtë: «të ringjallnin përpara opinionit publik të drejtat e një kombi të lavdishëm, por të panjohur», siç shkruante më 1847, në parathënien e veprës së vet «Mbi shqiptarët, kërkime dhe mendime», studiuesi arbëresh Vinçenc Dorsa. Ai ia kushtonte veprën e vet «kombit të tij të përndarë e të përçarë, por një». Me këtë Dorsa donte të theksonte se kolonitë arbëreshe e ndien veten si pjesë të pandarë të një të tërë, të kombit shqiptar.

Me gjithë kushtet e vështira, midis vatrave të veçanta të lëvizjes politike e kulturore shqiptare filluan të krijoheshin që herët lidhjet e para. Në vitin 1845 Naum Veqilharxhi dhe shqiptarët e tjerë të Bukureshtit e përgëzonin Jeronim de Radën me një letër për punimin e tij «Mbi hyjnitë e pellazgëve», të botuar më 1843, në të cilën poeti përpiqej të shpjegonte se një varg emrash të mitologjisë greke në të vërtetë ishin shqip, sepse shpjegoheshin, sipas tij, me anë të shqipes së sotme dhe se pellazgët i kishin dhënë hua kulturës së lashtë greke një varg elementesh. Mendime të ngjashme në lidhje me prejardhjen pellazgjike të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar shfaqën dhe një varg albanologësh të huaj.

Këto mendime të De Radës dhe të albanologëve në lidhje me teorinë pellazgjike u përqafuluan me zjarr nga N. Veqilharxhi dhe patriotët e tjerë shqiptarë. Ato luajtën një rol për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve dhe u përdorën nga patriotët për të vërtetuar autoktoninë e popullit shqiptar në

trojet e veta dhe për të propaganduar përpara opinionit publik ndër-kombëtar njohjen e të drejtave të shqiptarëve si komb më vete.

Intelektualët arbëreshë ndiqnin me vëmendje ngjarjet që po zhvilloheshin në vitet 30-40 të shekullit XIX në Shqipëri. Veprat e tyre jo vetëm u bënë jehonë këtyre ngjarjeve, por edhe duke evokuar të kaluarën ngrinin probleme të rëndësishme si ato të luftës së armatosur për liri, të bashkimit të popullit shqiptar etj. Duke vënë në dukje rëndësinë e kryengritjeve që po ndodhnin në mëmëdheun e tyre të lashtë dhe duke i interpretuar ato si shenja të një kthese V. Dorsa i përshëndeste «këto kërcënime të vazhdueshme, inkursione, rebelime, mosbindje ndaj ligjeve, bashkimin e shpejtë nën flamurin e një kryetari dhe tërheqjen e vëmendjes që i bëjnë Portës së Lartë». «Në këto fakte, unë lexoj, vazhdonte atë, përgatitjen e furtunës së afërme dhe agimin e ditës së kthjellët që do të vijë pas saj». Dhe më poshtë: «Shqipëria beson se kjo ditë (e rilindjes së saj — red.) është e afërme dhe besimi i vë asaj në lëvizje shpirtin për ta arritur. Ajo nuk flet veçse për rilindje...».

3) KUNDËRSHTIMI I PLANEVE EKSPANSIONISTE TË SHTETEVE FQINJE. SHQIPËRIA DHE KRIZA LINDORE

«Megali Idea» greke dhe «Naçertanie-ja» serbe*

Kryengritjet për autonomi të viteve 30-40, si pjesë përbërëse dhe element aktiv i lëvizjes çlirimtare në Ballkan e dobësonin sundimin e Portës së Lartë dhe krijonin kushte objektive për bashkëpunimin luftarak të popujve të shtypur të gadishullit dhe për shpejtimin e çlirimit të tyre nga zgjedha osmane. Por ky bashkëpunim u sabotua nga politika ekspansioniste e Greqisë dhe e Serbisë.

Në vitet 40 shteti serb dhe ai grek nuk e kishin përfunduar bashkimin e tyre kombëtar. Një pjesë e mirë e territoreve me popullsi serbe e greke ndodhej ende nën sundimin

* Në këtë syth është bashkautor St. Pollo.

osman. Për këtë arsye, një nga drejtimet e politikës së këtyre vendeve ishte ai i çlirimit të këtyre territoreve dhe i bashkimit të tyre me shtetet kombëtare përkatëse. Por te qeveritë greke dhe serbe, që drejtonin këto shtete, ishin shfaqur prirje të frymëzuara nga ide shoviniste, të cilat u zhvilluan e u shndërruan në një vijë themelore të politikës së tyre.

Në fillim të vitit 1844 kryeministri grek J. Koleti e formuloi dhe e shpalli zyrtarisht programin politik ekspansionist, i cili hyri në histori me emrin «Megali Idea» (Idea e madhe). Sipas këtij programi, Greqia si trashëgimtare e Bizantit duhej të shndërrohej në një shtet të madh me kryeqytet Stambollin, ku do të bënin pjesë jo vetëm tokat greke, por edhe të gjitha popullsitë ortodokse jogreke të Ballkanit, që kishin qenë nën Perandorinë Bizantine dhe vareshin fetarisht nga Patrikana e Stambollit. «Megali Idea» përfshinte në kufijtë e Greqisë së Madhe edhe tokat shqiptare. Kufiri i tyre në veri në fillim përfshiu gjithë Shqipërinë, kurse pas viteve 60 caktohej herë lumi Drin, herë Shkumbini, ndërsa shovinistët më të moderuar grekë i çonin ata deri te lumi Vjosë.

«Megali Idea» greke gjeti një mbështetje të fuqishme te Patrikana Ortodokse e Stambollit. Me formimin e shtetit grek Patrikana e humbi dora-dorës karakterin ekumenik që kishte përpara dhe u kthye në një kishë greke, në një aleate të Greqisë. Kështu që kisha ortodokse dhe shkollat në gjuhën greke u kthyen në vatra për të helenizuar besnikët dhe nxënësit që i frekuentonin ato.

Po atë vit, më 1844, ministri i Serbisë I. Garashanin shpallte programin që do të vihej në themel të politikës serbe e që është i njohur në histori me emrin «Naçertanie» (Projekt). Edhe borgjezia serbe, ashtu si ajo greke, me pretekstin e çlirimit të tokave të sllavëve të jugut nga zgjedha osmane synonte të krijonte një shtet të madh, që do të përtërinte perandorinë mesjetare të Stefan Dushanit. Në kufijtë e kësaj perandorie të re, sipas «Naçertanie-s», do të hynin edhe viset e Shqipërisë së Veriut së bashku me Kosovën, që ministri serb e pagëzoi me emrin Serbia e Vjetër.

Të dy programet kishin karakter shovinist dhe shprehnin aspirata ekspansioniste të borgjezisë greke e serbe. Ato nuk e njihnin ekzistencën e kombit e të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe si pasojë edhe nevojën e krijimit të shtetit shqiptar.

Sipas këtyre programeve tokat shqiptare ishin të destinuara të ndaheshin midis Greqisë dhe Serbisë.

Këto synime të shteteve fqinje që ishin shfaqur edhe më parë, u shndërruan prej viteve 40 të shekullit XIX në një politikë të përhershme zyrtare, pasojat e së cilës u ndienë shumë shpejt në Shqipëri.

Lufta kundër «turkomanizmit» dhe «grekomanizmit»

Duke filluar prej viteve 50 Lëvizja Kombëtare Shqiptare bëri një luftë gjithnjë e më të ashpër kundër ideologjive reaksionare dhe antishqiptare të panislamizmit të propaganduar nga Porta e Lartë dhe të panhelenizmit të përhapur nga rrethet shoviniste të Athinës.

Qeveria e Stambollit ua mohonte kombësinë shtetasve myslimanë joturq të perandorisë dhe ndiqte me këmbëngulje parimin se Perandoria teokratike Osmane duhej të mbështetej mbi gjithë shtetasit myslimanë pa dallim.

Me qëllim që të përforconin pozitën e tyre në Shqipëri, të rrezikuara nga kryengritjet e vazhdueshme shqiptare dhe nga lëvizja e përgjithshme kryengritëse e popujve të tjerë ballkanas dhe për t'i lidhur sa më ngushtë masat e prapambetura të popullsisë myslimane shqiptare me fatet e perandorisë, qeveritarët e Stambollit filluan të zhvillonin një fushatë me parulla panislamike për të nxitur fanatizmin dhe përçarjen fetare midis shqiptarëve. Ata dërguan në Shqipëri për këtë qëllim edhe klerikë myslimanë nga Anadulli dhe nga vende të tjera lindore.

Këtij qëllimi i shërbenin edhe shkollat shtetërore turke që po ngriheshin në vitet 50-60 në Shqipëri, të cilat edhe pse quheshin formalisht shkolla laike pjesën më të madhe të programit e kishin me lëndë fetare islamike.

Kundërshtimi që i bënte Porta Lëvizjes Shqiptare gjente mbështetje te disa shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare, te «turkomanët». Këta përbëheshin, në radhë të parë, nga elementët fanatikë të klerit mysliman shqiptar si dhe nga një pjesë e feudalëve të vendit, të cilët pozitën e privilegjuar që kishin si funksionarë fetarë ose shtetërorë ia detyronin sulltanit dhe prandaj ishin të interesuar të mos prisheshin e as

të prekeshin lidhjet me të. Ndër turkomanët bënin pjesë edhe disa elementë të borgjezisë së pasur qytetare, të cilët jo vetëm nën ndikimin e parullave fetare islamike, por edhe si sipërmarrës shtetërorë dhe pjesëmarrës në spekulime të përbashkëta me funksionarët e Perandorisë, kishin interes të ruanin gjendjen ekzistuese, që u siguronte atyre një varg fitimesh. Qarqet e turkomanëve përqeshin të shfrytëzonin për qëllimet e tyre faktin se shtresat më të prapambetura të shoqërisë shqiptare nuk ishin shkëputur ende nga paragjykimet fetare.

Kundërshtim të ashpër gjeti Lëvizja Kombëtare Shqiptare si dhe ajo e disa popujve të tjerë ballkanas edhe nga prirjet shoviniste të disa qarqeve të borgjezisë së madhe greke që propagandonin «panhelenizmin» si armë ideologjike për të përgatitur realizimin e planit ekspansionist të «Idesë së madhe». Një rol të madh në këtë lëvizje luante edhe kleri i Patrikanës Greke të Stambollit. Ideologjia panheleniste gjeti mbështetje edhe në disa shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare. «Grekomanët», siç u quajtën përfaqësuesit e këtij orientimi, vinin në radhë të parë nga një pjesë e borgjezisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut, që kishte lidhje me tregjet e Selanikut, të Korfuzit etj.

Dobësia e borgjezisë shqiptare si klasë e re dhe ndikimi i parullave fetare të përhapura me anë të kishës e të shkollave greke u bënë shkak që «grekomanët» të shihnin te borgjezia greke, e cila kishte krijuar shtetin e vet kombëtar, të vetmen mbështetje për t'u çliruar nga zgjedha osmane.

Propagandistët e «Idesë së madhe» në Shqipëri u përpoqën të shfrytëzonin për qëllimet e tyre edhe urrejtjen e qarqeve të borgjezisë e të fshatarësisë së krishterë kundër bejlerëve çifligarë të vendit, që në shumicën dërrmuese ishin myslimanë, si edhe nevojën e madhe për arsim që kishte popullsia shqiptare, nevojë e cila, për mungesë shkollash në gjuhë shqipe, nuk kishte mundësi të plotësohej veçse në shkolla greqisht.

Në luftë të ashpër ideologjike Lëvizja Kombëtare Shqiptare përpunoi dhe zhvilloi platformën e vet që u bë baza e veprimit të saj të mëtejshëm politik-kulturor. Duke u nisur nga fakti se në bazë kriteresh objektive populli shqiptar, me gjithë ndarjen fetare, përbënte një komb më vete dhe si i tillë kishte një rrugë të veçantë të formimit historik, që e shpinte në mëvetësinë e tij kulturore e politike, ideologët e Lëvizjes Kombë-

tare u drejtuan kundër «panislamistëve», kundër «panhelenistëve», si edhe kundër përpjekjeve të tyre për të bërë për vete politikisht, sipas parimit fetar, një pjesë të popullit shqiptar.

Një luftë të veçantë bënë ata ndër të tjera kundër konkluzioneve politike që nxirrnin panhelenistët, duke i mbështetur synimet e tyre në teorinë pellazgjike; sipas tyre shqiptarë dhe grekë, si pasardhës të pellazgëve nga gjuha dhe nga prejardhja, ishin vëllezër dhe prandaj shqiptarët duhej të shkriheshin jo vetëm nga pikëpamja kulturore, por edhe politikisht në gjirin e «helenizmit».

Kushtet e vështira të krijuara nga propaganda armiqësore nuk penguan N. Veqilharxhin dhe aktivistët e tjerë të çështjes kombëtare të vazhdonin rrugën e nisur. N. Veqilharxhi iu drejtua pasanikëve shqiptarë në Rumani, Vangjel Zhapës nga Labova e Lunxherisë (Gjirokastër) dhe Apostol Arsaqit nga Hotova e Përmetit, të njohur si dhurues shumash të konsiderueshme për qëllime mirëbërëse në Greqi, që të jepnin përkrahjen e tyre për të shtypur një varg librash shkollorë në gjuhën amtare, të hartuar nga Veqilharxhi dhe për të hapur shkolla shqipe. Por V. Zhapa u shfaq kundër një orientimi të pavarur të veprimtarisë arsimore shqiptare.

Pikërisht kur po zhvillonte një veprimtari të dëndur për çështjen shqiptare, N. Veqilharxhi vdiq (në vitin 1854). Si faktorë për vdekjen e tij shqiptarët akuzuan, në radhë të parë, Patrikanën e Stambollit, e cila, për të ruajtur «unitetin» e fesë së krishterë, që gjoja ishte vënë në rrezik nga veprimtaria e N. Veqilharxhit, kishte nxitur Portën për të marrë masa kundër tij. Rrugën e veprimtarit të palodhur e vazhduan shumë dishepuj, midis të cilëve ishte edhe Thimi Mitkoja nga Korça.

Një rrugë të veçantë filluan të ndiqnin në këto vite disa intelektualë ortodoksë nga Shqipëria e Jugut e në radhë të parë Anastas Byku nga Lekli i Tepelenës (veproi në vitet 1859-1878). Duke u nisur nga bindja se pa përparim kulturor, pa lëvrimin e mësimin e gjuhës amtare populli shqiptar nuk do të kishte mundësi të zinte vendin që i përkiste midis popujve të tjerë, A. Byku botoi në vitet 1861-1862 në Lamia të Greqisë gazetën greqisht-shqip «Pellagos», kushtuar çështjes shqiptare. Të njëjtit qëllim i shërbente edhe abetarja e vogël me titull «Gramë për shqiptarët» (1861), në të cilën

përdorej alfabeti greqisht për shkrimin e shqipes. Më tej A. Byku punoi për krijimin e një rrjeti të gjerë shkollash fillore e të mesme në gjuhën shqipe, për të cilat u përpoq të fitonte përkrahjen financiare edhe të V. Zhapës. Por A. Byku, ndonëse ishte për ruajtjen e karakterit të veçantë të popullit shqiptar, u shpreh kundër zhvillimit të tij të pavarur dhe për hyrjen e tij në gjirin e helenizmit.

Rrugën e A. Bykut e ndoqi në fillimin e veprimtarisë së vet edhe Jani Vretoja nga Postenani i Leskovikut (1822-1900), si dhe Eftim Brandi nga Korça (veproi në vitet 1860-1880).

Mendimi i A. Bykut, i cili e vinte Lëvizjen Shqiptare në varësi të synimeve armiqësore të qarqeve panheleniste, u kundërshtua nga veprimtarët e Lëvizjes Shqiptare, midis tyre nga Thimi Mitkoja.

Lufta që zhvillonte Lëvizja Kombëtare Shqiptare në fronte të ndryshme dëshmonte për rritjen e saj ideologjike. Mendimi i rilindësve i formuar qysh në këtë kohë, në lidhje me rrugën e veçantë historike të popullit shqiptar, u bënte jehonë kërkesave të kryengritjeve popullore antiosmane për autonominë e Shqipërisë. Me forcimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare filluan të diferencoheshin edhe radhët e rretheve borgjeze «turkomanë» e «grekomanë», një pjesë e anëtarëve të të cilave u bashkua me të.

Politika osmane në Shqipëri në vitet 1848-1853

Kryengritjet kundër Tanzimatit dhe sidomos kryengritja e madhe e vitit 1847 i kishin treguar Stambollit rrezikun që i kanosej perandorisë nga një acarim i ri i gjendjes në Shqipëri në një kohë kur kishte filluar të rritej edhe lëvizja e përgjithshme për çlirimin kombëtar të popujve të Ballkanit dhe ishin acaruar kontradiktat e Fuqive të Mëdha lidhur me trashëgimin e «të sëmurit të Bosforit», siç quhej tani Perandoria Osmane. Shqetësimi i Portës ishte shtuar shumë edhe nga interesimi që kishin filluar të tregonin për Shqipërinë shtetet e reja ballkanike dhe nga orvatjet e tyre për t'i shfrytëzuar lëvizjet antiosmane të shqiptarëve.

Këto rrethana e shtynë Portën e Lartë të mendonte seriozisht për gjendjen në Shqipëri. Në një përlëshje të afërt Stambolli dëshironte të kishte në krahun e vet forcën ushtarake të shqiptarëve, që e çmonte shumë. Për këtë arsye, autoritetet osmane në Shqipëri krahas zgjerimit të propagandës panislamike morën urdhër të mos përdornin përkohësisht forcën për të zbatuar reformat. Sulltani fali një varg krerësh të burgosur ose të internuar të kryengritjes, si dhe Z. Gjolekën. Më 1849, kapidanit të Mirditës, Bibë Dodës, iu dha titulli pashë dhe iu njoh e drejta që të merrte pjesë në luftë me një repart të vetin, të përbërë prej afër 10 mijë luftëtarësh. Si komandantë repartesh të çrregullta u njohën edhe feudalë të tjerë, të cilëve Porta u siguroi shpërblime dhe grada.

Nga ana tjetër, në Shqipëri kishte filluar të shtohet gjithnjë e më tepër shqetësimi i shkaktuar nga synimet ekspansioniste të shteteve fqinje, i cili e kishte rritur gatishmërinë e popullsisë për të mbrojtur trojet e veta. Këtë rrethanë u përpoq me të gjitha mënyrat ta shfrytëzonte qeveria osmane për të nxitur urrejtjen e shqiptarëve kundër vendeve fqinje dhe për të siguruar një bashkëpunim sa më të ngushtë me ta.

Një rast i tillë u paraqit më 1852, kur Turqia i shpalli luftë Malit të Zi, duke marrë shkas nga disa ndryshime në formën e shtetit që i kishte bërë princi i ri Danilo. Thirrjes së sulltanit për të marrë pjesë në luftë iu përgjigjën një varg krerësh feudalë dhe bajraktarë shqiptarë, midis tyre edhe Bibë Doda, Zenel Gjoleka etj., të cilët shkuan me repartet e tyre në ndihmë të ushtrisë osmane. Por lufta nuk i solli ndonjë përfitim Stambollit. Ndonëse u sulmua edhe nga Shqipëria edhe nga Hercegovina, Mali i Zi, me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha, doli nga lufta i padëmtuar. Repartet shqiptare, nga ana e tyre, patën humbje të ndjeshme në njerëz, midis të cilëve ishte edhe Zenel Gjoleka.

Përlëshjet e përgjakshme në kufirin turko-malazias vazhduan edhe pas luftës. Ato nxiteshin nga krerët e Malit të Zi për të përgatitur truallin për aneksimin e trojeve veriore të Shqipërisë. Sulmet malazeze ndeshën në qëndresën e vendosur të popullsisë shqiptare të këtyre krahinave.

Kriza Lindore e viteve 1853-1856 dhe Shqipëria

Në mesin e shekullit XIX u acarua shumë rivaliteti midis Fuqive të Mëdha evropiane për ndikim në vendet e Lindjes së Afërme. Në këtë kohë Anglia dhe Franca e kishin dëbuar pothuajse krejtësisht Rusinë e prapambetur nga tregjet e kësaj zone. Me qëllim që të shtinte në dorë ngushticat e Dardaneleve dhe vetë Stambollin dhe të shtrinte praninë e saj në Lindjen e Afërme dhe në Ballkan, Rusia cariste priste të krijohej një gjendje ndërkombëtare e përshtatshme për ta shembur perandorinë e sulltanëve. Në projektet e saj për rregullimin e ardhshëm të Turqisë evropiane ajo parashikonte krijimin e disa shteteve më vete, të cilat do të ishin nën ndikimin e Ruisë. Por në këto projekte nuk figuronte Shqipëria. Qeveria cariste nuk parashikonte krijimin e një shteti shqiptar dhe prandaj qëllimisht i identifikonte shqiptarët myslimanë me turqit, ndërsa ata të krishterë ortodoksë me grekët.

Politika ruse e copëtimit të Perandorisë Osmane ndeshi në kundërshtimin e vendosur të fuqive perëndimore e, në radhë të parë, të Anglisë dhe të Francës. Këto fuqi vazhdonin të garantonin e të përkrahnin status quo-në dhe paprekshmërinë e Turqisë, sepse po e kthenin atë në një gjysmëkoloni të tyre dhe sepse me ruajtjen e Turqisë pengohej dalja e Ruisë në Mesdhe. Kur në korrik 1853 qeveria cariste i shpalli luftë Perandorisë Osmane, ajo u gjend shumë shpejt përpara një konflikti të madh, në të cilin Anglia dhe Franca dhe më vonë edhe Mbretëria e Sardenjës morën anën e Turqisë. Pas një vargu fitoresh fillestare të Ruisë në frontin e Danubit e në det, operacionet e aleatëve të Turqisë u përqendruan në gadishullin e Krimesë dhe prandaj konflikti mori emrin Lufta e Krimesë.

Duke pasur ushtritë e saj në brigjet e Danubit, Rusia u bëri thirrje popujve ortodoksë të Ballkanit të rrëmbenin armët kundër shtypësit shekullor. Duke shpresuar se me fitoren e Ruisë ortodokse do të përmirësohej gjendja e tyre, kësaj thirrjeje iu përgjigjën vullnetarë nga vende të ndryshme ballkanike, si edhe shqiptarë ortodoksë nga Shqipëria e Jugut.

Edhe Turqia, nga ana e saj, u përpoq të mobilizonte forcat shqiptare me parullën e mbrojtjes së fesë islame, por nuk

arriti ndonjë sukses të madh. Ajo nuk mundi të nxirrte nga Shqipëria veçse pak nizamë. Nuk dhanë rezultate të dukshme edhe përpjekjet e saj për të dërguar krerët shqiptarë me forcat e tyre në frontin rus. Shumica e tyre nuk pranuan të shkonin në një front kaq të largët, siç ishte fronti i Danubit dhe preferuan t'i mbanin forcat e tyre gati në rastin e një sulmi të mundshëm nga Mali i Zi ose Greqia. Vetëm Bibë Doda me një numër mirditasish u nisën për në front, por pas disa kohësh ai u kthye në vendin e vet për shkak të mosmarrëveshjeve që lindën midis tij dhe kryekomandantit turk, Omer Pashës.

Lufta e Krimesë nxiti Malin e Zi dhe Greqinë që të hartonin plane për një aksion luftarak kundër Perandorisë Osmane.

Mali i Zi ndërmori disa sulme në Hercegovinë e në tokat shqiptare dhe përgatiste një goditje kundër Tivarit. Por përballë qëndresës së vendosur të shqiptarëve dhe nën presionin e fortë të Austrisë dhe të Francës princi Danilo u detyrua të hiqte dorë nga kjo ndërmarrje.

Më larg shkuan veprimet e Greqisë. Megjithëse Anglia dhe Franca nuk e lanë të hynte në luftë kundër Portës, qeveria greke organizoi çeta të shumta të komanduara nga oficerë të ushtrisë, të cilët u futën fshehurazi në Thesali dhe në krahinat e vilajetit të Janinës për të organizuar një kryengritje antiosmane. Ata hynë edhe në krahina të Shqipërisë, si hap i parë drejt realizimit me forcën e armëve të «Megali Idesë». Për këtë qëllim ajo u përpoq të shfrytëzonte urrejtjen e shqiptarëve ortodoksë kundër sundimtarëve osmanë dhe prandaj vuri në krye të lëvizjes figura të shquara të luftës për pavarësi me prejardhje arbëreshe ose nga Suli, të cilat do t'i jepnin kryengritjes në tokat shqiptare dukjen e një aleance greko-shqiptare. Më 2 janar 1854, pasi shpallën lirinë dhe pavarësinë e gjithë provincave të «Greqisë së vjetër», udhëheqësit e kryengritjes me parullën «Perandori Greke ose vdekje» i ftuan banorët e këtyre krahinave të rrëmbenin armët. Kryengritësit korrën në fillim disa suksese në ato krahina ku nuk kishte ushtri të rregullt dhe ku vepronin disa feudalë shqiptarë me forcat e tyre lokale. Arta ra në duart e kryengritësve dhe një çetë e madhe andartësh* e komanduar nga gjenerali Griva

* Andart (greqisht) — pjesëmarrës çetash vullnetare greke.

arriti deri në Mecovë. Gjatë marshimit të tyre në viset e brendshme të vilajetit të Janinës, andartët grekë përdorën edhe forcën për t'i detyruar vendasit të bashkoheshin me ta. Por synimet e qarta aneksioniste të qeverisë greke bënë që shqiptarët t'i shmangeshin bashkëpunimit me ta dhe kryengritja të mos merrte karakter të përgjithshëm. Për më tepër krerët shqiptarë të Jugut mobilizuan forcat e tyre dhe i thyen andartët grekë në krahinën e Artës dhe në Thesali. Nga ana tjetër, Anglia me Francën e detyruan qeverinë e Athinës të hiqte dorë nga këto veprime që ishin në dobi të Rusisë; si masë shtrënguese kundër saj, ato pushtuan me flotën e tyre Pireun, limanin kryesor të Greqisë.

Krizën e shkaktuar nga Lufta Ruso-Turke e shfrytëzoi edhe Vjena për t'i shkëputur Portës së Lartë një varg koncesionesh dhe për të përforcuar pozitat e saj në Shqipërinë e Veriut, ku, në bazë të traktateve ndërkombëtare, ajo kishte fituar të drejtën e mbrojtjes së popullsisë katolike (i ashtuquajtimi kultusprotektorat*).

Me ndërhyrjen e Austrisë mundi të kthehej përsëri në Shkodër urdhri i jezuitëve, i dëbuar prej andej 11 vjet më parë. Me anë të një demonstrate detare përpara grykës së Bunës, më 1853, Vjena e detyroi Portën të lejonte ngritjen e një seminari të jezuitëve. Disa vjet më vonë u themelua në Shkodër nën mbrojtjen e Austrisë edhe një kuvend françeskan. Nga ana tjetër, kapitali tregtar austriak po bëhej veçanërisht aktiv në Shqipëri dhe në trevat e tjera perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Kjo u pasqyrua edhe në shtimin e numrit të anijeve austriake që vinin në limanet shqiptare. Me forcimin e pozitave ekonomike e politike Austria fitoi në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor një pozitë të privilegjuar ndër Fuqitë e Mëdha kapitaliste.

Edhe Franca u përpoq të përforconte me këtë rast pozitat në Ballkan e të vinte nën ndikimin e saj princin Danilo të Malit të Zi dhe kapedanin e Mirditës, Bibë Dodën.

Lufta e Krimesë mori fund në mars të vitit 1856 me nënshkrimin nga ndërluftuesit të Traktatit të Paqes në Paris. Në këtë traktat u përfshinë edhe parimet themelore të dekretit të ri perandorak (Hat-i humajun), që sulltan Abdyl Mexhiti ishte

* Kultusprotektorat (gjermanisht) — protektorat fetar.

detyruar ta shpallte më 15 shkurt 1856 me shtytjen e drejtpërdrejtë të Anglisë dhe të Francës e që shënonte fillimin e periudhës së dytë, të reformave të Tanzimatit. Ky dekret ritheksonte, përveç të tjerave, detyrimin e Portës së Lartë për t'u njohur popullsisë të krishtera nën sundimin e saj disa të drejta administrative. Duke e përfshirë thelbin e Hat-i humajunit në Traktatin e Pages të Parisit, Anglia dhe Franca synonin t'i hiqnin Rusisë mundësinë që të ndërhynte në favor të këtyre popullsive.

4) POLITIKA GRABITQARE E PORTËS SË LARTË DHE RIACARIMI I MARRËDHËNIEVE TË SHQIPTARËVE ME SUNDIMTARËT OSMANË DHE ME SHTETET FQINJE

Pasojat shkatërrimtare të Tanzimatit në Shqipëri

Prej mesit të viteve 50 deri në vitet 60 u përforcua edhe më tej administrata e re dhe politika e saj shtypëse e shfrytëzuese në trevat e ndryshme të vendit. Ndarja e re administrative e vitit 1864 në vilajete, si njësi më të vogla se vilajetet e mëparshme, e theksoi centralizimin e pushtetit osman. Në krye të nëndarjeve të vilajeteve, të sanxhakëve (prefekturave), të kazave (nënprefekturave) dhe të nahieve (komunave) qëndronin nëpunës civilë të dërguar nga qendra, në shumicën e rasteve, turq. Centralizimi burokratik i administratës nuk zbutej nga fakti se, për të përmbushur premtimet e dekretit të ri perandorak të vitit 1856, Porta ishte e detyruar të krijonte pranë organeve lokale këshillat administrativë, të cilët mbetën krejtësisht formalë. Në një varg qytetesh, qeveritarët osmanë nuk i pranonin fare në mbledhje anëtarët e krishterë.

Porta e Lartë u përpoq të vinte nën kontrollin e drejtpërdrejtë të administratës së re edhe krahinat malore të Veriut. Si hallkë të ndërmjetme, në fund të viteve 50 ajo krijoi pranë valiut të Shkodrës një komision të Xhibalit (Malësisë), në të cilin u emëruan si anëtarë me rrogë përfaqësues nga secili prej 26 bajraqeve të vilajetit të Shkodrës. Si anëtarë të komisionit Porta caktoi edhe 26 bylykbashë nga paria feudale turkomane

e Shkodrës, të cilët do të shërbenin si komisarë qeveritarë për bajraçet. Me anë të këtij komisioni, qeveria shpresonte të kufizonte autonominë e malësorëve. Edhe pse veprimtaria e komisionit të Xhibalit u përqendrua në qytetin e Shkodrës dhe çdo orvatje për ta zgjeruar atë hasi në qëndresë të armatosur, qeveritarët osmanë bënë presion të vazhdueshëm mbi Malësinë, duke e ngushtuar pak nga pak autonominë e saj.

Synimi kryesor i administratës së re turke ishte të siguronte pagesën e taksave dhe mbledhjen e rekrutëve nga të gjitha krahinat. Për të përballuar shpenzimet e mëdha që kërkonte mbajtja në këmbë e aparatit burokratik e ushtarak, për të vënë në vend të ardhurat fiskale të pakësuar me humbjet tokësore që kishte pësuar dhe, më në fund, për të paguar kamatat e huave ndërkombëtare, Stambollit nuk i mbetej tjetër rrugë veç asaj të shtrëngimit të darës së taksave. Duke vënë në dukje se administrata e re osmane dhe nëpunësit e saj, pas Tanzimatit, nuk kishin ndryshuar aspak, K. Marksi shkruante: «... padituria, paturpësia, grabitjet e tyre mbetën po ato që kishin qenë në lulëzim të arbitrariteteve të satrapëve aziatikë»¹. Kështu, shuma e taksave të nxjerra nga popullsia e Perandorisë, e cila më 1850 kishte qenë 2,5 milionë lira ari, më 1860 arriti në 4 milionë dhe vazhdonte të rritej. Ministria e Financave, në caktimin e shumës së taksave që do të nxirreshin nga popullsia, nuk nisej nga gjendja dhe nga numri i kontribuesve, por nga nevojat e veta. Shtoheshin llojet e taksave, por rritej sidomos shuma e kërkuar. Veçanërisht e dëmshme ishte mënyra e nxjerrjes së taksave me anën e iltizimit. Me shitjen dhe me rishitjen në ankand të së drejtës së mbledhjes së taksave myltezimeve më të vegjël, e dhjeta arrinte deri në një të pestën e prodhimit. Ajo vinte vazhdimisht duke u shtuar për arsye se çdo vit për ofertat e blerjes merrej zakonisht si pikënisje maksimumi i arritur në vitet e kaluara.

Taksa e vergjisë, që paguhej për pasurinë e patundshme (shtëpi, kopshte, dyqane) dhe për disa kategori të caktuara të ardhurash, shtohej gjithashtu vazhdimisht. Më 1863, në sanxhakun e Ohrit, që përfshinte edhe një pjesë të Shqipërisë Juglindore, vergjia u shtua në krahasim me vitin e mëparshëm nga 350 000 në 420 000 groshë, d.m.th. 20 për qind.

¹ K. Marks — F. Engels, *Veprat*, bot. gjerm., vëll. 11, f. 460.

Taksa e veçantë që paguanin të krishterët meshkuj prej 12 deri 60 vjeç për zëvendësimin e shërbimit ushtarak (bedel-i asqerie) në qytetin e Shkodrës u shtua nga 45 000 groshë, që ishte në vitet 30, në 100 000 më 1856.

Për të rritur të ardhurat, Porta përqendroi në duart e veta, në formë monopolesh shtetërore, tregtinë e një vargu artikujsh të përdorimit të përditshëm, siç ishin kripa, plumbi, duhani, baruti dhe peshku, duke i ngarkuar ato me taksa të veçanta.

Përveç taksave shtetërore, popullsia e qyteteve paguante edhe një varg taksash komunale, si taksën e peshimit në treg, taksën policore etj. Më në fund rëndonte mbi gjithë meshkujt (prej 16 deri në 60 vjeç) taksa e rrugës, detyrimi përkatës ditë-punë angari në vit bashkë me kafshën e punës, detyrim që kryhej edhe në viset më të largëta.

Shtimi i tatimeve, ngarkimi i çdo veprimtarie ekonomike me taksa të reja etj., e ngritën në vitet 1850-1870 koston e jetesës në mënyrë shumë të ndjeshme. Në këtë ndikoi edhe zhvlefësimi i vazhdueshëm i monedhës turke, e cila ra deri në 40-50 për qind të vlerës së saj, meqenëse qeveria nxirrte bankënota (kajme) pa pasur mbulesën e duhur në ar.

Pjesa më e madhe e shumave që nxirreshin nga Shqipëria dhe nga provincat e tjera shkonin në Stamboll për të kënaqur lakmitë e tepruara për të holla të sulltan Abdyl Azizit (1861-1876) dhe të oborrtarëve të tij. Por edhe nevojat për të holla të funksionarëve të lartë të Portës në provincat nuk ishin të pakta. Ata i kënaqnin këto lakmi me abuzime të drejtpërdrejta ose duke marrë pjesë si ortakë në spekulime. Këto abuzime nxiteshin edhe nga praktika e Portës, e cila me qëllim i ndërronte shpesh funksionarët e saj në provinca, sepse caktimi në funksionet e larta bëhej me anë «peshqeshesh» në të holla për sulltanin. Qeveritarit të një province, zakonisht, nuk i mjaftonin as dy vjet për të nxjerrë shpenzimet e këtij «peshqeshi» dhe për të rregulluar financat e veta dhe, nga ana tjetër, ishte i detyruar të nxirrte shuma sa më të mëdha taksash nga provinca e tij për të ruajtur favorin e sulltanit. Prandaj ardhja e çdo funksionari të ri shënonte një katastrofë për provincën. Nga ndërrimet e funksionarëve të lartë e pësoi në mënyrë të veçantë vilajeti i Shkodrës, ku brenda 40 vjetëve (1831-1871) u emëruan 52 valinj.

Vilajeti i Janinës, që përfshinte, ndër të tjera, gjithë Shqi-

përinë e Jugut (me përjashtim të rrethit të Korçës e të Pogradecit), në vitet 60 paguante rreth 22 milionë groshë, nga të cilët shkonin në Stamboll më tepër se gjysma. Në fillim të viteve 70, shuma që paguante kjo krahinë kishte arritur në afër 30 milionë, nga të cilat dy të tretat shkonin në Stamboll.

Dërgimin në Stamboll të shumave të konsiderueshme, që nxirreshin nga provincat, autoritetet osmane e shpjegonin me nevojën e mëkëmbjes së një aparati shtetëror modern, për ndërtim rrugësh, për sigurimin e «rendit dhe të qetësisë» etj. Në të vërtetë vendi ishte mbushur me banda kusarësh, krerët e të cilëve binin shpeshherë në marrëveshje me vetë qeveritarët dhe me feudalët vendas. Plaçkitjet dhe vrasjet ishin diçka e zakonshme jo vetëm në fshatra, por edhe në qytete, e sidomos e pësonte popullsia e krishterë. Vetëm një pjesë e borgjezisë së pasur kishte mundësi t'u shpëtonte këtyre përdhunimeve, duke siguruar me pagesë «mbrojtjen» nga ana e konsullatës së ndonjë shteti evropian ose nga vetë kusarët.

Edhe ajo pjesë e taksave që mbetej në vend nuk përdorej për qëllime prodhuese, por, para së gjithash, për mbajtjen e aparatit parazituar burokratik.

Shfrytëzimi i egër feudal, shtypja dhe abuzimet e administratës së re, e keqësuan në kulm gjendjen ekonomike të popullsisë. Udhëtarë të huaj, që kanë kaluar nëpër Shqipëri gjatë viteve 1860-1875, kanë vënë në dukje se mjerimi i fshatarësisë së disa krahinave ishte aq i madh, saqë siç thoshte njëri prej tyre, konsulli rus Trojanovski, «prindët i çojnë fëmijët e tyre në pazar për t'i shitur. Edhe familje që kanë qenë dikur mirë, kanë rënë në gjendje lypësishe». «S'është aspak për t'u çuditur, shkruante Jonin, një tjetër diplomat rus, përse fshatari i mjerë, duke jetuar në një gjendje të tillë, humbi çdo shije dhe dëshirë për punë...».

Në këto kushte u rrit zemërimi dhe urrejtja kundër elementëve të klasës sunduese feudale turke, që thirreshin me emrin përbuzës «halldupë» (të trashë, të pangopur) ose «konjarë» (nga qyteti Konja i Anadollit, me kuptimin e njerëzve të këqij).

Fshatarë të veçuar rrëmbenin armët, dilnin maleve dhe përpiqeshin të hakmerreshin kundër shfrytëzimit të rëndë nga ana e organeve shtetërore, si dhe të bejlerëve çifligarë. Lëvizja e «kaçakëve» si shprehje e protestës sociale e kombëtare

që njihej qysh shumë kohë përpara, mori përpjesëtime më të mëdha.

Një shprehje të zjarhtë të kësaj ndjenje të përgjithshme e jepte në vitin 1865 dervishi bektashi Ali me anë të një vjershe, e cila është një dëshmi e gjallë e patriotizmit popullor të kësaj kohe:

*« . . Ky halldupi, ky konjari, bukën tonë po na ha,
Xhveshur, z bathur na ka lënë, lakuriq pa një para.
Gjithë halldupët pashallarë, të mëdhenj e si zotë.
Shqipëtari s'ka të mbajë asnjë feste në kokë.
Gjynah, pra, nga perëndia të punojë shqipëtari,
dhe të hajë e të pijë e të bëjë rehat konjari. . . »*

Revolta e vegjëlisë shkodrane më 1854

Gjendja e keqe ekonomike dhe abuzimet e papërmbytura të administratës së re osmane në Shkodër i dhanë shkas shpërthimit në këtë qytet të një revolte të fuqishme të vegjëlisë.

Gjatë viteve 1851-1852, vali i ri Masar Pasha ua dyfishoi të krishterëve të qytetit taksën «nizamie», një pjesë të mirë të së cilës e merrte për vete. Protestat që popullsia bëri në Stamboll kundër këtij veprimi arbitrar nuk dhanë rezultat. Një burim tjetër pasurimi për qeveritarët turq u bë spekulimi me tregtinë e drithit, sidomos më 1854, kur vazhdonin Lufta e Krimesë dhe konfliktet me Malin e Zi. Duke bashkëpunuar ngushtë me ta sipërmarrësit dhe tregtarët e grumbullonin drithin dhe e shisnin me leverdi jashtë vendit. Pasoja e menjëhershme e këtij veprimi ishte ngritja e çmimeve të artikujve ushqimorë e sidomos e çmimit të drithit, që në kohën e lëmit u dyfishua në vend që të ulej. Përveç mungesës së drithit gjendjen në Shkodër e keqësoi edhe më tepër detyrimi i popullsisë për të mbajtur me ushqime 20 mijë ushtarë osmanë, që ndodheshin në kufirin turko-malazias. Shkodrës po i kanosej zija e bukës. Pakënaqësia e shtresave të varfra shpërtheu haptazi, kur në qytet ndodhën vdekjet e para nga uria. Më 7 gusht 1854 vegjëlia qytetare e udhëhequr nga Hasan Alia, klerik i ri, që do të njihet më vonë me emrin Sheh Shamia, në një mbledhje të gjerë kërkoi ndalimin e eksportit

të drithit, uljen e çmimeve dhe dënimin e spekulatorëve. Por valiu nuk mori asnjë masë. Të nesërmen, më 8 gusht, një turmë e madhe prej disa mijëra zejtarësh e punëtorësh të varfër vërshoi në treg, i cili u mbyll, ndërsa qeveritarët u detyruan të tërhiqeshin në kala. Demonstruesit hapën hambarët dhe ua shpërndanë drithin banorëve të varfër. Sheh Shamia dha shembullin duke hapur i pari hambarët e babait të vet. Një ditë më vonë, vegjëlja e armatosur në një demonstratë të madhe kërkoi largimin e valiut nga qyteti. Atëherë ndërhyri konsulli i Francës, i cili bëri çmos që t'i shpërndante të revoltuarit duke vënë në dukje rrezikun që mund t'i vinte Shkodrës nga revolta për shkak të gjendjes së luftës dhe qëndrimit kërcënues të Malit të Zi. Për ta mbyllur çështjen, Porta më në fund e zëvendësoi Masar Pashën. Por valiu i ri, me forca të shumta ushtarake të përqendruara në qytet, bëri arrestime në masë. Sheh Shamia mundi të largohej fshehurazi nga Shqipëria, kurse udhëheqësit e tjerë të revoltës u internuan.

Qëndresa kundër zbatimit të Tanzimatit në Shqipërinë e Veriut në vitet 1861-1862

Në vitet 60 të shekullit XIX marrëdhëniet midis sundimtarëve osmanë dhe popullsisë së Shqipërisë së Veriut u acaruan përsëri në një shkallë të tillë sa shkaktuan shpërthimin e një vargu konfliktesh të reja të armatosura.

Edhe pse kryengritjet e viteve 40 kundër Tanzimatit ishin shtypur, pakënaqësia e popullsisë ndaj administratës së re dhe qëndresa kundër saj nuk ishin shuar dhe vazhdonin të shfaqeshin në forma të ndryshme. Kjo e kishte detyruar pushtetin osman që të vepronte në mënyrë të matur. Kur nga fundi i viteve 50 Porta e Lartë ndërmori veprime të reja për të shtrirë kudo administratën e re e për të zbatuar me forcë reformat, ajo ndeshi përsëri në kundërshtimin e vendosur jo vetëm të malësorëve, por edhe të banorëve të qytetit të Dibrës, të Shkodrës dhe të qyteteve të Kosovës.

Më 1860 Porta i filloi veprimet në malësitë e Dibrës. Tani ajo gjeti atje kushte të favorshme për realizimin e qëllimeve të saj, sepse midis dibranëve kishte shpërthyer një konflikt i

nxitur nga një pjesë e klerikëve reaksionarë myslimanë të rritit synit. Këta i luftonin si heretikë të rrezikshëm bektashinjtë e Dibrës dhe udhëheqësin e tyre sheh Fejzën nga Bulqiza, të cilët, ashtu si gjithë sekti i bektashinjve, ishin në konflikt me dogmat synite dhe me shtetin osman që i përkrahte ato.

Duke përfituar nga konflikti që në pamjen e jashtme kishte karakter fetar, por në thelb kishte të bënte me qëndrimin ndaj politikës që ndiqte Porta e Lartë në Shqipëri, ekspedita osmane e komanduar nga Avdi Pasha mundi të hynte në Dibër, pa hasur pengesa. Vetëm krahina e Grykës së Madhe e udhëhequr nga sheh Fejza rroku armët. Në një ndeshje që u bë në fshatin Xixull, malësorët u thyen pas një beteje të ashpër. Turqit i vunë zjarrin fshatit Bulqizë. Me forcë ata e shtrinë zbatimin e reformave edhe në trevat deri atëherë të panështruara. Në qytet u vendosën funksionarë turq të ardhur nga Stambolli. Pas kësaj filloi rritja e taksave. Në vitin 1863 Porta merrte prej Dibrës 3000 qese (1 qese = 500 groshë) në vend të një shume globale vjetore prej 100 qesesh, që kishte marrë që nga viti 1831.

Një problem shqetësues për Stambollin vazhdonte të ishte Shkodra me malësitë e saj të krishtera. Në vjeshtën e vitit 1861 Porta filloi përsëri nga orvatjet për të zbatuar këtu reformat që kishin mbetur pezull. Me pretekstin se kërkonte vendosjen e rendit publik, Porta nisi të çarmatoste popullsinë e qytetit dhe të fushave, për t'i hapur rrugën zbatimit të masave të tjera, por ndeshi në kundërshtimin e shkodranëve, të cilët në çarmatosjen shihnin heqjen e çdo mundësie për t'u mbrojtur si nga grabitjet dhe nga zullumet e administratës, ashtu edhe nga sulmet e herëpashershme të Malit të Zi. Qytetarë të armatosur të mbështetur nga malësorët i detyruan trupat turke të tërhiqeshin nga qyteti, prenë lidhjet telegrafike, e shpallën valiun të rrëzuar nga funksionet dhe e mbajtën të rrethuar në selinë e tij. Myslimanët e të krishterët e qytetit, të bashkuar, i dërguan sulltanit një memorandum ku shprehnin zemërimin e tyre kundër administratës së vendit, e cila, në emër të «rregullit e të rendit publik» e rëndonte popullin me barrë të reja fiskale. Vendi, deklaroi shkodranët, s'kishte as rrugë, as gjyqe të paanshme, as siguri nga kusarët që kishin pllakosur mbi të. Administrata nuk ishte në gjendje të mbronte vendin, jetën dhe pasurinë e banorëve nga sulmet e çetave malazeze, që sa vinin bëheshin më të shpeshta.

Për t'iu shmangur një konflikti, Porta dërgoi në Shkodër një komisar të jashtëzakonshëm dhe largoi andej valiun. Ajo u përpoq ta mbyllte çështjen sa më parë, meqë ndërkaq ishin acaruar marrëdhëniet me Malin e Zi.

Por edhe pse u shtypën përsëri këto kryengritje, popullsia nuk u pajtua asnjëherë me politikën e egër antishqiptare të qeverisë osmane. Kjo e detyroi të dërgonte herë pas here ekspedita ushtarake kundër malësive të Shkodrës, të Prizrenit, të Gjakovës dhe të Dibrës, të cilat mbetën edhe më tej vatra të ndezura të qëndresës popullore.

Shqipëria në kuadrin e krizës ballkanike të viteve 60

Çështja e çlirimit dhe e bashkimit kombëtar të popujve ballkanas nuk gjeti zgjidhje as me Hat-i humajunin dhe as me Traktatin e Paqes të Parisit të vitit 1856. Përkundrazi me këtë traktat Anglia, Franca dhe Austro-Hungaria u bënë garante të tërësisë territoriale dhe të pavarësisë së Perandorisë Osmane. Popujt e shtypur të Ballkanit nuk u pajtuan me përmbytjen reaksionare të Traktatit të Parisit.

Një varg kryengritjesh çlirimtare shpërthyen gjatë viteve 60 në Hercegovinë, në Bullgari, në trevat serbe etj. Vetëm përpjekjet e diplomacisë së Fuqive të Mëdha Perëndimore dhe prirjet shoviniste të shteteve ballkanike e shmangën rrezikun e një lufte të përbashkët të popujve të shtypur të Ballkanit kundër Perandorisë së sulltanëve.

Porta e Lartë, nga ana e saj, bënte çmos që ta nënshtonte principatën e vogël të Malit të Zi, e cila i kishte shkaktuar asaj kaq telashe, kurse princi Danilo organizonte vazhdimisht provokacione në kufirin turko-malazias kundër viseve shqiptare, të cilat synonte t'i aneksonte.

Në fillim të vitit 1862 midis tyre shpërtheu lufta. Popullsia e Shkodrës dhe viset kufitare në Veri u shqetësuan nga sulmet e çetave malazeze drejt tokave shqiptare. Të nxitur nga Porta e Lartë, që ishte e interesuar të përdorte në luftë forcat e shqiptarëve, disa reparte vullnetarësh u nisën për në front. Më 26 shkurt, pas disa ndeshjesh paraprake, në një betejë të rreptë në Kërnice ata pësuan humbje të ndjeshme. Në një aksion të kryer nga disa çeta malazeze, komandanti i

një reparti vullnetarësh, Oso Kuka, mbeti i rrethuar në një kullë të ishullit të Vraninës (buzë liqenit të Shkodrës). Për të mos rënë në duart e malazezve, ai u vuri zjarrin fuçive të barutit dhe u hodh në erë bashkë me luftëtarët e tjerë shqiptarë, duke vrarë edhe kundërshtarët malazez që sulmonin kullën. Akti i tij u bë legjendar si shembull vetëmohimi për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Në vitet 60, për ndarjen e trojeve të Perandorisë Osmane në Gadishullin Ballkanik, ku përfshihej edhe Shqipëria, u aktivizuan përsëri qeveritë e Serbisë dhe të Greqisë. Qysh në vitin 1861, ato hynë në bisedime për një aleancë politiko-ushtarake kundër Turqisë. Në këto bisedime, të cilat nuk patën rezultat, të dyja palët i jepnin rëndësi qëndrimit të shqiptarëve si për potencialin e tyre ushtarak që e çmonin shumë, ashtu edhe për faktin se territori i Shqipërisë do të formonte hallkën ndërlidhëse midis frontit jugor grek dhe atij verior serb. Sipas fjalëve të kryeministrit serb I. Garashanin, pjesëmarrja e shqiptarëve në luftë ishte një kusht i domosdoshëm për fitoren mbi Turqinë.

Një mendim të tillë kishin edhe shumë diplomatë rusë. Njëri prej tyre, M. Hitrov, duke vlerësuar gjendjen në Shqipëri, ku vihej re një pakënaqësi e përgjithshme jo vetëm në malësitë dhe në radhët e borgjezisë së qyteteve, por edhe midis bejlerëve dhe pashallarëve të cenuar nga administrata e re, deklaronte më 1862: «Turqia jo vetëm nuk mund të shpresojë shumë në përkrahjen e shqiptarëve, por përkundrazi, në disa kushte të caktuara, pikërisht këtu përgatitet mbarimi i saj i shpejtë. Çdo gjë varet nga kjo: A do të përgatitet Shqipëria me kohë për ngjarjet e ardhshme? A do t'i kushtohet asaj vëmendja e duhur?»

Në gjendjen e krijuar në Gadishullin Ballkanik ndikuan edhe ngjarjet që kishin ndodhur në Italinë e afërt. Në vitet 1859-1861, si pasojë e një lëvizjeje të gjerë popullore, ishte realizuar, ndonëse akoma jo plotësisht, çlirimi dhe bashkimi i Italisë në një shtet.

Një rol të rëndësishëm në këto ngjarje kishte luajtur demokrati revolucionar Xhuzepe Garibaldi. Në luftë me diplomacinë e fuçive, Xh. Garibaldi mendonte ta zgjidhte çështjen e çlirimit dhe të bashkimit kombëtar jo vetëm të Italisë, por të të gjitha kombeve të shtypura, veçanërisht të Evropës

Juglindore dhe asaj Lindore, me anë të një lëvizjeje të gjerë revolucionare të vetë popujve, të cilët, sipas tij, ishin aleatë dhe duhej të harronin urrejtjet, grindjet dhe paragjykimet kombëtare dhe fetare. «Çështja e lirisë është një e vetme, cilido që të jetë populli që e mbron. Kur ta kenë kuptuar të gjithë popujt këtë të vërtetë... atëherë mbretëria e despotizmit do të marrë fund përgjithmonë... Kur të jetë përmbysur më në fund krenaria e Habsburgëve dhe të jetë dëbuar osmani barbar në shkretëtirat e tij, Adriatiku do të banohet, në dy brigjet prej popujsh të lirë, të denjë të duhen e të kuptohen si vëllezër...», deklaronte Garibaldi në një proklamantë të vitit 1862.

Vëmendja e revolucionarëve italianë u drejtua edhe nga Shqipëria. Arbëreshët e Sicilisë dhe të Kalabrisë, të cilët kishin luajtur një rol me rëndësi në lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të Italisë, shërbyen në këtë rast si ndërmjetës për vendosjen e lidhjeve midis revolucionarëve italianë dhe shqiptarëve.

Qendra kryesore për organizimin e bashkëpunimit midis Italisë dhe Ballkanit u krijua në Korfuz. Emisarët italianë filluan të përshkonin Shqipërinë dhe provincat e tjera ballkanike të Perandorisë Osmane. Me kërkesën e shqiptarëve, Garibaldi filloi të dërgonte armë në Shqipëri. Ai parashikonte t'i zbarkonte forcat e veta diku në bregun e Shqipërisë dhe, duke u bashkuar me forcat vendase, të niste marshimin drejt veriut.

Kjo ekspeditë, sipas mendimit të revolucionarit të shquar italian, do ta ndihmonte popullin shqiptar, që ai e çmonte si popull trim, të fitonte lirinë dhe do ta vinte diplomacinë evropiane, që nuk ishte për një kryengritje, përpara një fakti të kryer.

Por diplomacia evropiane dhe vështirësitë e brendshme e penguan një zhvillim të tillë të ngjarjeve. Këtë lëvizje u përpoq ta shfrytëzonte qeveria borgjeze italiane për shtrirjen e ndikimit të saj në bregun lindor të Adriatikut, ndërsa qeveria greke me anën e saj shpresonte të realizonte «Idenë e madhe». Nga ana tjetër, Porta e alarmuar nga mundësia e një zbarkimi të garibaldinëve, mori masa ushtarake duke bllokuar me flotën e saj bregdetin shqiptar dhe duke lidhur një

marrëveshje me Austrinë për të luftuar së bashku çdo lëvizje revolucionare në Ballkan.

Pas disfatës që pësoi Austria në luftën kundër Prusisë, më 1866, dhe duke marrë shkas nga kryengritja e popullsisë greke të Kretës, që shpërtheu po atë vit kundër zgjedhës osmane, Rusia filloi të bënte përsëri një politikë aktive në Ballkan. Duke synuar të vendoste ndikimin e saj në këtë zonë, diplomacia ruse kërkoi nga Porta njohjen e autonomisë së popujve të krishterë të Perandorisë.

Me memorandumet e kancelarit Gorshakov të datës 12 mars dhe 18 prill, qeveria ruse, duke u bërë një kritikë të ashpër reformave të deriatëhershme centraliste, paraqiste një projekt për krijimin e katër provincave të mëdha autonome në Turqinë Evropiane, që do të kishin të drejta mjaft të gjera vetëqeverisjeje. Por projekti rus e mbështeste parimin e autonomisë mbi fenë e popullsisë. Asnjëra nga provincat nuk do të kishte karakter homogjen nga pikëpamja etnike. Shqipëria e Veriut dhe Kosova do të bashkoheshin me Bosnjën dhe Hercegovinën me popullsi sllave, kurse Shqipëria e Jugut me Thesalinë dhe me krahinat e vilajetit të Janinës.

Politika ruse përpiqej njëkohësisht të krijonte në Shqipëri edhe një vatër të dytë kryengritjesh pranë Kretës, për ta ashpërsuar edhe më tej krizën. Diplomatët rusë u vunë në lidhje me disa feudalë shqiptarë të pakënaqur, midis të cilëve ishte edhe Xhelal Pashë Mati, i cili rronte në Stamboll nën vëzhgimin e Portës. Pashai shqiptar i premtoi Rosisë se do të mobilizonte forca të rëndësishme shqiptare për një kryengritje, me kusht që të kishte përkrahjen financiare dhe politike të Rosisë. Qeveria ruse e vuri pashën e Matit në lidhje me qeverinë serbe, e cila e siguroi se do ta përkrahte në përpjekjet për t'u bërë sundimtar i pavarur i vendit të tij. Lidhje të tilla qeveria serbe krijoi dhe me disa krerë bajraktarë të Veriut e të Dibrës.

Meqë ndërhyrja energjike e Anglisë nuk e lejonte të merrte pjesë haptazi në konfliktin midis Portës dhe kretasve, qeveria greke filloi të hidhte andartë në Thesali dhe në krahinat greke të vilajetit të Janinës. Qeveria e Athinës edhe kësaj radhe u përpoq të gjente mbështetje në viset e banuara prej shqiptarësh. Por propaganda e saj, ashtu si edhe më parë, hodhi parullën për formimin e një Greqie të Madhe, që kësaj

here shtrihej «nga gjiri i Burgasit në Detin e Zi e deri në Shkodrën e Shqipërisë në detin Adriatik», gjë që jo vetëm e bëri të pamundur çdo afrim me shqiptarët, por shkaktoi dhe kundërshtimin e vendosur të tyre.

Pas dështimit të bisedimeve serbo-greke të vitit 1861 dhe të nismave të tjera që u morën më 1862 e 1863 për një luftë të përbashkët kundër Turqisë, qeveritë e Athinës dhe të Beogradit i rifilluan ato në janar të vitit 1867 dhe i përfunduan më 26 korrik të atij viti me një traktat të nënshkruar në qytetin austriak Vëslau dhe me një konventë ushtarake, që u nënshkrua në Athinë, më 28 shkurt 1868. Gjatë këtyre bisedimeve të dyja palët hynë në pazarllëqe për ndarjen e territoreve dhe i trajtuan si plaçkë tregu, sidomos tokat shqiptare. Qysh në fillim ato ishin marrë vesh që Greqia nuk do ta kundërshtonte aneksimin prej Serbisë të Bosnjës, të Hercegovinës dhe të Shqipërisë Veriore gjer në Durrës, kurse Serbia do të pranonte bashkimin e Thesalisë, të Epirit (ku përfshihej Shqipëria Jugore dhe e Mesme deri në Durrës), të Maqedonisë, të Trakës dhe të ishujve të Egjeut me Greqinë. Këto ishin kërkesat maksimale të tyre që do të shërbenin si bazë për ndarjen territoriale pas fitores së luftës kundër Turqisë, kurse në traktat u përfshinë zyrtarisht kërkesa më të moderuara. Gjatë të gjitha bisedimeve, si edhe në dokumentet përfundimtare, shqiptarëve u kushtohej një vëmendje e veçantë. Të dyja palët merrnin përsipër të punonin me të gjitha mjetet për t'i pasur ata me vete në rastin e konfliktit me Turqinë, d.m.th. për t'i hedhur shqiptarët në një luftë, fitorja e së cilës do të çonte në copëtimin e atdheut të tyre.

Lëvizja e vitit 1862 në Mirditë

Qëndresa e vendosur që vazhdonte t'i bënte popullsia e Shkodrës dhe e malësive të saj politikës shtypëse të administratës së re osmane frymëzoi një grup intelektualësh të rinj shkodranë, të cilët u vunë në lëvizje për t'i dhënë luftës çlirimtare antiosmane një karakter më të organizuar. Ky grup përbëhej nga Zef Jubani, nga Pashko Vasa dhe nga disa klerikë katolikë patriotë si abati i Mirditës Gaspër Krasniqi etj.

Në nismën e këtij grupi ndikuan lëvizjet për çlirimin kombëtar, që po zhvilloheshin në vendet fqinje dhe në Itali dhe kontaktet e revolucionarëve italianë me rrethet patriotike shqiptare. Sipas planit të hartuar prej grupit të intelektualëve shkodranë, kryengritja që do të ishte pjesë përbërëse e lëvizjes së përgjithshme antiosmane në Ballkan duhej të shpërthente në Mirditë dhe prej këtej do të shtrihej edhe në malësitë e tjera. Për realizimin e këtij plani ata mbështeteshin në gatishmërinë për luftë që ekzistonte prej kohësh në popullsitë e armatosura të Malësisë, në rrethanat e krijuara nga gjendja e luftës me Malin e Zi që i lidhte duart Perandorisë Osmane, si edhe në ndihmën që shpresonin të kishin nga Franca. Në fakt, Napoleoni III prej disa kohësh kishte filluar t'i ndiqte me interes ngjarjet në Ballkan, me qëllim që ta rivendoste përsëri ndikimin e Perandorisë Franceze në Lindje. Në konfliktin malazias-turk Franca përkrahte principatën e vogël dhe nuk kursente premtime e ndihma edhe në Shqipëri, veçanërisht në Mirditë, e cila, për numrin e bajraqeve, për potencialin luftarak më të madh dhe për ndikimin që kishte midis malësive të tjera, kishte tërhequr vëmendjen e perandorit francez.

Sipas mendimit të grupit shkodran, kapedani i Mirditës, Bibë Doda, duhej të ngrinte së pari flamurin e kryengritjes dhe të shpallte një principatë shqiptare autonome ose të pavarur, rreth së cilës më vonë mund të bashkoheshin edhe krahinat e tjera të vendit.

Pasi arriti t'i ndalonte malësorët që të mos rekrutoheshin në repartet ndihmëse, të cilat kërkonte t'i ngrinte Porta, grupi i atdhetarëve shkodranë filloi të përgatiste truallin për kryengritjen. I trembur nga zhvillimi i ngjarjeve, kapedani Bibë Doda, i cili si pasha merrte një rrogë të majme, u tërhoq nga ndërmarrrja. Kur ai, me urdhër të qeverisë, u mundua të rekrutonte disa reparte vullnetarësh, në Mirditë shpërtheu një konflikt i ashpër, ku shumica e popullsisë u rreshtua kundër kapedanit, të cilin e akuzonin se donte të përfitonte në kurriz të saj, se edhe në fushatat e mëparshme kishte përvetësuar rrogat e vullnetarëve, se po i shpinte ata në një vdekje të sigurt etj. Në këto kushte ky u detyrua të largohej nga Mirdita dhe të kërkonte strehë e mbrojtje te valiu turk në Shkodër. Ndërkohë, mirditasit sulmuan shtëpitë dhe pronat e kapedanit në Kallmet dhe u vunë zjarrin.

Njëkohësisht reparte të tjera ndërprejnë rrugën Shkodër-Prizren. Situata u bë kërcënuese për Portën. Masa që mori ajo me arrestimin e abatit Gaspër Krasniqi, i cili ishte bërë udhëheqësi i lëvizjes në Mirditë, nuk e qetësoi, por përkundrazi e acaroi edhe më tepër gjendjen. Atdhetarët shkodranë nuk nguruan të akuzonin Bibë Dodë Pashën si «vrasës të popullit të tij» dhe qeverinë e sulltanit si «shtypëse të pamëshirshme të kombit shqiptar» dhe të vinin në dukje se Fuqitë e Mëdha si Anglia dhe Austria, të cilat me politikën e tyre përkrahnin «një kufomë që quhet Turqi», ndihmonin për të mbajtur edhe më tej nën zgjedhë popullsitë e Perandorisë Osmane.

Me gjithë fillimet e mbara, kryengritja në Mirditë nuk mori hov. Fitoret e rëndësishme që korri ushtria turke kundër malazezve në qershor, armëpushimi i arritur në gusht 1862 dhe dështimi i projekteve për kryengritjen e përgjithshme në Ballkan i hoqën lëvizjes mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm. Për më tepër, kundër saj ndërhyri tani edhe diplomacia austriake, e cila e shihte me shqetësim gjithnjë e më të madh zhvillimin e ngjarjeve në Shqipërinë e Veriut. Hovi i kryengritjes ra. Pas disa kohësh Bibë Doda u kthye përsëri në Mirditë si kapedan-pashë.

Me përpjekjet e përfaqësuesve të kulturuar të borgjezisë për t'u lidhur me lëvizjen popullore antiosmane dhe për ta organizuar e për ta drejtuar atë bëhej një hap i ri në Lëvizjen Kombëtare. Por lëvizja u projektua në një zonë të ngushtë, të banuar vetëm prej popullsisë katolike, pa lidhje me krahina të tjera dhe për më tepër u zhvillua vetëm në Mirditë, në një nga krahinat më të prapambetura të vendit.

Konfliktet e reja shqiptaro-osmane në vitet 1867-1873

Orvatjet që bënte herë pas here Porta e Lartë për të zbatuar Tanzimatit në zonat e panënshtuara të vendit, ku rreshin venomet tradicionale ose për të vendosur taksa të reja që rëndonin në mënyrë të veçantë popullsinë, shoqëroheshin me konflikte të reja. Në vitet 1867-1868 Porta e Lartë ndërmori ekspedita të reja kundër krahinave të Lumës dhe të Malësisë

së Gjakovës. Por zaptiet (xhandarët) turq që vajtën për të nxjerrë taksa dhe rekrutë u pritën me pushkë dhe u dëbuan nga popullsia e udhëhequr nga krerët Binak Alia dhe Shaqir Curri. Njëfarë sukse si patën autoritetet turke në Mirditë pas vdekjes së Bibë Dodë Pashës, më 1868; ato larguan për në Stamboll trashëgimtarin e tij të mitur, Prengën, dhe vendosën një kaimëkam nga gjiri i familjes së kapëdanit të vdekur si dhe dy batalione. Megjithatë, Porta nuk mundi ta thyente qëndresën e mirditasve, të cilët, duke kërkuar që trashëgimi të respektohej sipas zakonisht, e mbrojtën për një kohë të gjatë autonominë e tyre. Më 1873 atje shpërtheu kryengritja e disa muaj më vonë ajo u shtri edhe në Dukagjin. Ekspedita osmane u soll shumë egërsisht me popullsinë, por duke mos mundur ta nënshtrojë atë u detyrua të tërhiqej.

Në vitin 1869, presioni i ushtruar nga organet e Portës shkaktoi revolta në qytetet Pejë, Gjakovë e Prizren. Lëvizja mori përpjesëtime të mëdha veçanërisht në Shkodër. Pakënaqësia e shkodranëve shpërtheu atëhere kur valiu vendosi tri taksa të reja, e veçanërisht «karagjymrykun». Tani fshatarët detyroheshin të paguanin 8 për qind të vleftës për çdo mall që çonin në qytet. Kjo taksë shkaktonte shtrenjtimin e ndjeshëm të jetesës dhe dëmtonte veçanërisht shtresat e vegjëlisë. Me këtë rast borgjezia shkodrane paraqiti ankesat e vjetra kundër korrupsionit të valiut dhe të gjyqëve, si dhe kundër abuzimeve që bëheshin me monopolet shtetërore të kripës dhe të duhanit. Shkodranët dhanë kushtimin dhe kërkuan ndihmën e malësorëve. Por autoritetet turke, duke nxitur fanatizmin fetar, ia dolën ta përçanin popullsinë qytetare dhe të largonin një pjesë të saj nga lufta. Megjithatë, malësorët i sulmuan forcat e rëndësishme ushtarake që ishin përqendruar pranë qytetit, në fushën e Shtojit. Por pas një përlëshjeje të ashpër me një armik më të madh në numër e të armatosur mirë, malësorët e pushuan zjarrin, duke lënë në fushën e luftës shumë të vrarë e të plagosur.

Në vitin 1869 ndodhën turbullira në krahinën e Matit dhe në qytetin e Tiranës. Për shpërthimin e trazirave në Tiranë u bë shkak urdhri i qeverisë për të ndërtuar rrugën për në Durrës vetëm me shpenzimet dhe me punën e qytetarëve dhe të fshatarëve që ndodheshin buzë rrugës. Meqenëse paria feudale e qytetit gjeti mënyrë për të shpëtuar nga çdo detyrim,

e gjithë barra i mbeti vegjëlisë, e cila protestoi duke rrëmbyer armët, ndërsa zejtarët mbyllën dyqanet. Qëndresa vazhdoi edhe pasi në përleshje me repartet ushtarake u vranë mjaft qytetarë dhe u internua një numër i madh udhëheqësish.

Më 1872 ushtria osmane që u dërgua në Dibër u thye me humbje mjaft të rënda. Të njëjtin fat patën orvatjet për të nënshtruar zonat malore të Kosovës në vitet 1872-1874. Në një letër të shkruar nga Prizreni, në tetor 1873, thuhej se përballë ushtrisë së madhe turke që po depërtonte në Kosovë shqiptarët nuk rrinin duarkryq. Ata, thuhej në letër, «dëshirojnë ta ndezin zjarrin dhe janë të vendosur të luftojnë dhe të qëndrojnë përballë ushtrisë turke pa marrë parasysh nëse do t'i ndihmojë ndokush apo jo. Ata kurrsesi nuk e pranojnë pushtetin turk dhe dëshirojnë të çlirohen nga ai». Edhe në Malësitë e Kosovës, ashtu si në malësitë e tjera të Shqipërisë së Veriut, autoritetet turke ushtronin një pushtet formal, duke e kufizuar veprimtarinë e tyre vetëm në qytetet dhe në afërsitë e tyre.

Megjithëse të kufizuara dhe shpeshherë spontane këto konflikte ishin rrëke që çonin ujë në shtratin e Lëvizjes së përgjithshme Kombëtare dhe i jepnin peshë çështjes shqiptare në arënenë ndërkombëtare.

Rrymat politike në Lëvizjen Kombëtare në fund të viteve 60 dhe në fillim të viteve 70

Qarqet borgjeze shqiptare ishin para së gjithash të interesuara të zhdukeshin anarkia dhe grabitjet sistematike që bënë sunduesit osmanë në bashkëpunim me feudalët vendas. Përveç kësaj, ato ishin të pakënaqura nga shpenzimi joprodhues i shumave të konsiderueshme që nxirreshin nga Shqipëria duke varfëruar fuqinë blerëse të tregut shqiptar, pa i dhënë vendit asgjë që të ndihmonte zhvillimin e tij ekonomik.

Me dështimin e kryengritjeve kundër reformave të Tanzimatit, kur një rol të rëndësishëm luajtën qytetet kryesore të vendit, rrethet borgjeze i kishin humbur shpresat se mund t'u vinte ndonjë ndihmë nga shteti osman për zhvillimin e tregtisë, të industrisë dhe për mbrojtjen nga depërtimi shkatërrim-

tar i mallrave të huaja. Për më tepër, me zbatimin e reformave të Tanzimatit elementët e borgjezisë shqiptare ishin përjashtuar pothuajse krejtësisht nga pozitat drejtuese të administratës së re. Përveç kësaj, dobësimi i Perandorisë Osmane po e bënte gjithnjë më të qartë se ajo nuk ishte në gjendje të mbronte territoret e saj nga orvatjet ekspansioniste të shteteve të tjera. Pikërisht këto lakmi të monarkive ballkanike fqinje, që u drejtuan në mënyrë të theksuar edhe ndaj tokave shqiptare, u bënë një faktor tjetër i rëndësishëm shqetësues për qarqet borgjeze si edhe për çifligarët.

Në këto kushte, në fund të viteve 60, ideologët e Lëvizjes Kombëtare i formuluan hapur e më gjerë kërkesat për reforma ekonomike, shoqërore e politike. Një ndër këta ishte Zef Jubani nga Shkodra (1818-1880).

Bir i një tregtari, Zef Jubani mësimet e para i mori në Shkodër edhe i vazhdoi në shkollën e mesme tregtare në Maltë. Jashtë atdheut ai ra në kontakt, si edhe intelektualë të tjerë të rinj shqiptarë të kësaj kohe, me qarqet demokrate të vendeve të Evropës Perëndimore dhe veçanërisht të Italisë, ku u lidh ngushtë edhe me personalitetet arbëreshe.

Zef Jubani iu vu mbledhjes dhe studimit të folklorit të pasur të Shqipërisë së Veriut. Idetë e tij ai i parashtrroi në mënyrë më të qartë në dy studime: «Gjendja aktuale e popullit të Shqipërisë së Veriut» dhe «Kundërime mbi gjendjen morale dhe mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar», që u botuan, më 1871, si hyrje e një përmbledhjeje këngësh popullore. Duke përshkruar gjendjen e vajtueshme ekonomike, shoqërore e kulturore, ku e kishte lënë popullin shqiptar sundimi i huaj, Zef Jubani vinte në dukje traditat pozitive të së kaluarës së lavdishme të popullit shqiptar, shprehte besimin në aftësitë e tij për të ecur përpara dhe bënte thirrje për bashkim e për të vënë të gjitha energjitë në shërbim të atdheut të robëruar.

Zef Jubani i kritikonte ashpër ligjet e padrejta, vendimet arbitrare, taksat e rënda, angaritë dhe gjykatat osmane që drejtoheshin nga të paditur e që shkelnin drejtësinë. Ai dënonte qeveritarët osmanë, të cilët, gjoja për të luftuar zakonin barbar të hakmarrjes, përdornin mjete edhe më barbare. «Në këto kushte, thoshte Jubani, në Shqipëri nuk do të mund të zërë kurrë vendin ideja e qytetërimit». Prandaj ai kërkonte që në Shqipëri të vendosej barazia politike pa marrë parasysh

ndryshimet fetare, sepse shqiptarët «janë të një gjaku dhe janë të njëjtë për nga gjuha, për nga zakonet, për nga aspiratat» Krahas ligjeve të përgjithshme të Perandorisë, Jubani kërkonte që të kishte edhe ligje të veçantë për Shqipërinë «të nxjerra prej statutesh kombëtare nga më të mirat e më të përshtatshme». Ai shprehej në mënyrë të prerë kundër idealizimit të privilegjeve që kishte pasur dhe i ruante malësia. Ruajtja e tyre, sipas mendimit të tij, donte të thoshte ruajtje e një gjendjeje arbitrariteti e barbarie. Ai ishte për zbatimin e reformave themelore, për ndërtimin e rrugëve e të hekurudhave, për themelimin e «ndërmarrjeve publike», për zhvillimin e lundrimit me avullore e të tregtisë, për shfrytëzimin e pasurive natyrore të vendit.

Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive të popullit shqiptar, sipas Zef Jubanit, duhej të luante shkolla kombëtare e laike, me mësues vendas e jashtë çdo ndikimi fetar. Mësimin e gjuhës shqipe ai e quante shumë më të nevojshëm për veprimtarinë e ndërmarrësve shqiptarë, sesa atë të turqishtes ose të italishtes, aq më tepër që shkollat në gjuhë të huaja e ftohnin ndjenjën kombëtare. Jubani ishte për një alfabet të vetëm të gjuhës shqipe dhe kundër atyre që shkruanin vetëm me shkronjat latine ose greke. Krijimin e një alfabeti të përbashkët ai e quante një shërbim të paharrueshëm për popullin shqiptar. Në shkrimet e tij shqip ai përdori një alfabet të posaçëm me një sistem të ri shkronjash me bazë alfabetin latin dhe hartoi një gramatikë të thjeshtë të gjuhës shqipe.

Për të ngritur ndërgjegjen dhe krenarinë kombëtare të bashkatdhetarëve të tij Jubani shkroi edhe një «Histori të jetës dhe të veprave të Gjergj Kastriotit», që mbeti dorëshkrim e që nuk mundi të shohë dritën e botimit.

Ndonëse vinte në dukje me ngjyra të forta gjendjen e mjerueshme që karakterizonte Shqipërinë, Zef Jubani theksonte se nuk kishte arsye për t'u dëshpëruar. Ai drejtohej me urrejtje të veçantë kundër «reshperëve që s'bëjnë asgjë dhe presin, duke ndenjtur me duarkryq, shpëtimin dhe qytetërimin e Shqipërisë nga kombet e huaja», d.m.th. kundër atyre përfaqësuesve të borgjezisë tregtare që e kishin lidhur fatin e vet politik me një shtet të huaj. «Unë nuk i besoj sinqeritetit të të huajve që të na bëjnë një të mirë pa pasur një qëllim të dytë» deklaronte Jubani. Si vegla të këtyre qëllimeve të fshehta ai demaskoi në

mënyrë të veçantë klerin e huaj katolik në Shqipërinë e Veriut, që kishte përvetësuar këtu monopolin e arsimit e të kulturës dhe i përdorte këto për të luftuar përparimin. Zef Jubani u shpreh edhe kundër pozitës mbizotëruese, që mbante Austro-Hungaria në ekonominë e Shqipërisë, duke dëmtuar kështu interesat e borgjezisë shqiptare. Për këtë veprimtari të tij ai u luftua shumë ashpër nga kleri katolik që e quante atë «njeri të asnjë feje», «...shumë të rrezikshëm nga çdo pikëpamje, sidomos në raportet politike».

Duke kërkuar ligje, kode e institucione të veçanta të përshtatshme për popullin shqiptar, i cili tanimë, sipas tij, ishte «formuar si një komb i bashkuar», Zef Jubani shprehte hap-tazi kërkesën e borgjezisë shqiptare për autonomi, d.m.th. për njohjen e interesave të veçanta të territorit që banohej nga kombi shqiptar, të cilin ajo e konsideronte si treg të saj dhe donte ta dallonte nga territori i kombësive të tjera të Perandorisë Osmane.

Nga fundi i viteve 60, kur u acaruan marrëdhëniet ndër-kombëtare në Gadishullin Ballkanik, disa intelektualë të tjerë shqiptarë, si Thimi Mitkoja (1820-1890), Preng Doçi etj., shfaqën mendimin se kishte ardhur koha për një kryengritje të përgjithshme kombëtare dhe për shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Turqia.

Por, nga ana tjetër, vetë Thimi Mitkoja mendonte në këtë kohë se shteti i ri shqiptar do të ishte tepër i dobët për t'u bërë ballë rreziqeve që i vinin nga jashtë dhe prandaj ishte i mendimit që Shqipëria, duke ruajtur individualitetin e vet shtetëror, të formonte me fqinjën e saj në jug, Greqinë, një mbretëri dualiste, sipas shembullit të Austro-Hungarisë. Mitkoja mendonte se ishte në interes të vetë Greqisë t'u respektonte shqiptarëve të gjitha të drejtat kombëtare në shtetin e tyre, për t'i pasur si aleatë kundër një zgjerimi territorial të Serbisë drejt jugut, e veçanërisht në Maqedoni. Ky mendim, i cili përkrahej edhe nga disa qarqe arbëreshe, nënvleftësonte rrezikun që kërcënonte Shqipërinë për shkak të prirjeve ekspansioniste të qarqeve drejtuese të Greqisë që Mitkoja, me sa duket, nuk i njihte mirë. Vënia në jetë e këtij mendimi krijonte kushte shumë të favorshme për realizimin e planeve shoviniste të Athinës.

Intelektualët arbëreshë si edhe shkrimtarja përparimtare

rumune me prejardhje të largët shqiptare, princesha Elena Gjika*, që bashkëpunonte me ta, mendonin se kriza e krijuar në Ballkan duhej shfrytëzuar për një kryengritje shqiptare, e cila do të lidhej me lëvizjet e tjera kryengritëse në Evropë.

Për këtë qëllim grupi i arbëreshëve u vu në lidhje me qarqe demokratike përparimtare italiane dhe të Evropës Perëndimore në përgjithësi, të cilat mendonin se në Gadishullin Ballkanik vendin e Perandorisë Osmane duhej ta zinte një konfederatë popujsh e shtetesh me të drejta të barabarta. Përkërisht në këtë periudhë K. Marksi dhe F. Engelsi, duke analizuar thelbin e çështjes lindore, dënonin metodat e diplomacisë evropiane, që kërkonte t'u përgatiste popujve të Lindjes një robëri të re. Kundër kësaj politike ata vinin programin e demokracisë evropiane, i cili duhej të realizohej me anë të revolucionit. Marksi dhe Engelsi konsideronin të drejtë vetëm atë zgjidhje të çështjes lindore që do t'u jepte pavarësinë kombëtare kombësive të shtypura të Turqisë dhe do t'i shpëtonte ato nga intrigat e diplomacisë së shteteve të mëdha. «Zgjidhja e problemit turk... i bie si detyrë revolucionit evropian», shkruante K. Marksi dhe F. Engelsi¹.

Në kushtet e Shqipërisë, kur shumica e madhe e feudaleve të vendit, me gjithë konfliktet që kishin grupe të caktuara të tyre me pushtetin qendror, e shihnin të nevojshme ruajtjen e lidhjeve me Portën e Lartë dhe lidhjet fetare me kalifatin ushtronin gjithnjë një ndikim të madh në masat e besimtarëve myslimanë, kur borgjezia shqiptare ishte e dobët, pjesërisht e varur nga tregu i huaj dhe e përçarë nga ndikimi i feve, më realiste ishin kërkesat e atyre përfaqësuesve të mendimit politik shqiptar si Zef Jubani etj., të cilët, pa hequr dorë nga synimi kryesor i çlirimit të vendit, e quanin të parakohshme shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Turqia. Një Shqipëri e pavarur, por ende e dobët dhe e pamëkëmbur, sipas mendimit të tyre, mund të binte së shpejti viktimë e politikës grabitqare të shteteve fqinje, ndërsa duke qëndruar në kuadrin e Perandorisë Osmane si provincë autonome, Shqipëria do të siguronte më mirë tërësinë e saj jo vetëm sepse do të kishte një admi-

* Elena Gjika (1829-1888) njihet me pseudonimin Dora d'Istria.

¹ K. Marks - F. Engels, *Veprat*, bot. gjerm., vëll. 9, f. 33.

nistratë shqiptare, por edhe sepse tërësia tokësore e Perandorisë mbrohej edhe nga Porta dhe ishte garantuar nga një sërë marrëveshesh të Fuqive të Mëdha.

5) KULTURA KOMBËTARE NË VITET 50-70

Përpjekjet për organizimin e shoqërisë kulturore dhe çështja e alfabetit të gjuhës shqipe

Qysh në vitet 50 jo vetëm në Shqipëri dhe në Vllahi, ku vazhdonte punën N. Veqilharxhi, por edhe në Stamboll, ku ishin grumbulluar shumë shqiptarë: tregtarë, nëpunës, intelektualë të ardhur nga krahina të ndryshme të vendit, vazhduan përpjekjet për lëvrimin e shqipes dhe hapjen e shkollave kombëtare. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim u bë në vitet 50 me themelimin e një shoqërie kulturore në Stamboll, qëllimi i së cilës ishte të grumbullonte mjetet e nevojshme për shtypjen e librave dhe për mbajtjen e shkollave. Shoqëria i vinte vetes si detyrë të përfshinte në gjirin e saj përfaqësues të të gjitha krahinave dhe feve. Vetëm kështu, siç deklaronte më 1857 një nga anëtarët e saj, Th. Mitkoja, do të mund të sigurohej qëllimi i shoqërisë «ringjallja e përgjithshme kombëtare».

Themelimi i shoqërisë së Stambollit qe hapi i parë që bënë aktivistët e Lëvizjes Shqiptare për të dalë nga faza e veprimeve të veçuara, për të krijuar një bërthamë organizative e përfaqësuese të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Anëtarët e shoqërisë bënë përpjekje brenda dhe jashtë Shqipërisë për të siguruar përkrahje për realizimin e qëllimeve të saj.

Por veprimi i atdhetarëve shqiptarë nuk dha rezultate, sepse u prit me armiqësi nga Porta e Lartë dhe nga qarqet panheleniste me Patrikanën Greke të Stambollit në krye.

Situata e krijuar veçanërisht me krizën e viteve 60, e cila hapi për popujt e Perandorisë perspektivën e çlirimit të tyre, i nxiti atdhetarët që të rifillonin përpjekjet për orga-

nizimin e lëvizjes kulturore kombëtare. Nismën për këtë e mori Kostandin Kristoforidhi nga Elbasani.

K. Kristoforidhi (1830-1895) i kishte kryer studimet e larta në Maltë dhe në Angli. Nga albanologu i njohur J.G. Han ai kishte marrë nxitjen e parë për t'iu kushtuar studimeve shqiptare dhe shumë shpejt u bë një njohës i thellë i gjuhës shqipe.

Si N. Veqilharxhi, edhe K. Kristoforidhi kishte arritur në përfundimin se mësimi i shqipes kishte një rëndësi të jashtëzakonshme si shprehje e ekzistencës së kombit shqiptar dhe e të drejtave të tij, si mjet vëllazërimi midis shqiptarëve të feve e të krahinave të ndryshme. Ai e shprehte këtë më vonë me fjalët: «Ndë mos u shkroftë gjuha shqipe, nuk do të shkojnë shumë vjet dhe nuk do të ketë Shqipëri në faqe të dheut, as nuk do të shënohet më emri shqiptar në hartë të botës».

Qysh në vitin 1864, sapo kishte vajtur në Stamboll, në bashkëpunim me bashkatdhetarë të tjerë që ndodheshin atje, si Pashko Vasa nga Shkodra, Ismail Qemali nga Vlora, Hoxha Hasan Tahsini nga Filati i Çamërisë, Kostandin Kristoforidhi kishte organizuar një varg mbledhjesh për ringjalljen e shoqërisë kombëtare. Në këto mbledhje morën pjesë shumë shqiptarë që ndodheshin në Stamboll. Në to u bisedua përsëri mbi nevojën e sigurimit të mjeteve financiare për «shkronja dhe për shkolla shqipe». Por kusht i domosdoshëm për hapjen e shkollave dhe për shtypjen e librave shqip ishte caktimi i një alfabeti të vetëm të shqipes, që të njëjët dhe të përdorej nga të gjithë shqiptarët si alfabeti i tyre kombëtar në vend të alfabetëve të shumta që ishin në përdorim dhe që pengonin mësimin e gjuhës amtare (alfabeti latin në Shkodër, alfabeti grek ndër ortodoksët e Jugut, alfabeti arab midis myslimanëve, alfabeti i Dhaskal Todhrit dhe i Veqilharxhit në disa krahina të veçanta).

Por, që në mbledhjet e para ishin dukur shenja moskuptimi midis pjesëmarrësve në lidhje me caktimin e alfabetit. Mosmarrëveshjet nxiteshin nga Porta, e cila ia arriti qëllimit që mbledhja të shpërndahej pa dhënë fryt.

Më 1867 këto përpjekje u përsëritën. K. Kristoforidhi, P. Vasa, H. Tahsini, I. Qemali, me të cilët u bashkuan dhe shqiptarë të tjerë si bankieri Kristaq Zografi, funksionarë shqiptarë të Portës si Mustafa Pashë Gjiriti, Rustem Pashë Lesko-

viku etj., iu drejtuan kryeministrit Ali Pasha me lutje që të lejonte veprimin e një shoqërie shqiptare me karakter kulturor.

Gjendja e nderë në Ballkan e kishte bindur Ali Pashën dhe disa përfaqësues të qarqeve qeveritare osmane se vazhdimi i politikës së forcës ndaj shqiptarëve dhe pengimi i çdo përpjekjeje të tyre për përparim do ta thellonte armiqësinë ndaj Portës jo vetëm të të krishterëve, por edhe të myslimanëve shqiptarë dhe do të bënte që shqiptarët të merrnin të gjithë anën e armiqve të Perandorisë. Përkundrazi, liria e mësimit të gjuhës, sipas tyre, do t'i lidhte myslimanët shqiptarë më ngushtë me Portën, ndërsa të krishterët do t'i neutralizonte. Për këtë arsye Ali Pasha autorizoi dhe inkurajoi komisionin të vazhdohte mbledhjet e tij. Anëtarët e komisionit iu përveshën përsëri punës për ringjalljen e shoqërisë kulturore. Mirëpo hovi që po merrte lëvizja patriotike në radhët e shqiptarëve ortodoksë e trembi shumë Patrikanën Greke, e cila ushtroi presion mbi ta për t'i larguar nga rruga e Lëvizjes Kombëtare.

Në të njëjtën kohë filloi të ndryshonte edhe qëndrimi i kryeministrit turk ndaj nismës shqiptare. Qarqet konservatore në Portën e Lartë «kursin e butë» të Ali Pashës ndaj çështjes shqiptare e konsideruan të rrezikshëm për unitetin e islamizmit dhe të Perandorisë, meqenëse u haptë shtegun edhe kërkesave të kombësive të tjera myslimane. Nën presionin e tyre, Ali Pasha filloi t'i nxirrte pengesa komisionit nismëtar e pak më vonë ta ndalonte krejtësisht veprimtarinë e tij.

Me gjithë dështimin që pësoi më 1867, grupi i atdhetarëve të Stambollit nuk hoqi dorë nga përpjekjet për të krijuar një qendër të Lëvizjes Kombëtare. Kjo mbetej një detyrë e përhershme, veçanërisht në kushtet e zgjerimit të luftës që i bënin Lëvizjes Shqiptare Patrikana dhe Porta. Në vitin 1867 nën hijen e Patrikanës ishte themeluar organizata me emrin «Vëllazëria qendrore kulturore» dhe më 1871 «Silogu (klubi — red.) kulturor epirot», president nderi i të cilit u zgjodh renegati i çështjes shqiptare bankieri K. Zografi. Ku synonte në të vërtetë Silogu, kjo shihej qartë në statutin e tij, në të cilin gjente shprehje shqetësimi që kishte kapur Patrikanën me qarqet shoviniste greke për përparimin që po bënte Lëvizja Kombëtare edhe në popullsinë e krishterë shqiptare. Duke vënë në dukje se edhe në vise të largëta malore, siç ishte krahina e Shpatit të Elbasanit, kishte filluar të mësohej fshehurazi gjuha

shqipe, statuti theksonte nevojën për të shtuar përpjekjet për përhapjen e arsimit grek në Shqipëri. Nën kujdesin e Silogut e me lejën e qeverisë osmane në Shqipërinë e Jugut e të Mesme u hapën dhjetëra shkolla greqisht krahas atyre turqisht.

Kjo veprimtari e qarqeve shoviniste greke bashkërendohej me politikën thellësisht antishqiptare të Portës së Lartë, e cila ua mohonte shqiptarëve të drejtën për të mësuar gjuhën amtare. Edhe gazeta zyrtare, që filloi të dilte më 1871, në Prizren, botohej turqisht e serbisht, ndërsa në Janinë turqisht e greqisht.

Në këto kushte, në vitin 1871, atdhetarët shqiptarë në Stamboll i rifilluan përpjekjet për krijimin e një organizate patriotike shqiptare. Një rol të rëndësishëm në këto përpjekje, krahas K. Kristoforidhit, luajti H. Tahsini (1832-1884), i cili i kishte bërë studimet në Francë dhe ishte një figurë e shquar e shkencës. Hasan Tahsini nuk reshti së predikuari se mësimi i gjuhës shqipe, edhe me germa joarabe, nuk ishte aspak në kundërshtim me frymën e kuranit. Rreth tij u bashkuan jo vetëm personalitete që ishin aktivizuar qysh në përpjekjet e para, por edhe intelektualë të rinj si Sami Frashëri, Jani Vretoja etj. Por Porta e Lartë edhe kësaj here i nxori pengesa komisionit nismëtar, duke ngulur këmbë që puna e tij të kufizohej vetëm me të krishterët shqiptarë, kurse myslimanët s'duhej të kishin asnjë lidhje me këtë çështje.

Kundërshtime u shfaqën edhe në vetë gjirin e komisionit. Disa pashallarë, të nxitur nga Porta, kërkonin që gjuha shqipe të shkruhej me alfabetin arab. Kundër kësaj zgjidhjeje që shumica e anëtarëve të komisionit, të cilët vinin në dukje se jo vetëm për arsye shkencore, por edhe politike, shqiptarët, si anëtarë të familjes evropiane, nuk duhej të përdornin një alfabet oriental, por evropian.

Një grup tjetër, me J. Vreton në krye, duke u mbështetur në tezën e prejardhjes së përbashkët pellazgjike të popullit shqiptar e grek dhe të lidhjeve kulturore midis tyre, u shpreh për alfabetin grek. Për alfabetin latin ishte më në fund një grup i tretë, me Pashko Vasën, Ismail Qemalin dhe K. Kristoforidhin, edhe në argumente praktike (siç ishte fakti që germat latine nuk duheshin derdhur veçanërisht, por gjendeshin të gatshme në çdo shtypshkronjë).

Një zgjidhje tjetër propozonte H. Tahsini, i cili, ashtu

si N. Veqilharxhi, mendonte se në kushtet e Shqipërisë duhej përdorur një alfabet i ri, krejt i veçantë, për të cilin shkronjat i kishte shpikur vetë.

Komisioni arriti më në fund në marrëveshjen për të hartuar alfabetin duke u mbështetur në parimin themelor «për secilin tingull një germë». Ky parim përjashtonte adoptimin e pandryshuar si të alfabetit latin, ashtu edhe të alfabetit grek, të cilët tingujt e veçantë të shqipes nuk mund t'i shkruanin pa dyzime germash. Por çështja e alfabetit dhe formimi i shoqërisë kulturore shqiptare nuk mundën të zgjidheshin përfundimisht. Porta mbajti një qëndrim kërcënues dhe pashallarët shqiptarë u larguan menjëherë nga komisioni. Në të njëjtën kohë edhe Patrikana i shtoi intrigat e saj kundër Lëvizjes patriotike Shqiptare. Në këto kushte komisioni u detyrua të ndërpriste edhe këtë herë punën, pa arritur ndonjë përfundim konkret.

Me gjithë vështirësitë që hasën, atdhetarët nuk hoqën dorë nga qëllimet e tyre. Por duke mos pasur lejën dhe mundësitë që të vepronin haptazi për lëvrimin e mësimin e gjuhës amtare, ata përpiqeshin të punonin fshehurazi, duke bërë çdo fli. Koto Hoxhi nga Qestorati i Gjirokastrës (1824-1895), i cili ishte emëruar më 1873 mësues në Normalen e Qestoratit, në orët e lira u mësonte fshehurazi nxënësve shqipen dhe u ngjallte atyre dashurinë për gjuhën, për atdheun, për bashk-atdhetarët e feve të tjera. Kjo veprimtari patriotike e futi Koto Hoxhin në grindje me konsullin grek dhe me peshkopin e Gjirokastrës. Peshkopi e shkishëroi dhe njëkohësisht vuri njerëz ta sulmonin atdhetarin. Por ky nuk u tërhoq para vështirësive. Kështu, nga shkolla e Qestoratit nuk dolën vetëm mësues fanatikë të helenizmit, por edhe atdhetarë si Pandeli Sotiri dhe Petro Nini Luarasi, të cilët ndoqën rrugën e mësuesit të tyre.

Lëvizja letrare dhe botimet shkencore

Fundi i viteve 60 shënoi një etapë me rëndësi në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare. Ky zhvillim pasqyrohej edhe në rritjen e letërsisë shqipe.

Një veprimtari të madhe në këtë fushë zhvilloi K. Kristoforidhi. Duke hyrë në shërbim të një organizate protestane angleze të Shoqërisë Biblike, e cila botonte përkthime të ungjillit në gjuhët e ndryshme të botës për përhapjen e ideologjisë fetare, Kristoforidhi kishte shpresë që të realizonte planet e tij për zhvillimin e letërsisë në gjuhën shqipe me fondet e kësaj shoqërie. Dhe me të vërtetë, në vitet 1864-1872, me ndihmën e Shoqërisë Biblike, ai mundi të botonte mbi 10 vëllime, midis të cilave ishin disa përkthime të rëndësishme fetare si «Dhjata e re» etj.

Por Kristoforidhi nuk mendonte ta kufizonte veprimtarinë e vet vetëm në botime fetare. Në këtë kohë ai vazhdoi punën për hartimin e një fjalori themelor të gjuhës shqipe dhe përgatiste një varg botimesh popullore, si dhe një revistë kulturore. Nga këto ai mundi të botonte, më 1867, «Abetaren e gjuhës shqipe» toskërisht dhe gegërisht. Ndonëse planet e tij për mungesë përkrahjeje nuk mundën të realizoheshin veçse pjesërisht, veprimtaria e K. Kristoforidhit në këto vite pati një rëndësi të madhe. Përkthimet e shkrimeve fetare të tij u bënë objektivisht një mjet lufte kundër propagandës shkombëtarizuese të kishës greke; ato shënonin një hap të ri drejt krijimit të një kishë ortodokse shqiptare dhe rrëzonin pretendimet e «panhelenistëve», që thoshin se gjuha shqipe ishte një gjuhë e varfër dhe nuk mund të shërbente si gjuhë kulture. Me përkthimet e tij Kristoforidhi bëri gjithashtu një punë të madhe për pasurimin e gjuhës së shkruar me një varg termash dhe shprehjesh të nxjerra nga gjuha e popullit. Për më tepër, me shkrimet e tij ai ndihmoi për afrimin e dy dialekteve kryesore të shqipes: gegërishtes dhe toskërishtes, duke marrë si bazë për përkthimet e tij gegërisht autorët e vjetër të Shqipërisë së Veriut që ishin shumë afër toskërishtes.

Në këto vite letërsia shqiptare filloi të merrte përmbajtje të re më të përparuar, lidhur me detyrat e reja që shtronte gjendja. Kështu, krahas shkrimeve me karakter fetar e didaktik, që kishin mbizotëruar deri tani, filloi të trajtohej tema patriotike. Në këto krijime rilindësit u bënë thirrje bashkëatdhetarëve për të luftuar sundimin e huaj, për ta vënë çështjen kombëtare përmbi fetë, për të zhvilluar e për të lëvruar gjuhën e kulturën kombëtare. Një rol të rëndësishëm si aktivist i letërsisë artistike shqipe dhe i Lëvizjes Kombëtare në

përgjithësi filloi të luante në këto vite Thimi Mitkoja nga Korça. I mërguar në Egjipt, ai zhvilloi një veprimtari të madhe e të frytshme për mbledhjen e folklorit shqiptar.

Në të njëjtën kohë filloi të shkruante vjershat e tij Spiro Risto Dineja nga Vithkuqi i Korçës (1846-1922). Ato përshkoheshin nga fryma patriotike. Shovinistëve grekë Dineja nuk ua kurseu qortimet për armiqësinë që tregonin kundrejt shqiptarëve si, p.sh., për vrasjen e pabesë të N. Veqilharxhit.

Dashuria për atdheun gjeti një shprehje të zjarrtë dhe artistikisht të lartë në vjershat e Preng-Doçit (1846-1917) siç dëshmojnë, ndër të tjera, vargjet:

*«Shqyptarë trima, zgjedhën lshoni,
kputni prangat e luftoni»!*

Fryma patriotike përfshiu edhe të tjerë poetë klerikë katolikë të Veriut si Pjetër Zarishin (1806-1866), Ndue Bytyçin (1847-1917), Leonard de Martinon (1830-1923) etj.

Në këtë lëvizje morën pjesë edhe intelektualë arbëreshë, duke dhënë një ndihmë të çmuar në dobi të çështjes shqiptare.

Besnikë ndaj traditave demokratike, që ishin shfaqur edhe me pjesëmarrjen masive të arbëreshëve në Revolucionin e vitit 1848 dhe në lëvizjen për çlirimin e Italisë në vitet 1859-1861, një plejadë intelektualësh arbëreshë, midis të cilëve shquheshin Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Vinçens Dorsa, Zef Serembe etj. iu dhanë me mish e me shpirt mbledhjes dhe studimit të thesarëve të gjuhës dhe kulturës së popullit shqiptar.

Një rol veçanërisht të rëndësishëm në këtë drejtim vazhonte të luante Jeronim de Rada me punën e tij si poet i shquar, studiues i palodhur dhe propagandisti i flaktë i çështjes së çlirimit të popullit shqiptar. Me veprat e tij shkencore si «Vjetërsi e kombit shqiptar», me poemat epike madhore si «Skënderbeu i pafanë», të botuara në vitet 60 e në fillim të viteve 70, De Rada u bë një figurë e madhe e kulturës shqiptare, e njohur jo vetëm në kolonitë arbëreshe e në Shqipëri, por edhe në botën letrare e kulturore evropiane. Veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e nderonin De Radën si një udhëheqës të shquar të luftës së tyre. Veprat e tij i çmuan edhe

figurat e mëdha të letërsisë evropiane të kohës si A. de Lamar-
tin, F. Mistral; ato u përkthyen në një varg gjuhësh të huaja.

Në vitin 1866 u botuan dy përmbledhje të rëndësishme të folklorit arbëresh-shqiptar, njëra «Rapsodi të një poemi shqiptar» prej De Radës dhe tjetra prej filologut të shquar Dh. Kamarda (1821-1882) nga Hora e Arbëreshëve pranë Palermos, si «shtojcë» e veprës «Sprovë e gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe».

Nëpërmjet pasurisë së madhe artistike që paraqiste folklori, të dy studiuesit arbëreshë u përpoqën me sukses të tërhiqnin vëmendjen e opinionit publik botëror mbi popullin shqiptar dhe lashtësinë e tij si dhe mbi të drejtën e tij për t'u njohur si komb më vete.

Nga viti 1865 filloi të bashkëpunonte me studiuesit arbëreshë edhe Dora d'Istria. Ajo zhvilloi një veprimtari të gjallë publicistike, veçanërisht mbi tema lindore, midis tyre edhe shqiptare, që e bënë atë shumë të njohur dhe shërbyen njëkohësisht për ta popullarizuar çështjen shqiptare në opinionin publik botëror.

Duke marrë shkas nga libri i De Radës, Dora d'Istria botoi po atë vit në gjuhën frënge një studim me titull «Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore». Në të autorja vinte në dukje se këngët popullore historike shqiptare e, në mënyrë të veçantë, rapsoditë e botuara nga De Rada, që kishin si figurë qendrore Skënderbeun, flisnin jo vetëm për aftësitë krijuese artistike të një populli me kulturë të lashtë, por përbënin edhe një dokument historik, i cili dëshmonte për dashurinë për liri e pavarësi, që kishte ruajtur populli shqiptar gjatë shekujve, me gjithë kushtet e vështira të pushtimit të huaj. «Ka ardhur koha, i shkruante ajo De Radës, që historia jonë të dalë gjithashtu nga varri ku e kanë groposur kaq e kaq farisej». Duke u mbështetur në të dhënat e historisë, në këtë vepër dhe në vepra të mëvonshme, Dora d'Istria vinte në dukje se shqiptarët kishin të drejtë, me rastin e një risistemimi të ardhshëm politik të Evropës Juglindore, të fitonin lirinë e tyre dhe mundësinë për përparim në kuadrin e shtetit të tyre të pavarur.

Grupi i atdhetarëve arbëreshë u vu në lidhje me atdhetarë shqiptarë në Shqipëri dhe në kolonitë si, p.sh., me Zef Jubanin në Shkodër, me Thimi Mitkon në Egjipt etj., të cilët u dhanë zemër për të vazhduar veprimtarinë politike dhe letrare për

të mirën e çështjes shqiptare. Duke u nisur nga parimi i shprehur nga Dora d'Istria se «pa rilindje letrare nuk ka ringjallje politike», grupi arbëresh përpiquej të themelonte një shoqëri letrare mbarëshqiptare, që do të botonte një gazetë me emrin «Flamuri i Skënderbeut», një fjalor dhe një gramatikë të gjuhës shqipe.

Grupi arbëresh zhvilloi një veprimtari të rëndësishme për të bërë të njohur çështjen shqiptare në opinionin publik botëror dhe për të krijuar lidhje me lëvizjen patriotike në Shqipëri. Dëshmi e këtij bashkëpunimi u bë libri me titull «Dora d'Istrias — shqiptarët», një përmbledhje vjershash, botuar nga Dh. Kamarda, më 1870, për të cilën kishin bashkëpunuar autorë shqiptarë dhe arbëreshë të kolonive të Italisë e të Greqisë si Zef Jubani, Thimi Mitkoja, I. Pema, P. Doçi, Jeronim de Rada, A. Santori, Zef Serembeja etj. Përtej qëllimit të parë, për t'i shprehur filoshqiptares së shquar mirënjohjen për ndihmën që i jepte çështjes shqiptare, libri u bë një manifest i parë i përbashkët i lëvizjes letrare kombëtare që po rritej në këto vite.

TË DHËNA MBI LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET 1859-1861*

Të dhënat që kemi për fillimet e veprimtarisë politike-kulturore të rilindësve tanë janë mjaft të kufizuara. Duke u nisur nga ato që dimë për veprimtarinë e Naum Veqilharxhit në vitet 1844-1846, duhet të presim 20 vjet të plota, deri në mesin e viteve 60, kur, sipas kujtimeve të Jani Vretos, fillon të bjerë diçka dritë mbi përpjekjet e një grupi shqiptarësh në Stamboll, me Kristoforidhin në krye, dhe nga ana tjetër të një grupi arbëreshësh në Itali, përpjekje për të dalë nga veprimet individuale e të veçuara dhe për të krijuar një bërthamë organizative të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Vetëm prej këtyre viteve e këndej mund të themi se të dhënat për veprimtarinë e rilindësve tanë nuk reshtin më.

Pikërisht këtu qëndron interesi i një burimi historik, mbi të cilin do të flitet në këtë kumtesë, një burim që na lejon t'i japim disa formë dhe ta mbushim me përmbajtje një pjesë të kësaj zbrazëtire prej njëzet vjetësh, të dallojmë disa rryma kontradiktore, që zhvillohen në gjirin e inteligjencies shqiptare të kohës dhe të shohim sesi, nëpërmes konfliktesh, rilindësit po përpunojnë një platformë të veçantë e të drejtë për lëvizjen kulturore politike shqiptare. Me këtë rast ne do të mund të anticipojmë për disa vjet fillimet e lëvizjes së organizuar, krijimin e një qendre drejtuese dhe fillimet e shtypit shqiptar.

* Artikulli është nxjerrë nga «Studime historike», 1965, nr. 2, f. 55-68.

E kemi fjalën për gazetën «Pellagos», që botohej në vitin 1860-61 në Lami të Greqisë. Mundësinë për të njohur këtë gazetë ia detyrojmë mirëdashjes së disa kolegëve historianë në Athinë.

Gazeta nuk ka qenë shfrytëzuar deri tani nga historiografia jonë mbi Rilindjen; atë e përmend në dy raste albanologu G. Majer, i cili e quan botuesin e gazetës «një toskë të inspiruar nga dashuria për të kaluarën e për të ardhmen e popullit të tij».¹ Duke u nisur nga këto të dhëna, K. Frashëri bënte supozimin se ky patriot duhej të ishte N. Veqilharxhi.² Por vetë Majeri e jepte emrin e tij në formën greko-gjermane Pykäos.³ Përveç indikacionit, G. Majeri, si do të shohim, nuk na jep hollësira mbi përmbajtjen e kësaj gazete.

Dy fjalë për veprimtarinë e botuesit të gazetës Anastas I. Piqueu, ose, me emrin e vërtetë shqiptar, Anastas Byku nga Lekli i Gjirokastrës, siç e thotë ai vetë në shumë raste. A. Byku kishte bërë gjimnazin e Janinës dhe më 1860 kishte 12 vjet veprimtari si mësues i greqishtes në qendra të ndryshme të Perandorisë Osmane. Mund të supozojmë pra, se më 1860 duhej të ishte të paktën 30-32 vjeç. Më 25 nëntor 1859 A. Byku hartoi një lajmërim të gjatë, me të cilin bën të ditur qëllimin për të botuar një gazetë dhe shpall në mënyrë pak a shumë të hapur programin e vet. Më 1 janar 1860 gazeta «Pellagos» filloi jetën si e përjavshme dhe si motër e gazetës «Ftiotis», që botohej po nga A. Byku. Më vonë gazeta mori emrin e kombinuar «Pellazgiotis» dhe mbante nëntitullin shqip «Shqiptari dhe greku». Gazeta dilte në gjuhën greke, por nuk mungonin edhe materialet shqip. Mund të thuhet se ajo i kushtohej krejtësisht çështjes shqiptare; në të bashkëpunonin një varg shqiptarësh si Th. Mitko, A. Armodhi, P. Cale (të tre korçarë), laboviti V. Zhapa nga Rumania, P. Petridhi nga Dhroviani etj. Në këtë kuptim mendojmë se «Pellagu» mund të konsiderohet si e para gazetë shqiptare, sepse gazeta e De Radës «L'albanese d'Italia», me gjithë emrin e saj, të paktën duke gjykuar pas atyre numrave që njohim, nuk mund të thuhet se trajtonte çështje shqiptare. Më 1 janar 1861 A. Byku botoi, përsëri në

1 «Nuova Antologia», viti 1885, f. 597.

2 «Zëri i popullit», Tiranë, 22 nëntor 1962.

3 G. Meyer, *Albanesische Studien*, Wien, 1883, f. 6-7.

Lami, një broshurë të vogël me titull «Grammë për shqipëtarë», një abetare shqip, siç e thotë nëntitulli greqisht, por më mirë me thënë, një shpjegim i dhënë greqisht, dhe i pajisur me shembuj, i alfabetit që propozon autori për shqipen, duke i përshtatur asaj alfabetin grek. Vepra i është kushtuar kolonelit Dhimo Lulja nga Hormova dhe mban si moto dy vargje shqip:

*Digjem tretëm nd'erë
të punoj (për) të tjerë.*

Edhe këtë vepër na e ka sinjalizuar G. Majeri.

Pas pushimit të gazetave të tij (numrat e fundit që njohim janë të marsit 1861), A. Byku duket se ndërroi vendbanimin. Më 25 shtator 1862 ai mbaroi, dhe ndofta e botoi po atë vit në Stamboll, një broshurë greqisht me titull «Πελασγικών προόλων» (Prelud i çështjeve pellazgjike), botuar, siç thuhet në titull, «me shpenzimet e të mirënjohurit... Vangjel Zhapa, grek vlonjat (shqiptar)», me të cilin kishte lidhje miqësie dhe bashkëpunimi. Me sa munda të hetoj, në bibliotekat e Athinës kjo broshurë nuk gjendej. Por duke gjykuar nga titulli dhe nga fakti i bashkëpunimit me Zhapën, lidhjet me të cilin kishin të bënin, siç do të shohim, pikërisht me çështje shqiptare, dhe nga një indikacion i mëvonshëm i vetë autorit se ajo drejtohej kundër pansllavizmit, mund të themi se edhe ky libër merrej pa dyshim me çështje shqiptare.

Më 1873 A. Byku botoi në një gazetë greke një artikull, i cili një vit më vonë u shtyp si libër më vete, me titull «Elenizmi dhe krishterimi». Nuk i njohim përmbajtjen, por autori na thotë se më vonë pati ngatërresa për shkak të tij; pra mund të mendojmë se duhet të ketë pasur gjithashtu karakter politik a ndonjë lidhje me çështjen shqiptare. Më në fund, në çastet kritike për Shqipërinë e verës së vitit 1878, A. Byku botoi në Athinë, më 6 gusht 1878, një numër tetëfaqësh të një gazete me titull «Πελασγός ó Προμήθεύς» («Pellazgu Promete»), drejtuar, siç thuhet në nëntitull, «krerëve të politikës panheleniste», në të cilën bën, ndër të tjera, një përmbledhje të veprimtarisë së tij të deriatëhershme dhe tërheq vëmendjen e publikut grek mbi problemet urgjente të çastit, luftës së shqiptarëve kundër rrezikut të copëtimit të vendit të tyre.

Çfarë të dhënash na japin këto vepra të A. Bykut, e ve-

çanërisht ato të periudhës 1859-1861, mbi të cilat do ta përqendrojmë vëmendjen kryesore, duke i plotësuar me të dhëna nga gazeta e vitit 1878?

Ne nuk mund të pajtohemi me vlerësimin që i bën G. Majeri, duke u nisur vetëm nga pozita e linguitit, gazetës «Pellagju», kur thotë se ajo qenka «shumë e pasur në etimologji të marra, dhe fare e varfër në materiale të dobishme» dhe si qëllim të saj të vetëm na vë në dukje atë që «të tregojë lidhjet shumë të ngushta që ekzistojnë midis shqiptarëve dhe grekëve». Por ne jemi të një mendjeje me G. Majerin, kur ai alfabetin grek të përshtatur nga A. Byku për shqipen e quan «shumë të komplikuar dhe jopraktik».¹

Ne mendojmë se materiali i gazetës «Pellagju» ka disa të dhëna me interes mbi disa rryma që janë zhvilluar në gjirin e inteligjencies shqiptare në fund të viteve 50 të shekullit XIX dhe nëpërmes polemikës që zhvillon, na jep mundësinë të njohim platformën e rilindësve tanë në këtë periudhë.

Le të fillojmë së pari me një shtjellim të pikëpamjeve të A. Bykut, që do të na lejojnë të hymë në mes të çështjes. Mund të themi qysh në fillim se pikëpamjet e kësaj figure janë, në një varg pikash, kontradiktore. Si dishepull entuziast i teorisë pellasgjike, e cila atëherë kishte përfshirë jo vetëm disa qarqe të botës shkencore, po edhe shtresa më të gjera të opinionit publik në Shqipëri e në Greqi, A. Byku nuk reshti së theksuari se populli shqiptar ka një të shkuar të lashtë dhe të lavdishme historike, si pasardhës i pellazgëve përrallorë e hyjnorë dhe i «ylltarëve» ose ilirëve. Vërtetimit të këtyre lidhjeve gjenetike ai i ka kushtuar një pjesë të mirë të vendit në gazetën e vet, duke grumbulluar argumente që në të vërtetë, edhe për kohën e tij, ishin mjaft naive, siç e ka vënë në dukje me të drejtë G. Majeri. Populli shqiptar, pjesëtar të të cilit A. Byku quan veten me mburrje, gjendet sot po në ato vende ku ka pasë banuar në lashtësinë e largët. «Nuk jemi as arabë, as harvatë, as turq prej fare. . .» thotë ai në një artikull të shkruar shqip («Pellagos», 30.III.1860), jemi. . . «pasardhës të Aleksandrit të Shqipërisë, Skënderbeut, që u kall me shqiptarët e tij tmerrin dy sulltanëve të mëdhenj dhe që e lusnë për ndihmë mbretërit e Napolisë e të Mangiarëve». Fatkeqësia i erdhi po-

¹ G. Meyer, Vep. cit., f. 6-7.

pullit shqiptar nga pushtimi turk që i shkaktoi vuajtje të panumërta, shtypje, përçarje fetare. «Ajo që na ka prishurë, që më kohërat e lashta gjer më sot, është që nuk kemi pasur dashuri, se ashtu na mësonte hasmi ynë, halldupët». Në këtë artikull, që është në të vërtetë një letër drejtuar disa personaliteteve myslimane shqiptare, A. Byku theksonte «se jemi të gjithë vëllezër shqiptarë... jemi pjellat e të njëj tate e të njëj mëme, kemi një gjuhë e një të prurë. Besa na ndanë, të tjerët na përziejnë (bashkojnë A.B.)».

Pasojat e prapambetjes kulturore dhe nevojën e mësimi A. Byku i vë në dukje me fjalë të ndjera: «Prishja më e madhe na ka ardhur që nuk jemi të ditur», në një kohë kur edhe turqit «... zunë të bëhen frengj më të prurë e të mbësuarë. E na shqiptarët mbetëm pa gramati e të paditur! Qysh durojmë të na quajnë njerëz të egër neve, që na kanë njohur e na nderojnë e na thonë shumë të zgjuarë e mëntëhollë. Jani ndë vete e të Aliut, të Krishtit, të Moametit!».

Lidhur me këtë orientim, A. Byku, në frymën e Naum Veqilharxhit, të cilin e përmend disa herë me nderim, e shtron në mënyrë programatike, se «në qoftë se ne nuk e mësojmë një popull në gjuhën e tij amtare, nuk është e mundur ta edukojmë. Cili është qëllimi i anëtarëve të shoqërisë shqiptare? të sigurojnë arsimin e të gjithë shqiptarëve». («Pellagos», 24.XII.1860).

Për të arritur këtë qëllim, A. Byku shtron një program të gjerë veprimtarie: botimi në shkallë të gjerë i librave shkollorë në gjuhën shqipe; hapja e shkollave fillore shqip për vajza dhe për djem, mundësisht në çdo fshat; ndërtimi i gjimnazëve në Gjirokastrë, në Përmet dhe i një liceu në Berat si edhe i dy shkollave të mesme për vajza në Rëzë dhe në Labovë. Librat do të përdornin alfabetin e hartuar prej tij dhe do të mbështeteshin mbi botimet shkollore greke. («Pellagos», 25.V.1860 dhe 24.XII.1860).

Për të fituar ndihmat dhe mjetet e nevojshme për këto qëllime kaq të gjera, ai u drejtonte një thirrje të zjarrtë shqiptarëve në Shqipëri, në Greqi dhe në kolonitë, duke përmendur me emër Vangjel Zhapën, Panajot Dhimën, Vito Biron, Vajën (nipin A. B.), Eftim Mitkon, Zografët, Stefan Kokën, Dhimo Lulen etj. («Pellagos», 10.VIII.1860).

A. Byku kishte varur shpresa të veçanta te milioneri shqip-

tar në Rumani, Vangjel Zhapa nga Labova, me të cilin familja e tij kishte miqësi të vjetër. Siç marrim vesh nga A. Byku, Vangjel Zhapa kishte dhuruar të holla për mbajtjen e shkollave në fshatra të rrethit të Tepelenës, të Gjirokastrës, të Përmetit etj. Në njërën nga këto shkolla, në Labovën e Zhapës, nuk mësohej vetëm greqisht, po edhe shqip, si mjet ndihmës për mësimin e gjuhës greke. Siç del nga një letër e V. Zhapës («Pellagos», 1.III.1861), nga janë marrë këto të dhëna, dhe nga një shënim i A. Bykut, milioneri shqiptar e kishte shpërndarë projektalfabetin e tij mbi baza të greqishtes në shumë personalitete dhe e kishte botuar dhe në një gazetë athinase.

V. Zhapa tregoi gatishmërinë e tij për bashkëpunim me A. Bykun, duke i ofruar këtij postin e drejtuesit ose të inspektorit të shkollave të tij në Labovë e gjetkë.

Premtimet e V. Zhapës iu dukën A. Bykut mjaft të gjera e të rëndësishme dhe ai vrapoi t'i jepte dijeni për këtë publikut me anë të gazetës («Pellagos», 24.XII.60) dhe në parathënie e «Gramës», datuar 1.I.1961. Bashkëpunimi me milionerin V. Zhapa, që kishte bërë dhurime shumë të mëdha për institucione kulturore në Greqi, i jepte çështjes një bazë reale dhe serioze.

Veprimtaria e A. Bykut dhe planet e tij arsimore u pritën mirë si brenda dhe jashtë Shqipërisë, siç tregojnë letrat që merrte ai nga shumë anë (shih. p.sh., letrat e Thimi Mitkos, A. Armodhit etj. në numrin e datës 31.III.1861). Deri këtu ato përputheshin me pikëpamjet edhe të përfaqësuesve të tjerë të inteligjencisë shqiptare të asaj kohe.

Por referimi ynë mbi pikëpamjet e A. Bykut nuk do të ishte i plotë, po të mos vinim në dukje edhe kontradiktat e brendshme të ideve të tij si dhe kontradiktat që ekzistonin midis tij dhe disa përfaqësuesve të lëvizjes shqiptare. Polemika që zhvillohet në gazetën «Pellagos» lidhur me këto kontradikta, na lejon të nxjerrim përfundimin se në gjirin e lëvizjes shqiptare në fund të viteve 50 të shekullit XIX, tashmë ishte duke u kristalizuar ajo platformë politike që u bë baza e veprimtarisë së përfaqësuesve më të përparuar të Rilindjes sonë dhe që hyri në luftë ideore edhe me A. Bykun.

Dobësia e lëvizjes së Rilindjes në këtë fazë të saj fillestare, dobësia e borgjezisë shqiptare si klasë e re, që po bënte hapat e parë të pavarur në arenën politike-kulturore dhe e

ndiente veten akoma të pafuqishme për t'u dalë mbanë, e vetme; pengesave të mëdha që i dilnin përballë, nuk kishin si të mos ndikonin mbi A. Bykun dhe e shtynë atë t'i varte shpresat te borgjezia greke, e cila tani kishte krijuar shtetin e vet kombëtar. Pa dyshim ndikonte mbi të edhe ideologjia «heleniste» e predikuar nga qarqet e borgjezisë së madhe greke dhe nga rrethet e klerit të lartë fanariot të Patrikanës të Stambollit. Por me gjithë disa tipare përparimtare që mund të kishte pasur, «helenizmi» tani po kthehej në ideologji-bazë e politikës shoviniste të «megali idhesë», në të cilën ruheshin në mënyrë anakroniste elemente të vjetra mesjetare (si ishte p.sh. parimi se ortodoksia ishte bazë e unitetit të gjithë botës heleniste).

Ndikimi i këtyre ideve shihet qartë pra edhe te A. Byku. Ai vërtet e thekson disa herë idenë se populli shqiptar, ndonëse i ndarë në disa fe, është një popull i veçantë, i cili me anë të arsimit duhet të arrijë vetëdijen e tij kombëtare dhe duhet të fitojë rëndësinë politike që i përket («Pellasgos», 24.XII.1860). Por megjithatë, kjo është bindja e Bykut, rruga historike e këtij populli duhej të ishte që të hynte në gjirin e «helenizmit», jo vetëm në kuptimin e një rrethi kulturor, por edhe në kuptimin politik («Pellasgos», 24.XII.1860), ndonëse do të ruante gjithmonë individualitetin e tij kombëtar: «Ishim e jemi dhe do të jemi shqiptarë», thotë ai në kryeartikullin e numrit të datës 30.III.1860, ku shtjellohen këto mendime.

Ideja e A. Bykut për të mëkëmbur një sistem arsimor të gjerë në gjuhën shqipe duhej t'i shërbente këtij qëllimi të dyfishtë: të zhvillonte vetëdijen e shqiptarëve dhe nga ana tjetër t'i përgatiste ata për të hyrë në gjirin e «helenizmit» («Pellasgos», 30.III.1860).

Por është e qartë dhe këtu qëndron kontradikta e brendshme kryesore në mendimet e A. Bykut, se duke qenë ortodoksia bazë e helenizmit («Pellasgos», 1.I.1860), elementët jo-ortodoksë të popullit shqiptar, që përbënin madje shumicën, do të formonin në këtë botë heleniste e shumta një aneks të huaj në të. Kësaj inkonseguence nuk mundi t'i shpëtonte A. Byku duke bërë të vetën parullën «Μία πίστις Μία πατρις» (Një besë — një atdhe!) («Pellasgos», 1.I.1860). Kështu ai detyrohej të përjashtonte në fund të fundit nga gjiri i helenizmit gjithë zonën e Shqipërisë së Veriut, ndërsa për zonat myslimane të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut ai ngushëllohej duke thënë

se ato ishin përfshirë tashmë nga idetë e helenizmit («Pellagos», 1.III.1861). Por me këtë krijohet koncepti i dy rrugëve të veçanta për popullin shqiptar: një për Veriun e një për Jugun, dhe pengoheshin përpjekjet për bashkimin e tij kombëtar. Duhet thënë se me këto pikëpamje lidhur me «helenizmin», A. Byku nuk qëndronte vetëm. Letrat e A. Armodhit nga Korça, të P. Petridhit nga Dhroviani dhe të V. Zhapës etj. tregojnë se A. Byku ishte shprehës i pikëpamjeve që kishin gjetur përhapje në disa qarqe intelektualësh ortodoksë të Shqipërisë së Jugut.

Ky orientim i pikëpamjeve kulturore-politike të A. Bykut kërkoi dhe gjeti mbështetje «teorike» në teorinë pellazgjike. Sipas saj, jo vetëm shqiptarët, po edhe grekët ishin pasardhës të pellazgëve. Greqishtja dhe shqipja ishin pra motra, siç thoshin edhe gjuhëtarët A. Shlajher (A. Schleicher), Shtir (T. Stier) etj. Sipas A. Bykut, shqipja ishte dega më e vjetër e pellazgjishtes, por më e prapambetura dhe e papunuara motër në krahasim me greqishten («Pellagos», 1.I.1860). Ishte pra me vend që ajo të kërkonte ndihmë te motra më me fat, ishte e kuptueshme pra edhe që kthimi i shqiptarëve në gjirin e «helenizmit» të mos kishte tjetër kuptim, veçse kthimin në një situatë historikisht të arsyetuar («Pellagos», 1.III.1861).

Me gjithë këto përpjekje për të pajtuar qëllimet e lëvizjes shqiptare me qëllimet e «helenizmit», veprimtaria e A. Bykut gjeti kundërshtim pikërisht nga këto qarqe heleniste. Në «Pellagos» (24.XII.1860) dhe në hyrjen e «Gramës» nuk mungojnë qarje të botuesit për mungesë mirëkuptimi pikërisht nga ana e këtyre qarqeve, si dhe polemika me to. Argumenti kryesor i këtyre kundërshtarëve ishte se shqiptarët ortodoksë ishin vetvetiu pjesë e helenizmit dhe mësimi i shqipes do t'i largonte nga helenizmi, në vend që t'i shkrinte me të. Një polemikë të veçantë A. Byku zhvilloi me gazetarin grek T. Nerucos, i cili në një varg artikujsh në një gazetë athinase ishte përpjekur të godiste Bykun me armët e veta. Në qofshin shqiptarët si pellazgë dhe shqipja si degë e pellazgjishtes pothuajse identike me grekët e greqishten, atëherë, thoshte Nerucos, përse duhet të zhvillohet mësimi i shqipes? Por në qoftë se shqipja dhe shqiptarët janë diçka e veçantë nga grekët e greqishtja, ahëre përpjekjet e A. Bykut ishin vetvetiu të kota («Pellagos», 29.XI.1860).

A. Byku këta «ekstremistë», që nuk duan të shohin realitetin, i cilëson si «helenistë të (kohës së) Tukididit, që ndërtojnë kështjella ëndrrash» («Pellagos», 1.III.1861).

Por synimet e A. Bykut për të ndërtuar gjerësisht shkolla fillore e të mesme në gjuhën shqipe, të cilat edhe pse duhej t'i shërbenin «helenizmit», në fakt do t'i sillnin një shërbim të madh çështjes shqiptare, gjetën kundërshtim edhe nga «helenistë» shqiptarë. Në një letër të tij, të botuar në numrin e fundit të «Pellagos» (1.III.1861), milioneri Zhapa distancohej nga projektet e A. Bykut dhe bënte disa rezerva të rëndësishme në lidhje me to. Pasi vë në dukje veprimet e veta në favor të shkollave në Shqipëri, ku ka futur dhe shqipen, ai thekson se e ka bërë këtë vetëm me funksion ndihmës, për sa kohë që është e nevojshme për të mësuar greqishten, «që të bëhemi një, si një fis që jemi». Prandaj propozimin e A. Bykut për të ngritur një sistem arsimor më vete në gjuhën shqip ai e quan «shumë larg nga rruga e drejtë; ai (propozim) vë idetë e veçanta provinciale mbi ato të përgjithshmet të të gjithë kombit, të popullit grek». Por Zhapa është gati ta shpjegojë këtë «gjynah» që bën Byku, duke e shfajësuar me «entuziazmë të tepërtë».

Kemi arsye të besojmë se ky qëndrim armiqësor i qarqeve heleniste në përgjithësi dhe i V. Zhapës në veçanti, u bë shkak që planet e A. Bykut të shemben dhe gazeta e tij të pushojë botimin e saj.

Por idetë e A. Bykut ishin në kundërshtim, në radhë të parë, me disa përfaqësues të lëvizjes patriotike shqiptare, ndonëse këta kishin miratuar dhe kishin përshëndetur përpjekjet e A. Bykut për krijimin e një rrjeti të gjerë arsimor në gjuhën shqip. Nga materialet e gazetës «Pellagos» del se kishte një varg pikash, në të cilat ishin në konflikt idetë e Bykut me ato të këtyre intelektualëve shqiptarë. Ndonëse polemizonte me ata shpeshherë, botuesi i «Pellagos» nuk i shquante ata me emër, por i përfshinte me emrin «filalbanistët», «propaganduesit e filalbanizmit» etj. (Hyrja e Gramës, «Pellagos», 1.III.1861). Përjashtim bën ai vetëm kur polemizon në këtë pikë me «të ndjerin» Naum Veqilharxhi («Pellagos», 1.I.1860, Gramë). Me anë të kombinimit të të dhënave të «Prometeut» të vitit 1878 me ato të «Pellagos» (25.V.1860) ne mund të nxjerrim

konkluzionin se midis kundërshtarëve ideorë të Bykut ishte edhe Th. Mitkoja vetë.

Ku ishin pikat e divergjencës? Në orientimin politik «helenist» të veprimtarisë kulturore të A. Bykut.

Për atdhetarët shqiptarë si N. Veqilharxhi ose Th. Mitkoja, ndonëse edhe këta kishin dalë nga gjiri i borgjezisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut, siç shihet qartë nga polemika që zhvilloi me ta Byku te «Pellagos» (1.III.1861), rruga historike e popullit shqiptar ishte një rrugë e veçantë, e mbështetur mbi veçoritë e tij territoriale - gjuhësore, politike e kulturore, që e dallonin atë nga popujt fqinjë, me gjithë lidhjet e ngushta fetare, kulturore e politike që mund të kishte prej kohësh me to. Kuptohet pra pse këta atdhetarë do të binin medoemos në konflikt me A. Bykun, i cili synimin final nuk e shihte në veçimin edhe politik të popullit shqiptar si komb më vete, por në hyrjen e tij në gjirin e «helenizmit».

Kontradiktat mishërohen para së gjithash në dy çështje, që mund të mos dukeshin çështje parimore, po s'u panë nën këtë prizëm politik: çështja e prejardhjes së popullit shqiptar dhe çështja e alfabetit të shqipes. Nga polemika që zhvilloi Byku kundër tyre del se «filalbanistët» janë kundërshtarë të «vëllazërimit» ose të identifikimit të shqipes me greqishten, të shqiptarëve me grekët, pra edhe të konkluzioneve politike që nxjerr andej A. Byku. «Filoalbanistët» mbështeteshin për këtë qëllim shprehimisht te disa albanologë si Han (Hahn), Pukëvil (Pouqueville), të cilët kishin pikëpamje të ndryshme nga përfaqësuesit e teorisë pellasgjike («Pellagos», 1.III.1861, «Prometeu» 1878). Duke i akuzuar këta për mosnjohje, A. Byku vë në lëvizje një arsenal të tërë argumentesh filologjike, duke theksuar rrezikshmërinë e konkluzioneve të këtyre pikëpamjeve, që kanë për qëllim, siç thotë ai, të ndajnë «vëllezërit», të ndajnë rrugët dhe fatet e tyre etj. («Pellagos», 1.III.1861).

Në lidhje me çështjen e alfabetit, konflikti ishte edhe më i ashpër e më i qartë. Për arsye në radhë të parë historike, A. Byku përjashtonte a priori çdo alfabet tjetër për shqipen, përveç alfabetit grek. Në përpjekjet e Veqilharxhit për të futur shkronja «sllavizante», dhe të shkrimtarëve shkodranë e arbëreshë për të përdorur alfabetin latin, ai sheh gjithashtu qëllimin për të përçarë të dy popujt vëllezër, sheh «synimet e errëta» të fuqive të huaja të interesuara në dobësimin e në

nënshtimin e këtyre etj. («Pellagos», 1.III.1861, hyrje e Gramës). Është e qartë se çështja e alfabetit të shqipes për të dyja palët, si për Bykun, si për «filoalbanistët», kishte dalë nga sfera e një konflikti filologjik, ishte bërë qysh në këtë kohë një konflikt politik.

Duke polemizuar me «filoalbanistët», A. Byku dhe përkrahësit e tij si A. Armodhi, P. Petridhi, V. Zhapa, na vënë në dukje se ky konflikt nuk është i ri. Qysh më 1857, në një takim midis A. Bykut dhe një tregtari korçar, që nuk ishte tjetërkush veçse Th. Mitkoja, ky konflikt kishte shpërthyer me forcë të madhe, bile edhe me fraza pak a shumë fyese («Prometeu», 1878, f. 3).

Po ajo që ka rëndësi të veçantë për ne në këtë mes, është fakti se Th. Mitkoja nuk fliste thjeshtësisht në emër personal si individ, por i paraqitej A. Bykut në këtë takim të parë, më 1857, «me mburrje» si «anëtar i një shoqërie filoalbaniste» në Stamboll, e cila po mblidhte të holla për libra e shkolla në gjuhën shqipe. Për të arritur qëllimet, për të cilat përpiquej shoqëria, «duhet, thoshte bashkëbiseduesi i A. Bykut, të përgatisim një ringjallje kombëtare, të bëhemi tok me ata bashkadtëtarë myslimanë që ëndërrojnë këtë». («Prometeu», f. 3).

Të gjitha këto tregonin se më 1857 lëvizja shqiptare po dilte nga faza e veprimtarisë së veçuar të disa personaliteteve dhe po krijohej një qendër organizative për punën e së cilës mjerisht nuk dimë më tepër. Por në polemikën e tij A. Byku i përmend disa herë «anëtarët e shoqërisë shqiptare», duke vënë në dukje mospajtimet ose përkimet që kishte ai me pikëpamjet e tyre («Pellagos», 24.XII.1860); kjo do të thotë se edhe në vitet 1860-61 kjo shoqëri, të paktën në mënyrë latente, vazhdonte të ekzistonte. Këtë e përforcon edhe fakti se në një letër të tij botuar në «Pellagos» (25.V.1860) Th. Mitkoja e këshillonte A. Bykun që, për të mbajtur lidhje me shqiptarët e Vllahisë, t'u drejtohej «patriotëve në Kostandinopojë». Prandaj mund të mendohet se përpjekjet e Kristoforidhit, më 1864, në Stamboll ishin më tepër përpjekje për të ringjallur, sesa për të themeluar një shoqëri patriotike.

Ne nuk dimë se kush bënte pjesë në këtë shoqëri. Por nga thirrja e nëntorit 1859 del se veprimtaria e Naum Veqilharxhit kishte gjetur «përkrahje nga shqiptarë myslimanë e të krishterë». Me gjithë kundërshtimet që ka me të, nga fjalët

e A. Bykut del pa dashur figura e N. Veqilharxhit si figura e një iniciatori të madh, rrugën e të cilit e ndoqën edhe të tjerë. N. Veqilharxhit A. Byku i ngarkon fajin, që e nis i pari atë rrugën e tij «të shtrembër» («Pellagos», 1.I.1860, hyrje e Gramës), ne do të thoshim se qe i pari që shtroi në mënyrë programatike një platformë pak a shumë të qartë të rrugës që duhej të ndiqte Rilindja jonë për të arritur në fitoren përfundimtare.

Më 25.XI.1859 A. Byku dhe diçka më vonë edhe të tjerë, Veqilharxhin e quajnë «i ndjeri». Më 1 tetor 1860 V. Zhapa thotë se «jo para shumë kohësh diskutuam me javë të tëra me N. Veqilharxhin në lidhje me çështjen e alfabetit të shqipës». Mund të nxjerrim këndej konkluzionin se Naum Veqilharxhi, më 1859, nuk kishte shumë kohë që kishte vdekur. Unë mendoj se po. Rrugën e të ndjerit e vazhdonte, më 1859, i vëllai («Pellagos», 1.I.1860). A. Byku, me gjithë orientimin e tij «helenist», na jep disa të dhëna interesante për rrethanat në të cilat duket se u zhvillua deri në fund veprimtaria e N. Veqilharxhit. Ai nuk ngurron të dënojë si kundërshtarë të saj edhe Portën e Lartë, edhe hipokrizinë e krerëve të ortodoksisë vendase si dhe Patrikanën. Me këtë rast duhet vënë në dukje se Dh. S. Shuteriqi¹, duke përkthyer keq një citat të G. Majerit nga «Gramë», le të kuptojë sikur më 1861 A. Byku e konsideronte akoma të gjallë N. Veqilharxhin.

Kritika e figurës kontradiktore të A. Bykut dhe e rrymës që përfaqëson ai, duhet bërë, mendojmë ne, duke u nisur nga pozitat e kohës.

Është e vërtetë se në rrugën e A. Bykut eci për disa kohë deri në fillim të viteve 70, Jani Vretoja dhe më vonë akoma Eftim Brandi, autori i veprës «Allvanika Parapona» («Ankime shqiptare»), botuar më 1880. Por shumica e rilindësve u gjendën në kundërshtim me rrugën e A. Bykut. Cila rrugë mund të realizonte në mënyrë më konsekuente dhe realiste detyrat e bashkimit dhe të emancipimit kombëtar, detyrat e mëdha që shtronte momenti historik në atë shekull që u quajt me të drejtë «shekulli i zgjimit të kombeve»? Vetë zhvillimi i ngja-

1 Dh. Shuteriqi, *Bibliografi e letërsisë së vjetër shqipe*, në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës», (Seria Shkencat Shoqërore), 1962, Nr. 3, f. 143.

rjeve, vetë rruga që ndoqi K. Kristoforidhi, Th. Mitko, J. Vreto e të tjerë i japin përgjigje kësaj pyetjeje. Njihen simpatitë që ushqenin këta përfaqësues të Rilindjes për kulturën greke, për «helenizmin» në kuptimin më të mirë të fjalës. Por K. Kristoforidhi, posa nisi veprimtarinë e tij, më 1864, në Stamboll, me një frymë të shëndoshë realizmi, u drejtohej së pari qarqeve myslimane shqiptare, duke e parë qartë se çdo veprim që do të zhvillohej në Shqipëri, pa marrë parasysh këtë faktor të realitetit shqiptar, pa përfshirë të gjitha krahinat e fetë, do të ishte destinuar të dështonte. Dihet gjithashtu se Th. Mitkoja që anëtar i idesë së një shteti dualist shqiptaro-grek. Por, dihet edhe se qysh nga fillimi ai e mendonte këtë shtet jo thjeshtësisht si përfshirjen e elementit shqiptar në helenizmin, po si një federim shtetesh kombëtare të veçanta, me të drejta të barabarta, secili zot brenda caqeve të veta. Dhe Th. Mitkoja hoqi dorë nga ky mendim, kur u bind se nuk ekzistonin këto kushte.

Në dritën e këtyre shembujve le të vizatet gjykimi i historisë mbi Anastas Bykun dhe rrymën që përfaqëson ai, si një rrymë divergjente dhe në kundërshtim me lëvizjen e madhe të Rilindjes sonë Kombëtare.

ÇESHTJA SHQIPTARE DHE MARRËDHËNIET NDERKOMBËTARE NË VITET 1878-81*

Ndonëse nuk mungojnë punime mbi Krizën Lindore dhe vitet 1878-81, aq të rëndësishme për historinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit, mund të thuhet se ato kanë një të metë të madhe, që qëndron në faktin se i kanë parë ngjarjet që u zhvilluan në Shqipëri pothuajse krejtësisht të varura nga ngjarjet e jashtme. Prandaj kumtesa jonë i vë vetes për qëllim të trajtojë, duke u mbështetur mbi aktet diplomatike të kohës¹, një aspekt deri tani pak të studiuar si nga historiografia jonë², ashtu dhe nga e huaja³, të vërë në dukje, pa mohuar ndikimin e faktorëve të jashtëm, se në fakt kemi të bëjmë me njëfarë ndërvarësie, se në këto vite, e veçanërisht

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962). Kumtesa është nxjerrë nga libri «Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike», Tiranë, 1965, f. 591-601. Është botuar në «BUSHT» SSHSH», 1962, nr. 4, f. 186-204. Botuar edhe italisht në «Rassegna di Studi Albanesi», Roma, 1963, nr. 1, f. 79-91.

1 H.H.S.t.A, Politisches Archiv, Konsularberichte Skutari, Prizren, Janina etc 1878-1881. Kopje të daktilografuara, ruhen në arkivin e Institutit të Historisë e të Gjuhësisë dhe në Arkivin Qendror Historik të RPSSH. — Turkey, Nr. 15 (1880), Part II. Correspondence respecting the New Law for the european provinces of Turkey London (1880).

2 K. Dako, *Liga e Prizrenit*, Bukuresht, 1922; M. Frashëri, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1928; Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1939; K. Frashëri, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë, 1956.

3 Sp. Gopčević, *Oberalbanien und seine Liga*, Wien, 1883; G. Schiro, *Gli albanesi e la questione balcanica*, Napoli, 1904; I. H. Vasiljević, *Arnautska Kongra, Belgrad*, 1908; H. M. Seliščev, *Slavianskoje, Nase-lenie v Albanii*, Sofia, 1931; G. M. Monti, *La Liga di Prizren, në «Le terre albanesi redenti»*, Romë, 1941; A. Novotny, *Der Berliner Kongress 1878*, I. Wien, 1957.

në vitin 1880, lëvizja shqiptare u bë një veprues aktiv në arenën ndërkombëtare, i cili i detyroi fuqitë evropiane të merrnin parasysh edhe faktorin shqiptar dhe ta orientonin deri diku politikën e tyre pas tij.

Është e vërtetë se shtetet evropiane dhe opinioni publik botëror në shekullin XIX dhe më parë kishin pasur disa herë rast të merreshin me aspekte të pjesshme të çështjes shqiptare, siç ishin, p.sh., kryengritjet e Ali Pashë Tepelenës dhe të Kara Mahmud dhe Mustafa Pashë Bushatit, kryengritjet e disa krahinave shqiptare veçanërisht në vitet 30-70 të shekullit XIX. Por kurrë ndonjëherë nuk ishte shtruar zyrtarisht çështja shqiptare në tërësi si çështje e një kombi.

Në qoftë se kjo ndodhi pikërisht në vitet e përmendura, shkak nuk mund të kërkohet vetëm në faktorët e jashtëm, të cilët pa dyshim vepruan nëpërmes reperkusioneve të ndryshimeve territoriale dhe ndërlikimeve që sollën për Shqipërinë ndërhyrjet e politikës së Fuqive të Mëdha evropiane dhe traktatet e paqes së vitit 1878, traktatet e Shën-Stefanit dhe të Berlinit.

Vendimtar që fakti që këta faktorë të jashtëm gjetën një terren tashmë të përgatitur brendapërbrenda, me ndryshimet ekonomiko-shoqërore dhe politike që kishin ndodhur atëherë në Shqipëri me gjithë prapambetjen e madhe dhe pengesat që vinin nga regjimi feudal osman.

Mund të themi se udhëheqësit e lëvizjes politike në Shqipëri hynë në fazën vendimtare të krizës (vitet 1877-78) me konceptet kryesore politike tashmë të formuluar qartë: me konceptet mbi nevojën e afirmimit para botës së shqiptarëve si një komb më vete, me të drejtat dhe interesat e tij të veçanta dhe të përbashkëta, pavarësisht nga ndarjet krahinore dhe fetare, mbi nevojën e një qendre përfaqësuese dhe organizative kombëtare dhe më në fund me konceptin e autonomisë që rridhte nga parimi i interesave të veçanta të këtij kombi. Këto koncepte gjenin shprehje tashmë në idetë dhe në veprimtarinë e atdhetarëve në vitet 60 dhe në fillim të viteve 70 si dhe në memorandumun e Janinës (pranverë 1877).*

Por ajo që duhet theksuar këtu është se këto ide, ndonëse atdhetarët i nxirrnin nga eksperiencia e hidhur që kishin masat

* Shih shënimin në faqen 201 të këtij vëllimi.

popullore prej sundimit shekullor osman, nuk ishin përvetësuar tërësisht nga lëvizjet masive popullore kundër sundimit turk, të cilat zhvilloheshin në këto vite.

Nuk munguan raste si, p.sh., gjatë kryengritjes së Mirditës, më 1876-77, kur nën ndikimin e përfaqësuesve të lëvizjes patriotike shqiptare këto lëvizje popullore merrnin karakter disi më të shprehur kombëtar dhe deri diku u ngritën, me ndihmën e disa qarqeve politike italiane dhe ruse të interesuara, edhe në arenën ndërkombëtare si «çështje shqiptare», për ta bërë Mirditën autonome bërthamën, rreth së cilës do të zhvillohej më vonë një shtet shqiptar i bashkuar. Por kjo bëhej në kushtet më të vështira, në Mirditën malore, të izoluar, të prapambetur dhe ishte vetvetiu e dënuar të dështonte.

Edhe hapi i rëndësishëm i bërë në pranverën 1877, kur mbledhja e parisë shqiptare të Jugut në Janinë ngriti për herë të parë në mënyrë të organizuar dhe publike kërkesën e autonomisë për gjithë Shqipërinë, të bashkuar në një provincë, nuk pati më tepër sukses. Në rrethanat e kohës (jemi në pragun e shpërthimit të Luftës Ruso-Turke) ajo mbeti akoma një çështje e brendshme shqiptaro-turke.

Në aktivitetin e ethshëm diplomatik që shkaktoi shpërthimi i Luftës Ruso-Turke në vitin 1877 Shqipëria figuronte para së gjithash si objekt pushtimi. Më 1877 kancelari gjerman Bismark dhe ministri i Jashtëm anglez Derbi (E. S. Derby) i ofronin Italisë të pushtonte Shqipërinë si kompensim për zgjerimin austro-hungarez në Bosnjë-Hercegovinë, ndërsa po në këtë kohë Vjena përgatitej ta pushtonte vetë Shqipërinë deri në Vlorë, për të kundërbalancuar përparimet e shpejta ruse në Bullgari.

Në të njëjtën kohë theksoheshin synimet grabitqare të qeverive të shteteve fqinje ballkanike kundrejt Shqipërisë.

Disfatat katastrofale të Perandorisë Osmane, rreziku i copëtimit të Shqipërisë, që sollën ato me vete, fillimin e të cilit e shënonte Traktati i Shën-Stefanit, u bënë shkas për një lëvizje të fuqishme e të gjerë për vetëmbrojtje në krahinat e veçanta, lëvizje në të cilën morën pjesë fshatarësia, borgezia dhe feudalët e vendit. Nga ana tjetër, përgatitja e një kongresi ndërkombëtar, i cili si forum më i lartë duhej të arbitronte mbi çështjet e lindura nga disfata e Turqisë, i nxití atdhetarët shqiptarë të merrnin masa për t'u paraqitur para

këtij forumi në mënyrë të organizuar dhe representative për gjithë popullin shqiptar. Në këto kushte rryma politike e ndër-gjegjshme dhe ajo masive, spontane, që në vitet 60 dhe 70 kishin qenë të ndara, u afruan dhe për një kohë edhe u shkrinë. Tani lëvizja e atdhetarëve nuk ishte më një lëvizje e dobët e një grushti intelektualësh, prapa saj qëndronte një lëvizje e fuqishme, nganjëherë edhe me një karakter të turbullt, por që përbënte një forcë reale. Atdhetarët shqiptarë u përpoqën ta merrnin në dorë këtë lëvizje, t'i jepnin asaj orientim të ndër-gjegjshëm kombëtar. Si rezultante e këtyre rrymave filloi nga veprimi, më 10 qershor 1878, Lidhja Shqiptare, Lidhja e Prizrenit, që u bë, me gjithë karakterin e saj heterogjen, me gjithë peripecitë e saj, e para organizatë politike përfaqësuese për gjithë popullin shqiptar.

Në intervalin midis Traktatit të Shën-Stefanit dhe mbledhjes së Kongresit të Berlinit (mars-qershor 1878) para opinionit publik botëror dhe kancelarive të shteteve evropiane filluan të grumbulloheshin protesta të shumta nga popullsitë myslimane të Rumelisë, protesta të nxitura dhe të shtyra nga vetë qeveria turke për të ndaluar lëshimin e tokave të Perandorisë në Ballkan. Në atë kohë filluan të dëgjoheshin edhe zërat e protestës nga ana e shqiptarëve. Por për opinionin publik botëror dhe për kancelaritë evropiane në fillim që e vështirë për t'i dalluar këta zëra shqiptarë nga zërat e porositur turq. Dhe me të vërtetë, në disa raste mund edhe të kishin të drejtë. Dora e porositësit — qeverisë turke — mund të shihej bile edhe në vetë vendimet e para të Lidhjes së Prizrenit*.

Por që nuk ishte vetëm dora e qeverisë osmane në këtë mes, siç mendonin diplomatët evropianë në përgjithësi, për këtë fliste fakti se bashkë me zërat, prejardhja dhe karakteri i të cilëve ishte i dyshimtë, filluan të ndihen edhe zëra me një përmbajtje krejtësisht të re e të qartë, siç ishte memorandumimi i dërguar, më 18 qershor 1878, nga atdhetarët shkodranë lordit Bikonsfild (Beaconsfield) — kryeministrit dhe përfaqësuesit të Britanisë së Madhe në Kongresin e Berlinit — dhe kërkesat e dërguara nga një grup atdhetarësh shqiptarë nga Stambolli, më 20 qershor 1878 kontit Andrashi (J. Andrassy), ministrit

* Krahaso me faqen 229 të këtij vëllimi.

të Jashtëm dhe përfaqësuesit austro-hungarez në Berlin. Këto dokumente nuk kufizoheshin vetëm të ngrinin zërin e protestës kundër shkëputjes nga Perandoria Osmane të krahinave që konsideroheshin shqiptare, pra kundër ndryshimit të marrëdhënieve të deritanishme me Perandorinë, por, përkundrazi, ngrinin kërkesa që përfshinin ndryshimin zyrtar e formal të këtyre marrëdhënieve, duke kërkuar formimin e një komisioni «ad hoc» dhe hartimin e një «rregulloreje organike» për Shqipërinë, me një fjalë njohjen e një statusi autonom për Shqipërinë, në bazë të parimit të kombësisë.

Por tërësia e çështjes shqiptare që paraqitej me këto kërkesa përpara Kongresit të Berlinit nuk gjeti truall të favorshëm.

Dihet se midis Fuqive të Mëdha Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria ndiqnin politikën e mbrojtjes energjike të ekzistencës së Perandorisë Osmane, që ato e konsideronin si të domosdoshme për të luftuar zgjerimin rus në Ballkan.

Ishte e vërtetë se Vjena në marrëveshjen e Budapestit të viteve 1877 siguroi të drejtën të pushtonte provincën turke të Bosnjë-Hercegovinës dhe, për rastin e prishjes së Turqisë, kërkoi formimin e një Shqipërie autonome, për të evituar kalimin e kësaj zone me rëndësi në duart e Rusisë. Por, siç e formulonte Andrashi, Vjena ishte në përgjithësi për ruajtjen e Perandorisë së sulltanëve për aq kohë «sa nuk mund ta zëvendësonte me diçka më të mirë» — nënkupto, me sundimin e vet në Ballkan.

Në këto kushte pra Britania dhe Austro-Hungaria nuk i merrnin parasysht kërkesat shqiptare, realizimi i të cilave nuk mund të sillte me vete në fakt dobësimin e Perandorisë Osmane.

Rusia, nga ana e saj, tani që Austro-Hungaria, pa hyrë në luftë, kishte siguruar për vete pjesën kryesore të plaçkës, Bosnjë-Hercegovinën, dhe me këtë mbizotërimin faktik në Ballkanin Perëndimor, mori një qëndrim armiqësor në çështjen shqiptare, për të goditur influencën austro-hungareze dhe për të lidhur pas politikës së vet shtetet sllave të Ballkanit.

Franca dhe veçanërisht Italia në kongres luajtën një rol të dorës së dytë. Megjithëse, për t'i bërë vështirësi politikës ekspansioniste të Vjenës, Roma prej kohësh inkurajonte fshehurazi lëvizjet çlirimtare në Shqipëri dhe në Ballkan me parullën «Ballkani — ballkanasve!», ajo në kongres, në përgjithësi, ndoqi politikën gjermane dhe austro-hungareze.

Në këto kushte çështja shqiptare nuk u ngrit në rendin e ditës dhe nuk u mor parasysh asnjë nga kërkesat shqiptare; në Traktatin e Berlinit përkundrazi toka të banuara prej shqiptarësh u përdorën për të kënaqur kërkesat territoriale të shteteve fqinje ballkanike. E vetmja çështje që lidhej me Shqipërinë dhe që u formulua në një protokoll të veçantë të traktatit ishte vendimi për të mbrojtur «privilegjet e liritë» e Mirditës.

Prapa këtij kujdesi për të «mbrojtur» popullsinë katolike fshihej në të vërtetë interesi i Vjenës për të siguruar dhe më tej ndikimin e vet në malësitë e Veriut, për t'i përdorur ato me anë të agentëve të vet klerikë si një bazë të avancuar kundër shteteve sllave të Ballkanit.

Zbatimi i vendimeve të marra në Berlin në lidhje me rektifikimin e kufijve me Malin e Zi dhe me Greqinë hasën në kundërshtim të vendosur dhe të organizuar nga ana e Lidhjes Shqiptare. Repartet malazeze u prapsën me humbje në përpjekjet e tyre për të marrë me forcë, në dimrin e 1879-80-ës, krahinat e Plavës dhe të Gucisë dhe më vonë, në prill 1880, malësitë nga Kelmendi e deri në liqenin e Shkodrës, që iu njohën Malit të Zi si kompensim në vend të krahinave të para (Vija Korti). Propozimet e Rusisë, që u pranuan edhe nga Porta, për të shpërblyer Malin e Zi në drejtim të tokave sllave të sanxhakut të Novi Pazarit ose të Hercegovinës, e vetmja zgjidhje e drejtë!, kishin gjetur kundërshtimin e prerë të Vjenës, që e konsideronte këtë zonë tashmë si sferën e saj ekskluzive.

Nuk qe e ndryshme situata në Jug, në kufirin greko-turk, ku Kongresi i Berlinit kishte rekomanduar bisedime dypalëshe greko-turke dhe si vijë të re kufitare vijën e lumenjve Kalamas-Selevria, duke i lënë kështu Greqisë Çamërinë shqiptare si dhe Janinën, qendrën e vilajetit jugor. Bisedimet greko-turke, që kishin filluar në janar 1879, në Prevezë vazhduan më tej në Stamboll deri përtej shkurtit 1880, pa dhënë asnjë fryt. Një nga argumentet kryesore, që paraqiste Porta e Lartë për të kundërshtuar kërkesat greke, ishte pikërisht rezistenca e fortë nga ana e shqiptarëve — dhe me të vërtetë edhe në Jug ishin grumbulluar forca të armatosura shqiptare të rëndësishme, për të penguar çdo lëshim tokësor.

Si pasojë, deri në pranverën e vitit 1880 asnjë nga dispo-

zitat e Traktatit të Berlinit në lidhje me lëshimet tokësore në zonat shqiptare nuk qe zbatuar, me përjashtim të atyre pikave që qenë pushtuar qysh gjatë operacioneve luftarake më 1877-78. Çështja e kufijve dhe si pasojë edhe çështja shqiptare mbetet gjithmonë e hapur.

Moszbatimi i këtyre pikave të traktatit nuk ishte vetëm një «fyerje» për Fuqitë e Mëdha nënshkruese të traktatit, por ishte në kundërshtim dhe me interesin e fuqive kryesore: Anglisë dhe Austro-Hungarisë, për të rivendosur sa më parë «qetësinë» në Ballkan dhe për të zhdukur kështu një konflikt të ri të armatosur në kufijtë e Turqisë dhe rrezikun e një ndërhyrjeje të Rusisë e ndofta edhe të Italisë.

Prandaj Londra dhe Vjena nxitonin ta mbyllnin sa më parë konfliktin shqiptaro-malazias dhe të kënaqnin kërkesat e Greqisë, tek e cila shihnin faktorin kryesor ballkanik për të përballuar fuqizimin e influencës ruse në gadishull. Megjithatë, të dyja qeveritë ishin të mendimit se në kufijtë e Greqisë nuk duheshin përfshirë «tepër shqiptarë», gjë që do ta dobësonte, në vend që ta forconte, Greqinë.

Por përveç këtyre interesave të përgjithshme, Austro-Hungaria kishte edhe disa interesa të veçanta, që e bënin të merrte një qëndrim të hapur armiqësor ndaj lëvizjes në Shqipëri.

Nga qendrat kryesore të lëvizjes në Shqipëri ishin Kosova dhe krahina e Shkodrës, të dyja të ndodhura në kufi ose shumë afër Bosnjë-Hercegovinës së pushtuar, si dhe sanxhakut të Novi-Pazarit, ku, në bazë të Traktatit të Berlinit dhe të një konvente të veçantë midis Vjenës dhe Stambollit, monarkia do të vendoste tani garnizonet e saj ushtarake. Afrimi i këtyre garnizoneve deri para Mitrovicës u bë shkak për një alarm të ri midis popullsisë së Kosovës dhe u dha një hov të madh tendencave antiaustriake në Lidhje, duke krijuar kështu një zonë të re nevralgjike për politikën austro-hungareze.

Dhe me të vërtetë, rritja e rezistencës në Shqipëri pati një jehonë të drejtpërdrejtë në Bosnjë-Hercegovinën e afërt dhe krijoi kushte për një bashkëpunim të lëvizjes shqiptare me lëvizjen e rezistencës në Bosnjë-Hercegovinë, gjë që filloi ta shqetësonte shumë Vjenën. Kur në pranverë të 1880-ës në Tuz, në kufirin me Malin e Zi, u grumbulluan më se 12 000 luftëtarë shqiptarë për të pritur një sulm eventual të forcave

malazeze kundër tokave që kërkonte Cetina, Vjena pati frikë se shqiptarët mund të kalonin në kundërsulm dhe dyshonte që Mali i Zi të kishte në këtë rast forcat për ta përballuar atë. Për t'i dalë përpara rrezikut që forcat shqiptare të arrinin drejtpërdrejt te kufijtë e Bosnjë-Hercegovinës, shtatmadhuria austro-hungareze mori urdhër të hartonte planin e një operacioni drejtuar kundër Shqipërisë.

Në këto kushte, para kërkesave dhe protestave të paretitura të qeverisë greke dhe malazeze, u bë e nevojshme një ndërhyrje e re për të kënaqur kërkesat e Malit të Zi për kompensim. E frikësuar se mos kompensimi bëhej në drejtim të sanxhakut, Vjena vrapoi të propozonte që Malit të Zi t'i lëshohej qyteti dhe krahina shqiptare e Ulqinit. Propozimi i Vjenës u pranua dhe u përkrah menjëherë nga Kabineti i Londrës. Madje, në dukje u bë Londra faktori kryesor veprues në çështjen e Ulqinit, ndërsa Vjena qëndronte me qëllim në radhë të dytë, për të mos tërhequr mbi veten e saj mërinë e shqiptarëve. Propozimi i ri u pranua më në fund më 11 qershor edhe nga fuqitë e tjera, me përjashtim të Turqisë, e cila filloi të paraqiste përsëri vështirësi. Çështja e kufirit greko-turk dhe turko-malazias u mor në shqyrtim nga një konferencë e ambasadorëve në Berlin, në qershor të vitit 1880. Përpjekjet e qarqeve të atdhetarëve shqiptarë për ta bërë Konferencën e Berlinit një forum, ku mund të ngrihej në tërësi çështja shqiptare, duke përfshirë në të edhe autonominë, nuk patën sukses. Qeveria italiane, me të cilën atdhetarët shqiptarë kishin hyrë në kontakt qysh më 1879, me rastin e udhëtimit të delegacionit shqiptar, të kryesuar nga Abdyl Frashëri, nëpër kryeqytetet e Evropës, siç duket nën ndikimin e disa qarqeve, u përpoq, por më kot, të fitonte edhe përkrahjen e Francës për një qëndrim më pozitiv ndaj kërkesave shqiptare. Nuk ka dyshim se prapa interesit për autonominë e Shqipërisë fshiheshin jo vetëm qëllimet antiaustriake të politikës së Romës, por edhe synimet e saj për të depërtuar vetë në këtë zonë të rezervuar deri tani ndikimit të Vjenës.

Në këto kushte Konferenca e Berlinit, në qershor të vitit 1880, nuk bëri gjë tjetër veçse të vendoste vijën kufitare greko-turke të lumenjtë Kalamas-Selemvria, të rekomanduar qysh nga traktati i mëparshëm.

Konferenca e Berlinit dhe lajmi i planit për lëshimin e

Ulqinit dha rast për rritjen e mëtejshme në Shqipëri të lëvizjes së rezistencës kundër çdo cungimi tokësor. Por bashkë me të po rritej gjithnjë e më tepër edhe urrejtja e masave popullore kundër qeverisë osmane, e cila jo vetëm që nuk ishte në gjendje ta mbronte nga copëtimi, po kishte dhënë edhe vetë aprovimin për këto cungime të truallit shqiptar, «duke e nxjerrë në ankand sikur kjo tokë të mos kishte zot», siç i deklaroi plot zemërim disa përfaqësues shkodranë një diplomati anglez.

Në këtë zemërim të gjerë popullor gjetën terren për t'u zhvilluar më tej kërkesat për autonomi, të ngritura në arenën ndërkombëtare në qershor të 1878-ës dhe të përsëritura botërisht ndaj Portës së Lartë nga mbledhja plenare e Lidhjes, më 27 nëntor 1878, dhe ndaj Fuqive të Mëdha nga memorandum i 9 korrikut 1879. Krahas këtij veprimi në terren diplomatik, në Shqipëri po zhvillohej me fuqi një aksion popullor, i cili kishte vendosur në një varg krahinash pranë organeve të pushtetit turk, në fakt edhe një pushtet të dytë, atë të komiteteve shqiptare. Por elementët turkofilë, në radhë të parë feudalë, klerikë myslimanë fanatikë etj., të përfshirë edhe të interesuar gjithashtu në rezistencën kundër lëshimeve tokësore si dhe Porta e Lartë, kishin ditur të shmangnin deri tani një konflikt të hapur me lëvizjen patriotike, duke u përpjekur ta përdorin lëvizjen popullore për qëllimet e tyre.

Me ngjarjet e pranverës dhe të verës të vitit 1880 u krijuan kushtet, kur lëvizja autonomiste në Shqipëri, «lëvizja kombëtare e vërtetë dhe serioze», siç e quante pikërisht në këtë kohë K. Kristoforidhi, «filloi të rritej shpejt», të bëhej «tepër e fuqishme për derebejt dhe Portën». Jehonën e këtyre ngjarjeve e gjejmë në lajmet «alarmante», që dërgonin në muajt prill-qershor vëzhguesit diplomatikë austro-hungarezë dhe rusë nga Shkodra, nga Prizreni, nga Manastiri, nga Janina mbi lëvizjen për formimin e një «Shqipërie të madhe», siç e quanin ata, d.m.th. për bashkimin e krahinave të ndryshme shqiptare në një provincë autonome, lëvizje që vihej re njëkohësisht në vende të ndryshme të Shqipërisë.

Dhe me të vërtetë, më 23 korrik 1880, atdhetarët me në krye Abdyl Frashërin organizuan mbledhjen e një kuvendi në Gjirokastrë, i cili afirmoi edhe një herë botërisht vendosmërinë e tyre për të krijuar një shtet autonom shqiptar nën so-

vrانيتin e sulltanit. Realizimi i statutit të hartuar nga kuvendi hapte rrugën e një zhvillimi ekonomik-shoqëror përparimtar për popullin shqiptar.

Jó vetëm Rusia, po edhe Austro-Hungaria ndiqte me sy të keq dhe armiqësi këtë kthesë të rëndësishme në Shqipëri. Ministri i Jashtëm austro-hungarez H. Hajmerle (H. Haymerle), më 26 korrik, udhëzonte ambasadën në Stamboll të protestonte kundër veprimeve të komiteteve në Shqipëri dhe të vinte në dukje se këto përbënin një rrezik të madh për vetë Portën. Njëkohësisht ai u jepte instruksione konsujve të vet të mos impresionoheshin dhe të mos lëkundeshin në qëndrimin e tyre të deritanishëm nga ato që po ndodhnin në Shqipëri.

Po pikërisht në këtë periudhë, pranverë-verë 1880, filloi të vihej re një ndryshim në qëndrimin e politikës së Britanisë së Madhe ndaj çështjes shqiptare. Kabineti i ri liberal i kryesuar nga Gledstoni (Gladston), që njihej për politikën e tij hipokrite me të cilën ishte paraqitur si «mik» i popujve ballkanas, kërkonte një sukses të shpejtë përpara parlamentit britanik dhe opinionit publik botëror, duke u dhënë fund vatrave të një konflikti të ri, që kishin mbetur hapur në Ballkan, përgjegjësinë për të cilat ia ngarkonte kabinetit konservator të lordit Bikonsfild. Në këto kushte vëmendja e politikës angleze do të drejtohej edhe nga çështja shqiptare që ishte treguar tashmë si një faktor i fuqishëm, pa përfillien e të cilit nuk mund të mendohej të zgjidheshin çështjet e mbetura pezull. Kjo e detyronte politikën angleze për një qëndrim më realist në çështjen shqiptare, aq më tepër kur Gledstoni, ndonëse ishte i vendosur të vazhdonte politikën tradicionale britanike të ruajtjes së ekzistencës së Perandorisë Osmane, donte t'i jepte një «mësim» të mirë Portës së Lartë dhe vetë sulltanit, te të cilët ishin shfaqur tendenca kokëfortësie për t'u shkëputur nga tutela e fuqive, që u ngarkohej gjithë faji për disfatat e dështimet e pësuar.

Ky qëndrim i ri ndaj çështjes shqiptare shfaqet, me sa dimë, qysh nga prilli i vitit 1880, nga ambasadorët britanikë në Stamboll, Lajar (Layard) dhe më vonë Goshen (G. Goschen), si dhe nga përfaqësuesi anglez në «Komisionin evropian për Rumelinë Lindore», Ficmoris (Fitzmaurice), dhe arrin deri në qendër, te sekretari i shtetit Çarls Dilk dhe deri diku edhe te ministri i Jashtëm Grenvil (Granville).

Kjo tendencë e re u shpreh pikësëpari në mendimin se çështja e kufijve, veçanërisht me Malin e Zi, nuk mund të zgjidhej po të mos i jepej popullsisë shqiptare për humbjet territoriale që do të pësonte, një sadsifaksion, duke «kënaqur aspiratat e saj legjitime», siç i shkruante ambasadori Goshen nga Stambolli ministrit Grenvil. I bindur nga ky argumentim, Grenvili udhëzoi konsullin e përgjithshëm Grin (K. Green) në Shkodër që të studionte mundësinë e një autonomie provinciale që do të përfshinte vilajetin e Shkodrës. Duke qenë se në këtë zonë shtriheshin interesat e veçanta të Austro-Hungarisë, Londra veproi këtu në bashkëpunim të ngushtë me Vjenën. Kështu Grini hartoi bashkë me kryekonsullin austro-hungarez Lipih (M. Lippich) në Shkodër një projekt për autonominë e malësive që do të bënin pjesë në vilajetin autonom të Shkodrës. Ambasadorët britanikë dhe austro-hungarezë së bashku paraqitën, më 26.VI. 1880, me një notë drejtuar Portës propozimin për lëshimin e Ulqinit Malit të Zi si dhe për t'i dhënë vilajetit të Shkodrës një administrim autonom, propozim që hasi menjëherë në kundërshtim nga ana e sulltanit.

Një zgjidhje e tillë, e pjesshme natyrisht nuk u përgjigjej as kërkesave, as edhe interesave të popullit shqiptar, siç pasqyroheshin në kërkesat e ngritura për formimin e një vilajeti shqiptar të bashkuar.

Por një zgjidhje e tillë, sipas mendimit të disa diplomatëve anglezë, nuk mund të ishte as edhe në interesat e politikës britanike.

Duke u nisur nga mendimi se, siç i shprehej Grenvili ambasadorit Goshen, më 26 korrik, lëvizja shqiptare nuk ishte «një dukuri artificiale ose një qëndrim për t'u qortuar, po, përkundrazi pasojë e natyrshme e lëvizjes së përgjithshme (të kombësive) në Ballkan», diplomatët anglezë në Stamboll e quanin kombësinë shqiptare «si një element që nuk duhej kapërcyer në çdo kombinacion të ardhshëm politik». Në korrespondencën e vet me Grenvilin, Gosheni vinte në dukje përfitimet politike që do të kishte Britania, në qoftë se Shqipërisë do t'i akordohej vëmendja e duhur: «Po të formohej një Shqipëri e fortë (d.m.th. e bashkuar), atëherë do të dobësoheshin për një pjesë të mirë shkaqet për pushtimin e (gadishullit) nga një fuqi e huaj në rastin e shthurjes së Perandorisë Osmane, sepse një popull për pjesën më të madhe mysliman, do të bëhej burim vështirësish nga më të mëdhatë për vendet sllave e greke».

Ishte e qartë pra, se interesi i politikës britanike ndaj çështjes shqiptare lidhej me përpjekjet e Londrës për t'i mbyllur shtëgun depërtimit të mëtejshëm të Rusisë dhe influencës së saj në Ballkan.

Për një Shqipëri e dobët nuk do të mund të luante atë rol, që donin t'i atribuonin diplomatët britanikë, prandaj Gosheni, ngulte këmbë pranë Grenvilit kundër çdo mase të pjeshme që do të pengonte krijimin e një province të madhe shqiptare dhe shfaqej në rastin konkret kundër projektit të autonomisë vetëm për Shkodrën, gjë që «do t'i shkëpuste fiset katolike nga trangu i madh shqiptar».

Diplomatët anglezë u përpoqën të fitonin në konceptin e tyre të ri në lidhje me Shqipërinë edhe fuqinë tjetër të interesuar në Ballkan, Austro-Hungarinë. Gosheni i komunikonte në lidhje me këtë të ngarkuarit me punë austro-hungarez Dubski (Dubsky) në Stamboll konceptin e tij mbi të ardhmen e Turqisë dhe të Shqipërisë. Sipas mendimit të tij, nuk duhej prishur Turqia, për të mos «prishur paqen e Evropës. Duke ruajtur sundimin turk, Shqipëria duhet të udhëzohet qysh tani për t'u bërë një provincë autonome, në mënyrë që në një krizë të ardhshme të mund të këputet si një pemë e arrirë. Një Shqipëri e bashkuar do të ishte një garanci e mjaftueshme për qëndresën e brendshme dhe qetësinë e Ballkanit», përfundonte Gosheni. Por si kusht të domosdoshëm për këtë, diplomati anglez vinte «rregullimin e kërkesave të Malit të Zi dhe të Greqisë».

Qëndrimi britanik takohej vetëm pjesërisht me politikën austro-hungareze. Edhe në Vjenë qëndresa shqiptare dhe rritja e hovshme e lëvizjes autonomiste nuk kishte munguar të bënte përshtypje dhe ta detyronte atë të shqyrtonte qëndrimin e saj ndaj çështjes shqiptare. Por interesat e veçanta të Vjenës në Ballkan nuk mund të pajtoheshin me krijimin e një Shqipërie të bashkuar autonome, që mund të bëhej pengesë për synimet e saj ekspansive drejt jugut. Në këto kushte Vjena, duke u bindur për nevojën e një hapi që do t'i pajtonte shqiptarët me lëshimin e Ulqinit, u kap pas projektit për dhënien e një administrate autonome vetëm vilajetit të Shkodrës e në radhë të parë Malësisë, ku mbizotëronte elementi katolik dhe ku, nëpërmes të klerit katolik, do të mund t'i kishte ajo vetë e vetëm frerët në dorë. Vetëm për shumë kohë më vonë,

i shkruante Lipihu qendrës, mund të mendohej që rreth kësaj krahine autonome të bashkoheshin dikur edhe krahina të tjera shqiptare.

Këto dy koncepte lidhur me problemin e autonomisë së Shqipërisë u ndeshën njëri me tjetrin gjatë mbledhjeve të «Komisionit evropian për Rumelinë Lindore», në muajt qershor-gusht 1880, në Stamboll. Këtu Porta, në bazë të nenit 23 të Traktatit të Berlinit, paraqiti një projektligj mbi administrimin e vilajeteve të Turqisë evropiane. Projektligji nuk zbuste aspak centralizimin, por zhdukte, për sa i përket Shqipërisë, dhe ato privilegje të ruajtura në luftë nga malësitë. Me këmbënguljen e komisionit britanik, lordit Ficmoris, se nuk mund të zbatohet ky projekt në vilajetet shqiptare të Shkodrës, të Janinës dhe të Kosovës që kërkonin një konsideracion të veçantë, komisioni vendosi, më 26 qershor, t'i rezervonte vetes të drejtën të vendoste nëse disa provinca mund e duheshin përjashtuar nga zbatimi i tij.

Gjatë punimeve të komisionit, me aprovimin e Grenvilit, Ficmorisi u përpoq të fitonte përkrahjen e kolegëve të tij për një plan të komunikuar gojarisht përfaqësuesve të tjerë të fuqive, plan që përashihte së pari «formimin e 4 provincave shqiptare me qendër në Shkodër, në Prizren, në Elbasan, në Gjirokastër me perspektivën e formimit, në të ardhmen, të një Shqipërie të madhe».

Por këto propozime nuk gjetën një pritje të mirë nga fuqitë e tjera. Në mënyrë të veçantë Vjena dhe Petërburgu ngulnin këmbë se kjo çështje dilte jashtë kompetencave të komisionit. Austro-Hungaria deklaronte se për të kënaqur shqiptarët mjaftonte plotësisht projekti i autonomisë së Malësive të vilajetit të Shkodrës, i hartuar nga Grini e Lipihu.

Përfaqësuesi austro-hungarez Kosjek (Kossjek) dhe francezi Obare (Aubaret) hartuan një projekt që mbështetej mbi projektin e lartpërmendur dhe ia paraqitën atë komisionit, i cili, më në fund, e nënshkroi, më 23 gusht 1880, me përjashtim të përfaqësuesit rus. Po projekti, duke parashikuar emërimin e qeveritarëve të Malësisë nga Porta, e cila edhe do t'i paguante ata si funksionarë të saj, i jepte në të vërtetë qeverisë garanci më të mëdha, nga ç'i kishte pasur, për të kontrolluar malësitë.

Grenvili, duke parë kundërshtimin e përgjithshëm të fuqive kundrejt projektit anglez për 4 sanxhakët shqiptarë, nuk

nguli këmbë për të arritur pranimin e tij dhe Ficmorisi, më në fund, u kënaq që komisarët në deklaratën përcjellë Portës të përfshinin edhe dy shtesa të propozuara prej tij. Një nga këto këshillonte Portën që të respektonte privilegjet edhe të krahina-ve të tjera jashtë vilajetit të Shkodrës, siç ishin veçanërisht ato të Himarës. Shtesa tjetër prekte rrëshqitazi çështjen e bashki-mit të Shqipërisë, pa detyruar Portën për asgjë: «Në qoftë se Porta e Lartë do ta shihte oportune të bashkonte krahinat shqiptare në një vilajet të vetëm, thuhej në deklaratën e përbashkët, të nënshkruarit nuk do të kishin asnjë kundërshtim». Kjo që gjithçka që mbeti nga aksioni britanik në lidhje me autonominë e Shqipërisë. Por as ky projekt, as edhe vetë projektligji turk mbi administrimin e vilajeteve nuk u nënshkrua nga sulltani.

Fuqizimi i qëndresës shqiptare në lidhje me çështjen e kufirit greko-turk dhe rritja e lëvizjes autonomiste i dhanë rast nga ana e saj qeverisë greke për një aksion diplomatik, që pretendonte ta zgjidhte në mënyrë të saj çështjen shqiptare.

Duke vazhduar të ngulte këmbë për lëshimin e territoreve në jug të lumit Kalamas dhe duke theksuar nga ana tjetër se këmbëngulja e shqiptarëve e bënte të pamundur këtë zgjidhje, qeveria greke hodhi një projekt, që, pas mendimit të saj, do të evitonte luftën, drejt së cilës po ecte e gjithë kriza. Ishte fjala për një monarki dualiste greko-shqiptare. Kjo ide gjeti përkrahje për disa kohë te diplomatët gjermanë. Ministri i Jashtëm princi Hohenlohe (F. von Hohenlohe) deklaronte, në gusht 1880, se po të formohej nga pjesa shqiptare e Epirit, së bashku me Shqipërinë tjetër, një shtet më vete dhe të bashkohej ky në union personal me Greqinë, do të mund të gjendej një rrugëdalje nga situata pa krye që ishte krijuar. Ambasadori austro-hungarez në Berlin, konti Seçeni (I. Szécheny) iu përgjigj se edhe mendimi i tij ishte: «më mirë një Shqipëri nën hegjemoninë greke sesa një Shqipëri e shpërdorur nga Turqia ose një Shqipëri e pavarur». Mendime të tilla filloi të ushqente edhe sekretari i shtetit britanik për punët e jashtme Çarlz Dilk. Por asnjë nga këto projekte nuk hyri në rrugën e realizimit aq më tepër që marrëdhëniet aq të acaruara midis Lidhjes Shqiptare të Jugut dhe qeverisë greke e bënë pak të besueshme mundësinë e një bashkimi të tillë shtetëror.

Edhe Porta e Lartë vetë u detyrua më në fund t'i përshtatej gjendjes së acaruar në kulm në Shqipëri gjatë pranverës e verës të vitit 1880. Ambasadori gjerman në Stamboll, konti Hacfeld (Hatzfeld) me një lodër fjalësh e karakterizoi shumë mirë ngushticën në të cilën e kishte shpënë qëndrimi intransigjent i shqiptarëve sulltanin. «Sulltani ndodhet midis Skillës së një «action générale» (aksioni të përgjithshëm të Flotës së Fuqive të Mëdha) dhe Karidbit të një «insurrection générale» (kryengritjeje të përgjithshme të shqiptarëve)».

Në këto kushte sulltani kishte emëruar Abedin Pashë Dinon, një nga krerët e Komitetit Shqiptar të Jugut, si ministër të Punëve të Jashtme dhe u detyrua të merrte në shqyrtim mundësinë e krijimit të një province autonome shqiptare. Që prapa këtyre masave nuk fshihej vetëm qëllimi për të mashtruar shqiptarët ose fuqitë po kishte edhe një plan më serioz, shihet nga raportet diplomatike të kohës. Te disa qarqe me influencë të oborrit, midis të cilëve ishte edhe mareshali Ahmet Muhtar Pasha, komandant i korparmatës së Rumelisë me qendër në Manastir, ishte përhapur bindja se perandoria nuk do të dilte e pacenuar as nga një kryengritje në Shqipëri, as edhe nga ana tjetër nga një luftë me Greqinë. Në këto kushte ata e bindën sulltanin të hartonte një projekt për shpalljen e autonomisë së Shqipërisë për ta botuar sa të bëhej e qartë se nuk mbeste tjetër rrugë për të evituar humbjen e zotërimeve turke në Ballkanin Perëndimor. Por kundërshtimi që gjeti ky plan te qarqet e Portës, që ishin për një kurs të fortë, u bë shkak që ai të mos ndiqej më tej.

Më në fund, ky kurs i fortë i Portës, e cila vuri në lëvizje gjithë aparatit e saj ushtarak bashkë me intriga dhe korrupsion, ia doli të përçante në Shqipëri, e veçanërisht në Shkodër, frontin e rezistencës në çështjen e Ulqinit. Porta pati në këto çaste aq kritike, para së gjithash, përkrahjen e diplomacisë austro-hungareze dhe me anë të saj edhe të diplomacisë britanike, të cilat larguan një pjesë të mirë të Komitetit të Shkodrës nga lufta, duke i premtuar autonominë e vilajetit shkodran. Dorëzimi i Ulqinit në veri qe një sakrificë e vogël për Portën, që i hapi asaj, me përkrahjen e diplomacisë austro-hungareze në radhë të parë, rrugën për një kompromis të favorshëm në çështjen e kufirit me Greqinë, që u përvijua qysh në tetor të 1880-ës dhe u formulua përfundimisht pas një vargu peripe-cish, më 24 mars 1881.

Uniteti i çështjes së kufijve me atë të autonomisë, që kishte qenë një nga parimet kryesore dhe një nga faktorët më vendimtarë për suksesin e veprimit të atdhetarëve, u prish me këtë. Kushtet për një fitore nuk ekzistonin më. Megjithatë atdhetarët vendosën të vepronin.

Me këtë lëvizja e gjerë popullore në Shqipëri hyri në fazën e saj të fundit, më të lartë dhe më heroike. Në fillim të vitit 1881 patriotët shpallnin, ndonëse në një zonë të kufizuar, në Kosovë, në Dibër dhe në viset shqiptare të Maqedonisë, autonominë e Shqipërisë, formonin një «kuvernë të përdorme» dhe i jepnin për herë të parë botës provën, dhe një provë me sukses, siç e dëshmojnë vetë vëzhguesit diplomatikë austro-hungarezë, se shqiptarët ishin të aftë të vetëqeveriseshin.

Por rrethanat e reja të pafavorshme, në të cilat po zhvilloheshin këto ngjarje, nuk munguan të ndikonin mbi zhvillimin e punëve në Shqipëri. Turqia, pikërisht për arsye të ngjarjeve shqiptare, vrapoi të përfundonte përfundimisht marrëveshjen me Greqinë. Ajo nxitej dhe përkrahej në këtë rrugë nga diplomatët austro-hungarezë dhe britanikë, midis tyre — kulm i hipokrizisë së politikës angleze — edhe ambasadori Goshen, të cilët, tani që ishte mënjanuar rreziku i një konflikti ndërkombëtar në lidhje me kufijtë shqiptarë, e ftonin kryeministrin Said Pasha të merrte masa sa më energjike kundër shqiptarëve.

Ekspedita e Dervish Pashës mundi ta shtypte në prill-maj të 1881-shit me aprovimin e Evropës së «qytetëruar» luftën e popullit shqiptar. Por ai flamur luftarak, që ishte ngritur nga shqiptarët në vitet 1878-81, në arenën ndërkombëtare me kërkesën e mbrojtjes së integritetit të territorit kombëtar, me kërkesën për formimin e një shteti autonom, që do t'i siguronte popullit shqiptar një jetë të pavarur, të lirë e të përparuar, ai flamur nuk u ul më kurrë. Në çdo etapë vendimtare të historisë sonë, më 1896 e më 1897, më 1908 e më 1911 ai ngrihet përsëri, për të triumfuar në ditën e madhe të 28 Nëntorit të 1912-ës.

Në këtë kuptim ne nderojmë sot luftën e patriotëve shqiptarë në vitet 1878-1881 si një nga etapat më të rëndësishme që e shpunë popullin shqiptar në fitoren historike, pesëdhjetëvjetorin e së cilës po festojmë.

LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR COPËTIMIT TË SHQIPËRISË DHE PËR AUTONOMI. LIDHJA E PRIZRENIT (1875-1881)*

1. KRIZA LINDORE E VITEVE 1875-78 DHE SHQIPËRIA

Shqipëria në pragun e Krizës Lindore

Në mesin e viteve 70 të shekullit XIX Perandoria Osmane hyri përsëri në një krizë të rëndë. U bë e qartë tani se, siç thoshte K. Marksi, përpjekjet e qeverisë turke për të hyrë në rrugën e qytetërimit pësuan një dështim të vajtueshëm¹. Më 1875 borxhet e jashtme të Perandorisë Osmane ishin shtuar në 5,3 miliardë fr. ari, nga të cilat ajo kishte marrë në të vërtetë vetëm 3 miliardë. Por edhe këto kishin shkuar krejtësisht për qëllime joproduktive. Nga të ardhurat shtetërore vjetore 37 për qind ishin caktuar vetëm për të larë kamatën e huave. Në tetor 1875, Porta e Lartë, në pamundësi ta paguante më tej këtë kamatë, deklaroi zyrtarisht falimentimin. Ajo mundi të dilte nga kjo gjendje vetëm duke u detyruar të linte peng të ardhurat nga doganat, nga monopolet dhe nga taksa të tjera. Kështu, për të garantuar pagesën e huasë së

* Është nxjerrë nga «Historia e Shqipërisë», vëll. 2, Tiranë, 1965. kapiullu XII, f. 112-120.

1 K. Marksi — F. Engels, *Veprat*, botimi gjermanisht, vëll. IX, f. 7.

vitit 1865, shërbenin të ardhurat nga taksat e bagëtisë të Rumelisë, kurse për huanë e vitit 1875 e dhjeta e Shqipërisë së Veriut, e Kretës dhe e Tripolit.

Vendet kapitaliste të Perëndimit, si kreditorë, po e forconin kështu gjithnjë e më shumë kontrollin e tyre ekonomik e politik mbi Turqinë.

Shfrytëzimit feudal të masave punonjëse të Perandorisë iu shtua edhe shfrytëzimi i kapitalit të huaj. Objekti kryesor i shfrytëzimit ishte fshatarësia. Më 1874, e dhjeta (yshyri) u shtua 25 për qind, masë kjo që shkaktoi një kundërshtim të fortë në krahinat ku filloi të zbatohet. Shkatërrimtare për fshatarësinë vazhdonte të ishte mungesa e taksave doganore proteksioniste që pengonte formimin e çmimeve më të favorshme për drithin dhe me këtë e bënte të paleverdisshëm një punim më intensiv të tokës; prandaj toka ose lihej djerrë, ose përdorej si kullotë. Taksat e larta doganore mbi eksportin dhe ato të ulëta mbi importin dëmtonin rëndë zejtarët e tregtarët.

Pakënaqësia e përgjithshme që sundonte në Shqipëri, ishte veçanërisht e madhe në qarqet e borgjezisë shqiptare. Shprehje e kësaj pakënaqësie u bë libri i Pashko Vasës me titullin «E vërteta mbi Shqipërinë e shqiptarët» (1879), që përgjithësonte përvojën e grumbulluar nga populli shqiptar në marrëdhëniet e tij me administratën e re turke në vitet e fundit. «Tregtia pushoi për mungesë rrugësh e sigurie, bujqësia pësoi pengime të mëdha nga ana e myltezimeve, industria mbeti pa punë për mungesë inkurajimi», me këto fjalë P. Vasa karakterizonte situatën që ishte krijuar në Shqipëri. Kësaj i shtohej politika fiskale grabitqare e qeverisë, e cila mbështetej në «pabarazi të drejtash e detyrash». Kështu, qarqet e borgjezisë shqiptare theksonin se taksat, në dukje të njëjta për të gjithë Perandorinë, ishin në të vërtetë shumë në disfavor të shqiptarëve. Taksa për kokë bagëtie ishte 5 groshë edhe në rrethet e Stambollit, ku vlera e një deleje ishte 130 groshë edhe në rrethet e Beratit, ku vlera e saj ishte vetëm 20-30 groshë. Po kështu ishin pa përpjesëtim me vlerën reale taksat e caktuara pas regjistrimit të ri të pasurive të patundshme. Ato ishin vlerësuar me çmime që mund t'i kishin në Stamboll ose në Selanik, por jo në qytetet shqiptare.

Situata ekonomike u bë veçanërisht e rëndë me mungesën e përgjithshme të të hollave, që u shkaktua nga ndërprerja për

një kohë të gjatë e çdo pagese nga ana e arkave shtetërore pas shpalljes së falimentimit. Në këto kushte Porta e bëri zakon t'i detyronte tregtarët e Perandorisë, duke përfshirë edhe tregtarët e Shqipërisë, për pagesa të veçanta në formë huaje. Këto hua, gjoja vullnetare, u bënë me kohë një institucion i qëndrueshëm.

Një barrë tjetër për popullsinë e Shqipërisë vazhdonte të ishte shërbimi ushtarak, i cili, siç thoshte P. Vasa, «ka qenë i rëndë këto vitet e fundit, për arsye të luftërave të vazhdueshme, i ka dhjetuar shqiptarët. . . dhe i ka hequr nga punët e tokës krahët më të fortë». Por edhe këto sakrifica ishin të kota dhe nuk u jepnin shqiptarëve as një garanci minimale për ruajtjen e tërësisë së tokave të tyre. Shqiptarët i mbushte me zemërim fakti që Porta ua kishte lënë hapur shtegun agjenturave të huaja, të cilat, nën maskën fetare-shkolllore, zhvillonin një propagandë shumë aktive midis popullsisë shqiptare në favor të qeverive të vendeve fqinje. Veprimtaria e tyre shko-mbëtarizuese lehtësohej nga fakti se Porta vazhdonte të ruante ndarjen e vjetër administrative, sipas së cilës krahinat shqiptare bënë pjesë në vilajete me popullsi të përzier. Ndërsa Porta njihte gjuhën e kombësive joshqiptare si gjuhë të dytë zyrtare pranë turqishtes dhe botonte që prej vitit 1871, p.sh. në Janinë, gazetën zyrtare dhe gjithë ligjet në gjuhët turqisht e greqisht, në Prizren turqisht dhe serbisht, ajo luftonte me çdo mënyrë përhapjen e shkollës dhe të gjuhës shqipe, megjithëse këto vilajete, në pjesën më të madhe, kishin popullsi shqiptare.

Ndonëse Shqipëria përbënte një unitet ekonomik e kombëtar, siç deklaroi Pashko Vasa e atdhetarë të tjerë, qeveria turke i kishte «ndarë ata që duhej të ishin bashkuar» dhe kishte vënë «së bashku elementë të ndryshëm». Kështu, krahina të afërta e të lidhura ngushtë si, p.sh., Durrësi, Elbasani, Berati, vareshin nga tri qendra të ndryshme dhe të largëta: Shkodra, Manastiri e Janina; dhe, për më tepër, për të shkuar nga një vilajet në tjetrin, shqiptarët duhej të kishin lejkalimi.

Të gjitha këto arsye bënë që popullsia shqiptare ta shihte me mosbesim çdo veprim të organeve qeveritare turke. Për atë zgjerimi i rrjetit të xhandarmërisë, ndërtimi i zyrave qeveritare, i kazermave të garnizoneve ushtarake, madje i vetë rrugëve, ishte një mjet i ri shtypjeje nga ana e një qeverie,

«ekzistencën e së cilës ajo e ndien dhe e njeh vetëm nëpërmjet akteve drakoniane», siç shprehej një vëzhgues i huaj diplomatik.

Të njëjtën përvojë të hidhur po fitonin edhe popullsitë e zonave të tjera të gadishullit. Mjaftonte një shkëndijë për t'i dhënë zjarr gjendjes. Kjo shkëndijë u bë kryengritja në Hercegovinë. Më 1875 këtu filloi një lëvizje, e cila u drejtua së pari kundër rritjes të së dhjetës dhe abuzimeve të myltezimeve. Ajo përfshiu brenda pak kohe edhe Bosnjën. Kryengritësit ngritën kërkesën e autonomisë. Në pranverën e vitit 1876 shpërtheu edhe në Bullgari një kryengritje, që udhëhiqej nga një komitet kombëtar revolucionar.

Edhe Shqipëria u bë vatër trazirash. Një rol me rëndësi luanin këtu përsëri zonat malore, të cilat vazhdonin t'u bënë ballë me armë në dorë orvatjeve, për t'i nënshtuar ato administratës së re. Portën e shqetësonte veçanërisht qëndrimi i Mirditës, e cila përbënte një faktor ushtarak të rëndësishëm, që nuk mund të lihej pas dore, aq më tepër që rreth saj po bashkoheshin edhe bajraquet e tjera të Malësisë. Në këto kushte, duke parë se nuk bënte punë vetëm dhuna, Porta u detyrua të ndiqte një taktikë tjetër. Ajo nxiti përçarjen midis krerëve, duke emëruar njërin prej tyre si kajmekam në vend të Preng Bibë Dodës, të cilin e mbante gjithnjë në Stamboll. Gjithashtu ajo filloi të regjistronte në Mirditë me pagesë «zaptie» (xhandarë), për të krijuar kështu një taraf të vetin. Por megjithatë Mirdita mbeti për Portën një plagë e hapur. Nuk ishte e ndryshme gjendja edhe në malësitë e tjera. Më 1874 malësia e Dukagjinit zbrapsi dy ekspedita ushtarake dhe bëri të dështonin përpjekjet e reja për të vendosur aty kontrollin e Portës me anë të bylykbashëve të komisionit të Xhibalit. Malësitë e Mbishkodrës, të Kosovës dhe të Dibrës, me armë në dorë, dëbuan repartet e dërguara nga Porta për të ndërtuar atje kulla që do të shërbenin si pikëmbështetje për garnizone të vogla ushtarake. Për të frenuar lëvizjet e Malësisë, Porta u mbyllte kohë më kohë malësorëve rrugën për në treg dhe u ndalonte blerjen e misrit, duke i kërcënuar kështu me vdekje për bukë.

Lëvizjet e malësorëve shqiptarë po zhvilloheshin në një kohë kur kishin shpërthyer edhe kryengritjet e popujve të tjerë të shtypur të Ballkanit dhe kur po shtoheshin përpjekjet

e atdhetarëve për të ndikuar në këto lëvizje. Në këto kushte kryengritjet në Shqipëri, ndonëse zhvilloheshin veç nga lëvizjet e tjera në Gadishullin Ballkanik, objektivisht po shkriheshin me to në një lëvizje të përbashkët. Jo më kot revolucionari i shquar bullgar Kristo Botev vinte në dukje në një artikull se tani popujt ishin ngritur në këmbë që nga Bosnjë-Hercegovina e Shqipëria e deri në Bullgari, duke e përshëndetur këtë fakt si një kusht për fitoren e përbashkët.

Lëvizjet në Shqipëri u bënë kështu pjesë përbërëse dhe aktive e Krizës së madhe Lindore që tronditi nga themelet Perandorinë Osmane.

Kriza ballkanike e viteve 1875-1877

Në vitet 70 të shekullit XIX filloi të merrte fund faza e zhvillimit të lirë të kapitalizmit. Nga ndarja e botës kishin përfituar në radhë të parë shtetet e zhvilluara kapitaliste si Anglia dhe Franca, ndërsa mbetën prapa vendet që e bëjnë bashkimin e tyre kombëtar pas të tjerëve si Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia. Kjo solli acarimin e marrëdhënieve midis shteteve të mëdha të Evropës.

Ngjarjet politike që u zhvilluan gjatë këtyre viteve sollën ndryshimin e raportit të forcave në lëmin ndërkombëtar. Pas fitores mbi Francën (1870-71), Gjermania e bashkuar u bë një shtet i fuqishëm. Politika e kancelarit gjerman Bismark synonte të acaronte dhe më tej konfliktet ekzistuese dhe të nxiste konflikte të reja në Lindjen e Afërme për të larguar vëmendjen e Fuqive të Mëdha nga Evropa dhe veçanërisht për të penguar një aleancë midis dy shteteve të mundura prej Gjermanisë, Francës dhe Austrisë, ose midis Francës dhe Rusisë. Për këtë qëllim, me iniciativën gjermane, qysh më 1873 u arrit një marrëveshje konsultimi midis Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Rusisë (e ashtuquajtura Aleanca e Tre Perandorëve).

Duke përfituar nga disfata e Francës, Rusia, nga ana e saj, gjeti mundësinë të çlirohej nga nenet e traktatit të vitit 1856 dhe fitoi të drejtën të ndërtonte fortifikata bregdetare dhe të mbante një flotë luftarake në Detin e Zi. Përpjekjet e saj për të siguruar kalimin e lirë të flotës nëpërmjet ngushticave të Dardaneleve drejt Mesdheut, theksuan edhe më tepër riva-

litetin dhe kontradiktat midis Anglisë dhe Ruisë. Anglia shihte te Rusia kundërshtaren e saj më të rrezikshme në Mesdheun Lindor dhe në Azinë e Mesme. Edhe Austro-Hungaria, e debuar jashtë Gjermanisë dhe Italisë pas disfatës së vitit 1866, e shtyrë edhe nga Bismarku, po e kthente vëmendjen e saj gjithnjë e më tepër drejt Ballkanit, në zotërimet turke, ku ajo ndeshej me interesat e Ruisë.

Lufta diplomatike e Fuqive të Mëdha u bë veçanërisht e ashpër në lidhje me çështjen e Perandorisë Osmane dhe të zotërimeve të saj në Gadishullin Ballkanik. Politika ruse, me synimin e saj për të zhdukur sundimin turk mbi ngushticat dhe për të zgjeruar ndikimin e vet në Ballkan, pavarësisht nga qëllimet që ndiqte qeveria cariste, objektivisht ndihmonte çështjen e çlirimit të popujve që vuanin nën zgjedhën shekullore osmane. Përkundrazi, Anglia, e interesuar për ruajtjen e Perandorisë Osmane, me politikën e saj ndihmoi në shtypjen e çdo lëvizjeje çlirimtare.

Në këto rrethana kryengritjet e popullsive sllave të krishtera të Hercegovinës dhe të Bosnjës, më 1875, të cilat u pasuan nga kryengritjet e Bullgarisë dhe të Shqipërisë, shpunë në një krizë të përgjithshme ballkanike; Rusia ndërhyri duke përkrahur kërkesat për autonomi të kryengritësve hercegovinas dhe boshnjakë. Për të mos ia lënë iniciativën vetëm Ruisë, me këtë u bashkuan edhe Austro-Hungaria dhe Gjermania. Por bisedimet u zgjatën aq shumë, sa Porta gjeti kohë t'i shtypte në mënyrën më mizore këto kryengritje.

Në korrik të vitit 1876 Serbia dhe Mali i Zi, prapa të cilave qëndronte Rusia, i shpallën luftë Turqisë, për t'u ardhur në ndihmë popullsive hercegovinase e boshnjake.

Për t'u dalë përpara ngjarjeve, dy fuqitë më të interesuara, Peterburgu dhe Vjena, shpejtuan të përcaktonin qëndrimin e tyre kundrejt ngjarjeve në Ballkan. Në një takim të perandorëve të Ruisë dhe të Austro-Hungarisë në Raihshtat në Bohemi, më 8 korrik 1876, të dyja palët ranë në marrëveshje që, në rastin e një fitoreje turke, të rivendosej në gadishull gjendja ekzistuese (status quo), por duke siguruar reforma në provincat që kishin ngritur krye. Në rastin e disfatës dhe të prishjes së Turqisë, Bosnja do të kalonte nën zotërimin e Austro-Hungarisë dhe, pjesërisht, të Serbisë. Kjo e fundit do të merrte edhe një pjesë të Serbisë së Vjetër (sic

quhej vilajeti i Kosovës nga serbët), ndërsa Mali i Zi një pjesë të Hercegovinës. Nga tokat e tjera turke në Ballkan do të formoheshin shtete autonome si Bullgaria, ose provinca autonome si Rumelia. Austro-Hungaria kërkoi edhe autonominë e Shqipërisë, gjë që nuk parashikohej në planin rus. Me krijimin e një shteti autonom shqiptar, Vjena mendonte t'i bënte ballë rrezikut të zgjerimit të shteteve sllave dhe me këtë zgjerimit të ndikimit të Ruisë në bregun e detit Adriatik, ku prekeshin drejtpërsëdrejti interesat e monarkisë habsburgase. Austro-Hungaria ngulte këmbë që të mos lejohej në asnjë mënyrë formimi i një shteti të madh sllav në Ballkan, i cili mund të bëhej pengesë për synimet e saj të mëtejshme në këtë gadishull.

Ndërkohë, veprimet luftarake në frontin serbo-turk po zhvilloheshin në dëm të Serbisë. Pas disa suksesesh të para, ushtritë serbe pësuan një varg disfatash të rënda. Vetëm pas një ultimatumit të ashpër rus, Porta u detyrua të ndalte përparimin e ushtrive të saj në Serbinë Jugore dhe të pranonte një armëpushim.

Në frontin e Malit të Zi, me gjithë forcat e konsiderueshme turke, malazezët korrën disa fitore në Medun dhe në Danilovgrad si dhe në territorin e Kuçit e të Piprit.

Kryengritja e Mirditës në vitet 1876-1877

Shpërthimi i krizës ballkanike, lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi kundër Turqisë, zhvillimi i ngjarjeve luftarake dhe humbjet që pësoi Porta në kufirin me Malin e Zi nuk mund të mos ushtronin një ndikim të rëndësishëm edhe në Shqipëri, duke i dhënë hov lëvizjes antiturke që ziente prej kohësh.

Përtpjekjet e Portës për të rekrutuar në masë forca të çrregullta shqiptare dhe për t'i hedhur në luftë kundër Malit të Zi dhe Serbisë, dështuan. Përkundrazi, urrejtja kundër qeveritarëve turq ishte bërë aq e madhe, saqë në një varg rastesh, si në veri ashtu edhe në jug të Shqipërisë, u shfaqën tendënca për t'u bashkuar me një aksion kundër sulltanit, qoftë edhe me forcat malazeze ose greke. Në Mirditë mori hov tarafi i luftës dhe krerët e tarafit të Portës u dëbuan. Malësorët që ishin shkruar «zaptie» u bashkuan me lëvizjen.

Në këto rrethana u aktivizuan në Shkodër përsëri një grup atdhetarësh, në të cilin bënë pjesë, përveç Zef Jubanit, inte-

lektualë si Pjetër Gurakuqi, prifti Preng Doçi, Lorenc Gurakuqi etj. Një nga kujdeset kryesore të atdhetarëve shkodranë ishte drejtimi i lëvizjes mirditore. Ata u përpoqën t'i jepnin asaj detyra politike më të përcaktuara. Nga ana tjetër, grupi u mundua ta zgjeronte kryengritjen përtej Mirditës dhe elementit katolik, duke krijuar lidhje edhe me përfaqësues të popullsisë myslimane në Malësi dhe në Shkodër.

Për t'i dalë përpara rrezikut të një aleance të Mirditës me Malin e Zi, Porta, në verë të vitit 1876, u detyrua të kthente në Shkodër nga internimi trashëgimtarin e kapidanit të Mirditës, Preng Bibë Dodën, duke i dhënë detyrën e kapjekamit. Që kur ndodhej në Stamboll, Preng Bibë Doda kishte krijuar kontakte me diplomatë rusë, të cilët e kishin këshilluar të lidhej me Malin e Zi. Në fillim, i pavendosur në qëndrimin e tij, Prenga i ri, i ndodhur para një lëvizjeje të fuqishme popullore, e la Shkodrën dhe u bashkua me kryengritësit, ndonëse ndërkohë Mali i Zi, për të mos u gjetur vetëm përballë Turqisë, kishte bërë armëpushim me Portën.

Kryengritja e Mirditës filloi të tërhiqte vëmendjen e diplomacisë evropiane, veçanërisht të Rusisë dhe të Italisë. Duke e konsideruar lëvizjen në Shqipëri si një faktor ndihmës në rastin e një lufte të ardhshme kundër Turqisë, Peterburgu synonte ta përdorte atë për të zgjeruar ndikimin rus në viset perëndimore të Gadishullit Ballkanik, ku mbizotëronte ndikimi austro-hungarez. Politika italiane, nga ana e saj, duke e parë veten të pafuqishme për të bërë në Ballkan një politikë ekspansioni, ashtu siç bënte Austro-Hungaria, nxiste dhe përkrahte çdo iniciativë që mund t'i krijonte vështirësi politikës së rivales së saj. Qarqe politike me influencë në Itali nuk nguronin të përkrahnin parullën «Ballkani — ballkanasve». Ata inkurajonin, nëpërmjet arbërëshëve dhe të një komiteti që mbante emrin «Lidhje për çlirimin dhe vëllazërimin e popujve të Gadishullit Ballkanik», idenë e krijimit të një vargu shtetesh ballkanike, midis tyre edhe të një shteti shqiptar, që do të formonin një federatë. Kjo federatë duhej t'i mbyllte rrugën ekspansionit austro-hungarez në Bosnjë-Hercegovinë e më tej Vjena, nga ana e saj, u përpoq ta frenonte lëvizjen në Mirditë, që mund të krijonte ndërlikime të rrezikshme për të.

Atdhetarët shkodranë e gjykonin situatën ndërkombëtare të favorshme për një kryengritje të përgjithshme shqiptare, me

anë të së cilës Porta do të detyrohej të njihte krijimin e një principate shqiptare autonome nën sovranitetin e sulltanit. Për të realizuar këtë qëllim, grupi i Shkodrës krijoi lidhje edhe me vende fqinje. Nëpërmjet një komiteti arbëresh në Kozencë, ai u lidh me qarqe demokratike revolucionare në Itali, që e nxitnin të bashkonte «forcat për çlirimin e Shqipërisë, duke u shtrirë dorën vëllezërve sllavë të Jugut kundër shtypësit të përbashkët», siç thuhej në një deklaratë të këtij komiteti. Për këtë qëllim u nis për në Cetinë, për bisedime me burrat e shtetit të Malit të Zi, prifti Prengë Doçi. Princi i Malit të Zi i dha P. Doçit sigurime për ndihmë financiare dhe për armë. Njëkohësisht ai deklaroi se Mali i Zi nuk kishte asnjë pretendim mbi tokat shqiptare dhe kërkonte zgjerim në krahinat sllave të Hercegovinës dhe në drejtim të Tivarit.

«Përpara botës u ngrit tani çështja shqiptare», kështu shkruante në këtë kohë nga Shkodra diplomati rus Jastrebov. Lëvizja në Mirditë, në krye të së cilës qëndronte Prengë Bibë Doda, filloi të fitonte përkrahje gjithnjë e më të gjerë në Malësitë e Veriut. Më 27 dhjetor, një kuvend i madh, i mbledhur në Shënpal të Mirditës, lidhi besën për kryengritje. Mbledhje të tilla u bënë në javët e mëvonshme edhe në Kthellë, në Pukë dhe në Malësinë e Lezhës. Shpresat e kryengritësve ishin varur, sipas shprehjes së Jastrebovit, «te gjëmimi i topave në Danub», d.m.th. te mundësia e një lufte ruso-turke.

Por vendimi i Prengë Bibë Dodës për të filluar në shkallë të gjerë nga veprimet kryengritëse ishte vonuar shumë dhe u mor në janar 1877, në një kohë kur Mali i Zi ishte në gjendje armëpushimi dhe nuk kishte ende shenja për shpërthimin e luftës midis Perandorisë Osmane dhe Rusisë. Kryengritësit ndërmorën një aksion të rëndësishëm, duke prerë rrugën ushtarake Shkodër-Prizren. Aksione të tjera u drejtuan kundër repartëve turke që ishin mbledhur në krahinat rreth Mirditës.

Për të mos e lënë kryengritjen të shtrihej në të gjithë Shqipërinë e Veriut dhe të bashkohej me kryengritjen në Bosnjë-Hercegovinë, ose eventualisht me luftën e Malit të Zi e të Rusisë, Porta mori masa energjike dhe nisi një ekspeditë ushtarake kundër Mirditës. Në fund të marsit 1877 forca të rëndësishme turke arritën më në fund deri në Orosh. Njëkohësisht, konsulli anglez dhe ai austro-hungarez në Shkodër me premtime e të holla e shtynë Prengë Bibë Dodën që të

braktiste kryengritjen dhe t'i dorëzohej autoriteteve turke, duke i siguruar falje dhe përkrahjen e tyre që Porta ta njihte si kapidan të Mirditës. Pas luftimesh që zgjatën deri në fillim të majit, kryengritja, e mbetur pa udhëheqës, u shtyp. Mirdita, e shkelur nga forca turke, pësoi dëme të mëdha nga djegiet dhe nga plaçkitjet.

Memorandumi i Janinës (pranverë 1877). Fillimet e veprimtarisë së Abdyl Frashërit

Në të njëjtën kohë me lëvizjet kryengritëse në provincat joturke, në kryeqytetin e Perandorisë, në Stamboll, në verën e vitit 1876, u zhvilluan trazira të mëdha. Rritja e pakënaqësisë së masave popullore turke u bë shkak për rrëzimin e sulltan Abdyl Azizit; pak kohë më vonë u rrëzua nga fronti edhe pasardhësi i tij, Murati V. Një rol të rëndësishëm në këto ngjarje luajti shoqëria e fshehtë e osmanllinjve të rinj, e përbërë nga oficerë dhe nga intelektualë të pakënaqur nga dobësimi i vazhdueshëm i Perandorisë. Ndryshe nga rrethet reaksionare, osmanllinjtë e rinj synonin ta shpëtonin Perandorinë me anën e reformave të mëtejshme, duke vendosur një regjim kushtetues që do ta kufizonte pushtetin autokratik të sulltanit.

Sulltani i ri Abdyl Hamiti, që erdhi në fuqi më 31 gusht 1876, premtoi se do të shpallte kushtetutën. Por shumë shpejt sulltani dhe qeveria e tij u ndodhën përballë ndërlikimeve të reja ndërkombëtare të lidhura me krizën ballkanike.

Rusia bënte presion pranë Portës për t'i siguruar Serbisë së mundur status quo-në territoriale, për t'i lëshuar Malit të Zi disa toka dhe për t'i dhënë autonominë Bosnjë-Hercegovinës dhe Bullgarisë. Kundërshtimi i Turqisë i dha rast Ruisë të shpejtonte përgatitjet ushtarake. Për t'iu shmangur një konflikti që mund të ishte vdekjeprurës për Turqinë, Anglia propozoi mbledhjen e një konference ndërkombëtare për të zgjidhur çështjet e ngritura nga konferenca ndërkombëtare, për të zgjidhur çështjet e ngritura nga Rusia. Por Porta, e përkrahur fshehurazi nga Anglia, i pengoi punimet e Konferencës së Ambasadorëve, që filluan në Stamboll, më 11 dhjetor 1876. Për këtë qëllim sulltani shpalli më 24 dhjetor kushtetutën. Mithat Pasha, udhëheqës i lëvizjes për kushtetutën dhe kryeministër,

deklaroi para konferencës se me këtë akt të sulltanit çështjet e ngritura në konferencë zgjidheshin vetvetiu, meqenëse kushtetuta u siguronte të gjithë shtetasve, pa dallim kombësie dhe feje, të drejtat politike. Por kushtetuta turke e 1876-ës nuk u jepte popullsiive të shtypura të Perandorisë asnjë të drejtë të veçantë si kombësi më vete. Ajo parashikonte vetëm disa liri të kufizuara si atë të shtypit, të mbledhjeve etj., dhe krijonte një parlament; por në të vërtetë ajo mbeti në letër, sepse pushteti i sulltanit ruante të drejta të tilla që e paraliznin kushtetutën, aq më tepër që prapa saj nuk qëndronte një borjezi turke e aftë për ta vënë në jetë.

Me gjithë manovrimet e Portës, Fuqitë e Mëdha nënshkruan në Londër, në mars 1877, në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, një protokoll që e detyronte Turqinë të pranonnte formimin e disa provincave autonome (Bosnjë-Hercegovinën dhe dy provinca bullgare).

Protokolli i Londrës njihte parimin e autonomisë kombëtare, ndonëse jo për të gjitha kombësitë e Ballkanit. Ai ishte një hap i ri drejt decentralizimit të Perandorisë Osmane.

Konferenca e Stambollit kishte caktuar edhe vijat kufitare të dy provincave bullgare. Kufijtë e vilajetit perëndimor, me qendër në Sofje, shtriheshin në perëndim deri në Drin, duke përfshirë edhe krahina e qendra me popullsi shqiptare, siç ishin Kaçaniku, Tetova, Gostivari, Dibra etj. Konferenca pranonnte gjithashtu një rektifikim të kufijve të Malit të Zi nga ana juglindore, duke i njohur atij, përveç të tjerave, edhe tre ishuj në liqenin e Shkodrës, si dhe të drejtën e lundrimit të lirë në këtë liqen dhe në lumin e Bunës.

Vendimet e Konferencës së Stambollit patën rrjedhime të rëndësishme në Shqipëri. Ato krijuan përshtypjen se tani kishte filluar, në njëfarë mënyre, ndarja e zotërimeve turke midis kombësive të ndryshme dhe u dhanë shkas shqiptarëve të ngrinin nga ana e tyre kërkesën për të dalluar kombësinë shqiptare dhe për të veçuar truallin e saj nga provincat e tjera të Perandorisë. Në këto rrethana bëhej e nevojshme që edhe për Shqipërinë të siguroheshin kushtet e favorshme, që parashikonin vendimet e Stambollit për provincat e reja, d.m.th. autonomia.

Për këtë qëllim, në pranverën e vitit 1877*, u thirr në Ja-

* Shih shënimin në faqe 201 të këtij vëllimi.

ninë një mbledhje e parisë së Shqipërisë së Jugut. Një rol me rëndësi në organizimin e saj luajti, në radhë të parë, Abdyl Frashëri, një intelektual i ri, i cili shërbente si drejtor i financës së vilajetit në Janinë.

Bashkë me të tjerë, përfaqësues të parisë së vendit që morën pjesë në këtë mbledhje si Mehmet Ali bej Vrioni, Ibrahim Dragoti, Myslim Gjoleka etj., Abdyl Frashëri ishte bindur tani nga ngjarjet se Shqipëria ishte e dënuar të zhdukej, në qoftë se gjendja e saj në kuadrin e Perandorisë nuk do të ndryshonte, në qoftë se shqiptarët nuk do të merrnin masa për ngjarjet që po përgatiteshin. Këtij qëllimi duhej t'i shërbente memorandumimi që u adoptua nga mbledhja e Janinës dhe që iu paraqit qeverisë së Stambollit. Me anë të tij paria shqiptare i tërhoq vëmendjen Portës së Lartë mbi gjendjen e keqe, në të cilën ndodheshin krahinat shqiptare, dhe shtronte kërkesën për bashkimin e të gjitha krahinave të banuara prej shqiptarëve në një vilajet të vetëm, me një administratë të përbërë prej nëpunësish shqiptarë dhe me shkolla e gjyqe në gjuhën shqipe. Të ardhurat nga taksat e këtij vilajeti duhej të përdroreshin kryesisht në dobi të popullsisë vendase. Vilajeti shqiptar duhej të kishte milicinë e vet, që do të kryente shërbimin brenda Shqipërisë.

Memorandumimi i Janinës ishte kërkesa e parë e hapur dhe zyrtare e lëvizjes patriotike shqiptare për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë. Por ngjarjet e Luftës Ruso-Turke që shpërtheu pak kohë më vonë, u bënë shkak që Porta ta kalonte në heshtje këtë kërkesë.

Lufta Ruso-Turke 1877-1878. Traktati i Shën-Stefanit

Duke e ditur veten të përkrahur nga Anglia, Porta e zvarriti zbatimin e protokollit të marsit 1877. Për këtë arsye qeveria ruse po përgatitej në mënyrë aktive për luftë. Për të larguar, në rast lufte, një sulm nga ana e Austro-Hungarisë, Peterburgu, me një marrëveshje të bërë në Budapest, në janar 1877, i njohu asaj të drejtën që të pushtonte pas luftës tërë Bosnjën dhe Hercegovinën. Marrëveshja përsëriste dispozitat e marrëveshjes së Raihshtatit, d.m.th. parashikonte, në rast se pri-

shej Perandoria Osmane, krijimin e disa shteteve të pavarura ballkanike, midis të cilave do të ishte edhe Shqipëria. Përveç kësaj, pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik Rusia e njihte si zonë ndikimi të Austro-Hungarisë.

Më 24 prill 1877 Rusia i shpalli luftë Turqisë. E kalbur nga brenda, ndonëse e armatosur mirë, Turqia nuk mundi t'i bënte ballë përparimit të ushtrive ruse në Bullgari. Pasi thyen qëndresën e ashpër të fortesës së Plevnës dhe pasi pushtuan, më në fund, Edrenen (Adrianopojën), trupat ruse, në janar të 1878-ës, iu drejtuan Stambollit.

Duke përfitur nga operacionet e ushtrisë ruse, që kishte gozhuar forcat kryesore turke, Mali i Zi rifilloi luftën kundër Turqisë. Ushtritë malazeze i shtrinë veprimet luftarake deri në Hot, kurse në perëndim të liqenit të Shkodrës deri në krahinat e Krajës dhe të Anamalit. Ato pushtuan, midis të tjerash, Tivarin dhe pas një lufte të ashpër, shtëpi më shtëpi, Ulqinin dhe dolën në brigjet e Bunës, në afërsi të Shkodrës.

Veprimet luftarake kundër Turqisë i rifilloi edhe Serbia. Një kolonë e ushtrive të saj përparoi në drejtimin juglindor dhe mori, ndër të tjera, Nishin, ndërsa një kolonë tjetër, duke marshuar drejt jugperëndimit, arriti në Gjilan.

Me gjithë kundërshtimin e Anglisë, edhe Greqia bënte përgatitje për të hyrë në luftë kundër Turqisë, qoftë edhe në çastin e fundit, për të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes në ndarjen e plaçkës së luftës.

Përparimi i shpejtë i trupave ruse e shpuri Perandorinë Osmane në pragun e shembjes së plotë. E shqetësuar nga përparimi i ushtrive ruse në drejtim të Stambollit, Anglia dërgoi flotën e saj luftarake në detin Marmara dhe e shtyu Turqinë të nënshkruante, më 29 janar, në Edrene «preliminarët» e paqes. Njëkohësisht, duke përfitur nga rrethanat, sulltani gjeti rastin për të shpërndarë parlamentin dhe për të rrëzuar nga fuqia kushtetutën.

E ndodhur para kërcënimit të një lufte të re me Anglinë, në qoftë se do të vazhdonte veprimet luftarake, Rusia nënshkroi, më 3 mars 1878, në Shën-Stefan (lagje e jashtme e Stambollit) traktatin e paqes. Ky traktat u jepte pavarësinë e plotë Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë, që deri atëherë kishin qenë shtete autonome. Bullgaria fitonte autonominë, duke mbetur nën sovranitetin e sulltanit.

Për sa i përkiste Shqipërisë, Traktati i Shën-Stefanit jo vetëm e linte atë nën sundimin turk, por e cungonte në mënyrë mjaft të rëndë territorin e saj në favor, para së gjithash të Bullgarisë, dhe pastaj të Malit të Zi e të Serbisë. Në kufijtë e Bullgarisë, që do të shtriheshin prej Danubit në detin Egje dhe prej Detit të Zi në Drinin e Zi dhe në malet e Voskopojës, përfshiheshin disa krahina me popullsi shqiptare të Maqedonisë, si dhe rrethet e Pogradecit, të Korçës, të Bilishtit etj. Malit të Zi i jepeshin, përveç të tjerave, edhe vise të banuara vetëm ose kryesisht prej shqiptarësh si Ulqini, Kraja, Anamali, Hoti, Gruda, Kelmendi, Vermoshi, Plava, Gucia, Rugova etj. Serbia zgjerohej në sanxhakun e Prishtinës deri në afërsitë e Mitrovicës dhe merrte disa vise me popullsi shqiptare mjaft të dendur.

Rreziku i copëtimit të Turqisë dhe i rritjes së ndikimit të Rusisë në detin Mesdhe nëpërmjet Bullgarisë, alarmoi Anglinë dhe Austro-Hungarinë, të cilat kërkuan që kushtet e paqes të rishikoheshin nga një kongres i posaçëm i Fuqive të Mëdha. Këtë u detyrua ta pranonte, më në fund, edhe Rusia. Mbledhja e kongresit u vendos të bëhej në Berlin, në fillim të qershorit 1878.

Themelimi i «Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare»

Kriza ballkanike në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë zhvillimi i stuhishëm i ngjarjeve të Luftës Ruso-Turke, shtroi përpara popullsive të krahinave të ndryshme shqiptare gështjen e fatit të mëtejshëm të Shqipërisë në çastin kur disfatat e para të ushtrive turke linin të kuptohej se shembja e plotë e Perandorisë Osmane ishte e afërt. Me këtë rast bëhej i pashmangshëm edhe rregullimi i ri i gjithë punëve të Ballkanit. Situata hapte kështu, nga njëra anë, rrugën e realizimit të synimeve të atdhetarëve për sigurimin e autonomisë së Shqipërisë, por, nga ana tjetër, krijoheshin një varg rreziqesh të reja lidhur me pretendimet që ngrinin disa shtete ballkanike kundrejt tokave shqiptare si pjesë të trashëgimit të Perandorisë së sulltanëve. Midis problemeve më urgjente që shtronte kështu situata para aktivistëve të lëvizjes politike shqiptare, ishte në radhë të parë ai i sigurimit të tërësisë së tokave shqiptare

dhe pas kësaj, çështja e marrëdhënieve me Turqinë. Lidhur me këto probleme shtrohej edhe çështja e fitimit të një aleati, që do të kishte interes të ndihmonte lëvizjen shqiptare.

Duke u ndodhur përballë këtyre detyrave dhe problemeve, përfaqësuesit e shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare, me gjithë divergjencat që kishin midis tyre, u bashkuan në një çështje kryesore, që ishte çështja e sigurimit të tërësisë dhe të unitetit tokësor për popullin shqiptar. Ndërsa qarqet zyrtare turke në Shqipëri dhe elementët e verbër turkomanë shqiptarë i përfshiu një çorientim dhe një demoralizim i plotë, që në disa raste shpuri në nxitje pogromesh kundër të krishterëve, shtresat më të gjera të popullit, masat fshatare, me të cilat u bashkuan çifligarët dhe borgjezia e qyteteve, filluan të përgatitnin masa për mbrojtjen e vendit. Kështu në Kosovë, në Dibër e në disa krahina të Veriut filluan të organizoheshin reparte lokale të vetëmbrojtjes, për rastin kur operacionet luftarake do të kërcënonin drejtpërdrejt viset e tyre.

Me përparimin e malazezve në drejtim të Hercegovinës dhe të Shqipërisë, prej nga ishin tërhequr forcat turke për t'u përqendruar në Ballkanin Lindor, në malësitë, në fillim, u bënë përgatitje të reja për një kryengritje. Me nxitjen e Malit të Zi, që synonte t'i përdorte malësorët për një aksion të kombinuar kundër Shkodrës, në janar të 1878-ës filluan përsëri sulmet e mirditasve kundër reparteve turke të vendosura në Orosh. Por këto aksione nuk u zhvilluan më tej dhe në krahina të tjera. Ushtritë serbe dhe malazeze, posa shkelën në vise me popullsi shqiptare myslimane, filluan dëbimin ose shpërnguljen masive të popullsive vendase, duke shkaktuar një alarm të madh në krahinat kufitare.

Këto veprime e bënë të qartë se lufta e këtyre dy shteteve nuk kishte më si qëllim vetëm bashkimin e tyre kombëtar, por edhe aneksimin e tokave shqiptare. Ky qëndrim, tanimë haptazi armiqësor e grabitqar, e bëri të pamundur që të zhvilloheshin më tej kontaktet e filluara në vitet 1876-77 dhe të krijohej një front i përbashkët i luftës kundër armikut të përbashkët, Turqisë.

Në këto kushte, për rrethet patriotike u bë e qartë se detyra më urgjente ishte organizimi i lëvizjes spontane për vetëmbrojtje, që kishte shpërthyer në krahina të ndryshme dhe ajo të shndërrohej në një lëvizje të ndërgjegjshme kombëtare

me një organizatë udhëheqëse të vetme, e cila duhej të merrte në dorë çështjen e shpëtimit të Atdheut dhe të përfaqësonte popullin shqiptar para opinionit publik botëror.

Por asnjë nga grupet që ekzistonin në këtë kohë në Shqipëri nuk kishte autoritetin dhe mundësitë për të luajtur një rol të tillë. Këtë mundi ta bënte vetëm një grup atdhetarësh që ishte formuar në kryeqytetin e Perandorisë, në Stamboll, nga nëpunës, nga tregtarë, nga funksionarë të lartë shtetërorë, nga çifligarë të internuar etj., që vinin nga krahina të ndryshme dhe që përfaqësonin fetë e ndryshme të vendit. Bërthamën e këtij grupi e përbënin Pashko Vasa, Jani Vretoja, Sami Frashëri, Zija Prishtina dhe Abdyl Frashëri, i cili kishte ardhur në kryeqytet si deputet i Janinës. Pak më vonë grupi mori emrin «Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare».

Disfatat e rënda që kishte pësuar ushtria turke me rënien e fortesave të fundit në malet Ballkan, krijuan qysh në vjeshtë të 1877-ës tek anëtarët e këtij grupi përshtypjen se fundi i Perandorisë ishte i afërt dhe përcaktuan veprimtarinë e mëtejshme të komitetit.

Anëtarët e këtij grupi ishin të mendimit se duhej shfrytëzuar sa të ishte e mundur, interesi i Portës për të mbrojtur territoret e saj, pra edhe Shqipërinë, kundër copëtimit, porse detyrat e shqiptarëve nuk mund të kufizoheshin me kaq: tërësia e tokave shqiptare mund të mbrohej vetëm në rast se lufta për të mbështetej në parimin e kombësisë dhe çohej deri në sigurimin e autonomisë së Shqipërisë. Anëtarët e Komitetit të Stambollit mendonin se Shqipëria mund ta arrinte autonominë edhe në rrugën e një marrëveshjeje me Portën, duke shfrytëzuar situatën e ngushtë të Perandorisë, kur Porta nuk kishte tjetër rrugë për të ruajtur sovranitetin e saj mbi provincat perëndimore.

Me anën e disa anëtarëve të tij me influencë, që kishin lidhjes me qarqet e oborrit, komiteti arriti të nxirrte një dekret të sulltanit që autorizonte krijimin e reparteve vullnetare shqiptare për mbrojtjen lokale. Me këto reparte, të cilat do të ishin nën komandën e udhëheqësve shqiptarë, komiteti mendonte se do të kishte në dorë forcat e nevojshme jo vetëm për mbrojtjen e krahinave shqiptare, por edhe për të realizuar

autonominë, në rast se Porta do të kundërshtonte, edhe kundër vullnetit të saj.

Një çështje që filloi të tërhiqte në mënyrë të veçantë vëmendjen e komitetit, ishte sigurimi i një aleati të jashtëm për lëvizjen autonomiste shqiptare. Në kushtet kur fitorja e plotë e Rusisë mbi Turqinë po krijonte mundësinë për realizimin e synimeve të qeverisë serbe e malazeze kundër tokave shqiptare, komiteti mendonte se aleat i lëvizjes shqiptare mund të ishte vetëm ai shtet, interesat e të cilit prekeshin nga zgjerimi i Serbisë në Maqedoni ose nga krijimi i një shteti bullgar me kufij të zgjeruar në jug, por që, nga ana tjetër, të mos ishte përfshirë në konfliktin që po zhvillohej. Ky shtet ishte Greqia, prapa së cilës qëndronte Anglia.

Për anëtarët e komitetit nuk ishte i panjohur fakti që qarqet zyrtare greke kishin ngritur kohë më kohë pretendime mbi tokat e Shqipërisë së Jugut. Por interesat e përbashkëta para rrezikut që sillte me vete situata, sipas mendimit të shumicës së anëtarëve të komitetit, duhej ta bindnin qeverinë greke të hiqte dorë nga pretendimet e saj. Për këtë qëllim, qysh në tetor të 1877-ës, filluan në Stamboll bisedimet midis përfaqësuesve të Komitetit Shqiptar dhe një personi të autorizuar nga qeveria greke. Nga pala shqiptare u kërkua që qeveria greke të jepte sigurime formale për njohjen e tërësisë tokësore dhe të ekzistencës së një shteti shqiptar të pavarur. Kufijtë jugorë të këtij shteti shqiptar duhej të përfshinin gjithë krahinat shqiptare të vilajetit të Janinës, bashkë me Çamërinë dhe bregdetin deri në Prevezë, duke i lënë Greqisë Janinën dhe krahinat e tjera në jug të lumit Kalamas. Me këtë kusht komiteti shqiptar ishte i gatshëm të pranonte si kryetar shteti të Shqipërisë një princ nga shtëpia daneze, e cila sundonte në Greqi, duke përforcuar kështu aleancën që do të lidhej midis dy vendeve. Bisedimet zgjatën deri në shkurt të 1878-ës pa rezultat, për arsye të qëndrimit të qeverisë greke, e cila ngulte këmbë që kufirin midis dy shteteve ta përbënte një vijë që nisej në jug të Vlorës dhe duhej t'i linte Greqisë gjithë krahinën e Gjirokastrës, të Delvinës e të Përmetit.

Bisedimet shqiptare-greke u ndërpre në atëherë kur, më 27 shkurt 1878, banda andartësh grekë, duke ardhur nga Korfuzi, zbarkuan në Lëkurës, në afërsitë e Sarandës, dhe u përpoqën të nxitnin një kryengritje midis popullsisë së vendit,

për t'i siguruar kështu Greqisë, në çastet e fundit të Luftës Ruso-Turke, një pjesë nga plaçka e luftës. Ndërmarrja, e cila tregonte se qarqet qeveritare greke nuk hiqnin dorë nga planet e tyre kundër Shqipërisë, u shpartallua brenda disa ditëve nga forcat vendase.

Në këto kushte Komiteti i Stambollit e braktisi idenë e aleancës shqiptare-greke. Në veprimtarinë e tij të mëtejshme, në një varg memorandumesh të botuara në shtypin evropian ose të paraqitura qeverive të huaja, komiteti ngriti zërin jo vetëm kundër copëtimit të Shqipërisë sipas Traktatit të Shën-Stephanit, por edhe kundër synimeve grabitqare të qeverisë greke.

Megjithatë, Komiteti i Stambollit theksonte edhe më tej nevojën që populli shqiptar të mbante marrëdhënie miqësore me popujt fqinjë. Në proklamatinë e shpallur më 30 maj 1878, komiteti deklaronte: «Ne dëshirojmë nxehtësisht të rrojmë në paqe me të gjithë fqinjët tanë: Malin e Zi, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë. Ne nuk kërkojmë, nuk dëshirojmë asnjë prej tyre, por jemi krejtësisht të vendosur të mbrojmë me këmbëngulje çdo gjë që është jona. T'u lihet pra, shqiptarëve toka shqiptare!».

Luftën kundër copëtimit të Shqipërisë Komiteti i Stambollit e lidhi ngushtë me luftën për autonominë territoriale-administrative të vendit. Në një promemorje të paraqitur në mars të 1878-ës, në emrin e popullit shqiptar, ambasadës britanike në Stamboll, nga një shqiptar që ka të ngjarë të jetë anëtari i komitetit Pashko Vasa, vihej në dukje se, si pasojë e të gjitha ngjarjeve të kohës së fundit «po lind një çështje e re, çështja shqiptare. Në qoftë se është e drejtë që të formojnë shtetet e tyre të pavarura ose autonome popujt sllavë, është e qartë se edhe shqiptarët nuk mund të kënaqen me një administratë të tillë të kalbur, siç e kanë pasur gjer tani. Ata janë të bindur se qeveria turke nuk do dhe nuk mund t'u japë atyre një administratë më të mirë. Prandaj nuk ka asnjë arsye që shqiptarët të heqin dorë me vullnet të tyre nga të mirat e një administrate autonome. Ata janë të vendosur t'i këputin të gjitha lidhjet që i bashkojnë me Turqinë. Ata kërkojnë një administratë të veçantë që t'u përgjigjet më tepër nevojave dhe traditave të tyre. Shqiptarët kërkojnë të drejtën të hyjnë në gjirin e familjes së madhe evropiane, prej së cilës janë një pjesë...»

Me këtë program Komiteti i Stambollit caktonte një vijë të drejtë për gjithë veprimtarinë e mëtejshme politike brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ai e orientonte lëvizjen popullore që kishte marrë hov në Shqipëri, të mos binte në kthetrat e Portës e të mos bëhej thjesht një vegël në luftën që kishte filluar kjo kundër Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit. Për të ndikuar më efektivisht mbi këtë lëvizje, Komiteti i Stambollit u përpoq të vendoste lidhje të drejtpërdrejta me udhëheqësit e saj në Shqipëri.

2. FORMIMI I LIDHJES SË PRIZRENIT DHE VEPRIMTARIA E SAJ GJATË VITIT 1878

Lëvizja shqiptare kundër Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit. Formimi i Lidhjes së Prizrenit

Traktati i Shën-Stefanit shkaktoi një valë të madhe protestash në Shqipëri. Nga mbledhjet që u organizuan në qytetet e ndryshme të Kosovës si dhe në Shkodër, u zgjodhën një varg komisionesh lokale, të cilat morën përsipër që të organizonin forcat për të kundërshtuar çdo lëshim tokash Serbisë dhe Malit të Zi. Komisionet filluan të mblidhnin ndihma për dhjetëra mijë muhaxhirë shqiptarë që kishin lënë vendet e tyre për arsye të veprimeve luftarake ose të dëbuar nga administrata e re serbe dhe malazeze.

Për të zgjidhur më mirë detyrën e mbrojtjes së vendit dhe për të vepruar në mënyrë të bashkuar dhe të organizuar në arenën ndërkombëtare, komisionet lokale të disa krahinave, të nxitura edhe nga Komiteti i Stambollit, u vunë në lidhje midis tyre. Kjo u bë veçanërisht e nevojshme me afrimin e datës së hapjes së kongresit në Berlin, që duhej të rishikonte vendimet e Shën-Stefanit.

Përfaqësues të krahinave të Shqipërisë Veriore e Verilindore organizuan një varg mbledhjesh në Guci, në Gjakovë, në Lumë e në Prizren me qëllim që të krijonin një qendër drejtuese. Një rol me rëndësi në organizimin e këtyre mbledhjeve luajti Ali bej Gucia (më vonë Ali Pasha), pronar i

pasur tokash dhe me influencë në krahinën e Gucisë. Porta jo vetëm nuk i pengonte, por edhe i inkurajonte këto përpjekje, ashtu siç bënte edhe në krahina të tjera të Maqedonisë e të Bullgarisë, duke nxitur myslimanët vendas t'u dërgonin Fuqive të Mëdha telegrame proteste kundër traktatit të paqes. Por ndryshe nga këto krahina, në Shqipëri lëvizja për të organizuar vetëmbrojtjen politike dhe ushtarake u bë shumë popullore. Ajo i kishte rrënjët në zemërimin e thellë të masave popullore, jo vetëm kundër synimeve për copëtimin e tokës shqiptare, por edhe kundër sulltanit që nuk ishte në gjendje ta ndalonte atë. «Shqipëria është një tokë me zot, deklaroinin në këtë kohë disa përfaqësues të Shkodrës, dhe sulltani nuk mund të nxjerrë në pazar asnjë pëllëmbë toke prej saj pa pyetur për dëshirën e trashëgimtarëve që janë shqiptarët vetë...».

Si vend për një mbledhje të përgjithshme atdhetarët caktuan Prizrenin, ku u ftuan përfaqësues nga shumë krahina të prekura prej vendimeve të Shën-Stefanit. U vendos që mbledhja të bëhej më 10 qershor 1878, në pragun e hapjes së Kongresit të Berlinit.

Me gjithë kohën e shkurtër, në ditën e caktuar, në Prizren u mbledhën të dërguar nga shumë krahina të Shqipërisë Verilindore dhe Lindore. Një pjesë e delegatëve përbëhej nga çifligarë feudalë e klerikë myslimanë, nga krerë malësorësh dhe elementë borgjezë. Por në mbledhje morën pjesë edhe njerëz të thjeshtë, «që nuk ishin as krerë, as njerëz me influencë, që folën në emër të popullit shqiptar, pasi ishin vetë populli, që u zhdukën, që hynë përsëri në gjirin e popullit, prej të cilit kishin dalë», siç thoshte dëshmitari bashkëkohës Pashko Vasa.

Nga krahinat e Jugut, për mungesë kohe, në fillim u paraqitën vetëm dy delegatë, njëri prej të cilëve ishte Abdyl Frashëri, përfaqësues i Komitetit të Stambollit. Më vonë, shumë krahina jugore u solidarizuan me thirrjen dhe qëllimet e mbledhjes.

Në mbledhjet morën pjesë edhe feudalë myslimanë sllavë nga Bosnja, nga Hercegovina dhe nga sanxhaku i Novi Pazarit, të cilët ishin gjithashtu të interesuar për të luftuar kundër shkëputjes së vendit të tyre nga sundimi turk.

Mbledhja i zhvilloi punimet në sallën e një medreseje. Fjalimin e çeljes e mbajti Abdyl Frashëri. Ai i ftoi të pranishmit

të bashkoheshin të gjithë në çastin e rrezikut për mbrojtjen e vendit. Puna e parë që bëri mbledhja, sipas propozimit të Abdylit, ishte adoptimi i një proteste, me anën e së cilës ngrihej zëri kundër copëtimit të atdheut.

Mbledhja e përgjithshme vendosi krijimin e një organizate me karakter politik e ushtarak, me një qendër drejtuese dhe me degë përkatëse në krahinat e ndryshme të vendit. Kjo organizatë duhej t'u dilte zot me çdo mjet të drejtave dhe interesave të vendit që ishin në rrezik.

Kështu filloi nga veprimi ajo «besëlidhje» (itifik), që më vonë u quajt «Lidhja shqiptare» ose «Lidhja e Prizrenit». Si organ më i lartë i saj u caktua këshilli qendror, me qendër në Prizren, me të cilin do të mbanin lidhje degët krahinore. Kryetar i këshillit qendror u zgjodh Iljaz Pashë Dibra, ndërsa si anëtarë të komitetit drejtues Ali Pashë Gucia, Sheh Mustafa Tetova, myderiz Omer Efendiu nga Prizreni, Sulejman Vokshi nga Gjakova etj.

Vendimet që u morën në mbledhjet e para të Lidhjes së porsaformuar u përfshinë në Kararnamenë (libri i vendimeve), që u aprovua më 18 qershor. Ato u caktonin si detyrë degëve krahinore të organizonin dhe të mbanin secila reparte ushtarake lokale dhe të siguronin qetësinë dhe rregullin. Njëkohësisht u shpall një «besë» e përgjithshme dhe ndaloheshin të gjitha «gjaqet». Kundër atyre që do të shkelnin «besën», parashikoheshin dënime të rrepta.

Vendimet e aprovuara në Prizren pasqyronin interesat e përbashkëta të shtresave dhe të klasave të ndryshme të shoqërisë shqiptare, që kishin marrë pjesë në themelimin e Lidhjes për mbrojtjen e tërësisë tokësore. Të gjithë delegatët u shprehën për ruajtjen e sovranitetit të sulltanit mbi Shqipërinë dhe tokat e tjera të kërcënuara, duke parë në të garancinë për ruajtjen e vendit nga copëtimi.

Roli mbizotërues i feudalëve dhe i elementëve të tjerë konservatorë në Lidhje dhe ndikimi i Portës së Lartë që vepronte nëpërmjet atyre, nuk mund të mos linin gjurmë në vendimet e Lidhjes në këtë periudhë. Kjo shprehej në mënyrë të veçantë në ato pika të Kararnamesë që donin t'i jepnin Lidhjes karakterin e një organizate të mbështetur në parime fetare islamike, të destinuar për ruajtjen e sundimit turk në Ballkan. Këtë qëllim kishin ato nene të vendimeve, të cilat

parashikonin që Lidhja të mbronte me forcat e saj Bosnjë-Hercegovinën, të pengonte formimin e shtetit bullgar etj. Për këtë qëllim Lidhja, e cila e quante veten Xhemiati Ihtilati Islami (Komiteti i Myslimanëve të Vërtetë), duhej të përfshinte, sipas Kararnamesë, të gjithë shtetasit myslimanë të Perandorisë, pavarësisht nga kombësia e tyre, qofshin ata shqiptarë, boshnjakë, bullgarë etj.

Interesat e Portës përkonin në këtë pikë me ato të feudalëve të mëdhenj shqiptarë, për të cilët kuptimi i Shqipërisë shtrihej përtej viseve të banuara nga popullsi shqiptare. Për këta feudalë tërësi e Shqipërisë donte të thoshte tërësi e gjithë viseve, ku ata kishin çifligjet e tyre, d.m.th. duke përfshirë edhe Maqedoninë deri në Selanik, Thesalinë, krahinat greke të vilajetit të Janinës etj.

Këto rrethana ia lehtësonin Portës përpjekjet për ta përdorur lëvizjen popullore në Shqipëri në interes të vet.

Kararnameja nuk përfaqësonte mendimin politik më të përparuar të vendit. Elementët politikisht më të zhvilluar, që u ndodhën në Prizren, ishin të paktë dhe nuk mund t'i hiqnin Lidhjes karakterin e një organizate mbi baza fetare islamike në shërbim të Portës. Në kushte më të favorshme, nën drejtimin e grupit të atdhetarëve, në Shkodër lëvizja mori qysh në fillim një rrugë patriotike më konsekuente. Kjo shihej në një memorandum të nënshkruar nga 500 veta që iu drejtua më 13 qershor 1878, në emër të të gjithë shqiptarëve, kryetarit të delegacionit anglez në Berlin, kryeministrit lordit Bikonsfild (Beaconsfield). «Shqipëria, thuhej midis të tjerash në këtë memorandum, nuk mund të përfaqësohet nga qeveria osmane. Shqiptari, qoftë katolik, ortodoks apo mysliman, e urren pushtuesin turk po aq sa urren çdo pushtues tjetër të huaj... Ashtu sikurse nuk jemi dhe as duam të jemi turq, po ashtu do të luftojmë me të gjitha forcat tona kundër cilitdo që do të kërkonte të na bënte sllavë, austriakë ose grekë. Ne s'duam të jemi veçse shqiptarë». Pasi i bënte një kritikë të ashpër politikës ekspansioniste të Rusisë dhe Traktatit të Shën-Stefanit, memorandum i kërkonte t'i jepej Shqipërisë autonomia në mbështetje të parimit të kombësisë dhe të caktohej një komision ndërkombëtar i kontrollit që duhej të garantonte si në Kretë e në Bullgari zbatimin e reformave.

Nga ana e tyre, qarqet borgjeze katolike me influencë

të Shkodrës u dhanë porosinë delegatëve shkodranë, të cilët shkuan në Prizren në mesin e qershorit, që «të kishin kujdes, të mos pranonin asgjë që mund të interpretohej si forcim i frymës islamike... dhe, po të vinin re se Lidhja po i shmangej rrugës kombëtare për të hyrë në rrugën thjesht fetare, të largoheshin prej saj».

Protestën kundër copëtimit tokësor dhe kërkesën e autonomisë sipas parimit të kombësive e përmbante edhe memorandum i paraqitur, më 20 qershor 1878, ministrit të Jashtëm austro-hungarez Andrashi nga anëtarët e Komitetit Shqiptar të Stambollit Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj. Aty shtrohej kërkesa për të formuar një komision «ad hoc»* prej shqiptarësh, i cili, pa cenuar sovranitetin e sulltanit, duhej të hartonte një «rregullore organike» (një lloj ligji themelor) për administrimin autonom e të njësuar të krahinave shqiptare, duke iu përshtatur karakterit, dokeve dhe nevojave të vendit.

Ndërsa rrethet e përparuara patriotike shqiptare përpiqeshin të ngrinin kështu përpara Kongresit Ndërkombëtar në Berlin çështjen e autonomisë së Shqipërisë në mbështetje të parimit të kombësisë, elementë reaksionarë shqiptarë, të shtyrë nga Porta, i drejtoheshin kongresit duke kërkuar që në Shqipëri të mos lejohej asnjë ndryshim në administratën ekzistuese. Në të njëjtën kohë Porta ishte e interesuar të nxiste në Shqipërinë Veriore, në Kosovë e në Bullgari konflikte të armatitura në kufijtë e zonave të pushtuara gjatë operacioneve luftarake nga fuqitë serbe, malazeze ose ruse. Autoritetet turke, për t'u dalë përpara vendimeve të kongresit, vunë armë në dispozicion të popullsisë myslimanetë alarmuar dhe veçanërisht të muhaxhirëve të dëshpëruar.

Edhe Komiteti Drejtues i Lidhjes mori masa përgatitore. Më 2 korrik ai shpalli «udhëzimet ushtarake» (Talimat), me të cilat bënte të ditur se krahinat e Shqipërisë Veriore e Lindore dhe Bosnja ishin bashkuar me qëllim që të mbronin vendin e tyre dhe të ripushtonin tokat e zëna nga Mali i Zi dhe Serbia. Njëkohësisht jepeshin udhëzime për formimin e 5-6 korpuseve

* Ad hoc (latinisht) = për këtë, d.m.th. për këtë qëllim të veçantë. Në principatat rumune termi «divan (mbledhje) ad hoc» në vitet 50-60 kishte kuptimin e një mbledhjeje kushtetuese.

me një forcë prej afro 100 000 burrash, të cilët do të mbronin kufijtë, duke filluar nga Mali i Zi, nga Bosnja dhe nga Hercegovina e deri në kufirin serb e bullgar. Ushtria, e komanduar prej një qendre, duhej të vepronte pas një plani unik të paracaktuar.

E përgatitur kështu politikisht dhe ushtarakisht, Lidhja po priste vendimet e Kongresit të Berlinit.

Kongresi i Berlinit dhe çështja shqiptare

Kongresi i Berlinit u hap më 13 qershor 1878. Në të morën pjesë 6 Fuqitë e Mëdha: Anglia, Austro-Hungaria, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia. Përfaqësuesit e Turqisë nuk kishin të drejta të barabarta me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, ndërsa përfaqësuesit e shteteve ballkanike u lejuan vetëm të paraqisnin pikëpamjet e qeverive të tyre. Pas një muaj punimesh, kongresi mori një varg vendimesh për rishikimin e Paqes së Shën-Stefanit dhe për rregullimin e gjendjes në Ballkan, duke mos përfillur fare parimin e vetëvendosjes së popujve. Vendimet kryesore kishin qenë përgatitur në bisedime të fshehta që përpara se të hapej kongresi.

Traktati i Berlinit, i nënshkruar më 13 korrik, i njohu Bullgarisë autonominë nën sovranitetin e sultanit, por trualli i saj kufizohej tani nga Danubi dhe nga vargmalet e Ballkanit, kurse viset bullgare në jug të këtij vargmali do të formonin një provincë autonome të Turqisë me emrin Rumelia Lindore. Krahinat e Maqedonisë do t'i mbeteshin Turqisë. Serbia, me këmbënguljen e Austro-Hungarisë, u zgjerua në juglindje, duke marrë Pirotin, Trenin, Vranjën dhe Nishin, në vend të tokave që i kishte dhënë Paqja e Shën-Stefanit në drejtim të sanxhakut të Novi Pazarit, të Mitrovicës dhe të Prishtinës. Mali i Zi ngushtohet në krahasim me Traktatin e Shën-Stefanit, sepse kufizoheshin fitimet e tij tokësore, në radhë të parë, nga ana e Hercegovinës dhe e Novi Pazarit. Kështu krijohet një korridor mjaft i gjerë midis Malit të Zi dhe Serbisë, afrimi i të cilave e kishte shqetësuar shumë Austro-Hungarinë. Traktati i Berlinit i linte Malit të Zi disa toka pjellore nga ana jugore, siç ishin Tivari, Podgorica, Plava dhe Gucia. Atij i njihej e drejta e lundrimit të lirë mbi lumin Bunë dhe në liqenin e

Shkodrës. Si Serbisë ashtu edhe Malit të Zi iu njoh pavarësia e plotë.

Me përkrahjen e diplomacisë angleze dhe franceze, në Berlin doli me kërkesat e veta edhe Greqia, ndonëse nuk kishte marrë pjesë në luftë dhe prandaj nuk ishte përmendur në Traktatin e Paqes së Shën-Stefanit. Por kongresi e la këtë çështje të pazgjidhur dhe vendosi që kufiri greko-turk të caktohej nga një komision prej të dy palëve, duke rekomanduar si bazë vijën e formuar nga lumi Selevria në Thesali dhe lumi Kalamas në vilajetin e Janinës. Sipas këtij propozimi, Greqisë do t'i kalonin nga vilajeti i Janinës jo vetëm qytetet e rrethet e Janinës, të Prevezës dhe të Artës, por edhe krahina shqiptare e Çamërisë. Në rast mosmarrëveshjeje, Fuqitë e Mëdha mund të ndërhyjnë si ndërmjetëse midis të dyja palëve.

Me ndihmën e Anglisë dhe të Gjermanisë, Austro-Hungarisë iu dha e drejta të pushtonte Bosnjën dhe Hercegovinën, për të siguruar «qetësinë» e këtyre krahinave, të cilat, megjithatë, mbeteshin zotërimi të sulltanit. Përveç asaj, ajo mori limanin Spic, që u bashkua me Dalmacinë. Për më tepër, «për të siguruar gjendjen e re politike (në Bosnjë — red.) dhe lirinë e sigurinë e vijave të komunikacionit», siç thuhej në traktat, Austro-Hungaria fitoi të drejtën të mbante garnizone dhe të ndërtonte rrugë tregtare e ushtarake në sanxhakun e Novi Pazarit «deri përtej Mitrovicës». Në këtë mënyrë Austro-Hungaria i shtrinte pozitat e saj deri te portat e Shqipërisë dhe fitonte një bazë për depërtimin e mëtejshëm drejt jugut dhe Selanikut.

Një pozitë të tillë e siguroi Austro-Hungaria edhe në Adriatikun Jugor, ku i kaluan funksionet e policisë detare. Në bregdetin e Malit të Zi nuk mund të ndërtoheshin fortifikata, rrugë dhe hekurudha, as nuk mund të ndaleshin anije luftarake pa lejen e Austro-Hungarisë. Përfitime të rëndësishme tokësore pati edhe Anglia, duke marrë ishullin e Qipros në bazë të një traktati të veçantë që ia imponoi Turqisë qysh në prag të kongresit.

Në nenin 23 të Traktatit të Berlinit parashikoheshin më në fund disa masa për popullsinë joturke të Perandorisë, për të cilat nuk ishin marrë vendime të veçanta në traktat.

Për këto krahina, thoshte neni 23, Porta detyrohej të krijonte komisione të veçanta, në të cilat «duhej të përfaqësohej

në mënyrë shumë të gjerë elementi vendas», për të hartuar «reglemente (rregullore) speciale», që do t'u siguronin këtyre krahinave një administratë autonome, analoge me atë të Kretës. Hollësitë e këtyre rregulloreve do të hartoheshin në çdo provincë veçan, sipas nevojave të secilës, dhe, më në fund, para se të hynin në fuqi, do t'i paraqiteshin nga Porta për aprovim një komisioni të fuqive evropiane.

Traktati i Berlinit, duke marrë nëpër këmbë parimin e vetëvendosjes së kombësive, e ruajti sundimin e kalbur osman në një pjesë të Gadishullit Ballkanik dhe u dha, nga ana tjetër, fitimin kryesor Fuqive të Mëdha si Austro-Hungarisë dhe Anglisë. Me të drejtë Lenini, duke karakterizuar veprimin e Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit, shkruante më vonë se ato «po e grabitnin Turqinë».¹

Karakterit i padrejtë i vendimeve të kongresit shfaqej në mënyrë të qartë, veçanërisht në Lidhje, me çështjen shqiptare. Asnjëra nga fuqitë nuk i paraqiti në kongres protestat shqiptare kundër copëtimit dhe as nuk i përkrahu kërkesat për njohjen e autonomisë. Fuqitë evropiane, përkundrazi, e mohuan krejtësisht ekzistencën e çështjes shqiptare, duke e konsideruar Shqipërinë thjesht si një «shprehje gjeografike» dhe kështu e bënë një objekt pazarllëqesh.

Politika ruse, duke parë ndikimin mbizotërues që kishte siguruar Austro-Hungaria në Ballkanin Perëndimor dhe në Shqipëri, e konsideronte Shqipërinë vetëm si një tokë rezervë për të kënaqur kërkesat e shteteve ballkanike dhe për të siguruar kështu ndikimin e vet mbi to.

Austro-Hungaria, ndonëse në verën e vitit 1877 kishte filluar të përgatitej për të pushtuar vetë Shqipërinë, për të krijuar me këtë një kundërpeshë kundër zgjerimit të ndikimit të Ruisë, ishte, bashkë me Anglinë, mbrojtëse e vendosur e parimit të ruajtjes së Perandorisë Osmane. Ky parim i shërbente asaj jo vetëm për të ndaluar zgjerimin e shteteve sllave në Ballkan, por, duke përfituar nga dobësia e Perandorisë, edhe për të depërtuar vetë në mënyrë «paqësore», politikisht edhe ekonomikisht, drejt viseve të brendshme të gadishullit. Shqipëria i shërbente asaj në të dyja këto drejtime. Prandaj

1 V. I. Lenin, *Fletore mbi imperializmin*, botim rusisht, Moskë, 1939, f. 6.

Vjena interesohej ta ruante sundimin e Perandorisë Osmane në këtë vend, derisa të mund ta zëvendësonte atë vetë, dhe nuk ndërmori asgjë në kongres për të ndryshuar gjendjen e Shqipërisë. Nga ana tjetër, ajo donte t'i shmangej një konflikti me shqiptarët, konflikt që do ta largonte vëmendjen e tyre nga fqinjët sllavë, kundër të cilëve Austro-Hungaria përpigjej t'i nxiste. Prandaj Vjena nuk e përfshiu sanxhakun e Novi Pazarit në zonën e pushtimit të Bosnjës dhe të Hercegovinës. «Mund të jetë vetëm në interesin tonë, deklaronte Andra-shi, që rezistenca (e shqiptarëve — red.) të kthehet kundër serbëve dhe malazezve». Por Vjena u përpoq ta luftonte atë lëvizje që kishte filluar në Shqipëri, për arsye se druante re-perkursionet e saj në Bosnjë-Hercegovinë, të cilën do ta pushtonte.

Italia, e cila sapo kishte arritur bashkimin e saj kombëtar, nuk kishte akoma peshë në fushën e marrëdhënieve ndër-kombëtare. Burrat e shtetit italian ishin thellësisht të pakënaqur nga zgjerimi i ndikimit austro-hungarez në Adriatik dhe në Ballkan, meqë Italia nuk mundi të siguronte për vete as një kompesim. Qarqet qeveritare italiane nuk mundën të përfitonin as nga oferta që u kishin bërë, më 1877, Bismarku dhe ministri i Jashtëm britanik Derbi për të pushtuar Shqipërinë. Qeveria italiane iu shmang një veprimi të tillë, që do ta fuste atë në një konflikt jo vetëm me Austro-Hungarinë, por edhe me shqiptarët vetë.

Në pamundësi të bënte një politikë të vetën të drejtuar kundër Austro-Hungarisë, Italia bëri në kongres një përshtypje të vajtueshme, duke qëndruar në bisht të politikës austro-hungareze dhe gjermane. Po për t'i shkaktuar vështirësi rivales së saj në Shqipëri, fshehurazi ajo inkurajonte me propagandën e vet lëvizjen shqiptare për autonomi.

Me qëllim që të largonte vëmendjen e Italisë nga Shqipëria, politika austro-hungareze u përpoq ta orientonte atë drejt pushtimit të bregut verior të Afrikës, Tripolit ose Tunizit; por këtu Italia ndeshej me interesat e Francës, e cila po përgatitej vetë për pushtimin e Tunizit. Për këtë arsye ministri i Jashtëm francez e drejtonte vëmendjen e Italisë drejt Shqipërisë dhe limanit të Vlorës, i cili, siç thoshte ai, «... do të ishte për zotëruesit e Brindisit dhe Otrantos një fitim shumë i çmueshëm».

E vetmja çështje lidhur me Shqipërinë që u ngrit në Kon-

gres, qe ajo e «privilegjeve të Mirditës». Edhe kjo në të vërtetë u shërbente interesave të Austrisë, e cila e ngriti këtë çështje duke u fshehur prapa Francës. Këto dy shtete kërkuan që kongresi të merrte vendim për t'i garantuar Mirditës privilegjet dhe liritë që kishte pasur deri atëherë.

Delegatët osmanë e kundërshtuan këtë propozim, por megjithatë deklaruan se tani për tani Turqia nuk kishte ndërmend të bënte ndryshime në gjendjen e malësive. Propozimi austro-hungarez, nën maskën e mbrojtjes së popullsisë katolike, donte t'i siguronte Austro-Hungarisë një bazë ndikimi në malësitë dhe në malësorët e Veriut, të cilët do t'i përdorte me anë të agjentëve të saj klerikë si mjet presioni kundër shteteve sllave të Ballkanit.

Kështu Lëvizja Kombëtare Shqiptare, ndryshe nga ato të popujve të tjerë ballkanikë, u ndodh vetëm dhe pa përkrahje të jashtme në një nga çastet më kritike. Kjo ishte një rrethanë negative për zhvillimin e saj.

Zgjerimi i lëvizjes popullore në Shqipëri. Ngjarjet e Gjakovës (korrik-shtator 1878)

Vendimet e Kongresit të Berlinit e shtuan pezmatimin dhe zemërimin e shqiptarëve kundër Fuqive të Mëdha dhe Portës. Kjo ndodhte veçanërisht në krahinat e prekura drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga vendimet e kongresit si në Shkodër, në Plavë e në Guci, në Kosovë, por edhe në Shqipërinë e Jugut, ku ishte ngritur çështja e kufirit me Greqinë.

Kjo rrethanë e favorizoi veprimin e atdhetarëve për ta kthyer lëvizjen spontane në një lëvizje të organizuar.

Komitetet e vetëmbrojtjes, të cilat ekzistonin që më përpara, u solidarizuan kudo me Lidhjen, duke e shpallur veten degë të saj.

Delegatët që u kthyen nga Prizreni nga mesi i korrikut, u shpërndanë nëpër krahinat e tyre, për të krijuar kudo degë të reja të Lidhjes dhe për të organizuar rezistencën duke krijuar reparte ushtarake lokale. Në këtë drejtim zhvilloi një veprimtari shumë të madhe Abdyl Frashëri. Me iniciativën e tij, në një varg qytetesh të Shqipërisë (Berat, Vlorë, Gjirokastër) u zhvilluan mbledhje të gjera. Një mbledhje veçanërisht e rë-

ndësishme u organizua në teqenë e Frashërit, ku morën pjesë përfaqësuesit e krahinave të të gjithë Shqipërisë Jugore. Në frymën e vendimeve të Prizrenit, mbledhja vendosi të krijoheshin edhe këtu degë të Lidhjes dhe të organizoheshin forca ushtarake për të mbrojtur krahinat e Jugut dhe për t'i shkuar në ndihmë, në rast nevoje, Veriut. Në mbledhjen e teqesë së Frashërit, ku merrnin pjesë myslimanë e të krishterë, mbizotëronin çifligarë të shkolluar dhe elementë borgjezë. Në këto kushte grupi i atdhetarëve mund të vepronte më haptazi nga ç'kishte bërë në Prizren. Abdyl Frashëri i paraqiti mbledhjes një program që shprehte vendosmërinë për të mos i lëshuar Greqisë asnjë pëllëmbë tokë si dhe kërkesën për autonominë e Shqipërisë në kuadrin e Perandorisë: bashkimin e të gjitha krahinave shqiptare në një vilajet të vetëm shqiptar me milicinë e vet, me administratë e me shkolla në gjuhën shqipe, me një kuvend përfaqësues etj.

Për të mbrojtur kërkesat shqiptare para opinionit publik botëror, mbledhja vendosi botimin e një gazete, e cila, që të mund t'u shpëtonte vështirësive nga ana e qeverisë turke, do të dilte në Itali, në kolonitë arbëreshe.

Atdhetarët, duke dashur, siç duket, ta paraqisnin programin e aprovuar nga mbledhja e Frashërit si program të të gjithë shqiptarëve, nuk e shpallën, por e lanë për ta shtruar në një mbledhje plenare të Lidhjes në Prizren, së cilës donin t'i jepnin karakterin e një organizate qendrore, përfaqësuese për gjithë Shqipërinë. Në të vërtetë, si qendër për degët e Jugut funksiononte Komiteti i Janinës dhe me Veriun mbahehin vetëm lidhje të dobëta me anë të degës së Elbasanit, që shërbente si ndërmjetëse.

Fushë vendimtare për lëvizjen, në vitin 1878, ishte Veriu. Këtu, në krahinat e Shkodrës dhe të Kosovës, lëvizja mori karakter masiv për arsye të rrezikut që po i kërcënonte këto vise drejtpërsëdrejti.

Më 22 korrik 1878 trupat austro-hungareze kishin filluar marshimin drejt Bosnjës dhe Hercegovinës, por u pritën me luftë nga ana e popullsisë myslimane vendase. Njëkohësisht Mali i Zi ngriti zërin për dorëzimin e krahinave që i ishin premtuar nga kongresi. Në lidhje me zbatimin e vendimeve të Berlinit, në gusht u formuan dy komisione ndërkombëtare për caktimin e kufirit të ri serbo-turk dhe turko-malazias.

Të gjitha këto ngjarje patën si rrjedhim rritjen e hovshme të lëvizjes në Shkodër, ku në korrik u bë një manifestim i madh popullor për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë, të cilat do t'i përfshinte kufiri i ri i Malit të Zi. Dega e Lidhjes në Shkodër filloi të rekrutonte vullnetarë, të mblidhte ndihmë dhe armë. Qytetarët u ngarkuan të dorëzonin të holla dhe drithë si kontribut për luftën. Banorët e Plavës e të Gucisë, që në shumicën më të madhe përbëheshin nga shqiptarë, vendosën ta mbronin vendin e tyre deri në fund. Mbledhje dhe përgatitje të tilla u bënë edhe në Kosovë, veçanërisht në Gjakovë, që kishte marrëdhënie të ngushta me këto dy krahina.

Porta, nga ana e saj, u përpoq ta shfrytëzonte këtë lëvizje për t'u treguar Fuqive të Mëdha nënshkruese të Traktatit të Berlinit se vendimet e marra atje, veçanërisht në lidhje me Bosnjë-Hercegovinën, ishin të pazbatueshme, se ato sillnin me vete rrezikun e një kryengritjeje të përgjithshme të popullsisë myslimane të Ballkanit dhe, me këtë, rrezikun e një lufte të re.

Por në rrethet e Portës dhe të oborrit të sulltanit, krahas një rryme që kërkonte të mos shkohej më tej këtij agjitacioni, kishte një parti që ishte për shpërthimin e një lufte kundër Austro-Hungarisë, për të ndaluar dorëzimin e Bosnjë-Hercegovinës, që ata e konsideronin vetëm si fillimin e humbjeve të tjera tokësore për Perandorinë.

Partia e luftës, në krye të së cilës qëndronin ushtarakë të lartë dhe nga e cila anonte edhe vetë sulltani, e shtynte Portën të bënte një lodër të dyfishtë. Ndërsa Porta shpallte zyrtarisht se do të zbatonte traktatin, partia e luftës nxiste fshehurazi shqiptarët të hynin në konflikt me Austro-Hungarinë në Bosnjë. Të nxitur nga kjo parti, autoritetet turke në vilajetet e Kosovës dhe të Shkodrës jo vetëm që shpërndanin sasi të mëdha armësh midis shqiptarëve, por lejuan edhe degët e Lidhjes që të vinin dorë mbi disa të ardhura shtetërore si e dhjeta dhe taksa «bedelije». Për t'u vënë në lidhje me këto qarqe të Stambollit, një anëtar i qendrës së Prizrenit, sheh Mustafa Tetova, u nis për në kryeqytet. Ndërkohë, forcat vullnetare shqiptare u dërguan në sanxhak të Novi Pazarit, për të zënë pozita kundër trupave austro-hungareze.

Çështjes së luftës me Austro-Hungarinë iu kushtua mbledhja e Lidhjes, që filloi më 19 gusht, me pjesëmarrjen e për-

faqësuesve të parisë së krahinave të Kosovës, të Tetovës, të Dibrës dhe të disa qyteteve të tjera të Maqedonisë. Në mbledhje merрте pjesë edhe vetë vali i Kosovës. Por në kundërshtim me elementët turkomanë që kërkonin, sipas udhëzimeve të Portës, të shkonin menjëherë në Bosnjë kundër Austro-Hungarisë, shumica e pa të arsyeshme të mos hynte në një aventurë që do të përpinte forcat shqiptare, duke e lënë Shqipërinë vetë të zhveshur kundrejt rreziqeve më imediate.

Nën presionin e këtyre forcave, Lidhja vendosi të mos ndërhynte në ngjarjet që po zhvilloheshin në Bosnjë. Kjo qe një fitore e korrur kundrejt synimeve të Portës së Lartë për ta bërë lëvizjen në Shqipëri thjesht një vegël të saj.

Traktati i Berlinit e detyronte Portën të merрте masa për të siguruar veprimtarinë e dy komisioneve të kufijve, që u ngri-tën menjëherë nga Fuqitë e Mëdha. Por qëndrimi i Lidhjes Shqiptare e bënte të vështirë, në mos të pamundur, funksioni-min e komisioneve. Për të mënjanuar ndërlikime të reja në arenën ndërkombëtare dhe për të dhënë prova të gatishmërisë së vet, Stambolli dërgoi në Shqipërinë e Veriut mareshalin Mehmet Ali Pasha, të shoqëruar nga një adjutant personal i sulltanit, me detyrën që t'i bindte shqiptarët të pranonin ve-primtarinë e komisioneve. Mareshali turk, me prejardhje gjermane, kishte qenë i dërguar i Turqisë në Kongresin e Berlinit dhe ishte për një politikë mosacarimi të marrëdhënieve me fuqitë evropiane. Me të arritur në Prizren, Mehmet Ali Pasha thirri, më 25 gusht, Komitetin drejtues të Lidhjes dhe i bëri presion që të pranonte vendimet e kongresit.

Për të realizuar misionin e tij, Mehmet Ali Pasha mendonte të shfrytëzonte lidhjet miqësore që kishte me disa pashallarë shqiptarë. Disa krerë të Lidhjes si Iljaz Pashë Dibra, Hasan Pashë Tetova, Ali Pashë Gucia, Abdulla Pashë Dreni nga Gjakova etj. kishin shërbyer nën komandën e tij si udhëheqës re-partesh të çrregullta në luftën e fundit me Serbinë e Malin e Zi dhe ishin graduar pashallarë me rekomandimin e tij. Por ardhja e mareshalit turk kishte shkaktuar një shqetësim të madh në masat popullore, që e shprehnin haptazi urrejtjen e tyre kundër të deleguarve të sulltanit. Në këto kushte pashallarët shqiptarë nuk guxuan t'i bindeshin kërkesës së mareshalit dhe në mble-dhjen e caktuar për ditën 27 gusht nuk vajti njeri. Pas pak arriti lajmi se disa të panjohur kishin vrarë në treg telegrafistin

që përcillte mareshalin. Të trembur nga kjo ngjarje, pashallarët dhe disa krerë të tjerë të Lidhjes u paraqitën te Mehmet Ali Pasha për t'i deklaruar se pranonin në emër të Lidhjes vendimet e kongresit. Veprimi i tyre shkaktoi zemërimin e masave popullore, të cilat rrethuan selinë e Lidhjes dhe kërkuan që të përjashtoheshin nga kryesia ata që tregoheshin të gatshëm për kapitullim përpara Portës.

Mehmet Ali Pasha u ndodh në një gjendje kritike. Duke e ndier veten në rrezik, ai kërkoi nga Mitrovica përforcime ushtarake për të vazhduar rrugën për në Gjakovë. Më 31 gusht u largua nga Prizreni, pasi nisi përpara një batalion ushtarësh. Edhe në Gjakovë ai u përpoq t'i bindte krerët e Lidhjes të hiqnin dorë nga kundërshtimi i tyre dhe të pranonin vendimet e Traktatit të Berlinit, por gjeti një qëndresë edhe më të rreptë. Shumica e anëtarëve të degës së Lidhjes si Ahmet Koronica, Sulejman Vokshi etj., ishin për një qëndrim të papërkulur ndaj kërkesave të Portës. Për më tepër, në qytet kishin zbritur nga malet qindra malësorë të armatosur, të alarmuar prej lajmeve të arritura nga Prizreni.

Më 2 shtator 1878, një delegacion i Lidhjes u paraqit te mareshali, në konakun e Abdulla Pashë Drenit, dhe e ftoi atë të largohej nga qyteti. Kur Mehmet Ali Pasha nuk u bind, dega e Lidhjes lëshoi kushtimin në qytet dhe në Malësi. Po atë ditë forcat e Lidhjes rrethuan konakun e fortifikuar të Abdulla Pashës, që mbrohej nga 6 kompani, prenë lidhjet telegrafike dhe i dhanë pashait 24 orë kohë që të përcillte mareshalin për në Prizren. Nga ky afat përfitoi vetëm adjutanti i sulltanit, i cili u largua fshehurazi nga Gjakova.

Të rrethuarve u erdhën në ndihmë vetëm disa malësorë katolikë, që kishin lidhje miqësie me Abdulla Pashën. Më 3 shtator konaku ishte rrethuar nga më se 3500 veta që filluan sulmin. Ditën e tretë, më 5 shtator, gjendja e të rrethuarve u keqësua shumë. Dy batalione që ishin nisur nga Mitrovica në ndihmë të mareshalit e që përbëheshin prej ushtarësh shqiptarë, dezertuan dhe u bashkuan me kryengritësit. Më 6 shtator filloi sulmi i fundit. Një pjesë e ushtarëve që kishin mbetur nga 6 kompanitë turke, u dorëzuan. Kryengritësit i vunë zjarr konakut. Mareshali Mehmet Ali Pasha dhe Abdulla Pashë Dreni mbetën të vrarë. Me këtë mori fund edhe qëndresa.

Luftimet e ashpra u kushtuan të dy palëve afro një mijë të vrrarë e të plagosur.

Ngjarjet e Gjakovës ishin pasojë e zemërimit e të protestës së masave të gjera të popullit jo vetëm kundër rrezikut të copëtimit, por edhe kundër Portës dhe lojës së saj të dyfishtë.

Kërkesat e Lidhjes së Prizrenit për autonominë (nëntor 1878)

Ngjarjet e Gjakovës patën një jehonë të madhe si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ato tërhoqën vëmendjen mbi problemin e marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe qeverisë turke dhe i dhanë shkas diferencimit në radhët e pjesëmarrësve të lëvizjes. Elementët e moderuar dhe turkomanë filluan të lëkundeshin dhe ta shikonin me shqetësim lëvizjen që po u shkiste nga dora.

Edhe Porta kishte filluar të shqetësohej nga karakteri anti-turk i manifestimeve që po zhvilloheshin në qytete të ndryshme të Shqipërisë së Veriut dhe të Verilindjes. Nën ndikimin e këtyre ngjarjeve dhe me urdhër të degëve të Lidhjes, edhe në garnizonet e krahinave që ndodheshin larg Shqipërisë si në Thesali, në Maqedoni etj., u shtuan dezertimet e ushtarëve shqiptarë. Në Shqipëri po ngriheshin gjithnjë më me forcë kërkesat e vjetra të drejtuara kundër administratës turke. Masat popullore kërkonin të mos paguanin taksa dhe të mos jepnin ushtarë në shërbim të Turqisë, të paktën tani, kur gjithë forcat duheshin përqendruar në mbrojtjen e vendit. Ata kërkonin gjithashtu që detyrën e ruajtjes së rendit publik e të qetësisë ta merrte vetë Lidhja dhe ta realizonte me anën e një «bese popullore», në të cilën do të përfshihej edhe popullsia e krishterë. Në mënyrë të veçantë e preokuponte popullin çështja e gjykatave të reja, me të cilat ai nuk mund të pajtohej. Prandaj një nga kërkesat që përsëritej me këmbëngulje, ishte krijimi i gjykatave me nëpunës vendas që të gëzonin besimin e popullit, të cilat duhej të mbështeteshin në praktikën e tyre në normat e së drejtës zakonore shqiptare e jo në kodet e ndërlikuara turke.

Ngjarjet e Gjakovës sollën me vete një shturje të plotë

të administratës turke në atë krahinë. Organet qeveritare pushuan së funksionuari dhe u zëvendësuan me njerëz të cilët populli kishte besim. Përfaqësuesit konsullorë austro-hungarezë dhe rusë nga Prizreni dhe nga Shkodra raportonin në qendrat e tyre se në Gjakovë pushteti ishte në dorën e shtresave më të «ulëta» të popullit, gjë që i shtynte ata që ta krahasonin gjendjen e krijuar aty me Komunën e Parisit.

Për atdhetarët shqiptarë u krijuan tani kushte të favorshme që të shtronin në mënyrë zyrtare, si një kërkesë të të gjithë popullit shqiptar, kërkesën për autonominë e Shqipërisë.

Duke u mbështetur në vendimet e marra në Janinë, më 1877*, dhe në teqenë e Frashërit, Komiteti i Stambollit formuloi projektin e autonomisë, i cili u botua, më 27 shtator 1878, në gazetën «Terxhuman-i Shark» (Interpreti i Lindjes), që botohej në Stamboll nga Sami Frashëri. Njëkohësisht qendra e Lidhjes ftoi gjithë krahinat e vendit për të dërguar delegatët e tyre në Prizren për mbledhjen e këshillit të përgjithshëm. Më 27 nëntor 1878, në mbledhjen plenare u shtrua dhe, pas diskutimesh të gjata, u aprovua në lidhje me çështjen e autonomisë një memorandum, që iu drejtua Portës.

Memorandumi fillonte me një rreshtim të krahinave, të cilat, sipas mendimit të hartuesve, përbënin Shqipërinë. Këto krahina fillonin që prej Novi Pazarit e shkonin deri në Janinë e në Prevezë. Memorandumi argumentonte kërkesën e autonomisë me nevojën për t'i dhënë këtij vendi e këtij populli me aftësi të mëdha mundësinë e zhvillimit të lirë.

Dhuratat e veçanta, që u kishte falur natyra banorëve të saj, thuhej në memorandum, ishin garanci të mjaftueshme për qytetërimin e Shqipërisë. Por gjendja e vërtetë e vendit ishte në kundërshtim të madh me këto mundësi. Për faj të qeverive të mëparshme, në Shqipëri varfëria dhe padija ishin shumë më të mëdha se në çdo vend tjetër të Perandorisë. Ndonëse i kishin bërë shërbime të mëdha, Perandoria i kishte braktisur shqiptarët në një gjendje të mjerueshme.

Këtij mjerimi të brendshëm i ishte shtuar qysh prej 40 vjetësh, deklaronte memorandum, edhe rreziku i jashtëm. Kongresi i Berlinit jo vetëm që i kishte shkëputur Shqipërisë disa krahina, por kishte vënë edhe pjesët e tjera në një rrezik të

*) Shih shënimin në faqe 201 të këtij vëllimi.

madh. Në qoftë se nuk do të merreshin masa energjike, katastrofa do të ishte e pashmangshme. Por zhdukja e Shqipërisë do të ishte në dëm të Perandorisë dhe të myslimanizmit. Prandaj bëhej e domosdoshme që Perandoria të lejonte zbatimin e 5 pikave që parashtroi mbledhja:

- 1) Të gjitha krahinat e Shqipërisë të përmblihdeshin në një vilajet dhe qendra e tij të bëhej një qytet në mes të Shqipërisë.
- 2) Nëpunësit që do të shërbenin në këtë vilajet, duhej të dinin shqip.
- 3) Arsimi duhej të përhapej në të gjitha anët dhe nëpër shkolla të mësohej gjuha shqipe.
- 4) Duhej të krijohesh një këshill i përgjithshëm, i cili do të mblidhej katër herë në vit në qendër të vilajetit dhe do të hartonte ligje të dobishme për vendin.
- 5) Një pjesë e mjaftueshme e të ardhurave të vilajetit duhej të përdorej për punë botore në vend.

Memorandumi i 27 nëntorit 1878 ishte i detyruar t'i bënte një lëshim nacionalizmit shovinist të feudalëve, duke përfshirë në territorin shqiptar edhe vise ku popullsia shqiptare përbënte vetëm një pakicë. Nga ana tjetër, ai duhej të maskohej me fraza që kërkonin t'ia bënin të pranueshëm Portës këtë vendim në emër të interesave të myslimanizmit. Megjithatë, memorandumi, duke ngritur në mënyrë publike, në emër të të gjithë popullit shqiptar, kërkesën për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë, shënonte një ngritje të re në lëvizjen politike që kishte përfshirë vendin.

Për t'ia paraqitur sulltanit kërkesën për autonomi, në një mbledhje që u bë në Dibër, u caktuan 9 delegatë: 3 nga krahinat e Veriut dhe 6 nga ato të Jugut. Midis tyre ishin sheh Mustafa Tetova, Abdyl Frashëri, Mustafa Pashë Vlora, Iljaz Pashë Dibra, Mihal Kristo Harito nga rrethi i Gjirokastrës etj. Për t'i dhënë kërkesës më tepër peshë, Abdyl Frashëri, gjatë dhjetorit të 1878-ës e janarit të 1879-ës, përshkoi viset e Shqipërisë që nga Dibra e deri në Vlorë e më tej, për ta pajisur delegacionin me mandatin e gjithë popullit shqiptar. Ai u prit, siç shkruante vetë, kudo me entuziazëm. Populli i nënshkroi me gëzim mandatet e të dërguarve. Mirëpo elementët feudalë të caktuar për të marrë pjesë në delegacion, ngurronin të shkonin në Stamboll me një mision të tillë që mund të shkaktonte zemërimin e Portës. Megjithatë vendimi i Lidhjes u zbatua. Nën udhëheqjen e Abdyl Frashërit delegacioni u nis për në Stamboll në fund të janarit të 1879-ës.

Duke shpresuar gjithnjë që ta vinte lëvizjen shqiptare në shërbim të saj kundër Austro-Hungarisë dhe shteteve ballkanike, Porta nuk mori masa në lidhje me ngjarjet e Gjakovës dhe delegacionit shqiptar që shkoi në Stamboll i premtoi se kërkesat e paraqitura qeveria turke do t'i shqyrtonte me mirëdashje.

3. LUFTA E LIDHJES SË PRIZRENIT KUNDËR COPËTIMIT TË TOKAVE TË SHQIPËRISË. RITJJA E LËVIZJES PËR AUTONOMI (JANAR 1879 — QERSHOR 1880)

Kërkesat e shteteve ballkanike kundrejt tokave shqiptare. Çështja e «Serbisë së vjetër» dhe e «Epirit»

Çështja e kufijve të rinj të Perandorisë Osmane, e ngritur nga Traktati i Shën-Stefanit, nuk u mbyll ende me nënshkrimin e Traktatit të Berlinit. Për ta mbajtur gjallë alarmin rreth saj shërbeu jo vetëm presioni i vazhduar diplomatik i shteteve ballkanike, që kërkonin zbatimin e menjëhershëm të traktatit, por edhe propaganda e tyre që lëshimet tokësore të vendosura në Berlin i quante vetëm si pikënisje ndryshimesh më të mëdha, duke e quajtur fare të afërt prishjen e plotë të Perandorisë. Për këtë rast qarqet zyrtare dhe publike të shteteve ballkanike ngrinin kërkesa të reja tokësore.

Pretendimet kryesore që ngrinin qarqet politike të shteteve ballkanike kundrejt Perandorisë Osmane preknin edhe truallin shqiptar. Synimet e tyre shkonin kryesisht në drejtim të trevës së Shkodrës, të Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit si dhe të Shqipërisë së Jugut.

Pa mbaruar akoma mirë lufta me Turqinë, princ Nikolla i Malit të Zi deklaroi se ai nuk do ta pushonte luftën, derisa të mos kishte siguruar lumin Drin si kufi jugor të principatës së tij, e cila në të ardhmen duhej të shtrihej nga Adriatiku në Gjakovë. Mali i Zi nuk e reshti propagandën e vet në këtë drejtim edhe pasi Traktati i Berlinit realizoi në mënyrë të kufizuar disa nga kërkesat e tij.

Qarqet politike serbe, nga ana e tyre, kërkonin që të përfshiheshin në kufijtë e Serbisë tokat serbe që kishin mbetur nën sundimin e sulltanit. Por bashkë me kërkesa të drejta, këto qarqe ngrinin edhe pretendime për vise ku nuk kishte fare popullsi serbe, ose që në një pjesë të mirë banoheshin prej shqiptarësh.

Kështu në kërkesat që i paraqiti qeveria serbe komandës ruse në Edrene në janar të vitit 1878, bënte pjesë edhe Kosova e Rrafshi i Dukagjinit deri në Drinin e bashkuar, Dibra dhe e gjithë Maqedonia deri te lumi Struma. Botime gjysmëzyrtare të kësaj kohe i shtrinin kërkesat e Serbisë në Shqipëri deri në Dukagjin e në Pult, duke përfshirë kështu pothuajse gjithë Shqipërinë e Veriut.

Për këto kërkesa qarqet politike serbe, në mungesë argumentesh etnografike, mbështeteshin në argumente gjoja «historike», duke qenë se prej shekullit XIII deri në shekullin XV këto krahina kishin bërë pjesë në shtetin mesjetar serb; prandaj propaganda serbe i quante ato me emrin «Serbi e vjetër».

Për ta kthyer në favor të Serbisë gjendjen etnike, të paktën në krahinat e pushtuara gjatë veprimeve të luftës, qeveria e Belgradit përdori mjetet më mizore. Princi Milan i Serbisë urdhëroi komandën e trupave serbe që të merrte masa sa më energjike. «Sa më tepër shqiptarë të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut», thuhej në një urdhër të tillë. Dhe me të vërtetë dhjetëra mijë banorë shqiptarë u dëbuan me dhunë nga vendet e tyre, duke shpopulluar krahina të tëra.

Por as vendimet e Shën-Stefanit, as ato të Berlinit nuk i kënaqën kërkesat e Serbisë, veçse në mënyrë të kufizuar. Pretendimet tokësore të borgjezisë serbe, që përfshinin midis të tjerash edhe toka të gjera shqiptare, mbetën kështu edhe në të ardhmen një motiv shtytës i rëndësishëm i politikës serbe kundrejt Shqipërisë.

Kriza Lindore u kishte dhënë shtytje edhe qarqeve politike greke të kërkonin realizimin e «idesë së madhe». Qysh në mars të 1878-ës, qarqet qeveritare të Athinës kishin ngritur pretendime tokësore, që shkonin nga «deti Adriatik në detin Marmara», duke u mbështetur gjoja në argumente historike dhe fetare. Kongresi i Berlinit me rekomandimin që si vijë e re kufitare midis Greqisë dhe Turqisë të shërbenin lu-

menjtë Selevria e Kalamas, bëri që qarqet shoviniste greke t'i drejtonin në mënyrë të veçantë kërkesat e tyre drejt vilajetit të Janinës, ose, siç e quanin ata me një emër të trashëguar nga historia e lashtë, Epirit, duke përfshirë në kërkesat e tyre jo vetëm pjesën greke të vilajetit, por të gjithë vilajetin e Janinës, i cili në të vërtetë kishte një popullsi me shumicë shqiptare.

Në kërkesat e saj qeveria greke nuk nisej aq nga arsye etnografike, sa nga synime politike. Siç i deklaronte në ato kohë kryeministri grek Komunduros ambasadorit austro-hungarez në Athinë, arsyeja për të cilën ngulte këmbë Greqia aq tepër për «Epirin», ishte se këtu ajo do të mund të pengonte bashkimin e Shqipërisë së Jugut me atë të Veriut. Pa Shqipërinë e Jugut, «helenizmi», thoshte Komundurosi, nuk do të ishte në gjendje të përballonte i vetëm presionin e «sllavizmit».

Menjëherë pas mbarimit të Kongresit të Berlinit, qeveria greke ftoi Portën e Lartë që të fillonte bisedimet rreth çështjes së kufijve. Qeveria turke mendohej ta zvarriste sa më shumë punën, duke shpresuar në ndonjë ndryshim të rrethanave ndërkombëtare si dhe në efektin e qëndresës shqiptare.

Ngritja e çështjes së kufirit nga Greqia vuri në lëvizje të veçantë komitetet shqiptare të Jugut.

Në lëvizjen e gjerë të rezistencës ishin përfshirë edhe feudalët të mëdhenj shqiptarë. Si feudalët e Veriut, edhe këta kërkonin të mbronin si «toka shqiptare» gjithë ato krahina të Perandorisë, qoftë edhe me popullsi joshqiptare, ku ata kishin çifligjet e veta. Me këtë mënyrë kërkesat e tyre përfshinin gjithë krahinat greke të vilajetit të Janinës dhe arrinin deri në Thesali e më tej. Por në gjirin e komiteteve shqiptare kishte edhe elementë më realistë. Kështu, në degën e Shkodrës u ngritën zëra që thoshin se si shqiptare mund të konsideroheshin vetëm tokat që shkonin deri te «portat e Janinës», por jo më tej. Nën ndikimin e qarqeve më të moderuara, qysh në fillim të vitit 1879, Lidhja e Jugut deklaroi se nuk e përfshinte Thesalinë në tokat që kërkonte të mbronte.

Tokat në jug të vijës Kalamas-Selevria, që rekomandonte Kongresi i Berlinit t'i lëshoheshin Greqisë, kishin vetëm një pakicë shqiptare (popullsia shqiptare përbënte këtu rreth një të katërtën e popullsisë së përgjithshme, sipas llogaritjeve të bëra nga disa bashkëkohës). Megjithatë, atdhetarët shqiptarë në përgjithësi, duke përfshirë këtu edhe përfaqësues të rretheve

borgjeze ortodokse si Jani Vreton, i konsideronin edhe krahinat jugore të vilajetit të Janinës në tërësi si pjesë përbërëse të Shqipërisë, për arsye të lidhjeve të ngushta ekonomike dhe historike që kishin ato me krahinat e Shqipërisë së Jugut. Duke marrë parasysh pretendimet e politikës greke, atdhetarët mendonin se të hiqej dorë, qoftë edhe nga një pjesë, donte të thoshte të sakrifikoje gjithë vilajetin, të humbje gjithë Shqipërinë e Jugut dhe me këtë të rrezikoje unitetin e Shqipërisë.

Në fillim të vitit 1879, Porta, më në fund, pranoi të merrte pjesë në një konferencë për të diskutuar me palën greke çështjen e kufijve. Si vend i mbledhjes u caktua Preveza.

Lajmi i mbledhjes së konferencës në fillim të shkurtit dha shkas për grumbullimin në Prevezë të qindra personaliteteve të ardhura nga krahinat e ndryshme të Shqipërisë jo vetëm të Jugut, por edhe të Veriut. Të mbledhurit e deklaruan veten si përfaqësi të popullit shqiptar. Komiteti drejtues i Prizrenit delegoi si përfaqësues të vetin Mustafa Pashë Vlorën. Me anën e një shpalljeje mbledhja bëri të ditur se nuk do të njihte asnjë ndryshim tokësor në kufijtë e vilajetit të Janinës. Në qoftë se qeveria turke do të pranonte një zgjidhje në dëm të interesave shqiptare, shqiptarët nuk do të ngurronin t'i drejtonin armët edhe kundër saj. Para shpërndarjes mbledhja zgjodhi tri komisione. Njëri do të qëndronte në Prevezë për të ndjekur punët e konferencës greko-turke, ~~ndërsa~~ tjetri, në bashkëpunim me degët e Veriut dhe me komandën ushtarake turke, do të organizonte mbrojtjen e vendit. Një komision i tretë do të shkonte në Stamboll, ku do të bashkohej me komisionin e dërguar atje që më parë, për të përkrahur pranë sulltanit kërkesat shqiptare.

Në këto kushte konferenca greko-turke e Prevezës ishte e dënuar të shpërndahej pa dhënë rezultate. Përfaqësuesit turq deklaruan se për ata rekomandimet e kongresit s'kishin fuqi detyruese, ndërsa pala greke i konsideronte këto si vendime të prera.

Ndërkohë qarqet publike greke filluan një fushatë të madhe në shtypin evropian për të siguruar përkrahjen e diplomacisë së shteteve të mëdha në lidhje me kërkesat greke. Propaganda greke përpiqej t'i paraqiste shqiptarët si barbarë, të paaftë për një jetë shtetërore të pavarur dhe të kulturuar. Për këto arsye atdhetarët shqiptarë e panë të nevojshme të dërgonin

një delegacion shqiptar për të paraqitur pikëpamjet shqiptare në takime të drejtpërdrejta me diplomatët e Fuqive të Mëdha, veçanërisht të Francës, e cila kishte luajtur rolin e mbrojtëses kryesore të kërkesave të qeverisë greke. Në muajt prill-qershor 1879 Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali bej Vrioni vizituan disa kryeqytete të Evropës Perëndimore, midis tyre Berlinin, Parisin, Vjenën dhe Romën. Me këtë rast ata u drejtuan, në emër të popullit shqiptar, një përkujtesë kabineteve të pesë Fuqive të Mëdha, në të cilën vinin në dukje kërkesat për një zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare.

Shqipëria, thoshte përkujtesa, nuk duhej konsideruar si një grumbull i thjeshtë krahinash, nga të cilat «mund të shkëputet njëra pa dëmtuar ose pa pyetur të tjerat». Shqiptarët, megjithëse një komb me histori shumë të lashtë, ishin bërë padrejhtësisht objekt synimesh grabitqare nga ana e Greqisë qysh më 1854, më 1866 dhe së fundi më 1878. Duke vazhduar të qëndronin në kuadrin e Perandorisë Osmane, theksonte dokumenti, shqiptarët «nuk heqin dorë nga kërkesa që të konsiderohen si një kombësi e veçantë me të gjitha të drejtat e veta». Si mjet për t'i siguruar përparimin, duheshin shtirë edhe mbi popullin shqiptar reformat dhe e drejta për arsim në gjuhën kombëtare. Promemorja mbaronte me thirrjen drejtuar Fuqive të Mëdha për të mos u mbyllur shqiptarëve me qëndrimin e tyre «rrugën e përparimit».

Në Romë, në disa bisedime të veçanta, delegacioni shqiptar u përpoq të siguronte përkrahjen e qarqeve politike italiane. Në këtë drejtim e ndihmonte atë edhe veprimtaria e intelektualëve arbëreshë me De Radën në krye, të cilët, qysh prej fillimit të Krizës Lindore, nuk kishin rreshtur të propagandonin në favor të çështjes shqiptare. Delegacioni deklaroi se shqiptarët, të ndodhur midis lakmive të Greqisë nga njëra anë, dhe të Serbisë e Malit të Zi, nga ana tjetër, nuk kishin ç'të prisnin as edhe nga Austro-Hungaria, që i kishte zbuluar qëllimet e saj të vërteta në Bosnjë-Hercegovinë. Duke dashur të përfitonin nga kontradiktat italo-austriake, delegatët shqiptarë kërkuan përkrahje nga Italia, duke ditur se ishte edhe në interes të kësaj të siguronte një Shqipëri, e cila, në rastin e prishjes së Turqisë, si shtet autonom ose i pavarur, mund të ishte në gjendje t'u qëndronte synimeve të Austro-Hungarisë.

Qarqet politike italiane, ndonëse të pakënaqura nga rezul-

tatet e Kongresit të Berlinit, propagandën për autonominë e Shqipërisë e përdorën vetëm për t'i sjellë vështirësi Austro-Hungarisë. Ato e konsideronin më me leverdi të përkrahnin në këtë rast politikën greke, duke dashur ta forconin Greqinë si një pengesë kundër zgjerimit të Austro-Hungarisë dhe të shteteve sllave në Ballkan. Disa qarqe politike italiane u zotuan t'u jepnin shqiptarëve përkrahjen e tyre politike dhe t'i ndihmonin me armë, por me kusht që Lidhja Shqiptare të merrte përsipër ta priste me luftë hyrjen e ushtrisë austro-hungareze në sanxhakun e Novi Pazarit, propozim që delegacioni shqiptar nuk e pranoi. Për çështjen shqiptare, nga ana tjetër, filluan të interesoheshin përsëri disa qarqe përparimtare italiane, të cilat përkrahnin idenë e një «federate ballkanike», që t'i shërbente luftës kundër autokracisë në Austro-Hungari, në Rusi dhe në Turqi. Kjo lëvizje përkrahej edhe nga qarqe qeveritare greke, të cilat mendonin të realizonin me të qëllimet e panhelenizmit në Ballkan. Kur politikani italian M.A. Kanini (M.A. Canini) u përpoq ta bindte Abdyl Frashërin për nevojën e pjesëmarrjes së shqiptarëve në këtë federatë, ky kundërshtoi, duke deklaruar se «grekët nuk na duan si pjesëmarrës me të drejta të barabarta, por si të nënshtruar». Edhe vetë Kanini u bind për vërtetësinë e këtyre fjalëve kur qeveria greke u shfaq me vendosmëri kundër pjesëmarrjes së shqiptarëve në një legjion ndërkombëtar garibaldinësh, që mendohej të krijohet në këtë kohë në tokën greke, për të nisur një kryengritje të re në Ballkan.

Megjithatë, udhëtimi i delegacionit shqiptar nuk mbeti pa fryt. Në verën e vitit 1879 qeveria italiane dërgoi në Janinë, me mision të posaçëm, një njohës të mirë të çështjeve ballkanike, konsullin E. de Gubernatis, për të hetuar gjendjen. Raporti i tij, i botuar në shtyp, ishte në favor të çështjes shqiptare në përgjithësi, dhe i dha njëfarë përkrahjeje veprimit të mëtejshëm të atdhetarëve shqiptarë. Në të njëjtën kohë nën ndikimin e qëndrimit të vendosur të Komitetit Shqiptar të Jugut, qeveria angleze, në një notë të drejtuar Austro-Hungarisë, më 18 qershor 1879, hidhte poshtë kërkesën austriake që Fuqitë e Mëdha të bënin presion mbi Turqinë për lëshimin e Janinës. Si arsye për këtë qeveria angleze paraqiste rrezikun e shpërthimit të turbullirave nga ana e shqiptarëve. Sipas qeverisë angleze, shqiptarët do të ishin në gjendje t'i bënin

ballë çdo force ushtarake greke që mund t'u dilte përpara me rastin e lëshimit të Janinës Greqisë. Në këto kushte çështja e kufirit greko-turk mbeti për t'u zgjidhur me anë bisedimesh. Por me gjithë mbledhjet e shumta të një komisioni të ri greko-turk që veproi në Stamboll, prej gushtit të vitit 1879 deri në shkurt të vitit 1880, në këtë çështje nuk u bë asnjë përparim. Me argumentin se i kërcënohej një kryengritje e përgjithshme në Shqipëri, po t'i bënte Greqisë edhe lëshimin më të vogël, Porta diti t'i shmangej një zgjidhjeje në dëm të saj dhe t'i ndalte Fuqitë e Mëdha nga ndërhyrja në çështjen e kufirit greko-turk.

Lufta kundër administratës turke. Përsëritja e kërkesës për autonomi

Porta nuk iu përgjigj kërkesës së shqiptarëve për autonomi, që kishte paraqitur delegacioni i Lidhjes së Prizrenit. Ajo përpiqej, duke e hequr zvarrë, ta linte në heshtje këtë kërkesë.

Por një varg aksionesh spontane në krahinat e ndryshme të Shqipërisë Veriore e Verilindore shërbyen për ta mbajtur të hapur këtë çështje dhe për t'i acaruar edhe më tej marrëdhëniet midis popullsisë dhe autoriteteve lokale turke. Kërkesat e vjetra të masave fshatare e malësore për të mos i paguar taksat e reja dhe për të mos dërguar ushtarë, të paraqitura në kohën kur atdhetarët zhvillonin fushatën e tyre për autonomi, u shkrinë në këtë lëvizje dhe u bënë pjesë e pandarë e saj.

Qysh në vitin 1878, në një numër krahinash administrata turke ishte paralizuar pothuajse krejtësisht. Autoritetet turke, të preokupuara nga gjendja kritike e krijuar gjatë luftës dhe nga pasojat e saj, i kishin lënë disa kohë pa mbledhur të dhjetat dhe rekrutët. Në pranverën e vitit 1879 gjendja u acarua përsëri, për shkak të orvatjeve që bëri Porta për të forcuar autoritetin e saj. Duke përfituar nga njëfarë stabilizimi i gjendjes, autoritetet turke filluan të kërkonin përsëri pagimin e taksave të prapambetura si dhe ato të vitit në vazhdim, dhe të ngulnin këmbë për dhënien e ushtarëve.

Në fillim të vitit 1879 qeveria turke, pas një ndërprerjeje, dërgoi përsëri në Mirditë një kajmekam, duke shkelur kështu

deklaratën e bërë në Kongresin e Berlinit. Këto masa e shtuan zemërimin e malësorëve. Në muajin mars 1879, në Lezhë u bë një mbledhje e përfaqësuesve të Malësive. Të pranishmit, më se 70 veta, u shprehën në mënyrë të ashpër kundër metodave të administratës turke, «angarive e zullumeve» dhe sidomos kundër valiut të Shkodrës, Hysni Pashës. Me përfaqësuesit e malësorëve u bashkua edhe kajmekami i Lezhës, me prejardhje shqiptar. Mbledhja vendosi njëzëri t'i kërkohej sulltanit që në organet qeveritare të mos kishte më veçse shqiptarë, të cilët duhej t'i drejtonin punët sipas nevojave dhe dokeve të vendit.

Mbledhje të tilla u zhvilluan në mars e në prill të atij viti edhe në Prishtinë. Ato përfunduan me kërkesën drejtuar Portës, që të lejohej krijimi i gjykatave shqiptare. Më 7 maj, 27 delegatë të Lidhjes në Prishtinë kërkuan nga vali i Kosovës të drejtën për të administruar vetë gjykatat. Për të mënjeluar shpërthimin e trazirave, Porta e pa të udhës të lejonte që pranë gjykatave shtetërore turke në Kosovë të vepronin edhe gjykata shqiptare. Kjo fitore vuri në lëvizje edhe krahina të tjera. Degët e Lidhjes, në Gjakovë e Pejë dolën me kërkesën që, me krijimin e gjykatave shqiptare, të mbylleshin krejtësisht gjykatat shtetërore turke. Duke marrë shkas nga kjo lëvizje e përgjithshme, në mbledhjen e saj të 19 majit 1879, Lidhja e Prizrenit e përsëriti kërkesën e autonomisë jo vetëm për administratën gjyqësore, por edhe për administratën shtetërore në përgjithësi.

Brenda një kohe të shkurtër, gjykata shqiptare u hapën në shumë qytete të Kosovës dhe në Shkup, në Kumanovë etj. Anëtarët e gjykatave u zgjodhën nga paria e vendit. Për gjykatat shqiptare u shpall një lloj statuti që përmbante në vija të përgjithshme udhëzime për veprimin e tyre. Por Porta e Lartë nuk pranoi të përmbushte kërkesën e shqiptarëve për shtrirjen e këtyre gjykatave në gjithë Shqipërinë dhe për mbylljen e gjykatave shtetërore.

Lëvizja në Shqipëri i kishte kapërcyer me kohë caqet, brenda të cilave donte ta mbante qeveria e sulltanit. E ushqyer nga urrejtja e thellë e masave popullore kundër Portës, lëvizja po merrte gjithnjë e më hapur drejtim kundër saj. Por komiteti drejtues i Lidhjes në Prizren nuk shkonte krahas me këtë lëvizje. Në të bënte pjesë një grup feudalësh, të përkrahur

nga klerikë fanatikë myslimanë dhe elementë borgjezë turko-manë, për të cilët lufta për autonominë e Shqipërisë, tani që u dukën shenjat e stabilizimit të gjendjes së Perandorisë, ishte bërë e rrezikshme.

Pikërisht pas këtyre elementëve të lëkundshëm reaksionarë u kap Porta. Ajo dërgoi në Shqipëri personalitete të larta të oborrit, të cilat kishin marrë udhëzime të korrupcionin kre-rët e Lidhjes me të holla dhe dekorata. Ata u orvatën t'i nxisnin këta krerë kundër «armikut të vjetër» sllav, për të organizuar inkursione në ato zona kufitare që gjatë operacioneve luftarake kishin kaluar nën sundimin serb edhe malazias. Me qëllim mashtrimi, ata i siguronin shqiptarët se sulltani kishte dhënë urdhër për të studiuar «reformat» që do të zbatoheshin në Shqipëri si edhe shpalljen e autonomisë së Shqipërisë së bashkuar me Bosnjën etj. Korrupsioni, premtimet, presioni nga ana e Portës patën deri diku sukses. Disa feudalë të mëdhenj si Iljaz Pashë Dibra, Hasan Pashë Tetova, Ali Pashë Guçia etj. iu përshtatën politikës së Portës. Komiteti drejtues i Prizrenit, i cili në disa mbledhje plenare kishte vepruar si organ i gjithë lëvizjes në Shqipëri, tani e humbi këtë funksion përfaqësues. Roli udhëheqës kaloi në duart e degëve dhe të grupeve të veçanta të atdhetarëve. Ndonëse u mbajt emri Lidhja Shqiptare ose Lidhja e Prizrenit, në të vërtetë ekzistonin disa lidhje, me qendër në Shkodër, në Janinë dhe në Prizren.

Ndërsa Porta përpiqej ta neutralizonte lëvizjen shqiptare, atdhetarët brenda Shqipërisë dhe veçanërisht grupi i Stambollit, që kishte mundësi t'i ndiqte më afër ngjarjet me karakter ndërkombëtar, vazhdonin të ngrinin çështjen e autonomisë së Shqipërisë.

Shpresën për realizimin e autonomisë së Shqipërisë atdhetarët e lidhën me zbatimin e artikullit 23, i cili parashikonte që Porta brenda një kohe të shkurtër të paraqiste projekte të statutit të administratës për krahinat e veçanta joturke të Perandorisë. Më 9 korrik 1879 Komiteti i Stambollit i drejtonte sulltanit një memorandum, ku kërkohej jo vetëm që të ndalohej copëtimi i tokave shqiptare, por që të shqyrtohej edhe kërkesa për një «ligj organik», i cili duhej t'u përshtatej karakterit e nevojave të shqiptarëve. Kjo, thuhej në memorandum, do t'i jepte mundësi popullit shqiptar «prej më se dy

milione frymësh që të rrojë, të qytetërohet dhe të hyjë në rrugën e përparimit...».

Memorandumi i korrikut 1879, që u përhap në Evropën Perëndimore me anë të komiteteve arbëreshe të Italisë, ishte një dëshmi e re e hovit, që kishte marrë lëvizja për fitimin e autonomisë së Shqipërisë.

«Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip»

Zgjerimi i lëvizjes patriotike në Shqipëri e bënte të nevojshme që edhe në fushën kulturore të kalohej në një veprimtari më të organizuar e më të gjerë, e cila duhej të plotësonte veprimtarinë politike të filluar nga Lidhja. Iniciativën për këtë e mori Komiteti i Stambollit. Detyrën për të zhvilluar ndër-gjegjen kombëtare në shtresa më të gjera, komiteti mendonte ta zgjidhte nëpërmjet shoqërive kulturore dhe shtypit periodik në gjuhën shqipe, nëpërmjet përhapjes së letërsisë me frymë kombëtare dhe me anën e shkollave shqipe.

Për këtë arsye, atdhetarët e Komitetit të Stambollit kishin përfshirë kurdoherë në programin e tyre, si një pikë me rëndësi, kërkesën për mësimin e shqipes në shkollat e vendit dhe kishin arritur që këtë kërkesë ta përfshinte zyrtarisht në programin e Lidhjes mbledhja e këshillit të përgjithshëm, e cila u zhvillua në Prizren, në nëntor të vitit 1878.

Po që të plotësoheshin këto detyra të rëndësishme të lëvizjes kombëtare dhe të mund të fillohej me botimin e librave dhe me hapjen e shkollave, duhej në radhë të parë të formohej një qendër që të merrej me këto punë dhe të hartohej një alfabet i përbashkët shqiptar. Për këtë qëllim komiteti ngarkoi anëtarin e tij Jani Vreto, që kishte marrë pjesë edhe në përpjekjet e mëparshme, për të hartuar një projekt të alfabetit. Duke njohur qëndrimin armiqësor që mbante Porta ndaj përhapjes së ideve kombëtare në radhët e myslimanëve shqiptarë, komiteti ngarkoi gjithashtu Jani Vreton të kërkonte nga qeveria turke lejën për themelimin e një shoqërie kulturore shqiptare me qendër në Stamboll.

Në muajt e parë të vitit 1879, nga gjiri i Komitetit të Stambollit u formua një komision i posaçëm për shqyrtimin e çështjes së alfabetit. Në të bënë pjesë përveç J. Vretos edhe

Sami Frashëri, Pashko Vasa, Hoxha Tahsini e Koto Hoxhi. Komisioni, pas një diskutimi parimor, nuk aprovoi projektin e Jani Vretos, që mbështetej kryesisht në alfabetin grek, as edhe projektin e një alfabeti origjinal të Hoxha Tahsinit si dhe alfabetin latin të përshtatur gjuhës shqipe nga Pashko Vasa, të dy këta të botuar ndërkohë nga autorët e tyre. Si alfabet unik për gjuhën shqipe komisioni aprovoi alfabetin e hartuar nga Sami Frashëri. Ky alfabet mbështetej kryesisht në alfabetin latin, por, duke ndjekur parimin fonetik që për çdo tingull të përdorej vetëm një gërmë, për tingujt e veçantë të shqipes merrte disa germa hua nga alfabeti grek e sllav. Megjithëse kjo përzjerje e vështirësonte deri diku shtypjen e librave në shtypshkronjat e zakonshme, të pajisura vetëm me germa latine, alfabeti i Samiut, ose, si u quajt më vonë, alfabeti i Stambollit, shënoi një hap të rëndësishëm përpara në mënjanimin e vështirësive për shkrimin e gjuhës shqipe. Ai u përhap gjerësisht në Shqipërinë e Jugut e të Mesme dhe në kolonitë shqiptare jashtë Atdheut. Por ai nuk u shtri në Shqipërinë e Veriut, ku kishte rrënjë të vjetra alfabeti thjesht latin.

Pas caktimit të alfabetit, komisioni botoi si libër të parë, të shtypur me alfabetin e ri «Alfabetaren e gjuhës shqip», një libër leximi i hartuar nga S. Frashëri, J. Vretoja, P. Vasa dhe K. Hoxhi. Përveç udhëzimeve gramatikore dhe gjuhësore, mësimëve gjeografike dhe aritmetike, libri përmbante edhe një skicë të historisë së Shqipërisë që prej pellazgëve deri te Skënderbeu, të shkruar nga P. Vasa, një kapitull kushtuar çështjeve të filozofisë dhe të moralit nga Jani Vretoja si edhe disa shkrime të S. Frashërit, në të cilat ky zhvillonte idetë e tij mbi detyrat e atdhetarëve shqiptarë në lidhje me përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe, në mënyrë që, siç thoshte ai, «të ndritohet edhe kombi ynë me dituri, me pasje e me rrojtje të mirë».

Porta e Lartë, për të mos e prishur me shqiptarët, nuk i pengoi mbledhjet e komisionit të alfabetit. Duke përfituar nga kjo rrethanë, udhëheqësit e Komitetit të Stambollit thirrën në fillim të tetorit të vitit 1879 një konferencë, në të cilën morën pjesë përfaqësues prej besimeve dhe krahinave të ndryshme: myslimanë, ortodoksë e katolikë nga Shkodra, nga Kosova e nga Shqipëria e Jugut. Midis tyre kishte çifligarë të mëdhenj si Ferid bej Vlora dhe Mehmet Ali bej Vrioni, intelektualë si Sami Frashëri dhe Pashko Vasa, përfaqësues të borgjezisë

tregtare dhe zejtarë të thjeshtë me prejardhje nga fshatrat e Përmetit, të Leskovikut etj. Më 12 tetor konferenca aprovoi statutin themeltar (kanonizmën) të shoqërisë së re, e cila u quajt zyrtarisht «Shoqëri e të shtypuri(t) shkronja shqip», shkurt: «Shoqëri e shkronjézave» ose «Shoqëri e Stambollit».

Kryetar u zgjodh Sami Frashëri, ndërsa anëtarët e grupit iniciator formuan këshillin qendror të shoqërisë.

Qëllimi i shoqërisë ishte, siç shkruante kryetari i saj, «të ndrituarit e kombit tenë», «të ngjallurit të gjuhës shqipe e të bashkuarit të dialekteve të saj». Ajo duhej të ndihmonte «punën e Lidhjes... punën e vllëzërimit të shqiptarëve, e bashkimit të ngjalljes së Shqipërisë».

Për këtë qëllim shoqëria, siç theksohej në «kanonizmë», u drejtohej gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine, gjendjeje shoqërore, brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe u bënte thirrje që të formonin degë dhe të jepnin kontributin e tyre moral e material. Me fondet e mbledhura shoqëria do të pajisej me një shtypshkronjë për shtypjen e librave, të gazetave dhe të revistave dhe do të hapte kudo shkolla shqipe.

Shoqëria, me interesimin e kryetarit të saj Sami Frashërit, që ishte një filolog i shquar, mendonte t'i kushtonte një vëmendje të veçantë çështjes së lëvrimin të gjuhës shqipe, e cila, për arsye të kushteve të vështira, kishte mbetur e pazhvilluar. Gjuha shqipe, sipas Samiut, duhej të ishte «e pandarë dhe e njëjtë, ashtu si duhet të jetë edhe Shqipëria, se shumë gjuhë dhe dialekte sjellin ndarje e mërgim (largim — red.)».

Në vazhdim të aktivitetit për zbatimin e programit të shoqërisë, po në vjeshtën e vitit 1879, Jani Vretoja nxori nga Porta lejën për botimin e një organi kulturor-arsimor shqiptar. Por veprimtaria e mëtejshme e Shoqërisë së Stambollit filloi të haste në vështirësi nga ana e qeverisë turke. Porta e Lartë, duke parë se lëvizja shqiptare po merrte gjithnjë e më tepër karakter kombëtar, e ndryshoi qëndrimin ndaj shoqërisë. Ajo ia hoqi lejën e dhënë Jani Vretos dhe pengoi veprimtarinë e aktivistëve të shoqërisë të dërguar në Shqipëri. Në këto veprime Porta përkrahej edhe nga kisha ortodokse greke. Kështu, p.sh., Koto Hoxhi, i cili i paraqiti valiut të Janinës një kërkesë të nënshkruar nga shumë qytetarë të Gjirokastrës për hapjen e një shkolle shqipe, jo vetëm që nuk mori lejën e dëshiruar, por u bë objekt ndjekjesh nga kleri grekoman. Patrikana e

Stambollit dhe veçanërisht peshkopi ortodoks Anthimi i Gjirokastrës lëshuan solemnisht mallkimin kishtar kundër librave në gjuhë shqipe, siç ishte «Alfabetarja» e Stambollit, si dhe kundër atyre ortodoksëve si Jani Vretoja e Koto Hoxhi, që kishin marrë pjesë në botimin e saj. Në qarkoren e lëshuar nga peshkopi, përpjekjet «për të krijuar një çështje shqiptare» dënoheshin si herezi. Ishte e qartë që fjalët e thëna nga Sami Frashëri në këtë kohë se «turku nuk do zgjuarjen e Shqipërisë dhe lindjen e Shqipërisë përsëri, por do ta ketë të fletur e të verbër...» vlenin po aq edhe për kishën greke.

Veprimtaria e «Shoqërisë së shkronjzëve» në Perandorinë Osmane po bëhej gjithnjë më e vështirë. Në këtë gjendje udhëheqësit e shoqërisë filluan ta drejtonin vëmendjen e tyre ndaj kolonive shqiptare jashtë Perandorisë, si në Rumani dhe në Egjipt, ku kishte kushte më të favorshme për një veprimtari politike-kulturore të papenguar. Ata vendosën lidhje me këto koloni për të drejtuar veprimtarinë e atdhetarëve të atjeshëm në frymën e Shoqërisë së Stambollit dhe për të krijuar një bazë organizative, që do të ishte në gjendje të merrte përsipër detyrat e caktuara nga situata e lëvizjes patriotike.

Mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë (tetor 1879 — janar 1880)

Në vjeshtën e vitit 1879, përveç çështjes së kufirit me Greqinë, që vazhdonte të ishte në rendin e ditës, u ngrit përsëri çështja e mbetur pezull mbi dorëzimin e atyre krahinave që do t'i lëshonin Malit të Zi nga Turqia. Nën presionin e Rusisë, që i kishte akoma trupat e saj në Edrene, Porta kishte qenë e detyruar të kënaqte pjesërisht kërkesat malazeze. Në shkurt të vitit 1879 ajo kishte dorëzuar krahinën e përfshirë midis Shpuzës, Podgoricës dhe Zhabjakut bashkë me qytetet përkatëse. Nga ana e tij, Mali i Zi zbrazi bregun e djathtë të Bunës me Ulqinin si dhe Dinoshin, në verilindje të liqenit, që nuk bënë pjesë në tokat e tij, por që i mbante të pushtuara qysh nga koha e luftës. Zbrazja e Podgoricës, e Shpuzës dhe e Zhabjakut, të banuara kryesisht me popullsi malazeze, nuk shkaktoi ndonjë kundërshtim nga ana e shqiptarëve. Për sa u përkiste Plavës dhe Gucisë, Porta duke parë vendosmërinë

e popullsisë shqiptare të këtyre dy krahinave për të mbrojtur vendin e vet, po e tërhiqte çështjen zvarrë. Në këto kushte jo vetëm Stambolli, por edhe Cetina po bindej se puna nuk do të zgjidhej pa konflikt me shqiptarët dhe se «dhurata» që i kishte bërë Malit të Zi Kongresi i Berlinit ishte shumë e dyshimtë, një «dhuratë danajsh»*, siç shprehej një gazetar serb bashkëkohës.

Princ Nikolla, duke e hequr më në fund shpresën për një zgjidhje paqësore, në fillim të tetorit 1879 mobilizoi ushtrinë. Degët e Lidhjes u përgjigjën duke lëshuar kushtrimin. Me mijëra vullnetarë nga krahinat e Kosovës dhe të Shkodrës u vajtën në ndihmë forcave vendase në Plavë e në Guci, të cilat u organizuan nën komandën e Ali Pashë Gucisë dhe Jakup Ferrit.

Për t'iu shmangur një konflikti, Turqia i propozoi Malit të Zi të hiqte dorë nga nga Plava e Gucia, duke i ofruar në vend të tyre një shpërblim në Hercegovinë. Por propozimi turk nuk u pranua nga Austro-Hungaria e pastaj edhe nga Mali i Zi. Në fillim të tetorit ndodhën ndeshjet e para në kufi midis malazezve dhe shqiptarëve. Rusia propozoi një ndërhyrje kolektive të Fuqive të Mëdha për një ndryshim eventual të kësaj pike të Traktatit të Berlinit, propozim që e kundërshtoi Anglia, dhe në mënyrë të veçantë Austro-Hungaria.

Pas përpjekjeve që ndodhën në fillim të nëntorit në Pepiç e në Velikë dhe më 4 dhjetor në Nevshkov e në Velikë, si komisar të lartë për të zbatuar dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë, Porta dërgoi mareshalin Muhtar Pasha, të shoqëruar nga forca ushtarake. Me të shkelur në tokën e Shqipërisë, Muhtar Pasha u dha urdhër forcave turke të tërhiqeshin nga Plava e Gucia. Por shqiptarët e kërcënuan mareshalin turk me luftë, në rast se ai do të vazhdonte rrugën për në Plavë e në Guci. Nga frika se mos përsëriteshin ngjarjet e ndodhura në Gjakovë, në shtator të vitit 1878, mareshali u detyrua të tërhiqej. Në raportin dërguar Portës ai vinte në dukje se nuk mund të mbështetej as mbi forcat e 7 batalioneve që kishte me vete, të cilat anonin nga shqiptarët.

Në janar të vitit 1880, përsëri në afërsitë e fshatrave Velikë

* Dhuratë danajsh — dhuratë që ka pasoja të këqija për atë që e merr, ashtu si pati pasoja të këqija për trojanët kali i lënë nga danajtë (grekët).

e Pepiç, u bënë përlëshje të reja në përfundim të të cilave 12 mijë malazez të udhëhequr nga vojvoda Mark Milani, u detyruan të sprapseshin nga qëndresa e 8 mijë shqiptarëve.

Atdhetarët shqiptarë, edhe ata të krahinave më të largëta, çështjen e Plavës dhe të Gucisë e konsideruan si një çështje të përgjithshme shqiptare. Në mbrojtjen e tyre morën pjesë luftëtarë nga vise të ndryshme të vendit. «Fuqia e Lidhjes e theu atë ushtri malazeze që ka qenë kurdoherë e zonja t'u bëjë ballë ushtrive turke. Shqiptarët luftuan të shtyrë nga ideja kombëtare», kështu i vlerësonte një vëzhgues diplomatik austro-hungarez ngjarjet e fillimit të vitit 1880 në Shqipëri.

Mbrojtja e Hotit dhe e Grudës. Ashpërsimi i marrëdhënieve shqiptare-turke (pranverë 1880)

Fitorja e korrur në mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë e shtoi besimin e masave të popullit dhe të udhëheqësve atdhetarë në forcat e veta dhe e diskretitoi politikën që kishte ndjekur Porta në Shqipëri gjatë konfliktit me Malin e Zi.

Në pranverë të vitit 1880 marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe Portës u acaruan përsëri, jo vetëm nga ndërlikimet e reja ndërkombëtare, por edhe nga përpjekjet e përsëritura të Portës për të mbledhur rekrutë dhe taksa për llogari të viteve të kaluara, në një kohë kur shumë krahina malore të Shqipërisë vuanin nga zia e bukës. Në shkurt e në mars në rrethet e Prizrenit dhe të Prishtinës ndodhën përpjekje midis forcave ushtarake turke dhe malësorëve, të cilët hynë deri brenda në Prizren dhe çliruan disa udhëheqës të tyre të arrestuar prej turqve.

Por ajo që i ashpërsoi në mënyrë të veçantë marrëdhëniet shqiptare-turke qe çështja e Hotit dhe e Grudës. Dështimi i ndërmarrjes malazeze kundër Plavës dhe Gucisë vuri në lëvizje diplomacinë evropiane. Qeveria ruse, për të kufizuar deri diku ekspansionin austriak, propozoi përsëri t'i jepej Malit të Zi një krahinë e Hercegovinës, por edhe kësaj here ndeshi në kundërshtimin energjik të Vjenës. Më në fund, më 2 prill 1880, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Stamboll pranuan kompromisin e propozuar nga ambasadori italian Korti (Corti) për t'i dhënë Malit të Zi, në vend të Plavës dhe të Gucisë, të banuara nga myslimanë, viset e Hotit e të Grudës dhe të

Kelmendit. Ambasadorët mendonin se popullsia katolike e këtyre viseve nuk do të kundërshtonte bashkimin me Malin e Zi të krishterë. Propozimi u pranua nga Turqia dhe nga Mali i Zi. Si datë për dorëzimin e Hotit e të Grudës u caktua 22 prilli i vitit 1880.

Lajmi i pazarllëkut të ri me tokat shqiptare, i pranuar nga Porta, e forcoi edhe më tepër bindjen e shqiptarëve se Stambolli e konsideronte Shqipërinë vetëm si vend për të nxjerrë taksë e rekrutë dhe tokat e saj si plaçkë tregu. Udhëheqësit patriotë të lëvizjes në Shqipëri e shfrytëzuan këtë gjendje për të zgjeruar agjitacionin në favor të autonomisë.

Kundrejt kësaj lëvizjeje që vinte duke u rritur, komiteti i vjetër drejtues i Lidhjes në Prizren qëndronte pasiv dhe i mënjanuar. Elementët më aktivë të komitetit si Sulejman Vokshi dhe Ahmet Koronica nga Gjakova, Ali Ibra nga Gashi, Haxhi Jonuzi nga Prizreni, duke parë se me qëndrimin pajtues që mbanin ndaj Turqisë krerët feudalë e turkomanë të Lidhjes, kjo e kishte humbur shumë autoritetin e vet në masat e popullit, më 21 mars 1880, krijuan në Gjakovë një Lidhje të re, në të cilën morën pjesë përfaqësues të malësive të Gjakovës, të Prizrenit dhe të Lumës. Lidhja e re kërkonte një qëndrim më të ashpër kundrejt qeverisë turke në çështjen e gjyqeve dhe të nizamëve si dhe theksonte nevojën e bashkëpunimit të ngushtë me elementin e krishterë për t'u bërë ballë rreziqeve të reja që po shfaqeshin.

Sa më tepër afrohej data e dorëzimit të viseve të Hotit e Grudës, aq më tepër shtohej agjitacioni në të gjitha Malësitë e Veriut deri në Kosovë, dhe në mënyrë të veçantë në Shkodër, e cila kishte lidhje të ngushta me ato vise. Qysh në gjysmën e dytë të marsit filluan përpjekjet për të organizuar një mbledhje të përgjithshme të përfaqësuesve të Malësisë dhe të qytetit të Shkodrës, për të marrë masa për mbrojtjen e viseve që kërcënoheshin. Popullsisë iu shpërndanë trakte, me anën e të cilave ajo ftohej të merrte pjesë në përpjekjet për të mos lejuar cenimin e vendit.

Më 3 prill 1880 në Shkodër u bë mbledhja e parë, e cila vendosi formimin e një «Lidhjeje mbrojtëse» të Malësisë e të qytetit. Në krye të Lidhjes u zgjodh një komitet i përbërë prej 12 vetash, myslimanë e të krishterë, i cili do të organizonte mbrojtjen e vendit. Si kryetar i komitetit u zgjodh Hodo

bej Sokoli, një përfaqësues i parisë qytetare shkodrane, kolonel i xhandarmërisë turke në qytet. Nënkrjetar u caktua Prengë Bibë Doda, të cilit iu premtua se do të njihej si kapedan i malësive të Mirditës, të Lezhës dhe të Pukës. Mbledhja u kërkoi me këmbëngulje autoriteteve turke shpërndarjen e mexhlisit të vjetër të vilajetit, i cili nuk gëzonte besimin e popullsisë së vendit. Komiteti shpalli se do t'i ushtronte vetë funksionet që kishte pasur deri atëherë mexhlisi.

Komiteti i Mbrojtjes përfshiu në gjirin e vet përveç Mirditës, edhe Malësinë e Dukagjinit dhe vendosi lidhje me Pejën, me Gjakovën dhe me Prizrenin. Për të siguruar mjetet e nevojshme për mbrojtje, si ndihmë për luftën ai caktoi një kontribut të veçantë për popullsinë; shuma të rëndësishme detyroheshin të paguanin tregtarët e pasur dhe sarafët e mëdhenj shkodranë. Komiteti vuri dorë mbi të dhjetat, mbi taksën e vergjisë dhe mbi të ardhurat doganore të mbledhura në Shkodër, të cilat i përdori për të blerë ushqim, veshje dhe armë. Në Tuz, në qendrën e krahinës së rrezikuar, filluan të mbli-dhen me mijëra mbrojtës të ardhur nga të gjitha anët e vendit.

Në qytetin e Shkodrës dhe në krahinën e saj mbretëronte një atmosferë luftarake. Të krishterë e myslimanë deklarorin haptazi: «Nuk u bindemi më urdhrave të sulltanit». Në këngët popullore që u krijuan me këtë rast, thuhej plot entuziazëm: «kena nisë me u ba millet» (komb — red.).

Kuvendi i popullit në Mirditë vendosi të merrte pjesë në mbrojtjen e Hotit e të Grudës. Vullnetarë filluan të vinin edhe nga krahinat më të largëta: Mati, Luma, Kosova, Dibra e deri nga Tetova. Djem të rinj nga Shkodra vraponin për në Tuz që të merrnin pjesë në mbrojtjen e vendit. Dy batalione të ushtrisë turke, të përbëra nga ushtarë shqiptarë, dezertuan dhe u rreshtuan përkrah vullnetarëve vendas. Me aksione të organizuara nga komiteti, shkodranët shpërthyen depot e ushtrisë turke dhe morën që andej armë e municione. Lëvizja përfshiu edhe tregtarët e mëdhenj shkodranë si dhe klerin katolik, i cili ishte gjithashtu i interesuar që të mos linte vise me popullsi katolike të binin në duart e Malit të Zi ortodoks.

Sa më tepër afrohej data e caktuar për dorëzimin e Hotit dhe të Grudës, aq më tepër shtohej në Shkodër dhe në malësitë revoltimi i popullsisë. Masat e popullit demonstرونin nëpër rrugët e qytetit, duke deklaruar se nuk i njihnin më

autoritetet turke si zotër të vendit. Lëvizja përfshiu edhe oficerë të ushtrisë turke me prejardhje shqiptare. Kolonel Hodo bej Sokoli zhveshi publikisht uniformën turke dhe vajti në Tuz si ushtarak dhe udhëheqës i Lidhjes së Shkodrës për të organizuar forcat e grumbulluara atje. Shembulli i tij u ndoq edhe nga oficerë të tjerë, midis tyre edhe nga oficerë turq, të cilët shfaqnin kështu protestën kundër nënshtrimit të Portës ndaj politikës së Fuqive të Mëdha.

Autoritetet lokale, nga frika se mos kundërshtimi nga ana e tyre shkaktonte shpërthimin e një kryengritjeje në Shkodër dhe, nga ana tjetër, me shpresë se kështu ndoshta mund ta bënë të pamundur lëshimin e këtyre krahinave, në fillim nuk morën asnjë masë për ta penguar këtë lëvizje.

Më në fund, valiu i Shkodrës shpalli zyrtarisht vendimin e Portës për të dorëzuar Hotin, Grudën e Kelmendin dhe njoftoi qeverinë e Malit të Zi t'i merrte ato në dorëzim. Më 22 prill 1880 forcat turke u tërhoqën nga pozicionet që kishin zënë në këtë zonë gjatë kufirit. Por menjëherë në pozicionet e braktisura u vendosën forcat shqiptare, që kishin pritur në afërsitë. Kështu, kur ushtria malazeze kaloi kufirin e vjetër, tek ura e Rzhanicës dhe në një varg pikash të tjera, u ndesh në pararojat shqiptare. Pas një shkëmbimi zjarri, në të cilin të dyja palët lanë të vrrarë e të plagosur, ushtria malazeze u tërhoq në Podgoricë.

Lajmi i fitores e ngriti edhe më shumë prestigjin e Komitetit të Shkodrës. Forcat e vullnetarëve të grumbulluara në Tuz dhe gjatë bregut të majtë të lumit Cem nën komandën e komitetit, arritën në më tepër se 12 000 vota. Për furnizimin e tyre me armë dhe me ushqime komiteti bëri një punë të madhe organizative. Me këtë rast vetëm nga popullsia e qytetit të Shkodrës u mblodh si kontribut një shumë që arriti në 600 000 groshë. Të dërguarit e komitetit përshkuan vendin deri në Vlorë, në Janinë e në Manastir duke mbledhur ndihma dhe duke u dhënë kështu shkas shfaqjeve të solidaritetit. Ndoq dhitë e Shkodrës, e cila në këtë muaj u bë qendra kryesore politike e vendit, tërhoqën vëmendjen e opinionit publik botëror. Për t'i ndjekur më afër ngjarjet, në Shkodër erdhën një numër korrespondentësh të gazetave të mëdha evropiane. Vetë Komiteti i Shkodrës vuri dorë mbi gazetën zyrtare turke të vilajetit, që tani filloi të dilte në gjuhën shqipe.

Duke pritur një ndërhyrje të re të qeverisë malazeze pranë Fuqive të Mëdha, Komiteti i Shkodrës u drejttoi atyre, më 18 maj, një memorandum, me anën e të cilit kërkonte ndalimin e copëtimit të truallit shqiptar dhe njohjen e të drejtave kombëtare shqiptare. «Shqipëria, atdheu ynë i dashur, por fatkeq, nuk pranon të shitet ose të shkëmbehet, as nuk do ta durojë kurrë një sundim të huaj. . . ; ne nuk duam të jemi veçse shqiptarë. T'i njihen pra edhe Shqipërisë gjithë ato të drejta që u janë njohur popujve të tjerë», përfundonte memorandumimi.

Ardhja në fuqi në Angli e një kabineti të ri liberal me U. Gladstonin (W. Gladstone) në krye, i cili njihej për qëndrimin e tij antiturk, u dha shpresë atdhetarëve se ky do të mbante një qëndrim të favorshëm ndaj çështjes shqiptare. Me një telegram drejtuar atij, më 19 maj 1880, atdhetarët shkodranë kërkuan përsëri zbatimin e parimit të kombësisë në lidhje me çështjen shqiptare.

Krijimi i një vatre konfliktesh në Shqipërinë e Veriut dhe rritja e lëvizjes autonomiste shkaktuan shqetësimin dhe kundërveprimin e Austro-Hungarisë dhe të Turqisë. Në grumbullimin e forcave të mëdha shqiptare në Tuz Vjena shihte një kërcënim jo vetëm për Malin e Zi, por edhe një rrezik për pozitën e saj në Bosnjë-Hercegovinën e porsanënshtuar. Dhe me të vërtetë, midis Shqipërisë dhe Bosnjës ishin krijuar prej disa kohësh lidhje, të cilat vetëm ndërhyrja energjike e princ Nikollës nuk i lejoi të zhvilloheshin më tej. Duke e parashikuar si të afërt një sulm të forcave shqiptare kundër Malit të Zi, qeveria austro-hungareze i dha urdhër shtabit të përgjithshëm të merrte masa të efektshme për një ndërhyrje në ndihmë të Malit të Zi. Njëkohësisht, diplomacia austriake vuri në lëvizje të gjitha mjetet për të arritur që t'i përçante e t'i shpërndante forcat e Lidhjes Shqiptare me anë të presionit të drejtpërdrejtë dhe të korrupsionit. Duke u shpërndarë gjerësisht të holla bajraktarëve dhe veçanërisht Prengë Bibë Dodës, ajo arriti që ky, bashkë me një pjesë të mirditasve dhe malësorëve të tjerë katolikë, të largohej nga Tuzi. Edhe qeveria turke, nga ana e saj, me anë të feudalëve, klerikëve dhe elementëve të tjerë të lidhur me të, u përpoq ta largonte lëvizjen nga rruga që kishte marrë. Më 15 qershor ajo provokoi një deklaratë besnikërie të nënshkruar nga një varg krerësh të mbledhur në Tuz dhe shkaktoi me këtë një konflikt midis

krahut autonomist dhe elementëve reaksionarë e turkomanë.

Me gjithë përçarjen e arritur dhe largimin e një pjese të forcave, në Tuz vazhduan të qëndronin ende për një kohë të gjatë reparte vullnetare, për t'i bërë ballë një sulmi të dytë të Malit të Zi.

Nga ana tjetër, qeveria e princ Nikollës iu drejtua përsëri Fuqive të Mëdha që të ndërhyjnë. Meqë edhe përpjekja e dytë për të kënaqur kërkesat e princ Nikollës dështoi, Anglia dhe Austro-Hungaria filluan të shqyrtonin mundësinë për t'i dhënë Malit të Zi një krahinë tjetër shqiptare afër bregdetit, ku do të ishte më e lehtë ndërhyrja e fuqive.

Çështja e kufirit greko-turk në Konferencën e Berlinit (qershor 1880)

Rritja e lëvizjes popullore në Veri, në muajt maj e qershor, pati si rrjedhim të drejtpërdrejtë që edhe në Jug të merrte hov lëvizja, aq më tepër që në marrëdhëniet greko-turke po përgatitej përsëri një krizë e re në lidhje me çështjen e kufirit.

Meqë një konferencë dypalëshe greko-turke, që i kishte zhvilluar punimet e saj gjatë kohës në Stamboll, kishte marrë fund në shkurt të 1880-ës, pa arritur një marrëveshje, me propozimin e qeverisë angleze u mbledh, më 16 qershor, në Berlin një konferencë e përfaqësuesve të fuqive pjesëmarrëse në Kongresin e Berlinit, për t'u dhënë fund çështjeve të mbetura pezull në zbatimin e traktatit.

Në pragun e konferencës komitetet shqiptare zhvilluan një fushatë aktive politike. Në Janinë e në Prevezë u organizuan përsëri disa mbledhje plenare. U aprovua një deklaratë drejtuar sulltanit, ku theksohej vendosmëria për ta marrë vetë në dorë fatin e vendit dhe për të ndaluar me mjete e më forcat e veta çdo lëshim tokësor. Njëkohësisht, komitetet në Veri e në Jug i drejtuan konferencës në Berlin një varg protestash kundër pretendimeve tokësore greke. «Ne nuk kemi kurrsesi ndërmend të paraqesim projekte në dëm të fqinjëve tanë, thuhej në një protestë të Komitetit të Stambollit, më 18 qershor 1880. Por ne kërkojmë që edhe fqinjët tanë të heqin dorë nga atentatet

drejtuar kundër vendit tonë. Ne respektojmë të drejtat e të tjerëve dhe kërkojmë vetëm respektimin e të drejtave tona».

Atdhetarët shqiptarë përpiqeshin ta përdornin Konferencën e Berlinit si arenë për të ngritur në tërësi çështjen shqiptare. Edhe Porta, nga ana e saj, i nxiste shqiptarët për një qëndrim këmbëngulës. Për këtë qëllim, pikërisht në pragun e Konferencës së Berlinit, sulltani emëroi anëtarin e Komitetit Jugor të Lidhjes, Abedin Pashë Dinon, një çifligar të madh nga Çamëria, si ministër të Punëve të Jashtme. Me anë qarkoresh të fshehta, Abedin Pasha u premtonte komiteteve të Lidhjes ndihmën e Portës në konfliktin me Greqinë.

Kundër kësaj politike dyfaqëshe të qeverisë turke dhe veçanërisht kundër qëndrimit të mbajtur nga ministri i Jashtëm Abedin Pashë Dinoja, protestuan përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha në Stamboll.

Konferenca e Berlinit u ndodh përsëri në të njëjtat vërshtirësi si konferencat e mëparshme greko-turke. Greqia, e përkrahur nga Rusia, paraqiti kërkesën për një kufi që do të përfshinte kanalën e Korfuzit dhe, duke u nisur nga Manastiri i Shëngjergjit në jug të Sarandës, do t'i linte Greqisë liqenin e Butrintit dhe Konispolin dhe do të dilte në luginën e sipërme të Vjosës. Franca propozoi përsëri vijën e Kalamas-Selemvria. Edhe Anglia me Austro-Hungarinë ishin të interesuara të kishin një Greqi të fortë, si kundërpeshë ndaj ndikimit rus. Prandaj, në përgjithësi, ato ishin të mendimit se duhej të përkrahej kërkesa greke, por pa përfshirë në tokat që do t'i lëshoheshin Greqisë tepër shqiptarë gjë që do ta dobësonte, në vend që ta forconte atë.

Delegacioni turk në konferencë mbajti që në fillim një qëndrim të prerë kundër propozimit rus e francez, duke përdorur si argument qëndresën shqiptare. Ai la të kuptohej se do të ishte gati për ndonjë koncesion të vogël nga ana e The-salisë, por nuk mund të bënte asnjë lëshim në vilajetin e Janinës, sepse do t'i jepte shkas kryengritjes së Shqipërisë.

Qarqet diplomatike italiane u përpoqën të siguronin përkrahjen e Francës për të ngritur në konferencë, në tërësi, çështjet që i përkisnin Shqipërisë, por hasën në kundërshtimin e vendosur të Austro-Hungarisë, e cila donte t'i shmangej një ndërhyrjeje kolektive në këtë zonë.

Konferenca, më në fund, me përjashtim të përfaqësuesit

të Turqisë, u bashkua me propozimin e Francës për të vendosur si vijë kufitare vijën Kalamas-Selevria. Por vendimi nuk përbante asnjë dispozitë në lidhje me mënyrën e zbatimit të tij. Në këtë mënyrë, vendimi i konferencës nuk kishte karakter detyrues dhe çështja e kufijve mbetej e hapur.

Më 26 qershor, pa i mbyllur ende punimet Konferenca e Berlinit, ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Stamboll i paraqitën Portës kërkesën e propozuar nga ana e Anglisë dhe e Austro-Hungarisë që t'i lëshonte Malit të Zi, në vend të Plavës e Gucisë, një krahinë tjetër midis liqenit të Shkodrës dhe detit Adriatik, qytetin e Ulqinit dhe rrethin e tij. Ata i jepnin Portës një afat për të pranuar propozimin e ri ose për të zbatuar konventën e prillit në lidhje me Hotin e Grudën. Njëkohësisht, ambasadorët e këshillonin Portën të shqyrtonte mundësinë për t'i dhënë vilajetit të Shkodrës një administratë autonome.

Kështu çështja e kufijve hynte në një fazë të re acarimi. Nga ana tjetër, në Shqipëri po' rritej gjithnjë e më tepër veprimtaria e masave popullore. Në këto kushte, lëvizja shqiptare që nga mesi i vitit 1880 po hynte në një fazë më të lartë të zhvillimit të saj, në të cilën si çështje kryesore filloi të dilte ajo e sigurimit të autonomisë.

4. ASHPËRSIMI I KONTRADIKTAVE NË GJIRIN E LIDHJES. KONFLIKTI PËR ULQININ (KORRIK—NËNTOR 1880)

Rrymat politike në gjirin e Lidhjes Shqiptare

Paaftësia e Turqisë për të mbrojtur veten dhe Shqipërinë nga copëtimi u kishte dhënë atdhetarëve shqiptarë një armë të fuqishme në luftën e tyre për t'i dhënë lëvizjes karakter autonomist kombëtar. Qëndrimi i mëtejshëm i Shqipërisë si pjesë e pandarë e Perandorisë donte të thoshte, sipas një shprehjeje të mëvonshme të Sami Frashërit, të qëndroje në një shtëpi që ishte gati për t'u shembur dhe të humbisje nën gërmat dhat e saj.

Por lëvizja e atdhetarëve për autonominë e vendit ishte e detyruar të zhvillohej në luftë të vazhdueshme kundër ndërhyrjes së faktorëve të jashtëm, në radhë të parë të Portës, që kishte si synim devijimin e saj nga rruga patriotike. Jo më pak e rëndësishme ishte lufta që atdhetarët duhej të zhvillonin kundër elementëve reaksionarë, feudalëve, klerit ose turkomanëve të tjerë, të cilët mbanin gjithnjë pozita të rëndësishme në organizatat e Lidhjes.

Në vitin 1880 kjo luftë midis rrymave u bë më e ashpër. Duke bërë në këtë periudhë (korrik 1880) një analizë të hollësishme dhe të qartë të raportit të forcave në Lidhjen e Prizrenit, K. Kristoforidhi vinte në dukje se feudalët e mëdhenj e derebejtë, që kishin marrë pjesë në Lidhje, në të vërtetë nuk bënin tjetër veçse luanin «me kryengritjen për të ruajtur autoritetin e sulltanit dhe supremacinë myslimane dhe njëkohësisht për të përtëritur pushtetin e tyre në atë shkallë si përpara reformave të sulltan Mahmudit».

Edhe çifligarët e rinj që kishin hyrë në lëvizjen për mbrojtjen e tokave shqiptare, nuk mund të pajtoheshin plotësisht me qëllimet e autonomistëve. Ata i trembte mendimi i shkëputjes nga autoriteti i sulltanit, gjë që do të vinte në rrezik gjithë privilegjet e tyre politike dhe shoqërore, të cilat mbështeteshin pikërisht mbi këtë regjim, aq më tepër që autonomia nuk mund të realizohej pa rënë në konflikt me sulltanin. Njëri nga këta çifligarë, Abedin Pashë Dinoja, që ishte ministër i Punëve të Jashtme, me anë të një qarkoreje drejtuar komiteteve të Lidhjes përpigëj t'i bindte shqiptarët se shpëtimin e tyre duhej ta prisnin vetëm nga ruajtja dhe nga forcimi i lidhjeve me sulltanin. «Sulltani, deklaronte Abedin Pasha, do ta bëjë Shqipërinë të madhe e të fuqishme. . .». Ai dhe shokët e tij kërkonin që sulltani të emëronte në pozitë drejtuese të vilajeteve të Shqipërisë qeveritarë shqiptarë; por kjo çështje, si edhe ajo e unitetit të Shqipërisë, siç deklaronte ai, «nuk kishte të bënte aspak me çështjen e autonomisë së Shqipërisë».

Si derebejtë dhe Abedin Pasha me pasuesit e tij, ashtu edhe Porta nuk donin tjetër veçse «luftë për mbrojtjen e atdheut të përbashkët», për ta bërë Shqipërinë, siç thoshte qarkorja e ministrit Abedin Pasha, «një ledh të fortë kundër lakmive të armiqve».

Atdhetarët bashkëpunonin me derebejtë dhe çifligarët në

Lidhjen Shqiptare, thoshte K. Kristoforidhi, «për aq sa qëllimet e tyre janë të njëjtoja», duke kuptuar me këtë luftën kundër copëtimit të tokave shqiptare.

Për atdhetarët ishte e qartë se «lëvizja kombëtare e vërtetë dhe serioze» që përfaqësonin ata, ishte «në fillimet», por, thoshte K. Kristoforidhi, ajo «do të rritet shpejt. . . dhe do të bëhet tepër e fortë për derebejtë dhe Portën».

Duke u nisur nga interesat e përgjithshme kombëtare, atdhetarët filluan të theksonin gjithnjë e më tepër kundërshtimet Portës dhe derebejtë karakterin mbifetar dhe mbikrahinor të lëvizjes dhe të vinin në dukje se autonomia do të sillte barazi të plotë të drejtash për anëtarët e atyre feve që gjer tani kishin qenë të shtypura në Perandorinë Osmane, se do ta vinte Shqipërinë në rrugën e përparimit, sipas shembullit të shteteve borgjeze të Evropës. Me këtë atdhetarët synonin të tërhiqnin në lëvizje masat e popullsisë së krishterë, të cilat parullat me karakter islamik që kishte përdorur në fillim Lidhja Shqiptare, i kishin bërë të qëndronin në disa raste mënjanë ngjarjeve. Kështu atdhetarët luftonin propagandën armiqësore të qarqeve shoviniste greke, të cilat deklaroinin se lëvizja shqiptare nuk ishte gjë tjetër veçse një lëvizje e bejlerëve myslimanë, prej së cilës të krishterët nuk do të kishin asnjë përfitim, veçse një shtypje dhe robëri edhe më të rëndë.

Në sajë të përpjekjeve që bënin atdhetarët, në luftë me elementët reaksionarë të brendshëm dhe nxitësit e tyre nga jashtë, po forcohej gjithnjë e më tepër karakteri kombëtar në lëvizjen politike në Shqipëri.

Lëvizja për autonomi po i përfshinte gjithnjë e më shumë masat e popullit. Kjo e thelloi edhe më tepër diferencimin e rrymave politike në gjirin e lëvizjes shqiptare dhe në mënyrë të veçantë në gjirin e organizatave të Lidhjes. Konfliktet e brendshme në disa komitete filluan të bëheshin aq të mëdha, sa që në Shkodër, p.sh., elementët turkomanë ishin gati të largoheshin nga komiteti. Në disa qytete të Kosovës e në Shkodër, komitetet e Lidhjes, ndonëse bashkëjetonin me organet qeveritare turke, në të vërtetë filluan të vepronin jo vetëm pa i përfillur ato, por edhe kundër tyre. Vëzhguesit diplomatikë vinin në dukje se disa komitete po merrnin kështu një karakter «terrorist». Në Prizren masat e popullit dëbuan disa nëpunës, midis tyre edhe mytesarifin, dhe qeveria turke u detyrua të

mbyllte sytë përpara këtyre fakteve. Njëkohësisht, disa degë lokale filluan të ngrinin zërin për të kërkuar riorganizimin e Lidhjes së Prizrenit. Ato kërkonin që çështja e luftës kundër copëtimit tokësor të lidhej me çështjen e autonomisë. Në muajin korrik nga udhëheqja e Lidhjes në Prizren u largua në mënyrë demonstrative një grup që kërkonte një veprim energjik për realizimin e autonomisë. Veprimtaria e komitetit që vazhdoi të ekzistonte në Prizren, u paralizua kështu krejtësisht. Iniciativa kaloi në duart e rretheve patriotike autonome, që mbështeteshin në lëvizjen popullore.

Kuvendi i Gjirokastrës (23 korrik 1880)

Kur po rritej lëvizja popullore për autonomi dhe çështja shqiptare po bëhej një problem i marrëdhënieve ndërkombëtare, atdhetarët i shtuan përpjekjet për t'i përtëritur lidhjet e dobësuar midis krahinave dhe për të organizuar një kuvend të përgjithshëm shqiptar. Një veprimtari veçanërisht të madhe zhvilloi në këtë drejtim Abdyl Frashëri.

Pas një përgatitjeje prej disa javësh, më 23 korrik 1880, u mbledhën në Gjirokastrë përfaqësues të krahinave të ndryshme të Jugut e të Veriut. Krahinat që nuk kishin pasur mundësi të dërgonin delegatët e tyre, u solidarizuan me qëllimet e mbledhjes duke i dërguar telegrame. Në këtë kuvend morën pjesë myslimanë e të krishterë; pranë bejlerëve çifligarë kishte edhe shumë elementë borgjezë dhe intelektualë.

Çështja e parë dhe e vetme që qëndronte në rendin e ditës ishte ajo e autonomisë. Të pranishmit ishin të një mendimi se ekzistenca e kombit shqiptar ishte në rrezik dhe se e ardhmja e tij nuk mund të sigurohej ndryshe veçse me krijimin e një shteti autonom shqiptar. Abdyl Frashëri paraqiti një program të hollësishëm për organizimin e Shqipërisë autonome, sipas të cilit marrëdhëniet me Turqinë do të kufizoheshin në minimum. Shqipëria do të kishte një qeveri të vetën me qendër në një qytet në mes të Shqipërisë. Autoritetet turke do të largoheshin nga vendi dhe vetëm guvernatori i përgjithshëm do të emërohej nga sulltani. Përveç pagesës së një shume vjetore dhe shërbimit ushtarak në rast lufte, Shqipëria nuk do të kishte

të tjera detyrime ndaj Portës. Pasuritë e vendit, doganat, taksat dhe të ardhurat e tjera do të kalonin në duart e administratës shqiptare, në të cilën do të merrnin pjesë nëpunës pa dallim feje. Në kuvend u paraqit një program-bazë, i cili shpallte sigurimin e pronës, të personit mbi barazinë e plotë të besimeve. Vetëm duke dalë nga prapambetja dhe duke ndjekur shembullin e shteteve më të përparuara, thuhej në këtë program, populli shqiptar do të mund të siguronte të drejtën e ekzistencës si pjesëtar i familjes së popujve evropianë. Për këtë arsye duhej të zhdukeshin institucionet e vjetra patriarkale dhe të luftoheshin zakonet e dëmshme dhe prapanike si hakmarrja etj.

Programi parashikonte gjithashtu që të gjitha krahinat të merrnin pjesë në shpenzimet për mbajtjen e ushtrisë, duke paguar një kontribut të rregullt, që u përgjigjej forcave të tyre, dhe të jepnin një numër ushtarësh për mbrojtjen e vendit. Kjo detyrë u binte në mënyrë të barabartë si të krishterëve ashtu edhe myslimanëve. Më në fund, statuti parashikonte edhe sanksione kundër atyre që do të pengonin veprimet e Lidhjes.

Vendimet e Kuvendit të Gjirokastrës kishin një rëndësi të madhe historike. Ato përbënin një dokument të rëndësishëm programatik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të aprovuar nga një kuvend që përfaqësonte gjithë popullin shqiptar. I frymëzuar nga parimet e demokracisë borgjeze evropiane, programi i Gjirokastrës shënonte një hap të madh përpara në zhvillimin e mendimit politik shqiptar. Realizimi i tij do t'i hapte vendit rrugën e zhvillimit borgjez kapitalist.

Por ndërsa delegatët qenë të një mendjeje për sa i për-kiste qëllimit kryesor, autonomisë, në gjirin e mbledhjes u shfaqën pikëpamje të ndryshme lidhur me kohën dhe mënyrën e veprimit për realizimin e këtyre kërkesave. Elementët më të vendosur mendonin se duhej vepruar menjëherë. Duke përfituar nga vështirësitë që po kalonte Turqia, ata mendonin të bënin një grusht shteti dhe të merrnin në dorë pushtetin në qytetet kryesore të Shqipërisë së Jugut. Atdhetarët llogaritnin që në këtë rast të kishin edhe ndihmën e forcave të Lidhjes së Veriut, dhe e quanin të mundshme që edhe një pjesë e ushtrisë turke të rreshtohej përkrah Lidhjes Shqiptare, ose të paktën të mos merrte pjesë në veprimet kundër saj. Por

pjesëmarrës të tjerë ngurronin dhe propozonin të pritej një çast më i volitshëm. Siç deklaronte një vëzhgues diplomatik francez, në këtë konflikt midis «të moderuarve» dhe «radikalëve», siç i quante ai, këta të fundit përfaqësoheshin nga elementë «të shtresave të ulëta». Mbledhja, më në fund, arriti në marrëveshjen që autonomia të shpallej posa të bëhej një veprim agresioni në Jug ose në Veri kundër tokave shqiptare.

Posa kuvendi mbaroi punimet, atdhetarët filluan në krahinat e Jugut një aksion për të popullarizuar rezultatet e tij. Jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra u shpall programi i hartuar prej kuvendit dhe nënshkruhej në mbledhje të veçanta krahinore prej popullsisë. «Të krishterë dhe myslimanë janë vëllezër, thuhej në rezolucionet e këtyre mbledhjeve. — Jeta, nderi dhe pasuria e vëllezërve të krishterë është edhe e myslimanëve dhe këta do ta mbrojnë me çdo therori».

Në sajë të kësaj fushate, brenda një kohe të shkurtër administrata e vendit kaloi në fakt në duart e njerëzve të Lidhjes, ndonëse nëpunësit e vjetër turq vazhdonin të qëndronin në vend. Kështu edhe në krahinat e Jugut, ashtu si në ato të Veriut, u krijua ai lloj dypushteti, që karakterizonte administratën e Shqipërisë në këto vite.

Me gjithë kundërveprimin e peshkopëve ortodoksë dhe të agjentëve të tjerë të politikës shoviniste greke, në lëvizje po përfshihej edhe popullsia ortodokse e Jugut. Atdhetarët si Dhimitër Kolea nga Berati, Petro Meksi nga Lunxheria, Mihal Haritoja nga Zagoria, Vasil Hidoja nga Gjirokastra dhe të tjerë morën pjesë si udhëheqës në të gjitha aksionet e Lidhjes së Jugut, duke manifestuar botërisht vendosmërinë e tyre për të luftuar për bashkimin dhe autonominë e Shqipërisë, për të mos i shkëputur fatet e popullsisë ortodokse shqiptare nga ato të vëllezërve të tyre myslimanë.

Abdyl Frashëri (1839-1893). Jeta dhe veprimtaria

Në ngjarjet e periudhës vendimtare për fatet e Shqipërisë, që kishte nisur qysh prej viteve 1876-1877, një rol gjithnjë e më të rëndësishëm si burrë shteti largpamës, si propagandist i flaktë i çështjes së çlirimit kombëtar dhe predikues i përparimit

shoqëror e kulturor të popullit shqiptar po luante Abdyl Frashëri. Ai qe një nga organizatorët kryesorë të Kuvendit të Gjirokastrës.

Abdyl Frashëri lindi në vitin 1839 në fshatin Frashër të krahinës së Dangëllisë, kaza e Përmetit, e cila bënte pjesë në sanxhakun e Gjirokastrës dhe në vilajetin e Janinës. Ai ishte i biri i Halil bej Frashërit, një feudali ushtarak të zhveshur nga timaret, dhe vëllai më i madh i poetit Naim dhe i dijetarit Sami Frashëri.

Qysh në moshën 18 vjeç, pas vdekjes së të atit, Abdyl u shpërngul në Janinë, ku punonte për të mbajtur familjen dhe njëkohësisht studionte bashkë me të vëllezërit, duke përvetësuar kështu idetë përparimtare të kulturës bashkëkohëse. Abdyl Frashëri punoi për disa kohë si tregtar, sipërmarrës dhe në fund si nëpunës. Kështu ai pati mundësi të bënte udhëtime jashtë Shqipërisë, të cilat e ndihmuan të zgjeronte horizontin mendor.

Duke qenë drejtor i financave të vilajetit në Janinë, ai u caktua deputet në parlamentin e parë të Perandorisë, që u mblodh në Stamboll në vitin 1877.

Kur filluan të acaroheshin marrëdhëniet ndërkombëtare në lidhje me çështjen lindore dhe me Shqipërinë, Abdyl Frashëri u bë një nga iniciatorët kryesorë për organizimin e lëvizjes, e cila kishte si qëllim të mbronte të drejtat e popullit shqiptar dhe të siguronte autonominë e vendit. Duke organizuar në shërbim të kësaj çështjeje elementët më të përparuar nga bashkatdhetarët, ai luajti një rol drejtues për hartimin e memorandumit të Janinës, në Komitetin e Stambollit dhe për organizimin e Lidhjes së Prizrenit.

Për Abdyl Frashërin ishte e qartë se edhe sikur të fitohej autonomia, kjo si dhe tërësia tokësore e vendit nuk mund të sigurohej, po qe se Shqipëria, me një kthesë vendimtare, nuk do të dilte nga kjo gjendja e saj e prapambetur dhe të zinte vend përkrah shteteve borgjeze të Evropës.

Për të fituar për çështjen kombëtare shtresa sa më të gjera të popullsisë, pavarësisht nga ndarja fetare apo krahinore, Abdyl nuk kurseu as mundin fizik, as pasurinë personale. Ai vraponte ku të ishte nevoja, nga Stambolli në Janinë, nga Labëria në Kosovë. Përpjekje të veçanta bëri Abdyl për të mbajtur lidhje me kolonitë shqiptare jashtë Shqipërisë, me

kolonitë arbëreshe të Italisë së Jugut si dhe me udhëheqësit e tyre J. de Rada e Dh. Kamarda.

Duke i dhënë rëndësi të veçantë detyrës për të ndikuar në opinionin publik botëror në favor të çështjes shqiptare, Abdyl Frashëri, gjatë udhëtimit të delegacionit shqiptar në kryeqytetet e Evropës, në pranverë të 1879-ës, mundi të fitonte simpatinë e një vargu personalitetesh evropiane për këtë çështje, midis të cilave edhe të demokratit të shquar italian M. A. Kanini. «Në qoftë se shqiptarët janë më pak të mësuar se grekët, u deklaronte Abdyl gjatë këtij udhëtimi disa përfaqësuesve të shtypit të huaj, kjo nuk është arsye që çështja e tyre të jetë më pak e drejtë dhe më pak e denjë për ndihmë nga ana e popujve të qytetëruar...». Dhe në një rast tjetër ai thoshte: «Evropa na ka njohur deri tani vetëm si njerëz të luftës, tani ajo do të na njohë edhe si njerëz të punës e përparimit». Duke iu drejtuar opinionit publik francez, ai theksonte: «Franca vajton humbjet e krahinave të saj, Alzasës dhe Lorenës. Pse një gazetë franceze i quan atëherë qesharakë shqiptarët që përpiqen të shpëtojnë nga rreziku i një fatkeqësie të tillë?».

Për jehonën e madhe që gjeti veprimtaria e Abdyl Frashërit qysh në fillimet e saj në qarqet e gjera të popullit shqiptar, dëshmon, ndër të tjera, letra dërguar atij, më 31 korrik 1878, prej një grupi shqiptarësh ortodoksë nga Misiri, nënshkruar nga Thimi Th. Kreji. Duke përshëndetur plot entuziazëm iniciativën e marrë nga Abdyl Frashëri për mbrojtjen e çështjes shqiptare, këta shkruanin: «... Gëzim të madh e të papërskrueshëm ndjemë së bashku, posa dëgjuam se me tërë fuqinë dhe me çdo mënyrë veproni për të mirën e kombit tonë. Të gjithë gëzohemi dhe mburremi, si dhe mëmëdheu vetë, mëmë e të tillë burrave... Morëm vesh se nuk reshtni së vepruari me zell të palodhur natë e ditë për të ardhmen e mirë të kombit tonë. E dimë mirë se edhe pengime të shumta keni për të pasur, mirëpo me ngulm e durim keni për t'i mposhtur... për të mirë të kombit dhe kështu, me bashkëpunim të shumë burrave të tillë, do të shkojë kombi ynë në një të ardhme të sigurtë pëparimi».

Në sajë të kësaj pune vetëmohuese dhe të palodhur, në bazë të dashurisë së madhe që ushqente për atdheun dhe për njerëzit e thjeshtë të popullit, Abdyl Frashëri u bë një figurë

e njohur dhe e dashur edhe në krahinat më të largëta, që nga Jugu e deri në Veri e në Verilindje të Shqipërisë. Goja e popullit në krahinat e Lumës e mburrte «Abdyl beg Toskën» po aq sa edhe muza popullore e Labërisë, e cila këndonte:

*«... Ky Avdul bej Frashëri
ç'u përpoq i varfëri,
çkriu tri barrë flori,
shtatë herë në Frëngji...»*

Abdyl Frashëri i qëndroi deri në fund besnik çështjes së atdheut dhe punoi pa u lodhur për të. Kur disa personalitete shqiptare i vinin në dukje se përpjekjet e tij, në fund të fundit, do të ishin të kota, se ai po sakrifikonte më kot pasurinë dhe kishte marrë përsipër vuajtje pa shumë shpresë, Abdyl Frashëri përgjigjej se ai po mbillte sa të mundte, por të tjerë do të korrnin.

Çështja e autonomisë së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare

Deri në mesin e vitit 1880 asnjë nga dispozitat e Traktatit të Berlinit në lidhje me ratifikimin e kufijve të Malit të Zi e Greqisë nuk qe zbatuar. Kjo ishte jo vetëm një goditje për autoritetin e Fuqive të Mëdha nënshkruese të traktatit, por edhe në kundërshtim me interesin e fuqive kryesore, Britanisë së Madhe dhe Austro-Hungarisë, për të zhdukur rrezikun e një konflikti të ri në lidhje me Turqinë, i cili mund të bëhej shkak për ndërhyrjen e Rusisë. Austro-Hungaria kishte arsye të veçanta për ta mbyllur sa më parë çështjen shqiptare. Dy nga qendrat kryesore të lëvizjes shqiptare, Kosova dhe Shkodra, ndodheshin në kufi ose shumë afër Bosnjë-Hercegovinës. Për më tepër, vendosja e garnizoneve austro-hungareze deri afër Mitrovicës u kishte dhënë një hov të madh tendencave austriake në Lidhje. Me këtë krijohej një vatër e re rreziqesh për politikën austro-hungareze në një nga zonat më nevralgjike për të. Për këtë arsye si Londra ashtu edhe Vjena kërkonin me këmbëngulje që të kënaqeshin sa më parë kërkesat territoriale të Cetinës dhe të Athinës sipas Traktatit të Berlinit.

Por propozimi i ri që bëne Fuqitë e Mëdha për lëshimin e

Ulqinit dhe vendimi i Konferencës së Berlinit, i dhanë ushqim të ri zemërimit të masave popullore shqiptare kundër këtyre vendimeve dhe qëndrimit të Portës. Pasoja e këtij zemërimi që rritja e veprimtarisë së komiteteve shqiptare në qytetet e ndryshme.

Në këto kushte ambasadori austro-hungarez në Stamboll nxiste Portën të merrte masa energjike kundër kësaj veprimtarie, që përbënte një rrezik për vetë Portën.

Rritja e lëvizjes shqiptare i detyroi kabinetet e Fuqive të Mëdha të merrnin parasysh këtë faktor, pa të cilin, në fund të fundit, nuk do të mund të zgjidhej një nga problemet e mëdha ndërkombëtare të kohës, të mbetura hapur.

Shenja për një qëndrim më realist në çështjen shqiptare u shfaqën së pari në Londër. Kryeministri i ri liberal Gledston, i cili përpiqej për një sukses të shpejtë para parlamentit, mendonte se zhdukja e vatrave të konfliktit në Ballkan, përgjegjësinë e të cilave ai ia ngarkonte kabinetit konservator të Bikonfildit, mund t'i shërbente këtij qëllimi. Mendimi i tij përforcohej edhe nga ambasadorët britanikë në Stamboll, Lajar (Layard) e më vonë Goshen, të cilët shfaqën mendimin se çështja e kufirit greko-turk dhe turko-malazias do të mund të zgjidhej pa konflikte, po të mos i jepej popullsisë shqiptare për humbjet territoriale një satisfaksion, duke «kënaqur aspiratat e saj legjitime», siç i shkruante Gosheni ministrit të Jashtëm Grenvil (G. L. Granville). I bindur nga ky argumentim, ministri udhëzoi kryekonsullin britanik në Shkodër K. Grin (K. Green) që të studionte mundësinë e një autonomie për vilajetin e Shkodrës.

Duke qenë se në këtë zonë shtriheshin interesat e veçanta të Austro-Hungarisë, Londra vendosi të veprojë në bashkëpunim me Vjenën. Kryekonsulli anglez bashkë me kryekonsullin austro-hungarez Liph (M. Lippich), hartoi një projekt të autonomisë, që do të përfshinte në radhë të parë Malësitë e Shkodrës. Më në fund, Londra dhe Vjena i bindën edhe kabinetet e tjera që të bashkoheshin me notën e 26 qershorit të vitit 1880 për të këshilluar Portën që t'i jepte vilajetit të Shkodrës një administratë autonome.

Një zgjidhje e tillë e pjesshme nuk u përgjigjej as kërkesave të paraqitura deri atëherë, as interesave të popullit shqiptar. Pas mendimit të disa diplomatëve anglezë, kjo zgjidhje

nuk mund të ishte as edhe në interesin e politikës britanike. Ambasadori anglez në Stamboll Goshen, duke parë efektin që kishte bërë qëndresa e shqiptarëve, e quante kombësinë shqiptare «si një element që nuk duhej kapërcyer në çdo kombinacion të ardhshëm politik». Nga pranimi i këtij realiteti, mendonte ambasadori, do të kishte pa dyshim, përfitim edhe politika britanike në përpjekjet e saj për t'i mbyllur shtegun depërtimit të mëtejshëm të influencës së Rosisë në Ballkan. Sepse, siç thoshte ai, «po të formohej një Shqipëri e fortë... ky popull, në pjesën më të madhe mysliman, do të bëhej një burim vështirësish nga më të mëdhatë për vendet sllave e greke...». Në këtë kuptim, Gosheni mendonte se mund të thuhej që parimi i autonomisë së Shqipërisë zgjidhte çështjen lindore. Një Shqipëri e dobët nuk do të mund ta luante këtë rol; prandaj ambasadori ngulte këmbë pranë ministrit të Jashtëm kundër çdo zgjidhjeje të pjesshme dhe shfaqej kundër projektit për t'i dhënë autonominë vetëm Shkodrës.

Diplomatët anglezë u përpoqën të fitonin për këtë pikëpamje të re edhe Vjenën, duke vënë në dukje se ishte edhe në interesin e saj që «Shqipëria e bashkuar» të bëhej «një garanci e mjaftueshme për qëndresën e brendshme dhe qetësinë e Ballkanit». Por mendimi i diplomatëve britanikë përkonte vetëm pjesërisht me atë të Vjenës; interesat e veçanta të Austro-Hungarisë në Ballkan, d.m.th. planet e ekspansionit drejt Jugut, do të pengoheshin nga krijimi i një Shqipërie të bashkuar. Duke u bindur për nevojën e një hapi që t'i pajtonte shqiptarët me lëshimin e Ulqinit, Vjena ngulte këmbë për projektin e autonomisë së Shkodrës dhe në radhë të parë të Malësisë, ku mbizotëronte elementi katolik dhe ku ajo mendonte se, nëpërmjet klerit katolik, do të mund t'i mbante vetë frerët në dorë.

Këto dy pikëpamje, në lidhje me problemin e autonomisë së Shqipërisë, u shfaqën në mbledhjet e «Komisionit evropian për Rumelinë Lindore», i cili, në muajt qershor-gusht 1880, mori në shqyrtim projektligjin mbi administrimin e vilajeteve të Turqisë Evropiane, të paraqitur nga Porta. Projekti, në kundërshtim me nenin 23 të Traktatit të Berlinit, ishte hartuar pa asnjë konsultim me komisionet vendase. Projekti nuk e zbuste aspak centralizimin; përkundrazi, për sa i përkiste Shqipërisë, ai zhdukte edhe ato privilegje që kishin ruajtur me luftë Malësitë. Me këmbënguljen e përfaqësuesit britanik në komision,

Ficmoris, i cili deklaroi se vilajetet shqiptare të Shkodrës, të Janinës dhe të Kosovës kërkonin një vështrim të veçantë, komisioni vendosi t'i rezervonte vetes të drejtën ta shqyrtonte veçan çështjen nëse disa provinca duheshin përjashtuar nga zbatimi i ligjit.

Përfaqësuesi britanik u përpoq më kot të fitonte aprovimin e komisionit për një projekt të tij, i cili parashihte formimin e katër sanxhakëve shqiptarë me qendër në Shkodër, në Prizren, në Elbasan e në Gjirokastrë, që do të bashkoheshin në të ardhmen në një «Shqipëri të madhe». Projekti anglez gjeti kundërshtim të veçantë nga përfaqësuesi rus dhe austro-hungarez. Ky i fundit, bashkë me përfaqësuesin francez, i paraqiti komisionit një projekt të ri, i cili e kufizonte autonominë vetëm në Malësitë. Duke parashikuar krijimin e një rrjeti qeveritarësh të paguar nga Porta, projekti i jepte në të vërtetë qeverisë turke garanci më të mëdha për të mbikqyrur këto zona, që deri atëherë kishin qenë jashtë kontrollit të saj.

Duke mos gjetur përkrahje, diplomatët anglezë nuk ngulën këmbë për projektin e tyre dhe komisioni, me përjashtim të përfaqësuesit rus, më 23 gusht 1880, nënshkroi projektin austro-francez, duke pranuar që në deklaratën përcjellë Portës, të përfshiheshin dy shtesa të propozuara nga përfaqësuesi anglez. Në njërën nga këto këshillohej Porta të respektonte edhe privilegjet e malësive të tjera jashtë vilajetit të Shkodrës, siç ishte Himara. Me tjetrën rimerrej çështja e bashkimit të Shqipërisë në një vilajet, por pa e detyruar Portën për asgjë: «Në qoftë se Porta e Lartë do ta shihte oportune të bashkonte krahinat shqiptare në një vilajet të vetëm, thuhej në deklaratën e komisionit, të nënshkruarit nuk do të kishin asnjë kundërshtim». Por as ky projekt i kufizuar, as edhe vetë projektligji turk mbi administrimin e vilajeteve nuk u detyruan nga sulltani.

Fuqizimi i qëndresës shqiptare në lidhje me çështjen e kufirit greko-turk dhe rritja e lëvizjes autonomiste ndikuan edhe në politikën e qeverisë greke. Ato i dhanë kësaj rast për një aksion diplomatik, që pretendonte ta zgjidhte më mirë çështjen shqiptare.

Duke vazhduar të ngulte këmbë për lëshimin e territoreve në jug të lumit Kalamas dhe, nga ana tjetër, duke theksuar se këmbëngulja e shqiptarëve e bënte të pamundur këtë zgjidhje, qeveria greke parashtroi një projekt që, sipas mendimit

të saj, do ta shmangte luftën, drejt së cilës po e çonte e gjithë kriza. Ishte fjala për krijimin e një monarkie dualiste greko-shqiptare. Kjo ide gjeti për disa kohë edhe përkrahjen e diplomatëve gjermanë. Ministri i Jashtëm Hohenlohe (F. von Hohenlohe) deklaronte në gusht të vitit 1880 se po të formohej nga pjesa shqiptare e vilajetit të Janinës së bashku me Shqipërinë tjetër një shtet më vete dhe të lidhej ky në bashkim personal me Greqinë, do të mund të gjendej një rrugëdalje nga situata pa krye. Konti Seçenji (Széchenyi), ambasador austro-hungarez në Berlin, iu përgjigj se edhe mendimi i tij ishte «më mirë një Shqipëri nën hegjemoninë greke sesa një Shqipëri e shpërdoruar nga Turqia ose një Shqipëri e pavarur». Por këto projekte ishin të perealizueshme sa kohë që shqiptarët vetë nuk donin të dëgjonin për një zgjidhje të tillë.

Lëvizja e gjerë për autonomi që kishte shpërthyer në Shqipëri, gjeti më në fund gjatë pranverës e verës së vitit 1880 njëfarë jehone edhe në qarqet e vetë Portës së Lartë. Këto qarqe filluan të merrnin në shqyrtim mundësinë e krijimit të një province autonome shqiptare. Prapa këtyre masave nuk fshihej vetëm qëllimi për të mashtruar shqiptarët; disa qarqe me influencë të oborrit, midis tyre edhe mareshali Ahmet Muhtar Pasha, dhëndër i sulltanit dhe komandant i korparmatës së Rumelisë, me qëndër në Manastir, kishin krijuar tanimë bindjen se Perandoria nuk do të dilte pa u cenuar, si nga një kryengritje në Shqipëri, ashtu dhe nga një luftë me Greqinë, në të cilën do të përziheshin edhe shtetet e tjera ballkanike.

Këto qarqe mendonin se krijimi i një Shqipërie autonome e të fortë do të ishte rruga më e mirë për të shpëtuar nga humbja e zotërimeve turke në Ballkanin Perëndimor dhe, nga ana tjetër, për t'i mbajtur nën presion shtetet ballkanike. Por kundërshtimi që gjeti ky plan në rrethe të tjera të Portës, të cilat ishin për një kurs të fortë në Shqipëri, u bë shkak që të mos ndiqej më tej.

Çështja e Ulqinit (gusht-tetor 1880)

Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria vazhdonin presionet edhe për ta detyruar Portën që të lëshonte qytetin e Ulqinit ose të zbatonte Marrëveshjen e Prillit, d.m.th. të dorëzonte

Hotin dhe Grudën. Për këtë ato i kërkuan në formë ultimatumit një përgjigje deri më 23 gusht 1880.

Porta lëkundej në qëndrimin e saj. Ajo ishte e gatshme në parim ta lëshonte Ulqinin, që nuk përfaqësonte për të një humbje të madhe, por u gjend përballë qëndresës së vendosur jo vetëm të banorëve të qytetit dhe të rrethit të tij, por edhe të popullsisë së krahinave të tjera të Shqipërisë e veçanërisht të Shkodrës, që kishte lidhje të ngushta ekonomike me Ulqinin. Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha i kanoseshin Portës me një aksion të përbashkët, me një demonstratë të skuadrave të flotës së tyre luftarake përpara bregdetit, për ta detyruar që të zbatonte vendimet e Berlinit.

Për të karakterizuar këtë gjendje të vështirë të Portës, ambasadori gjerman në Stamboll Hacfeld (Hatzfeld) deklaronte se sulltani gjendej midis «Skillës së një veprimi të përgjithshëm (action générale) të Fuqive të Mëdha dhe Karibdit të një kryengritjeje të përgjithshme (insurrection générale) të shqiptarëve»*, kurse ambasadori austro-hungarez i shkruante Vjenës se sulltani kishte më shumë frikë nga kryengritja e shqiptarëve sesa nga demonstrata navale vetë.

Po përveç frikës nga një kryengritje e përgjithshme, Porta kishte edhe një arsye tjetër që e shtynte të mos merrte qëndrim të hapur kundër shqiptarëve. Sulltani edhe kësaj here donte ta përdorte lëvizjen në Shqipëri si mjet për të trembur fuqitë evropiane, në mënyrë që me anë të këtij presioni të siguronte kushte më të mira në lidhje me çështjen e kufirit grek. Në të vërtetë, viset që ishin parashikuar t'i lëshoheshin Greqisë, qoftë nga madhësia e tyre, qoftë edhe nga pikëpamja strategjike, kishin një rëndësi shumë të madhe për Portën sesa Ulqini. Për këtë arsye, sa kohë që ishte hapur kjo çështje, Porta nuk donte ta prishte me shqiptarët, për ndihmën e të cilëve mund të kishte nevojë kundër Greqisë. Duke u kërcënuar se po të shtrëngohej tepër, ajo do t'u linte shqiptarëve plotësisht dorë të lirë kundër Malit të Zi, Porta, në bisedime të fshehta, mundi të merrte premtimin nga Austro-Hungaria se kjo do të ndërhynte për zbutjen e disa kushteve, për shtyrjen e afateve

* Skillat dhe Karibdi — përbindësia mitologjike në dy anët e ngushticës së Mesinës, që vinte në rrezik lundërtarët. Shprehja përdoret për të treguar dy rreziqe njëjloj të mëdha.

dhe për heqjen dorë nga zbarkimi i trupave tokësore në Ulqin, si dhe për të mos e zgjeruar demonstratën navale mbi bregdetin Jon, në lidhje me çështjen e kufirit greko-turk. Megjithatë, Turqia u gjend nën kërcënimin e vazhdueshëm të Fuqive të Mëdha, të cilat deklaruan se do të vinin dorë mbi limanin më të madh të Perandorisë, mbi Izmirin, dhe të ardhurat doganore të tij, në qoftë se ajo do të vazhdonte edhe kësaj herë lodrën e saj dyfaqëshe. E zënë kështu ngushtë, Porta dërgoi në Shkodër në gusht si komisar të jashtëzakonshëm Riza Pashën, të shoqëruar nga 3000 ushtarë, me porosi që të përgatiste dorëzimin e Ulqinit pa arritur në konflikt të hapur me shqiptarët.

Rreziku i ri, që i kanosej një krahine thjesht shqiptare, bëri që të shpërthente një valë e fuqishme zemërimi dhe protestash, veçanërisht në Shqipërinë e Veriut. Dega e Lidhjes në Ulqin ftoi gjithë krahinat e Shqipërisë ta ndihmonin në mbrojtjen e qytetit. Me qindra vullnetarë nga krahinat e Veriut, nga Shkodra e nga Malësia, nga Kosova e nga Tetova, u vunë në rrugë. Në shtator, pranë Ulqinit ishin grumbulluar afro 6 000 luftëtarë, ndërsa në qytetet vazhdonte të qëndronte një garnizon turk.

Porta filloi të vepronte me energji, para së gjithash në Shkodër, ku ishte vatra kryesore e qëndresës. Sulltani vetë u vu në lidhje telegrafike me një komision qytetarësh myslimanë e katolikë, duke kërkuar që të bëhej çmos për ta dorëzuar Ulqinin përpara se të vinte flota ndërkombëtare, gjë që mund të jepte shkas për ndërhyrjen e fuqive në Shqipëri dhe për ndërlikime më të mëdha. Por komisioni, duke marrë parasysh zemërimin e masave të popullit, që nuk dëgjonin kurrsesi ta lëshonin këtë qytet shqiptar në duart e Malit të Zi, u përgjigj se ai ishte i plotfuqishëm ta bënte këtë.

Atëherë qeveria turke filloi të përdorte korrupsionin, duke shpërndarë sasi të mëdha të hollash, për t'i larguar krerët e qytetit, bajraktarët dhe malësorët nga pjesëmarrja në luftë. Për këtë qëllim përdori edhe faktin që në Malësi atë vit kishte pllakosur zia e bukës. Një shumë e konsiderueshme të hollash u shpërnda edhe midis klerit katolik për të ndikuar në këtë drejtim. Aksioni i qeverisë turke u përkrah edhe nga organet e qeverisë austro-hungareze, e cila vuri në lëvizje të gjitha mjetet për të mos i lënë mirditasit dhe malësorët e tjerë kato-

likë të merrnin pjesë në luftë, duke i këshilluar që ta kufizonin veprimin e tyre vetëm në mbrojtjen e Tuzit kundër ndonjë sulmi eventual malazias, ndërsa nuk duhej të shqetësoheshin për Ulqinin mysliman.

Por megjithëkëtë Shkodra dhe Ulqini nuk u qetësuan. Në javën e parë të shtatorit, një skuadër detare ndërkombëtare prej 20 anijesh luftime, me 7 000 këmbësorë detarë dhe me 138 gryka zjarri, kaloi në mënyrë demonstrative gjatë bregdetit shqiptar dhe u vendos në një liman të grykave të Kotorrit, për të ndjekur prej këtej ngjarjet. Në Shkodër u shpall, më 10 shtator 1880, shtetrrethimi dhe 17 batalione turke rrethuan qytetin, zunë gjithë bregun e majtë të Bunës deri në det dhe shpërndanë disa çeta vullnetarësh shqiptarë të grumbulluar në grykën e Mozhurës, që zotëronte rrugën për në Ulqin.

Më 19 shtator lordi Kerr, si përfaqësues i admiralit anglez Sejmor (Seymour), që komandonte skuadrën ndërkombëtare, i dorëzoi Riza Pashës dhe komandantit turk të Ulqinit «somacionin»* për ta dorëzuar Ulqinin brenda tri ditëve. Njëkohësisht u lajmërua qeveria e Malit të Zi për t'i vënë në lëvizje trupat e veta dhe për të marshuar, nën mbrojtjen e flotës, kundër Ulqinit.

Por Riza Pasha nuk kishte ende urdhër të dorëzonte qytetin dhe Mali i Zi nuk pranoi të hynte përsëri në një konflikt me forcat shqiptare në Ulqin.

Nga ana e tyre, mbrojtësit e Ulqinit deklaruan përpara përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Shkodër se ishte «një nder i madh për qytetin e tyre të vogël të vihej në lëvizje flota ndërkombëtare», se ata kishin vendosur të mos dorëzoheshin kurrë me të mirë, por të luftonin kundër kujtdo qoftë, edhe kundër ushtrive turke. Përgjegjësia për këtë, deklarorin ulqinakët, i binte qeverisë së Stambollit. Mendimi i kabinetit anglez që komandanti i Flotës Ndërkombëtare të hynte në bisedime të drejtpërdrejta me udhëheqësit shqiptarë për të shmangur rrezikun e një konflikti, u kundërshtuan me vendosmëri nga ana e Vjenës, e cila shihte në këtë një njohje të tërthortë të Lidhjes Shqiptare nga Fuqitë e Mëdha. Por megjithëse u shkel afati i 23 shtatorit, Flota Ndërkombëtare nuk

* Somacion — një lloj ultimatum, por pa pasojat juridike të këtij.

u vu në lëvizje, duke pritur rezultatet e ndërhyrjeve diplomatike që po zhvilloheshin në Stamboll.

Për të përgatitur një zgjidhje «paqësore», Anglia e veçanërisht Austro-Hungaria e përkrahën Portën në përpjekjet e saj për ta përcarë nga brenda frontin e qëndresës shqiptare. Konsulli anglez e austro-hungarez u përpoqën të bënë për vete një pjesë të udhëheqjes së Lidhjes në Shkodër duke bërë presion që të hiqte dorë nga qëndrimi luftarak. Diplomatat anglezë dhe austriakë përdorën për këtë qëllim premtimin e autonomisë që do t'i jepej Shkodrës dhe deklaruan se kjo do të bëhej vetëm po qe se shqiptarët do të tregoheshin të bindur ndaj vendimeve të Fuqive të Mëdha. Në gjirin e Komitetit të Shkodrës filloi një diskutim lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur më tej. Një grup atdhetarësh mendonin se duhej vazhduar me qëndresën e armatosur, sepse vetëm duke qëndruar me armë në dorë mund të detyroheshin fuqitë të merrnin parasysh kërkesat shqiptare. Çështja e vazhdimit apo jo të qëndresës dha shkas për një diferencim në gjirin e lëvizjes. Për një qëndrim të papajtueshëm ishin veçanërisht elementët intelektualë dhe, siç e vinin në dukje shprehimisht vëzhguesit diplomatikë, vegjëlja e qytetit të Shkodrës. Nga ana tjetër, Hodo bej Sokoli, Prengë Bibë Doda dhe një pjesë e parisë së qyteteve malësore, duke u besuar premtimeve për autonomi, u tërhoqën nga lëvizja. Shenja të tilla u dukën edhe në komitete të tjera. Edhe në Prizren e në Dibër qarqet e moderuara ndërhynë për të mos dërguar vullnetarë në Ulqin.

Njëkohësisht Riza Pasha filloi të ndiqte një kurs më të ashpër kundër atyre që qëndronin në pozitat e luftës. Më 29 shtator ai kërcënoi degën e Lidhjes në Shkodër se, po të mos shpërndahej, do të merrte masa ushtarake kundër saj. Në një mbledhje të madhe, më 30 shtator, dega e Shkodrës deklaroi që e konsideronte të rrëzuar nga detyra komisarit e lartë turk dhe se do të vazhdonte qëndresën në Ulqin. Por ajo nuk ishte më aq e fortë sa të mund ta dëbonte Riza Pashën dhe ushtrinë turke nga Shkodra.

Si pasojë e presionit të ushtruar, një pjesë e vullnetarëve të mbledhur në Shkodër e në Ulqin filloi të shpërndahej.

Kuvendi i Dibrës. Dorëzimi i Ulqinit (tetor-nëntor 1880)

Duke parë se në çështjen e Ulqinit tanimë Turqia kishte kapitulluar përballë presionit të fuqive, atdhetarët shqiptarë mendonin se kishte ardhur koha për të vënë në veprim vendimet e Kuvendit të Gjirokastrës. Fuqitë e Mëdha i kishin dhënë Portës një afat të ri, deri më 30 tetor 1880, për lëshimin e Ulqinit. Për këtë arsye atdhetarët vendosën të thërrisnin përpara kësaj date një kuvend të ri, për të caktuar qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Portës. Mbledhja u bë, më 20 tetor, në Dibër. Përveç grupit autonomist, në të merrnin pjesë edhe shumë feudalë të mëdhenj, të cilët atdhetarët i kishin ftuar me shpresë se do të mund t'i tërhiqnin pas vetes në çështjen e mbrojtjes së Ulqinit. Duke u mbështetur në vendimet e Kuvendit të Gjirokastrës, atdhetarët kërkuan që të veprohej menjëherë për shpalljen e autonomisë dhe për mbrojtjen e Ulqinit. Për këtë qëllim duhej të mobilizoheshin forcat e të gjithë vendit dhe të ziheshin pozitë kryesore që nga Manastiri në Kosovë për të ndaluar ardhjen e ushtrive të reja turke.

Por në gjirin e mbledhjes së Dibrës u shfaqën mosmarrëveshje të thella, të cilat arritën deri në përleshje midis pjesëmarrësve. Një grup i rëndësishëm, në krye të të cilit qëndronin feudalë të mëdhenj reaksionarë dhe elementë turkomanë nga Dibra, nga Shqipëria e Mesme dhe nga Kosova, i shtyrë nga Porta e Lartë dhe nga frika se mos rrezikoheshin pozitë e tij tani që sulltani kishte shfaqur haptazi qëllimin e vet për të likuiduar çështjen e Ulqinit, u shpreh kundër propozimeve. Këta reaksionarë ishin kundër çdo ndihme për Ulqinin dhe kundër shpalljes së autonomisë. Duke u kufizuar në kërkesën për një politikë decentralizimi, ky grup kërkonte që krahinat e Shqipërisë të përjashtoheshin nga ligji i ri i administrimit të vilajeteve. Si pasojë e divergjencave midis grupit të autonomistëve dhe turkomanëve, nga mbledhja dolën dy rezoluta. Rezoluta që mbështetej në vendimet e Gjirokastrës fitoi afërsisht 120 vota, ndërsa rezoluta prapa së cilës qëndronte grupi feudal, fitoi shumicën, 150 vota.

Por përpara se të ndërmerre hapa vendimtarë, grupi i autonomistëve dërgoi në Stamboll një përfaqësues për ta vënë

në dijëni Portën në mënyrë ultimatumi se, në qoftë se kjo nuk do t'u jepte autonominë, shqiptarët do ta shpallnin vetë. Te sulltani dërguan një delegat edhe kundërshtarët e autonomisë për të paraqitur kërkesat e tyre.

Ndërkohë, në Veri ishte ashpërsuar në kulm çështja e Ulqinit. Sulltani tani kishte vendosur të thyente me çdo kusht kundërshtimin e shqiptarëve. Për këtë qëllim ai ndryshoi kabinetin, duke larguar nga posti i tij Abedin Pashë Dinon dhe siguroi një fetva (vendim) nga Sheh-ul-islami, që e quante të lejueshëm «në interes të shtetit» përdorimin e forcës kundër myslimanëve shqiptarë.

Më 25 tetor u largua nga Shkodra Riza Pasha dhe u zëvendësua nga mareshali Dervish Pasha, i njohur si «dorë e fortë», i cili u vu në krye të një ekspedite prej 21 batalionesh. Ai u vesh me fuqi të jashtëzakonshme edhe për vilajetet e tjera të Shqipërisë.

Dervish Pasha hyri në Shkodër në ditët e para të nëntorit. Me të arritur, ai i dha ultimatium Komitetit të Shkodrës që të tërhiqte vullnetarët e vet nga Ulqini dhe pjesërisht ia arriti qëllimit. Njëkohësisht shpalli shtetrrëthimin dhe ngriti gjyqin ushtarak. Por Dervish Pasha ndeshi në qëndresë të vendosur nga ana e masave popullore të qytetit, të cilat morën një qëndrim kërcënues jo vetëm kundër tij, por edhe kundër anëtarëve të degës së Shkodrës, që u shfaqën për lëshime, të trembur nga masat e Portës. Letra anonime iu drejtua Hodo Sokolit, i cili ndërkohë ishte graduar pashë, duke e qortuar që përkrahte aksionin e Portës për të lëshuar Ulqinin.

Më 19 nëntor, në pragun e veprimeve të Dervish Pashës kundër Ulqinit, në Shkodër u formua një komitet i ri, i përbërë nga 12 anëtarë myslimanë e katolikë, midis të cilëve ishin Selim Çoba, Ibrahim dhe Fetah Dragusha, Isuf Sokoli, Filip Çeka etj. Komiteti i ri iu drejtua popullit me thirrjen për të vazhduar luftën dhe për të dërguar forca vullnetare në Ulqin. Me këtë rast myderizi Sali Hylja deklaroi botërisht se nuk ishte «gjynah», por përkundrazi detyrë nderi të rrëmbeje armët e të luftoje për mbrojtjen e vendit, qoftë edhe kundër sulltanit — kalif.

Më 20 nëntor forcat turke u vunë në lëvizje në pika të ndryshme në mënyrë koncentrike kundër Ulqinit. Veprimi i tyre ndeshi në vështirësi për faktin se disa batalione redifësh

(rezervë), të përbërë nga shqiptarë, nuk pranuan të marshonin kundër vëllezërve të tyre.

Kolona turke e nisur nga Pulaj, fshat në breg të Bunës, ndeshi që në fillim në qëndresën e forcave shqiptare dhe u detyrua të ngadalësonte marshimin derisa u vu në lëvizje edhe kolona kryesore, në krye të së cilës ishte Dervish Pasha, që mori rrugën për në Ulqin nëpër grykën e Mozhurës.

Në mbrojtjen e Ulqinit merrnin pjesë gjithsej 3 000 veta, banorë të qytetit dhe vullnetarë nga Shkodra e nga Malësitë që kishin mundur të çanin bllokadën. Ata ishin nën komandën e Mehmet Becit dhe Mehmet Gjylit nga Ulqini si dhe të Isuf Sokolit nga Shkodra dhe kishin zënë pozitë kryesore për t'u prerë rrugën forcave turke dhe malazeze. Forcat turke kishin një epërsi numerike shumë të madhe, aq më tepër që kishin me vete edhe artileri fushore. Ndeshja kryesore u bë afër fshatit Kleshë në grykën e Mozhurës. Megjithëse aty nuk ishin më se 1 000 veta, shqiptarët, nën komandën e Isuf Sokolit, kishin krijuar një varg të dyfishtë llogoresh dhe mundën t'i sprapsnin për disa orë kolonat e Dervish Pashës. Por me ardhjen e forcave të reja turke dhe veçanërisht nën efektin shkatërrimtar të artilerisë, vullnetarët shqiptarë u thyen dhe komandanti i tyre Isuf Sokoli u plagos për vdekje.

Ndërkohë, qyteti i Shkodrës po jetonte çaste alarmi të madh. Ndonëse ishte shpallur shtetrrëthimi dhe elementët e moderuar ishin tërhequr nga lufta, populli mbylli pazarin. Një kolonë prej 3000 shkodranësh të armatosur u vu në rrugë, por, duke qenë e detyruar të kërkonte shtigje të fshehta për kalimin e bllokadës, ajo nuk mund të arrinte me kohë për të ndihmuar mbrojtësit e Ulqinit. Pas shpërndarjes së forcave shqiptare para Ulqinit, kolona e komanduar prej Dervish Pashës, në shtabin e të cilit ndodhej edhe Hodo Pashë Sokoli, më 23 nëntor 1880 hyri në Ulqin dhe më 26 nëntor ua dorëzoi qytetin ushtrive malazeze, që iu afruan qytetit vetëm pasi i thirri komanda turke.

Me këtë mori fund çështja e Ulqinit dhe përgjithësisht çështja e kufijve veriorë, që kishte mbajtur në këmbë për një kohë të gjatë jo vetëm Shqipërinë, por edhe diplomacinë evropiane. Si pasojë e veprimit përçarës të Portës dhe të Fuqive të Mëdha si dhe të qëndrimit të lëkundshëm të një pjese të udhëheqjes, çështja e Ulqinit nuk përfundoi në një aksion

të përgjithshëm, që do të siguronte bashkë me mbrojtjen e qytetit edhe kushte për arritjen e autonomisë. Megjithatë, ngjarjet e Ulqinit patën një jehonë të gjerë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në opinionin publik përparimtar të Evropës, të cilit i bëri përshtypje të madhe qëndresa e gjatë e shqiptarëve dhe vullneti i patundur për të mbrojtur vendin e tyre nga intrigat e Fuqive të Mëdha. Zëra proteste kundër lëshimit të Ulqinit u ngritën në shtypin dhe në parlamentet e disa vendeve të Evropës si, p.sh., të Anglisë dhe të Italisë. Në një broshurë të botuar frëngjisht në këtë kohë nga një shqiptar anonim thuhej plot zemërim: «Evropa, me gjithë parimet e saj të reja, me gjithë doktrinën socialiste dhe egalitare, ka humbur çdo ndjenjë për drejtësi dhe moral. Provë është e famshmeja demonstratë para Ulqinit... Përse kërkojnë që Shqipëria të paguajë për Turqinë... përse nuk dërgojnë një flotë në Stamboll për ta detyruar Portën të paguajë ajo për drurin që hëngri nga Mali i Zi?».

5. LUFTA E LIDHJES KUNDËR TURQISË

Lidhja e re e Prizrenit. Qeveria e Përkohshme

Dorëzimi i Ulqinit, me gjithë dëshpërimin që shkaktoi në popullsinë shqiptare, i dha fund agjitacionit të gjatë që ishte zhvilluar në Shqipëri për një luftë mbrojtëse kundër Malit të Zi. Tani vëmendja u drejtua kryesisht në marrëdhëniet me Turqinë, te çështja e autonomisë.

Kërkesat që ishin ngritur disa herë me radhë dhe së fundi në Kuvendin e Dibrës për autonominë e Shqipërisë, Porta e Lartë i kishte lënë pa përgjigje. Ajo i kishte mbajtur shqiptarët me shpresën se do t'i aprovonte, sa kohë që kishte pasur frikë nga një konflikt ndërkombëtar. Por tani që konflikti me Malin e Zi ishte mbyllur dhe me këtë ishte hapur rruga për një zgjidhje të konfliktit me Greqinë në favor të Portës, Stambolli e shihte të nevojshme të merrte masa të rrepta për t'i dhënë fund lëvizjes autonomiste në Shqipëri.

Për këtë arsye Porta ngarkoi Dervish Pashën jo vetëm me misionin që t'i dorëzonte Malit të Zi Ulqinin, por edhe të shpërndante Lidhjen Shqiptare dhe të shtypte lëvizjen në Shqipëri.

Pasi përfundoi çështjen e Ulqinit, Dervish Pasha filloi nga arrestimet brenda në qytetin e Shkodrës. Ai arrestoi dhe internoi me dhjetëra aktivistë të degës së Shkodrës, midis të cilëve edhe dy ish-komandantët e Lidhjes, Hodo Pashë Sokoli dhe Prengë Bibë Doda, që kishin shkaktuar dyshimet dhe mosbesimin e sulltanit, me gjithë qëndrimin e tyre të moderuar e të lëkundshëm. Në qytetin e në rrethin e Shkodrës u vendos një regjim terrori.

Qeveria e Stambollit e kuptoi se shtypja e lëvizjes në Shqipëri kërkonte forca më të mëdha se ato që kishte me vete Dervish Pasha, prandaj në fillim të dhjetorit 1880 e thirri mareshalin në Stamboll për të hartuar planin e një ekspedite të re kundër Shqipërisë.

Veprimet e qeverisë turke, shtypja e përgjakshme e qëndresës së shqiptarëve në Ulqin, fushata e internimeve dhe e burgimeve në vend të amnistisë së premtuar, orvatjet e Dervish Pashës për të nxjerrë rekrutë dhe taksa të reja me anë ekspeditash ndëshkimore, të gjitha këto bashkë me gjendjen e vajtueshme ekonomike, i dhanë një hov të veçantë luftës për autonomi. U bë tanimë e qartë se shpresat e fundit për të realizuar autonominë në mënyrë paqësore kishin dështuar. Fakti që Porta e Lartë nuk u dha asnjë përgjigje kërkesave të mbledhjes së Dibrës, u hoqi edhe argumentin e fundit atyre që predikonin taktikën e pritjes. Në këtë mënyrë u krijuan kushtet që autonomistët të viheshin në krye të lëvizjes shqiptare dhe të kalonin në veprim.

Në kohën kur Shkodra ndodhej nën shtetërrethim dhe në Shqipërinë e Jugut, për arsye të konfliktit me Greqinë, ishin përqendruar afro 50 mijë ushtarë turq, fusha kryesore dhe vendimtare e ngjarjeve në Shqipëri u bë Kosova.

Fill pas dorëzimit të Ulqinit, në dhjetor të 1880-ës, kudo në vilajetin e Kosovës, ku forcat ushtarake turke ishin të pakta, u bënë një varg sulmesh kundër administratës turke. Në Prizren, ku ishte dëbuar qysh më parë mytesarifi Ahmet Hilmi Pasha, populli nuk lejoi pasardhësin e dërguar nga Porta të hynte në qytet. Veprime të drejtuara kundër administratës turke ndodhën edhe në qendra të tjera të vilajetit si në Shkup,

në Tetovë, në Kaçanik, në Pejë, në Gjakovë. Për të shtënë në dorë drejtimin e kësaj lëvizjeje, rrethet patriotike riorganizuan Lidhjen e Prizrenit, por tani si organ për realizimin e autonomisë. Në komitetin e ri që u krijua, pozitë mbizotëruese kaluan në duart e elementëve autonomistë të vendosur, si myderiz Omer efendiu, Sulejman Vokshi, Shuaip agë Spahiu, Ali Ibra etj. Në muajin dhjetor 1880 në Prizren arriti fshehurazi nga Stambolli, ku mbahej nën mbikëqyrje, Abdyl Frashëri, me një grup përfaqësuesish të Shqipërisë së Jugut. Komiteti i Lidhjes e shpalli tani veten si «kuvernë e përdorme» (qeveri e përkohshme — red). Në Prizren u vendos një administratë e përbërë nga nëpunës shqiptarë që ishin anëtarë të komitetit drejtues të Lidhjes.

Vëmendja kryesore e komitetit të ri u përqendrua në organizimin e forcave ushtarake dhe në zgjerimin e pushtetit të Lidhjes në krahinat e tjera të vendit. Komiteti bëri përpjekje për të ngritur njësi ushtarake të rregullta, krijoi reparte të lëvizshme, të cilat, ndryshe nga repartet që luftonin vetëm në krahinat e tyre, do të shërbenin ku ta lypte nevoja.

Forcat e armatosura mbaheshin në sajë të kontributeve të mëdha vullnetare në të holla që jepte popullsia. Kështu, vetëm qyteti i Gjakovës dha për këtë qëllim më tepër se 20 000 lira ari.

Mjaft krahina si Luma, Gucia, Gjakova dhe Peja, që i kishin dëbuar autoritetet turke, u bashkuan menjëherë me Prizrenin. Nga ana tjetër, repartet e Lidhjes të komanduara nga Sulejman Vokshi, sulmuan dhe shtinë në dorë Shkupin më 4 janar, Prishtinën më 18 janar dhe Mitrovicën më 25 janar 1881 dhe më vonë Vuçiternin e Gjilanin. Në të gjitha këto qendra u vendos autoriteti i Lidhjes; nëpunësit turq kur nuk dëboheshin, lejoheshin të qëndronin, me kusht që të mos përziheshin në punët e administratës. Garnizonet e dobëta turke u detyruan të mbylleshin në pika të caktuara, nga të cilat nuk mund të largoheshin pa dorëzuar më parë armët. Forcat e Lidhjes zunë urat dhe hekurudhën; shoqëria austriake e trenave me qendër në Shkup mori urdhër të mos transportonte trupa dhe municione për ushtrinë turke. Autoriteti i Lidhjes u shtri edhe në Kumanovë, në Tetovë, në Gostivar e në Dibër. Në Dibër dëbimi i nëpunësve turq hasi në kundërshtimin e feudalëve përkrahës të Portës, të cilët kryesoheshin nga Sa-

dik Pasha. Pas një përlëshjeje të përgjakshme, në të cilën morën pjesë dy batalione turke të ardhura nga Manastiri, përkrahësit e Lidhjes, me ndihmën e reparteve të dërguara nga Prizreni, e dëbuan më në fund mytesarifin dhe u bashkuan me qeverinë e përkohshme. Nëpunësit turq në administratën e provincave, në mexhiliset dhe në gjykatat u zëvendësuan me njerëz që ishin anëtarë të Lidhjes dhe që gëzonin besimin e popullit.

Si pasojë, në qytetet dhe në fshatrat u vendos qetësi e plotë; taksat që shërbenin për mëkëmbjen e ushtrisë derdeshin pa shtrëngesë në arkën e Lidhjes. Rëndësi të veçantë organet e Lidhjes i dhanë çështjes së krijimit të marrëdhënieve të mira me të krishterët e vendit. Edhe vetë vëzhguesit diplomatikë të huaj u detyruan të pranonin se shqiptarët po jepnin me këtë një provë të aftësisë së tyre për një jetë shtetërore të pavarur. Në të njëjtën kohë, emisarët e Lidhjes vepronin në Mirditë dhe në Malësinë e Mbishkodrës për të bashkuar popullsinë e këtyre viseve me qeverinë e Prizrenit.

Pasi u përforcua në një varg krahinash të Veriut dhe të Lindjes, qeveria po përgatiste forca për të kaluar në Shqipërinë e Jugut, për të dëbuar autoritetet turke dhe për të vendosur atje administratën shqiptare.

Me këto veprime lëvizja po merrte një karakter të përgjithshëm shqiptar dhe po vihej në rrugën e realizimit të autonomisë me anë të një lufte aktive kundër Turqisë.

Qeveria e përkohshme ndiqte me vëmendje ngjarjet që zhvilloheshin në krahinat e tjera të Shqipërisë, veçanërisht në Jug. Acarimi në kulm i marrëdhënieve greko-turke në çështjen e kufirit ishte një rrethanë e favorshme për përforcimin e mëtejshëm të qeverisë së re, sepse largoi për disa kohë vëmendjen e Portës nga ngjarjet në krahinat verilindore të Shqipërisë.

Në këto rrethana qeveria e përkohshme mendonte të bënte hapa të mëtejshëm për konsolidimin e autonomisë. Ajo njoftoi se në fund të marsit në Prizren do të mblidhej një kuvend i përgjithshëm, në të cilin u ftuan të merrnin pjesë edhe krahinat që nuk ishin përfshirë ende nën pushtetin e saj. Kuvendi do të shqyrtonte para së gjithash çështjen e marrëdhënieve me Portën. Tani atdhetarët mendonin të shkonin një hap përpara në këtë çështje. Shqipëria duhej të bëhej një shtet

që do ta njihte sulltanin vetëm si sovran e kalif, duke i paguar një tribut, ashtu siç kishte bërë Serbia, ose siç bënte tani Bullgaria. Sulltanit do t'i përkiste vetëm e drejta të emëronte presidentin e shtetit të ri. Në qoftë se Porta nuk do të pranonte një zgjidhje të tillë, kuvendi do të shpallte pavarësinë.

Mbi përpjesëtimet e lëvizjes dhe qëllimet e saj hedh dritë një letër që Sami Frashëri i dërgoi pikërisht në kohën e zhvillimit të këtyre ngjarjeve (20 shkurt 1881) Jeronim de Radës, për ta vënë në dijeni të kthesës që kishin marrë punët në gjirin e Lidhjes dhe përgjithësisht në Shqipëri. Në këtë letër Samiu shkruante: «Lidhja e shqiptarëve, që ka kërthizën në Prizren, në Gegëri, ka kërkuar shumë herë që nga tre vjet e tëhu bashkimin e Shqipërisë në një provincë me autonomi; po mbretëria gjer më sot e kishte gënjyer me fjalë. Këtë herë shqiptarët e kuptuan fort mirë që mbretëria nuk do të bënjë gjë kurrë për ta, edhe Lidhja e Prizrenit pa nevojë të bashkonjë Shqipërinë e ta bënjë një me autonomi, e mbase me shkëputje fare, pas punës. Kështu Lidhja mori emrin e kuvernës së përdorme dhe përzuri kuvernatorët turq nga gjithë vilajeti i Kosovës dhe nga Prizreni, nga Gjakova, nga Tetova, nga Dibra etj. 10 000 shqiptarë të armatosur kanë zënë Ysqypnë (Shkupin — red.), edhe udhën e hekurtë, 10 000 të tjerë po bëhen gati për t'u unjur në Toskëri. Për pak kohë do të dëgjoni një ngritje (kryengritje — red.) të madhe në Shqipëri». Atdhetarët filluan të mendonin edhe mbi formën e qeverisë së shtetit të ardhshëm shqiptar. Mendimin e vet mbi këtë çështje Samiu e shprehte me këto fjalë: «Në u bëftë dot Shqipëria më vehte, nuk do të kemi nevojë për princër as të krishterë as muhamedanë, që të na rjepin e të na pinë gjaknë. Vendi ynë mund edhe do të kuvernohet (qeveriset — Red.) prej një fare dhimokratie, prej pleqve...»

Me këtë emër të marrë nga administrata e Malësive, Samiu nuk mendonte ta kthente jetën politike në Shqipëri në forma tanimë të kapërcyera të regjimit patriarkal të Malësive. Përkundrazi, si më parë Zef Jubani, ashtu edhe Samiu mendonte se Shqipëria duhej të bënte një kthesë drejt një regjimi demokratiko-borgjez. Dhe në qoftë se gjyqet vendase kishin filluar të përdornin ligjet e sheriatit ose të drejtën zakonore, kjo ndodhte, siç deklaronin atdhetarët, vetëm për arsye të prapambetjes kulturore të popullsisë. Administrata e re do të

mbështetej mbi parime të reja përparimtare të Evropës.

Ngjarjet e Kosovës dhe të Dibrës patën një jehonë të gjerrë edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë së Veriut e të Jugut, ku autoriteti i Lidhjes nuk arriti të shtrihej. Megjithëse në krahinën e Shkodrës qëndronin gjithnjë forca të mëdha turke dhe ishte në fuqi shtetrrëthimi, qarqet përparimtare, të përbëra nga intelektualë, nëpunës, tregtarë ose edhe oficerë shqiptarë në shërbim të Turqisë, rifilluan përpjekjet për të rimëkëmbur degën e Lidhjes në Shkodër, që ishte shpërndarë nga Dervish Pasha.

Qeveria e Stambollit nuk kishte mundësi ta shtypte lëvizjen në Shqipëri me forca ushtarake sa kohë që nuk ishte zgjidhur konflikti greko-turk. Hëpërhë ajo u përpoq ta mbyste atë me anën e heshtjes, duke mos lënë të dilte jashtë kufijve të saj asnjë lajm mbi ato që po ndodhnin në Shqipëri.

Zhvillimi i ngjarjeve në Shqipëri shqetësoi në mënyrë të veçantë diplomacinë austro-hungareze, e cila bëri përçapje pranë qeverisë turke, duke e këshilluar që t'i jepte sa më parë fund konfliktit kufitar me Greqinë dhe t'i grumbullonte forcat e saj në Kosovë për të shtypur Lidhjen, e cila ishte bërë një rrezik jo vetëm për Turqinë, por edhe për Austro-Hungarinë.

Zgjidhja e konfliktit greko-turk dhe lëvizja shqiptare (shkurt-mars 1881)

Në pamundësi të një veprimi të drejtpërdrejtë dhe për të fituar kohë, Porta përpiqej t'i mbante shqiptarët me fjalë se kërkesat e tyre do të merreshin parasysh, porse nuk ishte «patriotike» të veprohej për autonominë sa kohë që «atdheu» ishte në rrezik. Për një propagandë në këtë drejtim Porta mobilizoi të gjithë njerëzit e saj në Shqipëri.

Qëndrimi intrasigjent i Turqisë, e cila nuk bënte lëshime veçse në disa pika nga ana e Thesalisë, dhe këmbëngulja e Greqisë për zbatimin e plotë të vendimit të Konferencës së Berlinit, e çuan çështjen deri në pragun e shpërthimit të një lufte. Qeveria greke filloi mobilizimin e ushtrisë. Situata i alarmoi përsëri Fuqitë e Mëdha dhe i detyroi të mendonin

për rishikimin e vendimit të Konferencës së Berlinit, duke marrë parasysh rezistencën këmbëngulëse të shqiptarëve. Jo vetëm Vjena, por edhe Berlina e rishikuan në disa pika qëndrimin e tyre ndaj kësaj çështjeje. Të dyja palët ishin tani të mendimit se nga tokat që do t'i kalonin Greqisë, duheshin përjashtuar viset shqiptare, d.m.th. Çamëria, duke përfshirë edhe Prevezën. Bismarku mendonte se qëllimi i vendimit të Konferencës së Berlinit kishte qenë forcimi i Greqisë kundër Bullgarisë, porse, përkundrazi, «e ardhmja e Greqisë do të ishte e kërcënuar, thoshte kancelari gjerman, po të përfshinte ajo (Greqia — red.) një pjesë tepër të konsiderueshme të kësaj race luftarake të panënshtuar të shqiptarëve, që ajo as do t'i zotëronte, as do t'i asimilonte». Si shpërblim për këtë lëshim, sipas mendimit të Bismarkut, Greqisë mund t'i jepej Kreta. Por ky projekt mbeti pa u realizuar, për arsye të kundërshtimit që gjeti jo vetëm nga ana e Turqisë, por edhe nga Britania e Madhe. Nga ana tjetër, edhe Greqia nuk dëgjonte të hiqte dorë nga Preveza, të cilën e quante si pikën vendimtare që i siguronte ndikimin në Shqipërinë e Jugut.

Porta kishte mbajtur deri tani një qëndrim të papërkulur, sepse e dinte që kishte me vete përkrahjen e shqiptarëve. Por me kalimin e kohës për qarqet shqiptare u bë e qartë se ata me qëndrimin e tyre kishin bërë deri tani në të vërtetë lodrën e Portës, pa arritur të siguronin prej saj njohjen e autonomisë. Në këto rrethana, në qarqet e atdhetarëve lindi mendimi se tanimë ishte rasti i fundit për të përfitur nga gjendja dhe për të detyruar Portën dhe Fuqitë e Mëdha të njihnin autonominë e Shqipërisë. Por kjo nuk mund të bëhej duke mbajtur një qëndrim pritës, i cili i kishte dhënë mundësinë Portës ta shpërdoronte lëvizjen shqiptare për qëllimet e veta. Udhëheqësit shqiptarë, midis të cilëve edhe Abdyl Frashëri, mendonin se po të përfitonin shqiptarët nga konflikti që po përgatitej dhe po të bashkoheshin me kundërshtarin e Turqisë, ata do të detyronin Portën dhe Fuqitë e Mëdha të pranonin autonominë e Shqipërisë.

Këtij qëllimi i shërbenin përgatitjet për një kryengritje të madhe në gjithë Shqipërinë dhe bisedimet që filluan atdhetarët për të arritur një marrëveshje me qarqet qeveritare greke.

Të dërguar shqiptarë, midis tyre Myslim Gjoleka, vizituan disa herë Athinën dhe Korfuzin për të caktuar kushtet e bashkëpunimit. Marrëveshja që u arrit më në fund, mbështetej në njohjen dhe në respektimin e integritetit tokësor dhe të ekzistencës së një shteti shqiptar autonom ose të pavarur, i cili do të përfshinte edhe krahinat shqiptare të vilajetit të Janinës. Të dyja palët merrnin përsipër të koordinonin veprimet e tyre luftarake. Greqia, nga ana e saj, zotohej tu jepte shqiptarëve ndihmë në armë dhe financiare.

«Interesi i atdheut që më i fortë se antipatia e shqiptarëve për politikën greke», kështu e komentonte politikani italian M.A. Kanini kthesën që po zhvillohej në orientimin e politikës shqiptare. Por rrjedhimi i ngjarjeve tregoi se qeveria greke këtë aleancë nuk e konsideroi veçse si një mjet presioni kundrejt Turqisë dhe Fuqive të Mëdha. Ajo nuk e kishte ndryshuar, veçse për sy e faqe, orientimin e saj negativ në lidhje me çështjen shqiptare.

Rrjedha që po merrnin në mars të vitit 1881 punët në Shqipëri, rreziku i një kryengritjeje të përgjithshme shqiptare dhe aleanca shqiptaro-greke, të cilën qeveria greke me qëllim nuk e mbajti të fshehtë, të gjitha këto ndikuan mbi zhvillimin e konferencës greko-turke që kishte filluar punimet në këtë kohë në Stamboll. E trembur nga rreziku i humbjes së Shqipërisë dhe nën presionin e Anglisë dhe të Austro-Hungarisë, Porta e Lartë, më 24 mars 1881, pranoi në parim marrëveshjen për caktimin e vijës së re të kufirit me Greqinë. Sipas kësaj marrëveshjeje, kufiri i ri, duke ndjekur deri diku vijën e lumit Selevria, i jepte Greqisë pjesën më të madhe të Thesalisë bashkë me qendrën e saj kryesore, Larisën. Në pjesën perëndimore, në vilajetin e Janinës, Turqia nuk lëshoi veçse një pjesë shumë të vogël, qytetin e rrethin e Artës në jug, në gjirin e Prevezës.

Me këtë mënyrë u mbyll, më në fund, një çështje që kishte mbajtur në alarm për një kohë të gjatë Gadishullin Ballkanik dhe vetë Fuqitë e Mëdha,

Tani kërkesat e Greqisë deri diku ishin kënaqur me marrëveshjen e nënshkruar, qeveria greke nuk kishte më interes ta respektonte marrëveshjen me shqiptarët. Ndryshe mendonte një krah intransigjent i qarqeve politike greke. Në kundër-

shtim me qeverinë, ai ngulte këmbë se nuk duhej ratifikuar marrëveshja e Stambollit, por duhej të vazhdonte lufta për të siguruar një fitim maksimal, sa kohë që shqiptarët vazhdonin luftën e tyre. Prandaj marrëveshja greko-turke, e arritur më 24 mars, ishte akoma e pasiguruar.

Situata e krijuar në Shqipëri, rreziku i shkëputjes së kësaj, nevoja e mbylljes përfundimtare të konfliktit me Greqinë, të gjitha këto e shtynin Portën të nxitonte të merrte masa kundër Qeverisë së Përkohshme në Prizren.

Shpërthimi i konfliktit të armatosur me Turqinë

Me marrëveshjen turko-greke qeveria e sulltanit i kishte tani duart e lira për t'u marrë me çështjen shqiptare. Me kthimin e Dervish Pashës nga Shqipëria, në qarqet rreth sulltanit mbizotëroi ai grup që kërkonte ndjekjen e një politike të dorës së fortë në Shqipëri. Dervish Pasha mendonte se mund të kryente punë me një operacion të rrufeshëm.

Që në fillim të marsit Porta kishte filluar nga përgatitjet ushtarake kundër Shqipërisë. Në Selanik u grumbulluan forca të rëndësishme, përsëri nën komandën e Dervish Pashës, për një ekspeditë kundër Shqipërisë.

Ashpërsimi i qëndrimit të Turqisë kundrejt Lidhjes i dha shkas gjallërimit të veprimtarisë armiqësore të feudalëve reaktionarë të vendit, që shihnin tani mundësinë për të përmbysur autoritetin e Lidhjes, së cilës i qenë nënshtruar me pahir. Të parët që u hodhën në veprim qenë feudalët e Dibrës me Sadik Pashën në krye, të cilët organizuan një atentat kundër Abdyl Frashërit, që ndodhej në këtë kohë në Dibër. Abdyl shpëtoi, por dy shoqërues të tij mbetën të plagosur. Komiteti i Lidhjes u detyrua të merrte masa për t'i bërë ballë opozitës feudale që po forcohej. Një varg pashallarësh u internuan si kundërshtarë të Lidhjes, midis të cilëve Hasan Pashë Tetova, Ali Pashë Draga, Ago Pashë Mitrovica etj.

Më 22 mars 1881 arritën përpara Shkupit repartet e para osmane. Me ndihmën e garnizonit të vogël që kishte mbetur i bllokuar në qytet dhe me përkrahjen e disa elementëve të pa-

risë feudale dhe turkomane të qytetit, trupat turke e kapën në befasi Komitetin e Lidhjes dhe e pushtuan Shkupin përpara se të mund të organizohej ndonjë qëndresë. Me pushtimin e këtij qyteti, që ishte një qendër e rëndësishme hekurudhore, ushtria turke shtiu në dorë një pozitë kyç për zhvillimin e mëtejshëm të operacioneve ushtarake në vilajetin e Kosovës. Më 7 prill arriti këtu edhe vetë Dervish Pasha me forcat kryesore, të organizuara në 24 batalione, që arrinin gjithsej mbi 15 000 veta. Në qytet, ku ishte shpallur qysh më parë shtetrrrethimi, filloi një valë arrestimesh.

Pas Shkupit, objektivi kryesor i Dervish Pashës ishte të siguronte nënshtrimin e gjithë Fushës së Kosovës. Për këtë qëllim trupi i ekspeditës marshoi në drejtim të Ferizajt, të cilin e mori më 16 prill, pa ndeshur ndonjë qëndresë të madhe. Marshimin prej Shkupit në Ferizaj Dervish Pasha u përpoq ta shndërronte në një parakalim plot bujë të forcave turke, me qëllim që të mbillte panik në radhët e popullsisë vendase. Në krye të kolonave ushtarake mbahej një trekëmbësh dhe gjatë marshimit topat e artillerisë fushore qëllonin fshatrat që ndodheshin gjatë rrugës. Shtabin e Dervish Pashës e shoqëronte trupi i gjykatës ushtarake, që jepte vendime aty për aty. Në Ferizaj Dervish Pashës iu dorëzuan një varg pashallarësh e bejlerësh shqiptarë, që kishin marrë pjesë në Lidhje. Midis tyre ishin Iljaz Pashë Dibra, Ali Pashë Gucia etj.

Pas marrjes së Ferizajt, objektivi i parë i trupave turke u bë qendra e lëvizjes, Prizreni. Ndërkohë, Lidhja e Prizrenit kishte dhënë kushtimin për të rrokur armët dhe për t'u hedhur në luftë kundër trupave turke që po afroheshin. Njëkohësisht ajo u drejtoi një memorandum ambasadorëve të shteteve të mëdha në Stamboll, me anën e të cilit protestonte kundër Portës për dërgimin e fuqive ushtarake dhe kërkonte ndërhyrjen e tyre për të ndaluar ekspeditën ndëshkimore. Lidhja deklaronte edhe një herë se kërkesa e saj ishte që t'u jepej shqiptarëve autonomia, si mjet për t'u vënë në rrugën e qytetërimit dhe për të siguruar të drejtat e tyre kombëtare.

Pas thirrjes së parë të Lidhjes, në afërsitë e Prizrenit, u mblodhën afro 6 mijë veta, por njëkohësisht filluan të ndiheshin pasojat e qëndrimit armiqësor të krerëve feudalë. Nga disa krahina vullnetarët e grumbulluar nuk u lanë të shkonin

në Prizren. Rreth 3 mijë veta, nën komandën e Mic Sokolit nga Krasniqja dhe Ali Ibrës nga Gashi, zunë vend në afërsitë e Shtimljës, ndërsa të tjerët, nën komandën e Sulejman Vokshit, zunë grykën e Cernalevës pranë fshatit Slivovë. Këto ishin dy pozicione, pranë të cilave duhej të kalonte ushtria turke për të shkuar në Prizren.

Prej 16 deri më 20 prill Dervish Pasha organizoi një varg sulmesh të vogla, me qëllim që të orientohej më mirë dhe të fitonte një ide më të saktë mbi pozitat dhe forcat e shqiptarëve. Më 21 prill, në mëngjes, hynë në veprim forcat kryesore të ushtrisë turke. Të ndara në dy kolona, ato e filluan sulmin kundër vijës mbrojtëse të shqiptarëve në Shtimlje. Forcat shqiptare, ndonëse kishin pozita kodrinore jo shumë të përshatshme për mbrojtje, e pritën me një zjarr të dendur sulmin e ushtrisë turke dhe e ndalën për disa kohë përparimin e saj. Atëherë ndërhyri zjarri i baterive të artillerisë fushore të Dervish Pashës, që pati pasoja të rënda për forcat shqiptare të armatosura keq, kryesisht me pushkë me çark. Kjo i detyroi shqiptarët të tërhiqeshin drejt grykës së Cernalevës, pranë fshatit Slivovë. Këtu, në pozita më të mira, u grumbulluan forcat kryesore nën komandën e Mic Sokolit, të Binak Alisë dhe të Sulejman Vokshit. Më 22 prill u zhvillua ndeshja e dytë dhe vendimtare. Luftimet zgjatën 5 orë dhe shkaktuan humbje të rënda për të dyja palët. Turqit patën 1800 të vrarë, kurse shqiptarët 800 veta. Në Slivovë shqiptarët luftuan me heroizëm, duke u përleshur trup me trup me armikun. Për të ngritur moralin e bashkëluftëtarëve, të tronditur nga zjarri i artillerisë turke, Mic Sokoli u hodh mbi grykën e një topi dhe u vra duke e mbuluar atë me trupin e tij. Por, më në fund, përballë trupave armike shumë më të mëdha në numër, forcat shqiptare u detyruan të tërhiqeshin drejt perëndimit. Ushtria turke u soll me egërsi të madhe. Luftëtarët shqiptarë, që u zunë robër në fushën e luftës, u ekzekutuan në vend.

Një ndeshje e tretë ndodhi në fshatin Dule, ku forcat shqiptare prej 2 mijë vetash, që ishin nisur për t'i ardhur në ndihmë Slivovës, u munduan më kot të ndalnin përparimin e kolonave turke.

Përpjekja e fundit u zhvillua në Portat e Prizrenit, në Suharekë, tri orë larg qytetit. Por edhe këtu forcat shqiptare

u detyruan të tërhiqeshin, duke marrë rrugën drejt Gjakovës. Më 23 prill, në mesditë, trupat turke hynë në Prizren. Qyteti u bllokua nga të gjitha anët për të mos lejuar të vinin aty forca të reja shqiptare. Njëkohësisht u shpall shtetrrëthimi dhe filluan të bëheshin arrestime në masë. Nga gjyqi ushtarak që nisi nga veprimi, u dënuan me qindra luftëtarë të rezistencës. Dervish Pasha, nga ana tjetër, i fali pashallarët e bejlerët që iu dorëzuan atij.

Shpërndarja e Lidhjes së Prizrenit

Pas pushtimit të Prizrenit, qendër e fundit e rezistencës u bë Gjakova. Këtu u mbledhën udhëheqësit e Komitetit të Lidhjes, Sulejman Vokshi, myderizi Omer efendi, Abdyl Frashëri si dhe krerët e malësorëve. Kjo bërthamë e udhëheqjes së lëvizjes u përpoq të organizonte forca të reja për luftën kundër Portës.

Forcat shqiptare për disa kohë i prapsën me sukses orvatjet që ndërmoren trupat e Dervish Pashës për t'u futur në krahinën e Gjakovës.

Komandantit turk iu desh të priste ardhjen e 10 batalioneve të tjera nga Thesalia që të mund të fillonte në javën e parë të majit sulmin kundër Gjakovës. Më në fund, trupat turke e shtinë në dorë qytetin, por në Malësinë e Gjakovës, në Krasniqe dhe në Gash, më tepër se 3 mijë malësorë, të grumbulluar në Qafën e Morinës, nën udhëheqjen e Sulejman Vokshit dhe të myderiz Omer efendiut, i bënë të ditur Dervish Pashës se ata nuk do ta lejonin ushtrinë të shkelte këmbë në Malësi dhe e detyruan kështu të hiqte dorë nga kjo ndërmarrje. Pas Gjakovës administrata turke u vendos edhe në qytetet dhe në krahinat e Pejës, të Prishtinës, të Mitrovicës. Po, për të nënshtruar Lumën e Dibrën, megjithëse në këtë krahinë të fundit kishte përkrahjen e feudalëve vendas, Dervish Pashës iu desh ta zgjaste ekspeditën e tij deri në vjeshtë.

Me shpërndarjen e Lidhjes autoritetet qeveritare turke shpërthyen kudo një terror të hapur. Me mijëra qenë të dënuarit nga radhët e pjesëmarrësve aktivë të Lidhjes Shqiptare, që mbushën burgjet dhe që u internuan në skajet më të largëta të Perandorisë. Porta nuk kurseu edhe disa krerë që

i ishin dorëzuar në çastet e fundit si Zija Prishtinën, Riza bej Gjakovën etj.

Autoritetet e Portës bënë përpjekje të mëdha për të shtë-në në dorë udhëheqësit e Lidhjes që kishin mundur të shpë-tonin. Ato krijuan poste të posaçme në nyjat kryesore të ko-munikacioneve në Shqipëri, me qëllim që të kontrollonin qar-kullimin dhe të kapnin njerëzit e dyshimtë. Kryetari i Lidhjes, myderiz Omer efendiu, u strehua për një kohë në Malësitë e Gjakovës dhe prej këtej kaloi në Mal të Zi, ku qëndroi i mër-guar derisa vdiq, pa pranuar ofertat për falje që iu bënë nga qeveria turke. Autoritetet e Stambollit u munduan ta shtinin në dorë edhe Sulejman Vokshin, i cili qëndroi për një kohë të gjatë i arratisur në Malësi. Nënkryetari, Shuaip agë Spa-hiu, i cili u dorëzua pas shpartallimit të forcave shqiptare, u nxor përpara gjyqit në Prizren, u dënua dhe vdiq në burg. Dervish Pasha caktoi një shumë të madhe të hollash si shpër-blim për kokën e Abdyl Frashërit. Pas shpërndarjes së Lidh-jes Abdyl shkoi në Dibër, pastaj në Tiranë e prej andej në Jug për t'u hedhur përtej detit. Por në kohën kur po kapër-cente Shkumbinin afër Elbasanit, ai u kap nga një patrullë turke dhe u dërgua para gjyqit ushtarak në Prizren, ku u dënua me burg të rëndë.

Krejt ndryshe u soll Dervish Pasha kundrejt atyre feuda-lëve që iu dorëzuan. Për të siguruar përkrahjen e tyre dhe për të mos lejuar formimin e një fronti të ri të rezistencës, Der-vish Pasha në një kohë të parë shumë nga këta feudalë si, p.sh., Hasan Pashë Tetovën, Ali Pashë Guçinë, etj., i emëroi në po-zita të larta qeveritare në administratën e vilajetit të Koso-vës. Për më tepër, sulltani u dhuroi atyre çifligje të reja. Megjithatë Dervish Pasha mori edhe masa sigurimi duke rekrutuar shumë djem të tyre, gjoja për t'u bërë nder, në radhët e gardës së sulltanit, por në të vërtetë me qëllim që t'i mbante si peng në Stamboll.

Pas shpërndarjes së Lidhjes në Veri, Porta e pati të lehtë ta zhdukte atë edhe në Jug. Edhe këtu ajo ndoqi taktikën e përcarjes së frontit të qëndresës. Nga njëra anë, ajo mori masa shtypëse kundrejt elementëve aktivë të lëvizjes, dhe, nga ana tjetër, u mundua të fitonte përkrahjen e feudalëve të mëdhenj. Valiu i Janinës Mustafa Asim Pasha, në maj të vitit 1881, me

pretekstin e një kumtimi të rëndësishëm, thirri në Prevezë dhe arrestoi me të pabesë një grup nga udhëheqësit e Lidhjes. Edhe këtu filluan nga puna gjyqet ushtarake, që dënuan me mijëra veta me burgim ose internim. Po në atë kohë, dy nga udhëheqësit më me influencë, Mehmet Ali bej Vrioni dhe Neki Pashë Libohova, u emëruan mytesarifë, njëri në Berat dhe tjetri në Gjirokastër.

Me shpartallimin e reparteve ushtarake të Lidhjes dhe me regjimin e terrorit që vendosi Dervish Pasha, administrata turke rifilloi nga veprimi edhe në ato krahina, ku kishte pësuar goditje të rënda në vitet e veprimit të Lidhjes Shqiptare. Njëkohësisht vazhduan përpjekjet për regjistrimin e popullsisë për qëllime rekrutimi dhe për mbledhjen me dhunë të taksave në zonat e Malësisë. E zënë me këto detyra, ekspedita ndëshkimore e komanduar nga Dervish Pasha qëndroi në Shqipëri deri në fund të vitit 1981.

Rëndësia historike e Lidhjes së Prizrenit

Lidhja e Prizrenit zë një vend të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar. Ajo përfaqëson lëvizjen e parë masive shqiptare me karakter kombëtar dhe shënon kapërcimin nga periudha e gjatë e kryengritjeve të shkëputura dhe lokale në një përpjekje të organizuar, në të cilën morën pjesë pak a shumë të gjitha krahinat e Shqipërisë.

Për më tepër, Lidhja e Prizrenit ngriti për herë të parë me forcë e në mënyrë të organizuar, si përfaqësuese e gjithë kombit, çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare dhe i detyroi fuqitë evropiane ta merrnin parasysh ekzistencën e këtij kombi, në një kohë kur ato e kishin mohuar krejtësisht. Tani e tutje çështja shqiptare mbeti në rendin e ditës si një nga çështjet që kërkonin zgjidhje.

Atdhetarët që merrnin pjesë në Lidhjen e Prizrenit nuk u kufizuan të luftonin vetëm kundër rrezikut të copëtimit të Shqipërisë, që ishte bërë një çështje djegëse në rrethanat e krizës ballkanike, as edhe vetëm kundër disa masave të administratës turke, por shtruan në mënyrë konsekuente dhe të

plotë kërkesa për të siguruar autonominë e Shqipërisë si hap të parë drejt pavarësisë. Lidhja e Prizrenit i mbështeti këto kërkesa me veprime konkrete që arritën deri në veprime luftime, dhe krijoi organet e saj për realizimin e tyre. Gjatë periudhës, ndonëse të shkurtër, të qeverisë së përkohshme, ajo dha provën e parë dhe me sukses se shqiptarët, në kundërshtim me opinionin e përhapur qëllimisht nga armiqtë e tyre, ishin në gjendje të qeverisnin veten.

Drejtimi përparimtar që mori Lidhja e Prizrenit, duke shkuar përtej caqeve ku donin ta kufizonin qeveria turke dhe feudalët turkomanë shqiptarë, tregonte se në udhëheqjen e lëvizjes kombëtare po përforcohej gjithnjë e më tepër ndikimi i elementëve të dalë nga radhët e borgjezisë kombëtare, të cilët në veprimtarinë e tyre kishin mbështetjen e masave popullore. Por, megjithatë, këto forca borgjeze nuk e siguruan asnjëherë rolin e hegjemonit në udhëheqjen e lëvizjes. Nën ndikimin e elementëve përparimtarë, lëvizja i vuri vetes si qëllim kryesor luftën për një shtet autonom ose të pavarur, të cilit zbatimi i reformave do t'i siguronte një zhvillim të shpejtë ekonomik e shoqëror, mbi baza të reja, borgjeze.

Por, me gjithë veprimtarinë e këtij elementi përparimtar, me gjithë heroizmin që treguan njerëzit e thjeshtë, veçanërisht në fazën e fundit, Lidhja e Prizrenit u shtyp dhe u shpërnda. Ajo nuk arriti të realizonte qëllimet e saj për një varg arsyesh të brendshme dhe të jashtme. Ngjarjet e vitit 1880 e të fillimit të vitit 1881 treguan sesa të rënda ishin pasojat e prapambetjes ekonomike dhe shoqërore që sundonte në Shqipëri si provincë e Perandorisë Osmane; ato treguan sa luftë të madhe duhej të bënin ende atdhetarët kundër pasojave të kësaj prapambetjeje për të bërë për vete masat, për t'i shkëputur ato nga ndikimi i dëmshëm i feudalëve dhe i ideologjisë përçarëse fetare, për të forcuar në to ndërgjegjen kombëtare. Ndërsa në luftën për mbrojtjen kundër copëtimit tokësor u përfshinë pak a shumë të gjitha masat popullore të krahinave të rrezikuara, në luftën për autonomi kundër Portës së Lartë dhe sulltanit u ndie ndikimi i shtresave reaksionare, i feudalëve, i elementëve turkomanë të borgjezisë si dhe i vetë Portës. Në këto kushte, në fazën e fundit dhe vendimtare të

luftës së Lidhjes kundër Portës, Qeveria e Përkohshme në Prizren nuk mundi të mobilizonte popullsinë e gjithë krahinave të Shqipërisë. Krahinat e ndodhura larg ngjarjeve, duke pasur lidhje organizative shumë të dobëta me qendrën, nuk morën pjesë në mbrojtjen e qeverisë së përkohshme kundër forcave turke. Për më tepër, qëndrimi i lëkundshëm i feudallëve, largimi i tyre nga Lidhja dhe bashkimi i tyre më në fund me forcat e Dervish Pashës pati gjithashtu pasojë të dëmshme. Ata u bënë shkak që masa të gjera të popullit, të cilat ndodheshin nën ndikimin e tyre, të qëndronin mënjane në çastet vendimtare të luftës.

Një rol me rëndësi vendimtare negative luajtën edhe faktorët e jashtëm. Shqiptarët u ndodhën jo vetëm përballë forcave ushtarake, shumë herë më të mëdha, të Perandorisë Osmane, por edhe përballë qëndrimit armiqësor të shteteve të mëdha që ishin përkrahëse të deklaruara të status quo-së si Anglia dhe Austro-Hungaria. Por edhe Rusia, që ishte kundërshtarë e kësaj politike, i konsideronte tokat shqiptare si mone dhë për të kënaqur lakmitë e shteteve ballkanike fqinje me Shqipërinë dhe për t'i lidhur këto me politikën e vet. Në këto kushte lëvizja shqiptare nuk gjeti asnjë përkrahje të jashtme.

Rruga që përshkoi Lidhja e Prizrenit, fitoret dhe disfatat e saj, qenë një mësim i madh për rilindësit dhe për gjithë popullin shqiptar. Ngjarjet e këtyre viteve vërtetuan pikëpamjet e atdhetarëve përparimtarë mbi rreziqet që i kanoseshin Shqipërisë, po të vazhdonte të qëndronte si pjesë e Perandorisë së kalbur Osmane, po të mos fitonte autonominë e vet e të mos dilte nga prapambetja. Ato vunë në dukje rreziqet që i vinin Shqipërisë nga politika e fuqive evropiane dhe lakmitë shoviniste të vendeve fqinje. Ngjarjet e këtyre viteve vërtetuan në të njëjtën kohë idetë e atdhetarëve mbi nevojën e edukimit politik të masave të gjera popullore dhe të forcimit të ndjenjës kombëtare ndër to. Pikërisht për këtë arsye atdhetarët, pas shpërndarjes së Lidhjes së Prizrenit, i shtuan përpjekjet e tyre për të tërhequr në lëvizjen kombëtare masa sa më të gjera të popullit, për t'i bërë ato luftëtare më të ndërgjegjshme për qëllimin e çlirimit kombëtar dhe të përparimit shoqëror të atdheut.

Zhvillimi i letërsisë dhe i lëvizjes mendore shqiptare gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit

Hovi që mori Lëvizja Kombëtare në vitet 1876-1881 dhe veçanërisht në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, u shoqërua me një zhvillim të rëndësishëm të letërsisë artistike, dhe në përgjithësi të lëvizjes mendore shqiptare.

Duke u lidhur me detyrat e mëdha politike të ditës, lëvizja mendore mori një frymëzim të zjarrtë patriotik e luftarak; letërsia shqiptare e këtyre viteve në disa raste u ngrit në një shkallë të lartë artistike. Vjershëtarë si Spiro R. Dineja, Thimi Mitkoja, Pashko Vasa, Leonard de Martinoja, Filip Shiroka etj. krijimtarinë e tyre lirike ia kushtuan luftës së popullit shqiptar. Poezia e këtyre viteve në përgjithësi, ishte një thirrje e flaktë, që i ftonte shqiptarët të rrëmbenin armët për liri. Ndërsa S. R. Dineja, duke evokuar kohën e Skënderbeut, kërkonte që mbi muret e Krujës të valonte përsëri flamuri i lirë shqiptar; përndryshe nuk kishte kuptim rrojtja e shqiptarëve, Thimi Mitkoja përshëndeste me entuziazëm Lidhjen e Prizrenit që i kishte «dalë në krye Shqipërisë» si dhe luftën e saj për «vetëligjësi» (autonomi) dhe përkthente e përshtaste «Marsejezën» në gjuhën shqipe. Thirrjet për vëllazërimin, për bashkimin e shqiptarëve, si kusht për të siguruar ekzistencën e Shqipërisë, zinin një vend të rëndësishëm në vargjet e poetëve patriotë. Edhe folklori i kësaj kohe pasqyronte keqardhjen e njerëzve të thjeshtë për prapambetjen e vendit, të ndarë e të përçarë, zemërimin e tyre kundër synimeve grabitqare të shteteve të huaja ndaj Shqipërisë dhe gëzimin e entuziazmin për ngjarje të tilla siç ishin kuvendet e shqiptarëve, të bashkuar për mbrojtjen e atdheut.

Nevojat e propagandës së brendshme dhe të jashtme bënë që në periudhën 1876-1881, më tepër se letërsia artistike, të zhvillohej letërsia publicistike, veçanërisht ajo me karakter polemik. Për të forcuar ndërgjegjen kombëtare, për ta ushqyer atë me traditat e lashta e të lavdishme historike të popullit shqiptar dhe për të hedhur poshtë shpifjet e shovinistëve fqinjë që mohonin deri ekzistencën e popullit shqiptar, Thimi Krei, Zef Jubani, Jani Vretoja dhe Pashko Vasa filluan t'u kushtonin vëmendje të veçantë temave historike, duke i dhënë me këtë njëfarë nxitje historiografisë së re shqiptare.

Thimi Krei në Egjipt, më 1877, dhe rreth po asaj kohe Zef Jubani hartuan dy histori të Skënderbeut, të dyja të mbetura dorëshkrim. Tema historike trajtonte edhe J. Vretoja në librin e tij «Apollogjia», botuar, më 1878, në Stamboll. Ndonëse kishte ushqyer për disa kohë shpresa për mundësinë e një bashkëbisedimi greko-shqiptar, Jani Vretoja nuk ngurroi të godiste qarqet shoviniste greke dhe të zhvillonte kundër tyre një polemikë të ashpër me rastin e sulmit të një gazetari grek kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe Abdyl Frashërit në veçanti. Me një stil të mprehtë e plot sarkazëm, J. Vretoja fshikullonte shpifjet e gazetarit, i cili, siç thoshte autori, «do të na dëbojë nga foleja stërgjyshore me kamxhikun parahistorik, mitologjik, historik, arkeologjik, filologjik dhe politik», duke pretenduar se «Epiri ishte foleja e helenizmit», se shqiptarë në të vërtetë paska vetëm në Gegëri, ndërsa toskët na qenkan grekë të shqiptarizuar, se vetë Skënderbeu paska qenë grek etj. Me argumente historike, që e kanë ruajtur edhe sot vlerën e tyre, J. Vretoja shprehej, ndër të tjera, për tezën e autoktonisë së popullit shqiptar në vendbanimet e tij të sotme, si pasardhës i fiseve ilire, dhe hidhte poshtë gjithë shpifjet dhe shtrembërimet e fakteve historike të shkencëtarëve shovinistë grekë. «Apollogjia» e Vretos me erudicionin e saj, me frymën e thellë patriotike, me drejtësinë që shfaqte edhe ndaj kundërshtarit, ishte një dëshmi e pjekurisë që kishte arritur ndër kohë lëvizja mendore shqiptare.

Lëvizja patriotike shqiptare nuk kishte një shtyp periodik të vetin, ku mund të rrihte çështjet e ditës. Në këto kushte këtë funksion e ushtronte, ndonëse në mënyrë shumë të kufizuar, korrespondenca që shkëmbehin midis tyre, atdhetarët. Veçanërisht me rëndësi janë letrat e Jani Vretos, të shumta në numër, disa prej të cilave kanë vëllimin e një libërthi.

Interesi gjithnjë më i madh që ishte krijuar në botën e jashtme për çështjen shqiptare, u dha mundësi atdhetarëve shqiptarë të përdornin si tribunë për të shfaqur mendimet e tyre disa gazeta evropiane me rëndësi botërore. Kështu Sami Frashëri, Jani Vretoja, Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Thimi Mitkoja botuan artikuj në një varg gazetash italiane, gjermane, austro-hungareze etj.

Vetëm nga fundi i shtatorit 1879 filloi të botohej një ga-

zetë e përjavshme, e cila u vu krejtësisht në shërbim të çështjes shqiptare; kjo ishte gazeta «*I foni tis Allvanias*» («Zëri i Shqipërisë»), e botuar nga arberëshi A. Kullurioti greqisht në Athinë. Me devizën: «E duam Shqipërinë një, të pandarë dhe autonome», gazeta i vuri vetes si detyrë t'i bënte të njohur botës synimet e atdhetarëve shqiptarë dhe ta informonte atë drejt mbi ngjarjet e Shqipërisë. Gazeta botonte rregullisht artikuj e vjersha të Th. Mitkos, të J. Vretos, të P. Vasës etj. Megjithëse botohej në Athinë, A. Kullurioti nuk ngurroi të godiste politikën zyrtare greke, e cila, siç shkruante ai, bënte «zhurmë kundër shqiptarëve sikur këta të kishin ndërmend të pushtonin Atikën!» dhe zemërohej, sepse shqiptarët «po fillojnë të zgjohen si komb, në vend që të gëzohet si për një aleat të ardhshëm».

Për arsye të politikës së saj konsekuente që donte miqësinë dhe bashkëpunimin e popullit shqiptar me popullin grek, por kurrësi nënshtrimin e shqiptarëve ndaj qeverisë së Athinës, gazeta e A. Kulluriotit u mbyll pas afro një vit jete, më 1880.

Me idetë e Kulluriotit për mundësinë dhe dobinë e bashkëpunimit të shqiptarëve me popullin grek bashkohej edhe Eftim Brandi nga Korça, që banonte në mërgim në Egjipt. Në librin e tij «*Allvaniká parápona*» («Ankime të shqiptarëve»), botuar në 1880, E. Brandi trajtonte temën e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Duke u nisur nga teza e prejardhjes së përbashkët «pellazgjike» të shqiptarëve dhe të grekëve, ai vinte në dukje interesat e përbashkëta, që kishin të dy popujt, veçanërisht në gjendjen e atëhershme, kur kërcënoheshin, siç mendonte Brandi, nga rritja e shteteve sllave, prapa të cilave qëndronte Rusia. Shqiptarët, shkruante ai, nuk mund të prisnin asgjë të mirë edhe nga Austro-Hungaria e nga Anglia, që nuk kishin tjetër synim veçse interesat e tyre egoiste dhe për këtë arsye donin ta mbanin edhe më tej në këmbë «leckamanin» e Stambollit. E. Brandi godiste politikën zyrtare greke, që kishte frikë se «po të zhvillohej gjuha dhe kultura e shqiptarëve, do t'i pakësohej shkëlqimi helenizmit» etj. dhe nuk i ndihmonte aspak shqiptarët në luftën e tyre. Autori i siguronte grekët se Shqipëria e lirë e ardhme nuk do të bëhej kurrë një vegël në dorën e huaj kundër popullit grek. Brandi u drejtonte një thirrje edhe shqiptarëve grekomanë

që të ndihmonin Shqipërinë e të hiqnin dorë nga praktika për të «ushqyer të huajt, kurse vëllezërit e tyre kanë uri dhe etje për liri, qytetërim, arësim».

Një kritikë jashtëzakonisht të ashpër kundër regjimit të kalbur e të korruptuar të sulltanëve në Shqipëri dhe vetë në Turqi, përmbante broshura «Bisedime të ditës që meritojnë vëmendjen», botuar bullgarisht, më 1879, në Sofje nga Jusuf beu (me prejardhje, siç duket, nga Gjirokastra). Autori mendonte se ishin të gjitha mundësitë që midis popullit shqiptar dhe popullit bullgar të krijoheshin lidhje miqësie, të lidhura nga një varg interesash të përbashkëta.

Protesta kundër politikës së Fuqive të Mëdha në çështjen shqiptare dhe veçanërisht në çështjen e Ulqinit, gjente një shprehje të gjallë në broshurën e një autori anonim shqiptar, botuar, më 1880, frëngjisht me titull «*Shqiptarët dhe demonstrata navale përpara zhurisë eprore të shtypit*». Me fjalë të ashpra autori godiste veçanërisht politikën hipokrite të Anglisë, e cila «me një anë deklaroi se do t'u japë popujve lirinë dhe një qeveri të pranueshme dhe, nga ana tjetër, u dërgon flotën për t'i detyruar të zgjidhnin midis vdekjes e skllavërisë. E re ose e vjetër, ajo (politika angleze — red.) predikon paqe dhe përgatit luftë». Si të vetmen zgjidhje të çështjes lindore autori kërkonte njohjen e parimit të kombësisë edhe për Shqipërinë.

Por figura kryesore e lëvizjes mendore e letrare shqiptare në periudhën 1878-1881 u bë Pashko Vasa (1825-1892). Me veprat e tij letrare dhe publicistike-historike dhe si hartues i një vargu promemorjesh, që i shërbyen drejtpërsëdrejti luftës patriotike, Pashko Vasa u bë shprehës konsequent i kërkesave dhe i pikëpamjeve të lëvizjes patriotike shqiptare në këtë periudhë.

Pashko Vasa lindi në Shkodër dhe pati një jetë plot travajë. Më 1848-1849 ai mori pjesë në mbrojtjen heroike të Republikës së Venedikut kundër ushtrive të reaksionit habsburgas. Kësaj periudhe i përket libri i kujtimeve të tij italisht «*Burgjet e mia*», ku rreh i fortë pulsi i lëvizjes revolucionare të kohës. Një libër i dytë u kushtojë vërejtjeve që bëri autori gjatë një udhëtimi në Bosnjë dhe në Hercegovinë, më 1863. Ndonëse karakteri zyrtar i misionit nuk e lejonte të fliste hap-

tazi, libri tregonte se autori kishte njohuri edhe si ekonomist.

Edhe pasi hyri në shërbim të shtetit osman, P. Vasa nuk i humbi kontaktet me lëvizjen përparimtare të kohës. Ai kish-te lidhje miqësore veçanërisht me udhëheqësin e Komunës së Parisit, gjeneralin Klyzëre (G. P. Cluseret), që rronte aso kohe si emigrant në Turqi. Më 1878 Pashko Vasa botoi një alfabet të hartuar prej tij për gjuhën shqipe, që mbështetej krejtësisht në alfabetin latin dhe i afrohej shumë alfabetit tonë të sotëm.

Në vitin 1879 ose 1880 lindi kryevepra letrare e Pashko Vasës dhe një nga kryeveprat e letërsisë shqipe në përgjithësi, vjersha «Mori Shqypni, e mjera Shqypni», botuar dhe përhapur edhe në formë trakti. Me një gjuhë të bukur popullore, plot figura poetike, me një dashuri të ndjerë thellë për atdheun, poeti nis duke kënduar madhërinë e dikurshme të Shqipërisë dhe pastaj vajton gjendjen e mjerueshme të tanishme:

*«... Por si lisi i naltë i rrxuem për dhe,
Të shkon bata sipër, me kambë të shklet
E një fjalë t'ambël kurrkush s'ta flet».*

Shkakun e këtij mjerimi poeti e shihte para së gjithash në përçarjen fetare e krahinore të shqiptarëve dhe prandaj ai u drejtonte thirrjen për bashkim:

*«Çoniu, shqiptarë, prej gjumi çoniu,
Të gjithë si vllazën me një besë shtrëngoniu,
Edhe mos shikoni kisha e xhamia,
Feja e shqyptarit asht shqyptaria...»*

Vjersha mbaron me një thirrje të fuqishme për të rrokur armët dhe për të përtërirë periudhën e lavdishme të Skënderbeut, për ta bërë Shqipërinë përsëri një «zonjë të randë» e të nderuar midis vendeve të tjera.

Më 1879 P. Vasa botoi, së pari, shqip (në alfabetin e Shoqërisë së Stambollit) dhe po në atë vit në një përkthim të zgjeruar frëngjisht dhe gjermanisht veprën «*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, studim historik e kritik». Më

1880 libri u botua edhe turqisht e greqisht. Me këtë libër autori dëshironte «t'u rikujtonte popujve të qytetëruar këtë popull të harruar (shqiptar — red.), të mbronte kundër keqdashjes këtë popull që e kishin sharë, t'i bënte drejtësi këtij populli, kundër të cilit kishin grumbulluar shpifje».

Pasi përcaktonte kufijtë e Shqipërisë, brenda të cilave përfshinte edhe krahina ku popullsia shqiptare në të vërtetë ishte vetëm një pakicë, P. Vasa jepte një vështrim të historisë së Shqipërisë që prej pellazgëve legjendarë deri në periudhën e shkëlqyer të Skënderbeut. P. Vasa mendonte se në shekujt e parë të pushtimit turk populli shqiptar duhej konsideruar më tepër si «aleat» sesa i nënshtruar i sulltanëve, për arsye të privilegjeve që kishte gëzuar. Por autori nuk shihet se këto privilegje në të vërtetë i kishin pasur vetëm disa feudale si shpërblim për shërbimet e bëra Portës dhe jo gjithë populli. Kthesa vendimtare për keqësimin e gjendjes së popullit shqiptar, sipas tij, niste në vitin 1831, me rrëzimin e feudaleve të mëdhenj thuajse të pavarur. Në administratën e re turke, në ato «lakmi të dëmshme, në ato masa të reja të paqëndrueshme, në ato veprime pa kohezion», që e karakterizonin këtë administratë, P. Vasa shihet arsyet për mjerimin që kishte pllakosur mbi Shqipëri.

Për të shpëtuar nga kjo gjendje, Shqipërisë i duheshin «reforma rrënjësore». Si shprehës i mendimeve të qarqeve përparimtare që kishin marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit, P. Vasa kërkonte që reformat të fillonin, së pari, me «krijimin e një vilajeti të bashkuar shqiptar, me një administratë kompakte dhe unitare», «sipas nevojave dhe karakterit të popullsisë», në të cilën duhej «të merrte gjerësisht pjesë elementi vendës».

Kërkesat e P. Vasës ishin në të vërtetë për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë. Si edhe atdhetarë të tjerë, ai mendonte se Shqipëria autonome duhej të mbetej akoma në kuadrin e Perandorisë Osmane, për t'u mbrojtur nga synimet e qeverive shoviniste fqinje.

Vetëm brenda një province të tillë autonome do të mund të zbatoheshin reforma për përparimin ekonomik e shoqëror të vendit në frymën dhe pas interesave të borgjezisë kombëtare shqiptare. Vetëm atëherë, sipas fjalëve të P. Vasës, Shqipëria do të dilte nga prapambejtja karakteristike për Perandorinë feudale Osmane: «Bujqësia nuk do të vonojë të marrë pjesëtime të mëdha, tregtia do të zhvillohet e sigurt dhe e

shpenguar, industria do të sigurojë burime të reja të ardhurash dhe arsimit do të përhapet kudo, gjë që do të sjellë me vete përparim, qytetërim, pasuri e mirëqenie të përgjithshme».

Pashko Vasën si edhe atdhetarët e tjerë të kohës së tij e përshkonte ndjenja e zjarrtë e dashurisë për atdheun, ndjenja e detyrës për të luftuar për të ardhmen e tij; ky mendim gjente shprehje në fjalët me të cilat autori mbyllte librin:

«Ne e kemi zemrën të djegur nga dëshira për të parë atdheun të lumtur...»

Lëvizja e gjerë mendore dhe veprimtaria politike e gjithanshme, që u zhvillua në periudhën e viteve 1876-1881, dëshmonin për nivelin e rëndësishëm që arriti Lëvizja Kombëtare Shqiptare në këtë kohë dhe që e bën këtë një nga më të shkëlqyerat e Rilindjes sonë Kombëtare.

SHQIPËRIA NË VITET E KRIZËS LINDORE (1877—1881)*

Pikësnyimi dhe qëllimi i kumtesës sonë është të kontribojë për të plotësuar me aspektin shqiptar kuadrin e viteve 1877-81, periudhë aq interesante, sa edhe e agjitur e historisë së re të popujve ballkanikë. Me të vërtetë nuk mungojnë në historiografi punime kushtuar kësaj periudhe, që e kanë parë atë në plan të përgjithshëm ndërkombëtar, ose në aspektet e saj të veçanta: serb, bullgar, grek ose otoman. Për fat të keq, ana shqiptare në këto studime, në mos ka munguar krejt, ka dalë tepër e varfër, e pasaktë ose disa herë e shtrembëruar. Kjo vlen edhe për punimet më të reja si ato të D. Gjorgjeviçit,¹ madje në njëfarë shkalle edhe për dy punime mjaft mirë të dokumentuara, që përpiqen për një paraqitje më objektive të situatës shqiptare, siç janë ato të I. Senkjeviçit² dhe B. Stullit³. Në trajtesën tonë do të analizojmë disa anë the-

* Kumtesë mbajtur në Kongresin e Parë të Studimeve Ballkanike në Sofje, 25 gusht — 1 shtator 1966. Kumtesa është botuar gjermanisht në «Actes du Premier Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Européennes», V. IV, Sofia, 1969. Është nxjerrë nga «Studime historike», 1967, nr. 3, f. 101-110.

1 D. Gjorgjeviç, *Revolutions nationales des peuples balkaniques 1804-1914*, Beograd, 1965, f. 150-153.

kjo autore ka shkruar kapitullin përkatës në librin «Kratkaja Istorija
2 I. G. Senkjeviç, *Albania v period Vostočnovo krizisa*, Moskva, 1965. Po *Albanii*», Moskva, 1965, st. 87-111.

3 B. Stulli, *Albansko pitanje 1875-1882*, «Rad Jugoslovenske Akademije Znanosti i Umjetnosti», Zagreb 1959.

melore të kësaj çështjeje dhe do të përpiqemi, duke plotësuar ose duke korigjuar punimet e sipërme, të tregojmë se lëvizjet kryengritëse në Shqipëri në këto vite, të para objektivist, ishin një pjesë e lëvizjes së përgjithshme çlirimtare të popujve ballkanas; se në fakt Lëvizja Kombëtare Shqiptare qysh para ngjarjeve vendimtare të Traktatit të Shën-Stefanit dhe Kongresit të Berlinit e kishte përpunuar në mënyrë programatike platformën e saj politike, se nuk qenë këto dy ngjarje, sikundër është pranuar në përgjithësi, që shkaktuan lëvizjen në Shqipëri, ndonëse pa dyshim e ndihmuan të zhvillohet; se taktika e Lëvizjes Kombëtare çlirimtare Shqiptare, ndonëse ndryshonte për një varg arsyesh e rrethanash objektive nga ajo e lëvizjeve kombëtare të popujve të tjerë të Ballkanit, në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si e drejtuar për ruajtjen e integritetit të Perandorisë Osmane; më në fund do të tregohet se Lëvizja Kombëtare çlirimtare Shqiptare e këtyre viteve u bë një veprues aktiv në arenën ndërkombëtare, i cili më në fund i detyroi fuqitë evropiane të merrnin parasysh faktorin shqiptar dhe të orientonin deri diku politikën e tyre pas tij.

1) Në kundërshtim me një sërë afirmimesh shumë të përhapura se shqiptarët në shekullin XIX paskan qenë mbështetja kryesore e Perandorisë Osmane në Ballkan, duhet thënë se në Shqipëri, duke filluar nga vitet 30 të këtij shekulli, ishte krijuar një situatë e tillë, në të cilën njëra kryengritje ndiqte tjetrën, gjë që padyshim kontribuoi për dobësimin e Perandorisë. Në fakt, megjithëse te shqiptarët, ndryshe nga popujt e tjerë të Ballkanit, nuk koïncidonin antagonizmi social e fetar plotësisht me antagonizmin nacional, për shkak se këtu kemi të bëjmë me një popullsi në pjesën më të madhe islamike, të lidhur deri diku me lidhje fetare me Portën, dhe nga ana tjetër ekzistonte një klasë e fuqishme feudalësh shqiptarë, një pjesë e të cilëve ishin lidhur ekonomikisht e nëpërmes postesh të rëndësishme në aparatit shtetëror me regjimin e sulltanëve, megjithatë antagonizmi politik midis turqve dhe shqiptarëve dobësohej deri diku, por nuk zhdukej aspak nga këto rrethana. Ekzistonin një varg arsyesh social-ekonomike e politike të forta që nuk lejojnë të flitet për një përputhje të interesave të masave të gjera popullore me ato të rretheve sunduese osmane. Të rënduar nga barra gjithmonë në rritje e taksave, të rekrutimit e të abuzimeve

që u impononte një aparat shtetëror burokratik i korrumpuar, masat e gjera popullore myslimane të fshatit e të qytetit, si edhe borgjezia e re u rreshtuan në një front kundër aparatit shtypës shtetëror otoman. Nuk duhet harruar që ky konflikt, në thelb social, zhvillohej në terrenin e një kombësie të formuar, e cila mbështetej mbi territorin, gjuhën, historinë dhe traditat kulturore të përbashkëta. Me këtë rast shtojmë se habitusi shpirtëror i shqiptarëve dallohej shumë prej atij të osmanëve.

Por edhe në gjirin e klasës feudale-çifligare shqiptare po vepronin faktorë që shkaktonin rritjen e kontradiktave kundrejt shokëve të klasës sunduese osmane. Jo vetëm ajo shtresë feudalësh të vjetër, të zhveshur nga pozitat politike dominuese prej reformave centralizuese të Tanzimatit kishte kaluar në opozitë, po edhe çifligarët tashmë të lidhur me ekonominë e tregut si dhe borgjezia e re, ishin të interesuara për një kthesë rrënjësore, që do t'u siguronte kushte për zhvillimin e vendit e të veprimtarisë së tyre, gjë që nuk ua siguronte dot regjimi i prapambetur i sulltanëve.

Një fakt që duhet pasur parasysh në Shqipëri ishte se shqiptarët përbënin asaj kohe një faktor ushtarak të rëndësishëm — në fakt masa të gjera, të krishterë e myslimanë, ishin të armatosur; veçanërisht fshatarësia e malësive kishte mundur të ruante me armë në dorë një pozitë autonome faktike, që vihej në rrezik nga reformat centralizuese të qeverisë; prandaj ato jepnin vazhdimisht shkak për kryengritje. Këto kushte e bënin Shqipërinë një nga hallkat e rëndësishme në lëvizjen kryengritëse të Ballkanit e kuptohej pse ajo kishte tërhequr qysh herët vëmendjen e faktorëve politikë të vendeve fqinje (Koleti, Garashanin, të garibaldinëve, të diplomacisë serbe e ruse rreth vitit 1860). Veçanërisht në pragun e periudhës që na intereson, në vitet 1874-1877, në Shqipërinë e Veriut po zhvilloheshin një varg kryengritjesh, të cilat koinciduan me kryengritjet e Bosnjë-Hercegovinës, të Bullgarisë, me luftën e Malit të Zi e të Serbisë kundër Turqisë. Kryengritjet në Shqipëri, ndonëse zhvilloheshin veç nga lëvizjet e tjera në Ballkan, objektivisht po shkriheshin me to në një lëvizje të përbashkët të popujve të Ballkanit. Kështu e kuptuan edhe bashkëkohësit gjendjen reale. Jo më kot K. Botev e për-

shëndeste këtë fakt si një kusht për fitoren kundër armikut të përbashkët.

2) Në qoftë se masiviteti, karakteri popullor dhe i armatosur përbënte forcën e këtyre lëvizjeve shqiptare, do-bësinë e tyre e përbënte fakti se ato nuk kishin përve-tësuar ende një program politik të qartë e të ndërgjegjshëm. Kjo nuk do të thotë se ato ishin politikisht amorfe. Por nga ana tjetër, fakti se këto lëvizje masive nuk udhëhiqeshin poli-tikisht nga një klasë më e përparuar, siç ishte borgjezia e re shqiptare, nuk do të thotë akoma, se kjo klasë udhëheqëse, borgjezia e re për atë kohë përparimtare, mungonte në Shqipëri. Me gjithë prapambetjen e pengesat e shkaktuara nga regji-mi feudal osman, edhe në Shqipëri po çanin rrugën ndryshime ekonomike-shoqërore të rëndësishme. Nga radhët e borgjezisë së re filluan të dilnin ata iluministë që u bënë bartësit e ideve të reja kulturore-politike. Në këto kushte lindën mani-festet e para të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, hartuar nga N.Veqilharxhi në vitet 1844-46; u bënë përpjekjet e para në vitet 1856-1864 për krijimin e një qendre organizative të Lëvizjes Kombëtare në Stamboll; u formua ajo aleancë e borgjezisë shqiptare me opozitën feudal-çifligare, që do të kishte në dorë për gjithë shekullin XIX udhëheqjen e Lëvizjes Kombëtare çlirim-tare shqiptare. Njëkohësisht filluan të hyjnë në masat popu-llore idetë e lëvizjes së ndërgjegjshme kombëtare dhe u shkrinë karakteri kombëtar me karakterin social¹.

Cili ishte programi pozitiv që shtronte Lëvizja Kombë-tare çlirimtare Shqiptare? Ne mund të themi se qysh para se të zhvilloheshin ngjarjet vendimtare të krizës së madhe me Traktatin e Shën-Stefanit e Kongresin e Berlinit, Lëvizja Ko-mbëtare çlirimtare Shqiptare kishte arritur të përpunonte platformën e saj social-politike, të përpunonte strategjinë dhe taktikën e saj të veçantë. Së pari, nëpërmes arsimit dhe kulturës në gjuhën amtare, të cilat me karakterin e tyre de-mokratik do të depërtonin në shtresat më të gjera, do të përgatitej ajo kthesë rrënjësore, që do ta vinte Shqipërinë, një

¹ Shih për këto çështje *Historinë e Shqipërisë*, vëll. 2, Tiranë, 1965, ku është trajtuar gjerësisht në kapitullin XI Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1839-1875, ndërsa kriza ballkanike e ngjarjet e asaj kohe në Shqipëri janë trajtuar gjerësisht në kapitullin XII f. 112-200.

vend të prapambetur feudal, në rrugën e një vendi të përparuar e të qytetëruar. Këto teza iluministe të N. Veqilharxhit, të përpiluara rreth viteve 1840, u plotësuan më tej në vitet 60 nga Z. Jubani me kërkesën për reforma ekonomike në dobi të borgjezisë kombëtare, për institucione legjislative të veçanta për tokat e banuara nga shqiptarët.

Ndonëse për mungesën e një lëvizjeje organizativisht unitare është vështirë të flitet për unitet të plotë pikëpamjesh, mund të thuhet, për sa i përket strategjisë e taktikës, se idetë e përfaqësuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vitet 60 grupohen në dy grupe, si më poshtë.

Duke u nisur nga teza, e hedhur së pari nga Veqilharxhi, e rrugës së veçantë historike të shqiptarëve, si një komb më vete në bazë të bashkësisë territoriale, gjuhësore e historike, tezë që përmbante në vetvete embrionin e kërkesës së autonomisë së Shqipërisë, pjesa më e madhe e rilindësve shqiptarë, midis tyre edhe përfaqësuesit e borgjezisë myslimane e të krishtere, konceptuan idenë e një përgatitjeje graduale të shqiptarëve për pavarësi, duke u siguruar së pari, autonominë territoriale-administrative në kuadrin e Perandorisë Osmane; një zgjidhje e tillë do të ishte rruga më e mirë, e cila, pas mendimit të tyre, do t'u siguronte shqiptarëve unitetin dhe integritetin e tokave të tyre, kundrejt synimeve të qarqeve qeveritare të vendeve fqinje ballkanike. Me këtë rast le të shtojmë se disa kërkesa shoviniste nuk munguan edhe nga ana e shqiptarëve; por këto ishin sidoqoftë shumë më të moderuara nga ato që u paraqitën në vendet fqinje nën mbulesën e argumenteve gjoja historike për realizimin e perandorisë së St. Dushanit dhe të «Megali idhesë». Në këto rrethana përfaqësuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare preferonin sigurinë e një autonomie territoriale administrative në kuadrin e Perandorisë Osmane, të garantuar nga Fuqitë e Mëdha nëpërmes traktateve ndërkombëtare të vitit 1856, përpara rrezeve të një pavarësie akoma problematike.

Kundrejt këtyre ideve qëndronin ato të një grupi të dytë, i përfaqësuar në radhë të parë nga aktivistë të Lëvizjes Kombëtare në kolonitë italo-shqiptare, që synonte drejtpërdrejt shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Porta. Por duke marrë parasysh kushtet e vështira të jashtme, në të cilat do

të gjendej shteti i ri shqiptar, këta mendonin se vendi i tij do të ishte në një konfederatë ose në një monarki dualiste greko-shqiptare, për t'u bërë kështu ballë rreziqeve që u kanoseshin të dy palëve nga ekspansioni i shteteve sllave të Ballkanit, prapa të cilave qëndronte Rusia cariste. Duhet thënë se edhe ky grup nuk ishte aq naiv sa të mbyllte sytë para tendencave shoviniste që shfaqeshin në jetën politike të Greqisë, por ai shpresonte në fitoren e arsyes të qarqet sunduese të shtetit fqinj, që duhet të kuptonin interesat e përbashkëta të dy vendeve. Por përpara realitetit të hidhur, që si përfundim i zhgënjeu, përfaqësuesit e këtij grupi më në fund në vitet pas krizës nuk ngurruan t'i braktisnin këto pozita e të bashkoheshin me përfaqësuesit e grupit të parë, me autonomistët. Nga ana tjetër, anëtarët e grupit të parë, e theksuan më se një herë se qëndrimi i shqiptarëve në kuadrin e Perandorisë nuk duhej absolutizuar dhe se, posa të krijoheshin kushte të favorshme të brendshme e të jashtme, ata do të kalonin në luftë për të siguruar pavarësinë e plotë të vendit. Megjithëse kishin formuluar dyshime e rezerva në lidhje me politikën e shteteve fqinje, përfaqësuesit e grupit të parë nuk u shfaqën kundër bashkëpunimit me vendet fqinje dhe në vitet 1878-81 u kthyen disa herë te kjo ide.

Shprehjen më të qartë platforma e grupit autonomist e gjeti në memorandumun e Janinës të marsit 1877*, hartuar nga një mbledhje e parisë së Shqipërisë së Jugut, ku formuloheshin kërkesat themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare: bashkim i gjithë territoreve shqiptare, që gjer atëhere ishin përfshirë në disa vilajete, ku kishte pjesërisht edhe popullsi të huaj, në një vilajet shqiptar të vetëm, me administratë shqiptare, me shkolla në gjuhë shqipe, me milicinë e vet ë ligje të veçanta, të ardhurat fiskale të të cilit do të harxhoeshin në vend.

Nuk duhet mohuar, po të bëjmë vlerësimin përfundimtar të kësaj platforme autonomiste, se ky qëndrim mund të interpretohet edhe si shenjë dobësie e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, meqë e linte kështu çështjen shqiptare akoma si një problem të brendshëm të marrëdhënieve shqiptare-turke,

* Studimet e mëvonshme kanë vërtetuar se ky memorandum i takon mbledhjes së parë të Lidhjes në Jug, në korrik të vitit 1878.

nuk prekte status quo-në dhe prandaj problemin shqiptar nuk e sillte përpara një forumi ndërkombëtar. Por nga ana tjetër duhet thënë se në kushtet objektive ekzistuese brenda dhe jashtë Shqipërisë, kjo ishte e vetmja rrugë realiste.

3) Platforma e Janinës, e përpunuar në mars 1877*, u plotësua dhe u pasurua në vitet e ardhme nën ndikimin e ngjarjeve politike të jashtme të reja që u shfaqën. Le të shohim si u zhvillua më tej kjo platformë në rrethanat konkrete.

Zhvillimi i vrullshëm i ngjarjeve të luftës, disfatat e para të ushtrisë otomane, linin të kuptohej edhe në Shqipëri se shembja e Perandorisë Osmane ishte e afërt. Me këtë bëhej i pashmangshëm rregullimi i ri i gjithë punëve të gadishullit.¹

Situata hapte kështu, nga njëra anë, rrugën për realizimin e planeve të Lëvizjes Kombëtare për sigurimin e autonomisë ose pavarësisë së Shqipërisë, por nga ana tjetër bëhej edhe më i theksuar rreziku lidhur me pretendimet territoriale të shteteve ballkanike fqinje në kurriz të Shqipërisë. Në këto kushte dukej sikur njëra zgjidhje pengonte tjetrën, aq më tepër që në zgjidhjen e tyre nuk duhej të lihej pa u marrë parasysh dhe faktori otoman.

Në këto rrethana filloi veprimtarinë e vet të ethshme një grup politik, i formuar prej kohësh në Stamboll nga nëpunës, tregtarë, funksionarë të lartë shtetërorë, çifligarë të internuar etj., të cilët vinin nga krahina të ndryshme të Shqipërisë e përfaqësonin fetë e ndryshme të vendit. Në vjeshtën e vitit 1877 grupi, i cili kishte kohë që bënte përpjekje për çështjen ko-

* Shih më lart.

¹ Mbi ngjarjet në Shqipëri gjatë këtyre viteve na informojnë para së gjithash raportet e konsullatave austro-hungareze nga Shkodra, Prizreni, Manastiri, Janina etj., të cilat patëm mundësi t'i shfrytëzojmë në kopje mikrofilmash. Mjerisht ky material i pasur është botuar vetëm pjesërisht si, p.sh., nga A. Novotny, *Quellen und Studien zur Geschichte des Berliner Kongresses 1878*, Bd I, Graz-Köln, 1957. Krahaso edhe materialet arkivore ruse të I. G. Senkjeviçit. Rëndësi të jashtëzakonshme për prapaskenën e formimit të Komitetit Shqiptar në Stamboll dhe për taktikën e këtij Komiteti ka raporti i ambasadorit francez Tissot nga Athina, më 25 nëntor 1880 (kopje mikrofilmi nga Archives, Min. Aff. Etrang., Affaires de Grèce 1880).

mbëtare shqiptare, u shfaq me emrin «Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare».

Anëtarët e komitetit e kuptuan shpejt se detyra kryesore e çastit ishte sigurimi i unitetit dhe i integritetit tokësor të atdheut, mandej të organizohej ajo lëvizje e gjerë popullore e spontane që kishte shpërthyer veçanërisht në viset kufitare shqiptare me shfaqjen e ushtrive ndërluftuese ballkanikë, dhe të shndërrohej në një lëvizje të ndërgjegjshme kombëtare, me një organizatë udhëheqëse të vetme, e cila duhej njëkohësisht të përfaqësonte interesat kombëtare para opinionit publik botëror.

Një çështje tjetër që tërhiqte gjithashtu vëmendjen e komitetit ishte ajo e marrëdhënieve me disa nga vendet fqinje dhe sigurimi i një aleati të jashtëm për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Qysh prej vitit 1876 ekzistonin lidhje midis kryengritësve të Shqipërisë së Veriut me disa qarqe politike në Itali, me Malin e Zi dhe diplomatë rusë. Dhe me të vërtetë nuk mungonte interesi për Shqipërinë në këto vende, duke e konsideruar atë si një aleate eventuale në rast të një konflikti të armatosur me Turqinë. Veçanërisht aktive u bë në këtë periudhë propaganda italiane, ndonëse Italia, e porsa bashkuar, ishte akoma tepër e dobët për t'i bërë Austro-Hungarisë me të vërtetë njëfarë rivaliteti dhe për t'u dhënë ndihmë efektive shqiptarëve. Një faktor tjetër, territorialisht i vogël, por më efektiv për shkak të afërsisë së tij, ishte Mali i Zi, me të cilin Shqipërinë e Veriut e lidhnin prej kohësh disa interesa të përbashkëta. Qysh më 1876 kishte vajtur këtu prifti mirditas Prengë Doçi, si përfaqësues i një komiteti patriotik në Shkodër, për të kërkuar ndihmë financiare e në armë për Mirditën që ishte në kryengritje. Nikolla i Malit të Zi vrapoi për t'i dhënë priftit shqiptar premtime ndihme e të krijojë një aleancë pak a shumë efektive, duke deklaruar njëkohësisht, për të zhdukur çdo dyshim të shqiptarët, se Mali i Zi nuk kishte asnjë pretendim mbi tokat shqiptare dhe se zgjerimin e kërkonte në krahinat sllave të Tivarit e drejt Hercegovinës.

Por ngjarjet që u zhvilluan më tej treguan se as Mali i Zi, as Serbia, nuk kishin si qëllim vetëm realizimin e bashkimit të tyre kombëtar. Ushtritë serbe e malazeze, porsa shkelën, gjatë operacioneve, vise me popullsi shqiptare myslima-

ne, filluan të dëbonin ose të shpërngulnin në mënyrë masive popullsinë vendase. Princi Nikolla deklaroi se nuk do të pushonte luftën, derisa të mos kishte siguruar lumin Drin si kufi jugor të shtetit të tij, ndërsa nga ana tjetër qeveria serbe paraqiste pranë shtabit të ushtrisë ruse në Adrianopojë kërkesa që përfshinin pothuajse gjithë Shqipërinë e Veriut. Për ta kthyer në favorin e Serbisë gjendjen etnike, të paktën në krahinat e pushtuara gjatë operacioneve ushtarake, Milani, mbret i Serbisë, urdhëronte komandën e trupave që të fillonte shpërnguljen masive të shqiptarëve. «Sa më tepër shqiptarë që të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut», thuhej në një urdhër dite.

Në kushtet, pra, kur fitoret ruse e bënë të ngjashëm se klientët e politikës ruse, Mali i Zi, Bullgaria e Serbia do të mund të zgjeroheshin zotërimet e tyre në dëm të tokave shqiptare, si aleat i shqiptarëve mund të paraqitej ai shtet, interesat e të cilit prekeshin nga zgjerimi i Serbisë ose i Bullgarisë drejt jugut, dhe, që nga ana tjetër, nuk ishte përfshirë në luftën që po zhvillohej. Ky shtet i dukej grupit të Stambollit se ishte Greqia, aq më tepër që prapa saj qëndronte Anglia.

Për anëtarët e Komitetit Shqiptar nuk ishte i panjohur fakti se qarqet zyrtare greke shpeshherë kishin ngritur pretendime mbi toka të Shqipërisë së Jugut. Por ata ishin të mendimit se interesat e përbashkëta duhej ta bindnin qeverinë greke të hiqte dorë nga pretendime të padrejta në kurriz të tokave shqiptare. Për këtë qëllim, qysh në tetor të 1877-ës kishin filluar në Stamboll bisedime midis komitetit dhe një përfaqësuesi të qeverisë greke. Nga pala shqiptare u kërkuan sigurime formale për tërësinë tokësore, njohja e një shteti shqiptar që do të krijohet, me kufij të cilët do të përfshinin në Jug, ndaj Greqisë, gjithë krahinat shqiptare të vilajetit të Janinës, duke ia lënë Greqisë Janinën bashkë me territoret në jug të lumit Kalamas. Me këto kushte, komiteti ishte i gatshëm të pranonte si kryetar të shtetit të ardhshëm shqiptar një princ nga shtëpia daneze, që sundonte në Greqi. Por, ndërsa zhvilloheshin këto bisedime, në shkurt të 1878-ës një çetë andartësh grekë zbarkuan në bregdetin jugor shqiptar për t'i siguruar kështu Greqisë, në çastet e fundit të luftës, pa shumë mundime, një pjesë nga plaçka e luftës. Kjo ndërmarrje si

dhe qëndrimi intransigjent, që kishin mbajtur qarqet qeveritare greke gjatë bisedimeve, treguan se ato nuk kishin hequr dorë nga një qëndrim armiqësor ndaj çështjes shqiptare.

Me gjithë këtë eksperiencë të hidhur, Komiteti Shqiptar i Stambollit, me proklamatin e tij të datës 30 maj 1878, deklaronte: «Ne dëshirojmë të rrojmë në paqe me gjithë fqinjët tanë: Malin e Zi, Greqinë, Serbinë, Bullgarinë. Ne nuk kërkojmë asgjë prej tyre, por jemi krejtësisht të vendosur të mbrojmë me këmbëngulje çdo gjë që është jona. T'u lihet pra shqiptarëve toka shqiptare!»

Në kushtet që krijoi politika e shteteve ballkanike ndaj çështjes shqiptare u bë krejtësisht e pamundur që të zhvilloheshin më tej marrëdhëniet midis lëvizjes shqiptare e vendeve fqinje që kishin pasë filluar dhe të krijohej një front i përbashkët i luftës kundër armikut të përbashkët: Perandorisë Osmane.

Për izolimin e lëvizjes shqiptare kontribuoi edhe qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare. Nuk munguan edhe midis shqiptarëve zëra që e përshëndetën rolin e Rusisë si shpartalluese të Perandorisë Osmane e çlirimtare edhe të popullit shqiptar (si, p.sh., Jani Vreto, Isuf Ali beu dhe deri diku edhe vetë Komiteti Shqiptar me qendër në Prizren, i cili u vu në kontakt me shtabin rus në Adrianopojë).¹ Por me kohë qëndrimi i politikës ruse ndaj Shqipërisë sa vinte e po bëhej më i qartë; këtë e kishte treguar Traktati i Shën-Stefanit, i cili, kundrejt premtimit të një autonomie të kufizuar e të përgjithshme, shkëpuste një varg territoresh me popullsi thjesht shqiptare; si dhe qëndrimi i saj i mëtejshëm intransigjent ndaj çështjes shqiptare, që tregonte se Rusia e quante më të leverdishme të lidhte pas politikës së vet shtetet sllave ballkanike duke e sakrifikuat Shqipërinë, sesa t'i sakrifikonte Shqipërisë «miqësinë» e klientëve të saj. Por as armiqtë e betuar të Rusisë, Britania dhe Austro-Hungaria, si mbrojtës të status quo-së, nuk u treguan më mirëdashës ndaj autonomisë shqiptare, e cila mund të shpinte në prishjen e status quo-së e me të edhe të Perandorisë.

Nga ana tjetër, u tha se Italia e dobët ishte detyruar të bënte, dashur pa dashur, politikën e partnerëve të saj gjer-

¹ Shih për këto, hollësitat me interes që jep I. G. Senkjeviç, *Albania* etj. f. 116-117.

manë e austriakë. Kështu Lëvizja Kombëtare Shqiptare, ndryshe nga ajo e popujve të tjerë ballkanas, u ndodh vetëm e pa përkrahje të jashtme në një nga çastet më kritike. Kjo ishte një rrethanë shumë e rëndësishme negative për zhvillimin e saj.

4) Në këto kushte, qëndrimi i lëvizjes politike shqiptare nuk mund të ishte i thjeshtë, drejtuar vetëm kundër Portës, siç qenë orientuar lëvizjet kombëtare të popujve të tjerë të Ballkanit; ajo duhej të manovronte në dy fronte: kundër Portës po aq sa edhe kundër politikës shoviniste të shteteve ballkanike. Për anëtarët e Komitetit të Stambollit ishte e qartë se tërësia tokësore mund të mbrohej kundrejt pretendimeve shoviniste vetëm në qoftë se lufta për të mbështetej në parimin e kombësisë dhe të çohet deri në fund me sigurimin e autonomisë në luftë kundër Portës dhe me njohjen e saj ndërkombëtare. Por bashkë me Shqipërinë ishte e interesuar për mbrojtjen e integritetit të kërcënuar edhe Porta. Në këto kushte interesat e Portës objektivisht bashkoeshin me ato të shqiptarëve. Nga ana tjetër, anëtarët e komitetit mendonin se mund të shfrytëzonin situatën e ngushtë të Perandorisë, kur Porta nuk kishte tjetër rrugë për të shpëtuar të paktën hijen e sovranitetit të saj mbi provincat perëndimore, për ta detyruar atë që t'u jepte shqiptarëve «vullnetarisht» autonominë. Duke shfrytëzuar interesin e Portës për organizimin e mbrojtjes me forcat vendase, meqenëse forcat e rregullta të ushtrisë turke ishin treguar krejtësisht të pafata, Komiteti Shqiptar mundi të siguronte nga ajo lejën për organizimin e reparteve të milicisë vullnetare shqiptare. Me këtë lëvizja shqiptare kishte siguruar forcat e armatosura jo vetëm për të mbrojtur krahinat e rrezikuara, po edhe për të realizuar autonominë me dhunë, në rast se Porta do të kundërshtonte. Me këtë program lufte në dy fronte dhe të «aleancës» së kondicionuar e të përkohshme me Portën, lidhur me interesat e përbashkëta të mbrojtjes territoriale, Komiteti Shqiptar kishte siguruar një taktikë të shkathët, që ai e vuri në veprim në mënyrë pak a shumë konsekuente gjatë viteve 1877-1881, me gjithë vështirësitë e pengesat që hasi nga ana e qeverisë turke dhe përkrahësit e saj, turkomanët shqiptarë. Ai mundi ta bënte këtë me gjithë kundërveprimin e këtyre faktorëve heterogjenë, sepse nuk përfaqësonte vetëm lëvizjen

e një grushti intelektualësh; prapa tij qëndronte tashmë një lëvizje e fuqishme e masave popullore që kishin rrëmbyer armët për mbrojtjen e vendit të vet.

Si rezultante e faktorëve të ndryshëm të kësaj lëvizjeje masive, të veprimit të aktivistëve politikisht të ndërgjegjshëm dhe të përpjekjeve për ta bërë programin e tyre program të lëvizjes masive dhe nga ana tjetër e ndikimit të qeverisë osmane dhe të njerëzve të saj në Shqipëri, filloi nga veprimi, më 10 qershor 1878, Lidhja Shqiptare me qendër në Prizren. Me gjithë karakterin e saj në fillim heterogjen, nëpërmes një procesi të brendshëm zhvillimi, u bë e para organizatë politike masive kombëtare, që tani vepronte si përfaqësuese e gjithë kombit shqiptar.

Me emrin e saj është lidhur lufta e popullit shqiptar për ruajtjen e tërësisë toksore dhe për autonominë në vitet 1878-1881.

5) Në fakt zbatimi i vendimeve të Kongresit të Berlinit, të rikonfirmuara në Konferencën e Berlinit, më 1880, në lidhje me ratifikimin e kufijve të Malit të Zi e të Greqisë mbetën të pazbatuara, në sajë të qëndresës së fuqishme që u bënë atyre shqiptarët e organizuar rreth Lidhjes së Prizrenit. Ky moszbatim nuk ishte vetëm një afront për Fuqitë e Mëdha nënshkruese të traktatit, por rrezikonte edhe interesat e tyre, e veçanërisht të Britanisë e të Austro-Hungarisë, meqë ekzistonte rreziku që çështja shqiptare të bëhej shkas për një konflikt të ri të përgjithshëm në Ballkan. Kjo vlente aq më tepër që ngjarjet në Shqipëri nuk munguan të ndikonin edhe në Bosnjë-Hercegovinën e afërt, me popullsinë e saj myslimane të porsanështruar nga Austro-Hungaria.

Në këto kushte të disa nga Fuqitë e Mëdha u shfaqën tendenca për një qëndrim më realist për të marrë parasysh faktorin shqiptar, pa të cilin nuk mund të mbyllej ky konflikt. Shenja për një qëndrim të tillë më realist u shfaqën së pari, në Londër, ku kishte ardhur në fuqi kabineti liberal me Gladstonin (W. Gladstone) në krye. Duke u përpjekur për një sukses të shpejtë përpara parlamentit, Gladstoni mendonte se zhdukja e kësaj vatre konfliktesh në Shqipëri, përgjegjësinë e së cilës ai ia ngarkonte politikës së Bikonsfildit (Beaconsfield) mund t'i shërbente këtij qëllimi. Mendimi i tij u përkrah

nga ambasadorët Lajar (Layard) e më vonë Goshen (Goschen) në Stamboll. Sipas këtij të fundit çështja e kufijve të mbetur pezull për shkak të qëndresës së shqiptarëve, nuk mund të zgjidhej pa kënaqur aspiratat legjitime të këtyre. Por pas mendimit të Goshenit, një zgjidhje e pjesshme, siç e synonte ministri i Jashtëm Grenvil (Granville), duke i dhënë autonominë vetëm vilajetit të Shkodrës, nuk mund ta bënte këtë punë. Ajo do të haste në kundërshtim nga shqiptarët vetë dhe nga ana tjetër ishte në kundërshtim me interesat angleze. Duke parë efektin e qëndresës shqiptare, Gosheni e quante kombësinë shqiptare «një element që nuk duhej kapërcyer në çdo kombinacion të ardhshëm politik». Nga pranimi i këtij realiteti do të kishte pa dyshim përfitim edhe politika britanike në përpjekjen e saj për t'i mbyllur shtegun depërtimit të mëtejshëm të ndikimit rus në Ballkan nëpërmes shteteve sllave të gadishullit, duke krijuar një shtet shqiptar muhamedan¹. Një Shqipëri e vogël sipas Goshenit, nuk mund ta bënte këtë, prandaj ai insistonte pranë Grenvilit kundër çdo zgjidhjeje të pjesshme të çështjes shqiptare.

Diplomacia britanike u përpoq ta ngrinte çështjen shqiptare përpara një forumi ndërkombëtar. Kjo u bë me rastin e punimeve të «Komisionit evropian për Rumelinë Lindore», i cili në muajt qershor-gusht 1880 shqyrtoi projektligjin e administrimit të vilajeteve të Turqisë Evropiane. Përfaqësuesi britanik Ficmoris (Fitzmaurice) deklaroi me këmbëngulje se vilajetet shqiptare të Kosovës, të Shkodrës e të Janinës, kërkonin një trajtim të veçantë. Më tej ai kërkoi aprovimin e komisionit për krijimin e 4 sanxhaqeve shqiptare që do të bashkoheshin në të ardhmen në një «Shqipëri të madhe», si shprehej ai. Por projekti anglez hasi kundërshtim jo vetëm nga Rusia, po edhe nga Austro-Hungaria, që shihte në këto projekte rrezik për planet e saj të depërtimit të mëtejshëm drejt jugut. Kështu nga përpjekjet britanike nuk u realizua veçse një vendim i datës 18 gusht 1880, i cili, pa e detyruar Portën për

1 Shih për këtë problem materialet interesante në botimin zyrtar «Blue Book Turkey, nr. 15 (1880), p. II, Correspondence respecting the New Law for the European Provinces of Turkey»; mjerisht as Stulli, as Senkjeviçi nuk i kanë përdorur këto.

asgjë, deklaronte se «në qoftë se Porta do ta shihte oportune të bashkonte krahinat shqiptare në një vilajet të vetëm, të nënshkruarit nuk do të kishin asnjë kundërshtim». Aksioni i zhvilluar nga Anglia i shërbeu asaj për të larguar shqiptarët nga aksione të dhunueshme për mbrojtjen e kufijve, si në rastin e Ulqinit, duke u premtuar autonominë. Nga ana tjetër, pasi kaloi rreziku i një konflikti të armatosur me dorëzimin e Ulqinit, në nëntor të vitit 1880, diplomatët britanikë nuk e patën të vështirë të ngulnin këmbë pranë Portës për një kurs energjik e të ashpër kundër autonomistëve shqiptarë.

6) Programin e vet për realizimin e autonomisë Lëvizja Kombëtare Shqiptare e realizoi vetëm nëpërmjet një lufte të pandërprerë që zhvillohej në gjirin e Lidhjes së Prizrenit dhe në nënkomitetet lokale të saj.

Lufta e krahut autonomist mbështetej mbi urrejtjen gjithmonë e më të madhe të masave popullore kundër çdo cunqimi tokësor të diktuar nga Traktati i Berlinit si dhe kundër Portës, që nuk ishte në gjendje të mbronte tokat shqiptare nga copëtimi. Lufta për realizimin e autonomisë u zhvillua nëpërmes një lufte kundër ndikimit e ndërhyrjes së Portës, e cila me anë të elementëve turkofilë në Lidhje u përpoq ta shfrytëzonte këtë lëvizje vetëm e vetëm për të luftuar kundër depërtimit të Austro-Hungarisë në Bosnjë-Hercegovinë dhe kundër lëshimeve tokësore në favor të shteteve ballkanike.

Po ashtu Lidhja që e detyruar më në fund të bënte front edhe kundër një grupi me influencë feudalesh shqiptarë, për të cilët ajo duhet të shërbente vetëm për të ndaluar çdo ndryshim tokësor në ato krahina, ku ata kishin çifligjet e tyre; pavarësisht se nuk ishin banuar prej popullsisë shqiptare, këta vraponin t'i quanin këto krahina me emrin Shqipëri.

Aleanca që kishte ekzistuar në fillim midis këtyre forcave heterogjene filloi të përçahet atëherë kur u bë gjithmonë më e qartë se pa luftë për autonomi nuk mund të zhvillohej mbrojtja e integritetit tokësor.

Me gjithë këto vështirësi të jashtme e të brendshme, rryma e lëvizjes autonomiste në gjirin e Lidhjes erdhi vazhdimisht duke u rritur qysh nga apelet e para drejtuar lordit Bikonsfild e kontit Andrashi (J. Andrassy), në qershor të 1878-ës, deri në mbledhjet plenare të Lidhjes, në nëntor të

1878-ës e më 1879, kur kjo kërkonte zbatimin e autonomisë sipas memorandumit të Janinës. Pika kulminante të kësaj lëvizjeje ishin kuvendet panshqiptare të Gjirokastrës e të Dibrës në korrik e në tetor të 1880-ës, ku në formë të ndërgjegjshme përgatitej shkëputja e Shqipërisë nga Perandoria, duke lënë vetëm një lidhje të hollë suzereniteti, siç ekzistonte, p.sh., ende midis Egjiptit e sulltanit.

Kur dështuan shpresat e fundit, të lidhura me aksionin e Anglisë dhe me premtimet e Portës, atdhetarët shqiptarë nuk ngurruan të kalonin në veprime dhune: me forcë ata zbuuan nga një varg qytetesh të Kosovës e të Dibrës funksionarët turq të qeverisë dhe vunë në vend të pushtetit osman pushtetin e saj, që ata e quajtën «Kuvënë e përdorme» (janar 1881). Ndonëse e kufizuar vetëm në një pjesë të territorit shqiptar dhe në kushtet e vështira të konfliktit me Portën, Qeveria e Përkohshme, megjithatë, brenda kohës së shkurtër të ekzistencës së saj mundi të jepte një provë të mirë se shqiptarët nuk ishin të paaftë për një jetë shtetërore të rregullt.

Duke u ndodhur përpara konfliktit të hapur me Portën, Qeveria e Përkohshme u përpoq edhe një herë të arrinte në një marrëveshje me qeverinë greke, duke u nisur nga fakti se marrëdhëniet greko-turke ishin acaruar së tepërmi dhe prandaj edhe në Athinë ishin shfaqur tendenca për të rifilluar traktativat e dikurshme me shqiptarët. Porse rrjedhimi i ngjarjeve tregoi se qeveria athinase përpigjej ta përdorte mundësinë e një aleance shqiptaro-greke vetëm si një mjet për të ushtruar presion kundrejt Portës dhe për të arritur prej kësaj më tepër lëshime në bisedimet për çështjet e kufijve që po zhvilloheshin ato ditë.

Në një situatë të tillë Lidhja Shqiptare u gjend e vetme përballë Portës dhe fuqive të saj ushtarake, që ishin shumëfish superiore, atëherë kur Perandoria Osmane, pas likuidimit të konfliktit kufitar me Greqinë, i pati duart e lira kundrejt shqiptarëve.

Në prill të vitit 1881, pas një ndeshjeje të armatosur të ashpër, Lidhja Shqiptare u shpërnda. Qeveria e Përkohshme pushoi së qeni. Porse Lidhja Shqiptare e Prizrenit ushtroi një ndikim të thellë mbi gjithë historinë e re shqiptare; gjurmët e saj shkojnë nga lëvizjet e viteve 1896-1899, 1908 dhe 1911 deri në shpalljen e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912.

SHQIPTARËT PËRBALLË KRIZËS LINDORE TË VITEVE 1878-1881*

1) Vitet 30-60 të shekullit XIX i gjetën shqiptarët të përfshirë në një qëndresë të përgjithshme formash të ndryshme, drejtuar kundër Portës së Lartë, në një qëndresë që arriti deri në kryengritje krahinore mjaft të gjera.

Një varg vëzhguesish bashkëkohës, midis të cilëve njohës të mirë të vendit, si J. G. Han (J. G. Hahn), i kishin kuptuar drejt arsyet e thella të këtyre lëvizjeve. Është e vërtetë se te shqiptarët antagonizmi nacional që i ndante ata nga sunduesit osmanë, nuk acarohet më tej si te popujt e tjerë ballkanas, duke u përputhur me antagonizmin shoqëror e fetar (shqiptarët në shumicën e tyre i përkisnin fesë islame dhe ekzistonte një klasë e fuqishme feudale-çifligare shqiptare, lidhur me një varg interesash pas Portës), fakte këto që formonin rrethana zbutëse, por megjithatë nuk mund të zbutnin kontradiktën e thellë që ndante masat fshatare e qytetare

* Referat i mbajtur në Kolokuiumin Ndërkombëtar me temë «Kriza e Lindjes (1875-1878), problematika e një qindvjetori», organizuar në Paris prej 14 deri më 16 tetor 1977, nga Shoqata e Historisë Moderne si dhe Qendra e Studimeve për Popujt e Kulturat e Evropës Qendrore e Juglindore të Universitetit, Paris VIII. Referati është nxjerrë nga «Studime historike», nr. 1, 1978, f. 3-18.

Ai është botuar edhe në revistën shkencore «Përparimi», nr. 4, Prishtinë, 1978, f. 431-445.

shqiptare nga regjimi burokratik centralist që ishte vendosur në Shqipëri me Tanzimatit, regjim që sillte për ato barrë të reja të urryera, detyrime të rënda fiskale, shërbim ushtarak të detyrueshëm, gjyqe të korruptuara etj. Vendosja e funksionarëve të rinj të Portës, që ishin të huaj, mënjanoi nga pushteti politik në vend një pjesë të klasës feudale shqiptare dhe e shtyu atë në opozitë. Të gjitha këto rrethana i bënë tokat shqiptare në ato vite një pikë nevralgjike të Perandorisë Osmane, aq më tepër po të kemi parasysh se, të armatosur siç ishin në përgjithësi, shqiptarët përbënin një forcë të rëndësishme ushtarake.

Situata në Shqipëri përbënte një nga faktorët që ndihmonin për dobësimin e mëtejshëm të Perandorisë në këto vite fatale. Ngjarjet në vendin tonë ishin në të vërtetë një hallkë në luftën e përbashkët të popujve ballkanas për çlirimin nga autokracia e Portës dhe kështu u konsideruan edhe nga bashkëkohësit më të qartë e largpamës.

2) Porse këtij realiteti objektiv që po çante rrugë, nuk i përgjigjej ende plotësisht ana subjektive: pa një program politik të qartë e të përbashkët, këto lëvizje masive të armatosura, me rrënjë popullore, ishin në rrezik të amortizoheshin si lëvizje lokale, të organizuara keq dhe më në fund dështonin, siç ndodhi edhe në të vërtetë. Por megjithatë, ato ngritën në fakt qysh në vitet 30 kërkesën për t'u dhënë shqiptarëve një status të veçantë, një lloj autonomie, duke i përjashtuar nga reformat centraliste. Kjo kërkesë që njohu ngritje dhe zbritje, mbeti në të vërtetë në rendin e ditës deri në fundin e Perandorisë, si problem kyç në marrëdhëniet shqiptaro-osmane.

Kërkesat e këtyre lëvizjeve, për të përjashtuar vendin nga reformat centraliste, nuk donin të thoshin kurdoherë një kthim i thjeshtë prapa në regjimin e vjetër të kohës para Tanzimatit. Duke kërkuar që administrata në krahinat shqiptare të kalonte në duart e parisë së vendit, duke dhënë si shembull instruktiv atë që kishte ndodhur në vendet fqinje të Ballkanit, këto kërkesa fillestare vijnë duke u mbushur gjithnjë e më tepër me një përmbajtje konkrete ekonomike-shoqërore, që u përgjigjej më mirë interesave të borgjezisë vendase, po edhe të çifligarëve, të cilët po orientoheshin gjithnjë e më

tepër drejt ekonomisë së tregut dhe i ndjenin gjithashtu deri-diku pengesat që krijonte Perandoria e kalbur për zhvillimin e lirë të forcave të vendit.

Të thuash se forcat e reja shoqërore, borgjezia shqiptare dhe inteligjencia e dalë nga radhët e saj, nuk qenë ende në gjendje të merrnin në dorë plotësisht e të drejtonin këto lëvizje, nuk do të thotë të mohosh, siç e bën një pjesë e historiografisë së huaj, përmbajtjen e re që po marrin këto lëvizje popullore, lëvizje që përbëjnë sfondin mbi të cilin u rrit dhe u zhvillua Rilindja jonë Kombëtare, dhe njëkohësisht etapën e saj të parë.

Përpunimi teorik i kësaj përvoje të jetuar është vepër e një vargu ideologësh të shquar të viteve 1845-1871, ashtu si edhe përpjekja, ende pa rezultat, për krijimin e një qendre të parë organizative unike në Stamboll, ku ishte përqendruar në një pjesë të mirë inteligjencia shqiptare e asaj kohe.

Në kuptimin e N. Veqilharxhit, të E. Mitkos, të Z. Jubanit, shqiptarët, në bazë të bashkësisë territoriale, gjuhësore dhe historike përbënin një unitet, i cili kishte interesa ekonomike, politike e kulturore të përbashkëta, pavarësisht nga ndarja në krahina e aq më tepër në tri fe rivale e përçuese ndikimesh politike e kulturore të huaja. Kërkesat për arsimimin në gjuhën e popullit e për ligje të reja e reforma ekonomike të veçanta për shqiptarët e të destinuara vetëm për tokat shqiptare, plotësonin kështu kërkesën për një status të veçantë, përbënin në thelb kërkesën e autonomisë territoriale shqiptare në kuadrin e Perandorisë Osmane.

3) Ishte e qartë se rregullimi i punëve të Shqipërisë nuk ishte një problem që u përkiste vetëm shqiptarëve; ai i vinte ata në radhë të parë përballë Portës dhe shtronte rrjedhimisht pyetjen se ç'qëndrim do të mbante kjo dhe a mund të gjenin shqiptarët në këtë ballafaqim aleatë në plan ndërkombëtar, në radhë të parë te fqinjët e tyre ballkanas?

Shpresat e këtyre figurave udhëheqëse se Porta vetë do të kishte interes për një zgjidhje të tillë që mendonin ata se nuk cenonte integritetin e Perandorisë, por nga ana tjetër e siguronte këtë, duke i vënë tokat shqiptare në gjendje t'u bënin ballë vetë e me sukses synimeve të vendeve fqinje, nuk u realizuan as në kohën e Kushtetutës së vitit 1876. Një lëshim

i tillë, edhe sipas mendimit të Vezirit të Madh, Mithat Pasha, i njohur si liberal, do të ishte fillimi i shturjes së Perandorisë. Në konceptin politik të Portës, shqiptarët myslimanë në Perëndim e arabët në Lindje duhej të ishin shtyllat e shtetit teokratik osman, ide kjo që pësoi në këto vite një goditje të parë e fatale pikërisht nga shqiptarët. Jo më pak armiqësor ishte qëndrimi i fuqisë së dytë të madhe në Ballkan, Fanarit Grek, për të cilën «Ideja e madhe», e kuptuar si sundim i helenizmit në Lindje, e jo si bashkim i popullit të çliruar grek në shtetin e tij kombëtar, nuk mund të realizohej, po që se nga kjo ndërtesë do të shpëtohet ata që konsideroheshin si shtyllë e saj më perëndimore — ortodoksët shqiptarë. E luftuar nga të dyja fuqitë universaliste teokratike, Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk gjeti aleatë as midis shteteve ballkanike ekzistuese, që ia detyronin ekzistencën e tyre vetë zbatimit të parimit të kombësisë.

Gjendja në të cilën e kishte katandisur Porta Shqipërinë, për qarqet sunduese në këto shtete ballkanike krijonte një rrethanë shumë të favorshme, për të realizuar plane të një ekspansioni të guximshëm. Për qeveritarët e Malit të Zi, të Serbisë, të Greqisë dhe për diplomacinë ruse prapa tyre, gjendja e kryengritjeve të vazhdueshme e bënte Shqipërinë e shqiptarët një faktor të rëndësishëm, siç shprehej, p.sh., kryeministri serb Garashanin (M. Garašanin), por, sipas një fjale të Abdyl Frashërit, ata shihnin te shqiptarët jo «aleatë», por «të nënshtruar». Duke u nisur nga një tezë gjoja shkencore, që gjeti një argumentim më të plotë «teorik» më vonë nga Cvijiçi (J. Cvijić), se shqiptarët përbënin një entitet me kombësi ende të pakristalizuar e të papërcaktuar, qarqet qeveritare të këtyre vendeve hartonin plane e përfundonin marrëveshje për copëtimin e tokave shqiptare (shih bisedimet serbo-greke të viteve 1861-1867, Traktatin e Fshehtë të Veslout etj.).

Në kushtet kur në arenën ndërkombëtare mbisundonin fuqitë mbrojtëse të status quo-së dhe nga ana tjetër Rusia, për të siguruar shtrirjen e ndikimit të saj drejt Mesdheut, përkrahte në çdo mënyrë politikën ekspansioniste të shteteve të krishtera ballkanike, për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare nuk kishte zgjidhje tjetër — deri në një kthesë më të favorshme në rrethanat ndërkombëtare, veç qëndrimit të shqiptarëve në kuad-

rin e Perandorisë Osmane, të garantuar nga traktatet ndërkom-bëtare të paqes në Paris në vitin 1856, për t'i siguruar kështu popullit shqiptar unitetin si dhe integritetin e tokave të tija, si një nga kushtet themelore për ekzistencën e tij kombëtare. Kjo ishte një zgjidhje realiste, e vetmja në këto rrethana, në krahasim me planet pak a shumë ireale për ta bërë krahinën e vogël malësore të Mirditës që ishte në kryengritje, «Piemontin shqiptar», rreth të cilit do të formohej shteti i ardhshëm shqiptar, ose për të krijuar një «mbretëri dualiste» shqiptaro-greke. Është e vërtetë se me një zgjidhje të tillë nuk realizohej ende sigurimi i autonomisë, bashkimi i tokave shqiptare në një unitet administrativ; problemi shqiptar mbetej një problem i brendshëm shqiptaro-turk. Lufta për realizimin e këtyre kërkesave, në plan politik të brendshëm e ndërkombëtar, kjo ishte detyra e madhe që mbetej për t'u zgjidhur, një detyrë që aktivistët e Rilindjes sonë e kapën dhe e çuan më tej, edhe pse nuk e realizuan në vitet e Krizës Lindore.

Qëndruam në këtë çështje për të vënë në dukje atë që, pas mendimit tonë, përbën një mungesë të literaturës së huaj historike mbi Shqipërinë e Krizën Lindore: ajo vuan nga një e metë themelore, që nuk e njeh ose e mohon faktin se Rilindja Shqiptare i kishte formuluar, siç e pamë, vijat e saj themelore të qëndrimit e të veprimit qysh përpara Krizës Lindore e shpërthimit të Luftës Ruso-Turke. Natyrisht, efekti i këtyre ngjarjeve të stuhishme shërbeu si një katalizator që shpejtoi kristalizimin e plotë të këtij procesi që kishte filluar me kohë. Qëndrimi i shqiptarëve në këto vite nuk qe pra as improvizim i çastit, as edhe një qëndrim i frymëzuar nga forca të turbullta ksenofobe të brendshme, drejtuar kundër të krishterëve ballkanas, ose i nxitur që prapa kulisave nga forca të jashtme si Porta, pikëpamje këto që ende nuk janë zhdukur nga historio-grafia e huaj.

4) Ngjarjet e stuhishme të luftës dhe disfata e plotë e Perandorisë, shkelja e tokave shqiptare nga forcat ushtarake të aleatëve ballkanikë të Rusisë, «preliminaret» e paqes në Adrianopojë dhe më në fund Traktati i Shën-Stefanit, krijuan në Shqipëri bindjen se fundi i Perandorisë ishte i afërt, se në këto rrethana fundi i Turqisë mund të bëhej edhe fundi i Shqipërisë.

Në këto kushte të vështira u realizua një detyrë e cila, me gjithë përpjekjet, prej shumë kohësh nuk kishte gjetur zgjidhje: u krijua një qendër organizative unike e përfaqësuese për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, filloi nga veprimi në Stamboll në mënyrë të fshehtë «Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të Shqiptarëve», i përbërë nga forcat më të përparuara të inteligjencies shqiptare të kohës.

Për këtë komitet ishte e qartë se detyra e ditës ishte që të merrte në dorë e të drejtonte atë lëvizje masive por spontane, që në krahinat shqiptare të prekura nga ngjarjet e luftës përpjekje për t'i bërë ballë me forcat e veta çdo të papriture, tani që ushtria turke ishte tërhequr nga arena dhe forcat e shteteve fqinje kishin hyrë në territoret shqiptare kufitare.

Një çështje tjetër, që tërhiqte vëmendjen e komitetit, ishte ajo e marrëdhënieve me vendet fqinje dhe e sigurimit të një aleati eventual për lëvizjen shqiptare.

Shpërthimi e zgjerimi i krizës në vitet 1875-1877 kishte krijuar në fillim mundësi objektive për të integruar lëvizjet kryengritëse shqiptare në frontin e përbashkët të kombësive të shtypura, që kishin ngritur krye në Ballkan. Në një varg rastesh u krijuan lidhje të drejtpërdrejta, p.sh. midis mirditorëve kryengritës dhe malazezve, midis Komitetit të Stambollit e qeverisë greke. Por ato nuk u zhvilluan më tej, dhe, pas pak, u kthyen në të kundërtën, në konflikte të hapura. Në rregullimin e «trashëgimit osman» ndërhyjnë fuqitë e mëdha kapitaliste, të cilat, edhe kur shpallnin me të madhe se ishin për ruajtjen e status quo-së, edhe kur pretendonin se ndihmonin luftën e popujve të shtypur, në të vërtetë kërkonin drejtpërsëdrejti fitime territoriale për vete, ose të siguronin nëpërmjet fuqizimit të klientëve të tyre, monarkive të reja ballkanike, baza të shëndosha politike-strategjike për depërtimin e vet të mëtejshëm në Ballkan.

Po ky trashëgim osman për një pjesë të mirë, në të vërtetë, nuk përbëhej nga toka turke, por nga toka të banuara prej shqiptarëve, si dhe prej popullsive të Maqedonisë. Krijimi i provincës bullgare perëndimore, që ia kishte imponuar Rusia Konferencës së Stambollit, në janar të vitit 1877, prekte krahina të gjera me popullsi shqiptare, që arrinin gjer në Drin, dhe aq më keq e cungonte Traktati i Shën-Stefanit tërësinë

e tokave shqiptare. Rrjedha e ngjarjeve të Luftës Malazeze e Serbo-Turke në vitet 1876-1878, tregoi nga ana tjetër se qarqet në fuqi në këto vende nuk synonin vetëm çlirimin dhe bashkimin kombëtar të popujve të tyre.

Trupat malazeze e serbe, të cilat gjatë operacioneve luftarake kishin hyrë në krahina me popullsi muhamedane shqiptare, filluan menjëherë një aksion masiv shpërnguljeje. Princi Nikolla, që u kishte siguruar të dërguarve të malësorëve shqiptarë në fillim të luftës se nuk kishte pretendime mbi tokat shqiptare, por kërkonte të shtrihej në drejtim të Hercegovinës me popullsi prej të njëjtit fis sllav, deklaronte nga fundi se ai nuk do t'i ulte armët para se lumi Drin të bëhej kufiri jugor i vendit të tij. Nuk mbetej prapa nga ana tjetër, edhe princi Milan i Serbisë, i cili në fillim të luftës, më 1876, hartonte plane për të përvetësuar një pjesë të tokave shqiptare si pjesë të tij të plaçkës së luftës, gjë që shkaktonte reaksionin e qeverisë greke, që pretendonte të vepronte vetëm në Shqipëri. Më 1877, në një urdhër dite drejtuar trupave të tij, që kishin hyrë në toka të banuara prej shqiptarësh, princi Milan i porosiste: «sa më tepër shqiptarë të shpërngulni ju me forcë, aq më të mëdha janë meritat tuaja para atdheut».

Edhe kontaktet e Komitetit Shqiptar me qeverinë greke për të arritur një marrëveshje me të, si i vetmi shtet jashtë sferës ruse, kontakte që u zhvilluan gjatë vitit 1877 e në fillim të 1878-ës, dështuan para qëndrimit intransigjent të kryeministrit Komunduros për ta njohur Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. «Përse t'i bëjmë me ne? — pyeste ai. Ata (shqiptarët) kanë shpresë që me anën tonë të konsolidojnë kombësinë e vet. . .», çka donte të thoshte për kryetarin e qeverisë së Greqisë, «instalim i një fuqie armiqësore prapa krahëve tona!». Sulmet që ndërmorën në shkurt të vitit 1878 çeta andartësh grekë në territore të banuara prej shqiptarësh, tregonin se qeveria greke preferonte të zhvillonte po atë lodër që kishte tentuar disa herë, më 1854 dhe më 1866-67, për t'u rënë shqiptarëve prapa krahëve dhe për të krijuar kështu fakte të kryera, pa hyrë në një luftë të drejtpërdrejtë me Portën.

Për të vështirësuar gjendjen, në të cilën ndodhej lëvizja e shqiptarëve, ndihmoi edhe qëndrimi që mbanin Fuqitë e Mëdha ndaj çështjes së tyre. Qëndrimi ndaj shqiptarëve, i shpre-

hur në cungimet që u bënte tokave të tyre Traktati i Shën-Stefanit në përcaktimin e kufijve të Bullgarisë së re, të Malit të Zi e të Serbisë, tregonte se diplomacia cariste e quante më të leverdisshme të lidhte në këtë mënyrë pas politikës së vet shtetet sllave të Ballkanit. Por edhe armiqtë e betuar të Rusisë, Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria, mbrojtësit e parimit të status quo-së në Ballkan, nuk qenë më të prirur për të njohur kërkesat e shqiptarëve. Në pikëpamjet e këtij grupi të Fuqive të Mëdha, si dhe të Gjermanisë, Shqipëria ishte parashikuar të luante rolin e një monedhe të thjeshtë shkëmbimi. Lordi Derbi (E.S. Derby), ministër i Jashtëm britanik, kancelari gjerman Bismark dhe U. H. Vadington (W. H. Waddington), ministër i Jashtëm i Francës, i ofronin Italisë Shqipërinë për të larguar vëmendjen e saj nga objekte të tjera, ku kishin ata vetë interesa: nga Mesdheu, nga Trentino ose nga Tunisi. Rusia i këshillonte Italisë një zbarkim në Shqipëri për të bërë kështu presion anësor kundër Austrisë që po pushtonte Bosnjën. Dhe vetë Vjena, e cila në marrëveshjet që kishte bërë me Rusinë në Raihshtat e në Budapest, më 1876-1877, pati hedhur idenë e krijimit të një principate shqiptare autonome në rastin e shembjes së Turqisë, preferonte tani ta mbante Shqipërinë në kuadrin e Perandorisë Osmane, sa kohë që «nuk mund ta zëvendësonte këtë gjendje me diçka më të mirë» (Andrashi); pra, nënkuptohet për sundimin e vet.

Italia e porsabashkuar dhe politikisht e dobët, edhe pse zhvillonte një propagandë mjaft aktive midis shqiptarëve e vendeve të tjera ballkanike me parulla si «Ballkani — ballkanasve», mund ta shqetësonte Vjenën, por në fakt nuk ishte në gjendje të luante një rol më vete dhe efektiv në favor të çështjes shqiptare. Kështu lëvizja shqiptare ndodhej në një gjendje shumë më të vështirë se ajo e popujve të tjerë ballkanas. Ajo duhej të përballonte e vetme pa asnjë mbështetje nga jashtë, një situatë mjaft të komplikuar, që vinte në tërësi të shpatës fatet e vendit. Ky ishte një faktor shumë i rëndësishëm negativ.

5) Në këto kushte taktika e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nuk mund të orientohej drejt e vetëm kundër Portës, siç ndodhte te popujt e tjerë ballkanas. Ajo duhej të luftonte në dy fronte: kundër politikës pushtuese të monarkive ballkanike

për mbrojtjen e integritetit tokësor dhe të unitetit të saj kombëtar, si edhe kundër Portës për të fituar autonominë në territorin e saj kombëtar të bashkuar. Por asnjë nga këto qëllime nuk mund të sigurohej ndryshe veçse me luftë për afirmimin e plotë të parimit të kombësisë kundër faktorëve kundërshtarë: qeverive fqinje dhe Portës.

Por ishte e qartë se për mbrojtjen e integritetit të zotërimeve të saj, ishte vetë Porta po aq e interesuar. Në këtë kuptim, interesat e shqiptarëve me ato të Portës në këtë moment shkonin dorë më dorë. Nga ana tjetër, pikërisht situata e vështirë në të cilën ndodhej Porta, krijonte mundësinë për ta detyruar atë që të dekretonte në mënyrë «vullnetare» autonominë e Shqipërisë, për të ruajtur të paktën në këtë formë një pjesë të sovranitetit të saj në perëndim të Ballkanit. Në këtë drejtim vepronte me premtime edhe Porta vetë, duke dashur të inkurajonte shqiptarët për të kundërshtuar ndryshimet territoriale. Duke u nisur nga interesat e Portës për të organizuar në provinca vetëmbrojtjen lokale, pasi ajo vetë i kishte duart e lidhura nga traktatet e nënshkruara, Komiteti i Stambollit, me anë përkrahësish me influencë pranë oborrit, mori lejen për të mëkëmbur në Shqipëri një milici vullnetare shqiptare, që filloi të përdorte edhe armatimet e ushtrisë së rregullt. Në planet e komitetit synohej që kjo forcë të përdorej në rastin e volitshëm edhe për të shkëputur me forcë nga sulltani statutin e autonomisë së Shqipërisë.

Kjo taktikë e luftës në dy fronte dhe e aleancës së kushtëzuar me Portën, u zbatua nga Komiteti Shqiptar dhe nga forcat e varura prej tij në një mënyrë pak a shumë konsekuente, me gjithë vështirësitë që i dilnin vazhdimisht nga Porta, pasi kaloi «tronditja» e parë, si dhe nga partizanët e saj, bejlerë e pashallarë, klerikë turkomanë etj.

Nëse komiteti arriti t'i përballojë këto vështirësi të ndryshme, kjo ndodhi se Lëvizja Kombëtare Shqiptare tashmë nuk ishte më vetëm një lëvizje iluministe intelektualësh, por kishte prapa saj masa të armatosura, që ishin vënë në lëvizje për mbrojtjen e tokave të tyre, dhe arriti të krijonte organizatën e duhur për drejtimin e tyre.

Si rezultante e gjithë këtyre faktorëve u themelua, më 10 qershor 1878, në Prizren, në pragun e Kongresit të Berlinit,

Lidhja Shqiptare, e cila edhe pse në fillim me një përbërje heterogjene nga konceptet e orientimet politike-shoqërore, nëpërmjet një procesi evolucioni të brendshëm u bë një organizatë politike masive dhe e fortë, e para organizatë kombëtare panshqiptare, që me programin e saj kërkonte të përfaqësonte gjithë kombin shqiptar dhe në fakt edhe e bëri. Me emrin e saj është e lidhur lufta e popullit shqiptar për të mbrojtur të drejtat e veta kombëtare në vitet e stuhishme të Krizës Lindore.

6) Kongresi i Berlinit dhe vendimet e tij nuk ndryshonin në thelb thuajse fare nga Traktati i Shën-Stefanit në qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve. Vepër e diplomacisë së Fuqive të Mëdha, Shën-Stefani e Berlini u bënë shkak përçarjesh e grindjesh të thella e të zgjatura midis popujve ballkanas. Në të dyja rastet Shqipëria konsiderohej si një shprehje gjeografike, tokat e së cilës do të shërbenin për të kënaqur kërkesat territoriale të shteteve ballkanike (Malit të Zi e Serbisë), që u shtohesh tani në Jug edhe Greqia, për të cilën Kongresi parashikonte kompensime tokësore që do të caktoheshin në bisedime greko-turke të veçanta.

Kongresi krijoi rastin që shqiptarët të ngrinin për herë të parë kërkesat e tyre përpara një forumi ndërkombëtar në memorandumet dërguar në qershor të vitit 1878 nga Shkodra kryeministrit britanik, lordit Bikonsfild (Beaconsfield), nga Stambolli ministrave të Jashtëm dhe nga qytete të tjera Kongresit drejtpërdrejt. Aty shpreheshin kërkesat shqiptare në dy drejtime: kundër çdo cungimi tokësor të trojeve shqiptare dhe për ndryshimin në marrëdhëniet e tyre me Portën, për formimin e një komisioni «ad hoc» (special) ndërkombëtar dhe për hartimin e një «rregulloreje organike» të veçantë, me një fjalë për njohjen e një statusi autonom të tokave shqiptare.

Por asnjë nga këto kërkesa nuk u mor parasysht. E vetmja çështje lidhur me Shqipërinë, që u formulua në një protokoll të veçantë të Traktatit të Berlinit, ishte vendimi për të mbrojtur «privilegjet e liritë» e Mirditës katolike, për të siguruar kështu interesat e Austro-Hungarisë, për të siguruar në malësitë shqiptare të Veriut një bazë kundër shteteve sllave.

Zbatimi i ndryshimeve territoriale, me përjashtim të atyre që i përkisnin Serbisë, të cilat ishin realizuar qysh gjatë opera-

cioneve të luftës, hasi në kundërshtimin e vendosur të shqiptarëve. Në kufirin malazias, lëshimi i Plavës e i Gucisë, e më vonë, si kompensim në vend të tyre, i Hotit e i Grudës, u bë shkas për ndeshje të përgjakshme midis shqiptarëve e malazezve dhe mbeti pezull.

Një zonë tjetër nevralgjike në marrëdhëniet ndërkombëtare, e sidomos në raportet shqiptaro-greke dhe midis shqiptarëve dhe Portës, u krijua në kufirin greko-turk në lidhje me zbatimin e vijës kufitare Kalamas-Selemvria, që ishte rekomanduar nga Kongresi, vijë që kalonte përmes tokash me popullsi shqiptare. Lidhja Shqiptare ishte alarmuar thellësisht nga fakti që qarqet qeveritare greke me këtë rishikim donin të përfshinin në fakt gjithë vilajetin e Janinës, popullsia e të cilit ishte në shumicën e saj dërmuese shqiptare. Që ky shqetësim nuk ishte i pajustificuar, e vërtetonin pranë deklaratave të shumta publike e gjysmëzyrtare, edhe fjalët e kryeministrit Komunduros, drejtuar ministrit austriak në Athinë, kontit Dubski (Dubsky), që zbulonin thelbin e synimeve të politikës greke në Shqipëri: këtu nuk ishte fjala vetëm për një lokalitet më shumë a më pak, por për t'i siguruar helenizmit një bazë, nga e cila ai mund të përfshinte e të shkrinte në gjirin e vet elementin shqiptar, se pa këtë të fundit, sipas kryeministrit grek, helenizmi nuk do të ishte në gjendje të përballonte presionin sllav në Ballkan.

Për diplomacinë ndërkombëtare bëhej gjithnjë më shqetësues fakti që Porta, deri në vjeshtën e vitit 1880, nuk kishte qenë në gjendje të realizonte detyrimet e saj të rrjedhura nga Traktati i Berlinit jo vetëm se nuk donte, por në të vërtetë edhe se nuk mundte, duke u gjendur përpara kundërshtimit të vendosur të Lidhjes. Portës i kishte shpëtuar tashmë nga dora situata në Shqipëri, ku vepronin forcat ushtarake të Lidhjes dhe kjo kishte mënjanuar me organet e veta thujtë të gjithë administratën osmane në vend.

Për situatën e vështirë në të cilën u ndodh Porta, midis presionit të Fuqive të Mëdha dhe shqiptarëve, në vjeshtën e 1880-ës, është karakteristike lodra e fjalëve që bënte ambasadori gjerman në Stamboll, konti Hatzfeld-Vildenburg, P.f. (Hatzfeld-Wildenburg, Paul von), kur deklaronte se «Porta ndodhet midis Scilës te një «action générale» (veprim i për-

gjithshëm) të Fuqive të Mëdha dhe Karibdit të një «insurrection générale» (kryengritje e përgjithshme) të shqiptarëve».

Rreziku që gjendja e krijuar në Shqipëri, ose siç filloi të quhet «çështja shqiptare», mund të kthehej në një konflikt të ri ballkanik, me ndërhyrjet ushtarake të Malit të Zi e të Greqisë, gjë që sillte me vete rrezikun e një konflikti edhe më të gjerë ndërkombëtar, ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me interesat britanike e austriake për «pajtimin» e Ballkanit e konsolidimin e Portës, aq më tepër që ngjarjet në Shqipëri cenonin interesat e Vjenës edhe më afër, sepse ato nuk munguan të ndikonin edhe mbi Bosnjën fqinje, që sapo ishte shtruar me armë nën pushtimin austro-hungarez.

Për opinionin publik filloi të bëhej e qartë se prapa qëndresës së shqiptarëve gjendej në të vërtetë diçka tjetër, e re për Evropën zyrtare; një lëvizje e fuqishme kombëtare shqiptare, që ishte duke u çliruar tashmë nga çdo tutelë, në të cilën përpiqej ta mbante Porta. Ideja se kërkesat e shqiptarëve nuk bëheshin më pak legjitime, edhe pse Porta i përkrahte ato për të pakësuar humbjet e veta territoriale, filloi të fitojë terren në opinionin publik ndërkombëtar.

Në këto kushte bëhej detyrë e rëndësishme e Lidhjes Shqiptare, që pranë luftës së armatosur, të zhvillonte përpjekje për të thyer bllokadën e heshtjes që kishte vendosur Porta mbi ngjarjet e Shqipërisë dhe fushatën e desinformimit që zhvillonin qeveritë e shteteve ballkanike për ta paraqitur lëvizjen shqiptare si një lëvizje turmash të fanatizuara islamike dhe Lidhjen e Prizrenit si një organ të kamufluar keq të Portës (le të konstatojmë me keqardhje se koncepte të tilla pa asnjë bazë, vazhdojnë të mbahen ende sot në njëfarë literature që pretendon të jetë shkencore!). Një rol të rëndësishëm luajtën në këtë drejtim ideologët e Lidhjes, katoliku Pashko Vasa nga Shkodra, ortodoksët Jani Vreto nga Leskoviku, Eftim Mitko e Eftim Brandi nga Korça, myslimani Shemsedin Samiu nga Frashëri, arbëreshi nga Salamina e Greqisë, Kullurioti, arbëreshi nga Kalabria, De Rada (i japim këto hollësi për të treguar shtrirjen e gjerë panshqiptare që kishte marrë kjo lëvizje mendore). Letërsia politike që lindi nga zjarri i kësaj lufte, e radhiste me konsekuencë e drejt lëvizjen shqiptare atje ku e kishte vendin e saj historik, midis lëvizjeve moderne për emancipimin e bashkimin kombëtar. Në këtë drejtim janë

shumë kuptimplote fjalët që udhëheqësi kryesor i kësaj lëvizjeje, mendja drejtuese e Lidhjes Shqiptare, Abdyl Frashëri, shqiptoi në Paris, më 1879, pasi priti më kot te dyert e kabineve të diplomacisë evropiane: «Franca vajton humbjet e krahinave të saj, të Alsasit e të Lorenës. Pse një gazetë franceze i quan atëherë qesharakë shqiptarët që përpiqen të shpëtojnë nga rreziku i një fatkeqësie të tillë?»; e në një rast tjetër ai shtonte: «Në qoftë se shqiptarët janë më pak të mësuar se grekët, kjo nuk është arsye që çështja e tyre të jetë më pak e drejtë dhe më pak e denjë për ndihmë nga ana e popujve të qytetëruar», dhe përfundon se «Evropa na ka njohur deri tani vetëm si njerëz të luftës, tani ajo do të na njohë edhe si njerëz të punës e përparimit».

7) Që faktet janë kokëforta dhe realiteti nuk mund të mohohet gjatë, kjo e vërtetë filloi të çajë rrugën më në fund edhe në çështjen shqiptare. Qëndresa këmbëngulëse dhe e zgjatur filloi të ndikojë tek e mbramja edhe te Fuqitë e Mëdha të interesuara drejtpërsëdrejti dhe shkaktoi një qëndrim disi më realist në lidhje me «çështjen shqiptare». Faktet po e provonin se, pa marrë në konsideratë në njëfarë mënyre kërkesat shqiptare, vatra e konfliktit dhe rreziku i një përleshjeje të re ndërkombëtare në Ballkan, nuk mund të zhdukeshin. Shenjat e para për një orientim të ri u shfaqën së pari te disa diplomatë britanikë në vitin 1880. Kabineti i ri liberal, që sapo kishte ardhur në fuqi, ishte i interesuar për një sukses të shpejtë në parlament dhe vetë kryeministri Gladston (W. Gladstone) ishte i mendimit se zgjidhja e shpejtë e çështjes shqiptare, për të cilën përgjegjësinë ia ngarkonte paraardhësit të tij, Bikonsfildit, mund t'i shërbente këtij qëllimi.

Ai mbështetej në këtë qëndrim edhe nga ambasadorët britanikë pranë Portës, Lajar (Layard) e më vonë Goshen, që ishin të mendimit se rregullimi në kufijtë nuk mund të zbatohet pa kënaqur së pari kërkesat legjitime të shqiptarëve. Mirëpo një zgjidhje të tillë nuk mund ta arrinte akordimi i një autonomie lokale vetëm për vilajetin e Shkodrës, sepse kjo ishte në kundërshtim të hapur, në radhë të parë, me kërkesat shqiptare, por nuk u përgjigjej edhe interesave britanike. Duke u nisur nga çka po ndodhte në Shqipëri, deklaronte Gosheni (George Joachim Goschen), dilte qartë se shqiptarët përbënin

tashmë «një element që nuk mund të kapërcehej më në asnjë kombinacion politik të ardhshëm në Lindje». Politika angleze mund të nxirrte përfitim nga pranimi i këtij fakti, mendonte ambasadori, sepse me krijimin e një shteti të ardhshëm shqiptar, me popullsi kryesisht myslimane, mund t'i bëhej ballë përparimit të mëtejshëm të ndikimit rus në Ballkan.

Pasi Konferenca e Ambasadorëve në Berlin, në qershor të 1880-ës, nuk kishte qenë në gjendje për ta çuar më tej zgjidhjen e problemeve të varura, diplomacia britanike u përpoq ta ngrinte problemin shqiptar, duke u kapur pas zbatimit të nenit 23 të Traktatit të Berlinit, që kishte të bënte me administratën e provincave. Përfaqësuesi britanik Ficmoris (Fitzmaurice) kërkoi nga «Komisioni evropian për Rumelinë Lindore» në Stamboll, në korrik e në gusht, që vilajetet «e Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit e të Janinës të përjashtohen nga projektligji për administratën e vilajeteve të tjera të Turqisë evropiane». Këtu duhej të krijoheshin 4 sanxhakë thjesht shqiptarë, që mund të bashkoheshin në një «Shqipëri të madhe», siç shprehej ai. . .

Por mendimi britanik hasi në kundërshtim të fortë jo vetëm nga ana e Ruisë, po edhe e Austro-Hungarisë. Kështu nga gjithë aksioni britanik nuk rezultoi gjë tjetër veç vendimit të datës 18 gusht 1880 të komisionit në fjalë, që i deklaronte Portës, pa e detyruar për asgjë, se komisioni s'do të kishte asnjë kundërshtim nëse Porta do të donte t'i bashkonte krahinat shqiptare në një vilajet të vetëm shqiptar, çka natyrisht Porta s'kishte asnjë interes ta bënte. Kur, më në fund, u zgjidh në nëntor të 1880-ës edhe «çështja e Ulqinit», që kishte mbajtur hapur rrezikun e një konflikti ndërkombëtar, me një aksion të përbashkët të flotës së Fuqive të Mëdha dhe të trupave turke, që e mposhtën qëndresën e armatosur të Lidhjes dhe ia dorëzuan këtë qytet shqiptar Malit të Zi, atëherë edhe politika britanike, në personin e po atij Ficmorisi nuk e pati për gjë që të bashkohej me fuqitë e tjera për të kërkuar nga Porta zbatimin e një «kursi të fortë» në Shqipëri.

8) Qysh në hapat e parë të veprimtarisë së Komitetit Shqiptar dhe të Lidhjes së drejtuar prej tij, ideja e mbrojtjes së tërësisë tokësore ishte e lidhur me idenë e bashkimit kombëtar dhe ecte me hap të barabartë me kërkesën e autonomisë.

Sipas rastit theksohej herë njëra e herë tjetra nga këto gjymtyrë të një vargu, por ato qenë kurdoherë të pranishme në gjithë veprimtarinë e Lidhjes.

Por ndërsa për mbrojtjen e tërësisë tokësore lëvizja shqiptare mund të mbështetej mbi një front kompakt të brendshëm, i cili gëzonte mbështetje pak a shumë edhe nga Porta, lufta për sigurimin e autonomisë nuk mund të zhvillohej pa një luftë të brendshme, politiko-ideologjike, që u zhvillua në organizatat qendrore e lokale të lëvizjes shqiptare.

Lufta për autonominë drejtohej nga një grup udhëheqësish, që në raportet diplomatike evropiane të kohës cilësohen si «radikalë», personalitete me koncepte politike-kulturore progresive. Forca e këtij grupi qëndronte në faktin që prapa tij ishin masat e gjera popullore me urrejtjen e tyre të rrënjësorë thellë kundër Portës, e cila jo vetëm ishte treguar e pafuqishme për të mbrojtur tokat shqiptare, por përkundrazi, siç shpreheshin ata, i kishte nxjerrë në ankand, pa pyetur zotërit e vërtetë të këtij vendi, shqiptarët. Me hap të barabartë ecte edhe urrejtja e masave kundër sistemit burokratik të korrumpuar të Portës, rrjedhimet e të cilit i ndjenin masat drejtpërsëdrejti në shpinën e tyre. Nuk është e rastit se kur agjitacioni kundër lëshimeve territoriale të Portës arrinte pika kulmi, shpërthente njëkohësisht edhe urrejtja kundër organeve të administratës turke, e cila çonte në mbylljen e gjyqeve, në dëbimin e organeve të administratës, madje edhe në vrasjen e funksionarëve të Portës, siç qe vrasja e mareshalit Mehmet Ali Pasha nga turmat në Gjakovë, gjë që u kujtonte vëzhguesve diplomatikë Komunën e Parisit. Madje njëri prej udhëheqësve të saj, Klyzëre (G.P. Cluseret), mik i Pashko Vasës, që rronte në emigracion në Turqi, konsiderohej bile nga këta vëzhgues tepër «nuhatës», si frymëzuesi i vërtetë i «terrorit komunar në Shqipëri!».

Lufta për realizimin e autonomisë duhej të realizohej nëpërmes përpjekjesh konsekuente kundër ndërhyrjes së Portës, e cila me anë të njerëzve të saj në Lidhje, pashallarëve, turkomanëve, klerikëve reaksionarë, përpiqej ta mbante Lidhjen Shqiptare të kufizuar brenda atyre cageve që i interesonin Portës për të kundërshtuar lëshimin e territoreve të saj. Është e vërtetë se në momente të caktuara kritike, Porta i kishte

mbajtur shqiptarët me shpresa se sulltani ishte i gatshëm të lëshonte një ferman për të krijuar vilajetin e bashkuar shqiptar, porse u vërtetua se ato nuk ishin tjetër veçse premtime mashtruese që liheshin menjëherë në harresë, porsa kalonte situata kritike.

Në këto rrethana, aleanca e forcave të ndryshme, mbi të cilën ishte mbështetur Lidhja e Prizrenit, njohu një varg lëkundjesh. Në njërin ose në tjetrin moment, në gjirin e saj mbizotëroi herë njëri e herë tjetri krah, çka çoi në disa raste në shkëputje grupesh të veçanta e në riformime të saj, në mbizotërimin e organizatave krahinore më të përparuara si ato të Shkodrës, të Gjirokastrës e të Janinës, mbi qendrën. Por pavarësisht nga këto pengesa të brendshme e të jashtme, vija e autonomisë erdhi duke u zhvilluar në mënyrë konsekuente e ngjitëse, duke filluar nga memorandumet e para të qershorit të vitit 1878 dhe nga vendimet e Lidhjes në nëntor të vitit 1878, kur u shtrua para Portës e botës si vullnet i përbashkët i kombit shqiptar, që të rronte në një vilajet të bashkuar shqiptar, me nëpunës shqiptarë e shkolla në gjuhën e popullit, me organet e veta legjislative e ekzekutive, me ushtrinë e vet e qendrën administrative në një qytet shqiptar.

Mbi këtë program-bazë vepruan autonomistët gjatë viteve. Një pikë kulminante e re që në këtë drejtim Mbledhja e Gjirokastrës, në gusht të vitit 1880, ku u shtrua kërkesa e shkëputjes së Shqipërisë nga Porta, deri në një lidhje të fundit të dobët, siç e bashkonte Egjiptin e Bullgarisë me sulltanin si suzeren. Në kuptimin e drejtë të këtyre përfaqësuesve më të përparuar të Lidhjes, kjo nuk do të ishte një shkëputje e thjeshtë, por do të sillte një kthesë në gjithë jetën ekonomike-shoqërore e politike të atdheut. Shqipëria duhej të bëhej një shtet i përparuar në frymën e shteteve borgjeze-demokratike të kohës, në të cilën do të respektoheshin të drejtat e të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga feja e tyre. Në qoftë se Shqipëria do të bëhej e pavarur, ajo s'do të kishte nevojë as për mbretër, as për princër, që i pinin gjakun popullit. Shqipëria do të sundohej prej një lloj demokracie, shkruante në këto ditë të stuhishme ideologu i lëvizjes shqiptare Sami Frashëri, duke formuluar kështu paraprakisht mendime që do t'i zhvillonte më tej më vonë, si platformë

programatike për gjithë lëvizjen kombëtare dhe për shtetin e ardhshëm shqiptar.

Kur dështuan shpresat e fundit për aksionin e diplomacisë britanike (lëshimi i përdhuntë i Ulqinit tregoi se çfarë mund të pritej prej saj) krahu radikal autonomist në Lidhje kaloi në veprim. Në një varg qytetesh shqiptare të Kosovës e të Dibrës u dëbuan të fundit funksionarë e oficerë turq dhe në selinë e Lidhjes në Prizren u shpall Qeveria e Përkohshme Shqiptare. Edhe pse në kushtet e vështira të konfliktit me Portën e me njerëzit e saj, Lidhja dha, në kohën e shkurtër të ekzistencës së saj, një provë se shqiptarët ishin fare mirë të aftë për një jetë shtetërore të rregullt. Ajo që vinin në dukje, sidomos vëzhguesit diplomatikë si, p.sh., konsulli anglez Blant (K. Blant), ishte se Lidhja në veprimin e saj nuk ndoqi kurrsesi një politikë diskriminimi antikristian dhe antisllav, që i atribuonin kundërshtarët e saj.

E trembur nga ngjarjet në Shqipërinë Verilindore, që kërcënonin të përhapeshin në gjithë Shqipërinë, Porta vra-
poi të mbyllte, më 24 mars të vitit 1881, konfliktin kufitar ende të hapur me Greqinë, duke bërë lëshime tokësore që ajo deri atëherë, duke u mbështetur mbi rezistencën e shqiptarëve, i kishte mohuar. Lidhja Shqiptare u ndodh në këto kushte vetëm përballë Portës dhe forcave të saj ushtarake eprore, që tani, pas rregullimit greko-turk, i kishin duart e lira në Shqipëri.

Në fund të prillit të vitit 1881, Lidhja Shqiptare, pas një qëndrese të ashpër të armatosur, u mposht, Qeveria e Përkohshme u shpërnda.

Lidhja Shqiptare, veprimtaria e së cilës përfshiu vitet e Krizës Lindore, e cila në Shqipëri, për arsytet që pamë, u zgjat deri më 1881, përbën një ngjarje të shënuar. Si çdo ngjarje e madhe historike, ajo vuri në lëvizje forcat masive dhe mendjet më të përparuara të kombit dhe ushtroi një ndikim të thellë në gjithë historinë e re të popullit shqiptar. Lidhja Shqiptare e viteve 1878-1881 shënoi ndeshjen e parë frontale të organizuar të popullit shqiptar me sunduesit osmanë dhe me Fuqitë e Mëdha, që donin ta bënë atë monedhë shkëmbimi, një ndeshje frontale edhe me politikën ekspansioniste të shteteve fqinje ballkanike, në të cilën ajo i doli zot unite-

tit të tij kombëtar, integritetit të trojeve të atdheut dhe së drejtës për shtetin e vet kombëtar. Qëllimet për të cilat Lidhja luftoi, mbetën më tej në rendin e ditës; populli shqiptar i realizoi ato në kushte të reja, po aq të vështira si ato të Krizës së madhe Lindore, në vitet e Luftës Ballkanike më 1912, me krijimin e shtetit të tij të pavarur, por tashmë në një territor të cinguar rëndë.

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE RRENJËT E SAJ HISTORIKE*

Në jetën e popujve, në rrjedhën e viteve dhe të shekujve, ka ngjarje që për domethënien e tyre, qëndrojnë si udhërrëfyese në udhëkryqet e mëdha të historisë. Ato i vënë popujt përpara pyetjes: Nga duhet të shkojmë? Në shumësinë e rrugëve që ndeshen, ka të tilla, që të lehta në dukje, janë rrugë të mbyllura, pa krye e mbarojnë në greminë; të tjera, që duhen çarë me luftë e vështirësi, janë ato që çojnë më në fund drejt horizonteve të hapura.

Kësaj pyetjeje në një udhëkryq të madh të historisë i dha populli shqiptar një përgjigje që zë vend nderi në histori: me themelimin e Lidhjes Shqiptare në Prizren, më 10 qershor 1878, përfaqësuesit e kombit, të mbledhur në këtë qytet të lashtë shqiptar të Kosovës, shpallën vendosmërinë e tyre të patundur për të luftuar për të drejtat e veta kombëtare dhe i vunë themelet e asaj organizate politike, e cila për 3 vjet me radhë udhëhoqi luftën e masave popullore për çlirim nga zgjedha shekullore e huaj, për mbrojtjen e trojeve të veta,

* Referat i mbajtur në Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, që zhvilloi punimet më 12-14 qershor 1978 në Tiranë, botuar në librin «Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881», (12-28 qershor 1978), Tiranë 1979, f. 10-29. Referati është nxjerrë nga «Studime historike», 1978, nr. 3, f. 43-62. Është botuar dhe në frëngjisht në «Studia albana», 1978, nr. 1, f. 47-71.

për bashkimin në një shtet të vetëm autonom e të njësuar kombëtar.

Lidhja dhe lufta e masave popullore, që ajo udhëhoqi, përbën një nga ato ngjarje, për të cilën mund të thuhet, se pa të, rrjedha e historisë mund të kishte qenë detyruar të merrte tjetër rrugë e të zhbënte çka kishin ndërtuar vitet e shekujt. Prandaj, me krenari e mirënjohje, me dashuri e zjarr të pasuar patriotik, këtë qindvjetor e pret dhe e përkuqton mbarë populli shqiptar, në RPS të Shqipërisë dhe kudo ku banojnë shqiptarë, kudo ku tingëllon fjala e gjuhës së lashtë shqipe, sepse trashëgimi i madh i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte dhe është pasuri e përbashkët e një kombi të tërë, pavarësisht nga ndarjet, ashtu siç ishte para njëqind vjetësh e përbashkët lufta e tij.

Gjysmëshekulli që çoi në themelimin e Lidhjes Shqiptare, veprimtaria e saj si e para organizatë politike mbarëshqiptare që prej kohës së lavdishme të Skënderbeut, e cila bashkoi masat popullore mbi bazën e programit politik shoqëror të ri e të përparuar të lëvizjes kombëtare demokratike, përbënte dëshminë e rritjes së forcave ekonomike-shoqërore, të shkallës më të lartë politike e kulturore që kishte arritur tani populli ynë, edhe pse në kushtet e vështira të një sundimi të huaj shumë të rëndë, të regjimit despotik feudal osman.

Por kjo vijë rritjeje të gjithanshme kryqëzohej me vijën e ndërhyrjeve armiqësore po aq të gjithanshme, me politikën grabitqare të fuqive të mëdha kapitaliste evropiane dhe të satelitëve të tyre, të monarkive ballkanike. Ishte kjo ndërhyrje që krijoi, në kuadrin e konfliktit të madh ndërkombëtar të viteve 1877-1881, atë situatë krize vërtet tragjike që rrezikoi ta shpinte popullin shqiptar në «pikën zero» të rrugës së tij; ky komb me rrënjë të lashta etnike, që nuk ishte shkrirë gjatë shekujve në etnitë e mëdha historike: bizantine-greke, sllave, turke e në kulturat e tyre, tani do të copëtohej si një entitet gjoja «amorf», siç e formulonte diçka më vonë, Jovan Cvijiç (J. Cvijić), si një «mbeturinë e historisë»; trojet e tij do të ndaheshin si një «terra nullius», një tokë e kurrkuqjt dhe do të shërbenin si lëndë ndërtimi për të fuqizuar shtetet e reja ballkanike. Kjo ishte një ndërprerje brutale e rrugës së konstituimit të tij si entitet politik në shtetin e bashkuar

kombëtar. Kriza Lindore, nga një çështje politike, siç ishte për popujt e tjerë, për popullin tonë, për kombin shqiptar u kthye në një pyetje të madhe — jetë a vdekje, dhe kësaj pyetjeje populli shqiptar dhe figurat që qëndruan në krye të Lidhjes, i dhanë një përgjigje, rëndësia e së cilës vështirë se mund të mbivlerësohet: me luftën shumëfronteshe, shumëformëshe, për të asgjësuar atë vendim të forumeve të Fuqive të Mëdha, që një nga figurat e shquara të kohës, Abdyl Frashëri, e quajti një krim politik amoral: Një dënim me vdekje kundrejt një populli të tërë.

Me luftën e Lidhjes, populli shqiptar i bëri frontit të bashkuar të forcave të reaksionit një «sfidë të pashembullt», siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha: «këtu zot jam unë e kurkush nuk ka të drejtë ta nxjerrë këtë tokë n'ankand!»¹ Një fjalë e tillë nuk e humbet fuqinë as edhe pas një shekulli!

Pak ishin në numër vitet kur vepro i Lidhja, por çfarë vitesh! Çfarë ngjarjesh të ngjeshura e të stuhishme i mbushin ato! Si në çdo moment historik kur në arenë hyjnë masat popullore, të pajisura me një program që e kanë bërë për vete si mishërim i aspiratave të tyre jetësore, në këto vite ecuria historike bëri hope të vrullshme, arriti shkallë pjekurie politike, që do të ishin të pamendueshme për vite të një zhvillimi normal.

Me energji revolucionare të pashterura, me një patriotizëm të pastër, masat popullore shqiptare, si kurdoherë që janë në rrezik interesat e tyre më jetësore, gjetën në vetvete forcat morale e materiale, nxorën nga gjiri i vet forcat udhëheqëse dhe, sypatrembur e zemërhekur, u ngritën në luftë, pa mbështetje politike nga jashtë, me vetëbesim të patundur në forcat e veta.

Nën flamurin e luftës së Lidhjes për çlirim kombëtar, për mbrojtjen e tërësisë së trojeve të atdheut, për bashkimin e gjithë shqiptarëve në një unitet shtetëror autonom kombëtar, u bashkuan pa dallim krahine e feje, zemrat e armët e masave patriotike që nga Ulqini e Malësitë e Veriut, që nga Kosova kreshnike, që nga Dibra e krahinat e tjera të banuara prej shqiptarësh, deri në trevat më skajore shqiptare në jug

¹ Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 11.

e jugperëndim. Ky program u shpreh në protestat e memorandumet, në programet politike-ideologjike që dolën nga pena e udhëheqësve e ideologëve të shquar të Lidhjes si Abdyl e Sami Frashëri, Jani Vreto e Pashko Vasa etj., të atyre figurave të ndritura, të cilët i shërbyen çështjes së popullit si «iluministë revolucionarë të guximshëm, dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë», duke luftuar «me pushkë e me penë për lirinë e pavarësinë e popullit, për zgjimin e tij»¹.

Ky s'që një program që mbeti në letër; ai u vu në jetë në llogoret e luftës për mbrojtjen e trojeve të atdheut në Plavë e në Guci, në Hot e në Grudë, në Ulqin e në Jug, në mobilizimin e në luftën e masave popullore për të dëbuar administratën e urryer të memurëve osmanë, për t'ua dhënë pushtetin organeve të Lidhjes si organe të vetësundimit autonom, të «vetëligjësishë» kombëtare. Të paharruara do të mbeten për jetë aktet e heroizmit popullor të Sulejman Vokshit e Mic Sokolit, të Ali Ibrës e të Zef Koshares, të Isuf Sokol Logorecit e të armatës së paemër të luftëtarëve popullorë, të cilët në Dibër e në Kosovë, në betejat që u zhvilluan në Caralevë, në Shtimlje, në Slivovë e në Dule, në Malësinë e Tropojës etj., dhanë jetën për të mbrojtur autonominë dhe Qeverinë e Përkohshme, që ishte shpallur në tokat e çliruara.

Edhe pse u shtyp dhe u mbyt me terror e me gjak, lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare në vitet 1878-1881 çau rrugë të reja në historinë tonë kombëtare. Ajo qëndron si një bllok masiv në themelet e jetës së re të kombit shqiptar, këtë komb ajo e nxori faqebardhë para gjykimit të pasardhësve e të historisë, kësaj mësueseje të rreptë, po të drejtë të jetës.

*
* * *

Të ndërgjegjshëm për detyrën e nderit që ka shkenca marksiste-leniniste shqiptare për të studiuar e për të vlerësuar, për t'ua bërë të njohur masave tona punonjëse traditat e mëdha revolucionare patriotike të popullit tonë, historianët

¹ Enver Hoxha, *Raporte e fjalime 1967-1968*, Tiranë, 1969, f. 368-371.

e filozofët, filologët e letrarët tanë janë krenarë që mund t'i kushtojnë kësaj ngjarjeje të shënuar pengun e nderit e të ponisë së tyre, të mbledhur në këtë konferencë, që po i fillon sot punimet në atmosferën kremtore të këtij qindvjetori, si dhe në sesionet shkencore kombëtare që do ta pasojnë në 5 rrethe. Me referatat e kumtesat që do të paraqesin studiuesit tanë, duke u mbështetur mbi rezultatet e arritura prej kërkimeve tona dhe mbi një vlerësim kritik të studimeve të trashëguara do të përpiqen të japin një kontribut shkencor, secili nga këndi i fushës së tij, për të arritur një vlerësim e kuptim të thelluar, të kësaj ngjarjeje të shënuar të historisë sonë kombëtare.

Lidhja Shqiptare dhe veprimtaria e saj kanë tërhequr vëmendjen edhe të historiografisë së huaj, si pjesë e historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare në një periudhë kyç të tyre, dhe si problem interesant në kuadrin e studimeve krahasuese mbi lëvizjet kombëtare evropiane të shekujve XIX-XX. Nuk është e rastit që me këtë temë, për shkak të aktualitetit të saj, historiografia ndërkombëtare pati filluar të merrej qysh në vitet kur po zhvilloheshin vetë ngjarjet — dhe vazhdon ta bëjë këtë. Është e natyrshme se edhe në këtë fushë, ose sidomos në këtë fushë, ndeshen vijat e mëdha të kontradiktave ideologjike-politike të kohës, ashtu siç ndodh në përgjithësi për historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare të Krizës Lindore të viteve 1875-1878.

Duke u mbështetur mbi mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të Partisë e të shokut Enver, që Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe në gjirin e saj viteve të Lidhjes u kanë kushtuar kurdoherë vëmendje të veçantë, historiografia jonë e re, me një varg studimesh të saj është përpjekur për një kuptim dialektik e klasor të proceseve dhe të dukurive të kësaj periudhe të ndritur të historisë sonë. Në Historinë e Shqipërisë, vëllimi 2 (1965), u arrit një trajtim i parë i gjerë e i thelluar i kësaj epoke, i mbështetur mbi materializmin historik. Edhe pse jo pa të meta, kjo përbënte një hap të rëndësishëm përparë në historiografinë e përgjithshme kushtuar kësaj periudhe.

Historianët tanë kanë kënaqësinë të konstatojnë se për disa çështje e aspekte ata takohen edhe me rezultatet e punës së historianëve shqiptarë nga Kosova, si dhe me disa historianë përparimtarë të huaj. Mund të themi se rezultatet e historio-

grafisë së re shqiptare kanë çarë rrugë dhe një varg prej tyre janë pranuar tashmë dhe nga historiografia ndërkombëtare. Duke u mbështetur mbi punën e bërë, dhe me ndihmën e materialeve të reja që kanë dalë e që vazhdojnë të dalin në dritë, është bërë i mundshëm e i nevojshëm një trajtim më i thelluar e më i argumentuar i aspekteve të ndryshme të përmbajtjes së veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare në kuadrin e gjithë epokës së saj.

Këtij qëllimi i shërben edhe referati që po e hap vargun, i cili nuk synon tjetër veçse të shërbejë si njëfarë hyrjeje e përgjithshme për referatet e kumtesat që e pasojnë, duke paraqitur disa konsiderata mbi rrënjët historike të Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881.

*
* *
*

Problemi i rrënjëve historike të Lidhjes përbën një detyrë me karakter të ndërthurur e mjaft të ndërlikuar. Ai tërheq pas vetes një vargan pyetjesh të dyta, të cilat kërkojnë njëfarë zgjidhjeje paraprake, në qoftë se duam të arrijmë pastaj në kuptimin e drejtë të problemit të parë të shtruar.

Le ta nisim me konstatimin se historiografia jonë Lidhjen Shqiptare e veprimtarinë e saj nuk e kuptojnë si një episod të lidhur vetëm e thjesht kronologjikisht me çka e pararend dhe e pason. Ajo është pjesë përbërëse e rrjedhim i një tërësie ngjarjesh e procesesh, me të cilat është ndërlidhur dhe ndërthurur — procese që përbëjnë thelbin dhe përmbajtjen qenësore të shekullit XIX në historinë e popullit shqiptar.

Si në pikën e zjarrit të një thjerrëze optike, në vitet e mbarura me ngjarje të stuhishme të Lidhjes, përqendrohet problematika e gjithë këtij shekulli të epokës së Rilindjes sonë Kombëtare. Përmbajtja e këtyre viteve i përgjigjet plotësisht kuptimit historik të këtij termi, si një fazë që përbën përmbylljen e kapërcimit të kaluarës, në rastin tonë të periudhës së pashallëqeve feudale dhe nga ana tjetër lidhet me të ardhmen, në të cilën kalon nëpërmes një procesi përthyerjesh e përtëritjeje ekonomike-shoqërore e politike, duke nxjerrë for-

ca të reja shoqërore në skenë, duke u çarë rrugën marrëdhënieve shoqërore të reja më të larta.

Vitet e Lidhjes përbëjnë një kulm të parë të kësaj epoke historike, në të cilën procesi i konstituimit të shqiptarëve si komb, e fuqizon në shkallë të larta luftën e popullit për të dalë «nga errësira mesjetare feudale, imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë e arsim».¹ Kjo ishte rruga që çoi në çlirimin kombëtar, në emancipimin e plotë politik-shoqëror e kulturor të shqiptarëve si komb.

Duke e vendosur Lidhjen dhe veprimtarinë e saj në pikën e kryqëzimit të ligjësive, si një etapë më të lartë zhvillimi dhe rrjedhimi premisash objektive historike, të lidhur me armaturën ekonomike-shoqërore të një kombi të formuar, ky kuptim yni ndeshet ballë për ballë me disa pikëpamje sempliste, anti-shkencore, të cilat me një sofistikë antidialektike, duan ta përjashtojnë zhvillimin historik të popullit shqiptar nga sfera e veprimtarisë së ligjësive shoqërore «normale», duke paraqitur atë si rrjedhim fatalitetesh natyrore, gjeopolitike, të cilat përcaktokan pastaj edhe veprimin e faktorëve të tjerë shturës që nuk lejuakan zhvillimin e një kombi dhe të një lëvizjeje unitare kombëtare etj. etj.

«Autoritete» në lëmin e studimeve të Evropës Juglindore, që notonin dikur e notojnë ende në ujërat e turbullta të gjeopolitikës fashiste gjermane, e argumentojnë vlerësimin e tyre nihilist ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe luftës së saj me argumentin se tokat shqiptare, të cilat me të vërtetë përbëjnë kushtin themelor për ekzistencën e një kombi, qenkan «prej natyre një «tokë e kurrkujt» në dobi të fqinjëve majtas. djathtas e prapa krahëve të tyre». Vetë konfiguracioni i trojeve të tij e dënoka popullin shqiptar që të jetë, siç thonë ata, i paaftë për formimin e një shteti kombëtar, duke e detyruar të renditet kurdoherë në «suaza supranacionale», duke filluar «nga Bizanci e Perandoria Osmane e duke shkuar deri te Austro-Hungaria dhe Bashkimi Sovjetik», siç e formuloi përsëri tani së voni këtë mendim H.D. Shanderl, i cili qëndron mbi

1 Enver Hoxha, *Raporte e fjalime, 1967-1968*, Tiranë, 1969, f. 369.

shpatullat e «autoriteteve» si G. Shtadtmyler, Hajman, Hobus etj.¹

Ndofta nuk do t'ia vlente të qëndronim kaq gjatë në këto pikëpamje, po të mos ishte fakti se disa vepra si «Historia e Evropës Juglindore» e G. Shtadtmylerit, trumbetohen e ribotohen si një «Stardard work» i një autoriteti, i cili paska zbuluar ligjet që kanë drejtuar fatet e popullit tonë. Lëvizja Kombëtare Shqiptare — po ku ka një diçka të tillë, kur Shtadtmyleri e «di mirë», se shqiptarët, për shkak të përkatësisë së tyre «në bashkësinë fetare islamike» na paskan qenë «bartës klasikë të ndërgegjes perandorake osmane»². Çlirimi kombëtar i Shqiptarëve? — Po ai nuk qe gjë tjetër veç se një shkëputje mekanike e Shqipërisë nga territoret e Perandorisë Osmane, si një akt i diplomacisë evropiane, e cila e paska ngritur një «çështje shqiptare» sa herë që Perandoria Osmane kërcënohej me prishjen — më 1876 për herë të parë, thotë dishepulli i Shtadtmylerit, jugosllavi Stuli³ ose më 1912, thotë Shtadtmyleri⁴ dhe e përsërit D. Gjorgjeviçi (D. Djordjević) në raportin e tij para Kongresit Ndërkombëtar të Shkencave Historike në Vjenë, më 1965⁵, kur u prishën lidhjet territoriale me Stambollin dhe Shqipëria, «me kujdesin e Fuqive të Mëdha» paska rënë si një mollë nga druri, si shtet i pavarur në prehrin e shqiptarëve! Le t'u shtojmë këtyre zbulimeve edhe «ligjin e shpërthimeve demografike» të shqiptarëve që përcaktoka daljen e dhunshme të tyre në arenën historike sa herë që u dobësoka «autoriteti», d.m.th. kërbaçi, i pushtetit qendror perandorak!⁶

1 H. D. Schanderl, *Die Albanien-politik Österreich — Ungarns und Italiens 1877-1908*. Wiesbaden, 1971, f. 9, G. Gesemann, *Das Königreich Süd-slavien*. Leipzig, 1935, f. 20; E. Heymann, *Balkan Kriege, Bündnisse, Revolutionen*, Berlin, 1938, f. 63; G. Hobus, *Wirtschaft und Staat im südosteuropäischen Raum 1908-1914*, München, 1939, f. 72; G. Stadtmüller, *Albanische Volkstumsgeschichte als Forschungsproblem*, në: «Leipziger Vierteljahreschrift für Sudost-Europa», 5 (1941), f. 74.

2 G. Stadtmüller, *Geschichte Südosteuropas*, München, 1950, f. 343.

3 B. Stulli, *Albansko Pitanje*. Zagreb, 1959 (Rad. JAZU), f. 296.

4 G. Stadtmüller, vep. e cituar, f. 377.

5 D. Djordjević, *Les revolutions nationales des peuples balkaniques*, Beograd, 1965, f. 221-222.

6 G. Stadtmüller, vep. e cit. f. 339, 343, 347.

Në të tilla pikëpamje bashkëjetojnë në fakt edhe konceptet despotike e teokratike të sulltanëve-kalifë dhe të patrikanës ekumenike, për të cilët në Perandorinë Osmane nuk kishte kombësi, por vetëm 3 komunitete fetare, edhe konceptet shoviniste të një lloj publicistike të shkallës së fundit, të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX. E keqja është se pikëpamje të tilla, mbi bazën e ligjit të përsëritjes vazhdojnë të mbahen, ndonëse të kamufluara tani me një terminologji të re «sociologjike».

Shqiptarët? — S'ekziston një unitet i tillë; shqiptarë mund të quhen vetëm «turko-albanët» ose «gegët»!¹

Kryengritjet popullore shqiptare të viteve 1830-50? — produkte shthurjeje të një shoqërie feudale fisnore².

Lidhja shqiptare e viteve 1878-1881? — Një organ i maskuar keq i Portës, ose, në rastin më të mirë, një «aleancë turko-shqiptare» e forcave shoqërore më reaksionare, një shpërthim i ksenofobisë islamike, i shfrytëzuar nga Porta për të kundërshtuar humbjet territoriale pas Shën-Stefanit³.

Territoret kombëtare shqiptare të mbrojtura nga Lidhja? — Territore anësore!⁴

Autonomia e Shqipërisë si kërkesë e Lidhjes? — Një rrugë për të ruajtur epërsinë e myslimanëve shqiptarë mbi popullsinë sllave të krishterë të nënshtruar të Kosovës, derisa «dhuna shqiptare» e detyroi më në fund Serbinë të hyjë në Luftën e Parë Ballkanike!⁵

Emrat e historianëve si Stojançević, Rushes, Raznatović etj., që mbrojnë teza të tilla, as nuk do t'ia vlen të përmendje, po të mos ishte fakti që prapa këtyre pikëpamjeve fshihen tendenca dhe faktorë të caktuar politikë antishqiptarë.

Ne sollëm këtu si shembull e si tregues për qëndrimet që janë mbajtur, disa raste skajore nga literatura e 25 vjetëve të fundit, pa mohuar përpjekjet për një kuptim më të drejtë të dukurive e të proceseve që kanë të bëjnë me Lidhjen Shqip-

1 P. I. Rushes, *Albanias Captives*, Chicago, 1965, f. 8, 62.

2 V. Stojančević, *Jugoslovenski istorijski Časopis*, VII, 1957, f. 139, 140.

3 N. Raznatović, *Istoriski Zapiski*, Cetinje, 1963, nr. 1, f. 73 vv. «Mjedunarodni naučni Skup», vëll. I. Sarajevo, 1978, f. 294-297.

4 Po ai, *Istoriski Zapiski*, f. 37 vv.

5 V. Stojančević, *Jugoslovenski istorijski Časopis*, XI, 1960, f. 208-209, 212.

tare e me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, nga autorë të huaj si Stavrianos¹, Bartl², Shanderl³ etj., për të përmendur vetëm disa studime të fundit, me gjithë të metat që ato paraqesin.

Në këto kushte, detyra për të vënë në dukje rrënjët historike të Lidhjes Shqiptare e të veprimtarisë së saj, kërkon prejnesh që ato të vendosen së pari në pikën e kryqëzimit të ligjësive objektive të historisë së popullit tonë, për të treguar se faktorët themelorë që përbëjnë përmbajtjen e Lidhjes nuk qenë as produkte të «importit», as të rastit e të çastit. Rrënjët e tyre historike të çojnë në thelbin e atyre problemeve që përbëjnë koordinatat themelore të zhvillimit historik të popullit shqiptar, duke u nisur nga fillimi i shekullit XIX.

*
*
*

Le të fillojmë me konstatimin se përpjekja për një kuptim të drejtë shkencor të Lidhjes Shqiptare dhe të epokës së saj duhet të nisët nga vatra e këtyre ngjarjeve, nga Shqipëria e populli shqiptar, nga njohja e thellë e kushteve të zhvillimit të tyre të brendshëm e të forcave lëvizëse të shoqërisë shqiptare, pa lënë pas dore, pa dyshim, edhe ndërthurjen e faktorit të brendshëm me atë të jashtëm. Pikërisht një orientim i tillë u ka munguar studimeve të huaja, duke përfshirë këtu edhe literaturën historike shqiptare të Paraçlirimit. Një orientim i tillë kërkon që pika e gravitetit të kalojë nga jashtë — brenda. Kushti i dytë është që ky orientim të shprehet edhe në vlerësimin e bazës burimore, duke i dhënë përparësi materialit burimor të brendshëm. Këtu nuk është fjala thjesht për aspektin formal të prejardhjes, por në radhë të parë për karakterin e burimeve, nga i cili përcaktohet deri diku edhe orientimi i kuptimit të objektit që studiohet.

Duhet thënë se dobësia e përgjithshme e punimeve, midis tyre edhe e autorëve që përmendëm më lart për përpjekje më

1 I. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, N. York, 1958, f. 502-4.

2 P. Bartl, *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung 1878-1912*, Wiesbaden, 1968.

3 H. D. Schanderl, vep. e cit.

serioze për ta kuptuar këtë epokë, qëndron në absolutizimin e vlerës së bazës faktike që kanë pasur në dispozicion, qëndron në injorimin e karakterit të njëanshëm të saj. Nga kjo kritikë nuk mund të përjashtohen deri diku edhe punimet e deritani-shme të historiografisë sonë. Dihet se me gjithë materialin faktik të pasur që japin, raportet konsullore, të cilat përbëjnë mbështetjen kryesore, në disa raste edhe të vetmen, për njohjen e kohës, i shohin ngjarjet, sidomos ato që zhvillohen në Shqipëri, me syzet e paragjykimeve kulturore dhe të «parti pris» të politikës së shteteve të tyre. Dhe vetëm realiteti kokëfortë i de-tyron nganjëherë, por me shumë vonesë, hartuesit e tyre të pranojnë deri me njëfarë shkalle realitetin, në qoftë se ia arrijnë! Rrjedhimi i kësaj njëanshmërie është ai primitivizim i tmerrshëm që i bëhet nga shumica e literaturës së huaj gjendjes ekonomike-shoqërore të tokave shqiptare. Po të nisesh, p.sh., nga terminologjia e përdorur në ato dokumente, popullsia, jo vetëm e krahinave për të cilat luftonte Lidhja, po e gjithë tokave shqiptare, në të vërtetë nuk paska qenë shqiptare, sepse përbëhej nga «turq e grekë» (për ne është e qartë se këto terma përdorëshin natyrisht në kuptimin fetar!) Nga mosnjohja e nga moskuptimi i asaj gjendjeje të ndërlikuar që sundonte në malësitë shqiptare të ndara në njësi administrative-ushtarake të vetadministruara, përdorej termi «fis» në një funksion që ai as nuk e kishte, as nuk e kishte pasur që prej disa shekujsh, duke e përgjithësuar atë, ç'është akoma më keq përtej disa trevave të kufizuara malore, mbi territorin e gjithë Shqipërisë, në një fazë kur me gjithë prapambetjen karakteristike për vendet nën sundimin e Perandorisë Osmane, në jetën e saj vepronin tashmë ligjet e ekonomisë dhe të shoqërisë kapitaliste dhe ishte formuar ajo kategori e qëndrueshme historike, kombi shqiptar, mbi bazën e bashkësisë territoriale, gjuhësore, ekonomike e kulturore-shpirtërore. Si rrjedhim i këtij primitivizimi të përgjithshëm, primitivizohej edhe gjithë Lidhja Shqiptare, karakteri dhe përmbajtja e veprimtarisë së saj.

Për këtë arsye ne mendojmë se për kuptimin e veprimtarisë së Lidhjes, përparësi duhet të kenë dokumentet e lindura në vend, sidomos ato që kanë dalë nga veprimtaria e qendrës dhe e degëve të Lidhjes, d.m.th. aktet, vendimet, memorandumet, publicistika, epistolaret e anëtarëve të saj, që historiogra-

fia jonë i ka vlerësuar dhe i ka vënë në qarkullim si burime të dorës së parë. Me gjithë dobësitë e paqartësitë që jo rastësisht përmbajnë, me gjithë gjuhën ezopike që janë të detyruar të përdorin, ato përbëjnë një bazë autentike për të përcaktuar programet e Lidhjes dhe veprimtarinë e saj në evolucionin e tyre historik.

*
* *
*

Cili qe trashëgimi që mori epoka e Lidhjes nga e kaluara, trashëgim ndaj të cilit ajo, si çdo brezni historike pasardhëse, mbajti, në mënyrë të vetëdijshme ose jo, një qëndrim dialektik, e vazhdoi, e ngriti në nivel më të lartë dhe më në fund e kapërceu?

Jo rastësisht ne i lidhëm rrënjët e epokës së Lidhjes me filimet e shekullit XIX, që në kushtet historike të tokave shqiptare do të thotë me dy pashallëqet në fakt autonome të Shqipërisë së Veriut dhe të Jugut. Tregjet ndërkombëtare, të formuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII, qenë një hap drejt unitetit ekonomik të vendit e u shërbyen këtyre formacioneve shtetërore feudale shqiptare si bazë për të bashkuar shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare në kuadrin e dy formacioneve politike paralele. Këtu nuk është fjala për një dukuri anarkie (Shtadtmyler)¹, ose për një dukuri shturjeje e degjenerimi që shënon një fund (Vukosavljeviç)², por për një proces me elemente ekonomike e politike që çonin përpara, shprehje e një qëndrese të përgjithshme të një kombësie të nënshtruar, në të cilën bënte pjesë edhe klasa feudale e fuqizuar shqiptare. Ky ishte një proces, i cili, siç thekxson Engelsi, për mesjetën favorizonte formimin e kombeve e të shteteve kombëtare, në bazë terriroresh unitare nga pikëpamja e kombësisë e të gjuhës³.

Rënia e dy pashallëqeve, më 1822 e më 1831, nuk mund të ishte, pra, fundi, por ishte fillimi i një qëndrese në shkallë

1 G. Stadtmüller, Vep. e cituar, f. 345-347.

2 S. Vukosavljeviç, *Istoria seljačkog društva*, Beograd, 1956, f. 13.

3 *Marx-Engels-Lenin-Stalin zur deutschen Geschichte*, vëll. I, Berlin, 1956, f. 162.

më të gjerë, me forcat e reja të masave popullore, që zunë të dalin tani e tutje në ballë të konfliktit me pushtetin qendror të huaj; ky konflikt nuk zhvillohej më nëpërmes luftës së kufizuar të klasës feudale, por në ndeshje ballore e masive në një mënyrë siç nuk kishte ndodhur më që prej shekujve XV-XVI, kundër asaj që Sami Frashëri e quajti «pushtimin e dytë të Shqipërisë», kundër atij vërshimi memorësh «myflisë së pabrekë», «halldupë e konjarë», siç i cilësonte me urrejtje populli jo vetëm sepse ishin të huaj si kombësi, por edhe sepse me ta vinte një sistem i tërë i rëndë taksash e detyrimesh, gjyqesh të korruptuara dhe shërbimi ushtarak në dhe të huaj. Kontradikta kombëtare përforcohej kështu nga kontradikta shoqërore. Çdo lëvizje kombëtare e një populli të shtypur, na mëson Lenini, ka në vetvete një element demokratik¹. Një dëshmi të gjallë të kësaj shkrirjeje të dy elementeve, kombëtar e shoqëror, që përbën thelbin e fuqinë e lëvizjes kombëtare e të patriotizmit popullor, na e jep një vjershë e viteve 60. e lindur në zonën Tepelenë-Gjirokastër:

*Ky halldupi, ky konjari bukën tonë po na ha,
Xhveshur, zbathur na ka lënë, lakuriq pa një para.
Gjithë halldupët pashallarë, të mëdhenj e si zotë,
Shqipëitari s'ka të mbajë as një feste në kokë,
Gjynah, pra, nga perëndia të punojë shqiptari,
Dhe të hajë e të pijë e të bëjë rehat konjari...²*

Për vetë karakterin e saj të gjithanshëm, kjo kontradiktë nuk mund të kufizohej vetëm në masat fshatare, ajo do të për-fshinte, siç e bëri në fakt, së bashku me to, dhe për të njëjtat arsye edhe popullsinë qytetare. Kryengritjet, të nisura si lëvizje «fshatare», gjejnë mbështetje në qytetet (Berat, Elbasan, Shkodër, Prizren, Gjakovë etj.); në disa raste rolin udhëheqës e merr dhe e ruan tanimë qyteti, siç qe rasti në Shkodër, në qytetet e Kosovës, që dëshmonte për forcimin e frontit dhe për rritjen e ndikimit të borgjezisë qytetare, si forcë më e përparuar, mbi fshatin, që ishte përfshirë tani në sferën e veprimit

1 V. I. Lenin, *Veprat*, vëll. 20, f. 471.

2 E. Brandi, *Alvanika parapona*, Athinë, 1880, f. 152, 153.

të tregjeve qytetare. Me këto lëvizje u bashkua, në një varg rastesh edhe si udhëheqëse, një pjesë e klasës feudale shqiptare, e zhveshur prej reformave centralizuese osmane nga pushteti politik në vend, me synimin për t'u rikthyer në fuqi — një synim objektivisht i porealizueshëm, sepse me shembjen e pashallëqeve dhe me tatëpjetën e pronës feudale-ushtarake, klasa feudale ishte dobësuar tashmë, ndërsa po konsolidoheshin gjithnjë e më tepër pozitat e ekonomisë së re kapitaliste, në kuadrin e së cilës qe detyruar të përshtatej edhe ekonomia çifligare.

Kuadri që paraqiste Shqipëria në vitet 30-50 të shekullit XIX karakterizohet nga acarimi i mëtejshëm i konfliktit osmano-shqiptar, që nxori në shesh elemente të reja, sasiore dhe cilësore. Në këto kryengritje merrnin pjesë të gjitha klasat e shtresat e popullit shqiptar me një shtrirje të gjerë që nga veriu, nga lindja e deri në jug, ç'ka i bënte ato në fakt kryengritje të përgjithshme të shqiptarëve si një tërësi kombëtare. Dhe si të tilla ato u kuptuan edhe nga Porta, edhe nga diplomatët të huaj. Ato shpërthyen njëra pas tjetrës, në të njëjtat vite, kundër të njëjtit armik, për të njëjtat shkaqe edhe faktikisht për të njëjtat kërkesa e qëllime (nga lëvizje tipike fshatare, siç qe rasti në zonën Kumanovë-Tetovë-Gostivar, që «zgjedh» nga radhët e veta «mbretin e mirë», mbretin Dervish, për t'u mbrojtur nga zullumet e «mbretit të keq», ato shkojnë deri te kryengritjet e udhëhequra në Jug nga Tafil Buzi që kërkonin të arrinin qëllime të një niveli më të lartë politik, shkëputjen nga sundimi osman, për të shpëtuar nga të këqijat që sillte regjimi i absolutizmit burokratik të sulltanit, sipas shembullit të fqinjëve ballkanikë që kishin krijuar shtetet e veta.

Këto rrethana u bënë shkak që të realizoheshin forma organizative më të larta; u krijuan kuvende e besëlidhje ndërkrahinore, të cilat lejuan veprime luftarake të përbashkëta në shkallë të gjerë, siç ishte Besëlidhja e 9 krahinave, më 1828, e përtëritur më 1834, që drejtoi për disa vite me radhë kryengritjen e Toskërisë dhe krijoi lidhje edhe me lëvizjet e Shqipërisë së Veriut, aksionet e përbashkëta të Dibrës me Elbasanin, të Matit e të Kosovës me Shkodrën dhe Kuvendi i Madh Ndërkrahinor i Mesaplikut si organizatë politike e kryengritjes së vitit 1847.

Nevojat e luftës përbënin një faktor objektiv, që shtynte

përpara për të gjetur forma organizimi politik-ushtarak të reja më të larta e të qëndrueshme. Porse kësaj situatë objektive nuk i përgjigjej aspekti subjektiv. Deri në pragun e Lidhjes nuk u arrit ende një organizim i tillë unitar i gjithë kësaj lëvizjeje. Megjithatë kjo ishte objektivisht luftë e përbashkët e gjithë krahinave shqiptare, që përfshinte e përfaqësonte në thelb interesat objektive të të gjitha klasave e shtresave themelore që përbënin shoqërinë shqiptare. Kërkesa për të përjashtuar nga zbatimi i politikës së centralizmit burokratik tokat shqiptare, donte të thoshte në fakt zbatimin e një statusi të veçantë për territoret shqiptare duke i dalluar dhe duke i veçuar ato nga territoret e tjera të Perandorisë. Ajo përmbante pra, «në vezë» kërkesën e administrimit autonom të Shqipërisë, duke ia lënë këtë në dorë «krerëve» të vendit, çka nuk donte të thoshte kurrësi, në kushtet e shndërrimeve ekonomike-shoqërore, që po ndodhnin në Shqipëri, që pushteti t'u kalonte në dorë përfaqësuesve të «regjimit të vjetër» tashmë të perënduar.

Edhe pse nuk kishte ende një program politik me synime largshkuese të formuluar qartë, këtu kemi të bëjmë me një konstelacion forcash shoqërore, që përfaqëson tashmë interesat e kombit shqiptar si një unitet, një konstelacion që do të zotërojë arenën politike shqiptare deri më 1912.

Këto lëvizje të fuqishme të viteve 30-50, ku rolin kryesor e luanin masat popullore, përbëjnë në të vërtetë fazën e parë, e jo vetëm një premisë, përgatitje, ose sfond, të asaj epoke të re, e cila me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare, realizoi detyrën e vërtetë historike të shekullit XIX: çlirimin e popullit shqiptar nga robëria e Perandorisë feudale Osmane, krijimin e shtetit të pavarur e sovran, si kusht për zhvillimin e tij të mëtejshëm ekonomik e shoqëror.



Kërkesat që kishin shtruar kryengritjet popullore mbetën në fakt edhe më tej në rendin e ditës, përtej viteve 1878-81; po pikërisht në vitet e Lidhjes ato gjetën rast për të shpërthyer

me forcë të re; ato përbëjnë atë lëvizje masive që zhvillohet përsëri në të gjitha krahinat shqiptare, nga veriu në jug, kundër organeve të pushtetit osman. Edhe tani bashkohej urrej-tja kundër «të huajit», ai termi «halldup» e «konjar» vazhdon ta ruajë kuptimin e dallimit si kombësi — me urrejtjen me karakter shoqëror, të drejtuar kundër administratës së korrup-tuar osmane si shfrytëzuese të masave popullore. Pa këtë rrënjë shoqërore nuk do të mund të kuptoheshin as aksionet masive për mënjanimin (në shumë raste dhe dëbimin me dhunë) e organeve shtetërore thujse në të gjitha qytetet e Shqipërisë në vitet 1878-1881, as mbështetja që gjeti programi i autonomisë së hartuar dhe të zbatuar më në fund me dhunë, në luftë të hapur kundër Portës, nga krahu më i përparuar i Lidhjes, duke pasur për këtë mbështetjen, madje në radhë të parë, të masave popullore.

Por kjo urrejtje shoqërore kundër shfrytëzuesit e nxiste edhe më tepër urrejtjen kundër sundimitarit të huaj kur ky, pa pikë ngurrimi, po nxirrte tani në ankand pasurinë e parë dhe kryesore të popullit, truallin, tokën e tij, duke përdorur të njëj-tën dhunë, me të cilën po e mbante prej shekujsh nën robërinë e vet. Në këtë pikë përputheshin interesat shoqërore dhe ato kombëtare të masave popullore me ato të borgjezisë kombëtare, që përbënin në këtë etapë shtresat demokratike të shoqërisë shqiptare. Në momentin e caktuar historik, në këtë front u tërhoq edhe klasa çifligare e mënjeluar nga pushteti politik, e kërcënuar edhe ajo nga rreziku i përbashkët i humbjeve territoriale. Kjo përputhje interesash e klasave dhe e shtresave kryesore të kombit në këtë moment të caktuar, përbënte një faktor që e lejoi luftën të arrinte një etapë më të lartë zhvi-llimi.

Këtij fronti të gjerë forcash shoqërore i shërbeu programi i përvijuar nga aktivistët e Rilindjes në vijat e tij të për-gjithshme qysh në vitet 50-60; ky program arriti përcaktimin e objektivave dhe të rrugëve konkrete për realizimin e tyre, në pragun e Lidhjes dhe gjatë viteve të veprimtarisë së saj.

Nga vetë kushtet konkrete historike të Shqipërisë, ishte e qartë se objektivi që qëndronte përpara lëvizjes kombëtare, ishte lufta për çlirim kundër sundimit osman, kjo ishte vazhda logjike, sidomos e gjysmëshekullit të kryengritjeve popullore

kundër regjimit të centralizmit burokratik. Por në kushtet konkrete të krijuara veçanërisht në vitet e Krizës Lindore, ky objektiv kishte si plotësim një objektiv të dytë: mbrojtjen kundër ndërhyrjes grabitqare të monarkive ballkanike e të Fuqive të Mëdha prapa tyre.

Sigurimi i të drejtave kombëtare kundrejt Portës dhe njëkohësisht i trojeve kombëtare kundrejt rrezikut të copëtimit nga intervencioni i forcave të shteteve fqinje, përbënte një detyrë të ndërthurur shumë të madhe e të rëndë, e cila mund të zgjidhej me sukses, në rrugën e luftës së armatosur, vetëm po të mbështetej mbi një program politik të përparuar; mbi bashkimin e gjithë shqiptarëve në një unitet shtetëror kombëtar, cilado të ishte forma e tij. Kësaj lufte, pra, duhej t'i paraprinte një luftë ideologjike, e cila do ta shoqëronte dhe ta plotësonte atë, për ta vënë lëvizjen shqiptare mbi baza politiko-shoqërore të reja, të përparuara. Është e qartë se me këtë kuptim, Lidhja dhe veprimtaria e saj nuk hyjnë kurrsesi në atë kallëp, në atë shtrat Prokrusti, ku duan ta fusin ata historianë që e konceptojnë atë thjesht si një lloj lufte antiintervencioniste, duke nxjerrë prej kësaj premise fillestare të gabuar, domosdo, dashur e padashur, por më tepër me dashje, ato konkluzione të gabuara e antihistorike që vumë në dukje në fillim.

Këta komponentë themelore, të programit të Lidhjes kishin një parahistori; ato nuk lindën në një moment, të gatshme, si Athinaja nga koka e Zeusit.

Procesi historik i konsolidimit të kombit shqiptar si një kategori historike më e lartë, proces që zhvillohet në gjysmën e parë të shekullit XIX, ishte lidhur me një përmbajtje të re ekonomike-shoqërore. Në kushtet e Shqipërisë, as fshatarësia, për vetë gjendjen e saj të prapambetur dhe për natyrën e saj shoqërore, dhe aq më pak klasa sunduese çifligare, nuk mund të ishin forcat drejtuese të këtij procesi. Kjo ishte detyra historike e borgjezisë kombëtare shqiptare dhe e inteligjencies së re të dalë nga radhët e saj, të interesuar për vetë interesat e tyre klasore, në një zgjidhje përparimtare të detyrave kombëtare e demokratike që shtronte koha. Dhe kësaj detyre, inteligjencia përparimtare shqiptare e kohës iu përgjigj me nder.

Jo rastësisht, lind pyetja, se ku duhen kërkuar rrënjët e kësaj lëvizjeje që ka shkruar faqe të ndritura të historisë së mendimit politik-shoqëror e të kulturës së kombit tonë.

Një literaturë e tërë i është kushtuar kësaj pyetjeje, në kuadrin e problemit të studimit krahasues të lëvizjeve kombëtare të popujve, sidomos të Evropës Juglindore.

Nuk na çudit që një problem kaq i ndërlikuar ka gjetur shpesh përgjigje simpliste, si ajo e dhënë nga Shtadtmlyeri, sipas të cilit popujt e Evropës Juglindore paskan njohur vetëm ndjenjën e «dallimit etnik» kundër të huajit, por nuk paskan pasur një «ide kombëtare» (Nationalgedanken), të barabartë me atë të Perëndimit. Ata e paskan «importuar» këtë të gatshme, në momentin e çaktuar, prej andej¹.

Kjo është një mënyrë krejt e njëanshme e të shtruarit të problemit, që i sheh dukuritë ideologjike në prizmin e huazimeve thjesht mekanike. Këtu është fjala në të vërtetë për një ndërlidhje dialektike të proceseve ideologjike me bazën e tyre, ku proceset ideologjike në një varg rastesh, u paraprijnë ndryshimeve në bazë.

Një gjysmëshekulli i tërë, i mbushur me ngjarje e procese të brendshme politike-shoqërore tronditëse, kryengritjet e Bushatllinjve e të Ali Pashë Tepelenës e rënia e tyre, kryengritjet e mëdha popullore, të viteve 1830-1850, që mbuluan gjithë Shqipërinë, ndërthurja e konflikteve të jashtme, Revolucioni i viteve 1848-1849, kryengritjet e popujve fqinjë që çuan në formimin e shteteve ballkanike, ndërhyrja e këtyre në skenën politike shqiptare, e më në fund lëvizjet e armatosura që shpërthenin pa ndërprerje kudo në Shqipëri, deri në pragun e Lidhjes, në Dibër, në Dukagjin, në Kosovë, në Mirditë etj., a nuk përbënin ato ngjarje, të cilat shtronin përpara vepruesve mendorë të kohës atë pyetje tronditëse, që shtrohet para popujve pikërisht në momente kthese: Çfarë duhet të bëjmë? Cila është rruga që duhet të ndjekim? Nuk është kurrsesi e filluar nga Jubani, P. Vasa, e deri te S. Frashëri e nisën pikërisht nga këto ngjarje fillin logjik për konsideratat e tyre në lidhje me rrugën historike e me platformën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Përgjigjen u përpoq t'ua jepte këtyre pyetjeve një brez, i cili doli në arenën historike pikërisht në këtë fazë të re, që

¹ Stadtmüller, *Vep. e cituar*, f. 231-236.

nis me çerekun e parë të shekullit të ri. Midis të paemërve, i pari që e njohin me emër ndër figurat e ideologëve të Rilindjes sonë, është Naum Veqilharxhi, i cili shkruante, më 1846, ato fjalë lapidare që shënojnë këtë kthesë: «Ka ardhur koha që t'i flakim të gjitha paragjykimet e vjetruara, ka ardhur koha ... që të këmbëjmë udhë... duke marrë si shembull kombet e përparuara mbi tokë ... Dhe duke synuar këtu, le të ecim pa u lëkundur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje». Si në çdo rast, faza kur një proces bëhet i ndërgjegjshëm e gjen një shprehje programatike, tregon se ai ka arritur tashmë një shkallë të lartë pjekurie.

Problemi që shtruam në lidhje me zanafillën e këtyre lëvizjeve mendore dhe zgjidhja që mendojmë se i duhet dhënë, është në kundërshtim të plotë me shpjegimet që i janë dhënë mekanizmit të lindjes së proceseve të lëvizjeve kombëtare në literaturën historiografike perëndimore, ku përcaktohen për këtë qëllim disa «modele tip», siç është, p.sh., ai i historianit çekoslllovak M. Hroh¹, (M. Hroch) që pretendon të cilësohet marksist. Ato e kthejnë problemin me kokë poshtë, kur mendojnë se lëvizjet kombëtare të popujve të vegjël nisen nga veprimtaria hulumtuuese e disa figurave eruditësh si, p.sh., të tipit të Herderit, rreth gjuhës e historisë së një populli të tillë, dhe vetëm më vonë arritkan të përfshijnë një rreth të caktuar më të gjerë.

Shembulli shqiptar, si shprehje e një ligjësie më të përgjithshme, nuk hyn në këtë model jo sepse përbën një përjashtim, por sepse vetë modeli është i shtrembër. Rilindësit tanë u nisën nga përvoja historike e kohës dhe, nëpërmes përpunimit e përgjithësimit teorik të saj, hartuan platforma programatike, të cilat në një shkallë më të lartë të spiralit, iu drejtuan bazës nga e cila ishin nisur, duke u shërbyer lëvizjeve të kohës si program e si platformë ideologjike-politike. Kjo qe rruga që ndoqën pas Veqilharxhit Zef Jubani, Pashko Vasa e më vonë Sami Frashëri, vepra e të cilëve përbën në një vijë vazhduese ngjitëse, etapat kryesore të zhvillimit të mendimit politik-shoqëror të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

1 Th. Schieder (ed), *Sozialstruktur und Organisation europ. Nationalbeweg.* München, 1971, f. 124-125.

Armët mendore për zgjidhjen e këtyre detyrave, përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje të re i morën nga arsenali i ideve që u ofronte koha, duke zgjedhur e duke përvetësuar andej çka kishin nevojë. Iluminizmi, i lindur në kushtet e luftës së borgjezisë evropiane të fundit të shekullit XVIII kundër rendit feudal-absolutist, u bë shkolla ku, si gjithë inteligjencia ballkanike, edhe inteligjencia përparimtare shqiptare mësoi në gjysmën e parë të shekullit XIX të përdorte armët e luftës. Ata kaluan të gjithë nëpër shkollën e Rusoit, teoria e të cilit mbi të drejtën natyrore të individit e të popujve u kundërvihet si një «ungjill» i ri, pretendimeve të rendit të vjetër feudal-absolutist për të qenë i përjetshëm. Nga ky burim është ushqyer antiteza «natyrë-konvencion», e cila qëndron në bazë të mendimit filozofik e politik të Jani Vretos. Në bazë të teorisë të së «drejtës natyrore», Jani Vretoja «sovrانيتetin e popullit», lirinë «e lindur me njeriun si dhuratë të parë që i jep natyra», kombin si një kategori të «vetëdijtë»¹, ua kundërvinte atyre pushteteve që mbaheshin në fuqi «për hirë të zotit», perandorisë universale të sulltanit, «kishës së madhe të Stambollit» ose fuqive të mëdha bashkëkohore. «Shtetet e qytetëruara (nënkupto Fuqitë e Mëdha) kurrë nuk kanë folur gjëra të drejta, ata kanë folur e vepruar kurdoherë padrejhtësisht e në kundërshtim me natyrën»², shkruante ai në lidhje me vendimet e Kongresit të Berlinit kundrejt Shqipërisë, duke i vënë ato në një radhë si shkaktarë të dhunës, të grabitjes, të përçarjes, të obskurantizmit që rëndonin mbi popullin shqiptar.

Nën shenjën e historizmit fillon ai kthim drejt së kaluarës së kombit, një lloj romantizmi aktiv, i kthyer nga e kaluara për të marrë fuqi, e që shikon me optimizëm përpara, me besim në mundësitë e rrugës historike të popullit të vet, duke e konsideruar realitetin e prapambetur si një moment relativ në rrugën e zhvillimit njëlinear të popujve. Këto janë konceptet e Veqilharxhit, që përmbajnë «në bërthamë» gjithë filozofinë teorike e praktike të Rilindjes sonë në fazën e saj të parë, një filozofi e shtimit të shtetit dhe e demokratizimit. Edhe të

1 J. Vreto, *Vepra të zgjedhura*, përgatitur nga A. Uçi, Tiranë, 1973, f. 230, 232, 237.

2 Letër e J. Vretos drejtuar Jani Koto Hoxhit, datë 25.4.1879, AQS, Fondi 66, Dosja 6.

nisej nga pozita të filozofisë idealiste, ishte vetë realiteti, ishin kushtet reale historike që i imponuan asaj zgjidhjet konkrete të drejta. «Si iluministë revolucionarë të guximshëm, rilindësit bashkuan kurdoherë teorinë me praktikën, luftuan edhe «me pushkë e me pendë për lirinë dhe pavarësinë», thotë shoku Enver Hoxha¹.

Kjo ishte një detyrë e ndërthurur që niste me përpjekjet për afirmimin e gjuhës amtare si shprehje të identitetit dhe të unitetit kombëtar në luftë kundër presionit shkombëtarizues të gjuhëve e të kulturave universale të shtetit e të kishave, dhe njëkohësisht si «rrip transmisioni i rëndësishëm»² për të përfshirë në lëvizje masat, për të realizuar mbi këtë bazë të gjerë e demokratike njësinë kombëtare edhe në aspektin politik, duke kapërcyer përçarjet fetare e krahinore.

Vetë realiteti historik, faktori i masave të vëna në lëvizje prej dhjetëra vjetësh, në luftë për të drejtat e tyre shoqërore, vetë interesat klasore të borgjezisë kombëtare-bënin që kjo luftë të mos mbetej thjesht në një plan gjuhësor-kulturor. Bashkimi kombëtar — donte të thoshte bashkim jo vetëm mbi bazën e bashkësisë etnike-gjuhësore e të historisë së përbashkët; ai merrte edhe një përmbajtje politiko-territoriale dhe ekonomiko-shoqërore të përparuar.

Duke i shtruar në mënyrë thelbësore këto koncepte, Zef Jubani e Pashko Vasa, të parët, e zgjeronin konceptin e Kombit si bashkësi historike, shpirtërore e gjuhësore, duke vënë theksin mbi aspektin territorial dhe përmbajtjen ekonomike dhe mbi rrjedhimet shoqërore që duhej të kishte krijimi i një formacioni shtetëror shqiptar.

Problemi i njësisë dhe i mbrojtjes së trojeve të popullit shqiptar vihej kështu në kryqëzimin e vijave të mëdha ideologjiko-politiko-ekonomike. Këtu ishte fjala jo vetëm për troje stërgjyshore, për vatrën e lashtë historike të një populli që i kishte larë prej shekujsh me gjak, siç e theksonin memorandumet e Lidhjes Shqiptare vazhdimisht, por njëkohësisht edhe për bazën e jetës ekonomike të popullit, cenimi i së cilës prishte ekuilibrin e një bashkësie ekonomike të formuar historikisht, siç theksonite me një gjykim të mprehtë Jani Vreto.

1 Enver Hoxha, *Raportet e fjalime, 1967-1968*, Tiranë, 1969, f. 869.

2 Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 10.

Ideologët e Rilindjes dhe aktivistët e Lidhjes me të drejtë shihnin në unitetin territorial formën e vetme me të cilën jeta kombëtare mund të arrinte zhvillimin e saj të plotë dhe unitar. Këtu ishte fjala për një rezultat logjik të gjithë zhvillimit historik të jetës së një populli dhe njëkohësisht për kushtin themelor të realizimit të së drejtës për t'u konstituar e për t'u organizuar si një unitet politik kombëtar.

Në këtë kuptim, lufta që zhvilloi Lidhja për mbrojtjen e çdo pëllëmbë toke, kishte një kuptim të përgjithshëm. Deklarata që i bëri populli i Plavës e i Gucisë Komisionit Ndërkombëtar, më 15.VIII.1879, se as ai vetë nuk kishte të drejtë të dispononte mbi tokën e krahinës së tij pa miratimin e gjithë krerëve të Shqipërisë, tregonte se kjo ide kishte zënë tashmë rrënjë të thella në ndërgjegjen e masave popullore.

E parë në këtë ndërlidhje të përgjithshme, edhe kërkesa për një status të veçantë e autonom të tokave shqiptare vjen duke marrë një kuptim më të plotë e më të lartë politik, duke u mbushur me përmbajtje politike dhe ekonomiko-shoqërore më të përparuar në mendimin e në veprat e Zef Jubanit, të Pashko Vasës, në memorandumet e Lidhjes etj. Në konceptin e autonomisë së Shqipërisë fillojnë të bashkohen si në një lumë, rrymat e veçanta të luftës për autonomi krahinore që kishin një vatër aktive veçanërisht në malësitë. Me interes janë në këtë drejtim përpjekjet e përsëritura disa herë, qysh nga viti 1862 e deri më 1876-77, nga grupi i atdhetarëve të Shkodrës me Zef Jubanin në krye, për t'i bërë kryengritjet e Mirditës pikënisje për të shtruar gjithë çështjen shqiptare, një detyrë kjo që u realizua në plan kombëtar e ndërkombëtar vetëm në vitet e Lidhjes, në luftën e saj për realizimin e autonomisë politike të të gjitha tokave shqiptare së bashku.

Rritja dhe zgjerimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare shtrojnë si detyrë gjithnjë e më urgjente, krijimin e një qendre organizative unike të saj. Orvatjet e përsëritura qysh prej vitit 1858 në Stamboll, çuan në realizime akoma të pjesshme; tepër të mëdha qenë vështirësitë që vinin nga faktorë pengues të brendshëm e në radhë të parë, të jashtëm. Formimi i shoqërive e i komiteteve të veçanta në Shkodër e sidomos jashtë atdheut: në Stamboll, në Bukuresht, në kolonitë arbëreshe të Italisë, qenë një fillim që arriti të realizohej në plan

mbarëshqiptar vetëm më 1877, me krijimin e Komitetit të Stambollit dhe nën kujdesin e tij, të Komitetit Qendror të Lidhjes me qendër në Prizren dhe me degët e me komitetet e saj lokale në të gjitha krahinat e banuara prej shqiptarëve. Kjo qe zgjidhja në nivelin më të lartë të kësaj detyre të rëndësishme politike kombëtare.

Ndoqëm vijat e zhvillimit të një vargu procesesh të karakterit politik-shoqëror. Si rezultate të zhvillimit të brendshëm ato na çojnë deri në pikën e kryqëzimit të tyre, në prapësinë e themelimit të Lidhjes Shqiptare në vitin 1877.

Të theksosh se kjo ishte një rezultante procesesh të brendshme, nuk do të thotë kurrsesi të nënvleftësosh rëndësinë e faktorit ndërkombëtar. Ai luajti një rol të rëndësishëm, edhe sikishte si të mos e luante, si faktor ndihmës, si ajo «shkëndi elektrike» që shërbeu, pas fjalëve të Pashko Vasës, për shpërthimin e dinamitit të grumbulluar prej kohësh, si një katalizator që bën të precipitojnë proceset kimike.

*
* *
*

Në jetën politike të popujve të robëruar nuk mungojnë rastet kur lufta e tyre gjen një situatë ndërkombëtare të favorshme, e cila e bën të mundshme formimin e një aleance politike pak a shumë të qëndrueshme. Populli shqiptar, për një varg rrethanash, as në shekullin XIX nuk pati një mundësi të tillë që do ta kishte lehtësuar luftën e tij për çlirim.

Lëvizja politike shqiptare u ndodh kështu vetëm, përballë dy Fuqive të Mëdha që ndanin sundimin në Perandorinë Osmane: sulltanit kalif e Patrikanës Greke; po ajo nuk gjeti aleatë as midis shteteve ballkanike, të cilat ia detyronin ekzistencën e tyre zbatimit të parimit të kombësisë.

Përkundrazi, gjendja në të cilën e kishte katandisur Porta Shqipërinë, krijonte sipas mendimit të qarqeve sunduese në këto shtete një rrethanë shumë të favorshme për të realizuar plane të një ekspansioni të guximshëm, aq më tepër që kryen-gritjet e vazhdueshme shqiptare e kishin dobësuar sundimin osman në Shqipëri. Pikërisht kjo rrethanë shërbeu për ta akti-

vizuar edhe më shumë politikën e monarkive ballkanike në Shqipëri.

Në parashikim të mundësisë së një krize të re vdekjeprurëse për sundimin osman në Ballkan, secila nga këto monarki, duke llogaritur mbështetjen që mund të kishte në njërin nga Fuqitë e Mëdha, sidomos të Rosisë, synonte ta mbushte vetë atë zbrazëti që do të krijohet në tokat shqiptare, ose, në pamundësi, ta ndante plaçkën. Në pritje ato krijonin kontakte me personalitete ose me lëvizje kryengritëse në tokat shqiptare. Duke shfrytëzuar nevojën që kishin kryengritësit shqiptarë në veri e në jug për të gjetur strehim në tokat jashtë sferës së veprimit të qeverisë osmane, qeveritë ballkanike u përpoqën të fitonin nëpërmes tyre ndikim mbi këto lëvizje, për t'i kanalizuar në dobi të planeve të tyre. Për këtë qëllim shfrytëzohej mundësia që ato kishin për të krijuar pa pengesa nga Porta e Lartë shkolla e institucione të tjera kulturore e fetare në tokat shqiptare, kurse ndiqej me egërsi edhe përpjekja më e vogël nga ana e shqiptarëve për të organizuar veprimtari të tilla. Me shumë mjeshtëri shfrytëzohej edhe legjenda për një prejardhje të lashtë të përbashkët të shqiptarëve e të serbo-malazezve, e nga ana tjetër të shqiptarëve e grekëve nëpërmes stërgjyshërve të përbashkët pellazgë. Faktet e bënë të qartë se çfarë fshihej prapa këtyre «lidhjeve të farefnisës». Ndërsa u premtoun shqiptarëve «respektimin e fesë e të zakoneve», njëfarë «autonomie kulturore» sui generis, pa asnjë aspekt politik, qeveritë serbe e greke zhvillonin ndërkohë bisedime e hartounin plane të fshehta për ndarjen e tokave shqiptare.

Më 1877 u krijuan disa kontakte midis lëvizjes shqiptare e qarqeve zyrtare greke për të hetuar mundësinë e një aleance kundër ekspansionit të Malit të Zi e të Serbisë, të përkrahur nga Rusia, por ato dështuan. Përvojën e këtyre orvatjeve e përmbodhi më vonë A. Frashëri me fjalët se qeveria greke (e kjo vlente po aq për atë serbe e malazeze) kërkonte në të vërtetë të shqiptarët «jo aleatë, por të nënshtruar».

Qëllimet e vërteta të përpjekjeve për të arritur «një bashkëpunim» me shqiptarët, ishin dikur, më 1854 e më 1866 e më në fund në shkurt të vitit 1878, me aksionet e bandave greke të hedhura fshehurazi në territorin shqiptar. Nga ana tjetër, operacionet e luftës u dhanë më 1877-78 qeverive serbe

e malazeze rast për të realizuar më në fund planet e tyre të vjetra, për të krijuar «Serbinë e Madhe» dhe «Zetën historike» në kurriz të tokave shqiptare. Ky ishte rasti më i volitshëm, që me ndihmën e Ruisë, të dyja monarkitë të zbrisnin më në fund në rrafshinat e në tokat e buta të banuara prej shqiptarëve.

Ngjarjet treguan se aktorët kryesorë e vendimtarë në politikën ballkanike nuk ishin qeveritë e këtyre shteteve, por Fuqitë e Mëdha kapitalistë, që dolën nga prapaskena ku kishin qëndruar, atëherë kur kriza shpërtheu haptazi me disfatën e ushtrive osmane.

Traktati i Shën-Stefanit, që i jepte fund luftës sipas interesave të politikës cariste, dhe Kongresi i Berlinit, i cili pretendonte ta rishikonte të parin në favor të «ekuilibrit» të Fuqive, ishin në fakt që të dy vepër e së njëjtës politikë imperia-liste të Fuqive të Mëdha. Edhe kur përgatiteshin ta zhduknin Perandorinë Osmane nga Ballkani, edhe kur deklarorin se donin të ruanin ekzistencën e saj dhe status quo-në, të dyja grupimet zhvilluan të njëjtën politikë armiqësore ndaj popullit shqiptar dhe të drejtave të tij kombëtare themelore. Të dy i bënë tokat shqiptare gurë shahu dhe objekt kompensimi në lodrat e tyre politike, duke pritur një situatë të favorshme për ta zgjidhur definitivisht në favorin e vet çështjen ballkanike e me të edhe çështjen shqiptare.

*
* *
*

Situata e krijuar në vitet 1877-1878 e detyroi lëvizjen shqiptare dhe organin e saj, Lidhjen, të vepronte në një luftë me dy fronte: pa humbur nga sytë objektivin e luftës kundër Portës, të ndiqte nga ana tjetër objektivin e luftës kundër pushtimit të tokave shqiptare nga Serbia e Mali i Zi, të cilëve iu shtua me Traktatin e Shën-Stefanit edhe «Bullgaria e Madhe», e krijuar nga carizmi rus, e cila në shërbim të tij. fuste një pykë të thellë në tokat shqiptare, në drejtim të detit Adriatik.

Lufta në dy fronte, me dy objektiva, përbënte një veçori të lëvizjes shqiptare, jo vetëm në vitet e Lidhjes, por deri në Shpalljen e Pavarësisë.

Dallimi i dy objektivave nuk do të thotë kurrsesi se njëri objektiv kishte përparësi ndaj tjetrit. Një vlerësim i tillë do të thoshte në të vërtetë të nënvleftësoje njërin kundrejt tjetrit. Ato përbëjnë një të tërë, një detyrë të vetme me dy anë që rrjedhin njëra nga tjetra dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

Kjo veçori, e cila e dallon mjaft lëvizjen shqiptare nga lufta politike që bënin shtetet ballkanike në këto vite, nuk jep kurrsesi të drejtë për ta përjashtuar këtë lëvizje nga fronti i luftës së përgjithshme kundër sundimit shekullor osman në Ballkan, madje për ta hedhur atë në anën e kundërt të barrikadës, siç e bëjnë ata autorë që e paraqesin Lidhjen si organ të Portës, dhe në luftën e saj kundër Perandorisë nuk shohin asgjë tjetër veçse shpërthimin e pakënaqësisë së shqiptarëve, sepse kjo nuk paska ditur ose dashur të ndalonte lëshimet tokësore.

Në përgjithësi, tek autorët e huaj, si edhe te publicistika e sotme, zyrtare ose gjysmëzyrtare, që del në Jugosllavi, vihet re një moskuptim themelor i programit dhe rrjedhimisht edhe i gjithë veprimtarisë së Lidhjes.

Aty bëhet një ndarje antidialektike dhe antihistorike e qëllimeve të Lidhjes, duke mohuar lidhjen organike të kërkesave kryesore që qëndronin në programin e saj. Njohja e shqiptarëve si komb, një e i pandarë, implikonte logjikisht njëkohësisht edhe zbatimin tërësor të të drejtave të tij kombëtare; kjo donte të thoshte se nuk mund të ndahej lufta për çlirimin kombëtar dhe për autonomi, nga lufta e Lidhjes për unitetin e trojeve shqiptare, dhe kjo nga lufta për bashkimin kombëtar në një shtet. Këto përbëjnë tri hallka të pandashme njëra nga tjetra. Të mohosh njërin e të pranosh tjetrën do të thotë t'i mohosh të gjitha.

Këtu është rasti për të vënë në dukje, se qindvjetori i Krizës Lindore ka dhënë shkas për botimin e një literature të gjerë shkencore dhe joshkencore kudo në botë.

Me gjithë ndryshimet që kanë në dukje, shumë botime bashkohen në mbivlerësimin e rolit të Fuqive të Mëdha, duke konsideruar si faktor shpëtimtar, herë «të paqes» e herë «të popujve», politikën imperialiste të njëres ose të tjetres fuqi të madhe.

Sidomos historianët revizionistë nga Bashkimi Sovjetik, vazhdojnë përpjekjet për t'i «shpëtuar fytyrën», për t'i «ko-

rrigjuar» karakterin grabitqar politikës imperialiste të carizmit rus, për ta paraqitur atë si përkrahës të luftës së popujve ballkanas. Siç e kanë thënë prej kohësh klasikët e mëdhenj Marksi e Engelsi, dihet se këtu ishte fjala për hegjemoninë e Rusisë në Ballkan, për të dalë në «ujërat e ngrohta» të Mesdheut, duke futur në darën e vet Dardanelet nga ana e Bullgarisë, e aspak për të «ndihmuar» vëllezërit e krishterë të Ballkanit, në një kohë kur revolucionarët demokratë rusë shtronin si detyrë që populli rus vetë të çlirohej nga zgjedha e «turqve të brendshëm», d.m.th. e carizmit.

Sidomos disa historianë bullgarë si K. Kosev dhe H. Hristov kanë zënë këtu pozita shumë «të avancuara». I pari deklaroi me shumë guxim se lufta e Rusisë, në vitin 1877, paska pasur bile karakter ... «subjektivisht mbrojtës»¹; i dyti nuk ngurron të deklarojë se Traktati i Shën-Stefanit me të cilin carizmi, duke krijuar «Bullgarinë e Madhe» synonte të vinte bazat e hegjemonisë së vet në Ballkan, duke sakrifikuar e duke copëtuar sidomos truallin kombëtar të shqiptarëve, paska qenë për atë kohë zgjidhja plotësisht e drejtë e çështjes së popujve ballkanas, se ai u përgjigjej plotësisht situatës etnike në këtë gadishull² dhe për ndonjë pasaktësi në këtë drejtim, ai edhe historiani sovjetik Naročnicki, në mënyrë naive, bëjnë përgjegjës ... disa «shkencëtarë perëndimorë» të asaj kohe, që paskan dhënë informata jo të sakta...³.

Studimet rreth Lidhjes e veprimtarisë së saj bëjnë pjesë në atë problematikë shkencore që pikërisht në ditët tona përjeton një ringjallje, dhe jo rastësisht. Tematika e formimit të kombeve e të lëvizjeve kombëtare për çlirim, për zhvillimin e lirë të kulturës kombëtare të popujve, merr një rëndësi të veçantë pikërisht në ditët tona, në kushtet kur një varg popujsh janë çliruar ose janë duke luftuar për çlirimin e tyre, për identitetin e tyre kombëtar politik e kulturor.

Një literaturë e tërë e çdo ngjyre përpiqet në këto kushte ta paraqesë kombin e luftën kombëtare si një kategori tashmë historikisht të kapërcyer. Kombet e shtetet sovraane kombëtare

1 K. Kosev, *Spisanie na BAN*, nr. 4, 1977, f. 63.

2 H. Hristov, *Istoričeski pregled*. Sofie, 1977, nr. 5/6, f. 10, 12, 20.

3 V. Naročnickij, në: *Meždunarodni naučni Skup*, vëll. I, Sarajevo, 1978. f. 36.

përbëkan tashmë një kuadër tepër të ngushtë, brenda të cilit popujt nuk paskan mundësi të realizojnë e të zhvillojnë gjithë potencialin e forcave të veta ekonomike e kulturore, as të shfrytëzojnë fitoret e teknikës moderne. Nuk ka nevojë të shkohet më larg, për të treguar se vetë realiteti ynë i gjallë, i hedh poshtë këto «konstruksione».

Në këto kushte studimi i viteve të Lidhjes, si pjesë e lëvizjes së përgjithshme shqiptare për çlirimin kombëtar, merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e luftës ideologjike që bën sot Partia e Punës e Shqipërisë në plan kombëtar e ndër-kombëtar.

*
* *

Si çdo ngjarje e madhe që i ka rrënjët thellë në truallin historik, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si një lis vigan, i lëshon degët e veta përtej viteve të veprimtarisë së saj — mbi dhjetëvjetorët pasardhës. Me programin e saj vepruan lëvizjet e fuqishme që shpërthyen në Shqipëri në vitet 1896-99, për të realizuar autonominë kombëtare dhe çuan në themelimin e Lidhjes së Pejës, në kryengritjet e viteve 1908-1912, në Kuvendin historik të Gerçës, më 1911. Dhe kur atdhetarët shqiptarë, të nisur nga të gjitha skajet e trojeve shqiptare, morën rrugën për të shkuar në Vlorë, në ato ditë të stuhishme të nëntorit të 1912-ës, që ngjaisnin aq tepër me ato të fillimit të vitit 1878, ata ishin plotësisht të ndërgjegjshëm se po ecnin në rrugën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, se po shkonin për të kryer e për të plotësuar detyrat që kishte lënë ajo.

28 Nëntori i vitit 1912, Shpallja e Pavarësisë Kombëtare, krijimi i shtetit sovran shqiptar, qenë kurorëzimi i një lufte të lavdishme, një kulm i parë i së cilës kishte qenë pikërisht Lidhja e Prizrenit. Por detyra tjetër po aq e madhe, e ngritur nga Lidhja në plan ndërkombëtar, mbrojtja e tërësisë së trojeve shqiptare, bashkimi i tyre si kusht për realizimin e unitetit kombëtar, mbetën pa u realizuar. Në kushtet e Luftës Ballkanike, në kuadrin e politikës imperialiste të blloqeve që ndiqnin Fuqitë e Mëdha dhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të këtyre,

qeveritë shoviniste ballkanike gjetën mundësitë për të realizuar synimet e tyre grabitqare në Ballkanin Perëndimor, mbi atë që ata e quanin trashëgimi të Perandorisë Osmane e që për një pjesë ishin trojet kombëtare shqiptare.

Traktati i Shën-Stefanit, Kongresi i Berlinit ishin prologu i një dënimi e verdikti të egër imperialist, që u zbatua më 1913, me atë cungim e gjymtim territorial të pashoq që pësoi populli shqiptar, duke mbetur gjysma e trojeve të tij jashtë kufijve të shtetit kombëtar.

Në këtë rrugë historike, të çarë me shpatë e të larë me gjak, Lidhja Shqiptare e Prizrenit përbënte një ngjarje heroike e cila krijoi një bazë për luftën e mëvonshme të popullit shqiptar për liri, për pavarësi e për përparim shoqëror, sepse e kaluara nuk është thjesht një diçka e kaluar; ajo është pjesë përbërëse e së tanishmes, dhe i shërben së ardhmes. Ky kuptim dialektik qëndron në themel të mësimëve të Partisë e të shokut Enver, dhe shpjegon rëndësinë që ata u japin traditave për edukimin patriotik e revolucionar të popullit tonë.

Nga lartësitë e fitoreve të arritura, populli shqiptar kthehet sot për të ndjekur me syrin e mendjes atë rrugë aq të vështirë, po aq të lavdishme, që bënë të parët e tij.

Luftëtarët e shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, figurat e ndritura të Rilindjes sonë Kombëtare janë sot më afër se kurrë pranë popullit të tyre, në mesin e popullit të tyre, sot që flamurin aq të shtrenjtë për ta të luftës për liri e pavarësi, për sovranitetin kombëtar, për demokraci e progres shoqëror, flamurin e së ardhmes së kombit shqiptar e mori dhe e mban në dorën e saj të çeliktë klasa punëtore shqiptare dhe po e çon në fitore të plotë, nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë e të themeluesit të saj shokut Enver Hoxha.

ETNOGRAFIA SHQIPTARE DHE DISA PROBLEME TË SAJ*

I. Konferenca jonë Kombëtare e Studimeve Etnografike, edhe pse emërtimi vetë nuk e shpreh, ka vënë në qendër të vëmendjes të punimeve të saj një problem shkencor, i cili, për nga karakteri e domethënia që ka, hyn në radhën e problemeve të mëdha ideologjike e politike. Kultura popullore dhe vendi e roli i saj në kulturën socialiste kombëtare shqiptare — kështu mund të përcaktohej ideja qendrore, së cilës i nënrenditen referatet e kumtesat e kësaj konference, e para me një tematikë të tillë që mbahet në vendin tonë.

Një orientim i tillë nuk është i ri e i rastit për shkencat tonë shoqërore. Qysh kur ato, duke u vënë mbi bazat e materializmit dialektik e historik, u formuan dhe u kristalizuan për herë të parë e në kuptimin e plotë si shkencë, etnografia, folkloristika, arkeologjia, historia e artit dhe e letërsisë, e kanë quajtur detyrë të tyre nderi të zbatojnë mësimet e mëdha të Partisë e të shokut Enver Hoxha, që i porosisin kurdoherë për zbulimin e për studimin e kulturës sonë tradicionale popullore e kombëtare, e «pasurisë së popullit e të atdheut, e asaj pasurie të madhe shpirtërore që ka mbajtur gjallë kombin tonë në stuhi e furtuna».

* Referat mbajtur në Konferencën Kombëtare të Studimeve Etnografike të zhvilluar në Tiranë, më 28-30 qershor 1976. Nxjerrë nga libri «Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike», Tiranë, 1977, f. 15-35. Është botuar në «Studime historike», 1976; nr. 3, f. 9-29.

Më punën e vet shumëvjeçare shkencat tona, duke ndjekur këto porosi, duke bashkuar analizën e ftohtë shkencore dhe dashurinë e zemrës, kanë arritur suksese, për të ndriçuar rrugën historike që kaloi kjo kulturë, e lashtë e gjithmonë e re, e begatshme dhe e larmishme, përmbajtjen e domethënien e lartë ideore-artistike të këtyre krijimeve të njehershme që lindi gjenia e pashtershme e popullit tonë punonjës. Një kujdes të veçantë shkencat jonë po i kushton porosisë së shokut Enver që me punën e saj të ndihmojë «për të spastruar ferrat që mbysnin këtë kopsht», për të nxjerrë në dritë atë gurrë, nga e cila është ushqyer, atë truall mbi të cilin u ngrit, duke kurorëzuar një rrugë mijëvjeçare, kultura jonë socialiste kombëtare.

Konferenca jonë do të përpiqet të japë një sintezë të parë të rezultateve të arritura në kuadrin e kësaj tematike, e ndër-gjegjshme se në probleme të një domethënieje të tillë, më shumë se kudo është e vështirë të pretendosh për të thënë një fjalë të fundit, që u përket studimeve të ardhme.

Duke iu përmbajtur kësaj suaze, ky referat i vë vetes si qëllim të shërbejë, në njëfarë mënyre, si një hyrje në tematikën që do të rrihet gjerësisht e konkretisht nga referatet e kumtesat pasuese; ai synon të japë një vështrim përmbledhës mbi disa probleme, si dje dhe sot aktuale, që përbëjnë pika kryqëzimi të kontradiktave të mëdha ideologjiko-metodologjike në fushën e shkencave të kulturës; të përvijojë disa drejtime që janë shfaqur në historinë e studimeve kushtuar kulturës sonë popullore, brenda dhe jashtë vendit, të vërë në pah disa rezultate të rëndësishme, që janë arritur prej shkencave tona marksiste-leniniste të kulturës dhe të shfaqë disa mendime rreth disa detyrave aktuale që qëndrojnë para tyre.

Është me vend që të japim, që në fillim, disa vija përkufizuese të kuptimit me të cilin përdoren terma si «kulturë popullore» kulturë ose krijimtari «tradicionale» etj. Kuptimet e ndryshme, herë më të gjera e herë më të ngushta, të këtyre termave kanë të bëjnë me përmbajtjen që u jepet atyre, me rolin e funksionin që i atribuohet kësaj krijimtarie, kanë të bëjnë, në fund të fundit, me kontradiktat ideologjiko-metodologjike themelore që përshkojnë sot shkencat e kulturës në plan ndërkombëtar.

Ne e përdorim termin «kulturë popullore» në një kuptim

të parë e më të ngushtë, duke u nisur, së pari, nga sfondi shoqëror ku ajo lind e konsumohet, si krijimtari e masave punonjëse, e shtresave të ulëta e të shtypura të shoqërisë klasore («vulgus in populo»), pa një kulturë të shkruar — karakteristikë kudo, jo vetëm për shoqërinë feudale, po edhe borgjeze. Në relacionin etnik, në këtë krijimtari janë ruajtur një varg tiparësh arkaikë; për arsye të karakterit të mbyllur të kësaj shoqërie e të push-timeve të huaja, ato patën, veçanërisht në Shqipëri, një evolucion të brendshëm më të ngadalshëm dhe ndikime relativisht të pakta nga jashtë. Kjo dukuri është një prodhim relativisht anonim e impersonal; nga shndërrimet që pësoi gjatë përdorimit mund të quhet prodhim kolektiv që trashëgohet në formë rregullash të fiksuara, në bazë të traditës së pashkruar, një kulturë e quajtur prandaj «tradicionale». Në kundërshtim me etnografinë e sotme borgjeze, në përcaktimin e kësaj kulture, ne nuk mund të qëndrojmë vetëm ose kryesisht të kufizimet e saj, tek aspekti formal e funksional, të shohim vlerën e saj vetëm si dokument i një zhvillimi të ulët shoqëror e teknik, mbeturinat primitivo-rudimentare si gjurmë bashkësish të lashta etnike, të qëndrojmë te kufizimet e saj historikisht të shpjegueshme e të harrojmë atë që për ne është karakteristika thelbësore e kësaj kulture — përmbajtjen demokratike e përparimtare që karakterizon atë si pasqyrim të drejtpërdrejtë të realitetit shoqëror, të luftës klasore të krijuesve e të bartësve të saj, as të harrojmë se forca e shprehjes artistike, realizimi e dramaticiteti, freskia e ndjenjës dhe ruajtja e autenticitetit dhe e origjinalitetit të tipareve etnike të kulturës sonë popullore nuk kanë të bëjnë aspak me «kondicionim njerëzor» në përgjithësi, për të përdorur një term të modës së filozofisë së sotme borgjeze, por në radhë të parë me kondicionim klasor, me qëndresën e «vulgut», të masave punonjëse kundër shtypjes e shfrytëzimit të brendshëm e nga jashtë; si rrjedhim, kultura popullore në aspektin material mund të mos e ketë, po në tiparet, në karakterin, në gjuhën e saj ka një monumentalitet, që është afirmimi më pohues i optimizmit të luftës së popullit punonjës kundër degradimit fizik e moral, kundër çnjerëzimit, kundër zvetënimit — diçka që është e mbetet kurdoherë aktuale.

Janë pikërisht këto vlera ideore që e bëjnë këtë krijimtari, në Shqipëri, si kudo, të kalojë caqet e shoqërisë që e

lindi dhe barti këtë «kulturë tradicionale», që e bëjnë të imponohet, me peshën e energjinë e saj krijuese, me forcën e përmbajtjes së saj luftarake, optimiste, demokratike, edhe në kulturën «e lartë» të shoqërisë klasore, që ajo të përqafohet nga përfaqësuesit më përparimtarë të borgjezisë kombëtare të ngritur kundër kulturës së kalbëzuar feudale dhe sunduesve të huaj. E integruar qysh në shekullin XIX në kulturën tonë kombëtare të Rilindjes, në marrje e dhënie të vazhduar, duke u pasuruar prej saj me ide të reja dhe duke e ushqyer atë si burim i pashtershëm me frymën demokratike e popullore të krijimeve të saj, është kjo kulturë popullore në kuptim të gjerë, kjo kulturë popullore kombëtare, që e përfaqëson tani më popullin shqiptar; është ky tabani mbi të cilin u vunë themet e po ngrihet madhështore kultura jonë e sotme socialiste-kombëtare.

Ky orientim shkencor, që i jep një vend nderi kulturës sonë tradicionale, ka gjetur shprehje të qartë në shumicën e studimeve tona dhe do të tingëllojë fuqishëm edhe në këtë konferencë. Shkencat tona të kulturës kanë goditur me vendosmëri, duke u mbështetur mbi materiale me vlerë shkencore, jo vetëm për vendin tonë, qëndrimin «historicit» aq të përhapur në shkencën borgjeze dhe revizioniste, sipas të cilit kultura tradicionale popullore dhe rrjedhimisht dhe kultura e lëvruar me frymë popullore, përbëkan një kategori historike që tashmë i përkitka tërësisht e thjesht së kaluarës, sepse qenka e lidhur me rrethana e me forca shoqërore tashmë të kapërcyera, ose në kapërcim e sipër nga një zhvillim që përpiqen t'i japin karakterin e një ligji. I tillë është, p.sh., mendimi që kanë formuluar shkencat kulturologjike në shërbim të të dy superfuqive, në mënyrë konkorde, pavarësisht nga veshja e jashtme e ndryshme, sipas të cilit, konceptet e kombit e të kulturës kombëtare qenkan nocione që po zëvendësohen nga procese afrimi e integrimi kulturor, deri në shkrirjen e etnoseve historikisht të formuara me kulturë të dalluar në forma historike, siç u vu në dukje në dy sesionet të Akademisë së Shkencave të BRSS në Kishinev e në Leningrad, më 1966 dhe më 1969. Këto qenkan dukuri ligjësore, sepse nuk iu përgjigjkan më stadi të zhvillimit të sotëm ekonomik e kulturor-shoqëror, i cili kërkon një ndarje pune në shkallë ndërkombëtare dhe

forma organizimi të një niveli më të lartë, mbikombëtar e mbi-shtetëror. Nuk është vështirë të kuptosh se prapa një qëndrimi të tillë fshihen synime për të përligjur «shkencërisht» zhvishjen e popujve jo vetëm nga pavarësia e tyre politike dhe ekonomike, por edhe nga një pasuri po aq e madhe — nga traditat e tyre popullore-kombëtare, që e konsolidojnë atë.

Integrimin e këtyre vlerave, të lidhura me shtresa shoqërore dhe etnokulturore historike, në kulturën moderne të shoqërisë së industrializuar, kulturologjia e borgjezisë imperialiste e quan një kthesë antihistorike dhe zhdukjen e tyre si një dukuri progresive. Me argumente të tjera, biologjiko-sociologjike, por me konkluzione të ngjashme, vepron shkolla funksionaliste anglo-amerikane. e cila pasurinë e kulturës tradicionale popullore e sheh si një mbeturinë shoqërisht e mendimesh primitive, prelogjike, magjiike-asociative, që mund të rrojnë giatë edhe në shodëri teknikisht të përparuara si shoqëria e industrializuar imperialiste. por vetëm si «fosile» me funksione të ngurtëzuara, jokrijuese. Rriedhimisht, nuk mund të jetë kjo traditë kulturore popullore baza që mund të shërbejë për ndërtimin e një kulture adekuate për shoqërinë tonë moderne. Nuk janë larg këtyre edhe koncepte si ato të kulturologëve revizionistë, që në rastin më të mirë në këtë kulturë tradicionale popullore shohin, siç e shpreh folkloristja bullgare E. Ognianova, një kujtim të bukur, por vetëm një kujtim! të moshës «rinore», tashmë të perënduar të popujve. E prej këndeje, përsëri vetëm një çap, për ta mbyllur rrethin vicioz, deri tek ato prirje moderne «primitiviste», aq komode për borgjezinë imperialiste, që në një kulturë të tillë ahistorike primitive, shohin shpëtimin e njerëzimit nga barra e përgjegjësisë historike e nga lufta klasore, një «kthim në natyrë!», po kësaj here me funksione reaksionare në krahasim me atë të shekullit XVIII.

Shkencat tona marksiste-leniniste të kulturës, së bashku me shkencën përparimtare botërore e konsiderojnë kulturën tradicionale popullore si një faktor me rëndësi, që nuk e ka humbur funksionin e tij krijues e formues pikërisht kur ai integrohet në kulturën kombëtare përparimtare të popujve.

Në formimin e këtyre koncepteve, studiuesit tanë të shkencave shoqërore nuk janë nisur nga një sentimentalizëm i kthyer nga prapa, as nga një patriotizëm romantik i «fshatit të vet».

Për të ndjekur rrugën e kulturës sonë tradicionale në ditët tona, etnografët e folkloristët tanë, muzikologët e koreografët, historianët e artit etj. nuk kënaqen me konstruksione thjesht teorike, por mbështeten mbi një truall që lejon përgjithësime, mbi praktikën e ndërtimit shoqëror-kulturor të atdheut tonë socialist.

Një epokë prej 35-vjetësh, një e treta e shekullit me shndërime të gjera e të thella, intensive, ekonomiko-shoqërore e politiko-kulturore, i japin studiuesit të problemeve kulturologjike një material jetësor, që nuk përbëhet nga elemente të izoluara, por nga procese e vargje konstante faktesh të përsëritura e të përsëritshme, që kanë karakter ligjësie — një material burimor i dorës së parë, me të cilin etnografët dhe historianët e kulturës njihen nëpërmes ekspeditave fushore, koleksioneve muzeore dhe dokumentacionit të shkruar. Mbi këtë bazë burimore të realitetit, duke u mbështetur mbi materialet historike dhe në studimet e zhvilluara në vendin tonë dhe jashtë gjatë më se një shekulli, mund të nxirren tashmë disa konkluzione përgjithësuese lidhur me rrugën e kulturës sonë tradicionale dhe të kulturës sonë popullore kombëtare si dhe mbi vendin e rolin e tyre, si pjesë integrante, në kulturën tonë socialiste.

II. E rëndë, e mbushur me vështirësi e pengesa, plot luftë e fli — kjo qe rruga që rrethanat historike i imponuan popullit shqiptar, por nuk mundën t'i mbyllnin edhe rrugën e kulturës e të artit, të dijës e të shkencës. «Ç'tregon ky art e kjo kulturë e lashtë që ka pasur populli ynë — luftën e vendosur për mbrojtjen e tyre dhe bashkë me të për mbrojtjen e atdheut, të tokës, të jetës e të zakoneve» të tij, thotë shoku Enver Hoxha. E po nga këto burime u ushqye kurdoherë edhe shkenca përparimtare shqiptare që nga fillimet e saj.

Nuk ka dyshim se në kushtet e sundimeve të huaja, kur klasat sunduese vendase, me qëndrimin e tyre antikombëtar dhe obskurantist, kishin tradhtuar çështjen e lirisë e të luftës, për një kulturë popullore kombëtare, rruga në të cilën u zhvillua kultura e shkenca shqiptare nuk mund të ishte një rrugë zhvillimi e thjeshtë. E asnjë fushë më tepër se ajo e shkencave të kulturës, për vetë karakterin e saj të theksuar ideologjik, nuk mund të kishte më të theksuar karakterin e një arene lufte, ku ndesheshin interesat klasore të forcave të ndryshme sho-

qërore në plan kombëtar e ndërkombëtar koncepte kontradiktore, progresiste e konservatore-reaktionare dhe kontradiktat metodologjike-metodike, që karakterizonin shkencën ndërkombëtare.

Këto janë disa vija konstante kontradiktash që i karakterizojnë përpjekjet e para shqiptare në fushën e shkencës derisa, me fitoren e revolucionit popullor, lindi e u konsolidua shkenca shqiptare, tashmë si shkencë marksiste-leniniste.

Të pohosh këtë, nuk do të thotë të mohosh e të përbuzësh një punë të gjatë, të frytshme që zhvilluan plot vetëmohim breza të tërë, në kushte shumë të vështira, për të zbuluar, për të ruajtur, për të bërë të njohur thesaret e kulturës sonë popullore.

Kjo ishte një fazë parashkencore, në të cilën këto shkenca ende nuk mundën të formonin fizionominë, të përcaktonin fushat e tyre të veçanta si dhe metodikën e vet, shkencore speciale — kusht i domosdoshëm për përparimin e tyre.

Një fazë të tillë, mund ta quajmë të përgjithshme, e kaluan, në kushte shumë më të favorshme, shumë më herët, edhe vende të tjera, midis tyre edhe vendet fqinje që kur fituan pavarësinë shtetërore.

Kjo veprimtari e shquar nga fryma e lartë patriotike e bartësve të saj ishte njëri faktor dhe kryesori, ku u mbështetën më vonë shkencat tona kushtuar studimit të kulturës sonë popullore. Një faktor të dytë përbënin studimet e zhvilluara në vendet e Evropës Perëndimore, të cilat, duke filluar nga mesi i shekullit, përfshinë në mënyrë gjithnjë e më të dendur viset e Gadishullit Ballkanik në sferën e interesave të tyre ekonomiko-politike, çka u dha një shtytje energjike kërkimeve shkencore të mirëfillta kushtuar problemeve tona, duke filluar veçanërisht që nga çereku i fundit i shekullit XIX.

Kundrejt këtij trashëgimi shkenca jonë duhet të merrte qëndrim që në fillim të rrugës së saj si shkencë marksiste. Këtu nuk ishte fjala për një ballafaqim brezash, por për një vlerësim kritik, nisur nga fryma e partishmërisë proletare, nga kriteri klasor në interpretimin e dukurive kulturore. Qëndrimi historik i drejtë kërkonte të dallohej, së pari, kontributi i madh e pozitiv që kishin sjellë një varg studiuesish shqiptarë me frymën demokratike përparimtare të borgjezisë së re si dhe

disa studiues të huaj, në radhë të parë me materialet e tyre të vlefshme, të mbledhura në vend, materiale të një vlere të madhe që mund të shërbenin si bazë për sqarimin e një vargu çështjesh të gjenezës, të tipareve themelore dhe të zhvillimit të mëtejshëm të formave të kulturës e të mënyrës së jetesës së popullit shqiptar.

Nuk mund të ishte ndryshe — në këto punime pozitive nuk mungonin interpretime e dobësi ideologjike, karakteristike për metodologjinë e tyre idealiste antihistorike dhe për metodikën e tyre shkencore të dobët. Kategoria e kulturës dhe e shkencës mbi kulturën nuk përbëjnë përjashtim, ato, në mënyrë të veçantë, u nënshtrohen parimeve të luftës klasore dhe kërkojnë një qëndrim parimor, aq më tepër që prapa metodologjisë antishkencore të një vargu punimesh të tilla të autorëve të huaj çanin e çajnë rrugën qëllime të hapëta ose të fshehta politike antishqiptare, të cilat me një fjalë me kripë, një kritik i pati karakterizuar si punime jo të shkencës etnografike, por etnokratike.

U pohua më lart se rrënjën kryesore për fillimet e shtruarjes së problemeve të lidhura me kulturën popullore shqiptare e përbënte impulsi i brendshëm. Edhe kjo nuk është e rastit. Rrethanat historike, të krijuara me pushtimin shekullor osman, e vunë popullin shqiptar, qysh nga shekulli XV, përballë një situatë kritike, e cila vinte në pyetje atë që ishte realizuar tashmë si rezultat i një zhvillimi historik të pavarur: ekzistencën e shqiptarëve si kombësi të dalluar dhe shtronte problemin e madh të së ardhmes së fatit të popullit e të kulturës së tij tradicionale.

Në kushtet e së resë së huaj që po hynte me dhunë, në të gjitha fushat e kulturës, të gjuhës, të dokeve, të fesë, në strukturën sociale etj., u krijuan objektivisht disa probleme dominante që mbetën në rendin e ditës që nga shekulli XV e derisa zgjati sundimi i huaj osman, e që patën një rezonancë të gjerë popullore, sepse ishin lidhur pikërisht me interesat themelore të masave popullore. Të tilla ishin problemi i vazhdimësisë e i mosvazhdimësisë kulturore, problemi i njësisë «nacionale» kundrejt të huajit, i zakonit vendas ndaj inovacioneve etj. Ky realitet i mbarsur me kontradikta të thella, nuk mund të mos gjente shprehje edhe në mendimin e masave dhe, me

gjithë kufizimet klasore që i karakterizonte si klerikë, dhe te inteligjencia e kohës. Komponentët objektivë dhe të qëndrueshëm të etnosit shqiptar, karakteristikë për mesjetën, territori, gjuha, prejardhja historike e tiparet shpirtërore të përbashkëta, doket e zakonet si pasuri e përbashkët kulturore dalin të shprehura si elemente përbërëse të realitetit shqiptar, të vetdijes së tij qysh nga Barleti e deri te Budi, Bardhi e Bogdani. Masat popullore me një emër të ri të përbashkët e veçojnë veten ndaj të huajit. Në kryengritjet e mëdha të shekujve XVI-XVII, të shekullit XIX e deri më 1878 e 1908, roli i traditave, si shprehje e kulturës popullore ka tipare politike të ndërgjegjshme, me kërkesën që tokat e banuara prej shqiptarëve të sundoheshin sipas zakoneve të «dheut», prej njerëzve që njihnin gjuhën, doket e mënyrën e jetesës së popullit.

Ideja e rrugës së veçantë, që, sipas Barletit, kishte formuar historikisht, qysh prej kohës antike, ky popull, plotësohej me konceptin e kulturës si mjet formativ i shprehur qartë te Bogdani sipas të cilit zhvillimi i gjuhës amtare ishte një faktor vendimtar për fatin e vendit e të popullit, për «mos lanë dijen e gjuhën e dheut me u dvarun», për të cilën duhej luftuar «porsi lufton gjithë dheu e shekulli për të vetën». Nuk ka dyshim se vetë rrethi i kufizuar nga pikëpamja profesionale, mbi të cilin ai shtrihej, tregonte se koncepti kulturologjik i Bogdanit nuk kishte dalë, e nuk mund të dilte, nga sfera e mendësisë feudale. Kjo shihet qartë edhe në faktin që në relacionet e tyre, të cilat në vetvete përbëjnë një burim për njohjen e kulturës popullore të një zone të Shqipërisë në shekullin XVII, klerikët shqiptarë pasqyrojnë qartë zemërimin e tyre të madh që popullsia e krishterë malësore me vështirësi pranonte t'u nënshtrohej kanuneve kishtare dhe mbahej me këmbëngulje pas traditave e zakoneve të tyre pagane.

Problemeve që shtronte realiteti i hidhur i Shqipërisë së shekujve XVI-XVIII, rreziku për ta kthyer vendin e kulturën e tij nga rruga e zhvillimit të tyre historik, masat i përgjigjeshin me qëndrueshmëri e tyre të gjithanshme. Porse problemeve teorike, që ngrinte kjo situatë, inteligjencia e vogël, e dobët e vendit, e ngërthyer në ideologjinë e saj fetare, veçanërisht në një Shqipëri të përçarë fetarisht, nuk mund t'u jepte përgjigjen adekuate. Këtë nuk mund ta bënte, edhe pse në ku-

shte disi më të mira, e mbështetur në disa institucione të vetat, as inteligjencia e kolonive arbëreshe në shekujt XVII-XVIII, e cila, për mbrojtjen e autonomisë së ritit të vet kundër kishës latine, hartoi një varg veprash me karakter historik, ku nuk mungojnë edhe të dhëna me interes për kulturën e këtyre kolonive.

Zgjidhja e problemeve madhore të kulturës së popullit shqiptar shtrohej, në një fazë të re më të lartë, në shekullin XIX, me formimin e tij si komb borgjez, në atë periudhë zhvillimi të gjithanshëm, që, me të drejtë, mban emrin e Rilindjes Kombëtare. Kjo përgjigje nisej nga një ideologji e re e revolucionare, demokratike e nacionale, që kishte çarë tashmë rrugën në mendimin politiko-shoqëror të Evropës Perëndimore dhe po u vërsulej perandorive feudale absolutiste në Juglindje të Evropës, e, me gjithë prapambetjen, po zinte rrënjë edhe në borgjezinë shqiptare.

Në këto kushte lindi ajo shkencë e re e cila njihet me emra të ndryshëm si etnografi, Volkskunde, folklore, (shqip: popull-dije), etërit shpirtërorë të së cilës qenë iluministët e mëdhenj Viko dhe Herder.

Duke u ardhur në ndihmë forcave të reja përparimtare që të çanin rrugën përmes shoqërisë feudale, etnografia i ndihmoi të vinin në dukje vlerat pozitive që kishte kultura e shtresave «të ulëta» si dhe e popujve të vegjël, të cilët flisnin me gjuhën genuine të poezisë si shprehës të «shpirtit të stërlashtë të popujve» (Herder), duke ia kundërvënë kulturës së klasave të larta dhe gjuhës e mendësisë së tyre konvencionale. Ky mendim u përqaftua me entuziazëm edhe nga përfaqësuesit e Rilindjes sonë të shpërndarë në Shqipëri, në Itali, në Rumanë e në Egjipt. Nën flamurin e këtyre teorive fshihej një orientim themelor demokratik, që godiste, në radhë të parë, pushtuesit e huaj dhe mbështetjen e tyre shoqërore, aristokracinë feudale shqiptare: i kundërvihej përbuzjes së tyre ndaj masave popullore, godiste përçarjen fetare dhe krahinore të predikuar prej tyre, duke u nisur nga parimi romantik i «njësisë së shpirtit popullor» të stërlashtë.

Kjo ishte një shtytje e fuqishme, që u jepte forcave të reja shoqërore vendase armë teorike për të zgjidhur, sipas kuptimit të interesave të tyre klasore borgjeze, problemet madhore që përbënin koordinatat e zhvillimit kulturor të popu-

llit shqiptar, për të hartuar atë që mund ta quajmë rezultat të një pune kolektive disa brezash, vijën ideologjike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në fushën e kulturës. Problemi i prejardhjes së popullit shqiptar, i kuptuar si korelacion i lashtësisë, i autoktonisë dhe i vazhdimësisë, i njësisë midis kombëtares dhe krahinores, i raportit midis traditës dhe së resë, midis kombëtares dhe së resë ndërkombëtare, i forcave bartëse kryesore-shoqërore të zhvillimit të mëtejshëm të kësaj kulture popullore e kombëtare, u bënë problemet e mëdha, zgjidhjes së të cilave iu përvesh mendimi i ideologëve të borgjezisë demokratike shqiptare, edhe pse nga aspekti metodik shkencor s'ishin krijuar kushtet për t'i zgjidhur ato. Në këto përpjekje u bënë hapat e parë seriozë për studime në fushën e gjuhës, të historisë e të kulturës shqiptare, edhe pse këto deri nga fundi i shekullit XIX nuk arritën të ndaheshin e të formoheshin si disiplina të veçanta jo vetëm në plan shqiptar.

Nuk është detyra jonë të karakterizojmë, veçse me vija shumë të përgjithshme, rrugën me të cilën rilindësit tanë u përpoqën t'i zgjidhnin këto. Duke u nisur nga mendimi i shprehur prej arbëreshit A. Mashi së pari, rilindësit, çështjen «akademike» të prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve e bënë një mjet të fuqishëm të luftës politike për të mbrojtur të drejtën e vetëvendosjes së shqiptarëve si komb i veçantë, «më i lashtë» i Ballkanit, dhe i rrugës së veçantë të zhvillimit të kulturës së tyre, shkëputur nga ndikimet kulturore të reja e të huaja, të kulturës orientale, greke ose sllave. Në favor të kësaj teze u sollën jo vetëm paralelizma gjuhësore dhe argumente historike, por edhe të dhëna etnografike. S. Frashëri krahasonte mënyrën e jetesës së pellazgëve me atë të malësorëve shqiptarë të Veriut etj.

Duke u nisur nga teoria e prejardhjes pellazgjike të të gjithë shqiptarëve, studiuesit e Rilindjes u nxitën për të kërkuar e për të vënë në pah atë që ata e konsideronin si dalluese, të përbashkët, të të gjithë kombit shqiptar, si shprehje të veçorive etnokulturore të formuara prej kohësh, për t'ua kundërvënë synimeve asimiluese që vinin prej vendesh fqinje. Që prej këtij momenti ideja e lashtësisë, e autoktonisë dhe e vazhdimësisë së kulturës shqiptare përbën një element themelor të ideologjisë kulturore të popullit shqiptar: e kaluara vihej kështu në shërbim të së ardhmes.

Zhvillimi i studimeve me mjetet, me metodat, dhe me mundësitë e shkencës moderne bëri që shumë nga teoritë e rilindësve të mos qëndronin në lartësinë e studimeve të kohës. Por kërkimi për të përcaktuar veçoritë kulturore të popullit shqiptar, i çoi studiuesit e Rilindjes në ato fusha ku ata dhanë kontributin e vërtetë e më të rëndësishëm shkencor për njohjen e kulturës sonë popullore-kombëtare, një kontribut shembullor ky edhe për sot. Kaluan vitet e relativiteti i kohës ka bërë punën e vet, gërreu autoritetin e shumë veprave që sot as nuk njihen më; por, për shekuj do të rrojë emri i atyre që në kushte aq të vështira, pa mjete e në mënyrë të paorganizuar, por të frymëzuar me zjarrin e pashuar të dashurisë ndaj atdheut, kryen një punë kolosale, si vëllim e si peshë, madhështore në domethënien e saj: është fjala për veprimtarinë e tyre për të mbledhur, për të ruajtur e për të botuar pasurinë kryesore të popullit, gjuhën, krijimtarinë poetike, doket, traditat e zakonet, njohuritë mbi kulturën dhe mënyrën e jetesës së popullit të tyre. De Rada, Dorsa, Mitko, Jubani, S.R. Dine e një plejadë e tërë, emrat e të cilëve kanë hyrë tashmë në faqet e nderit të historisë së kulturës shqiptare, vajtën në gjirin e popullit për të mbledhur atje në arkivin e gjallë të historisë si bletë, atë mjaltë të shpirtit shqiptar, atje ku ai ishte ruajtur më mirë, te gratë, te njerëzit e thjeshtë të fshatit, te zanatçinjtë dhe i ngritën kështu kulturës së popullit tonë atë përmendore «aere perenius», më të përjetshme se bronzi, që sipas fjalëve të Th. Mitkos, më 1874 i përkiste «gjith kombit shqiptar, pavarësisht nga feja, e nga krahina».

Kjo vepër e rilindësve synonte të realizonte në unitet tradicionalen, populloren, krahinoren dhe ta bënte thelbin më të vyer të kulturës kombëtare, ta bënte pronë të të gjithë kombit e njëkohësisht të kulturës përparimtare botërore. Dhe në fakt komponentja shqiptare u shfaq në shkencën dhe në kulturën ndërkombëtare si një element i pamohueshëm.

Me kuptimin realist të interesave të veta klasore, përfaqësuesit demokratikë të borgjezisë së re shqiptare konsideruan si faktor të rëndësishëm për formimin e kulturës kombëtare shqiptare faktorin popullor dhe e kërkuan dhe e gjetën atje ku në kushtet e Shqipërisë së pazhvilluar, kjo kulturë ishte rritur dhe ruajtur më pastër në fshatin shqiptar. Te kjo forcë shoqërore deri tani e përbuzur, ata shihnin «rezervën» e klasës

së tyre për të përmbysur rendin e vjetër të kalbur feudal. Në këto çështje nuk munguan paqartësi dhe iluzione, që nuk ishin të rastit. Më qartë se kushdo tjetër në shekullin XIX e shtroi pyetjen rreth forcave lëvizëse të shoqërisë shqiptare Zef Jubani, së cilës i dha përgjigjen se «palcën e kombit» e përbënin fshatarët, që nga veriu në Myzeqe e në Çamëri, edhe pse e njihnte realitetin e hidhur të jetës së rëndë të malësorëve e të çifçinjve. Te këta njerëz të thjeshtë ai admiroi aftësitë krijuese artistike në fushën e muzikës popullore, të valleve, të lojërave dhe shprehu besimin e plotë se po t'u jepej ndihma ata do të bënin kryevepra. Me sy të mprehtë realist, Jubani, i zhveshur nga disa iluzione romantike, që idealizojnë jetën e malësorit tonë si te P. Vasa e S. Frashëri, e ka kuptuar se sa shtrenjtë ishte blerë «autonomia» që gëzonin malësorët. Në ruajtjen e kësaj autonomie në plan bajrakësh të vegjël, që ishin në luftë të përjetshme me qeverinë dhe midis tyre, ai shihte një faktor që përjetësonte një gjendje anarkie të dëmshme, në radhë të parë për vetë malësorët e pastaj për zhvillimin e përgjithshëm të kombit shqiptar. Me këtë ai nuk mohonte, nga ana tjetër, rolin pozitiv të izolimit të malësorëve për mbrojtjen e autonomisë së tyre. Këtë aspekt rilindësit në përgjithësi e lartësonin (ne do të thoshim e absolutizonin në mënyrë johistorike) si faktor vendimtar, që nuk i lejoi shqiptarët në përgjithësi, të asimilohen nga popujt më të përparuar.

Si shprehje e një idealizimi të tillë mund të konsiderohej ideja e Samiut nga e cila ai më vonë hoqi dorë, se Shqipëria e pavarur duhej të qeverisej nga një institucion tradicional si ai i kuvendit të pleqve të fisit në malësitë, duke mos marrë parasysh se një institucion i tillë nuk mund të përputhej me interesat e borgjezisë.

Rrethanat historike që prej shekullit XV kishin krijuar vështirësi për pjesëmarrjen e popullit shqiptar e të kulturës së tij në proceset e mëdha shoqërore e kulturore që po zhvilloheshin në përgjithësi në Evropë. Kjo dukuri dëmtoi kulturën edhe të popujve të tjerë të Gadishullit Ballkanik, por për shumë arsye që më i ndjeshëm në Shqipëri. Me gjithë vështirësitë e krijuara nga regjimi politik sundues, lidhjet ekonomike prapëseprapë nuk u ndërprejnë; edhe shtresat punonjëse zejtare, tregtare nuk e përjashtuan kurrë veprimtarinë e tyre nga ky kuadër evropian.

Në mënyrë të ndërgjegjshme demokratët rilindës, përpjekjen për ta lidhur kulturën shqiptare me rrymat më të përparuara të kohës e konsideruan si një detyrë të dorës së parë, që e realizuan në një varg rastesh me shembullin e tyre vetjak: pjesëmarrja e P. Vasës në Revolucionin e 1848/49-ës në Itali, e Z. Jubanit dhe e arbëreshëve në lëvizjet garibaldine etj. Përvetësimi i përmbajtjes demokratike të ideologjisë së çlirimit kombëtar ishte për rilindësit një kusht i domosdoshëm për përparimin e kulturës shqiptare. Ata e kushtëzuan këtë përparim me shndërrime ekonomiko-shoqërore, që do t'u çanin rrugën marrëdhënieve të reja më të përparuara, gjë që ata e shpallnin si kthimin e popullit shqiptar në gjirin e Evropës së qytetëruar. Duke ruajtur frymën dhe realizimet e kulturës tradicionale popullore, ata mendonin për një raport të drejtë në lidhje me elementët përparimtarë të kulturës ndërkombëtare. Një qëndrim i tillë përparimtar e dallon rrënjësisht konceptin e tyre të «modernizimit» nga ajo mënyrë formale me të cilën zbatohet ky koncept në një varg shoqërihsh koloniale ose neokoloniale të sotme. Për mendimin e këtyre demokratëve shqiptarë ishte i huaj një qëndrim refraktar ndaj «së huajës», megjithëse mbi gjendjen e fshatarit e të zejtarit shqiptar kishte filluar të ushtronte efektin e saj shkatërrimtar ndërhyrja e kapitalit evropian. Përgjigjja e drejtë, është mendimi i S. Frashërit, nuk do të ishte mbyllja e vendit me barrikadën ndaj së resë, por zhvillimi i tij për t'i bërë ballë me forcat e veta këtij presioni.

Për asnjërin nga rilindësit tanë nuk kishte dyshim se kultura popullore-kombëtare shqiptare e kishte vendin e vet me të drejta të barabarta midis kulturës së përgjithshme evropiane, për mbrojtjen e së cilës populli shqiptar ishte i ndërgjegjshëm se kishte bërë sakrifica gjatë historisë së tij. Një meritë të tillë historike kultura popullore-kombëtare shqiptare e fitonte edhe në shekullin XIX, me luftën që bënte krahas popujve të tjerë për përmbysjen e perandorive të kalbëzuara feudale-absolutiste dhe regjimeve të tyre universale feudaliste, në të cilat donin t'i ndrydhnin kulturat popullore të kombeve të tyre të shtypura.

Nën prizmin e raportit midis njësisë dhe dasisë, midis vendëses dhe së huajës, rilindësit shtruan edhe problemin e lidhjeve të fesë me kulturën popullore shqiptare. Duke u nisur

nga kushtet historike, ata e konsideruan me të drejtë fenë si një element përçarës, të huaj, të ardhur nga jashtë, përçuese tendencash kulturore divergjente antikombëtare. Megjithatë, ata nuk arritën derisa të kuptonin thelbin shoqëror të dukurisë fetare dhe me një forcë iluzioni romantik e quanin të mundur ta zëvendësonin fenë me ideologjinë kombëtare dhe me njëfarë mitologjie pagane, ashtu siç rronte ende në zonat e Malësisë së Veriut, te kulti i malit të Tomorit etj., duke e konsideruar këtë si një diçka kombëtare, si shprehje specifike të etnosit shqiptar, duke harruar funksionin ideologjik që nuk i mungonte edhe kësaj dukurie.

Lufta që rilindësit tanë, me gjithë kufizimet e tyre, u shpallën faktorëve konservatorë dhe regresivë kishte një karakter demokratik. Idealet e tyre nuk mund të realizoheshin, pa përpjekje për ta bërë kulturën pronë të popullit, pa ndihmesën e të cilit nuk mund të realizohej detyra themelore e çlirimit kombëtar. Kjo kërkonte të forcohej elementi popullor në gjuhë e në letërsi, në shkollë e në shtyp. Me këtë koncept të instrumentalizimit të kulturës, ideologjia e re e borgjezisë shqiptare kishte arritur një shkallë më të lartë pjekurie. Por, edhe në rastet më të përparuara, ajo nuk mund të kapërcente karakterin abstrakt të një humanizmi mbiklasor e të kalonte caqet e interesave klasore të borgjezisë kombëtare.

Studimet në fushën e kulturës, gjatë Rilindjes sonë, nuk arritën në një përgjithësim përmbledhës të rezultateve. Megjithatë, kjo periudhë përbën një fazë të re, një hap shumë të madh përpara me konceptet e me konsideratat e përgjithshme që përmbajnë veprat themelore, të cilat përbëjnë platformën ideologjike të rilindësve. Le të përmendim për këtë vetëm librin e V. Dorsës të vitit 1846, veprën e Z. Jubanit më 1870, hyrjen e «Bletës» të Th. Mitkos të vitit 1878, «Apologjinë» e J. Vretos po në atë vit, librin e P. Vasës më 1879 dhe atë vështrimin panoramik aq të pasur të S. Frashërit mbi «Shqipërinë ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet». Të gjithë ata, përtej këtyre ideve të përgjithshme mbi rrugën e popullit shqiptar e të kulturës së tij, dhanë materiale të një vlere të jashtëzakonshme për njohjen e kësaj kulture. Nuk na çudit se në këtë shkallë zhvillimi të studimeve mungojnë probleme më të ngushta të karakterit metodik, po të përjashtojmë proble-

met e folklorit. Vetëm prej njërit nga rilindësit kemi, qoftë edhe në mënyrë fragmentare, disa të dhëna që tregojnë se atyre nuk u ishin të huaja konsideratat e karakterit teoriko-metodik. Në një shënim Sami Frashëri jep të dhëna shumë interesante për mendimet e Hoxha Hasan Tahsinit, për problemet e historisë. Ky mendimtar materialist vinte me të drejtë në dukje karakterin joshkencor të historisë tradicionale oborr-tare, e cila, thotë ai, «jep disa të dhëna të gabuara vetëm për 5-10 veta» dhe nxirrte këndej konkluzionin e drejtë se ajo nuk mund të përbënte në kuptim të plotë një shkencë. «Është më mirë, thotë ai, të studiosh gjendjen e kaluar dhe të tashmen, të fisit njerëzor në përgjithësi», dhe kërkon që vendin e historisë së kuptuar aq ngushtë, ta zinte «antropologjia» në një kuptim sot prapë modern, si shkencë jo e cilësive fizike të njerëzimit, por, siç e formulonte përpara 100 vjetësh dijetari i shquar shqiptar, një shkencë që jep njohuri «për njerëzimin dhe për zhvillimin e tij të përgjithshëm».

Këtë koncept të një disipline shkencore, kushtuar rrugës së zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore të përfaqësuar në kulturën e saj, po e realizon sot, në kushtet e reja, që as nuk mund t'i mendonte rilindësi ynë, etnografia jonë marksiste.

* *

Gjendja në fushën e studimeve rreth kulturës popullore nuk ndryshoi thelbësisht në vitet e jetës së pavarur shtetërore. Mund të themi se tendencat themelore, që ishin shfaqur në kohën e Rilindjes, vazhduan edhe tani, me një numër më të madh punimesh të të njëjtit karakter, me mbledhje materialesh folklorike, dokesh e zakonesh, me botimin e artikujve kushtuar ndonjë fshati a krahine etj. Ajo punë kryesore që u bë ishte fryt i një pune vullnetmirë, në radhë të parë arsimtarësh e studentësh, materialet e të cilëve u botuan në disa revista e vëllime më vete. Vetëm pas vitit 1937, Ministria e Arsimit u kujtua të fillonte botimin e një serie, ku të gjente vend deri diku pasuria e traditave gojore të popullit. Një kontribut me vlerë për studimin e disa aspekteve të kulturës

sonë popullore, duke u nisur, veçanërisht nga ana gjuhësore, dha në fund të viteve 30 Eqrem Çabej.

Problemi i rolit të kulturës sonë popullore vazhdonte të ngrihej në mendimin shoqëror përparimtar dhe shkaktonte kundërpërgjigjen e reaksionit. Pikërisht në periudhën kur u acaruan konfliktet politike në luftën për zhvillimin demokratik të vendit dhe bëhej gjithnjë më i fortë rreziku i agresionit fashist dhe i kulturës së tij kundër popullit tonë, qarqet përparimtare e demokratike, midis të cilëve filluan të shquhen komunistët, ngritën zërin kundër rrezikut të ideologjisë fashiste dhe lidhur me të, kundër qëndrimeve kozmopolite, që karakterizonin qarqet zyrtare. Midis këtyre punimeve shquhen disa artikuj studimi kushtuar problemeve aktuale shoqërore, siç ishte gjendja e fshatarësisë, formimi i pronës së madhe çifligare etj. Një rëndësi të veçantë pati studimi themelor i Dalip Zavalanit me titull «Marrëdhëniet agrare në Shqipëri» (1939), ku për herë të parë jepej një përshkrim shumë realist e i dokumentuar i gjendjes së mjeruar të fshatarit tonë.

Përhapja e ideve demokratike, ndikimi gjithnjë më i madh i ideve komuniste e nxitën veçanërisht klerin katolik të shtonte veprimtarinë e tij në botimin e materialeve me karakter etnografik. Nota zotëruese e propagandës u bë idealizimi i patriarkalizmit, paraqitja e malësisë katolike si bartëse e vërtetë e kulturës popullore. Duke dashur t'i jepte propagandës së vet një bazë historike, kleri e paraqiste kishën si trashëgimtarin dhe mbrojtësin e përvetshme të kulturës kombëtare shqiptare. Në kushtet e Shqipërisë së ndarë në shumë fe, kjo donte të thoshte se kleri katolik kërkonte zhvillimin e një kulture të veçantë, krahinore, mbi baza fetare në dëm të unitetit të kulturës popullore-kombëtare. Këtij qëllimi i shërbeu edhe botimi me rëndësi shkencore që pa dritën në këto kushte «Kanuni i Lekë Dukagjinit», i mbledhur e i kodifikuar nga S. K. Gjeçovi. Me parullën «të shpëtojme popullin nga idetë e reja të rrezikshme», kleri paraqitej si «mbrojtësi» i kulturës popullore. Objekt sulmesh u bënë prej tij, bashkë me idetë demokratike, edhe rrymat të quajtura «oksidentale», por oksidentalizmi i tyre nuk donte të thoshte se ato niseshin nga ide përparimtare për vlerësimin e kulturës popullore; përkundrazi, këta oksidentalë ishin përçues të një ideologjie që i përbuzte masat

popullore si bartëse të primitivitetit prelogjik e të paragjykitmeve, në frymën e sociologut Levi Bryl (Levy Bruhl), si një masë të vrazhdë që e pengonte zhvillimin e «kulturës së vërtetë». Kozmopolitë si B. Merxhani dhe B. Koça nuk kishin asnjë kuptim e vlerësim të drejtë për këtë kulturë.

Në këto kushte, Shqipëria zyrtare e viteve të pavarësisë nuk ndërmori asnjë hap në dobi të studimit të kulturës sonë popullore.

Kjo detyrë u kap e u zhvillua më tej nga shkenca etnografike ose etnologjike evropiane. Historia e studimeve etnografike të huaja mbi Shqipërinë filloi në atë fazë, kur në arenën diplomatike po acaroheshin kontradiktat ndërkombëtare në lidhje me trashëgimin e Perandorisë Osmane. Një varg diplomatësh, ushtarakësh, ekonomistësh, misionarësh klerikë, shkencëtarësh të ngarkuar me misione politike, përshkuan vendin tonë, emrat e disa prej të cilëve kanë hyrë tashmë në historinë e studimeve albanologjike për kontributin që sollën ata me materialin e vëzhgimeve të tyre për njohjen shkencore të Shqipërisë e të popullit të tij. Le të kujtojmë vetëm emrat e një Likë (U. M. Lik), Han (J. Hahn), Dozon, Ipen (T. Ippen), Nopça (F. Nopcsa), Baldaçi (A. Baldacci), Luis etj.

Nuk është as e mundur, as detyra jonë, të bëjmë këtu analizën e veprave të tyre. Le të hedhim vetëm një vështrim mbi disa koncepte themelore në lidhje me probleme që na duken me rëndësi për problemin që po trajtojmë.

Figura e parë e përfaqësuese për gjithë shekullin XIX në fushën e studimeve shqiptare, është J. G. Hani, vepra e të cilit «Studime shqiptare» (1854) përbën një trajtim themelor të natyrës, të historisë, të kulturës, të mënyrës së jetesës së krahinave të ndryshme të Jugut e të Veriut, një burim etnografik me të dhëna të dorës së parë. Por, duke mos mundur t'i kuptojë dukuritë mbi një bazë të drejtë metodologjike, Hani niset nga disa forma të zbrazura nga përmbajtja konkrete, për të bërë disa krahasime formash. Kështu, ai niset nga format e organizimit shoqëror të shqiptarëve dhe nga disa institute të tyre juridike siç janë vllaznitë, lidhjet fisnore të Shqipërisë së Veriut etj., për t'i lidhur ato me fylet e fratritë e Atikës skllavopronare; krahason qëndrimin e aristokracisë feudale shqiptare kundër Tanzimatit me atë të tesalëve kundër

Filipit të Maqedonisë; hakmarrjen e shqiptarëve e përdor si argument për të vërtetuar prejardhjen prej pellazgëve dhe autoktoninë e shqiptarëve.

Të tilla krahasime antihistorike përbëjnë një vazhdë të tërë në letërsinë etnografike. Le të marrim etnografin angleze E. Durham, e njohur si filoshqiptare. Në veprën e saj mbi Shqipërinë Veriore, jetën e malësorëve ajo e karakterizon me këto fjalë: «ja si rronim në disa mijëra vjet përpara, ja si mendonim, ja si vepronim në fillim të kohërave!» duke krahasuar situata me përmbajtje thelbësisht të ndryshme.

Konceptin se ka vende që nuk u nënshtrohen ndryshimeve historike, lidhur me vendin tonë e shprehu, më 1920, etnografi austriak M. Haberland (M. Haberlandt), kur thotë se «rryma e jetës ka kaluar pa i prekur këto vende, këto pika të vdekura të jetës së popujve». Kultura jonë popullore konsiderohej kështu si një petrefakt, një ngurzim i vdekur.

Te Hani gjejmë të shprehur një koncept metodologjik të përgjithshëm, me jetë të gjatë në gjithë literaturën shkencore borgjeze: parimin e determinizimit gjeografik e demografik, si faktor vendimtar për gjithë mënyrën e jetesës e të historisë së popullit tonë. Në këtë mënyrë dukuritë kulturore shkëputen nga veprimi i ligjeve historike, konsiderohen si veçori të pandryshueshme të etnive e të popujve të një trualli të caktuar. Shqiptarët përbëjnë një tërësi etnike-gjuhësore-kulturore, thotë Hani, e megjithatë ata nuk kanë qenë kurrë një njësi politike; veçoria e tipareve natyrore të Shqipërisë e shpjegon këtë, dhe duke parë, më 1864, ashpërsinë e malësive midis Drinit e Vardarit, pa vlerësuar faktorët shoqërorë-historikë, ai beson të kuptojë përse shqiptarët ishin të dënuar të rronin të mbërthyer pas një shkalle të tillë të ulët zhvillimi kulturor, pikërisht atje ku sot po ndërtohen gjigantët e dritës!

Ky determinizëm gjeografik, që gjeti formulimin e vet të plotë te shkolla e Racelit, (F. Ratsel), i kombinuar me teorinë e «shpërthimeve demografike», si dukuri të ligjshme për këto malësi, gjen shprehjen e vet në veprat e G. Shtadtmylerit (G. Stadtmüller) mbi historinë e hershme të shqiptarëve. Pozita gjeopolitike dhe trajtësia e tokës (trualli si fat!), ja ç'ka përcaktuar kurdoherë fatin e këtij populli «pa atdhe», po vetëm me «hapësirë jetësore», siç u përket barinjve ravgues. Eks-

plozionet demografike kanë dalluar mënyrën e jetesës së shqiptarëve që nga koha e romakëve e deri nën sulltanët. Në këto kushte gjeografike nuk mund të ketë zhvillim të pandërprerë kulturash. Ky është përfundimi i antropogjeografit gjerman M. Urban, të cilit, nga ana tjetër, i detyrojmë një libër me interes mbi vendbanimet e Shqipërisë së Jugut (1938).

Nga fundi i shekullit XIX, shkencat etnografike dolën nga faza pozitiviste e përshkrimit dhe e kategorizimit të dukurive dhe të objekteve kulturore. Brenda caqeve të një botëkuptimi idealist, shkolla e evolucionizmit historik përpiqej t'i shihte kulturat në rrjedhën e shndërrimeve historike të kontakteve të ndërsjella. Ky parim përfundimtar tashmë i përfshinte edhe kulturat tradicionale në procesin e zhvillimit, porse të një zhvillimi të thjeshtë, jodialektik-klasor.

Kultura popullore konsiderohej kështu si pjesë e historisë së njerëzimit, e në këtë kuadër edhe dokumentet e kulturës popullore shqiptare fitonin vlerën për të rindërtuar historinë e këtij populli. Përfaqësuesi kryesor i kësaj rryme në studimet etnografike mbi Shqipërinë u bë gjeologu dhe etnografi austro-hungarez F. Nopça (F. Nopcsa). Trilogjia e tij, e përbërë nga një vëllim, kushtuar ndërtesave, veshjeve dhe orendive të Shqipërisë së Veriut, dhe dy mbi fiset e Malësisë dhe të drejtën e tyre dokësore dhe mitologjinë, përbëjnë një inventar të plotë të kulturës materiale shoqërore e shpirtërore të malësorëve të veriut, në fund të shekullit XIX. Këtu etnografi, me metodat e arkeologut, duke larguar shtresë pas shtrese elementet e reja, përpiqet të arrijë deri në themelet e asaj ndërtese të lashtë e aq komplekse siç është kultura e këtij populli. Kjo ishte një rrugë metodike e drejtë, edhe pse Nopça nuk arriti të shohë edhe në këtë shoqëri «primitive» ekzistencën dhe veprimin e faktorëve klasorë. Këtë mundi ta bënte vetëm etnografia jonë marksiste-leniniste.

Me analizën e tij, Nopça arrin deri në prejardhjen fillestare të një vargu dukurish të kulturës sonë. Kjo analizë stratigrafike dha rezultate shumë interesante: nga 64 objekte të kulturës materiale që analizoi ai, 30 ishin me prejardhje të lashtë mesdhetare, ballkaniko-trako-ilire, 18 me prejardhje romake, 6 romanike mesjetare, 3 sllave etj. Një rezultat të ngjashëm jepte analiza e dukurive mitologjike e të kulturës

shpirtërore, ku dalloheshin 36 elemente të lashta ballkanike, 6 romanike, 16 me prejardhje alpine, 17 mesdhetare e 2 sllave.

Le të shtojmë këtu me këtë rast, se atë që Nopça e bëri nëpërmjet analizës etnografike, miku i tij, gjuhëtari i njohur N. Jokli e bëri me një mënyrë analoge në fushën e gjuhësisë në veprën e tij «Hulumtime gjuhësore kulturore-historike në fushën e shqipes» duke u ngjitur po me këtë mënyrë analitike deri në shtresat më të larta të historisë kulturore të shqiptarëve.

Pranë analizës së kulturës materiale e shpirtërore, Nopça ndërmoi studimin e «fiseve» të Veriut dhe të së drejtës së tyre dokësore. Ai zbatoi edhe këtu parimin historik, duke këmbëngulur, në radhë të parë, në rrethanat e veçanta e të jash-tëzakonshme që krijoi si faktor përcaktues pushtimi osman në këto zona, e përgjithësisht në Shqipëri. Pikërisht në këtë pikë të së drejtës zakonore ndesheshin në mënyrë më kontradiktore pikëpamjet shkencore që shpesh nuk ishin thjesht të karakterit teorik, po merrnin edhe karakter politik (shqiptarët e «egër» vazhdonin të rronin në shkallën e «fiseve primitive»!) Zgjidhja që mendojmë ne se është vërtetuar sot nga studimet tona historike edhe etnografike është se këtu s'kemi të bëjmë me «fise» me kuptim të plotë, d.m.th. me bashkësi të një gjaku, por me bashkësi territoriale, të formuara në kushtet e pushtimit osman, si vende strehimi. Ajo që i bashkoi ishte në radhë të parë nevoja e mbrojtjes e pastaj prona e përbashkët (kullota, pyje, ujëra) pranë pronës private të familjeve.

Kundër mendimit antihistorik se e drejta dokësore shqiptare përfaqëson vazhdimësinë e drejtpërsëdrejtë të së drejtës ilire, pa dallime klasore, shfaqur tani vonë edhe nga A. Godin, sipas të cilit, këtu s'paska asnjë element të vonë antik ose mesjetar, Nopça, duke bërë një analizë krahasuese me të drejtën mesjetare në fuqi në pellgun e Adriatikut, përfundoi se këtu kemi të bëjmë në thelb me disa shtresa morfologjike të më të vjetra që nuk e kapërcejnë mesjetën e hershme dhe u fiksuat në shekullin XIII. Kanuni përbënte pra, të drejtën e një shoqërie feudale të hershme, por që paraqitej në një formë të degraduar, të përshtatur kushteve të shoqërisë së bashkësive malësore.

Vepra tërësore e Nopçës përbën një kontribut për të vënë

në dukje pasurinë e lashtësinë e kulturës dhe të institucioneve të shoqërisë malësore të Shqipërisë së Veriut. Shqipërinë ai e konsideronte për këtë arsye si pikën e Arkimedit, për të ndriçuar çështje me interes për historinë e kulturës të të gjithë Ballkanit e të Evropës së lashtë.

Kontributi i Nopçës në fushën e studimeve rreth kulturës shqiptare duhet vlerësuar në mënyrë dialektike. Pavarësisht nga synimet subjektive dhe nga interesat politike që qëndronin prapa saj, ai vuri në dukje rrugën aq komplekse e të vështirë që kultura popullore e shqiptarëve që e detyruar të ndiqte. Këtu s'ishte fjala vetëm për relikte, por për një kulturë të gjallë që kishte në gjirin e saj një trashëgim të pasur kulturor. Nga ana tjetër, për të ishte i huaj mendimi i integritit të saj në një kulturë të re. Vepra etnografike e Nopçës e studioi Malësinë e Veriut si diçka të veçuar, të shkëputur nga studimi kompleks i gjithë shoqërisë shqiptare, çfarë do t'i kishte dhënë asaj një aspekt historik të plotë dhe unitar. Karakteri i kufizuar i metodologjisë idealiste nuk e la, gjithashtu, Nopçën të shohë dukuritë e së drejtës dokësore si shprehje interesash klasore të përcaktuara në kundërshtim me zhvillimin shoqëror-kulturor të malësorëve, as nuk e lejoi të shihte dukuritë e risisë që po çanin rrugë edhe në këtë shoqëri patriarkale, ku po bënte punën e vet fuqia e parasë, diferencimi ekonomik-shoqëror dhe lufta e klasës. Vetëm shkenca jonë marksiste mundi ta vlerësonte të drejtën kanunore në këtë aspekt historik klasor dhe, duke u nisur nga rrënjët e saj historike klasore, të nxirrte konkluzionet që ajo ishte tashmë e papajtueshme me vetë interesat e masave punonjëse të Malësisë e të gjithë vendit Mbi bazën e veprës së Nopçës nuk mund të bëhej një prognozë reale e zhvillimit të kulturës demokratike popullore, në kuadrin e kulturës kombëtare. Në thelbin e saj vepra e Nopçës, e këtij aristokrati të zhgënjyer nga shoqëria bashkëkohore, ishte kthyer nga e kaluara dhe kjo nuk mund të ishte ndryshe.

Periudha e kapitalizmit të vonë, e imperializmit, karakterizohet nga degjenerimi i plotë që vihet re në shkencat e kulturës, me braktisjen nga ato të parimit historik e me kalimin në pozita të hapëta metafizike e reaksionare, që e konsideronin shoqërinë si një sistem statik, ku nuk kishte vend për parimin e zhvillimit e aq më pak për revolucionin.

Kulturata e shoqëritë përbënin në këtë kuptim sisteme të mbyllura. Antropologu amerikan J. G. Kun (J. G. Coon) e konsideron pikërisht në këtë kuptim Shqipërinë e viteve 20, kur ai ka qenë këtu, si tip ideal të një shoqërie, e cila ka gjetur një formë organizimi adekuat, që e lejoi të veçohet nga Evropa e nga zhvillimi i saj i shqetësuar, kurse kjo vetë nuk qe në gjendje të evitonte zhvillim, lëvizje, revolucion!

Sipas këtij koncepti, në shoqërinë patriarkale shqiptare ishte mishëruar një tendencë themelore konstante, rreth së cilës ishte kristalizuar gjithçka. Ekzogamia nuk ishte rrjedhim i lidhjeve të gjakut, por kishte një kuptim funksional praktik, d.m.th. për të evituar konflikte të ndryshme pasurore, duke i marrë gratë larg. Norma ideale e çdo shoqërie për etnologun amerikan është ajo, që krijon vështirësitë më të pakta në një sistem relacionesh. Edhe në sistemin e shoqërisë patriarkale vlen ligji i mbipopullimit, i cili prish staticitetin e sistemit dhe prandaj kërkon si parim regulativ, në Shqipëri si në Kaukaz e në Afganistan, një rregullim automatik, si një ventil sigurimi, gjakmarrjen. Hakmarrja zhduk burrat e tepërt. Institucioni i hakmarrjes nuk qenka lidhur pra me një organizim shoqëror të caktuar, por me dukurinë e shpërpjesëtimeve biologjike. Përhapja e armëve të zjarrit çon në një prishje tjetër të këtij ekuilibri gjë që e paska bërë të nevojshme që në shekullin XVIII të fillojë një imigrim popullsish të reja në zonat e malësisë shqiptare — një dukuri për të cilën historia nuk ka në fakt asnjë të dhënë.

Edhe antropologu tjetër amerikan R. Lovie (R. Lowie) i ka kushtuar vëmendje Shqipërisë pikërisht për këtë arsye se përbën një shembull instruktiv për teorinë e tij, kur një sistem i vjetër ndeshet me elemente të reja që lindin çrregullime. Dësh-timi i përpjekjeve për të modernizuar Shqipërinë (Lovie e shkruan më 1940 dhe e boton librin më 1952), dëshmuaka pikërisht për vështirësitë për t'i imponuar ide të reja një sistemi të formuar, dëshmon për vështirësitë e akulturimit. Dhe në qoftë se ka një element që vepron në Shqipëri si bartës ndryshimesh, ky ardhka nga jashtë, qenka tradita e shtegtimit të zanatçinjve e të tregtarëve që sjellin të renë, jo direkt në jetën ekonomike, që është më kompakte dhe rezistente, por në atë që qenka më e lëvizshme, në jetën familjare, duke thyer

traditën, duke i shkëputur të rinjtë nga mbikëqyrja e të vjetërve, gjë që lejuaka shprehjen e dëshirave individuale, e me këtë u çaka rrugën ideve të reja! Jeta tregoi se sa pak reale ishin këto konstruksione teorike.

* *

Vështrimi i shkurtër mbi studimet e zhvilluara në të kaluarën nga studiues shqiptarë e të huaj, vuri në dukje një sërë problemesh të mëdha që karakterizonin rrugën historike të kulturës popullore shqiptare. Këto ishin probleme të mëdha, të lindura nga kontradikta shoqërore e klasore. Më parë se probleme teorike të shkencave konkrete, ato përbënin probleme të realitetit, të realitetit ekonomik — e politiko-kulturor të shoqërisë shqiptare. Këto probleme të mëdha studimet etnografike të së kaluarës i pasqyrojnë ku më pak e ku më shumë, të penguara nga kufizimet ideologjike e metodologjiko-shkencore, që i karakterizonin ato. Zgjidhja e këtyre kontradiktave të trashëgimit tonë historiko-kulturor nuk mund të ishte një punë e thjeshtë teoricienësh ose specialistësh të një dege. Kjo ishte detyra e madhe që morën përsipër forcat e reja të klasës punëtore shqiptare nën udhëheqjen e Partisë së saj revolucionare, të dalë nga shoqëria tradicionale. Të rritura në gjirin e masave popullore shqiptare, por tashmë të pajisura me një ideologji të re shkencore, këto forca u vunë në gjendje të zgjidhin me shpatën e historisë njëjën gordiane që e kishin pleksur e lënë të pazgjidhur shekujt.

Në valët e kësaj lufte klasore për ngritjen e një shoqërie të re dhe të një kulture të re lindën e u formuan si shkenca marksiste-leniniste, shkencat tona shoqërore dhe në gjirin e tyre, shkencat tona të kulturës.

Në praktikën e ndërtimit socialist të kulturës sonë të re, etnografia dhe folkloristika jonë u rritën dhe u zhvilluan tashmë si shkenca në kuptim të plotë, duke përvetësuar bazën metodologjike dhe metodikën speciale, duke fituar fizionominë e tyre si shkenca të dukurive të kulturës. Në këtë kuptim ne duhet të themi se rruga e formimit të shkencave tona të kul-

turës nuk mund të kuptohet po të shihet e shkëputur nga toka-mëmë, nga detyrat që u shtronte realiteti ynë socialist dhe për të cilat ai u kërkonte një përgjigje shkencore.

Kjo nuk do të thotë se në këto kushte ato u ndodhën përpara një deti, në të cilin vepronin erëra të kundërta, se ato u gjendën përballë dallgëve të jetës si një anije pa busull e pa orientim.

Ajo që dallon realitetin kulturor të Shqipërisë socialiste në këtë epokë 35-vjeçare, që mban emrin e Partisë, është se për herë të parë ngjarjet e proceset që zhvillohen në truallin shqiptar nuk janë më, si në të kaluarën, rezultate procesesh spontane, forcash disparate kontradiktore, me orientime kulturore-ideologjike-politike divergjente, ekzogjene. Proceset e mëdha kulturore që karakterizojnë këtë epokë mbështeten dhe janë fryt i një plani strategjik e taktik të hartuar mbi baza shkencore, ku janë llogaritur forcat klasore që veprojnë dhe që përcaktojnë rrugën e zhvillimit ekonomik-shoqëror, politik e kulturor, jetën e masave popullore në aspektet e saj të ndryshme.

Për Partinë e klasës punëtore shqiptare, që përgjigjej për fatet e kulturës të këtij populli, qëndrimi që do të mbahej ndaj traditës aq të pasur kulturore të popullit paraqiste një problem të madh ideologjik-shkencor. Përbën një faqe nderi në historinë e mendimit politik e shoqëror shqiptar fakti që, qysh në ditët e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare e deri në ditët tona, Partia dhe shoku Enver këtij problemi madhor i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë, gjë që ka gjetur shprehjen më të qartë në dokumentet themelore të Partisë e në veprat e shokut Enver. Po për këtë aspekt do të flitet në mënyrë të veçantë në referatet pasuese.

Për Partinë tonë ishte e qartë se edhe në kulturën kombëtare shqiptare ekzistonin dy kultura; se edhe në kulturën tradicionale me frymë popullore vepronin kontradikta të fuqishme, rrjedhime të shoqërisë klasore në gjirin e së cilës ajo ishte rritur: primitivitet teknik, fetari, besëtytni, konservatorizëm patriarkal; por, nga ana tjetër, kjo kulturë, gjithmonë e gjallë prodhonte një pasuri të madhe krijimesh të reja. Ishte e qartë pra, se rruga e integritit të kësaj kulture nuk mund të ishte një rrugë idilike vazhdimësie të drejtpërdrejtë, por,

nga ana tjetër, ishin mijëra fije që lidhnin tiparet e saj përparimtare, frymën e saj popullore e demokratike me kulturën socialiste e me ideologjinë e klasës punëtore. Këtu nuk mund të veprohej duke u nisur nga mohimi nihilist ose nga pohimi i paparimtë. Edhe këtu ishte ligji i luftës klasore, që përbën forcën lëvizëse për ta çuar kulturën tonë tradicionale popullore të integrohej në kulturën tonë socialiste.

Në këtë sintezë më të lartë të kulturës sonë socialiste kombëtare kishte vendin e vet të nderit edhe tradita e krijuar nga klasa punëtore heroike shqiptare. Në kuadrin e kulturës sonë kombëtare socialiste, në gjirin e së cilës fryma popullore mban një vend nderi, Partia e klasës punëtore shqiptare dhe shoku Enver mishëruan fjalën gjeniale të Marksit, i cili në kuptimin e trefishtë të së njëjtës fjalë — aufheben — theksonte misionin e lartë të proletariatit ndaj trashëgimit kulturor botëror: të ruante e të ngrinte në një nivel më të lartë më të mirën që kishte trashëguar dhe të zhdukte atë që i kishte ikur koha.

Përvoja e ndërtimit të kulturës socialiste kombëtare shqiptare përbën një kontribut të rëndësishëm që jep PPSH edhe në plan ndërkombëtar në këtë fushë. Kjo vlen, në mënyrë të veçantë, në epokën kur po zhvillohet në shkallë botërore shkëputja gjithnjë e më e gjerë e popujve nga sistemi i kolonializmit dhe ndikimi i neokolonializmit, kur ata rreshtohen gjithmonë më me vendosmëri në luftën kundër hegjemonizmit, për krijimin e një kulture të tyre të re, popullore e kombëtare.

Etnologjia dhe shkencat e kulturës borgjezo-imperialiste, në përgjithësi, këtij procesi të brendshëm i kanë kushtuar një pjesë të madhe të veprimtarisë së tyre shkencore. «Autoritete» (me germa të mëdha) si, p.sh., specialisti i këtyre problemeve F. Bered (F. Behrendt) në veprën e tij «madhore» «Strategjia shoqërore në vendet e zhvillimit» përpiqet të gjejë ligjshmërinë e këtyre proceseve, që po përshkojnë sot një pjesë të madhe të botës. Edhe pse me terma të ndryshëm, ai takohet në fakt në shumë pika e koncepte me kolegët e tij sovjetikë, siç janë ndarja e botës në «zonat qendrore» dhe në «zonat anësore të dinamikës», ku vepron ligji i «pjerhtësisë kulturore», sipas së cilës zonat më pak të zhvilluara duhet të inkudrohen, për sa u përket proceseve themelore, në zonat e mëdha të dinamikës, që mund të jetë, sipas interesit të superfuqive, perëndimi kapitalist ose lindja revizioniste.

Kjo botë «anësore» u nënshtrohet impulseve që ardhkan nga zonat qendrore si impulse «ekzogjene» dhe, rrjedhimisht, shkaktojnë si dukuri të ligjshme një «traumë kulturore», ndeshjen e kulturës tradicionale popullore, me kulturat «eprore», traumë që mund të bëhet shkatërrimtare. Detyra e studiuesit na qenka që këto trauma të bëhen sa më pak të dhimbshme dhe të rrezikshme, d.m.th. revolucionare, duke shfrytëzuar «parimin e plogështisë shoqërore» që vepron në disa shtresa e klasa konservatore, por, duke përdorur edhe parimin e proklamuar si «shkencor» të «shndërrimeve kulturore të dirigjuara». Në këtë rrugë do të mund të shmangeshin dukuritë e rrezikshme të «diskontinuitetit» kulturor (nënkupto revolucionet).

Fitorja më e madhe, që arritën shkencat tona të kulturës në këto vite veprimtarie të dendur e të frytshme, qe fakti se ato u renditën në praktikën e ndërtimit socialist, se filluan të realizojnë parimin e madh të filozofisë marksiste-leniniste që detyra e tyre nuk ishte vetëm të njihnin, por edhe të shndërronin realitetin. Me punën e tyre shumëvjeçare ato kontribuan për të zbuluar, për të mbledhur e për të grumbulluar, për të bërë të njohur e për të studiuar një pasuri të paçmuar, të vetmen që kishte lënë ndoshta e kaluara e shqiptarit, kulturën tonë popullore. Kur ende nuk ishin mbyllur plagët e rënda, që i kishte shkaktuar agresioni fashist trupit të popullit e të Atdheut, u krijuan bërthama të para institucionale që filluan punën e tyre me entuziazëm të madh, edhe pse me mjete e me mundësi ende të pakta; më 1948 filloi punën i pari muze i vendit, kushtuar kulturës së popullit tonë, Muzeu Arkeologjik-Etnografik, u krijuan grupe e sektorë për studime etnografike, studime të historisë së artit e të krijimtarisë gojore të popullit, të monumenteve të arkitekturës, disa nga të cilat u rritën në institute më vete. Fondet e tyre erdhën duke u rritur në sajë të ekspeditave fushore që filluan të rrahin krahinat e atdheut kryq e tërthor. Fondet e grumbulluara prej sektorit të etnografisë kanë arritur të përfshijnë sot më se 15 000 objekte të kulturës materiale, rreth 600 vëllime me raporte nga ekspeditat fushore, mbi 18 000 fotografi, filma, skica etj. Instituti i Folklorit ruan sot një thesar të paçmuar prej më se një milion vargësh të krijimtarisë poetike popullore, më se 14 000 melodi të regjistruara, më se 100 valle të filmuara etj. Me mijëra janë fotografitë

dhe dokumentacioni teknik që shërben si bazë për studimin e arkitekturës sonë popullore në qytet e në fshat, që ruhet në Institutin e Monumenteve etj. Numri i punonjësve u shtua. Një rrjet i gjerë bashkëpunëtorësh shkencorë në rrethe jo vetëm si sasi, por edhe në kualifikimin e tyre shkencor, si specialistë të kulturës popullore, shtrihet sot në qytete e në fshatra dhe jep kontributin për mbledhjen e studimin e materialeve. Material të pasur për etnografinë ka sjellë edhe hartimi i historikëve të fshatrave në shkallë masive.

Kjo punë e dendur krijoi mundësinë për botimin e tij dhe për të ndërmarrë studime shkencore kushtuar aspekteve dhe fushave të ndryshme të kulturës sonë popullore: kulturës materiale, shoqërore e artistike, së drejtës zakonore, krijimtarisë poetike, etnomuzikologjisë, koreografisë etj. Studimet tona kanë sot organe të veçanta periodike të specialitetit si «Etnografia shqiptare», «Monumentet» e për së shpejti do të shohë dritën edhe një buletin periodik i Institutit të Folklorit.

Studimet në fushën e kulturës sonë popullore me revolucionarizimin e mëtejshëm bënë një hap të rëndësishëm përpara. Në tematikën e tyre, studimet kushtuar aspektit historik të kulturës popullore e të mënyrës së jetesës u lidhën më mirë me detyrat aktuale të luftës kundër dukurive negative të jetës sonë; u forcuan studimet kushtuar proceseve aktuale lidhur me evoluimin e dukurive të kulturës sonë popullore, raportit të traditës dhe të risisë, duke kapur kështu ato aspekte themelore që kanë të bëjnë me rolin e kulturës sonë popullore në krijimet e kulturës së re socialiste.

Në punimet e ndërmarra në këtë etapë të re mendimi teorik në fushën e shkencave kulturore është gjallëruar dhe është ngritur në nivelin e vet nga praktika revolucionare. Forcimi i karakterit të partishmërisë dhe të tendenciozitetit revolucionar i lejoi shkencat tona të kulturës të luftojnë mbeturina e ndikime objektiviste klerikale e nacionaliste në konceptet e tyre.

Në këto vite filluan punimet për realizimin e disa detyrave madhore me karakter sinteze, që kërkojnë punë komplekse shkencore, të organizuar mbi baza të gjera kolektive. Të tilla janë fillimi i punës për hartimin e Atlasit të Kulturës Popullore (Atlasit Etnografik) të Popullit Shqiptar, botimi i Korpusit të Folklorit Shqiptar (deri sot botuar më se 10 vëllime), har-

timi i teksteve përgjithësuese të Folklorit Shqiptar dhe Etnografia Shqiptare, organizimi i Konferencës së Parë të Folkloristikës Shqiptare e më në fund, po jo e fundit!, Konferenca e Parë Kombëtare e Studimeve Etnografike.

* * *

Studiuesit tanë në fushën e shkencave të kulturës kanë arritur një varg suksesesh, që do t'u shërbejnë si bazë për të vazhduar punën drejt objektivave të rinj më të lartë. Kultura e një kombi socialist me tradita të tilla të lashta, siç i ka kombi ynë shqiptar, është e pamendueshme pa ideologjinë revolucionare dhe pa tiparet, pa frymën e vet popullore, pa tabanin e vet kombëtar.

Kurrkush më shumë se shkencat tona të historisë së kulturës nuk mund t'i shërbejnë mirë kësaj detyre plot përgjegjësi, që u ka ngarkuar Partia dhe shoku Enver, që «me forca të bashkuara, të njerëzve tanë të shkencës, të arteve, të kulturës, të luftohet për të studiuar karakterin kombëtar në drejtime të ndryshme të kulturës».

Ky orientim i Partisë dhe i shokut Enver u jep studimeve tona perspektivën e madhe me rëndësi politike e shkencore, e rreshton punën tonë në luftën e madhe që bëjnë kudo popujt, forcat e përparimit e të revolucionit kundër konservatorizmit, regresit, të përfaqësuar nga hegjemonizmi imperialist.

Është detyra jonë që të vazhdojmë me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë studimet e filluara si dhe për t'i plotësuar e për t'i pasuruar më tej. Objektivat që qëndrojnë në planet tona pesëvjeçare përfaqësojnë probleme të mëdha të realitetit tonë ideologjik-kulturor. Aty është mishëruar drejt mendimi i Partisë dhe i shokut Enver se e kaluara duhet t'i shërbejë së ardhmes; aty është mishëruar, në një përpjesëtim të drejtë, studimi i pasurive të mëdha kulturore të së kaluarës, me studimin e proceseve të evoluimit të këtyre traditave tona të lashta, popullore përparimtare në kushtet e revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës sonë. Këto procese duhet të studiohen në mënyrë sistematike, si procese tërësore, kulturore-sociologjike, në plan kra-

hinor dhe kombëtar, në formë temash monografike. Duhet të vazhdojë me ritme të shpejtuara puna për dy objektiva të mëdhenj, për Atlasin e Kulturës Popullore Shqiptare dhe për Korpusin e Folklorit Shqiptar. Në mënyrë sistematike duhet të vazhdojë gjithashtu puna për zbulimin, për mbledhjen dhe për studimin e mëtejshëm të thesareve të kulturës sonë popullore. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar sidomos punës muzeore si detyrë me karakter të mirëfilltë shkencor e me përgjegjësi të madhe ideologjike.

Punonjësit tanë të shkencave të kulturës janë të bindur se në konferencat e ardhshme, kushtuar problemeve të kulturës sonë popullore, ata do të paraqiten me suksese të reja më të mëdha. Garanci për këtë është kujdesi që ka treguar kurdoherë për këtë çështje të madhe e të shtrenjtë për çdo zemër shqiptare shteti ynë socialist. Ringjallja e këtij populli tonë të vjetër dhe e kulturës së tij kombëtare socialiste, është vepër e lavdishme e epokës së Partisë. Fryt i kësaj rilindjeje është edhe shkenca jonë marksiste-leniniste e kulturës.

Duke mbyllur këtë referat, në të cilin përsjekohej rruga e shkencave tona etnografike, nuk mund të mos përmendim fjalët e shprehura para 100 vjetëve nga P. Vasa, të cilin mund ta rreshtojmë në radhët e studiuesve të parë të etnografisë shqiptare: «Zemra jonë digjet nga dëshira të shohim atdheun tonë të lumtur, të mos skuqet para kombeve të qytetëruara e punëtore... Ne s'duam që populli shqiptar të humbi në këtë rrugë tiparet e tij karakteristike, zakonet, legjendat, gjuhën, që janë të vetmet pasuri që të parët tanë na i kanë lënë trashëgim». Kombi socialist shqiptar ka sot arsye të plotë të mburrret me një trashëgim shumë më të madh e të pasur, për ta mbrojtur e për ta zhvilluar atë. Dëshirat e zjarra të atdhetarëve, që atëherë ishin një utopi, i bëri realitet, në luftë të ashpër revolucionare e me guxim prej vigani, PPSH me shokun Enver në krye.

SH. K. GJEÇOVI (1874-1929)

Nga jeta dhe veprimtaria*

Jemi mbledhur për të përkujtuar një figurë të shquar të kulturës kombëtare shqiptare, Shtjefën Kostandin Gjeçovin me rastin e 50-vjetorit të rënies, për t'i kushtuar atij dhe veprimtarisë së tij pengun e nderit e të ponisë së shkencës sonë shqiptare. Para 50-vjetësh, më 14 tetor 1929, atë e vranë në mënyrë mizore e barbare shovinistët serbomëdhenj në fshatin Zymb të Kosovës, ku ai lau tokën e Atdheut me gjakun e vet, si dëshmor e bir i tij nga më besnikët.

Vrasja e Gjeçovit shkaktoi një tronditje në opinionin publik shqiptar të kohës, edhe pse populli, në kushtet e shtypjes, të errësirës e të padijes që e kishin pllakosur, atëherë nuk mund ta vlerësonte plotësisht humbjen që pësoi jeta kulturore e kombit, aq e varfër në ato vite të vështira.

Gjeçovi, kjo figurë e shquar e lëvizjes patriotike, e shkencës dhe e kulturës shqiptare, spikat sot më qartë mbi atë sfond të zymtë, me dritën dhe, pse jo, edhe me hijet e veta; dhe

* Referat i mbajtur në mbledhjen përkujtimore, organizuar nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, me rastin e 50-vjetorit të rënies së Sh. K. Gjeçovit. Autori falënderon sh. Rrok Zojzi, i cili i krijoi mundësinë të shfrytëzonte të dhënat e monografisë së tij mbi Gjeçovin para se ta dërgojë në shtyp. Referati është nxjerrë nga «Studime historike». 1979, nr. 4, f. 105-117.

përtej, gjysmëshekulli që na ndan, u thotë brezave tanë të rinj fjalën e vet me domethënie edhe për të sotmen e të nesërmen, fjalën e dashurisë për popullin tonë të lashtë e për vlerat madhore të kulturës, që ai ka krijuar gjatë shekujve, fjalën e punës vetëmohuese për studimin e kësaj kulture dhe më në fund të flijimit më të epërt në shërbim të këtij populli.

Si shumë figura të Rilindjes sonë të ndritur, edhe Shtjefën Gjeçovi e vulosi me gjak jetën dhe veprën e vet. Rruga që u mbyll me këtë vdekje tragjike, ishte vazhdim i një veprimtarie patriotike të gjatë, që e pati filluar qysh herët, në vitet e fundit të shekullit XIX. Fjalëve që shkroi, kur ishte i ri 26-vjeçar:

*Ngrehuni burra, çohuni trima...
Liri të lypim, të lypim hakun,*

ai u mbeti besnik deri në vdekje. Kjo ide përshkon gjithë veprimtarinë e tij. Deri në vdekje ai kërkoi «hakun» për popullin, jo vetëm në kuptimin e lirisë nga robëria e pushtuesve të huaj, e lirisë nga sunduesit feudalë-bajraktarë vendas që rëndonin mbi të, po, në një mënyrë të veçantë, ai këtë «hak» e kërkoi edhe në kuptimin e njohjes së popullit, të rolit të tij si krijues i vlerave më autentike të kulturës sonë popullore kombëtare. Kjo ishte gurra që ushquu, pa u shteruar, gjithë veprimtarinë e Gjeçovit si atdhetar, si mësues e si shkencëtar, që nga fillimi deri në fund.

Është e qartë se Gjeçovi nuk e pati të lehtë të fitonte menjëherë një vijë të tillë udhëheqëse të veprimit të tij, as nuk e pati të lehtë ta zbatonte atë në mënyrë konsekuente. Ai do të ndeshje, ashtu siç u ndesh, me faktorë të jashtëm e të brendshëm të pashmangshëm, objektivë e subjektivë, që do ta pengonin. Të tillë qenë sundimi i huaj osman e prapambetja e shkaktuar prej tij, ndërhyrja armiqësore e politikës së fuqive të huaja dhe e veglave të tyre të brendshme dhe, më në fund, vetë përkatësia e Gjeçovit në radhët e asaj fuqie të madhe, tmerrësisht të organizuar e militante të reaksionit politik e ideologjik, të klerit katolik. Të gjitha këto rrethana nuk mund të mos linin gjurmë në jetën e në veprimtarinë e tij. Këto ndeshje e bënë jetën e Gjeçovit plot kontradikta drama-

tike, edhe pse, në fund të fundit, nuk mundën ta mposhtnin atë vetë.

Gjeçovi lindi, më 1874, në Janjevë, pikërisht në një nga fshatrat më periferike të Kosovës, ku takohet popullsia shqiptare me elementin sllav. Kjo pozitë, dhe nga ana tjetër përkatësia e tij në fshatarësinë kosovare, me ato tiparet e saj karakteristike burrërore e luftarake prej malësorësh (malësorë edhe kur banonin në fushë apo edhe në qytet), në të cilën vazhdon të ruhej ajo frymë patriotizmi luftarak popullor, që pati shpërthyer atëherë në vitet e Lidhjes së Prizrenit, në kryengritjet pasuese të njëpasnjëshme të Kosovës kundër Perandorisë Osmane, si dhe në mobilizimin e vazhdueshëm kundër synimeve pushtuese antishqiptare të monarkisë së afërt serbe, të gjithë këta faktorë e brumosën shpirtin e Gjeçovit dhe lanë gjurmë në të, edhe pse ai iku i vogël, 14 vjeç, nga fshati lindor dhe mori rrugën e shkollimit, së pari në Shkodër e pastaj në Bosnjë, provincë në të cilën bënë pjesë nga pikëpamja kishtarë françeskanët shqiptarë që e rekrutuan atë. Kjo ishte rruga tragjike e asaj kohe për njeriun e vegjël, fshatarin ose qytetarin shqiptar të cilësdo fe, pasi normalisht s'kishte tjetër rrugë për të marrë dije e kulturë, veçse të vishje rroben e jashtme të armikut të kulturës e të përparimit, e, çka më tepër, edhe rroben e brendshme mendore të klerit, qoftë ky kleri mysliman ose i krishterë. Kjo ishte rrugë shumë e shkathët dhe e rafinuar me të cilën veçanërisht kisha e Romës siguronte për radhët e ushtrisë së vet një potencial intelektual të fuqishëm, të zgjedhur midis forcave të reja, më aktive e më premtuese të një populli.

Që kjo «gjahtarë e rafinuar shpirtrash», kisha e Romës, nuk e arriti plotësisht qëllimin që ta thyente ose ta farkëtonte krejt pas qëllimeve të veta mendjen dhe personalitetin e Gjeçovit, për këtë ka prova të shumta. Studenti i ri françeskan nuk kënaqej me problemet teologjike e metafizike, që i ofronte programi i studimeve. Mendja e tij rrihte te vendlindja e te njerëzit e saj dhe malli, dashuria për to, gjetën shprehje në orvatjet e tij poetike-letrare rinore, ku shfaqej qysh herët tema patriotike. Edhe në këtë pikëpamje Gjeçovi ndjek një rrugë tipike: ndërsa shumë fillestarë me ambicie letrare e nisnin normalisht rrugën me vargje kushtuar dashurisë rinore,

Gjeçovi, si shumë rilindës, p.sh. Z. Jubani e Th. Krei, e filloi me një vepër kushtuar dashurisë më të madhe, dashurisë ndaj Atdheut, të mishëruar në figurën e Skënderbeut. Te kjo figurë ai do të kthehej përsëri e përsëri, si letrar dramaturg, si historian e folklorist, deri në vitet e fundit të jetës. Në trashëgimin e tij letrar gjenden në dorëshkrim jo më pak se 3 drama kushtuar kësaj tematike.

Franceskani i ri kthehet në Shqipëri dhe e fillon veprimtarinë e tij jo në qytet, por në fshatrat e Kosovës e të Malësisë së Veriut, të njohura për karakterin e vet specifik ekonomik-shoqëror. Qëndrimi i tij këtu nuk zgjati pak, por me ndonjë ndërprerje, rreth 20 vjet. Krahas prejardhjes së tij, ishte ky faktori kryesor që e mbajti gjithmonë të gjallë lidhjen e Gjeçovit me popullin punonjës të Malësisë. Le të përmendim, me këtë rast, disa nga stacionet e jetës së tij: që nga Laçi (atëherë një fshat) e Kurbini, nga Rubiku e Troshani, deri në fshatrat kosovare të rretheve të Pejës, të Gjakovës e të Prizrenit; që nga Gomsiqja e Gojani i Mirditës në Theth, në Shalë e në Shosh etj. Le të shtojmë edhe qytetet e Shkodrës, të Vlorës, të Durrësit dhe të Zarës, ku ai veproi gjithashtu për disa kohë. Kudo ai shërbeu edhe si famullitar edhe si mësues, por në radhë të parë në malësi ai mori pjesë drejtpërsëdrejti në jetën e ashpër e burrërore, në vuajtjet e në luftën e malësorëve kundër mjerimit e kundër presioneve që u vinin nga qeveria osmane. Jo rastësisht në këtë përvojë jetësore e ka rrënjën ajo temë e dytë interesante e krijimtarisë letrare të Gjeçovit, që mishërohet në tregime e në drama nga jeta fshatare; në radhë të parë kujtojmë këtu motivin e malësorit Marka Kuli dhe të rebelimit të tij antiosman, që ushqehet nga urrejtja shoqërore e malësorit të varfër kundër hyqymetit turk dhe pashallarëve vendas. Një hark interesant ky, që nga lufta e princit shqiptar Skënderbej deri te «kryeqitësi» e rebeli malësor, fisnikërisë së të cilit goja e popullit ia ka ruajtur deri më sot kujtimin. Nuk ka dyshim se në këtë njohje shumë të afërt të truallit e të jetës e ka rrënjën dhe mori shtytje të fuqishme dhe veprimtaria e Gjeçovit si etnograf, folklorist e arkeolog, për të cilën do të bëhet fjalë më poshtë.

Që Gjeçovi nuk mbeti, e nuk mund të mbetej vetëm në

pozitat e vëzhguesit ose makar thjesht të simpatizuesit të asaj që shihte, për këtë nuk mund të kishte dyshim, po të kemi parasysh karakterin e malësorit luftarak, që Gjeçovi e ruajti, në fund të fundit, edhe nën zhgunin e fratit. Më 1902, si famullitar e mësues, ai gdhendi me dorën e vet vulën e shkollës, me të cilën vuloste shkresat e saj: «Zyra e mësojtores komtare Gomsiqe-Gojan», titull ky, që tingëllon krenar, i asaj që ndofta s'pati qenë tjetër veçse një kasolle. Por është e qartë se ky titull tingëllon edhe si protestë kundër synimeve të krerëve klerikë për ta mbajtur arsimin që u jepte, në kufijtë e një shkolle të thjeshtë fetare. Më 1906 ai ishte përkrah fshatarëve të Kurbinit, të rrethit të Krujës, që ishin ngritur kundër kërkesave të hyqymetit për taksa e rekrutë. E përsëri, më 1910-1912, ai ndodhej me pushkë në dorë në radhët e kryengritësve të Bregut të Matës, kur ata morën pjesë në Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare në prag të Pavarësisë.

U tha më sipër, se në pjesën më të madhe të jetës së tij Gjeçovi qëndroi në Malësi. Studiuesi Rr. Zojzi, ka shfaqur mendimin, që na duket me vend, se ky fakt nuk kishte lindur vetëm prej dëshirës së Gjeçovit, nuk qe një rastësi e thjeshtë, por këtu gjenin shprehje kontradikta që ekzistonin midis Gjeçovit dhe udhëheqjes së klerit katolik shqiptar; ishte kjo pra mënyra me të cilën ky donte ta mbante Gjeçovin sa më larg, ta izolonte sa më mirë. «Jo vetëm si meshtar, por as si njeri, mos të sillet ma Gjeçovi në këto anë», shkruante, më 1914, me zemërim të dukshëm i tërëfuqishmi abat i Mirditës, Prengë Doçi. Por ky zemërim nuk qe një dukuri e çastit, personale dhe kalimtare; ai përshkonte heshtazi qëndrimin e hierarkisë së klerit katolik ndaj Gjeçovit dhe shpërthente herë pas here haptazi. Arsyen për këtë qëndrim e zbulon, më 1922, i tërëfuqishmi delegat i Selisë Apostolike në Shqipëri Ernesto Koci (E. Cozzi), kur flet për «të shkuarën e keqe politike» të Gjeçovit. Kjo ishte pikërisht fjala që i shpjegon të gjitha.

Dihet se Gjeçovi është shprehur kurdoherë plot mëri kundër synimeve armiqësore e grabitqare të qeverive të huaja ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Midis tyre ai vë në radhë të parë ato të Malit të Zi, të Serbisë e të Greqisë. Më se një herë ai ka stigmatizuar barbarizmat që trupat serbe patën kryer, më 1913 e më 1915 si dhe pas 1918-ës, në tokat e pushtuara

shqiptare, e sidomos në Kosovë. Por, pa dyshim, ajo që armiqësoi Gjeçovin me eprorët e tij nuk ishte kjo, por ishte fakti që ai guxoi të ngrihej edhe kundër padronëve të kishës, qofshin këta klerikë të huaj, qofshin këto qeveritë e shteteve të mëdha imperialiste.

Dihet se kisha katolike shqiptare prej kohësh subvencionohej me të madhe nga Monarkia Austro-Hungareze, për t'u shërbyer planeve të saj politike pushtuese në Shqipëri, sidomos edhe kundër rivalet së saj më të rrezikshme, Italisë. Përkrisht në kohën kur, gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria në pjesën më të madhe hyri nën sundimin e Austro-Hungarisë dhe kur organi i klerit, «Posta e Shqypnisë», nën drejtimin e Gjergj Fishtës, thurte himne për dinastinë habsburgase, si mbrojtëse e katolicizmit, Gjeçovi u ndesh drejtpërsëdrejti me organet e qeverisë ushtarake austriake, që zhvillonin një politikë të egër grabitqare kundër popullsisë vendase. Bashkë me gjithë popullsinë e malësisë, Gjeçovi e njohu vetë drejtpërsëdrejti, dhe e kuptoi se ç'ishte ky regjim që trumbetohej si mbrojtës i sprovuar dhe si padron i shqiptarëve dhe i kishës katolike shqiptare, prandaj nuk e fshehu zemërimin e vet.

Rrjedhim i këtij qëndrimi të tij patriotik qe se ai u bë më se i dyshimtë për organet e qeverisë ushtarake austriake, të cilat kërkuan dhe arritën nga eprorët fetarë të Gjeçovit që ta transferonin, ose më mirë ta mërgonin në famullinë më të izoluar e më të vështirë të malësisë.

Që këtu nuk ishte një konflikt i rastit, këtë e tregojnë ngjarjet pas vitit 1918, pas rënies së monarkisë habsburgase. Kur hierarkia e klerit katolik, sipas taktikës së njohur «Vdiq mbreti — rroftë mbreti i ri» kërkonte tek Italia katolike mbështetjen që duhej t'i siguronte, ashtu si dikur Vjena, kishës pozitën e saj si forcë sunduese në Shqipëri, Gjeçovi e vërtetoi edhe një herë qëndrimin e vet konsekuent. Ai nuk ishte për arsye koniunktive ose antipatie politike, kundër njëres ose tjetres fuqi, por në mënyrë parimore kundër çdo fuqie që vinte në rrezik interesat kombëtare shqiptare, pavarësisht nga lidhjet e interesat e kishës katolike.

Gjeçovi, qysh para Luftës së Parë Botërore, pati shfaqur mosbesim e shqetësim ndaj synimeve të politikës italiane në

Shqipëri. Kur Italia pas fitores doli haptazi me planet e saj pushtuese imperialiste, Gjeçovi, në kontradiktë me politikën e hierarkisë klerikale, mori përsëri një qëndrim konsekuent patriotik: ai u shfaq kundër qeverisë proitaliane që ishte vendosur në Durrës në fund të vitit 1918, dhe qëndroi krahas popullit në luftën antiimperialiste për çlirimin e Vlorës nga pushtimi italian. «As halldupi i Azisë nuk pat bamë, çka banë italianët», shkruante ai nga Vlora, ku, duke qenë famullitar, u ndodh jo vetëm si dëshmitar, por si pjesëmarrës veprues në ngjarjet; dhe shtonte plot zemërim: «Shnjërzim, shnjërzim!»

Ishte e natyrshme që ky qëndrim e bëri atë të dyshimtë dhe të urreyer për Romën, si dikur për Vjenën, dhe autoritetet italiane kërkuan nga eprorët e tij fetarë në Shkodër që ta largonin sa më parë nga Vlora. «Kjo luftë më bahet vetëm e vetëm se jam shqiptar», kështu i komentonte me të drejtë Gjeçovi këto veprime dhe qëndroi në qytet, duke u bërë ballë gjithë presioneve, derisa pa të hynin në Vlorë «burrat e dheut që liruen Vlonën me një trimni të pashoqe».

Gjeçovi u gjend përkrah popullit edhe në Lëvizjen Anti-feudale e Demokratike që u zhvillua në vitet 1920-1924.

Qysh në vitet e qëndrimit të tij në Kurbin, në rrethin e Krujës, Gjeçovi ishte ndeshur me veprimtarinë e Esat Pashë Toptanit, që ai kishte mësuar ta urrente si funksionar të lartë të xhandarmërisë në shërbim të Perandorisë Osmane, për arbitraritetet e tij si feudal mizor në kurriz të fshatarësisë dhe si njeri që ishte lidhur me politikën italiane në Shqipëri.

Për të njëjtat arsye të veprimtarisë së tyre antikombëtare dhe antipopullore, Gjeçovi nuk ngurroi të godiste bajraktarët e mëdhenj, të cilët si feudalët çifligarë të tipit të Toptanasve për gjithë Shqipërinë, përbënin në trupin e malësisë një plagë të tmerrshme, të trashëguar nga e kaluara.

Me guxim ai demaskoi derën e kapidanëve Gjomarkaj të Mirditës, që e treguan fytyrën e vërtetë duke i vënë kulmin veprimtarisë së tyre tradhtarë antikombëtare, kur organizuan, më 1921, të paguar nga Jugosllavia e Karagjorgjeviçëve, tragjikomedinë e përgjakshme të «vetëqeverisjes» së Mirditës, d.m.th. të shkëputjes së saj nga trupi i Atdheut.

Ky qëndrim i Gjeçovit gjente shprehje në një kohë kur hierarkia e klerit katolik predikonte ruajtjen e rëndit patriar-

kal në malësi, gjoja për të shpëtuar me këtë «palcën etnike» të kombit e të kulturës së tij. Kleri përkëdhelte sidomos Gjomarkajt, si shtyllën kurrizore të këtij rendi, me qëllimin e qartë për t'i siguruar vetes mbështetjen e këtij faktori ushtarak e për t'i ruajtur kështu kishës katolike pozitën e saj sunduese ideologjike dhe politiko-ushtarake, në rrafsh të përgjithshëm shqiptar. Për këtë arsye kleri, gjatë viteve 1920-1924 e në Revolucionin e Qershorit, nuk kërkonte reforma demokratike, anti-feudale, por ndryshime politike.

Sa kontraston me këtë qëndrimi i Gjeçovit, i cili pikërisht në këtë kohë kërkonte «gjyq prej Zotit përta gjak e lot të derdhun, katunde të shkrumueme prej zjarrit e burra të premë për besë prej Derës së Gjomarkajve», kur ai shprehte shpresën që do të vinte një kohë kur populli i malësisë «mos me mendue si Marka Gjoni, por si mendon Shqypnia mbarë». Edhe pse drejtohej në dukje vetëm kundër «fenomenit Gjomarkaj», kjo ishte një aktakuzë kundër gjithë atij rendi që e kishte bërë të mundshëm dhe e mbante të gjallë këtë dukuri. Pa dyshim, Gjeçovi në mendimin e tij politik nuk doli, e nuk mund të dilte nga rrethi i koncepteve idealiste-borgjeze. Ajo që kërkonte ai ishte që të arrihej një regjim ku, siç shkruante vetë më 1921 në një artikull, qeveria, «si bariu i mirë, me i qethë dhent, por jo me u rjepë lëkurën», siç bënin ata, që ai me aluzion për qeveritë e kohës, i quante me emrat e perandorëve despotikë romakë, Neron e Kaligula. Është interesant të vihet në dukje se ky krahasim i qeverisë me bariun dhe me detyrat e tij, gjendet fjalë për fjalë edhe te Samiu, dëshmi kjo jo e vetme, që tregon se Gjeçovi i njihte veprat e rilindësve tanë të mëdhenj dhe e ndiente veten në një rrugë mendimi me ta.

Duke përmbledhur, do të themi se ky qëndrim patriotik e demokratik i Gjeçovit e vuri, e do ta vinte medoemos, atë përballë udhëheqjes së klerit katolik, me njerëz si Gjergj Fishta, Pal Doda, Pashko Bardhi etj., të cilët ishin gati për çdo kompromis me fuqitë e huaja në dëm të interesave kombëtare, mjaft që të mund të siguronin me këtë pozitën e kishës katolike, armiq të betuar të çdo mendimi përparimtar — një qëndrim reaksionar antikombëtar, e antipopullor që e karakterizoi klerin e kishën katolike në Shqipëri deri në ngjarjet që shënuan fundin e saj. Por nga ana tjetër, ky qëndrim i tij pa-

triotik e demokratik e lidhi Gjeçovin në miqësi e bashkëpunim me figurat e shquara të Lëvizjes Demokratike të viteve 20, me L. Gurakuqin e F. Nolin, me H. Mosin e A. Xhuvanin, St. Vinjaun etj.

Pas Gjeçovit atdhetar, është vendi këtu të flasim për Gjeçovin mendimtar e shkencëtar. Midis këtyre aspekteve ka një lidhje organike.

Bie në sy që Gjeçovi ka një prodhim të madh letrar-shkencor, një trashëgim që rrallë e ka lënë dikush nga njerëzit tanë të kulturës e të shkencës (rreth 10 000 faqe dorëshkrim), prej të cilit fort pak u botua sa kohë që ai qe gjallë: një libër me përmbajtje filozofike-pedagogjike «Agimi i Qytetnis» (më 1908 e më 1910), disa artikuj revistash me tematikë historike si dhe 2 drama të përkthyer, të botuara më 1912 dhe më 1915. Si shpjegohet kjo kur dimë se po në vitet e veprimtarisë së Gjeçovit, në dy shtypshkronjat e Shkodrës që ishin në duart e klerit, u botuan një mori veprash «letrare»—hagiografike, që s'mund të mateshin as së largu me vlerën gjuhësore-letrare e kulturore-shkencore të dorëshkrimeve të Gjeçovit? Nuk është larg mendimi se Gjeçovi ishte «persona non grata», njeri i padëshirueshëm edhe në organet e shtypit të klerit, të vetmet ku disiplina kishtare e lejonte të botonte. Arsyet duhen kërkuar, mendojmë, në radhë të parë në tematikën e këtij prodhimi, e cila, siç e cekëm në fillim, i përket sferës shekullore-laike-patriotike. Rr. Zozji ka llogaritur se kjo përbën rreth 90% të të gjitha shkrimeve të Gjeçovit.

Le të hedhim një vështrim mbi disa nga këto vepra të botuara. Bie në sy tematika e dy dramave të përkthyer: «Atil Reguli» dhe «Vajza e Orleansit». Ajo që e ka tërhequr Gjeçovin te këto dy figura, është karakteri i tyre i theksuar patriotik. Romaku Atil Reguli, në mënyrë burrërore e të ndër-gjegjshme, zgjodhi vdekjen nga dora e armiqve kartagjenas para se të tradhtonte interesat e atdheut të tij. Nga ana tjetër, në jetën e «shenjtores» Joana D'Ark, Gjeçovin nuk e tërhiqte elementi fetar, hagiografik, sa guximi e vendosmëria e kësaj vajze të thjeshtë fshatare, që udhëhoqi luftën patriotike të popullit francez kundër pushtuesve të huaj anglezë, pa u tutur nga pengesat e shumta, e, më në fund, edhe nga vdekja. Është interesant të vihet në dukje se Gjeçovi në «Agimin e qytetnisë»

e fashikullon ashpër Volterin sepse nuk mund t'ia falte kurrësesi tonin ironik me të cilin ky flet për atë akt flijimi të epërt patriotik që bën «vajza». Jo më kot një jezuit bashkëkohës nga Shkodra, me nuhatje të mprehtë, ia vinte në dukje në formën e një kritike, këtë frymë të theksuar patriotikë që kishte kjo vepër.

Le të qëndrojmë diçka më tepër tek «Agimi i qytetnisë». Në këtë vepër ende të pavlerësuar, Gjeçovi mban qëndrim ndaj disa problemeve aktuale të kohës së paraqlirimit nga sundimi osman. Aty ne kemi mundësi t'i njohim më afër disa nga mendimet e tij politike e filozofike-pedagogjike, më aspektet e tyre pozitive, po edhe me disa kufizime karakteristike.

Në problemet themelore Gjeçovi qëndron në pozitën e Rilindjes sonë, pavarësisht se disiplina së cilës ai i nënshtrohet si klerik, ia bën atij shumë më vështirë se rilindësve të tjerë qëndrimin në pozitën të drejtë.

Ndërsa kleri katolik me parimin e tij programatik «Ubi spiritus domini, ibi libertas» (Ku është fryma e zotit, atje është liria), siç e shpallte revista e tij «Hylli i Dritës», i jepte konceptit të lirisë një përmbajtje fetaro-metafizike dhe jetën shoqërore ia nënshtrohte këtij parimi, Gjeçovi e niste librin duke vënë në krye një kapitull jo mbi «hyun» dhe mbi detyrat e njeriut ndaj tij, por mbi «shoqinë». Dhe esencën e kësaj shoqërie ai e koncepton në frymën e teorisë borgjeze të së drejtës natyrore, si të lindur nga nevoja e njerëzve për të rregulluar marrëdhëniet e tyre. «Shoqnia, shkruan ai, asht e nevojshme n'daçim për punë, për ndihmë, për mësim asht palca e jetës së njeriut, zani i natyrës me i pa njerzit e shoqnueshëm; prej kënde rrjedh detyra njerzore: jeto njerzisht!» Sa larg është ky koncept pozitiv, optimist, edhe pse nuk është materialist dhe historik, nga koncepti i teologjisë, që e konsideron shoqërinë njerëzore vetëm si një rrugë për të realizuar «shtetin e perëndisë» në botën e këndejshe dhe rrjedhimisht nuk mund të dalë kurrë nga një kuptim dualist e në thelb pesimist, se shoqëria njerëzore dhe njeriu s'qenkan tjetër veçse një fushë lufte, ku ndeshen një parim hyjnor shpëtimtar, dhe një parim negativ natyror, njerëzor, mëkatar, i cili duhet mundur.

Është e natyrshme që edhe për arsye të disiplinës së jashtme, por dhe të parimeve që ai kishte përvetësuar nga e gjithë

edukata dhe nga përgatitja e tij shkollore, Gjeçovi si klerik, nuk mundi të çlirohej nga parimet bazë të filozofisë e të teologjisë së krishterë. Por nga ana tjetër, si pjesëtar aktiv e i ndër-gjegjshëm i një populli që luftonte për të drejtat elementare, për liri e përparim, ai nuk mund të pajtohej plotësisht me transcendentalizmin metafizik karakteristik për moralin e krishterë.

Midis këtyre dy poleve të kundërta, Gjeçovi u përpoq të gjente një rrugëdalje, një rrugë kompromisi. Ai ndodhej afërsisht në të njëjtën situatë si disa filozofë të mesjetës, që krijuan teorinë e «dy të vërtetave», e cila, e lindur nga dobësia, përfaqësonte në njëfarë mënyre për ta një rrugëdalje nga kjo dilemë: besimi, si parim i teologjisë, vlente, sipas tyre, vetëm për çështjet e mbinatyrshme, porse ishte arsyeja njerëzore ajo që siguronte njohjen dhe zotërimin e botës natyrore e njerëzore. Në këtë kuptim u përpoq edhe Gjeçovi të gjente zgjidhjen e problemit aktual, për kohën e tij, si për gjithë Rilindjen tonë, të raportit midis «besimit e Atdheut», problem që ai e trajtoi në kapitujt e II e III të veprës. Zgjidhjen që gjeti, Gjeçovi e formulon në figurën e një «peshoreje», ku besimi dhe atdasheduria përbëjnë dy krahët që e mbajnë në drejtpeshim. Rrjedhimisht, sipas tij, besimi e feja nuk mund të pretendojnë për përparësi, siç e kërkonte kisha. Madje, Gjeçovi shkonte edhe më tej dhe formulonte kërkesën që një «shenjt» i kishës nuk mund të quhej si i tillë, po të mos kishte qenë edhe atdhetar.

Në këto pozita qëndronin, mund të themi, edhe shumë rilindës të tjerë, të cilët, edhe kur nuk ishin klerikë nuk mundën të shkonin më tej nga koncepti i «peshores» dhe të kalonin në pozita afetare ose më tej, në pozita antifetare.

Pasi siguroi kështu, në njëfarë mënyre, teorikisht krahët kundrejt teologjisë, Gjeçovi trajtoi gjerësisht problemet e mëdha politike-kulturore kombëtare të kohës, problemet e njësisë kombëtare, të përparimit politik-shoqëror e kulturor të kombit. Këtu ai qëndroi në pozitën përparimtare të krahut demokratik të Rilindjes sonë. Rruga për në «agimin e qytetnisë», d.m.th. te kultura kombëtare, për edukimin e popullit në frymën e patriotizmit demokratik, kalon nëpërmes shkollës e arsimit në gjuhën amtare, në frymën e traditave më të mira, përparimtare të kombit.

Kapitulli IV i librit të Gjeçovit është një himn i lartë mbi gjuhën shqipe, që nuk qëndron prapa fjalëve të zjarrta të Naimit, të cilin Gjeçovi e përmend shpesh, me dashuri e respekt, Gjeçovi shkruan jo vetëm me ndjenjë e entuziazëm, por edhe me një kuptim historik të qartë: «Gjithëshka shkon e vjen në këtë botë, ndrohet e shndërrohet, shitet e blehet, po vetëm gjuha amtare që është trashëgim i të parëve, as nuk shitet, as nuk blehet». Dhe me një ndjenjë të thellë përgjërimi, ai i drejtohet bashkatdhetarit: «Xeju në dashtni të gjuhës sate, pash atë kafshatë buke që ta pat përtypë goja e nanës!». Kjo ndjenjë patriotizmi popullor-fshatar nxjerr krye shpesh në mendimin e Gjeçovit dhe ai e argumenton edhe psenë e saj. Në kushtet historike, kur klasat e pasura të vendit tonë ishin bërë përcuese ndikimesh gjuhësore-kulturore të huaja, për Gjeçovin ishte e domosdoshme që kultura jonë kombëtare të mbështetej mbi atë trashëgim të pasur, që e kishin ruajtur sidomos shtresat e «ulëta» të popullit, të cilat, sipas tij, përbënin «palcën» e kombit. «Gjuha e katundarit, shkruante ai, asht gurra e vërtetë e gjuhës së popullit; ajo duhet të jetë baza e fjalorit të përgjithshëm të gjuhës shqipe». Pikërisht sepse është lidhur me jetën e masave punonjëse dhe sepse «gjuha asht rrëna e kombit», ajo është për Gjeçovin edhe dëshmi, edhe garanci e njësisë së kulturës dhe e kombit mbarë. Në një kohë kur veçanërisht kleri katolik, në mënyrë të ndërgjegjshme ngulte këmbë mbi ruajtjen e ndryshimeve dialektore në letërsi, dhe këtë qëndrim e mbajti konsekuent deri në pragun e Çlirimit, Gjeçovi argumentonte, duke ndjekur e duke vazhduar mendimin e Sami Frashërit, domosdoshmërinë që «të jetë ndër ne njënia (njësia) në të folmen, e njënia në shkrim... Njënia na mban në bashkim, na shton fuqinë».

Me një kuptim filozofik-teorik të drejtë, Gjeçovi e vlerësonte shumë lart gjuhën, jo vetëm si një trashëgim i vyer historik që i përket së kaluarës, po edhe si armë e fuqishme në rrugën e përparimit drejt së ardhmes. Gjuha «asht zhvilluesja e mendës sonë, asht shtjelluesja e mendimit tonë, asht zani i të parëve tanë, i kavalieteve (shekujve) të shkueme, dhe i kohëve që do të vijnë». Dhe me krenari të ligjshme ai shton: «gjuha jonë ka qenë dhe asht ende gjuhë luftare, gjuhë që ka ditë dhe din me prefë heshta e shigjeta, e jo pupla». Vetë stili

i fuqishëm i Gjeçovit ishte prova më e mirë e kësaj thënieje.

Që Gjeçovi nuk kufizohej në njëfarë predikimi idesh iluministe, është e qartë po të njihemi me këtë botëkuptim thellësisht aktivist e të angazhuar të tij. Nuk është e rastit që ai vë qysh në fillim të librit të tij një citat të marrë nga Marin Barleti, biografi i Skënderbeut: «Kemi mbaruar të tërë, po që se secili mendon se ka lindur vetëm për vete». «Mos rri ni në gjumë, u thërret ai bashkatdhetarëve, sepse ploghshtia jonë u shton fuqinë të huajve. Mos na dhembet jeta... Ku asht Kastrioti, ku janë trimat e tjerë të dheut tonë? Për liri t'atdheut kanë mbetë, ... Mbase atyne s'u kje dhimbtë jeta, shka jena ne që të kursehemi? Të përvjelim llanat, ... mos t'i turrena kujt, por në pafshim se don me na trazue, mos frigohe mi e t'i dalim për ballë».

Në lidhje të brendshme me idetë e Gjeçovit qëndron edhe veprimtaria e tij si arkeolog, si historian e si etnograf.

Në veprimtarinë e tij si shkencëtar Gjeçovi u nis nga parimi thellësisht shkencor e patriotik njëkohësisht, se «një popull që nuk ka histori të vetën, konsiderohet si një popull i vdekun». Duke u nisur, nga ana tjetër, nga rrethanat historike të sundimeve të huaja që qëndruan në Shqipëri për shekuj, ai formuloi mendimin e drejtë se jeta e vërtetë e popullit nuk mund të gjendej vetëm në dokumentet e vendeve sunduese të huaja. «Visari ynë i vërtetë kombëtar gjendet i mbulue nën dhe, ose në kujtesën e popullit», shkruante ai. Për këtë qëllim ai zhvilloi një veprimtari të dendur për të përshkuar vendin e për të mbledhur sistematikisht këto thesare, qofshin ato objekte arkeologjike, apo materiale etnografike, doke e zakone, norma juridike a dokumente të mirëfillta historike. Me zemëshin të huajve dhe u përpoq me forcat e veta të mbushte atë zbrazëti të madhe që përbënte në jetën tonë kulturore mungesa e një muzeu. Është i njohur koleksioni arkeologjik i Gjeçovit, i vetmi institucion i këtij lloji dikur në vendin tonë. Edhe më i pasur ishte materiali etnografik që ai mbledhi sistematikisht, material i cili pasqyron në fakt gjithë jetën e popullsisë së malësisë sonë, qysh nga djepi e deri në varr, duke përfshirë këtu material të vyer për institucionet karakteristike të jetës shoqërore si besa, nderi, burrnia etj. Një pjesë e këtij materiali

ka hyrë në veprën monumentale «Kanuni i Lekë Dukagjinit», që do të përjetësojë emrin e Gjeçovit, sepse përbën një burim të paçmuar historik, siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha. Kjo është një vepër që dëshmon kulturën e lashtë shoqërore-juridike të popullit shqiptar në aspektin e saj historik. Me gjithë origjinalitetin e saj, ajo na lejon të bëjmë diagnozën e marrëdhënieve shoqërore në përmbysjet dhe në evolucionet që ato kanë pësuar deri në ditët tona.

Ky qe një kontribut i madh që i dha Gjeçovi shkencës sonë shqiptare dhe, nëpërmes kësaj, shkencës ndërkombëtare. Por është e qartë se Gjeçovi nga e gjithë përgatitja e tij, nga mungesa e një metodologjie shkencore, nga botëkuptimi i tij idealist, nuk ishte në gjendje të bënte analizën historike-klasore të përmbajtjes së kanunit, të botëkuptimit dhe të ideologjisë së tij. Rrjedhimisht, Gjeçovi nuk mundi të dallonte në të as shtresat e ndryshme kronologjike, as pasqyrimin e kontradiktave klasore të shoqërisë malësore, që nuk mungonin edhe në këtë kanun.

Në mënyrë të veçantë ai nuk mundi ta shihte e aq më pak ta zgjidhte problemin e rëndësishëm, përse kanuni, si e drejtë zakonore që i përgjigjej një etape të caktuar të zhvillimit shoqëror të vendit, në kushtet e Shqipërisë pati një mbijetim abnormalisht të gjatë. Shkenca jonë marksiste-leniniste, pikërisht në rrethanat e caktuara historike e në raportin e forcave klasore që lidhen me rrethimin feudal të malësive në kushtet e regjimit osman, ka gjetur arsyet për të shpjeguar mbijetimin, dhe, në ndryshimet dhe në përmbysjet shoqërore të mëvonshme, shkaqet për rënien e për asgjësimin e kësaj së drejte së bashku me shoqërinë shqiptare që e pati mbajtur.

Por do të ishte e padrejtë, sikur ne t'i atribuonim Gjeçovit koncepte që ai nuk i ka pasur në lidhje me absolutizimin e vlerës së kanunit. Ndërsa Fishta, T. Toçi e të tjerë e konsideronin kanunin si normën ideale për shoqërinë shqiptare që ata ëndërronin ta mbanin të pandryshuar, dhe me këtë të ruanin edhe mbizotërimin e kishës katolike, Gjeçovi është shprehur kundër këtij absolutizimi si, p.sh., kur ai godiste përpjekjet «e derës së Gjomarkajve» për ta shtrirë kanunin përtej vendit dhe kohës të cilëve u përkiste, kundër përpjekjeve të klerit e të bajraktarëve për ta ruajtur kanunin si normë rregulluese

për jetën e malësorëve edhe në kohën e sotme. «Le të mësojë populli i Mirditës, thoshte ai, mos me mendue si Markagjoni, por si mendon mbarë Shqipëria».

Jeta e këtij burri të ndershëm, që mbeti malësor dhe i ruajti cilësitë fisnike të popullit, edhe pse i veshur në zhgunin e fratit, i rreptë në pamjen e tij të jashtme, por edhe i dashur pa masë, që një akt flijimi patriotik.

Edhe pse në mendimin e tij ka koncepte idealiste, boshiti patriotik që përshkon gjithë veprimtarinë e tij është i qartë dhe i pandërprerë. Shoku Enver na mëson se atdhetarët e kohëve të vjetra, qofshin këta klerikë apo laikë, qofshin këta fetarë ose që nuk besonin në zotin, nuk mund të akuzohen si joatdhetarë, pse patriotizmi i tyre ishte bazuar në idealizëm.

Dhe këtë patriotizëm Gjeçovi e vulosi me aktin e flijimit të epërt patriotik që bëri, duke vajtur për të shërbyer në tokën e nënës së tij Kosovë, më 1926. Atje ai vazhdoi deri në fund atë punë të përvuajtur, me të cilën e kishte filluar veprimtarinë e vet, si mësues. Në Kosovë ai u bë një nga figurat më të dashura e më me autoritet, pavarësisht nga përkatësia fetare e atëhershme e popullsisë. Në një shkollë të përkurme, si dikur në kohën e sundimit osman, ai i mësonte fëmijët në gjuhën amtare, i mësonte në frymën e historisë së kombit të vet. Por mjaftonte që ai t'u bënte të ditur se dardanët ilirë ishin barmëtarë e parë të Kosovës, se ata ishin stërgjyshërit e shqiptarëve dhe këta zotërit e vërtetë të kësaj toke të lashtë, për ta bërë Gjeçovin jo vetëm figurën e ndritur të idesë kombëtare në Kosovë, po edhe objekt të urrejtjes së tërbuar të serbomëdhenjve, që i dhanë më në fund vdekjen.

Populli e ruajti kujtimin e amanetin e këtij dëshmori të lirisë.

Gjeçovi jetoj e punoi si atdhetar e shkencëtar në kushte të vështira pa asnjë mbështetje, me të vetmen kënaqësi se u përpoq, siç thotë ai, «kurdoherë të mësojë fëmijët, për t'i vleftësuar së re e kombit tonë që të përparojnë nga zhvillimi i jetës shoqërore dhe qytetare». Shembulli i tij, pasioni i tij për shkencën e kulturën popullore, është një burim frymëzimi edhe për shkencëtarët tanë të sotëm, të cilët, të pajisur me mendimin teoriko-shkencor marksist-leninist të Partisë e të shokut Enver Hoxha, i kanë kushtuar punën e veprën e tyre

asaj detyre të madhe shkencore patriotike siç është studimi i kulturës sonë popullore kombëtare.

Vlerësimin e lartë të popullit e të Partisë për këtë figurë të shquar të së kaluarës e shpreh më së miri motivacioni me të cilin e dekoroi Gjeçovin, më 1962, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPS të Shqipërisë si «I pari etnograf dhe arkeolog shqiptar, i cili punoi pa u lodhur për të njohur kulturën e lashtë të popullit tonë, si botues i Kanunit të Lek Dukagjinit, një ndër monumentet më të çmueshme për historinë e së drejtës zakonore shqiptare, për atdhedashurinë dhe veprimtarinë e tij politike».

1870

Received of the
Hon. Secy of the
Interior
for the
Department of
the Interior
the sum of
\$1000.00
for the
purchase of
land for
the
Department of
the Interior

Received of the
Hon. Secy of the
Interior
for the
Department of
the Interior
the sum of
\$1000.00
for the
purchase of
land for
the
Department of
the Interior

TREGUESI I EMRAVE

A

Abdurrahmani, Haxhi — 12.
 Abdyl Azizi — 41, 106.
 Abdyl Hamiti — 106.
 Abdyl Mexhiti — 14, 38.
 Ahmet Kurt Pasha — 6.
 Ahmet Muhtar Pasha — 95, 165.
 Ali (dervish bektash) — 43.
 Ali Namik Pasha — 7, 8.
 Ali Pasha (kryeministër) — 61.
 Alia, Binak — 18, 53, 183.
 Alia, Hasan: shih Sheh Shamia.
 Andrashi, J. (Andrassy, J.) — 85,
 119, 210, 218.
 Anthimi i Gjirokastrës — 144.
 Arkimed — 279.
 Armodhi, A. — 69, 73, 75, 78.
 Arsaqi, Apostol — 33.
 Athinaja (e Zeusit) — 245.
 Avdi Pasha — 45.

B

Bajrami, Ali bej — 12.
 Baldaçi, A. — 275.
 Bardhi, Frang — 266.
 Bardhi, Pashko — 295.
 Barleti, Marin — 266, 300.
 Bartl, P. — 238.

Beci, Mehmet — 172.
 Belegu, Xh. — 81.
 Bered, F. (Behrendt, F.) — 283.
 Bikonsflid (Beacosfield) — 84, 90,
 118, 208, 210, 220.
 Biro, Vito — 72.
 Bismark — 83, 101, 102, 123, 179,
 218.
 Blant, K. — 227.
 Bogdani, Pjetër — 266.
 Botev, Kristo — 101, 198.
 Brandi, Eftim — 34, 79, 191, 222,
 241.
 Bryl, Levi — 276.
 Budi, Budi — 266.
 Bushati, Hysen bej — 12.
 Bushati, Mustafa Pashë — 7, 82.
 Bushatllinjhtë — 246.
 Buzi, Tafil — 9, 10, 11, 14, 242.
 Bujku, Anastastas — 33, 34, 69,
 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78,
 79, 80.
 Bytyçi, Ndue — 65.

C

Cale, P. — 69.
 Cara, Dervish — 16.
 Curri, Shaqir — 53.
 Cvijic, J. — 214, 230.

Ç

- Çabej, Eqrem — 274.
 Çapari, Halim — 21.
 Çapari, Tahir — 22.
 Çeka, Filip — 171.
 Çoba, Selim — 171.

D

- D'Ark Zhana (D'Arc, Joana) — 296.
 Dako, K. — 81.
 Danilo (princ i Malit të Zi) — 35, 37, 38, 46.
 De Gubernatis, E. — 137.
 De Lamartin, A. — 66.
 De Martino, Leonard — 65, 169.
 De Rada, Jeronim — 22, 28, 65, 66, 67, 69, 136, 160, 177, 222, 269.
 Derbi, E.S. (Derby, E.S.) — 83, 123, 218.
 Dervish (mbret) — 242.
 Dervish Pasha — 96, 171, 172, 174, 178, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 188.
 Dibra, Ijaz Pashë — 117, 127, 131, 140, 182.
 Dilk, Çarlz — 84.
 Dine, Spiro Risto — 65, 189, 269.
 Dino, Abedin Pashë — 95, 152, 154, 171.
 Doçi, Preng — 57, 65, 67, 104, 105, 203, 292.
 Doda, Bibë Pashë — 35, 37, 38, 51, 52, 53.
 Doda, Pal — 295.
 Doda, Preng Bibë — 100, 104, 105, 148, 150, 169, 174.
 Dorsa, Vinçenc — 28, 29, 65, 269, 272.
 Dozon — 275.
 Draga, Ali Pashë — 18.
 Dragoti, Ibrahim — 108.

- Dragusha, Fetah — 171.
 Dragusha, Ibrahim — 171.
 Dreni, Abdulla Pashë — 127, 128.
 Dubski (Dubsky) — 92, 221.
 Dukagjini, Lekë — 274, 301, 303.
 Durham, E. — 276.
 Dushani, Stefan — 30, 200.

DH

- Dhima, Panajot — 72.

E

- Emin Pasha — 6, 9, 14.
 Engels, Frederik — 58, 97, 240, 255.

F

- Ferri, Jakup — 145.
 Ficmoris (lord Fitzmaurice) — 91, 93, 94, 164, 218, 224.
 Filipi i Maqedonisë — 276.
 Fishta, Gjergj — 293, 295, 301.
 Frakulla, Alush bej — 11, 14.
 Frashëri, Abdyl (Abdyl bej Toska) — 88, 90, 106, 108, 112, 116, 117, 124, 125, 131, 136, 137, 156, 158, 159, 160, 161, 175, 179, 181, 184, 185, 190, 214, 223, 231, 232; 252.
 Frashëri, Halil bej — 159.
 Frashëri, Kristo — 69, 81.
 Frashëri, M. — 81.
 Frashëri, Naim — 159, 299.
 Frashëri, Sami (Shemshedin Samiu) — 22, 62, 112, 119, 130, 142, 144, 153, 159, 177, 190, 222, 226, 232, 241, 246, 247, 268, 270, 271, 272, 273, 295, 299.

G

- Garashanin, J. — 39, 47, 198, 214.
 Garibaldi, Xhuzepe — 47, 48.

Geseman, G. — 236.
 Gledston, V. (Gladstone, W.) — 90,
 150, 162, 207-208, 208, 223.
 Godin, A. — 278.
 Gopčević, Sp. — 81.
 Gorshakov (kancelar rus) — 49.
 Goshen, G. (Goschen, G.) — 90, 91,
 92, 96, 162, 163, 208, 223.
 Grenvil, G.L. (Granville, G.L.) —
 91, 92, 93, 162, 208.
 Grin, K. (Green, K.) — 91, 93, 162.
 Griva (gjeneral) — 37.
 Gucia, Ali Pashë (më parë Ali bej
 Gucia) — 115, 117, 127, 140, 145,
 182, 185.
 Gurakuqi, Lorenc — 104, 296.
 Gurakuqi, Pjetër — 104.

Gj

Gjakova, Riza bej — 185.
 Gjeçovi, S.K. — 274.
 Gjeçovi, Shtjefën Kostandin — 287,
 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295,
 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302,
 303.
 Gjika, Elena (Dora d'Istria) — 58,
 66, 67.
 Gjiriti, Mustafa Pashë — 60.
 Gjoleka, Myslim — 108, 180.
 Gjoleka, Zenel agë — 19, 20, 21, 35.
 Gjomarkajt — 294, 295, 301, 302.
 Gjoni, Marka (Markagjoni) — 295.
 Gjorgjeviç, D. — 196, 236.
 Gjyli, Mehmet — 172.

H

Haberland, M. — 276.
 Habsburgët (familja) — 48.
 Hacfeld — Vildenburg, P.f (Hatz-
 feld — Wiloddenburg, Paul fon) —
 95, 221.
 Hafiz Pasha — 10, 11, 12, 13.
 Hajman, E. (Heymann, E.) — 236.

Hajredin Pasha — 17.
 Hamdi Pasha — 9, 10.
 Hamerle, H. (Haymerle, H.) — 90.
 Han, J.G. (Hahn, J.G.) — 60, 77,
 211, 275, 276.
 Harito, Mihal Kristo — 131, 158.
 Hekali, Hamit — 22.
 Hekali, Rrapo — 19, 21, 22.
 Herder — 247, 267.
 Hido, Vasil — 158.
 Hilmi, Ahmet Pashë — 174.
 Hitrov, M. (diplomat rus) — 47.
 Hobus, G. — 236.
 Hohenlohe, F. von (F. von Hohen-
 lohe) — 94, 165.
 Hoxha, Enver — 231, 232, 233, 235,
 249, 257, 258, 259, 263, 282, 283,
 286, 287, 301, 302.
 Hoxha, Kasem — 12.

Hoxhi, Jani Koto — 63, 142, 144,
 248.
 Hristov, H. — 255.
 Hroh, M. (Hroch, M.) — 247.
 Hylja, Sali — 171.
 Hysni Pasha — 139.

I

Ibra, Ali — 147, 175, 183, 232.
 Idrizi, Haxhi — 12, 13.
 Ipen, T. — 275.
 Ismail Pasha (nipi i Ali pashë Te-
 pelenës) — 14.
 Ismet Pasha — 15.
 Isuf, Ali beu — 265.

J

Jastrebov (diplomat rus) — 105.
 Jokl, Norbert — 278.
 Jonin (diplomat rus) — 42.
 Jonuzi, Haxhi — 147.
 Jubani, Zef — 50, 54, 56, 57, 58,
 66, 67, 103, 177, 189, 190, 200, 213,

246, 247, 249, 250, 269, 270, 271,
272, 291.
Jusuf beu — 12, 192.

K

Kaligula — 295.
Karnarda, Dhimitër — 65, 66, 67,
160.
Kauini, M.A. — 137, 160, 180.
Kara Mahmud — 82.
Karagjorgjeviçët — 294.
Kastrioti, Gjergj — Skënderbeu
(Aleksandër) — 56, 65, 67, 71, 142,
189, 190, 193, 194, 230, 291, 300,
Kazazi, Hamza — 12.
Kerr (lord) — 168.
Klyzëre, G.P. (Cluseret, G.P.) —
193, 225.
Koci, E. (Cozzi, E.) — 292.
Koça, B. — 275.
Koka, Stefan — 72.
Kolea, Dhimitër, — 158.
Koletis, J. — 21, 30, 198.
Komunduros — 134, 217.
Koronica, Ahmet — 128, 147.
Korti (Corti) — 86, 146.
Kosev, K. — 255.
Kosjek (Kossjek) — 93.
Kosturi, Shahin bej — 20.
Kosharja, Zef — 232.
Krasniqi, Gaspër — 50, 52.
Krei, Thimi Th. — 160, 189, 190,
291.
Krispi, Josif — 27.
Kristoforidhi, Kostandin — 60, 62,
64, 68, 78, 80, 89, 154, 155.
Kuka, Oso — 47.
Kuli, Marka — 291.
Kullurioti, A. — 191, 222.
Kun, J.G. (Coon, J.G.) — 280.

L

Lajar (Layard) — 90, 162, 208, 223.

Leka, Cen — 17.
Lenin, V.I. — 122, 241.
Leskoviku, Rustem Pashë — 60.
Libohova, Neki Pashë — 186.
Lik, U.M. (Leake, W.M.) — 275.
Lipih, M. (Lippich, M.) — 91, 93,
162.
Logoreci, Isuf Sokol — 232.
Lovie, R. (Lowie, R.) — 280.
Luarasi, Petro Nini — 63.
Luis — 276.
Lule, Dhimo — 70, 72.
Lushnja, Abaz bej (nga familja e
Ngurzajve) — 9.

M

Mahmudi (sulltan) — 154.
Mahmut Pasha — 8.
Majer, G. — 69, 70, 71, 79.
Marks, Karl — 40, 58, 97, 255, 283.
Masar Pasha — 43, 44.
Mashi, A. — 268.
Mashi, Engjëll — 27.
Mati, Xhelal pashë — 49.
Mehmet Aliu i Egjiptit — 9, 10, 11.
Mehmet Ali Pasha — 127, 128, 225.
Meksi, Petro — 158.
Merxhani, B. — 275.
Milani, Mark — 133, 146, 204, 217.
Mitrail, F. — 66.
Mitko, Thimi — 33, 34, 57, 59, 65,
66, 67, 69, 72, 73, 77, 78, 80, 189,
190, 191, 213, 222, 269, 272.
Mitrovica, Ago Pashë — 181.
Mithat Pasha (kryeministër turk)
— 106, 214.
Monti, G.M. — 81.
Mosi, Hil — 296.
Muhtar Pasha — 145.
Murati V (sulltan) — 106.
Mustafa Asim Pasha — 185.

N

Napoleoni III — 51.
 Naročnicki, V. (Naročnickij, V.) — 255.
 Neron — 295.
 Nerucos, T. — 75.
 Nesho, Balil — 5.
 Nikolla (princ) — 132, 145, 150, 151, 203, 204, 217.
 Nivica, Hodo — 21.
 Noli, Fan S. — 297.
 Nopça, F. — 275, 277, 278, 279.
 Novotny, A. — 81, 202.

O

Obare (Aubaret) — 93.
 Ognianova, E. — 262.
 Omer Efendi — 117, 175, 184, 185.
 Omer Pasha — 37.

P

Pema, I. — 67.
 Petridhi, P. — 69, 75, 78.
 Piqen, Anastas I. — 69.
 Pollo, Stefanaq — 5, 29.
 Preng (i biri i Bibë Dodë Pashës) — 53.
 Prishtina, Zija — 112, 119, 185.
 Promete — 70, 76, 77, 78.
 Pukëvil, F.C.H.L. (Pouqueville, F.C.H.L.) — 77.

Q

Qemali, Ismail — 60, 62.

R

Racel, F. (Ratsel, F.) — 276.
 Rama, Sokol — 18.
 Raznatoviç, N. — 237.
 Reguli, Atil — 296.

Riza Pasha 167, 168, 169, 171.
 Ruso — 248.
 Rushes, P.J. — 237.

S

Sadik Pasha — 175-176, 181.
 Said Pasha — 96.
 Santori, A. — 67.
 Schiro, G. — 81.
 Seceni, I. (Szécheny, I.) — 94.
 Seçenji (Szechenji) — 165.
 Sejmor (admirali anglez Seymour) — 168.
 Selišceviç, H.M. — 81.
 Senkjeviç, J.G. — 196, 202, 205, 208.
 Serembe, Zef — 65, 67.
 Skiroj, Gjon — 27.
 Sokoli, Hodo bej (Pashë) — 147-148, 149, 169, 171, 172, 174.
 Sokoli, Isuf — 171, 172.
 Sokoli, Mic — 183, 232.
 Sotiri, Pandeli — 63.
 Spahiu, Shuaip agë — 175, 185.
 Spenser, E. — 20.
 Stavrianos, I. — 238.
 Štojançeviç, V. — 237.
 Stulli, B. — 196, 208, 236.

Sh

Shanderl, H.D. (Schanderl, H.D.) — 235, 236, 238.
 Sheh Fejza — 45.
 Sheh Shamia (Hasan Alia) — 43, 44.
 Shieder, Th. (Schieder, Th.) — 247.
 Shiroka, Filip — 189.
 Shkreli, Dasho — 12.
 Shlajher, A. (Schleicher, A.) — 75.
 Shtadtmyler, G. — 236, 240, 246, 276.
 Shtir. T. (Stier, T.) — 75.
 Shuteriqi, Dhimitër, S. — 79.

T

- Tahsini, Hoxha Hasan — 60, 62, 142, 273.
 Tepelena, Ali Pashë — 14, 82, 246.
 Tetova, Hasan Pashë — 127, 140, 181, 185.
 Tetova, Sheh Mustafa — 117, 126, 131.
 Tissot — 202.
 Toçi, T. — 301.
 Todhri, Dhaskal — 60.
 Topia, Serafina — 28.
 Toptanasit — 294.
 Toptani, Esat Pashë — 294.
 Trojanovsk (konsull rus) — 42.
 Tukididi — 76.

Th

- Thëngjilli, Petrika — 5.

U

- Uçi, Alfred — 248.
 Urban, M. — 277.

V

- Vadington, U.H. (Waddington, W. H.) — 218.
 Vaja (nipi i A. Bykut) — 72.
 Vasa, Pashko — 50, 60, 62, 98, 99, 112, 114, 116, 142, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 222, 225, 232, 246, 247, 249, 250, 251, 270, 271, 272, 287.
 Vasaf efendi — 12.

- Vasiljević, I.H. — 81.
 Veqilharxhi, Naum — 23, 24, 25, 26, 27, 28, 33, 59, 60, 63, 65, 68, 72, 76, 77, 78, 79, 199, 200, 213, 247, 248.
 Viko — 267.
 Vinjak, St. — 296.
 Vladimiresku, Tudor — 23.
 Vlonjati, Demir aga — 18.
 Vlorë, Fered bej — 142.
 Vlorë, Mustafa Pashë — 131, 135.
 Vokshi, Sulejman — 117, 128, 147, 175, 183, 184, 185, 232.
 Volter — 298.
 Vreto, Jani — 34, 62, 68, 79, 80, 112, 119, 135, 141, 142, 144, 189, 190, 191, 205, 222, 232, 248, 249, 272.
 Vrioni, Hysen Pashë — 18.
 Vrioni, Isuf bej — 19.
 Vrioni, Mehmet Ali bej — 108, 136, 142, 186.
 Vukosavljević, S. — 240.

Xh

- Xhuvani, A. — 296.

Z

- Zarishi, Pjetër — 65.
 Zavalani, Dalip — 275.
 Zeusi — 245.
 Zografët — 72.
 Zografi, Kristaq — 60, 61.
 Zojzi, Rrok — 288, 292, 296.

Zh

- Zhapa, Vangjel — 33, 34, 69, 70, 72, 73, 75, 76, 78, 79.

TREGUESI I EMRAVE GJEOGRAFIKË

A

- Adrianopojë — 109, 204, 205, 215.
Adriatik — 48, 50, 103, 123, 132, 133, 153, 253, 278.
Adriatiku Jugor — 121.
Afganistan — 280.
Afrikë — 123.
Alsas — 160, 223.
Anadoll — 31, 42.
Anamal — 109, 110.
Artë — 37, 38, 121, 180.
Atikë — 191, 275.
Athinë: shih Greqi.
Austro-Hungari, Austri (Vien) — 37, 38, 46, 49, 52, 69, 81, 83, 85, 86, 87, 88, 90, 91, 92, 93, 101, 102, 103, 104, 108, 109, 110, 120, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 132, 136, 137, 145, 146, 150, 151, 152, 153, 161, 162, 163, 165, 166, 168, 169, 178, 179, 180, 188, 191, 203, 205, 207, 208, 209, 218, 220, 222, 224, 235, 236, 293, 294.
Azi — 294.
Azia e Mesme — 102.
- Ballkan, Gadishulli Ballkanik, Ev-ropa Juglindore — 27, 30, 36, 38, 47, 47-48, 48, 49, 51, 52, 57, 58, 61, 81, 84, 85, 86, 90, 91, 92, 100, 101; 102, 103, 104, 107, 108, 109, 110, 112, 117, 120, 122, 123, 124, 126, 137, 162, 163, 180, 197, 198, 201, 206, 208, 211, 214, 216, 218, 219, 221, 222, 223, 224, 235, 236, 246, 252, 253, 254, 264, 268, 270, 279.
Ballkani Lindor — 111.
Ballkani Perëndimor — 38, 85, 95, 122, 165, 257.
Beograd: shih Serbi.
Berat, Belgrad — 5, 6, 7, 8, 10, 14, 18, 20, 21, 24, 72, 124, 133, 158, 186, 241, (kështjella) 6, 8, 9, 10, 14.
Berlin: shih Gjermani.
Bilisht — 110.
Bizant, Perandoria Bizantine — 30.
Bolenë — 21.
Bohemi — 102.
Bosfor — 34.
Bosnjë — 49, 50, 83, 85, 87, 88, 100, 101, 102, 105, 106, 107, 108, 116, 118, 119, 120, 121, 123, 125, 126, 127, 128, 136, 140, 150, 161, 163, 192, 198, 207, 209, 218, 222, 290.
Brailë — 23.

B

Ballkan, Gadishulli Ballkanik, Ev-

Bregu i Matës — 292.
 Brindizi — 123.
 Britania e Madhe, Angli (Londër)
 — 36, 38, 39, 46, 49, 52, 60, 84,
 87, 88, 90, 91, 92, 101, 102, 106,
 107, 108, 109, 110, 113, 120, 121,
 122, 145, 150, 151, 152, 153, 161,
 162, 165, 169, 173, 179, 180, 188,
 191, 192, 204, 205, 207, 209, 210,
 218.
 Budapest: shih Hungari.
 Bulqisë — 45.
 Bullgari (Sofje) — 46, 81, 83, 100,
 101, 102, 103, 107, 109, 110, 114,
 116, 118, 119, 120, 177, 179, 192,
 196, 198, 204, 205, 218, 226, 253,
 255.
 Bunë — 38, 107, 109, 120, 144, 168,
 172.
 Butrint (liqeni) — 152.

C

Cem (lumi) — 149.
 Cernalevë — 183, 232.
 Cetinë: shih Mali i Zi.

Ç

Çamëri — 5, 6, 8, 19, 60, 86, 113,
 121, 152, 179, 270.
 Çikago — 237.

D

Dalmaci — 121.
 Dangëlli — 20, 159.
 Danillovgrad — 103.
 Danub — 36, 37, 105, 110, 120.
 Dardanele (ngushtica) — 36, 101.
 Delvinë — 5, 6, 8, 19, 21, 113.
 Deti Egje — 50, 110.
 Deti Marmara — 109, 133.
 Deti i Zi — 50, 101, 110.

Dibër — 5, 15, 17, 19, 44, 45, 46,
 49, 54, 96, 100, 107, 111, 127,
 131, 133, 169, 170, 173, 174, 175,
 177, 178, 181, 184, 185, 210, 227,
 231, 232, 242, 246.
 Dinosh — 144.
 Dishnicë — 9.
 Drini — 15, 17, 30, 107, 132, 133,
 204, 216, 217, 276.
 Drini i Zi — 110.
 Drinopojë — 6.
 Dukagjin — 53, 133, 246; (malësia)
 100, 102, 148.
 Dule — 183, 232.
 Durrës — 10, 50, 53, 99, 291, 294;
 (kështjella) 10.
 Dhrovian — 69, 75.
 Dholan — 21.

E

Edrene — 109, 133, 144.
 Egjipt — 8, 9, 10, 65, 66, 144, 190,
 191, 210, 226, 267.
 Elbasan — 6, 7, 8, 19, 21, 60, 61,
 93, 99, 125, 164, 185, 241, 242.
 Epir — 50, 94, 134, 190.
 Evropë — 58, 88, 92, 96, 101,
 155, 159, 160, 173, 178, 223, 270,
 271, 279, 280.
 Evropa Lindore — 48.
 Evropa Perëndimore — 55, 58,
 136, 141, 264, 267.
 Evropa Qendrore — 211.

F

Fanari Grek — 214.
 Ferizaj — 182.
 Fier — 11.
 Filat — 60.
 Frakull — 14.
 Françë, Perandoria Franceze (Pa-
 ris) — 36, 37, 38, 39, 44, 46, 51,

62, 85, 88, 101, 120, 123, 124,
130, 136, 152, 153, 160, 193,
211, 215, 218, 223, 225.
Frashër — 125, 130, 159, 222.
Fuqitë e Mëdha — 34, 35, 36, 46,
52, 59, 82, 85, 87, 89, 95, 101,
102, 107, 108, 110, 116, 120,
121, 122, 124, 126, 127, 136, 137,
138, 145, 146, 149, 150, 151, 152,
153, 161, 162, 166, 167, 168, 169,
170, 172, 173, 178, 179, 180, 192,
200, 205, 207, 218, 220, 221, 222,
223, 224, 227, 231, 236, 245, 248, 251,
252, 253, 254, 256.
Fusha e Kosovës — 182.
Fusha e Shtojit — 53.

G

Gadishulli i Krimesë — 36.
Gash — 147, 183, 184.
Gegëri — 8, 177, 190.
Gerçë — 256.
Gojan — 291, 292.
Gomsiqe — 291, 292.
Gostivar — 16, 107, 175, 242.
Greqi (Athinë) — 20, 21, 22, 29,
30, 31, 33, 37, 38, 47, 49, 50, 57,
69, 70, 72, 73, 86, 87, 92, 94, 95,
96, 109, 113, 114, 121, 124, 125,
133, 136, 137, 138, 144, 152, 161,
165, 166, 173, 174, 178, 179, 180,
181, 201, 202, 204, 205, 207, 210,
214, 217, 220, 221, 222, 227, 241,
292.
Greshnicë — 19.
Grudë — 10, 146, 147, 148, 149,
153, 166, 221, 232.
Gryka e Mozhurës — 45, 168, 172.
Guci — 19, 86, 110, 115, 116, 120,
124, 126, 144, 145, 146, 153, 175,
221, 232, 250.

Gj

Gjakovë — 12, 15, 16, 46, 53, 115,
117, 124, 126, 127, 128, 129,
130, 132, 139, 145, 147, 148, 175,
177, 184, 225, 241, 291; (malësia)
53, 184, 185.
Gjermani (Berlin) — 82, 85, 86,
87, 88, 89, 93, 94, 101, 102, 110,
115, 116, 118, 119, 120, 121, 122, 124,
126, 127, 128, 130, 132, 133, 134,
137, 139, 145, 151, 152, 153, 161,
162, 163, 165, 166, 179, 197, 199,
207, 209, 218, 220, 221, 224, 236,
240, 248, 253, 257.
Gjilan — 109, 175.
Gjiri i Burgasit — 50.
Gjirokastër — 5, 6, 7, 20, 21, 24,
33, 63, 69, 72, 73, 90, 93, 113,
124, 131, 143, 144, 157, 158, 159,
164, 170, 186, 192, 210, 226, 241.
Gjoricë — 17.

H

Has — 15.
Hercegovinë — 35, 37, 46, 50, 83,
85, 86, 87, 88, 100, 101, 102, 103,
105, 106, 107, 108, 111, 116, 117,
118, 120, 121, 123, 125, 126, 136,
145, 146, 150, 161, 192, 198, 203,
207, 209, 217.
Himarë — 21, 94, 164.
Hormovë — 70.
Hot — 109, 110, 146, 147, 148, 149,
153, 166, 221, 232.
Hotovë — 33.
Hungari (Budapest) — 57, 85, 108,
218.

I

Itali (Romë) — 27, 28, 47, 48, 51,
55, 65, 68, 81, 85, 87, 88, 89,

101, 102, 104, 105, 120, 123, 125,
136, 141, 173, 203, 206, 218, 250,
267, 271, 290, 293, 294.
Italia e Jugut — 160.
Izmir — 167.

J

Janinë — 8, 10, 17, 20, 21, 37, 38,
41, 49, 62, 69, 81, 82, 86, 89, 93,
99, 106, 107-108, 108, 112, 113,
118, 121, 125, 130, 134, 135, 137,
138, 140, 143, 149, 151, 152,
159, 164, 165, 180, 185, 201, 202,
204, 208, 210, 221, 224, 226.
Janjevë — 290.
Jon (deti) — 167.
Jugosllavi — 254, 294.

K

Kaçanik — 107, 175.
Kalabri — 27, 28, 48, 222.
Kalamas (lumi) — 86, 89, 94, 121,
134, 152, 153, 204, 221.
Kallarati — 21.
Kallmet — 51.
Kanali i Korfuzit — 152.
Kapllan — 17.
Kavajë — 8, 10.
Karidbi — 95.
Kaukaz — 280.
Kelmend — 86, 110, 147, 149.
Kërnice — 46.
Kishinev — 261.
Kleshë — 172.
Kolonjë — 5.
Konispol — 152.
Konjë — 42.
Korçë — 23, 24, 33, 34, 42, 65,
75, 110, 191, 222.
Korfuz — 32, 48, 113, 180.

Kosovë (Prishtinë) — 15, 16, 17,
20, 30, 44, 49, 54, 87, 93, 96, 100,
103, 110, 111, 115, 119, 120, 124,
125, 126, 127, 132, 133, 139, 142,
145, 146, 147, 148, 155, 159, 161,
164, 167, 170, 174, 175, 178, 182,
184, 185, 208, 210, 211, 224, 227,
229, 231, 232, 233, 237, 241, 242,
246, 288, 290, 291, 293, 302; (ma-
lësia) 54.
Kostandinopojë — 78.
Kotorr — 168.
Kozencë — 105.
Krajë — 109, 110.
Krasniqe — 184, 193.
Kretë — 49, 98, 118, 122, 179.
Krifcë — 15.
Krime — 37, 38, 43.
Krujë — 189, 292, 294.
Kthellë — 105.
Kuç — 21, 103.
Kumanovë — 16, 139, 175, 242.
Kurbin — 291, 292, 294.
Kurvelesh — 6, 19.

L

Labëri — 19, 21, 159, 161.
Labovë — 33, 72, 73.
Labovë e Zhapës — 73.
Laç — 292.
Lamia — 33, 69.
Larisë — 180.
Leipzig — 236.
Lekël — 33, 69.
Leningrad — 261.
Leskovik — 34, 143, 222.
Lezhë — 13, 139, 148; (malësia)
105.
Lëkurës — 113.
Lindja e Afërme — 36, 101.
Londër: shih Britani e Madhe.
Lorenë — 160, 223.
Lumë — 52, 115, 147, 148, 161,

175, 184.
Lunxhëri — 33, 158.
Luzat — 6.

M

Makje — 28.
Malësi, Malësitë — 128, 139, 104.
167, 172, 177, 185, 186, 277, 279,
292.
Malësitë e Veriut — 105, 147, 231,
272, 279, 291.
Mali i Zi, Zeta (Cetinë) — 12, 35,
37, 38, 43, 44, 45, 46, 51, 86, 88,
91, 92, 103, 104, 105, 106, 107, 109,
110, 111, 114, 115, 119, 120,
121, 125, 126, 127, 132, 136, 144,
145, 146, 147, 148, 149, 150, 151,
153, 161, 166, 167, 168, 173, 174,
185, 198, 203, 204, 205, 207, 214,
218, 220, 222, 224, 237, 252, 253,
292.
Maltë — 55, 60.
Mallakastër — 9, 11, 18, 19.
Manastir — 16, 17, 18, 20, 21, 89,
95, 99, 149, 170, 176, 202, 224.
Manastiri i Shëngjergjit — 152.
Maqedoni — 50, 57, 96, 110, 113,
116, 118, 120, 127, 133, 216, 276.
Mat — 19, 49, 53, 148, 242.
Mbishkodër (malësia) — 12, 110,
176.
Mbretëria e Mangiarëve — 71.
Mbretëria e Sardenjës — 36.
Mecovë — 38.
Medu — 103.
Mesaplik — 21, 22, 242.
Mesdhe — 27, 36, 90, 101, 110, 214,
218.
Mesdheu Lindor — 102.
Mirditë — 8, 12, 35, 38, 50, 51,
52, 53, 83, 86, 100, 103, 104, 106,
124, 138, 148, 176, 203, 215,

220, 246, 250, 291, 292, 294, 302.
Mitrovicë — 87, 110, 120, 121, 128,
161, 175, 184.
Moskë: shih Rusi.
Munih — 236, 247.
Myzeqe — 11, 14, 270.

N

Napoli — 71, 81.
Nevshkov — 145.
Ngushtica e Mesinës — 166.
Nish — 109, 120.
Nju Jork — 238.
Novi-Pazar — 86, 87, 116, 120, 123,
126, 130, 137.

O

Ohër — 7, 40.
Orosh — 105, 111.
Otranto — 123.

P

Palavli (fshat) — 21.
Palermo — 66.
Paris: shih Francë.
Pejë — 12, 55, 139, 148, 175, 184,
256, 291.
Pepiç — 145, 146.
Perandoria Osmane, Porta e Lar-
të, Turqia, Turqia Evropiane (Sta-
mboll) — 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13,
14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 29,
30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38,
39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47,
48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56,
57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 68,
69, 70, 74, 78, 79, 80, 83, 84, 85,
86, 87, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95,
97, 98, 99, 100, 101, 102, 104,
105, 108, 107, 108, 109, 110, 112,
113, 114, 115, 116, 117, 118, 119,

- 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127,
 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134,
 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141,
 142, 144, 145, 146, 147, 150, 151,
 152, 153, 154, 155, 156, 157, 159,
 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168,
 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175,
 176, 178, 179, 180, 181, 182, 184,
 185, 187, 188, 190, 191, 192, 193,
 194, 198, 199, 200, 201, 202, 203,
 205, 206, 208, 209, 210, 211, 212,
 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219,
 220, 221, 222, 223, 224, 226, 227,
 235, 236, 237, 239, 240, 243, 244,
 245, 248, 251, 252, 253, 254, 257,
 290, 294.
- Peshkëpi — 6.
- Peterburg — 102, 104, 108.
- Përmet — 7, 18, 19, 20, 24, 33, 72,
 73, 113, 143, 159.
- Pipër — 103.
- Pire — 38.
- Pirot — 120.
- Plavë — 19, 86, 109, 110, 120, 124,
 126, 144, 145, 146, 153, 221, 232,
 250.
- Podgoricë — 120, 144, 149.
- Pogradec — 42, 110.
- Pollog — 15, 16.
- Portat e Prizrenit — 183.
- Portëzë (fshat i Fierit) — 11.
- Postenan — 34.
- Postribë — 12.
- Prevezë — 113, 121, 130, 135, 151,
 179, 180, 186.
- Prishtinë: shih Kosovë.
- Prizren — 15, 16, 46, 52, 53, 54,
 62, 81, 84, 89, 93, 97, 99, 105,
 115, 116, 117, 118, 124, 125, 126,
 127, 128, 129, 130, 132, 135, 138,
 139, 140, 141, 146, 147, 148, 154,
 155, 156, 164, 169, 173, 174, 175,
 176, 177, 181, 182, 183, 184, 185,
 186, 187, 188, 194, 198, 202, 205,
 207, 209, 210, 222, 226, 227, 229,
 230, 241, 251, 256, 257, 290, 291.
- Prusi — 49.
- Pukë — 105, 148.
- Pulaj — 172.
- Pult — 133.
- Q**
- Qafë e Morinës — 184.
- Qafë e Peshkëpisë — 6.
- Qafë e Sinjës — 20.
- Qestorat — 63.
- Qipro — 121.
- R**
- Rëzë — 72.
- Romë: shih Itali.
- Rubik — 292.
- Rugovë — 110.
- Rumani (Bukuresht) — 23, 24, 25,
 28, 33, 69, 73, 81, 109, 144, 250,
 265, 267.
- Rumeli — 11, 12, 15, 84, 95, 98,
 103.
- Rumelia Lindore — 91, 93, 120,
 163, 208, 224.
- Rusi, BRSS, Bashkimi Sovjetik
 (Moskë) — 36, 38, 39, 49, 85, 87,
 90, 101, 102, 103, 104, 105, 106,
 109, 110, 113, 118, 120, 122, 137,
 144, 145, 152, 161, 188, 191, 196,
 201, 205, 208, 214, 215, 216, 218,
 224, 235, 252, 253, 254, 261.
- RR**
- Rrafshi i Dukagjinit — 16, 132, 133.
- S**
- Salaminë — 222.
- Sarajevë — 237, 255.

Sarandë — 113, 152.
 Serbi (Beograd) — 16, 29, 31, 47, 50, 57, 81, 102, 103, 106, 109, 110, 113, 114, 115, 119, 120, 121, 127, 133, 136, 177, 196, 198, 203, 204, 205, 214, 217, 218, 220, 236, 237, 240, 252, 253, 292.
 Serbia Jugore — 103.
 Serbia e Vjetër — 30, 102.
 Selanik — 32, 98, 118, 121, 181.
 Selemvria (lumi) — 86, 89, 121, 134, 152, 153, 180, 221.
 Sicili — 27, 48.
 Skillë — 95.
 Skrapar — 6, 9, 18.
 Slivovë — 183, 232.
 Spic (liman) — 121.
 Strumë (lumi) — 133.
 Suharekë — 183.
 Sul — 37.
 Sulovë — 9.

SH

Shalë — 292.
 Shënpal (i Mirditës) — 105.
 Shën-Stefan — 82, 83, 84, 108, 109, 110, 114, 115, 116, 118, 120, 121, 132, 133, 197, 199, 205, 215, 216, 218, 220, 237, 253, 255, 257.
 Shkodër, Skutari — 7, 8, 10, 11, 12, 13, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 46, 50, 51, 52, 53, 54, 60, 66, 81, 87, 89, 91, 92, 93, 94, 95, 99, 103, 104, 105, 109, 111, 115, 116, 118, 119, 125, 126, 132, 134, 139, 140, 142, 145, 147, 148, 149, 150, 153, 155, 161, 162, 163, 164, 166, 167, 168, 169, 171, 172, 174, 178, 192, 202, 203, 208, 220, 222, 223, 224, 226, 241, 242, 250, 291, 294, 296, 297; (kalaja) 12; (liqeni) 12, 47, 86, 107, 109, 120-121, 253; (malësia) 40, 93, 104, 162, 163.

Shkumbin — 30, 185.
 Shkup, Ysqyp — 139, 174, 175, 177, 181, 182.
 Shosh — 291.
 Shpati i Elbasanit — 61.
 Shpuzë — 144.
 Shqipëria Juglindore — 40.
 Shqipëria e Jugut — 6, 11, 13, 14, 18, 19, 20, 21, 22, 27, 32, 33, 36, 42, 49, 50, 62, 74, 75, 77, 108, 113, 124, 125, 132, 134, 135, 142, 157, 174, 175, 176, 178, 179, 201, 204, 240, 277.
 Shqipëria Lindore — 116, 119.
 Shqipëria e Mesme — 6, 50, 62, 74, 142, 170.
 Shqipëria Verilindore — 115, 116, 127, 129, 138.
 Shqipëria e Veriut — 7, 12, 30, 38, 44, 49, 50, 52, 54, 55, 57, 64, 98, 105, 115, 119, 127, 129, 133, 134, 138, 142, 150, 167, 178, 198, 203, 204, 240, 242, 276, 277, 279.
 Shtimlje — 183, 232.

T

Tepelenë — 5, 7, 9, 11, 33, 73, 241.
 Tetovë — 16, 17, 107, 127, 148, 167, 175, 177, 242.
 Tiranë — 5, 8, 19, 53, 69, 81, 185, 199, 229, 232, 248, 249, 258.
 Tivar — 37, 105, 120, 203.
 Tomoricë — 6, 9.
 Tomorr (mal) — 272.
 Toskëri — 8, 18, 21, 177, 242.
 Trakë — 50.
 Tripoli — 98, 123.
 Treni — 120.
 Trentino — 218.
 Tropojë (malësia) — 232.
 Troshan — 291.
 Tunizi — 123, 218.
 Tuz — 88, 148, 149, 150, 151, 168

Th

Thesali — 20, 37, 38, 49, 50, 118,
121, 129, 134, 152, 178, 180,
184,
Theth — 291.

U

Ulqin — 12, 13, 88, 91, 92, 95,
109, 110, 144, 153, 162, 163, 165,
166, 167, 168, 169, 170, 171, 172,
173, 174, 192, 209, 227, 231, 232.
Ura e Rzhanicës — 149.

V

Vardar — 276.
Velikë — 145.
Venedik — 192.
Vërçë — 9.
Vëslau (qytet austriak) — 50, 214.
Vithkuq — 23, 65.
Vjosë — 30, 152.
Vlorë — 5, 6, 7, 9, 11, 14, 18, 19,

60, 83, 113, 124, 131, 149, 256,
291, 294; (lumi) 123.

Vllahi — 23, 59, 78.
Voskopojë — 110.
Vraninë (ishulli) — 47.
Vranjë — 120.
Vuçitern — 175.

W

Wiesbaden — 236, 238.

X

Xixull — 45.

Z

Zagori — 58.
Zagreb — 196.
Zarë — 291.
Zymb — 288.

Zh

Zhabjak — 144.

PASQYRA E LËNDËS

	faqe
RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE	
LËVIZJA KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET 30-70 TË SHEK. XIX	5
1) KRYENGRITJET ANTIOSMANE NË VITET 30-40	
Kryengritjet popullore të vitit 1833	
Përpyjekjet për organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme (1834-1835)	8
Kryengritjet popullore të Shqipërisë së Jugut në vitet 1836-1839	13
Kryengritjet e Kosovës, të Dibrës dhe të Pollogut në vitet 1837-1845	15
Kryengritja e vitit 1847 në Shqipërinë e Jugut	18
2) IDEOLOGËT E PARË TË LËVIZJES KOMBËTARE	22
Naum Veqilharxhi dhe veprimtaria e tij në vitet 40	23
Lëvizja e arbëreshëve të Italisë në përkrahje të çështjes kombëtare shqiptare në vitet 30-40	27
3) KUNDËRSHTIMI I PLANEVE EKSPANSIONISTE TË SHTETEVE FQINJE. SHQIPËRIA DHE KRIZA LINDORE	29
«Megali Idea» greke dhe «Naçertanie-ja» serbe	
Lufta kundër «turkomanizmit» dhe «grekomanizmit»	31
Politika osmane në Shqipëri në vitet 1848-1853	34
Kriza Lindore e viteve 1853-1856 dhe Shqipëria	36
4) POLITIKA GRABITQARE E PORTËS SË LARTË DHE RIACARIMI I MARRËDHËNIEVE TË SHQIPTARËVE ME SUNDIMTARËT OSMANË DHE ME SHTETET FQINJE	39
Pasojat shkatërrimtare të Tanzimatit në Shqipëri	
Revolta e vegjëlisë shkodrane më 1854	43

Qëndresa kundër zbatimit të Tanzimatit në Shqipërinë e Veriut në vitet 1861-1862	44
Shqipëria në kuadrin e krizës ballkanike të viteve 60	46
Lëvizja e vitit 1862 në Mirditë	49
Konfliktet e reja shqiptaro-osmane në vitet 1867-1873	52
Rrymat politike në Lëvizjen Kombëtare në fund të viteve 60 dhe në fillim të viteve 70	54
5) KULTURA KOMBËTARE NË VITET 50-70	59
Përpjekjet për organizimin e shoqërisë kulturore dhe çështja e alfabetit të gjuhës shqipe	
Lëvizja letrare dhe botimet shkencore	63
TË DHËNA MBI LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET 1859-1861	68
ÇËSHTJA SHQIPTARE DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE NË VITET 1878-1881	81
LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR COPËTIMIT TË SHQIPËRISË DHE PËR AUTONOMI. LIDHJA E PRIZRENIT (1875-1881)	97
1) KRIZA LINDORE E VITEVE 1875-78 DHE SHQIPËRIA	
Shqipëria në prapësinë e Krizës Lindore	
Krizë ballkanike e viteve 1875-1877	101
Kryengritja e Mirditës në vitet 1876-1877	103
Memorandumi i Janinës (pranverë 1877). Fillimet e veprimtarisë së Abdyl Frashërit	106
Lufta Ruso-Turke 1877-1878. Traktati i Shën-Stefanit	108
Themelimi i «Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare»	110
2) FORMIMI I LIDHJES SË PRIZRENIT DHE VEPRIMTARIA E SAJ GJATË VITIT 1878	115
Lëvizja shqiptare kundër Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit, Formimi i Lidhjes së Prizrenit	
Kongresi i Berlinit dhe çështja shqiptare	120
Zgjerimi i lëvizjes popullore në Shqipëri. Ngjarjet e Gjakovës (korrik-shtator 1878)	124
Kërkesat e Lidhjes së Prizrenit për autonominë (nëntor 1878)	129
3) LUFTA E LIDHJES SË PRIZRENIT KUNDËR COPËTIMIT TË TOKAVE TË SHQIPËRISË, RRITJA E LËVIZJES PËR AUTONOMI (JANAR-QERSHOR 1880)	132

	faqe
Kërkesat e shteteve ballkanike kundrejt tokave shqiptare.	
Çështja e «Serbisë së vjetër» dhe e «Epirit»	
Lufta kundër administratës turke. Përsëritja e kërkesës për autonomi	138
«Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip»	141
Mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë (tetor 1879 — janar 1880)	144
Mbrojtja e Hotit dhe Grudës. Ashpërsimi i marrëdhënieve shqiptare-turke (pranverë 1880)	146
Çështja e kufirit greko-turk në Konferencën e Berlinit (qershor 1880)	151
4) ASHPËRSIMI I KONTRADIKTAVE NË GJIRIN E LIDHJES. KONFLIKTI PËR ULQININ (KORRIK—NËNTOR 1880)	153
Rrymat politike në gjirin e Lidhjes Shqiptare	
Kuvendi i Gjirokastrës (23 korrik 1880)	156
Abdyl Frashëri (1839-1893). Jeta dhe veprimtaria	158
Çështja e autonomisë së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare	161
Çështja e Ulqinit (gusht-tetor 1880)	165
Kuvendi i Dibrës. Dorëzimi i Ulqinit (tetor-nëntor 1880)	170
5) LUFTA E LIDHJES KUNDËR TURQISË	173
Lidhja e re e Prizrenit. Qeveria e Përkohshme	
Zgjidhja e konfliktit greko-turk dhe lëvizja shqiptare (shkurt-mars 1881)	178
Shpërthimi i konfliktit të armatosur me Turqinë	181
Shpërndarja e Lidhjes së Prizrenit	184
Rëndësia historike e Lidhjes së Prizrenit	186
Zhvillimi i letërsisë dhe i lëvizjes mendore shqiptare gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit	189
SHQIPËRIA NË VITET E KRIZËS LINDORE (1877-1881)	196
SHQIPTARËT PËRBALLË KRIZËS LINDORE TË VITEVE 1878-1881.	211
LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE RRËNJËT E SAJ HISTORIKE	229
ETNOGRAFIA SHQIPTARE DHE DISA PROBLEME TË SAJ	258
SH. K. GJEÇOVI (1874-1929). NGA JETA DHE VEPRIMTARIA	288
TREGUESI I EMRAVE	305
TREGUESI I EMRAVE GJEOGRAFIKË	311